

Prej kohësh vendet e Ballkanit Perëndimor janë përballur me konflikte ndëretnike dhe ndërfetare. Kjo nuk ka ndodhur mes popullsisë që kanë banuar në territorin e shtetit shqiptar, ku, si rrjedhojë e laicizmit të sistemit, u zhvilluan pluralizmi dhe toleranca mes pjesëtarëve të feve të ndryshme. Ky studim sjell analizën e statuteve të komuniteteve të ndryshme fetare, si fryt i shkrirjes së vetërregullimit të brendshëm të tyre me normat përpunuese të shtetit. Giovanni Cimbalo, profesor në Universitetin e Bolonjës, Itali, rindërton dinamikat mbi të cilat e drejta ka ngritur rolin e vet pedagogjik, edukues për bashkëjetesë, duke synuar të hedhë dritë mbi rrënjët e përbashkëta europiane.

Studime të së drejtës së krahasuar.  
E drejta kishtare dhe të drejtat njerëzore.  
Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri.

**Giovanni Cimbalo** ka lindur në Kozencë (Itali), më 31 gusht 1947. Është profesor i së Drejtës Kishtare në Universitetin e Bolonjës “Alma Mater Studiorum”. Mes botimeve të tij, përmendim: *I rapporti finanziati tra Stato e Confessioni religiose nei Paesi Bassi* (Milano 1989); *La scuola tra servizio pubblico e principio di sussidiarietà: legge sulla parità scolastica e libertà delle scuole private confessionali* (Torino 1999); *Le Regioni alla ricerca di una identità inesistente. La legislazione regionale tra “differenziazione dell’offerta formativa” e parità scolastica* (Torino 2003); *Laicità come strumento di educazione alla convivenza*, in S. Canestrari, *Laicità e diritto*, (Bologna 2007); *Problemi e modelli di libertà religiosa individuale e collettiva nell’Est Europa: contributo a un nuovo diritto ecclesiastico per l’Unione Europea*. Scritti in onore di Giovanni Barberini (Perugia 2009); *Le confraternite islamiche nei Balcani; un modelo di Islam europeo plurale*, in “Daimon”. *Annuario di diritto comparato delle religioni* (Bologna 2009); *Integración de los migrantes: un Islam plural para Europa*, in Alvares Conde, M. Salazar dela Guerra (eds.). *Estudios sobre la integración de los emigrantes* (Madrid 2010), *Il diritto ecclesiastico oggi: la territorializzazione dei diritti di libertà religiosa*, in “Il riformismo legislativo in diritto ecclesiastico e canonico” (Cosenza 2011); *L’Africa in miniatura. Prime note su diritto e religione in Camerun*, in F. Alicino, F. Botti (a cura di). *I diritti culturali e religiosi tra Africa ed Europa* (Torino 2011)

ISBN 978 9928-109-61-3



9 789928 109613

Çmimi: 1500 lekë/ 15 euro


GIOVANNI CIMBALO

# Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri

Giovanni  
Cimbalo

Studime të së drejtës së krahasuar.  
**E DREJTA KISHTARE DHE TË DREJTAT NJERËZORE.**  
Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri.

PLURALIZMI I BESIMIT DHE  
KOMUNITETET FETARE NË SHQIPËRI



Giovanni Cimbalò

**Pluralizmi fetar  
dhe liria e besimit në Shqipëri**

Studim monografik

*Kolana “Studime të së drejtës së krahasuar: e drejta  
kishtare dhe të drejtat njerëzore”, e drejtuar nga  
Giovanni Cimbalò.*

Përktheu në gjuhën shqipe prej origjinalit: Flora Koleci

Giovanni Cimbalo

*Pluralizmi fetar dhe liria e besimit në Shqipëri*

Studim monografik

Kolana “Studime të së drejtës së krahasuar. E drejta kishtare dhe të drejtat njerëzore”, e drejtuar nga Giovanni Cimbalo.

Titulli i originalit në italisht: *Pluralismo confessionale e comunità religiose in Albania*, Casa editrice and ©2012: Bononia University Press, Collana: Ricerche di Diritto comparato. Diritto ecclesiastico

“Authorised translacion from italian language edition published by Bononia University Press”

Përktheu në shqip nga origjinali: Flora Koleci

Redaktor: Naim Zoto

Në ballinë: Ana e pasme e një kartmonedhe frange [50 cent], ku paraqiten, në të njëjtin plan, disa kisha, një xhami dhe një teqe.

ISBN: 978-9928-109-61-3

Copyright në gjuhën shqipe: “Naimi” - shtëpi botuese dhe studio letrare

[www.botimenaimi.com](http://www.botimenaimi.com)



Përkthimi i këtij libri është financiar nga SEPS - Sekretaria Europiane per Botimet Shkencore - SEPS - Segretariato Europeo per le Pubblicazioni Scientifiche, Via Val d'Aposa 7, 40123 Bologna (Italia), Fax (+39) 051 265983: [seps@seps.it](mailto:seps@seps.it), [www.seps.it](http://www.seps.it)

**Kolana “Studime të së drejtës së krahasuar. E drejta kishtare dhe të drejtat njerëzore”, e drejtuar nga Giovanni Cimbalo.**

**KOMITETI DREJTUES:**

Francesco Altimari  
Giovanni Barberini  
Adoracion Castro Jover  
Nicola Colaianni  
Mariacristina Folliero  
Irena Ilieva  
Dionisio Llamasarez  
Fernandez Francesco  
Margiotta Broglio  
Enrico Vitali

**KOMITETI VLERËSUES:**

Roberta Aluffi, Gianmaria Ajani, Salvator Bushati, Antonio Chizzoniti, Raffaele Cop-pola, Giuseppe D’Angelo, Sara Domianiello, Nicola Fiorita, Jonas Juskevicius, Flora Koleci, Carlo Marzuoli, Roberto Mazzola, Giorgio Tassinari, Luciano Zannotti.

Në varësi të përmbajtjes së veprës për botim, komiteti drejtues harmonizon udhëzimet e komitetit vlerësues me ato të ekspertëve të tjerë.



## **Pasqyra e lëndës**

### **Parathënie**

Roli pedagogjik i së drejtës në edukimin e pluralizmit fetar

### **Kreu I**

**Zanafilla e modelit të marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri**

1. 1. Lindja e shtetit shqiptar
1. 2. Kongresi i Lushnjës. Organizimi i shtetit të ri
1. 3. Njohja e lirisë së organizimit të kulteve
1. 4. Monarkia e mbretit Zog dhe institucionalizimi i komuniteteve fetare
1. 5. Politika e mbretit Zog kundrejt Kishës katolike
1. 6. Marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare nga koha e pushtimit italian deri në Luftën e Dytë Botërore

### **Kreu II**

**Republika Popullore e Shqipërisë**

2. 1. Lindja e Republikës Socialiste të Shqipërisë dhe marrëdhëniet me komunitetet fetare. Rishikimi i parë i statuteve
2. 2. Reforma agrare dhe shpronësimi i pasurive të komuniteteve fetare. Ndalimi e shkollave fetare
2. 3. Ligji i ri për komunitetet fetare dhe statutet e tyre. Statuti i komunitetit Mysliman i vitit 1950
2. 4. Statuti i komunitetit Bektashian i vitit 1950
2. 5. Statuti i komunitetit Ortodoks i vitit 1950
2. 6. Statuti i komunitetit Katolik

### **Kreu III**

#### **Stina e marrëveshjeve: Shqipëria rikthehet në origjinë**

3. 1. Rilindja e lirisë së besimit, e ndërgjegjes dhe e pluralizmit fetar
3. 2. Ligji mbi shoqatat jofitimprurëse dhe shfrytëzimi i tij për rregullimin e marrëdhënieve me kultet
3. 3. Veçanëtia e modelit shqiptar
3. 4. Rilindja e Kishës katolike në Shqipëri.
3. 5. Marrëveshjet e dakordësisë me Kishën katolike. Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë harton statutin e vet
3. 6. Marrëveshjet e bashkëpunimit me myslimanët Sunitë, Bektashian dhe Kishën ortodokse autoqefale të Shqipërisë

### **Kreu IV**

#### **Hapja ndaj “kulteve të reja”: Shqipëria rilexon historinë e saj**

4. 1. Ungjillorët shqiptarë në mbështetje të gjuhës, kulturës, identitetit dhe të pavarësisë shqiptare
4. 2. Marrëveshja e bashkëpunimit me Vëllazërinë Ungjillore (VUSH). Përmbajtja dhe efektet lidhur me legjislacionin e zakonshëm dhe mbrojtjen e lirisë së besimit
4. 3. Drejt marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit: Hebrenjtë, Bahaitë, Dëshmitarët e Jehovahit...
4. 4. Magjia e Perëndimit: një ligj shqiptar për lirinë e besimit
4. 5. Shtrirja e efektshmërisë së marrëveshjeve mbi trevat e Shqipërisë etnike
4. 6. Marrëveshjet e bashkëpunimit: model i eksportueshëm?

### **Bibliografia**

## Roli pedagogjik i së drejtës në edukimin e pluralizmit fetar<sup>1</sup>

*E ardhmja i përket pluralizmit dhe tolerancës,  
për ta bërë të mundshme bashkëjetesën  
nën laicizmin e plotë qeverisës.*

Studimi i marrëdhënieve mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare paraqet tipare të veçanta, duke qenë se ky vend shfaqet si një “ishull” me shumicë islame në një rajon ku mbizotëron ortodoksia. Kriza e stërzgatur e Perandorisë osmane, që çoi drejt shpërbërjes së marrëdhënieve mes qeverisë dhe komuniteteve fetare, po shkëpuste gradualisht edhe lidhjen me modelet e statuteve vetjake, që mbizotëruan në Shqipëri, kryesisht gjatë asaj kohe kur zbatimi i kanunit ishte shprehje e së drejtës zakonore për gjithfarë grupesh etnike, pavarësisht përkatësisë fetare<sup>2</sup>.

Megjithatë, nga pikëpamja institucionale, deri në vitin 1913, komunitetet fetare u qeverisën nëpërmjet Mileteve përkatëse, pavarësisht reformave të ndërmarra nga Perandoria. Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, feksi njëherësh padobia e strukturave të tilla dhe nevoja e ngutshme për t’u njohur të gjitha besimeve fetare dinjitet dhe të drejta të barabarta, falë bindjes së plotë se

---

\* *Reflektime për një kërkim shkencor mbi marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri.* Parathënie e autorit për botimin italisht.

<sup>2</sup> Edhe pse më i njohuri ndër ta është Kanuni i Lekë Dukagjinit, ka edhe disa variante të tjera, si: Kanuni i Maleve, Kanuni i Skënderbeut i quajtur ndryshe i Arbërisë, Kanuni i Labërisë ose ‘Shartet e Idriz Sulit’. Përsa i takon origjinës dhe zbatimit të tyre, Kanuni i Lekë Dukagjinit ishte më i përhapuri dhe i ka rrënjët në Veri të vendit. Nga kjo zonë vijnë edhe Kanuni i Skënderbeut dhe ai i Maleve, ndërsa në Jug ishte më i përhapur Kanuni i Labërisë.



ndërtimi i kombit shqiptar kërkon të kapërcehen përçarjet e shkaktuara nga dasitë fetare, deri sa i gjithë populli me grupe etnike dhe fetare të ndryshme, të konvergojë në rrugën e përbashkët për ngritjen e shtetit të ri. Ngjarjet që pasuan kanë qenë objekt studimi më shumë për historianët sesa për juristët.

Kur vendi ra nën ndikimin italian, u rrit interesi i juristëve të huaj, paçka se ku i rastit e ku i mangët. Gjithsesi, nuk qenë të pakta studimet mbi problematikat që po shfaqte shoqëria shqiptare, qoftë edhe në përpjekjen për të rregulluar marrëdhëniet mes shtetit dhe besimeve fetare. Vëmendje e veçantë iu kushtua veprimtarisë së Kishës katolike në Veri të vendit, por edhe faktorit mysliman, po aq sa marrëdhëniet e tij me ngjarjet që kishin mbërthyer islamin në Turqinë e asaj kohe. Megjithatë, mund të thuhet se, deri më sot, nuk ka një studim mirëfilli juridik që t'i japë përgjigje shteruese zhvillimit të normave ligjore për çështjet e marrëdhënies mes shtetit dhe komuniteteve fetare, por as ndërhyrjeve të vazhdueshme për përpunimin e legjislacionit që, jo vetëm rregullon organizimin e kulteve, por, mbi të gjitha, u njeh atyre të drejtën fetare dhe pavarësinë për t'u vetërregulluar.

Vëmendjen e juristëve e tërhoqi më fort vëzhgimi i kanunëve, sesa shqyrtimi i hartimit të ligjeve shtetërore apo autonomia e veprimit ligjor të komuniteteve fetare, ndaj e patën të vështirë të kuptonin rolin përtëritës të burimeve të reja të së drejtës, e, sidomos, ndikimin e këtyre dinamikave të brendshme mes komuniteteve fetare dhe marrëdhënies të tyre me shtetin, pa folur këtu për qëndrimet vetjake të faktorëve të ndryshëm shoqërorë kundrejt përkatësisë fetare dhe funksioneve publike të ushtruara nga selitë e këtyre besimeve. Rezulton të jetë krejt i panjohur, madje i zhdukur fare, legjislacioni shtetëror për çështjet fetare, i hartuar në vitet '20 të shek. XX, madje, për shumë studiues, i pavlerë. Të njëjtin fat kanë pasur edhe burimet normative me zanafillë fetare, që nga krijimi i statuteve të para, të cilët janë shpërfillur e lënë pas dore, bash nga vetë komunitetet fetare. Ndaj e pamë të udhës ta fillojmë punën me gjurmimin dhe mbledhjen e këtyre materialeve, që i ofrojmë në shërbim të komunitetit shkencor nëpërmjet sitit: <http://licodu.cois.it/albania>.

Një analizë krahasuese dhe përjasëse mes normave të miratuara nga këto dy burime ligjore, do të na lejonte të depërtonim më

thellë në shtigjet e historisë së këtij vendi, për të hedhur më shumë dritë mbi ndryshimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve institucionale mes komuniteteve fetare dhe shtetit; të kuptojmë ç'ndikim ka pasur kjo në formimin e mendësisë mbi përkatësinë fetare dhe ç'trajtë ka sot ushtrimi dhe pjesëmarrja në jetën fetare.

Legjislacioni Zogist i periudhës së Monarkisë duket se pati më shumë fat, por vetëm për faktin se u rikthye në fuqi, qoftë edhe për aq pak kohë, menjëherë pas rënies së regjimit, në vitin 1991. Përkundrazi, legjislacioni i kohës së komunizmit mbeti i panjohur për faktin se nuk u përfshi në gamën e studimeve të krahasuara në fushë të të drejtave dhe lirive fetare për vendet e Europës Lindore. Në kohën kur ndërmerreshin studime të tilla, Shqipëria i kishte ndërprerë marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, për t'u hedhur në krahët e Kinës, gjatë rrugëtimit të saj drejt izolimit të plotë, gjë që do ta rrokulliste vendin: nga nismat për ndalimin dhe shkërmoqjen e të gjitha komuniteteve fetare, deri tek shpallja e shtetit ateist në Kushtetutën e vitit 1976.

Jo më parë se në vitin 1991, Shqipëria ia del të shkëputet prej këtij izolimi dhe t'u hapë rrugë marrëdhënieve me komunitetet e rilindura fetare, pa shpërfillur lidhjet e kahershme me historinë juridike dhe institucionale, çka kërkon më së pari rindërtimin e fazave të ndryshme të marrëdhënieve intensive mes shtetit shqiptar dhe fesë, një tipar i rëndësishëm për sistemin ligjor të këtij vendi.

Nga shqyrtimi i historisë kushtetuese, del se, që në zanafillë të shtetit të vet, Shqipëria moderne ka ndër parimet e saj themelore ndarjen mes shtetit dhe fesë, laicitetin e institucioneve, e kryesisht, pluralizmin fetar, i parë si formant i rëndësishëm i sistemit ligjor, një prej përbërësve themelorë për ndërtimin e unitetit kombëtar, si vlerë e epërme për vendin. Ky qëndrim bëri të mundur që i vetmi shtet në Europë me shumicë myslimane, të përpunojë një trajtë dhe vizion pluralist për islamin dhe të kapërcejë pengesat për proselitizëm të besimeve të tjera jo islame, edhe pse ky i fundit ka epërsi shifrash. Dekreti i vitit 1923, me anë të të cilit sistemi shqiptar vendosi kriteret për njohjen e personalitetit juridik civil për komunitetet fetare, përbën, ende sot, një prej normave më të përparuara për rregullimin e marrëdhënieve me kultet dhe një mjet të admirueshëm për

parandalimin e konflikteve ndërjetare, një instrument juridik që nuk i zbehet vlera e originalitetit që mbart.

Rishqyrtimi i legjislacionit mbretëror për çështje të marrëdhënieve me komunitetet fetare dëshmon se si Shqipëria, në fund të njëzetvjetëshit të parë të shekullit të shkuar, nuk qe aq larg debatit që përfshiu Europën Perëndimore për këto çështje. Përkundrazi, ishte përfshirë tërësisht në procesin e gjetjes së mjeteve tipike neo-juridiksionale, për menaxhimin e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, duke përshtatur me sukses mjetet juridike më efikase dhe më garantuese në krahasim me ato të vendeve të tjera që po rrotulloheshin në dredhën pështjelluese të marrëdhënieve të dakordësisë. Kjo u bë e mundur falë dështimit të çdo lloj ndikimi të huaj gjatë kohës mes dy luftërave, kur marrëveshjet e dakordësisë prekën nivelet më të larta juridike mes shtetit dhe kulteve, konkretisht me Kishën katolike.

Pamundësia për të nënshkruar një marrëveshje me këtë komunitet, që, për më tepër, përbënte pakicën në vend, e përqendruar kryesisht në veriperëndim të tij, nuk ndikoi aspak në rregullimin e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare. Gabon kush mendon se çelësi i leximit të marrëdhënieve mes shtetit dhe kulteve duhet kërkuar te mungesa e nënshkrimit të marrëveshjes me Selinë e Shenjtë. Ata mund të nisen nga nostalgjia e largët për shartimin e normave juridike të së drejtës kolonizuese italiane në Shqipëri, çka ndodhi gjatë bashkimit me mbretërinë italiane, por këto norma, përveçse të mangëta, përbëjnë një element të huaj për traditën juridike shqiptare. Ndryshe do të mbijetonin, së paku pjesërisht, pas pushtimit ushtarak italian dhe atij gjerman.

Shumë është folur e përfolur për mbijetesën e kanunëve të ndryshëm dhe për ndikimin e tyre në shoqërinë e sotme shqiptare, duke i mëshuar idesë se normat zakonore të katundeve kanë dalë mbi ligjin shtetëror. Nuk mund të mohohet se kjo ka ndodhur deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, por, të këmbëngulësh që ende sot vepron e drejta kanunore në Shqipëri, do të thotë se je në padije të plotë për ndryshimet themelore në shoqërinë e sotme shqiptare, ku pjesa më e madhe e saj, tashmë është urbanizuar dhe shtresat klanore të dikurshme janë shpërbërë.

Për më tepër, mbijetesa e së drejtës zakonore u luftua ashpërsisht nga regjimi komunist për dyzet vjet me radhë, por goditjen më të fortë ia dha shoqëria konsumiste e propaganduar zhurmshëm nga televizionet, gjersa erdhi e kulmoi me ekonominë e tregut, këtu e njëzet vjet tashmë.

Thënë kjo, një ndër pyetjet që pret ngutshëm përgjigje, e që do të analizonte zhvillimin e marrëdhënieve mes shtetit dhe kulteve në Shqipëri, kërkon të kuptojë nëse pati ndryshim legjislacioni shqiptar i regjimit komunist nga ai i vendeve të tjera socialiste dhe në ç'masë, meqë ai nuk u analizua kurrë aq thellësisht, sa gjegjësit e tij lidhur me çështjet fetare. Pengesat qenë nga më të ndryshmet, duke filluar nga vendi që zinte Shqipëria në familjen e shteteve socialiste, për të vazhduar me mosnjohjen e shqipes; vështirësinë për t'iu qasur burimeve normative; peshën relative të këtij vendi në arenën ndërkombëtare, mjafton të përmendim mjerimin e tij ekonomik.

Sidoqoftë, nëse kërkojmë t'i shqyrtojmë në rrafsh krahasues legjislacionet e bllokut Lindor për çështje të fesë, kjo analizë duhet mbështetur, doemos, në kriteret e propozuara nga Giovanni Barberini. Kështu vepruam në këtë studim që mbështetet në punën prej pionieri të këtij studiuesi të shquar, të cilin e falenderoj me shumë dashamirësi për gatishmërinë, për mençurinë dhe miqësinë e tij. Kushdo që i futet studimit mbi problematikat e sotme dhe zgjidhjet juridike të zbatuara në Europën Lindore, lidhur me marrëdhëniet shtet-komunitet fetar, puna e tij duhet të zërë fill nga rezultatet e vyera të këtij studiuesi të nderuar.

Republika e Shqipërisë, e dalë nga lufta antifashiste dhe antinaziste, çmoi si një ndër parimet themelore të saj ndarjen e shtetit prej fesë, jo si diktat i ideologjisë marksiste-leniniste, por si fryt i përvojës historiko-institucionale të vendit, duke qenë se ajo përbën një gur të palëvizshëm në ndërtesën e kahershme kushtetuese. Liria e ndërgjegjes buronte drejtpërdrejt nga pluralizmi fetar i sistemit shqiptar, pavarësisht se më vonë u përforcua nga parimet e marksizmit, deri aty sa u bë parimi themelor i sistemit kushtetueses të vitit 1976, ku, pikërisht në mbrojtje të lirisë së ndërgjegjes, por nën dritën e tezës marksiste, u shpall bujshëm ateizmi i shtetit, një qëndrim ekstrem dhe i pashoq

i Shqipërisë brenda bllokut Lindor, edhe pse, formalisht, ndiqte të njëjtën linjë ideologjike me të.

Lidhur me qeverisjen mbi çështjet e fesë, edhe shteti shqiptar parashikoi formimin e strukturave për funksionimin e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, duke filluar me ngritjen e një zyre shtetërore për çështjet e kultit, që vërtet përkonte me gjegjëset e saj në vendet Lindore, por, zaten, një zyrë e tillë në Shqipëri funksiononte që në kohë të monarkisë. Po asaj kohe i përkasin procedurat për njohjen e besimeve fetare, për regjistrimin e tyre si dhe për dhënien e personalitetit juridik që gjejnë shprehje në të drejtën shqiptare, që në vitin 1923, sipas normave të së drejtës civile, që u konsoliduan në Kodin Civil të vitit 1928. Për këtë dëshmon ligji i vitit 1929 mbi njohjen e personalitetit juridik civil për komunitetet fetare, pasi aty janë rimarrë një sërë normash nga legjislacioni i mëparshëm, duke krijuar një standard modeli statutesh që u siguron të gjitha besimeve trajtim të njëjtë nga shteti. Një qëndrim tjetër tipik i juridiksionit shqiptar vihet re gjatë legjislacionit komunist, jo vetëm për mënyrën se si miratoheshin në postet e tyre drejtuesit e kultit, por edhe se si duhet t'i mbanin ata marrëdhëniet në nivel ndërkombëtar. Me këtë rast iu mëshua fort 'shqiptarisë' së komuniteteve fetare, si përpjekje për të shmangur çdo lloj qëndrimi vartës apo afrie të tepruar me qendrat fetare jashtë vendit.

Kjo sa u takon normave lidhur me ushtrimin konkret të lirisë së besimit, ndërsa, lidhur me normat që rregullojnë pasurinë e komuniteteve fetare dhe përqasjen e tyre me vendet e tjera socialiste, si, bie fjala, ligji i konfiskimit të pasurive fetare, sidomos i tokave, pas hyrjes në fuqi të reformës agrare të vitit 1949, edhe këtu duhet thënë se legjislacioni shqiptar karakterizohet nga një ashpërsi në rritje kundrejt masave të marra ndaj komuniteteve fetare, gjë që kulmoi me konfiskimin e plotë të të mirave të tyre, përndjekjen dhe persekutimin e pashoq të klerit, deri në ndalimin prerazi të shërbesave fetare, që në vitin famëkeq 1967. Problematikat e vendeve Lindore konvergojnë në një pikë kur bëhet fjalë për shkërmoqjen e këtyre regjimeve, pasi tradita relativisht e gjatë e tyre ka lënë gjurmë të thella në këto vende, ndaj meritojnë të shqyrtohen dhe analizohen në rrafsh krahasues për secilin syresh.

Nëse flasim për kohën e post diktaturës, mund të themi se ka më shumë dallime sesa të përbashkëta mes nismave ligjore në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera të Lindjes. Kushtetuta e re shqiptare nuk e mori menjëherë përsipër hartimin e normave lidhur me mbrojtjen e lirisë fetare apo të marrëdhënieve me kultet. Duhej pritur ca kohë për këtë, aq sa mbërriti yshtja prej organizmave ndërkombëtarë, e sidomos, prej Këshillit të Europës, ku Shqipëria nxitoi të bëhej pjesë e tij për t'i siguruar vetes legjitimitetin e nevojshëm ndërkombëtar. Përkundrajt avashllëkut lidhur me hartimin e normave në mbrojtje të lirisë fetare, qeveria e përkohshme shqiptare, ndryshe nga ajo e vendeve ish-socialiste, veprroi me zhdërvjellësi të admirueshme për zgjidhjen e problemeve konkrete lidhur me kthimin dhe kompensimin e të mirave të konfiskuara. Dëshmi për këtë është miratimi i ligjeve të veçanta dhe ngritja e një organi të posaçëm, si ai i *Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave*.

Marrëveshja e firmosur me Kishën Katolike në vitin 2002, ndryshe nga ajo e nënshkruar nga vendet me shumicë katolike, është një marrëveshje-kuadër, e cila, pasi përmend disa parime bazë, e fokuson vëmendjen në norma të tjera që lypin negociim nga komisione të ngritura *ad hoc*, e, mbi të gjitha, nga legjislacioni i së drejtës së përbashkët. Në këtë mënyrë shteti shqiptar përmbush nevojën e diplomacisë së Vatikanit për të nënshkruar vetë thujtje të gjitha marrëveshjet, edhe kur janë të dorës së dytë, me shpresën që është zgjidhja e duhur strategjike, pasi kjo i siguron Shqipërisë njëfarë legjitimiteti ndërkombëtar, siç ka ndodhur, fundja, me të gjitha vendet e tjera ish socialiste.

Në gjykimin tonë është e pavend t'i jepet më shumë rëndësi kësaj marrëveshjeje, sesa zbatimit të legjislacionit të zakonshëm për çështje me interes të përbashkët mes Kishës katolike dhe shtetit shqiptar. Kjo duhet parë më shumë si një mjet i veçantë për zbatimin e marrëdhënieve të negociuara me kultet, edhe pse lind nevoja e ngritjes së të ashtuquajtuajturve 'Komisione *ad hoc*', sipas marrëveshjes për rregullimin e çështjeve me interes të përbashkët. Të një rëndësie të veçantë duket se janë marrëveshjet e nënshkruara me komunitetet e ndryshme fetare, që dallojnë nga ato të Kishës katolike, për trajtimin juridik veçmas të kësaj të fundit, gjë që e zbeh lidhjen e saj me shoqërinë shqiptare,

pavarësisht përpjekjeve të shumta për ta shtrirë praninë e saj në vend. Me ndonjë përjashtim të rrallë, marrëveshjet, përgjithësisht, ndjekin një skemë të përbashkët, siç u veprua që me legjislacionin zogist, për të vijuar më me rigorozitet në atë komunist, por tashmë ka një frymëmarrje më të çlirët, në mënyrë që legjislacioni mbi komunitetet fetare të jetë sa më koherent, por edhe i njëtrajtshëm. Trajtimi i veçantë për Kishën katolike vihet re tek mbështetja për mbajtjen e klerit, sadoqë e pjesshme, duke qenë se shteti mbulon një pjesë të shpenzimeve të kulteve të ndryshme për mbajtjen e personelit fetar, siç ndodh në pjesën dërrmuese të Europës Lindore. Me sa duket, synimi është që të ndërtohet një sistem i përzier financimi, si shkrirje e donacioneve publike me apo private.

Liria e shkollimit është e garantuar, ashtu si dhe mësimdhënia fetare<sup>3</sup>. Trajtimi juridik i enteve kishtare rregullohet me ligj të posaçëm për besimin katolik, paçka se normat e parashikuara nuk kanë ndryshim nga legjislacioni për shoqatat jofitimprurëse, që u lejojnë të gjitha komuniteteve vetadministrimin e enteve përkatëse, provë është fakti që Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë e përkufizon veten në statut si shoqatë jofitimprurëse.

Nisur nga tiparet e sotme të legjislacionit shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve me kultet, gjykojmë se nuk mund të kuptohen bazat e këtij legjislacioni, nëse nuk shqyrtohen paraprakisht përvojat e hershme të tij dhe nuk vlerësohen elementet që i sigurojnë vazhdimësinë, jo vetëm me sistemin zogist, por edhe me mjetet juridike të përpunuara gjatë dyzet viteve të regjimit.

Një ndër arsytet që na shtyu t'i futemi këtij studimi ishte nevoja për të hetuar e zbuluar arsytet që e mbajtën Shqipërinë larg konflikteve ndërfaqetare, në një kohë kur trevat rreth saj, me përbërje etnike dhe fetare shumë të përafërt me të, nuk paqëtohen aq lehtësisht. Edhe pse e drejta, si e tillë, qëndron mbi strukturat konkrete, në shumë raste ajo luan rol vendimtar për edukimin e bashkëjetesës, pasi është e aftë të konsolidojë në jetën e faktorëve të ndryshëm shoqërorë, sjellje dhe struktura që shkojnë e përcaktojnë drejtpërsëdrejti marrëdhëniet ekonomike dhe shoqërore. Me fjalë

---

<sup>3</sup> Për rregullimin e kësaj çështjeje u miratua ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, i botuar në Gazetën Zyrtare nr. 87, datë 26.06.2012. Në këtë kohë, kishte përfunduar hartimi i këtij teksti.

të tjera, nëse përpunimi i rregullave të përbashkëta në raport me individët apo grupet bëhet në autonomi të plotë të këtyre grupeve, derisa t'u japin formën e statuteve përkatëse, atëherë, është shumë më e lehtë që këto rregulla të pranohen dhe asimilohen deri në atë shkallë, sa të bëhen pjesë e “traditës” kulturore dhe të gjejnë mbështetjen e një kuadri ligjor koherent, për t'u përkthyer në marrëdhënie njerëzore dhe ekonomike, siç është rasti i martesave mes besimeve të ndryshme, apo mes tyre dhe ateistëve; lënia në dorë të komuniteteve përkujdesjen për të mirat e përbashkëta etj. Të gjitha këto përkthehen në elementë strukturorë që përcaktojnë tiparet e një sistemi juridik e të një bashkësie shoqërore të caktuar. Vazhdimësia e këtij tharmi në jetën juridike shqiptare, pavarësisht përvojave të ndryshme politiko-institucionale të shtetit; natyra vetjake e rendit të tij kushtetues; vetëdija e fortë e “shqiptarisë” në popull që del mbi dasitë fetare, të gjitha këto kanë përcaktuar, brenda shoqërisë shqiptare, ato marrëdhënie që nuk u gjendet ekuivalentja në trevat përreth, sepse, atje, pavarësisht identitetit të gjuhës dhe përkatësisë fetare, as ka pasur dhe as nuk ka një strukturë shtetërore institucionale që t'i lejojë të drejtës shtetërore por dhe asaj fetare të kryejë një rol pedagogjik, edukues për bashkëjetesë.

Këto dinamika dolën në dritë, falë metodës studimore në rrafsh krahasues, duke ndjekur linjën e mjeshtrit të madh Francesco Onida-s. Që në hapat e parë të punës kërkimore për studimin e marrëdhënieve mes Kishës dhe Shteteve të Vendeve të Ulëta<sup>4</sup>, kjo qasje ka qenë dhe është pika kyç nga ku kanë nisur përsiatjet shkencore të autorit të këtyre radhëve.

Puna prej shumë vitesh në Universitetin e Firences është shoqëruar me shkëmbim të ndezur dhe të pandërprerë opinionesh të çmuara mes kolegëve, në lirinë e plotë të mendimit, por edhe në “kalimin e stafetës” thuajse në çdo seancë leksioni. Me vendim të titullarit të lëndës, paraqiteshim tre vetë para studentëve: profesori ynë, miku im, Luciano Zannoti, dhe unë për t'i dorëzuar stafetën njëri-tjetrit, në kuptimin që duhet të mbronim tri teza të ndryshme rreth të njëjtit argument. Kështu veprohej para çdo ore leksioni, me qëllim që, ne, studentët, të kishim stimujt e nevojshëm

---

<sup>4</sup> G. Cimbalo, *Marrëdhëniet financiare ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare në Vendet e Ulëta*, Milano, Giuffrè, 1989.



për një fazë parapërgatitore studimi, por veçanërisht për të na aftësuar që shprehja e pikëpamjeve të ndryshme të bëhej me sa më shumë dinjitet.

Këtij qëndrimi nuk i jam ndarë as gjatë punës së mëvonshme mbi kërkimin shkencor rreth sistemeve të ndryshme nga ai i së drejtës italiane, me bindjen se për të njëjtin problem mund të ketë më shumë se një zgjidhje. Prej këndej buron vetëdija për vlerën relative të së drejtës dhe rregullave të saj dhe metoda për t'i analizuar ato pa ngulur këmbë në teza të fabrikuara dhe paragjyquese.

Të çmueshme kanë qenë edhe takimet me prof. Francesco Margiotta Broglio-n, të cilit i detyrohem për këshillat e vazhdueshme, jo vetëm për të mos shpërfillur efektin e drejtpërdrejtë të normave në përcaktimin e sjelljeve individuale dhe kolektive, por edhe për t'i kushtuar vëmendjen e duhur zgjidhjes së problemeve nga sisteme të ndryshme ligjore dhe ndërvarësisë së pashmangshme të tyre në projektimin e kuadrit të përgjithshëm të marrëdhënieve mes shteteve dhe besimeve fetare, çka sjell dukurinë e “qarkullimit të së drejtës” dhe nxit nevojën për koherencë mes sistemesh. Këtu zë fill kujdesi për rindërtimin e përpunimit normativ, duke e gërshetuar atë me zhvillimin historik të institucioneve. Përvoja të tilla e orientojnë punën tonë, pikësëpari, në përjashtimin e prerë të çdo lloj kolonizimi juridik që tundon shpesh kahet politike dhe na përforcon vetëdijen se jo vetëm demokracia, por as e drejta nuk mund të eksportohet, dhe se një problemi mund t'i gjendet më shumë se një zgjidhje, që të gjitha juridikisht të vlefshme.

Këtu qëndron dallimi dhe formësohet qëndrimi kritik ndaj përdorjes së krahasimit, i cili s'duhet bërë kurrë mjet shartimi mes sistemesh të papërputhshme, sidomos kur njëri syresh u bie ndesh haptazi qëndrimeve autoktone që janë fryt i përvojave juridike të tjetrit, paçka se udhëzimet u përmbahen parimeve të sanksionuara nga e drejta ndërkombëtare, si: liria e ndërgjegjes; respekti për lirinë fetare; pluralizmi, toleranca, laicizmi dhe vlerësimi i kulturave të ndryshme. Kushteve të tilla mund t'u vihet përballë vlera e krahasimit, e cila s'duhet shndërruar në mjet për diktimin e një legjislacioni imponues, siç ka ndodhur kryesisht me vendet e Ballkanit.

Duhet të kemi përvujtërinë e nevojshme e të pranojmë se, nganjëherë krejt qorrazi e me pavetëdiqe, mund të na joshë mendimi se modelet 'tona' janë të epërme e të vetmit që u japin përgjigje nevojave për mbrojtjen e lirisë fetare, pluralizmit të besimit dhe laicizmit. Ky tundim ka marrë përmasat e një epidemie, sepse as që kujtohet kush ta kurojë, madje puna ka shkuar deri aty sa të mos shtrohet fare problemi i mbrojtjes dhe i promovimit të diversitetit, paçka se ngjishen bashkë shoqëri e sisteme krejt të largëta, jo vetëm gjeografikisht, por, pikësëpari, me histori, tradita e sisteme vlerash krejt të ndryshme.

Përvoja shqiptare tregon se sa e pavend është kjo sjellje karshi kokëfortësisë së fakteve, por edhe na ofron përvojën e sistemit të përpunuar prej saj, mbi të cilën duhet reflektuar për të kuptuar se si mund të sigurohet paqja fetare dhe bashkëjetesa në diversitet. Nëse ia dalim të reflektojmë deri në atë shkallë sa t'i hapim rrugë këtij procesi ballafaques, mund të themi se kemi ndihmuar, sadopak, në nxitjen për rishqyrtim kritik të bindjeve të sipërpërmendura.

Që kjo perspektivë të futet në hullinë e duhur, ndoshta janë pjekur kushtet për të shtruar këto pyetje: në ç'kuadër normativ mund të kultivohet njohja e veçantive të përkatësive të ndryshme fetare; në ç'mënyrë e në ç'kushte mund të kryhen negociatat për arritjen e objektivave; ç'dobi ka një ligj i posaçëm për lirinë fetare, që, padyshim anon në të mirën e përbashkët, por që i ka kufijtë e paqartë mes punëve të fesë dhe çështjeve të kulturës, ndërgegjes dhe solidaritetit, sidomos në ditët e sotme, që me hapjen e tregut fetar gjendemi përballë agjencive të shumta ku gërshetohet, por edhe kamuflohet e shenjta me bindje dhe përkatësi kryekëput të ndryshme dhe jo gjithnjë në sintoni me traditat dhe sjelljet e përbashkëta të njerëzve besimtarë. E për më tepër, ç'kuptim ka sot, që gjendemi përballë një pluralizmi fetar në rritje, të propozosh/imponosh, me pretekstin e marrëveshjeve të negociuara, paçka se duket sheshit sforcimi i anëtarëve me tradita dhe kultura të ndryshme, të shtrënguar të veshin të njëjtën 'uniformë', siç po bëhet në Itali me faktorët e ndryshëm të islamit, duke i yshtur të prezantohen nën të njëjtin emër.

Ky studim i fton të gjithë të rrokin vlerën e diversitetit dhe të veçantisë, mu në brendësi të sistemit të përgjithshëm të

marrëdhënieve me kulte për afërsisht të barabarta, nëpërmjet shqyrtimit të përvojave konkrete, e sidomos shfaqjes e rishfaqjes së tyre, sa në rindërtimin teorik, po aq, në mos më shumë, në rendin praktik, sepse vetëm kështu mund të vlerësojmë si duhet rolin e studimit krahasues. Lypset të shkojmë tej rregullit ligjor mbi të cilin ndërtohen marrëdhëniet shtet-kishë apo masave disiplinore në çështje fetare dhe të përqendrohemi tek domethënia konkrete që fitojnë këto rregulla, kur përballen, konkretisht, me çështje të ngutshme disiplinore, në mënyrë që mbi zgjidhjet e urta të ngrihet përvoja juridike. Paraqitja formale e parimeve dhe e mjeteve që i vijnë në ndihmë disiplinës për një fushë të caktuar, mund të duket si mbivendosje ndaj sistemeve të tjera, por punët qëndrojnë ndryshe, nëse faktet shfaqen dhe rishfaqen sërish. Prandaj nuk ka vend për paragjykime, e aq më pak për nivelime sistemesh të ndryshme nisur nga modele të përpunuara në mënyrë abstrakte, që më kot vlerësohen si të duhurit për zgjidhjen e problemeve mes palëve me interesa të ndryshme.

Ky studim paraqet një aspekt të parë të rendit sistematiko-rindërtues, por edhe metodologjik, sepse prek, si çështjen e klasifikimit të marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, po ashtu edhe qasjen që duhet të ketë studiuesi që në momentin e përballjes me to. Vend të veçantë në këtë studim zë edhe efektshmëria e sistemeve të të tjerëve (në rastin tonë, ai shqiptar), e cila mund të shërbejë për përmirësimin e marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme shoqërore dhe fetare, qoftë edhe në procesin e homologimit të këtyre sistemeve, si shprehje e globalizimit dhe e vlerave universale të disa parimeve e sidomos të rregullave për frenimin e qëndrimeve të pavend.

Nëse është e vërtetë që procesi i globalizimit dhe problematikat e integritetit të kontinentit evropian i japin përparësi rolit të pushteteve lokale për përmbushjen e detyrimeve ndaj lirive fetare, por që u lënë shteg sjelljeve 'benjamine' në kurriz të barazisë njerëzore, atëherë duhen gjetur mjetet dhe metodat për ngritjen e një discipline të përbashkët mbi fenomenet fetare, që siguron mbrojtjen e përbashkët dhe efikase. Procese të tilla nuk mund të shkojnë deri aty sa t'i bëjnë të paqena diversitetin, përvojat, traditat, qofshin dhe ato juridike, jo vetëm për vende të veçanta, por edhe për gjithë sa mbartin e sjellin me vete bashkësitë e emigrantëve me mënyrën e tyre të të jetuarit.

Integrimi nuk vjen nëpërmjet nënshtrimit, por falë respektit për identitetin dhe veçantinë e gjithsecilit; nuk vjen as nga homologimi, por duhet kërkuar në diversitetin e shumëfishtë, në rrënjët e historisë së popujve, në promovimin e pluralizmit që nuk ka jetë pa laicizmin e shtetit dhe të institucioneve. Dyndja në masë dhe pandërprerje e popujve e, bashkë me to, edhe përvojave të ndryshme të jetës, e ka shndërruar Europën në një zonë ku mbizotëron diversiteti kulturor dhe fetar. Në këtë kontekst, feks qëllimi praktik dhe jo vetëm akademik i këtij studimi. Përvoja shqiptare na ndihmon të ndjekim rrugën e duhur, në mënyrë që mbrojtja e komuniteteve që u mësyjnë territoreve të reja të mos prodhojë vlera regresive, për hir të lirisë së tjetrit.

\*

\* \*

Falenderoj: prof. Francesko Altamarin për shqyrtimet e vyera mbi Shqipërinë dhe shqiptarët; prof.as. Flora Kolecin për punën e çmuar me korrigjimin e çdo përkthimi; dr. Arens Çelën që më ndihmoi ta njoh dhe ta dua Shqipërinë, si dhe për ndihmën e madhe në gjetjen e burimeve; dr. av. Florian Kamsin për ballafaqimin mbi disa çështje dhe për informacionet e çmuara lidhur me Kishën Katolike në Shqipëri; dr. Federica Botti-in për drejtimin e sitit <http://licodu.cois.it>.

Falenderoj Arkën e kursimit të Ravenës, presidentin e saj të nderuar Antonio Patuelli-n, dhe presidentin e Fondacionit të saj, dr. Lanfranco Gualtieri-n, që e mbështeti financiarisht këtë kërkim shkencor.

Nuk falenderoj MURST-in dhe as sistemin universitar të kërkimit shkencor, pasi nuk kanë lënë rast pa më mohuar çdo lloj financimi për këtë kërkim shkencor, gjë që frenoi ndjeshëm mundësinë e shfrytëzimit të burimeve arkivore si në Tiranë, ashtu dhe Romë, duke cenuar pasurimin e tekstit me të dhënat e nevojshme.



## Kreu I

### Zanafilla e modelit të marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri

*Përmbajtja: 1.1. Lindja e shtetit shqiptar; 1.2. Kongresi i Lushnjës. Organizimi i shtetit të ri; 1.3. Njohja e lirisë së organizimit të kulteve; 1.4. Monarkia e mbretit Zog dhe institucionalizimi i komuniteteve fetare; 1.5. Politika e mbretit Zog kundrejt Kishës katolike; 1.6. Marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare nga koha e pushtimit italian deri në Luftën e Dytë Botërore.*

#### 1. 1. Lindja e shteti shqiptar

Më 28 nëntor të vitit 1912 u mbledhën në Vlorë 83 delegatë me përkatësi të ndryshme fetare, myslimanë dhe të krishterë, për të shpallur pavarësinë e Shqipërisë pas rreth pesëqind vjetësh sundimi turk. Shteti i ri mbledhi kuvendin kombëtar të përbërë nga 83 deputetë, ku u emërua një senat prej 18 anëtarësh dhe u zgjodh presidenti i përkohshëm i shtetit të ri, Ismail Qemal Vlora, i cili ngriti një drejtori prej katër anëtarësh<sup>5</sup>. Kufijtë e shtetit

---

<sup>5</sup> Ky organizëm e pati jetën të shkurtër, pasi njohja e pavarësisë së fituar dhe gjendja e saj u rregulluan nga Konferenca e Ambasadorëve, e mbledhur në Londër në dhjetor të vitit 1912, punimet e së cilës zgjatën deri më 29 korrik 1913. Aty morën pjesë gjashtë Fuqitë e Mëdha që përbënin “drejtimin evropian” nën drejtimin e ministrit të jashtëm britanik Sir Edward Grey. Konferenca shpalli përfundimin e Luftës së Dytë Ballkanike dhe vendosi ngritjen e shteteve të reja kombëtare, të dala nga shpërbërja e Perandorisë Osmane. Shqipëria, në mënyrë të veçantë, ishte nën shënjestrën e Italisë, e cila e shihte këtë shtet të ri nën sferën e ndikimit të vet. Shih. E. BUCCIOL, *Albania fronte dimenticato della guerra*, Portogruaro, Ediciclo editore, 2001, 18 ss.; R. MOSCA, *Il regime internazionale del Danubio, la guerra e altri studi*, Società carpato-danubiana, Budapest, 1943; F. L. GRASSI, *L'Italia e la questione turca 1919-1923. Opinione pubblica e politica estera*,

shqiptar u përcaktuan në Konferencën e Londrës 1912-1913 nga Fuqitë e Mëdha, të cilat u angazhuan në rishpërndarjen e sferave përkatëse të ndikimit të tyre dhe në shpërbërjen e pjesëve të Perandorisë Osmane<sup>6</sup>. Për garantimin e stabilitetit në trevat ballkanike, ata vendosën t'i hapnin rrugë statutit të parë të shtetit të ri sipas parimeve të liberalizmit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rregullimit të çështjeve të fesë<sup>7</sup> me qëllim që epërsia në

---

Torino, Ed. Zamorani, 1996. Një vështrim interesant mbi lindjen e shtetit shqiptar, parë nën këndvështrimin e gjendjes së përgjithshme ndërkombëtare është ai i sjellë nga F. JACOMONI DI SAN SAVINO, *La politica dell'Italia in Albania*, nelle testimonianze del Luogotenente del Re, Cappelli Editore, Rocca San Casciano, 1965, *passim*.

<sup>6</sup> Që me luftën e Krimesë, Fuqitë e Mëdha europiane hartuan një strategji të tyre për shpërbërjen e Perandorisë Osmane, fillimisht me pretendimin që në territoret e pushtuara prej tyre të mos zbatohet ligji dhe juridiksioni osman, e më pas duke shtrirë protektoratin mbi territoret e saj, siç ndodhi në vitin 1848 me Tunizinë. Kjo strategji politike vuri në përdorim përkatësinë fetare të popullsisë të Perandorisë Osmane si pretekst për të mbrojtur të drejtat e të krishterëve ortodoksë, katolikë dhe protestantë, duke i hapur rrugë shtrirjes së kolonializimit nga fuqitë europiane. Për të pasur dorë të lirë në territoret osmane, fuqitë europiane kërkonin heqjen e pengesave për proselitizëm, i cili, më shumë se nga myslimanët, pengohej nga ortodoksët, duke qenë se ishin të lidhur fort pas parimit të respektimit të "territorit kanonik", që e shihnin si mbrojtjen e vetme nga vrulli i katolikëve dhe protestantëve për konvertimin e besimtarëve. Kjo fazë politike është risjellë me përpikmëri, së fundi, nga R. BOTTONI, *Il principio di laicità in Turchia*, Profili storico-giuridici, Milano, Vita e Pensiero, 2012, 34.

<sup>7</sup> Lidhur me nocionin "territor kanonik" shih: *La nozione di territorio canonico nella tradizione ortodossa*, në "O Odigos", 3/2006, 10-20; O. Clement, Un vicariat extraordinaire du Trone oecuménique en Eurvepe occidentale, "Istina," t. 17, 1/1972; N. Daldas, Le statut de la diaspora orthodoxe, "Istina", 1995, 386 ss.; C. Papatthomas, Essai de bibliograph pour l'étude des questions de l'autocéphalie, de l'autonomie et de la diaspora, Epektasis, 2000; ID., Le Patriarche oecuménique de Constantinople et le statut canonique de la "diaspora" orthodoxe de langue hélienne: le cas de la France, Atene, Editions Epektasis, 2001; ID., Les differents modalités canoniques d'exercice de la jurisdiction du patriarcat oecuménique de Costantinveple, in Istina, 4, 1995, 369 ss.; Papadopoulos Th., Geographical jurisdiction and hierarchy Ecumenical Patriarchate, Studies and Documents Relating to the History of the Greek Church and people under Turkish domination, "Bibliotheca Graeca Aevi Posterioris", Brussels, 1952, 543 ss.; P. Rodoupolos, Territorial Jurisdiction according to Orthodox Canon Law, Territorialità e personalità nel diritto canonico ed ecclesiastico, Budapest, 2002, 207-224.

numër e popullsisë myslimane<sup>8</sup> të mos bëhej pengesë për bashkimin kombëtar. Formimi i shteteve kombëtare në hapësirat ballkanike u bazua në kriterin e përkatësisë fetare të shumicës, si një prej elementeve dallues e, për rrjedhojë, si një prej faktorëve stabilizues të hallkave të reja institucionale. Prandaj, u pa e nevojshme që ky kriter të zbatohet edhe për Shqipërinë.

Sidoqoftë, natyra klanore e shoqërisë shqiptare shtronte problemin e kapërcimit të fragmentarizmit të strukturave që përcaktoheshin mbi bazën e etnisë apo kufijve të sundimit feudal të një familjeje. Në këto zona zbatohet kanuni, një tërësi rregullash juridike tradicionale, origjinës së të cilit nuk i gjendet filli lehtësisht në kohë<sup>9</sup>. Kanunët, në mungesë të fuqisë së duhur të

---

<sup>8</sup> Interes të veçantë paraqet përbërja e islamit shqiptar, i karakterizuar nga shumica Sunite dhe një numër i konsiderueshëm vëllazërisht, ndër të cilët më e madhja është, padyshim, ajo Bektashiane. Lidhur me bektashizmin, në vija të përgjithshme, shih: A. PVEPOVIC., *Le confraternite sufi nell'area balcanica, Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo. Il difficile equilibrio tra mistica e politica*, (nën kujdesin e Marietta Stepanyants), Torino, Qendra e studimeve fetare të krahasuara (*Centro di studi religiosi comparati*) Edoardo Agnelli 2008, 181-206; P. ANDRE, *Contribution à l'étude de Confréries religieuses musulmanes*, Alger, Les Maisons des Livres, 1956; G. CIMBALO, *Le confraternite islamiche nei Balcani: un modello di Islam eurvepeo plurale*, "Daimon". Annuario di diritto comparato delle religioni, Il Mulino Bologna, 2009, 225-248. Kjo është arsyeja që islami shqiptar, gjenetikisht, ka karakter të shumëfishtë në organizimin dhe në ushtrimin e kultit, ndaj është i aftë të bashkëjetojë dhe të gëzojë të njëjtin trajtim si besimet e tjera, edhe pse përbën shumicën në vend. Që në zanafillë të vet, Shqipëria nuk ka qenë kurrë shtet islamik, por laik, duke dalë jashtë kornizave të trevave të Ballkanit Perëndimor e sidomos të Europës Lindore. Rreth islamit shqiptar dhe atij ballkanit në përgjithësi, shih: G. CIMBALO, *L'esperienza dell'Islam dell'Est Eurvepa come contributo a una regolamentazione condivisa della libertà religiosa in Italia*, in *Identità religiosa e integrazione dei Musulmani in Italia e in Eurvepa* (omaggio alla memoria di Francesco Castro, Roma 22 maggio 2008), (nën kujdesin e R. Aluffi Beck-Peccoz), Torino, Giappichelli, 2011, 71-104.

<sup>9</sup> Botimi i përmbledhjes së rregullave të trashëguara gojarisht, u bë në vitin 1933 në Shkodër, nën titullin *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, autor i të cilit ishte prifti i rregullit françeskan, at Shtjefën Gjeçovi. Ky kanun, i përhapur kryesisht në zonën malore të Shqipërisë së Veriut, në Mirditë, përmban kodifikimin e normave etike, ku bazohet rregullimi i jetës së banorëve të asaj zone. Kanuni përbënte një sistem vlerash, nëpërmjet të cilit bëheshe pjesë e jetës shoqërore dhe fitoje identitetin vetjak. Për një analizë më të zgjeruar të kësaj vepre, shih: *Il Kanun di Lekë Dukagjini*, (nën kujdesin e D. Martucci-t), Nardò (Lecce), Besa editore, 2009. Për të kuptuar më mirë zbatimin konkret të kanunit në jetën shqiptare, vlen të lexohet: I. KADARE, Prilli i thyer (*Aprile spezzato*), Milano, Longanesi, 2008.



shtetit për vënien e diktatit të ligjshmërisë, pranoheshin dhe respektoheshin nga e gjithë popullsia si rregulla bashkëjetese, të mbështetura në traditë, por të cytur, gjithaq, nga pushteti i padiskutueshëm i zotërve lokalë dhe i Kishës katolike. Për këtë dëshmon fakti që sistemi ishte më i përhapur në veri të vendit, kryesisht në zonat malore ku shumica e popullsisë i përket besimit katolik<sup>10</sup> (edhe sot e kësaj dite, kanuni mbijeton në disa zona). Forca e tij qëndron në faktin se ai është një sistem i vërtetë vlerash që vishet me pushtetin e administrimit të një komuniteti për të siguruar respektimin e rregullave dhe forcimin e asaj kulture që ka në themel nderin, mikpritjen, krenarinë, vetëmbrojtjen dhe që është ngushtësisht i lidhur me vlerat e tokës dhe me ekonominë rurale, që mbahet në këmbë nga fshatarë të thjeshtë dhe familje të mëdha luftëtarësh.

Nga ana tjetër, sundimi mysliman, me përkujdesjen e nevojshme për të ruajtur ekuilibrat e pushtetit lokal, nuk iu kundërvu kurrë kësaj prirjeje, por u mjaftua me kërkesën për të vjelur taksa në të holla dhe në forca ushtarake për t'u bërë ballë luftërave të ndryshme. Myslimanët ia dolën të konvertonin në fenë e tyre një pjesë të shqiptarëve duke zbatuar heqjen e taksave për krerët e familjeve (deri aty sa për një kohë të gjatë u shfaq dukuria e laramanisë: mysliman në publik, i krishterë në jetën private) dhe me mundësinë për të bërë karrierë në ushtri, mundësi kjo që shqiptarët ditën ta shfrytëzojnë duke u bërë gjeneralë dhe funksionarë të lartë të Perandorisë. Osmanët e toleruan përdorimin e kodit kanunor ndër shqiptarë dhe zbatuan të njëjtat rregulla si për Kishën dhe drejtuesit e saj, ashtu edhe për Xhaminë dhe hoxhallarët. Për këtë arsye, edhe myslimanëve iu garantua nga

---

<sup>10</sup> Po të shqyrtojmë kanunin e Lek Dukagjinit, si më i ploti dhe më i vlerësuar i llojin e vet, shohim se libri i parë i kushtohet Kishës, ku trajtohen të drejtat, detyrimet dhe ndëshkimet prej saj, duke qenë se Kisha është një ent juridik, person moral me aftësi juridike për të zotëruar, për të blerë dhe shitur. Libri i parë ka në përbërje të tij 17 kapituj: 1. *Kuptimi i hijes së Kishës* 2. *Tagari i Kishës*. 3. *Paperlimsija e Kishës*. 4. *Ndera e Kishës*. 5. *Vorret*. 6. *Pronet e pasunija e kishës janë të paprekshme*. 7. *Rregullimi i pasunis së kishës*. 8. *T'emnuemit e famulltarit*. 9. *Tagari e detyrët e Famulltarit*. 10. *Vehtja e Famulltarit asht e paprekshme*. 11. *Rrogatari i Kishës*. 12. *Punterija e Kishës*. 13. *Amtyra e ndeshkimeve*. 14. *Të dhanunat e ndeshkimit*. 15. *Të caktuemit e ndeshkimeve*. 16. *Cilltia e ndeshkimeve kundra fajtorve të kishës* 17. *Caktimi i ndeshkimit mbas cillsis së fajit*.

kanuni mbrojtje juridike e të mirave të kultit. Nga ana tjetër, duke zbatuar doktrinën sociale të islamit, osmanët e panë të udhës të ndërtonin vakufet<sup>11</sup> (arabisht *Wafq* apo *hubus*), si masë bamirësie e fesë për besimtarët, çka sillte shtimin e numrit të të konvertuarve në fe dhe fitonte pëlqimin e të varfërve dhe klasave jo shumë të kamura<sup>12</sup>.

Por, nëse kërkohej që Shqipëria të zhvillohej dhe të vishej me cilësitë e shtetit modern, duhej shpërbërë një herë e mirë ky

---

<sup>11</sup> Termi Vakuf (nga turqishtja: *Vakıf*), i përdorur në statutet e para është varianti më i vjetër i termit modern Vakëf. Që këndeje e tujtje, ne do të përdorim termin Vakëf (term që i përket vitit 1984), për t'iu afruar më shumë kuptimit të tekstit për ato arsye që sjell edhe gjuhëtarja Gilles de Rapper "*Je conserve dans les propos recueillis dans le Devoll la prononciation locale (vakef) et j'emploie la forme standard (vakëf) dans le reste du texte. La forme vakuf se rencontre en Albanie centrale*". Cfr.: g. de rapper, Vakëf : lieux partagés du religieux en Albanie, Religions traversées. Lieux saints partagés entre chrétiens, musulmans et juifs en Méditerranée. (nën kujdesin e D. Albera-s, M. Couroucli-it), Arles, Actes Sud, "Études méditerranéennes", 2009, 53-83.

<sup>12</sup> Ky term emërton një fondacion islam mëshire, qëllimi i të cilit është jo vetëm të dëshmojë *pietas* për individin, por në të njëjtën kohë të ruajë të mirat dhe paprekshmërinë e tyre. Ky institut nuk është themeluar mbi Kuranin, por megjithatë, *waqf* është i lidhur ngushtë me një *hadit* të rëndësishëm ku thuhet që Muhameti iu drejtua me këto fjalë shokëve të tij: "*Me të vërtetë dyert për të hyrë në amshim janë të shumta: lavdëroni Allahun, adhurojeni, thoni se është një i vetëm dhe i madhërishtëm, pranoni të mirën dhe të drejtën dhe kundërshtoni të keqën dhe padrejtësinë, të shmangim çdo kërcënim gjatë ecjes sonë, të përkujdesemi për të vuajturit, të udhëheqim drejt dritës atë që është i verbër në rrugën e jetës së tij, t'i tregojmë nevojtarit atë çfarë ai kërkon, të lehtësojmë vuajtjet e të shtypurit, ta mbështesim të dobëtin me forcën e kraut tonë. Të gjitha këto janë shprehje të mëshirës dhe detyrim për ju". *Hadit-i* i sjellë nga al-Bukhari në përmbledhjen e tij të njohur as-Sahih i referohet vetëm llojit të parë të *waqf-it*, konkretisht, atij *Khayri*. Shih: EL-BOKHARI, *Les traditions islamiques*, traduites de l'arabe avec notes et index par O. Houdas, W. Marçais, Vol. II, cap. XIX, Parigi, 1977, Stampa anastatica, 259. Instituti njeh edhe forma të tjera të *Waqf-it*, ku ndër më të rëndësishmit është i ashtuquajtur *Ahli*. Në Shqipëri, ky institut shfaqet në formën më primitive të *waqf-it*, siç e përshekruan: S. MERVIN, *L'Islam. Fondamenti e dottrine*, Bruno Mondadori, Milano, 2004, 183-184 dhe u përkushtohet njerëzve në nevojë. Për llojet e ndryshme të *waqf-ve*, shih: A. D'EMILIA, *Il waqf ahli secondo la dottrina di Abu Yusuf*, Pubblicazioni dell'Istituto di diritto romano, del diritto dell'oriente mediterraneo, Roma, 1938; D. SANTILLANA, *Istituzioni di diritto musulmano malichita con riguardo anche al sistema shafita*, Roma, Istituto per l'Oriente, 1938; C. CAHEN, *Reflexion sur le éaqf ancien*, in "*Studia Islamica*", XIV, 1961, 37-56.*

sistem për t'ia lënë vendin laicitetit si mënyrë e re për të qeverisur besimet e ndryshme fetare, ashtu siç duhej ngritur në sistem ndarja mes shtetit dhe kulteve.

Në Shqipëri, ndryshe nga vendet e tjera myslimane, administrimi i pasurive fetare iu besua komuniteteve fetare, pikërisht për rrethanat në të cilat ishin ngritur këto pasuri. Administrimi i tyre, siç do të shohim, rregullohet në mënyrë të detajuar nga statutet përkatëse të komuniteteve fetare. Nga ana tjetër, sipas doktrinës myslimane, pushteti i përkohshëm nuk kishte për detyrë të ndihmonte të varfërit, por mjaftohej me ruajtjen e rendit publik. Për kapërcimin e kësaj mungese të ndjeshme të shtetit, u krijua *waqf-i*, i cili, që në zanafillë të shtetit islam, u shërbeu jo vetëm sovranëve dhe funksionarëve të lartë, por edhe tregtarëve të pasur dhe pronarëve të tokave, si mjet themelor për t'u siguruar atyre dhe bashkëqytetarëve të vet shërbimet publike bazë<sup>13</sup>.

Po ashtu, nuk dukej e volitshme t'i besohej fesë islame roli i eprorit në një kontekst europian ku kërkohej t'i jepej fund pranisë turke këndej Bosforit<sup>14</sup>. Për këtë arsye, në statutin e vitit 1914 pranohet se shteti shqiptar është laik<sup>15</sup>. Gjurma juridike e lënë nga ky sistem,

---

<sup>13</sup> G. VERCELLIN, *Istituzione del mondo musulmano*, Torino, Einaudi, 1996, 318 ss.; G. BAER, *The Waqf as a Prop for the Social System (Sixteenth-Twentieth Centuries)*, "Islamic Law and Society", Vol. 4, No. 3, (Brill, Leiden), 1997, 264-297.

<sup>14</sup> Në të vërtetë, Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike i ndryshuan ndjeshëm territoret e kontrolluara nga Perandoria Osmane, duke pëfshirë në konflikt të ashpër të gjitha shtetet e dala nga shpërbërja e kësaj Perandorie, të cilët këmbëngulnin në përmbushjen e synimeve territoriale. Arsyet e këtyre mosmarrëveshjeve, shpesh, kishin të bënin me faktin që ngjarjet apo negociatat diplomatike kishin vendosur që popullsi me etni të ndryshme të bëheshin pjesë e shteteve me etni tjetër. Lidhur me këtë çështje është shkruar shumë dhe mund t'i referohemi: E. Ivetić, *Le guerre balcaniche del 1912-1913*, "La Nuova informazione bibliografica", nr. 3, korrik-shtator 2007, 473-486. Së fundi: R. Bottoni, *Il principio di laicità in Turchia...*, 22.

<sup>15</sup> Statuti i vitit 1914 u përmbahet linjave kryesore të Londrës, gjë që tregon se edhe oligarkia shqiptare u kushtonte vëmendje të madhe këtyre problemeve. Në statut, flitet për kultet në katipullin XI, më konkretisht në nenet 170-177.

*170.- Të gjitha komunitetet fetare shqiptare ekzistuese njihen (nga shteti). Ky parim zbatohet edhe për sektet e ndryshme myslimane. Asnjë pengesë nuk duhet të nxirret për organizimin hirarkik të komuniteteve të ndryshme e as për marrëdhëniet që këto mund të kenë në çështje të dogmës fetare, me kryetarët e tyre shpirtërore më të lartë. 171.- Komunitetet fetare do të vazhdojnë të ruajnë pasuritë e tyre. 172.- Komunitetet do të vazhdojnë të marrin, nën mbrojtjen e*

bëri që shteti të njohë të gjitha komunitetet fetare shqiptare, duke vendosur epërsinë e vet mbi besimet e ndryshme pa e zbehur, ndërkohë, vigjilencën ndaj tyre<sup>16</sup>. Statuti pohon, gjithashtu, se në Shqipëri, në gjirin e besimtarëve islamë, ekzistojnë dy përbërës kryesorë: sunitët dhe bektashinjtë, prandaj lipsej të sigurohej, që në zanafillë të shtetit të pavarur, respekti për pluralizmin fetar<sup>17</sup>.

Për më tepër, nëse do të krijoheshin komunitete të tjera fetare, veç atyre ekzistuese, shteti parashikon t'i njohë ato dhe të përcaktojë të drejtat që u duhen njohur atyre, gjithnjë në përputhje me përvojën e legjislacionit turk, i cili njihte një numër të caktuar miletesh. Shteti nuk ndërhynte për emërimin e anëtarëve të

---

*autoriteteve, të ardhurat e konsakruara nga zakoni. 173.- Përrjashtohen nga taksat godinat që shërbejnë për kultet, për arsimin publik dhe për veprat bamirëse. 174.- Në rast se formohen komunitete fetare të reja të kulteve të ndryshme, shteti rezervon të drejtën t'i njohë dhe të përcaktojë të drejtat e tyre. 175.- Klerikët dhe paria e të gjithave komuniteteve fetare të njohura prej shtetit do të marrin investiturën nga lartësia e tij princi. 176.- Rregullimi i marrëdhënieve midis kishave ekzistuese në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të jetë objekti i marrëveshjeve të posaçme që do të lidhen midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve. 177.- Shteti duhet të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura si dhe të klerit duke caktuar për këtë qëllim shumën që do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror; do të ketë parasysh edhe pasuritë e patundëshme që kanë aktualisht këto kulte. Statuti organik i Shqipërisë 1914; Kapitulli XI, Kultet Neni , 170 177, sot në: <http://licodu.cois.it/547/view>*

<sup>16</sup> Si dëshmi për vlerësimin e barabartë që u bëhej komuniteteve fetare në shoqërinë shqiptare, mjafton të sjellim imazhin e shtypur në pjesën e prapme të kartëmonedhës prej 0,50 cent, që qarkullonte më së shumti tek shtresat popullore. Aty paraqitet një xhami, një teqe dhe disa kisha të vendosura në të njëjtin plan si dëshmi e pluralizmit të komuniteteve fetare dhe e barazisë mes tyre. Sistemi shqiptar është laik, por nuk i kundërvihet fesë, madje kërkon të bashkërendojë laicizmin me tolerancën dhe pluralizmin fetar.

<sup>17</sup> Në Shqipëri ka pasur historikisht disa vëllazëri më të vogla, ndër të cilat mund të përmendim: Rufaizma, Halvetizma, Kadirizma, Sadizma. Për më tepër shih: F.K. ALLAM, *L'islam globale*, Milano, Rizzoli, 2002; *Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo Il difficile equilibrio tra mistica e politica*, Torino, Fondazione Giovanni Agnelli, 2003, *passim*; G. DUIZINGS, *Religion and Identity in the Balkan*, London 1999; *Muslim Identity and the Balkan State*, (a cura di) H. Poulton e S. Taji-Farouki, Ëashington Square 1997; A. VENTURA, *L'Esoterismo islamico*, Roma, Atanor, 1981; ID., *L'Islam sannita nel periodo classico (VII-XVI secolo)*, *Storia delle religioni*, (a cura di G. Filoramo), vol. 3, Bari, Laterza, 1995. Relativamente al periodo trattato: G. H. BOUSQUET, *Notes sur les réformes de l'Islam albanais*, " *Révue du monde musulman* ", 4, 1935, 410 ss.

hierarkisë fetare, as për përcaktimin e dogmave apo për organizimin e besimeve fetare në vend. Kleri dhe krerët fetarë të të gjitha komuniteteve të njohura nga shteti, ngarkoheshin në detyrë pasi merrnin emërimin zyrtar nga Princi, i cili ushtronte të drejtën e *placet-it*, njësoj siç vepronte dikur Sulltani. Rregullimi i marrëdhënieve mes komuniteteve fetare ekzistuese në Shqipëri dhe krerëve të tyre shpirtërorë, përbën thelbin e marrëdhënieve që do të nënshkruhen mes qeverisë shqiptare dhe krerëve të këtyre kulteve. Sistemi shqiptar i përmbahet parimit bilateral në marrëdhëniet me komunitetet fetare si tipar dallues i formës së shtetit dhe të qeverisë, që në kohën e themelimit të tyre. Një ndër rrjedhojat e para të këtij qëndrimi është fakti që komunitetet fetare në Shqipëri, mund të mbajnë pasuritë e tyre dhe të vazhdojnë të gëzojnë mbrojtjen e shtetit. Sa i përket çështjes së tatimeve, do të lirohen prej barrës së taksave godinat e tyre të kultit dhe ato që përdoren për arsim dhe vepra bamirësie.

Shteti vendos për shumën që do t'u kërkohet komuniteteve fetare nga të ardhurat e deklaruara, gjë që bëhet duke u mbështetur në masën e pasurive të paluajtshme në pronësi të tyre. Përdorimi i gjuhës shqipe në shkollat e tyre do të jetë i detyrueshëm, por mësimi fetar mund të zhvillohet në gjuhën e kultit<sup>18</sup>. Ngritja dhe funksionimi i shkollave teologjike do të rregullohet nga ligje të

---

<sup>18</sup> Arsimit publik i kushtohet kapitulli XII i statutit: “179. - Në shkollat vendase mësimi në gjuhën shqipe është i detyrueshëm. Por mësimi fetar mund të bëhet vetëm në gjuhën e kultit. 181. Ngritja dhe funksionimi i shkollave teologjike, të mjeshtërive dhe të zanateve të arteve të bukura, si dhe i çdo arsimit teknik do të rregullohen me ligje të posaçme” në <http://licodu.cois.it/547/view>. Çështja e përdorimit të gjuhës gjatë mësimdhënies fitonte një rëndësi të veçantë, pasi shtetet e ndryshme që shfaqnin interes për Shqipërinë, financonin shkollat të ndryshme ku mësimi mbahej në gjuhët përkatëse të këtyre shteteve, gjithnjë me qëllimin që të forconin ndikimin e tyre në këtë vend. Në mbështetje të veprimtarisë shkollore dhe të përdorimit të shqipes, ishin përkthimet e teksteve fetare dhe shkollat e ngritura nga Vëllazëria ungjillore. Për më tepër, shih G. CIMBALO,, *L'Albania apre agli accordi di collaborazione con i "nuovi culti"*, Stato, Chiesa e pluralismo confessionale, tetor 2011. Përdorimi i gjuhës shqipe, në mos tjetër, kishte për qëllim të zbehte zonat e influencës së fuqive të huaja, qoftë edhe nëpërmjet kufizimit të përdorimit të gjuhëve fetare, si psh. arabishtes dhe greqishtes, vetëm gjatë celebrimit të riteve përkatëse. Kjo bëri që komunitetet myslimane të parashikonin në statutet e tyre përdorimin e gjuhës shqipe edhe si gjuhë liturgjike, ndërkohë që Kisha ortodokse e mori këtë vendim gjatë rrugës së vështirë për të fituar autoqefalinë.

posaçme. Siç shihet, kuadri juridik i marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare është i mirëpërcaktuar dhe mjaft përparimtar po të krahasohet me gjendjen e përgjithshme të vendit, që vuan në varfëri të skajshme dhe prapambetje të thellë, sadoqë popullsia nuk i kapërcen një milion banorë. Mund të flitet vetëm për dy qendra kryesore të jetës shoqërore dhe politike gjatë asaj kohe. Në veri, konkretisht në Shkodër dhe në rrethinat e saj, mbizotëron katolicizmi, me qendër rëndese rreth dioqezës së françeskanëve, nën varësinë e komisionit të *Propaganda Fide-s*, i cili dërgon në Shqipëri meshtarë, rregulltarë dhe emëron ipeshkvinj që i përkasin vetëm dhe vetëm ritit latin. Të pranishëm dhe aktivë janë edhe jezuitët, tradicionalisht të mbërritur nga provinca Lombarde e Italisë qysh kur kjo zonë ishte nën ndikimin austriak. Qëllimi i komisionit është që këto anë, të ndodhura për kohë të gjatë mes orvatjeve të kishës së Bizantit dhe asaj të Romës, t'i afrojë me traditën perëndimore, duke i ftuar popullsitë e kahershme katolike romake, të konvertuara në ritin bizantin, t'i rikthehen tërësisht ritit latin.

Elita shkodrane, prej kohësh, ruan lidhjet me komunitetin arbëresh të Italisë Jugore, sidomos me Kalabrinë, ku shërbesat fetare bëhen sipas ritit bizantin dhe kleri i atjeshëm u bën qëndresë të konsiderueshme përpjekjeve për t'i latinizuar edhe ata. E gjendur mes këtyre rrymave, bota shkodrane bashkëjeton me një shkëmbim të vazhdueshëm idesh, nga ato rilindase deri tek anarkistet, shtu këtu edhe ndikimin e të ardhurve të huaj në këtë krahinë, që marrin emra dhe kombësi shqiptare<sup>19</sup>.

---

<sup>19</sup> Një ndër figurat kryesore është padyshim ajo e Jeronim de Radës, i lindur më 1824 në Maq (Macchia Albanese) nga një familje e kamur. I ati i tij, meshtar i ritit grek bizantin dhe famullitar i Maqit, e orientoi De Radën drejt studimit të klasikëve latinë dhe grekë. Ndoqi studimet pranë kolegjit italo-grek të shën Adrianit në shën Mitër (it. San Demetrio Corone), ku u formuan katër drejtuesit e komunitetit arbëresh që u bënë pjesë aktive e Rilindjes. Në vitin 1834, shkroi veprën e tij më të rëndësishme "Milosao" dhe në vitin 1848 themeloi gazetën *L'Albanese d'Italia* (Shqiptari i Italisë), organi i parë i shtypit shqiptar, nëpërmjet të cilit u përhapën idetë më liberale dhe u mbrojtën të drejtat shoqërore (si në shkrimet e gazetës, ashtu edhe me anë të konferencave, shkrimeve dhe lidhjeve personale), u kërkua e drejta e popullit shqiptar dhe rilindja e tij politike dhe kulturore. Në vitin 1864 u botua varianti përfundimtar i veprës etnologjike "*Antichità della Nazione Albanese*". Veprimtaria e tij letrare u zhvillua paralel me përpjekjet e tij për çështjen kombëtare shqiptare. Gazeta e tij *Fiamuri i Arbrit*

Prania e dendur e katolikëve të ritit romak, e mbështetur financiarisht, fillimisht nga Austria, e më pas nga Italia me synimin për t'i zënë vendin ndikimit austriak, ka bërë që, sidomos në Shkodër të ngrihen shkolla dhe institute edukimi, edhe të niveleve të larta ku mësimdhënia kryhej më shumë në gjuhën italiane se atë shqipe. Kleri luajti rol thelbësor për ndërtimin dhe rindërtimin e kulturës vendase, sidomos duke u fokusuar në mbledhjen dhe ruajtjen e traditës juridike tradicionale, çka e dëshmon dhe kontributi i dhënë për hartimin dhe sistemimin e tekstit të kanunit të Lekë Dukagjinit. Lidhjet me intelektualët dhe politikanët e Italisë së Jugut, patën ndikim domethënës edhe në rritjen e qëndresës dhe të rolit të Shkodrës në luftën për pavarësinë kombëtare.

Në jug të vendit, jo shumë larg territorit grek, ka po ashtu jetë të gjallë kulturore, kryesisht në qytetin e Korçës, ku u ngritën disa institucione arsimore. Një ndër më të rëndësishmit është, padyshim, Liceu francez, por edhe shkollat e ngritura nga Vëllazëria Ungjillore<sup>20</sup>. E njëjta gjë mund të thuhet për zonën mes Korçës dhe Gjirokastrës, ku hasim struktura fetare sunite, por sidomos ato bektashiane, mes të cilave vlen të përmendet teqeja e Tomorrit ku u mbajtën disa kongrese të këtij komuniteti, si dhe teqeja e Baba Selimit, mjaft e njohur si pikë pelegrinazhi mes viteve 1920-1940.

Pozicioni i veçantë gjeografik i krahinës e lehtësonte komunikimin me qytetin e Selanikut, nga ku këto popullsi emigruan drejt Rumanisë dhe ngritën atje komunitete të rëndësishme në mesin e të cilëve kishte mjaft intelektualë aktivë dhe të vëmendshëm ndaj problemeve të vendit të tyre<sup>21</sup>. E njëjta gjë mund të thuhet edhe

---

(Il vessillo dell'Albania), denoncoi rolin e diplomacive europiane dhe marrëveshjet e nënshkuara në Kongresin e Berlinit mbi copëzimin e territorit shqiptar, duke u bërë zëri i popullit shqiptar që vuante këto pasoja. Në vitin 1895, me nismën e De Radës, u mbledh në Koriljano (Corigliano Calabro) "Kongresi I shqiptar", ku morën pjesë personalitetet më të larta shqiptare. Në fund të punimeve, pjesëmarrësit ranë dakord të hartonin një plan politik në mbrojtje të Shqipërisë dhe shqiptarisë si dhe një alfabet të njësuar për të gjithë shqiptarët. G. DE RADA, *Antichità della Nazione Albanese e sua affinità con gli Ellene i Latini*, Napoli, Stamp. dell'Industria, 1864.

<sup>20</sup> Cfr.: *supra* n. 12; G. CIMBALO, *L'Albania apre agli accordi...cit.*, 1 ss.

<sup>21</sup> Në vitin 1920, komuniteti i emigrantëve në Rumani, konkretisht në Bukuresht, numëronte rreth 20.000 vetë. Ata botonin libra, gazeta si, psh. "Sqipetari" apo

për komunitetet e formuara në Egjipt dhe Kostandinopojë (Stamboll). Selaniku u bë, gjithashtu, porta drejt Amerikës së Veriut, në mos edhe drejt Australisë. Në Shtetet e Bashkuara, komuniteti ortodoks zhvilloi forcën e vet organizuese, e cila shfrytëzoi dhe krijoi kushtet e nevojshme për rrënjosjen e ortodoksisë që kulmoi më vonë, me lindjen e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Jo më pak të rëndësishme qenë qytetet bregdetare si Durrësi dhe Vlora, ku punët e tregtisë u hapën rrugë marrëdhënieve dhe ideve që mbërrinin nga bregu tjetër i Europës.

Kështu, falë pranisë franceze, idealet e lirisë dhe të vëllazërisë gjetën terren pjellor, sidomos në mesin e bektashinjve, por, ku më shumë e ku më pak, në të gjitha qarqet elitare intelektuale dhe politike të vendit, të cilët ishin të vetëdijshëm që rruga e emancipimit prej sundimit të gjatë turk, kalonte nëpërmjet Europës dhe jo aq nga Ballkani apo Lindja.

Mozaiku i veçantë i shoqërisë shqiptare dhe dinamikat e brendshme në çdo sektor të jetës së saj shoqërore, politike dhe fetare nuk mund të kuptohen nëse nuk merret parasysh se ç'ndodh paralelisht me të në 'territorin e ndarë' të komunitetit arbëresh, por, pa lënë mënjanë edhe rrjedhën historike të komuniteteve fetare dhe të proceseve të organizimit të brendshëm të tyre, të cilët marrin jetë, kryesisht, pas shpalljes së pavarësisë. Kjo vlen sidomos për Kishën katolike, pasi komunitetet e ngulitura në pjesën e Italisë Jugore, por edhe në pjesën qendrore të saj, kanë qenë prej shekujsh besnikë ndaj kishës së Romës, por duke përdorur gjerësisht ritin grek-bizantin, si në celebrimet fetare, ashtu edhe në përcaktimin e statusit të drejtuesve në hierarkinë e këtij kulti. Pa dyshim, Kisha katolike bëri çmos për praninë e ipeshkvinjve të ritit latin, me synimin për të bërë kalimin gradual të zakoneve të popullit drejt këtij riti, por që e pamundur, pasi kjo popullsi ishte e lidhur ngushtë me ritin grek dhe e çmonte atë si elementin e vet identifikues. Kjo jetë 'në simbiozë' e komunitetit autokton dhe atij të emigruar bëri që, paralelisht me zhvillimin e debatit fetar në Shqipëri, edhe në dioqezat kalabreze dhe siçiliane,

---

revista, si "Liçitjea" dhe zhvillonin një veprimtari të gjallë politike duke marrë pjesë në betejat për pavarësi dhe në ndërtimin e shtetit të ri shqiptar. Në vitin 1921, po në Rumani, u plotësua dhe u botua nga Ilo Mitkë Qafëzezi përkthimi i parë i Kuranit në gjuhën shqipe.



aty nga fundi i njëzetvjetëshit të parë të shek. XX, të shtrohej nevoja për ngritjen e një organizimi kishtar vetjak, brenda Kishës katolike, për të përcaktuar në njëfarë mënyre identitetin e tyre, qoftë edhe nëpërmjet organizimit kishtar. Debati që përfshiu radhazi hallkat hierarkike katolike dhe kishën vendase arbëreshe e dha rezultatin e parë me kushtetutën e Eparkisë së Lungrës (1919), e cila ia doli t'i mblidhte famullitë kalabreze në një dioqezë të pavarur<sup>22</sup>. Kjo dukuri është pak a shumë e ngjashme me strukturimin po aq modern të komunitetit fetar në Shqipëri, çka dëshmon një lidhje të fortë kulturore dhe mendësi të njëjtë mes komuniteteve shqiptare në të dy anët e deti Jon, madje të krijohet përshtypja se komunitetet fetare shqiptare të Italisë ndjeheshin më afër me komunitetet fetare të origjinës së vetë Kisha katolike e Shqipërisë. Kjo mund të shpjegohet me faktin se Kisha katolike, nuk i kushtonte aq vëmendje marrëdhënies me komunitetet e tjera, pasi prioriteti i saj ishte zbatimi i kalendarit të diktuar nga *Propaganda Fide*.

---

<sup>22</sup> Lidhur me këtë, shih: C. KOROLEVSKIJ, *L'Eparchia di Lungro nel 1921*, Relazione di viaggio, (nën kujdesin e Stefano Parenti-it), Rende (CS), Unical, 2011, *passim*; L. ANGELI MURZACU, *Returning home thro Rome*. The Basilian monks of Rottaferrata in Albania, Grottaferrata, Αναλεκτα Κρυπτοφερρης, 2009.

## 1. 2. Kongresi i Lushnjës. Organizimi i shtetit të ri.

Me përfundimin e Luftës I Botërore dhe riorganizimin e shtetit shqiptar, u mbledh në Lushnjë, më 21 janar 1920, një kongres kombëtar me pjesëmarrjen e shtresave të ndryshme shoqërore në vend. Këtu u përcaktuan tiparet themelore të shtetit dhe u ravijëzua profili i organeve të pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv. Dokumenti përfundimtar u miratua më 31 janar 1920 dhe u njoh si Statuti i Lushnjës (ose *Bazat e Kanunit të Këshillit të Lartë*)<sup>23</sup>. Teksti i hartuar përbën një arkitekturë të vërtetë kushtetuese të llojit evropian, ndonëse është i paplotësuar dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet kushtetutë në kuptimin e plotë të fjalës. Një prej tipareve dalluese të tij është prania e Këshillit të Lartë, që ushtron pushtetin ekzekutiv. Ky organ, që përbëhej nga katër veta, zgjidhej nga parlamenti me shumicë absolute për tre vjet dhe gëzonte imunitet parlamentar. Në të, bënë pjesë përfaqësues nga katër besimet fetare në vend: ipeshkvi katolik, imzot *Luigj Bumçi*, dedeja bektashian *Aqif Pashë Elbasani*, i njohur edhe si *Aqif Biçakçiu*, peshkopi ortodoks, hirësia e tij *Abdi Toptani* dhe kryetari i komunitetit mysliman, dr. *Mihal Turtulli*, i thirrur për të qenë kryetar i përkohshëm i shtetit, duke i besuar, kështu, kryetarit të komunitetit fetar më të madh në vend, një rol *primus inter pares* mes anëtarëve të tjerë të Këshillit të Lartë. Vendimi për t'ia lënë një kreu të komunitetit fetar detyrën e përfaqësimit të shtetit, është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e trashëgimisë osmane, e cila u drejtohej të katër mileteve që përfaqësonin popullsinë e shtrirë në territorin shqiptar. Ky është, gjithashtu, tregues i prestigjit të lartë që gëzonin komunitetet fetare dhe drejtuesit e tyre, por edhe dëshmi e rolit të tyre për bashkimin e vendit. Mbarë forcat politike e njohnin rëndësinë e këtij roli për shkak të synimit të shprehur qartazi nga komunitetet fetare për bashkëjetesë dhe respekt reciprok mes të gjithëve. Trajtimi dhe qëndrimi i njëjtë ndaj komuniteteve fetare përbën një ndër tiparet dalluese të traditës shqiptare, zanafillën e të cilit duhet ta kërkojmë që me reformat e Tanzimatit të ndërmarra nga Perandoria Osmane, qysh

---

<sup>23</sup> A. LUARASI, *Akte Juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, Tiranë, SHBLU, 1999, 59-64.

prej vitit 1839. Kjo reformë u pasua nga ligje të shumta<sup>24</sup> që, sa i përket rolit të komuniteteve fetare, ato kulmuan me vendimin e *Hatt-ı Hümayun*-it, më 18 shkurt 1856, sipas të cilit vendosej barazi e plotë ligjore mes qytetarëve të besimeve të ndryshme dhe u njihej të gjithëve liria fetare, ndërkohë që krerëve të mileteve të ndryshme u ndalohej të ushtronin funksionin shtetëror të mbledhjes së taksave<sup>25</sup>.

Trajtimi i njëjtë financiar në raport me funksionin e tyre në hierarkitë përkatëse fetare, i dha dorë kontrollit të shtetit mbi to dhe i hapi rrugë pluralizmit fetar, duke u kthyer atyre prestigjin që kishin humbur duke pranuar të bëheshin pjesë e burokracisë së administratës së Perandorisë Osmane në rolin e përgjegjësve dhe funksionarëve të mileteve përkatëse<sup>26</sup>. Sigurisht, bëhet fjalë për një

---

<sup>24</sup> Tanzimati (1839-1876) zuri fill me miratimin e vendimit perandorak *Hattif-serif* i njohur si "Edikti i Kopshtit të Trëndafilave". Ai nënkuptonte katër reforma: atë mbi sistemin tatimor që kishte të bënte me heqjen e taksës që funksionarët fetarë dhe krerët e provincave mblidhnin nga të ardhurat e mileteve; sigurimin e garancisë së pasurisë, të nderit dhe të jetës së qytetarëve; futjen e shërbimit ushtarak të detyruar; barazi për të gjithë nënshtetasit përballë ligjit, pavarësisht përkatësisë fetare. E. J. ZURCHER, *Storia della Turchia*, Roma, Donzelli editore, 2007, 27 ss.; S. FAROQHI, *L'Impero Ottomano*, Bologna, Il Mulino, 2008, 46. E. ENGELHARDT, *La Turquie et le Tansimat ou histoire des réformes dans l'empire ottoman depuis 1826 jusqu'à nos jours*, vol I., Paris, Cotillon et C.ie, 1882, 31 ss.; *Histoire de l'Empire ottoman*, (sous la Direction de R. Matran), Parigi, Fayard, 1989, 509 ss.; A. BERTOLA, *Il regime dei culti in Turchia. I. Il sistema giuridico dei culti nell'Impero ottomano*, Torino, SEI, 1927.

<sup>25</sup> Me vendimin e "*Hatt-i Humayun-it*", të datës 18 shkurt 1856, reformat u shtrinë mbi të gjithë nënshtetasit e Perandorisë, pa dallim përkatësie klasore apo fetare. U hoq çdo pengesë për praktikimin e kultit dhe u ndalua çdo veprim që kishte si qëllim konvertimin në fe tjetër. Patriarkët, ipeshkvinjtë, arqipeshkvinjtë, metropolitët dhe rabinët u detyruan të betoheshin për besnikëri ndaj shtetit dhe iu garantua atyre një pagë në varësi të rëndësisë, rangut dhe dinjitetit të tyre.

Një analizë të thelluar të procesit të reformave të Perandorisë Osmane, e në veçanti, të këtij ligji, e gjejmë tek: R. BOTTONI, *Il principio di laicità in Turchia ...cit.*, 27 ss. Vedi anche: M. G. LOSANO, *L'ammodernamento giuridico della Turchia 1839-1926*, Milano, Unicvepli, 1985, *passim*.

<sup>26</sup> Mileti ishte një institucion në kuadrin e sistemit të marrëdhënieve me komunitetet e ndryshme fetare në Perandorinë Osmane. Komunitetet jo myslimane nënshkruanin një pakt mbrojtjeje të quajtur *dhimma*, që lëshohej nga *umma* pa afat kohor, në këmbim të një pagese të quajtur *jizya*. Krerët e mileteve, apo më saktë, krerët fetarë të besimeve përkatëse, mblidhnin këtë taksë që

vizion të ri marrëdhëniesh mes besimeve fetare, në një vend me shumicë myslimane, i cili dëshmon aftësitë e duhura për t'i siguruar shtetit të ri demokracinë parlamentare, dhe për të hyrë në rrjedhën e zhvillimit kushtetues europian si shtet i rinovuar laik që trajton me barazi të plotë kultet, mbrojtjen e lirisë fetare vetjake dhe kolektive dhe garanton pluralizmin fetar. Në fakt, siç është theksuar më parë, arsyet që çuan drejt kësaj reforme janë shumë më të ndërlikuara dhe e kapërcejnë temën e këtij studimi, por, megjithatë, janë të domosdoshme për të kuptuar ç'ndikime pati qëndrimi rinovues i atyre që morën pjesë në ndërtimin e shtetit të ri. Jo pak prej tyre kishin formim osman, pasi, duke qenë bij dyerësh të mëdha, ishin arsimuar në *Aşiret Mekteb* (Shkolla e Fiseve), ose në shkollat e reja shtetërore të ngritura falë reformave të Perandorisë; të tjerët vinin nga komunitetet arbëreshe si, Terenc Toçi apo i përkisnin komunitetit të madh dhe mjaft aktiv të shqiptarëve të emigruar në Rumani<sup>27</sup>.

---

shkonte për Perandorinë dhe për Sulltanin. Reformat e sipërpërmendura, e vënë Perandorinë Osmane drejt shndërrimit të saj në një shtet multi-etnik dhe multi-fetar të karakterit të vendeve perëndimore. Lidhur me këto reforma, shih: R. BOTTONI, *Il principio di laicità in Turchia ...cit., passim*, ma anche *Histoire de l'Empire ottoman...cit., passim*, E. ASTHOR, *Storia economica e sociale del vicino oriente nel Medioevo*, Torino, Einaudi, 1982; A. FATTAL, *Le statut légal des non-musulmans en pays d'Islam*, Bayrou, Imprimerie catholique, 1958; H.A.R. GIBB, H. BOËN, *Islamic Society and the East*, I, II parte, London, Oxford University Press, 1950, 212, ss.; M. GRIGNASCHI, *L'Impero ottomano e le minoranze religiose, Studi in onore di Francesco Gabrieli nel suo ottantesimo compleanno*, (a cura di R. Traini), Roma, Dipartimento di studi orientali dell'Università di Roma La Sapienza, 1984, 411-422; C. K., PAPASTATHIS, *The Ecumenical Patriarchate and the International Administration of the Rum Millet in the Tanzimat Reform era (1839-1876) Orthodoxy and Oecumene Gratitudo Volume in Honor of Ecumenical Patriarch Bartolomaios I*, Athens, Harmos Publications, 2001, 367-382. B. L. ZEKIYAN, *Potere e minoranze, il sistema dei millet*, 2007, <http://www.oasiscenter.eu/node/2817>.

<sup>27</sup> Terenc Toçi, i lindur më 9 mars 1880 në Strigar (it. S. Cosmo Albanese), në provincën e Kozencës, studioi në kolegjin e shën Adrianit në shën Mitër (it. S. Demetrio Corone). Në vitin 1911 organizon një revoltë në Malësinë e Veriut të Shqipërisë dhe shpall qeverinë e përkohshme të pavarur, e para në historinë e Shqipërisë, pas vdekjes së Skënderbeut. Pas dështimit të kësaj nisme, ai themelon, në krye të vitit, organin e përdyjavshëm *La Rivista dei Balcani*, drejtor i së cilës është ai vetë. Me shpalljen e pavarësisë, transferohet përfundimisht në Shqipëri, ku merr emrin Terenc Toçi (nga Terenzio Tocci).

Lidhur me përfshirjen në politikë të drejtuesve të besimeve fetare dhe angazhimit të tyre në funksione të ndryshme publike, duhet thënë se jemi përballë një qëndrimi koherent kundrejt rolit të ri që komunitetet fetare kishin kryer në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Komunitetet përbënin milletet e ndryshme, ndaj përfaqësonin shtresat e ndryshme të shoqërisë dhe si të tilla kërkohej bashkëpunimi i tyre për garantimin e unitetit kombëtar. Kjo është arsyeja pse roli që u vishet komuniteteve fetare nuk e cënon aspak laicitetin e shtetit, por është shprehje e bashkimit të vendit, pavarësisht përkatësive të ndryshme fetare. Përparësia që fiton të qënë shqiptar përkundrejt përkatësisë fetare, nxjerr në pah një prej tipareve themelore të marrëdhënies së shqiptarëve me fenë. Duke qenë se, aso kohe, komunitetet fetare në vend nuk kishin ende një organizim të mirë të brendshëm, delegatët e kongresit e panë me pragmatizëm rolin e tyre shoqëror dhe dolën në përfundimin se në shoqërinë shqiptare ka një shpërndarje të popullsisë të përfaqësuar më së miri nga katër grupe fetare. Për të mirën e vendit dhe për kapërcimin e një tranzicioni të vështirë, ata e shohin të udhës të lihen mënjanë ndarjet dhe të vlerësohen konvergencat, sepse vetëm kështu mund të ngriheshin institucione shtetërore të qëndrueshme, gjë që ishte aq e domosdoshme për t'i sjellë stabilitetin e munguar shtetit shqiptar. Pas dy vite diskutimesh, qëndrimet e sistemeve të ndryshme europiane të së drejtës tradicionale të kanuneve dhe të përpunimit të teorisë së Montesquieu-së, nëpërmjet filtrit osman, ofruan ndihmesën e tyre për t'i dhënë sistemit shqiptar specifikën e vet, duke kapërcyer pengesat politike të vendit edhe në kohët më të vështira, për të ardhur deri në ditët e sotme<sup>28</sup>. Në vitin 1922,

---

<sup>28</sup> Me kalimin e shekujve, Perandoria Osmane duhej të ndërgjegjësohej për lindjen e nacionalizmave të ndryshëm. Një shtet i copëzuar në disa milete, e kishte të pamundur t'u bënte ballë kërkesave për pavarësi dhe njohjes së identiteve kombëtare që sa vinin e shtoheshin, jo vetëm në territoret europiane nën kontrollin e tyre, por edhe në Lindje dhe në Afrikën Veriore, si përpjekje e Fuqive të Mëdha për shpërbërjen e Perandorisë. Në këto kushte, lindte nevoja e reformave të thella të bazuara në njohjen e multi-etnive dhe të pluralizmit gjuhësor të shtetit, në krye të të cilave u vu Mustafa Qemal Pashai si udhëheqës i këtij tranzicioni. Roli i islamit si fe e shtetit, nuk mund të përputhej me këto rrethana. F.L GRASSI. *Atatürk. Il fondatore della Turchia moderna*, Roma, Salerno ed., 2008, *passim*; P. Dumont, *Mustafâ Kemal invente la Turquie moderne*, Paris, ed. Complexe, 1983; J E. ZURCHER, *Storia della Turchia, dalla fine dell'Impero*

Këshilli Kombëtar miratoi një ligj të ri kushtetues të njohur si Statuti i Zgjeruar i Lushnjës<sup>29</sup>, i cili në nenin 1, pjesa a, përcaktonte pushtetin dhe funksionet që i përkasin Këshillit të Naltë, si përfaqësues i kreut të shtetit.

Roli i garantit, që kishin komunitetet fetare në Këshillin e lartë, siç parashikonte Statuti i Lushnjës, i kushtëzonte ata të kishin një veshje juridike më të përcaktuar dhe i nxiste të hartonin statutet e veta. Përpjekja e institucioneve të reja shtetërore për ndërtimin e rregullit parlamentar, të ngritur mbi një përfaqësi të zgjedhurish, kërkonte përshtatje të plotë me parimet e përfaqësimit dhe të transparencës së aparatit klerikal, drejtuesit e të cilit merrnin pjesë në nivelet më të larta të jetës politike e, rrjedhimisht, në transformimin politik dhe social të vendit. Të parët që iu përgjigjën pozitivisht kësaj thirrjeje, qenë myslimanët bektashinj, si më të hapur ndaj kulturës perëndimore dhe përçues të vlerave iluministe në shoqërinë shqiptare<sup>30</sup>, por edhe të shtyrë nga ngjarjet ndërkombëtare që kërcënonin besimin e tyre, siç ishte lëvizja laike e Turqve të Rinj në Anatoli.

Në këto rrethana, besimtarët bektashianë e shihnin të nevojshëm sigurimin e një vendi të përshtatshëm për të transferuar sa më shpejt të qe e mundur selinë botërorë të këtij komuniteti, dhe ky s'mund të ishte veçse një vend, ku të jetohej në paqe së pari me bashkëvëllezërit myslimanë, por edhe me besimet e tjera, si dhe të

---

*ottomano ai giorni nostri*, Roma, Ed. Donzelli, 2007. E. Z. KARAL, *La trasformazione de la Turquie d'un empire oriental en un état moderne et national*, "Cahiers d'histoire mondiale", 4, 1958, 2, 426-445.

<sup>29</sup> Statuti dhe zgjerimi i tij i mëvonshëm pohonin haptazi se do t'i kishin themelet në traditë, pra në të drejtën e kanunëve, po ashtu, pohonin praninë e Këshillit të Lartë. Ky organ zgjidhej nga parlamenti me një afat kohor tre vjeçar dhe anëtarët e tij viheshin radhazi për tre muaj në krye të shtetit (neni 45-68). Për ruajtjen e një ekuilibri më të madh në marrëdhëniet mes komuniteteve fetare, organi përfaqësues i kryetarit të shtetit u bë kolegjal dhe me rrotacion. Për më shumë, lidhur me tekstin e Statutit të Lushnjës, shih : <http://licodu.cois.it/575/view>

<sup>30</sup> Me rastin e reportazheve të bëra në Shqipëri, Montanelli kishte shquar, me mprehtësinë e tij, të gjitha këto veçori. Shih: V. I. MONTANELLI, *Çështja fetare, Shqipëria një dhe njëmijë*, [Albania una e mille, përkthimi në shqip i saj nuk gjendet], Tiranë, ed. 55, 2005.

kishin garancitë e duhura për ushtrimin e lirisë së fesë dhe për administrimin e pavarur të saj<sup>31</sup>.

Kongresi i vitit 1921, ku u miratua statuti i parë i tyre, u mbajt në teqenë e Prishtës. Për drejtimin e komunitetit u caktua Këshilli Atënor, i cili duhet të veprojë në përputhje me "*Ligjin e përjetshëm Bektashian*". U përcaktua mënyra e organizimit të Këshillit, kohëzgjatja, mbledhjet periodike dhe detyrat e tij; u sanksionua pazgjidhshmëria e lidhjes shpirtërore të komunitetit me themeluesin e tij Haxhi Bektash Veli-u (Haiji Bektash Wali)<sup>32</sup>. Pas listimit të masave disiplinore që këshilli mund të marrë kundrejt funksionarëve të ndryshëm fetarë, statuti trajton financat e komunitetit për të shqyrtuar gjendjen e pasurisë së përgjithshme dhe të secilës teqe në veçanti, pasuri që mblidhet nga kontributi i besimtarëve dhe krerëve të komunitetit. Një çështje tjetër e rëndësishme është themelimi i një shkolle formimi për klerin, e cila do të mbahet me burimet e komunitetit dhe të administratës, nën mbikëqyrjen e një komisioni të posaçëm të emëruar nga Këshilli Atënor.

Institucionalizimi i besimit bektashian bëhet me mbështetjen e qeverisë shqiptare, ndaj Këshilli Atënor urdhëron të gjithë Baballarët të lutën për shtetin shqiptar dhe për mbarë kombin. Pasuria e komunitetit është ajo e teqeve të veçanta, por ndërkohë i hapet rrugë procesit për ndërtimin e një pasurie të përgjithshme të vëllazërisë. Komuniteti bektashian nuk e përdor institutin e

---

<sup>31</sup> Qendra botërore e vëllazërisë tradicionalisht ka qenë në Anadoll. Zhvillimi i lëvizjes së Turqve të Rinj, e drejtuar nga Qemal Pashai, i quajtur më vonë Ataturk, mbështeste laicitetin e shtetit dhe kundërshtonte çdo lëvizje fetare me karakter mistik apo shoqëror, duke i mëshuar idesë së ndarjes së shtetit nga feja. Si pasojë e këtij qëndrimi politik, drejtoria ndërkombëtare e bektashizmit u detyrua ta transferonte selinë e saj në Shqipëri ku kjo vëllazëri kishte mbështetje të gjerë dhe ishte rrënjosur tashmë në vend. Shih: R KALIÇANI, *Histori e Bektashizmit si sekt mistik Islam*, Tiranë, Koha, 1999, 62. Në vija të përgjithshme mbi komunitetin bektashian, shih: S. HYSI, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare, Tiranë*, Mësonjtorja e parë, 2006, 145 – 168.

<sup>32</sup> Haiji Bektash Wali, filozof dhe humanist persian, i kreu studimet e tij në Anatoli dhe i dha jetë një vëllazërie myslimane, ndër më origjinalet në gji të islamit. Vëllazëria bektashiane, e ngjizur sidomos brenda grupit të jeniçerëve, pësoi një persekutim të rreptë që në kohën e Tanzimatit, ndaj e transferoi qendrën e vet botërore në Tiranë. Mbi rolin e vëllazërive në islam G. CIMBALO, *Le confraternite islamiche nei Balcani... cit.passim*.

vakëfeve, as nuk mbledh taksa (zakar), por, gjatë kësaj kohe, mbështetet tërësisht në kontributin e lirë të besimtarëve. Lutjet e besimtarëve zhvillohen në gjuhën amtare. Me t'u miratuar statuti, normat e tij i shtohen ligjit të përgjithshëm bektashian<sup>33</sup>.

Të njëjtën rrugë ndjek edhe Kisha ortodokse e Shqipërisë, e cila, me një vendim të nënshkruar me datë 28 nëntor 1921, në Tiranë, nga katër përfaqësues të kësaj kishe, shpall themelimin e Kishës Kombëtare Autoqefale Ortodokse, duke ritheksuar besnikërinë e vet ndaj kanoneve të shenjta të të gjitha kishave të tjera ortodokse të Krishtit, nën mbrojtjen e Patriarkanës së Kostandinopojës<sup>34</sup>. Nuk bëhet fjalë për një autoqefali të plotë, pasi për të qenë e tillë, asaj i nevojitet miratimi i Patriarkanës Ekumenike, megjithatë ortodoksët shqiptarë janë të vetëdijshëm që prova për hartimin e një statuti është sfidë e nevojshme për marrjen e autoqefalisë nga Patriarku i Kostandinopojës dhe kusht për të mbijetuar në shoqërinë shqiptare pa u parë si mish i huaj apo si anëtarë të një organizate të huaj që synojnë të ndikojnë së jashtmi mbi vendin, duke cënuar unitetin dhe pavarësinë e tij<sup>35</sup>.

Në kohën kur shteti shqiptar po hidhte hapat e parë nuk mungonte presioni i shteteve fqinje që synonin të gllabëronin pjesë nga territori i tij. Greqia mobilizohet veçanërisht në të ashtuquajturin Epiri i Veriut, ku për një farë kohe ia del të ndërtojë një shtet të pavarur. Mund të thuhet se vetëm në vitin 1921 Greqia e shuan presionin e saj, falë ndërhyrjes së diplomacisë ndërkombëtare e, veçanërisht, asaj italiane<sup>36</sup>. Pjesa më e madhe e klerit të Kishës ortodokse në Shqipëri kishte origjinë greke, ishte formuar atje dhe ndikohej prej saj, në mos tjetër, së paku në frymën kulturore greke. Pavarësisht kësaj, nuk mungonte vullneti për ta shqiptarëzuar

---

<sup>33</sup> Lidhur me statutin e parë të Bektashinjve, shih: <http://licodu.cois.it/421/view>.

<sup>34</sup> *Proklamimi i kishës Autoqefale Ortodoxa kombëtare në kishën e Tiranës më 28 XI. 1921*. Ky tekst gjendet në: *Kujtim vepre dhe intige*, Tiranë, Shtypshkronja "Tirana", 1926, 4-6.

<sup>35</sup> Lidhur me tekstin e statutit të Kishës kombëtare të pavarur (ortodokse) në Shqipëri, shih: <http://licodu.cois.it/577/view>

<sup>36</sup> Në vitet 1914-1919 zhvillohet jeta e shkurtër e Republikës së Epirit të Veriut, e cila do t'u çelë rrugë ngjarjeve të ndërlikuara diplomatike, që do të marrin zgjidhje pas konfliktit të Greqisë me Turqinë, kohë në të cilën ky territor i kalon përfundimisht Shqipërisë. Ref.: P. KITROMILIDES, *Eleftherios Venizelos: The Trials of Statesmanship*, Edinburgh, University Press, 2008, *passim*.



Kishën ortodokse, falë përkushtimit të disa përfaqësuesve të saj, si, i madhi, Fan Noli, që u vu në krye të përpjekjeve për modernizimin e kombit dhe të gjuhës shqipe<sup>37</sup>.

Në këto rrethana politike, kaq të ndërlikuara, u mbledh në Berat, më 12 shtator 1922, këshilli i asaj që mund të quhet organizimi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në truallin shqiptar. Aty morën pjesë 33 përfaqësues të të gjitha krahinave. Një ndër vendimet më të rëndësishme ishte detyrimi për të përdorur gjuhën shqipe, gjatë celebrimit të meshës së shenjtë. Ky vendim u prit me entuziazëm nga pjesa më e madhe e popullsisë së këtij besimi. Po ashtu, u përcaktuan selitë peshkopale dhe organizimi hierarkik fetar, u vendos lloji i vulës për të gjitha nivelet zyrtare. Statuti u miratua më 17 shtator 1922, por, gjithsesi, bëhej fjalë për një statut të përkohshëm, derisa marrëdhëniet me Patriarkanën Ekumenike të Kostandinopojës të hynin në hullinë e duhur pas miratimit të një *Tomos*-i të posaçëm për njohjen e autoqefalisë. Është kjo arsyeja që Kisha ortodokse, në pritje të këtij miratimi, drejtohej nga një komitet i përkohshëm, përbërja e të cilit përcaktohej në nenin 3 të statutit.

U krye kështu akti i parë themelor i pranisë ortodokse të pavarur në vend, por ende ishte në gjendje embrionale dhe e priste një rrugë sa gjatë aq e vështirë për marrjen e autoqefalisë, rrugë që vështirësohet edhe nga kryqëzimi i ngjarjeve politike lidhur me peshkopin Fan Noli, themeluesit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë më 1919, në Boston<sup>38</sup>.

---

<sup>37</sup> Theofan Stilian Noli, kryeministër në vitin 1924, peshkop i kishës ortodokse, i lindur në një komunitet të krishterësh shqiptarë në Traki, afër Adrianopolit, u emërua peshkop i kishës ortodokse në Shtetet e Bashkuara. I kthyer në Shqipëri, mori drejtimin e vendit nga qershori deri në dhjetor të vitit 1924, por qeveria e tij u rrëzua nga grushti i shtetit, organizuar nga Ahmed Zogolli, nën mbështetjen e Jugosllavisë. Për më tepër shih: R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 49 ss.; S. BENAR, *Fan Nolin, siç e kam njohur*, Tiranë, Dituria, 1997

<sup>38</sup> Qeveria shqiptare e njohu rezolutën e këtij kongresi të Kishës së pavarur ortodokse të Shqipërisë. Gjithsesi vendimet e kongresit dhe emërimi i ipeshkvinjve u gjykuan kanonikisht jokorrekte nga Patriarkana e Kostandinopojës, që ishte e gatshme të pranonte formimin e një kisha të pavarur, por jo autoqefale, edhe për faktin se vendi përbëhej nga shumicë myslimane dhe jo ortodokse. Ref: D. H. BEDULI, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, Tiranë, 1992, 22; S. HYSI, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare...cit*,

Të fundit që u morën me hartimin e statutit, qenë myslimanët, të cilët e ndienin veten të rrënjësuar mirë në vend, por gjithsesi u përgjigjën kuadrit normativ për rregullimin ligjor të komuniteteve fetare. Nëse kërkojnë të dëgjohet zëri i tyre në jetën e vendit dhe të gëzojnë mbrojtje ligjore, duhet të organizohen njësoj si komunitetet e tjera<sup>39</sup>. Në datat 24 shkurt-12 mars të vitit 1923, u mbledh në Tiranë kongresi i parë në të cilin morën pjesë 36 përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Kongresi shqyrtoi ndërprerjen e marrëdhënieve të varësisë me *Shaykh ul-islâm-in* e Stambollit<sup>40</sup> dhe caktoi organet e komunitetit kombëtar sunit që janë: Kryemyftiu (Tiranë), myftijtë e rretheve (Shkodër, Tiranë, Korçë, Gjirokastër); emëroi *Këshillin e Lartë të Shëriatit*,<sup>41</sup> dhe hartoi statutin e vet<sup>42</sup>. Me mbylljen e kongresit, Komuniteti Mysliman Sunit vazhdon të sjellë risi të tjera, gjë që ia forcon më shumë identitetin. Këto risi kanë të bëjnë me konsolidimin e hierarkisë fetare dhe administrative, me shqyrtime autonome të kuadrit teologjik duke rivlerësuar rolin e gruas në shoqëri dhe

---

169 -189., si dhe broshurën: *Kujtim veprë dhe intigë*, me parathënie të Fan Nolit, ku përmbahen një sërë dokumentesh dhe shprehje qëndrimesh nga ana e Kishës.

<sup>39</sup> Një rinovim i tillë ishte përgatitur nga Kushtetuta e vitit 1921 e Aleancës Kombëtare islame, nën drejtimin e së cilës ishte organizata e komunitetit mysliman të Shqipërisë pas ndarjes nga juridiksioni i *Shaykh ul-islâm-it* të Stambollit. Deri në këtë moment që po shkruajmë nuk ia kemi dalë të sigurojmë statutin e parë të komunitetit mysliman, të miratuar nga kongresi i datës 23 mars 1923, çka na bën të dyshojmë që mund të ketë humbur. Të dhënat e sjella këtu janë rindërtuar nga R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 29 ss. e A. PVEPOVIC, *L'islam balkanique. Les musulmans du sud-est eurpéen dans la période post-ottomane*, Berlin-Wiesbaden, Otto Harrassowitz, 1986.

<sup>40</sup> Mbi shtypjen e Kalifatit dhe qëndrimin larg të myslimanëve shqiptarë nga ky institucion, shih: V. IANARI, *L'eclissi del califfato e i nazionalismi islamici*, "Ricerche di storia sociale e religiosa", 35 1989, 101-128; G. VERCELLIN, *Istituzioni del mondo musulmano*, Torino, Einaudi, 1996, 231-233. Da ultimo N. FIORITA, *Il costituzionalismo islamico tra modello liberale e integralismo religioso, I diritti cultural-religiosi dall'Africa all'Eurpepa, Torino Giappichelli, 2012*, 85-104.

<sup>41</sup> Megjithë kërkimet e shumta, statuti i hartuar gjatë kongresit të parë të komunitetit mysliman rezultoi i humbur. Disa të dhëna të pakta lidhur me aktivitetin e zhvilluar dhe vendimet e marra, mund të gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, tani e tutje AQSH, Fondi, nr. 882, viti 1923, dos. 4, fl. 8.

<sup>42</sup> AA. VV., *Historia e popullit shqiptar*, Tiranë, 1994, 166 ss. Sulla storia della Comunità musulmana in Albania vedi: S. HYSI, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare, cit.*, 114- 144.

duke riorganizuar arsimin e klerikëve. Për më tej, në vitin 1923, ky komunitet shprehet kundër poligamisë, mbulimit të grave me shami, avdeseve rituale dhe përmbysjes gjatë lutjes. Për këtë gjejmë dëshmi në revistën për formimin fetar të besimtarëve dhe rregulltarëve, botuar nga vetë komuniteti<sup>43</sup>.

Ndryshimi i vërtetë ka të bëjë me riorganizimin e administratës së vakëfeve. Me heqjen e legjislacionit osman dhe vendosjen e karakterit pluralist të shtetit si dhe ndarjen nga besimet fetare, këto institute nuk mund t'u besoheshin veçse privatëve, duke u garantuar atyre një rishpërndarje të re me garancitë e nevojshme. Për t'ia arritur këtij qëllimi, administrimi i vakëfeve mund t'i besohej vetëm komunitetit, prandaj kongresi hartoi një rregullore të posaçme lidhur me këtë, që, siç do të shohim, sa vjen e përmirësohet në kongreset e ardhshme. Me kalimin përfundimtar të vakëfeve nën administrimin e komuniteteve fetare, konsolidohet ndarja e plotë mes shtetit dhe besimeve fetare. Myslimanëve sunitë u takojnë të ardhurat e Zakatit që mblidhen nga anëtarët e këtij komuniteti, ndërkohë që kjo taksë do të marrë formë tjetër për bektashinjtë, të cilët do t'i riorganizojnë vakëfet e tyre gjatë viteve të ardhshme.

Këtij procesi kushtetues, që i trajton komunitetet fetare si subjekte të së drejtës private nuk i përgjigjet kisha katolike, strukturat e së cilës lidhen ngushtë me organizimin ndërkombëtar të Kuries së Romës, prandaj ajo nuk mund të pranojë të organizohet brenda një dimensionit thjesht kombëtar<sup>44</sup>.

---

<sup>43</sup> Bëhet fjalë për revistën "Zani Naltë" (1923-1939). Shih edhe: G. H. BOUSQUET, *Notes sur les reformes de l'Islam albanais*, " *Révue du monde musulman* ", 4, 1935, 399-410. Lidhur me heqjen e poligamisë, iu referuan ligjit osman të vitit 1917 mbi familjen (*Hukuk-u Aile kararnamesi*), i shfuqizuar më pas në Turqi në vitin 1919. Ky qëndrim gjeti pasqyrimin e vet në Kodin Civil të vitit 1928.

<sup>44</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vet. cit.*, 62. Është rasti të kujtojmë që, pavarësisht rrugëve të ndryshme që ndoqën, arbëreshët e Italisë ngritën strukturën e tyre organizuese në brendësi të kishës katolike dhe hartuan gjatë po asaj kohe statutet e tyre, sigurisht duke pasqyruar tiparet e Kishës katolike, pjesë e së cilës janë. Kjo dëshmon sintoninë dhe lidhjet kulturore-fetare mes tyre dhe atdheut mëmë, ndoshta edhe më shumë se për vetë Kishën katolike të rritit latin, e përqendruar kryesisht në veri të Shqipërisë. Kjo shpjegohet me varësinë e vazhdueshme të Veriut të Shqipërisë nga *Propaganda Fide* dhe nga prania e Administratës Apostolike për pjesën qendrore dhe jugore të vendit. Shih: V. C. KOROLEVSKIJ, *L'Eparchia di Lungro nel 1921...cit.*

Siç e kemi thënë, Kisha katolike e konsideron Shqipërinë si tokë misioni, duke qenë se ndodhet shumë pranë ndikimit ortodoks, prandaj ajo varet nga kongregata *Propaganda Fide*. Kjo e shpjegon gjithë atë vëmendje të veçantë që tregon Selia e Shenjtë kundrejt këtij vendi, kontrollet në nivel papnor për emërimin e hierarkisë kishtare dhe rolin e veçantë që u besohet urdhrave fetarë në drejtimin e vendit dhe unguillëzimin e tij<sup>45</sup>.

Miratimi i statuteve nga ana e komuniteteve fetare, i diktuar nga dispozitat kushtetuese dhe rrjedha e ngjarjeve ndërkombëtare, bën që, në vitin 1923, të miratohet ligji për statutet e ligjshme të komuniteteve fetare, i cili u njeh atyre personalitet juridik civil<sup>46</sup>.

Kështu, në vitin 1923, Shqipëria është i vetmi vend në Europë që harton normat për dhënien e personalitetit juridik komuniteteve fetare, çka përfaqëson shkallën më përparimtare të përpunimit të së drejtës europiane, duke dëshmuar aftësinë e saj për t'i hyrë në thelb debatit konstruktiv, aq të nevojshëm për themelimin e shtetit modern<sup>47</sup>. Ky ligj, i panjohur për shkencën juridike perëndimore, ku pasqyrohet jehona e përvojave të mëparshme të karakterit europian dhe të reformimit osman, përmban parime që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë edhe sot për ruajtjen e paqes fetare të këtij vendi, brenda hapësirës ballkanike, zonë që vazhdon të përçahet dhe të luftojë, duke vënë në themel të mëvetësisë dhe identiteteve të ndryshme, pikërisht përkatësinë fetare<sup>48</sup>.

---

<sup>45</sup> Lidhur me këtë shih: MINISTERO PER I BENI E LE ATTIVITÀ CULTURALI, DIREZIONE GENERALE PER GLI ARCHIVI, *L'unione fra l'Albania e l'Italia* (a cura di Silvia Trani), Roma, Pubblicazioni degli Archivi di Stato, Strumenti CLXXIII, 2007, 72-82, dhe F. JACOMONI DI SANSAVINO, *vep. cit., passim*.

<sup>46</sup> *Statuti legal i komuniteteve fetare*, <http://licodu.cois.it/415/view>.

<sup>47</sup> Për riorganizimin e shtetit shqiptar në vitet '20: N. JOTGA, *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar*, Saraçi, 2004, 138-139.

<sup>48</sup> Për një analizë përmbledhëse të regjimit juridik të besimeve në Shqipëri, shih: S. HYSI, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare...cit*, 190 – 208.

### 1. 3. Njohja e lirisë së organizimit të kulteve

Në dekretin e vitit 1923 për komunitetet fetare, pasi sanksionohet se liria e mendimit mbrohet nga neni 93 i Statutit të Shtetit Shqiptar të vitit 1922 dhe nga nenet 1-2 të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës, tetor 1921, thuhet se: “2.- Çdo degë e Myslimanizmit si Synnizma, Bektashizma, Rufaizma, Halvetizma, Kadirizma, Sadizma e tjerat, ashtu dhe çdo degë e Krishtenizmit, si Katolikizma, Orthodhokizma, Protestanizma si edhe të gjitha degat e çdo feje tjetër, mund të organizohet në një shoqat fetare independente njana prej tjetrës<sup>49</sup>.”

Nuk mund të ketë një pohim më të qartë ku të shprehet pluralizmi fetar dhe vetëdija se nuk ekziston vetëm një besim islam, por disa dhe secilit prej tyre shteti i njeh të drejtën të paraqesë statutin dhe rregulloren e vet. E njëjta liri u jepet katolikëve, ortodoksëve, protestantëve etj. Nuk bëhet fjalë për një fotografi statike ekzistuese, por shikimi hidhet drejt së ardhmes, çka nënkupton hapje ndaj besimeve të reja të mundshme<sup>50</sup>. “3. Çdo shoqatë fetare mund të ketë me qendrat e mëdha fetare jashtë Shqipërisë vetëm lidhje shpirtërore dhe dogmatike. Marrëdhëniet dhe korrespondencat mes tyre janë të lira, pa farë pengese nga qeveria<sup>51</sup>”. Pra, marrëdhëniet ndërkombëtare të kulteve nuk janë të ndaluara, por kanë të bëjnë vetëm me çështje dhe veprimtari fetare, si garanci e pavarësisë kombëtare. Për të garantuar respektimin e kësaj dispozite, të gjithë ata që kanë detyra fetare duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe të flasin shqip, të gëzojnë të

---

<sup>49</sup> Statuti legal i komuniteteve fetare, <http://licodu.cois.it/415/view>.

<sup>50</sup> Në këtë paraqitje dallohen pasojat e ligjeve të reformës së sistemit osman e veçanarisht ato të *Hatt-i Humayun-it* që me futjen e lirisë fetare dhe shpërbërjes së mileteve në Perandorinë Osmane, i hapën rrugë pluralizmit fetar brenda sistemit të saj. Ajo çfarë bie në sy është barazia mes të gjitha besimeve jo vetëm mes individësh, por në nivel kolektivi, duke kapërcyer kështu kufizimet e diktuar nga sistemi turk. Kjo dëshmon që sistemi shqiptar nuk i trembet rolit shoqëror dhe politik të organizatave fetare, por njeh llojshmërinë e besimeve dhe të traditave fetare si tregues të pasurisë dhe forcës shoqërore, si instrument i kohezionit kombëtar dhe karakteristikë themelore e trajtës së shtetit.

<sup>51</sup> *Ibidem*.

drejta civile dhe politike<sup>52</sup>, të kenë etni shqiptare apo të jenë bij shqiptarësh prej tre brezash dhe të mos i kenë dalë kundër pavarësisë së shtetit shqiptar<sup>53</sup>.

Rëndësi të veçantë paraqet njohja e plotë e autonomisë së komuniteteve fetare, çka e dëshmon fakti që krerët e çdo feje dhe të çdo besimi zgjidhen sipas statuteve të tyre, dhe njihen nga qeveria nëpërmjet një dekreti, në përputhje me karakterin juridiksional të kësaj norme. Sidoqoftë, çdo shoqatë apo institut fetar si: xhami, teqe, kishë, manastir etj., njihet si person juridik dhe përfaqësohet në bazë të rregullave të brendshme fetare të kultit përkatës.

Nuk mund të ketë garanci më të madhe se kjo për të shprehur njohjen efektive të lirisë fetare, të shoqatave dhe individëve, aq më tepër kur organizatat e ndryshme të kultit kanë të drejtë të zotërojnë, të blejnë, të tjetërsojnë dhe të administrojnë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, por të drejtat civile që u njihen atyre, duhet të jenë në përputhje me natyrën e shoqatave me karakter fetar. Shteti mjaftohet me të drejtën e kontrollit mbi administrimin e pasurisë dhe të bilancit vjetor të personave juridikë të komuniteteve fetare, duke zbatuar një ligj të posaçëm për shoqatat. Mbështetja tek legjislacioni i përbashkët për kontrollin e ushtruar nga qeveria mbi të mirat e komunitetit fetar dhe të enteve të veta bëhet edhe për çështje që kanë lidhje me

---

<sup>52</sup> Edhe normat e mëvonshme që rregullojnë çështjen e shtetësisë së personelit dhe të drejtuesve të fesë kanë të njëjtën origjinë. Megjithatë, “Pavarësisht këtyre cilësive, kushdo që deri më 28 nëntor 1922, por edhe më tej ka kundërshtuar pavarësinë shqiptare, nuk mund ta fitojë këtë titull”, ndërkohë që “Nëpërmjet një ligji të posaçëm, mund të fitohet ky titull edhe në mungesë të cilësive të sipërpërmendura”. Për t’u siguruar të gjithë mbrojtjen e nevojshme pakicave, përjashtohen nga detyrimi i njohjes së gjuhës shqipe klerikët e atyre krahinave shqiptare ku shumica e popullsisë flet një gjuhë tjetër. Kjo është dëshmi e fleksibilitetit të legjislacionit shqiptar në respekt të identiteve të ndryshme. *Ibidem*.

<sup>53</sup> Është me vend të nënvizojmë vendosjen e masës ligjore që parashikon e drejta austro-hungareze lidhur me lirinë fetare dhe organizimin e komunitetit islam në Bosnjë-Hercegovinë. Shih: *Gesetz vom 15 Juli 1912 betreffend die Anerkennung der Anhänger des Islams als Religionsgesellschaft*, (IslamG), RGBl 159/1912. Për një shqyrtim dhe inkuadrim historiko-juridik të këtij ligji të rëndësishëm, shih: A. TORRES GUTIÉRREZ, *El derecho a la libertad de conciencia en Austria*, Madrid, Dykynson, 2006, 190 ss.

sektorin e ndërtimit për kultet. Kështu: “*çdo shoqatë apo komunitet besimtarësh ose fetar ka të drejtë të ndërtojë, të zotërojë, të drejtojë dhe kontrollojë me shpenzimet e veta xhami, kisha, teqe, manastire dhe vende të tjera lutjeje, si edhe varreza pranë tyre por edhe institute bamirësie pa farë pengese apo formaliteti, por vetëm duke zbatuar ligjin bashkiak për leje e ndërtimi*”<sup>54</sup>. Nuk ka se si të jetë më e qartë norma për garantimin dhe sigurimin e lirisë dhe autonomisë së plotë të komuniteteve fetare, në një vizion modern, pluralist dhe laik në marrëdhënie me kultet, kur dekreti shkon deri aty sa njihet autonominë e brendshme të komunitetit: “*Shoqatat kanë të drejtë të vendosin masa disiplinore mbi klerin dhe vartësit e tyre*”.<sup>55</sup>

Për rrjedhojë, në të drejtën civile shqiptare, që nga viti 1923, komunitetet fetare janë shoqëri individësh, të bashkuar nga një besim i vetëm për celebrimin e tij; kanë një kalendar të vetin liturgjik; respektojnë ditët e festave fetare; respektojnë disa detyrime lidhur me ushqyerjen; kanë shkollat e veta, një organizim të vetin komunitar dhe praktikojnë të njëjtin besim, gjë që i vesh ato me personalitet juridik të së drejtës civile<sup>56</sup>. Me këtë ligj, rendi shqiptar fut një nocion për komunitetet fetare, ndër më përparimtarët në nivel evropian<sup>57</sup>. Mund të themi se, pikërisht në

---

<sup>54</sup> *Ibidem*

<sup>55</sup> *Statuti legal i komuniteteve fetare... cit.*

<sup>56</sup> Sot, komuniteti evropian duhet të administrojë marrëdhëniet me të paktën 10 milionë qytetarë (duke përfshirë Turqinë), që i përkasin kulturës islame evropiane dhe aspirojnë për t'u bërë pjesë e këtij komuniteti. Për këtë arsye, përvoja shqiptare është një dhuratë e çmuar që s'duhet nënvlerësuar. Forca e këtyre parimeve që aq e madhe, sa edhe regjimit komunist shqiptar iu desh t'i respektonte, së paku formalisht, duke lejuar lirinë e organizimit të besimeve fetare, deri në momentin kur shpalli ateizmin e shtetit. G. CIMBALO, *Contributo allo studio dell'Islam in Eurvepa*, in *Aequitas sive Deus, Studi In onore di Rinaldo Bertolino*, Torino, Giappichelli, 2011, 557-574.

<sup>57</sup> Ka gjasa të mos e njohë jo vetëm këtë ligj, por edhe të tjerët lidhur me të, O. CARULLI FUMAGALLI, *Lo Stato albanese e le Comunità religiose*, “*Jus*”, LI, gennajo-aprile 2004, 35-49, gjersa përpiket të heqë paralele mes sistemit italian dhe atij shqiptar lidhur me idenë e komunitetit fetar, duke arritur në përfundimin që asnjëri nga këto sisteme nuk ka një koncept të vetin lidhur me besimet fetare. Faktikisht, sistemi shqiptar ka një përvojë të konsoliduar normative lidhur me çështjen e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, si dhe një koncept mjaft të qartë për këto të fundit. Kjo na bën të kuptojmë që gjatë shqyrtimit të *Marrëveshjes për çështjet juridike mes Selisë së Shenjtë dhe*

Shqipëri, arrin kulmin e vet rrugëtimi i gjatë i konceptit *besim fetar*, i cili, pasi ka kaluar nëpër disa sisteme ligjore europiane, gjen tek pluralizmi fetar dhe e drejta civile e këtij vendi ballkanik, mbështetjen e duhur konceptuale dhe strukturore për rregullimin e veprimtarisë fetare, duke i siguruar veshje juridike nocionit *komunitet fetar*<sup>58</sup>. Lidhur me këtë çështje, duhet pohuar se dekreti i vitit 1923 i paraprin Kodit të ardhshëm Civil shqiptar.

Rruga që ndoqi Zogu si ministër i Brendshëm i asaj kohe, gjeti përkrahjen e myslimanëve por u kundërshtua nga ortodoksët dhe katolikët të cilët denonconin lindjen e një kontrolli të rreptë shtetëror mbi kultet dhe shkeljen e normave kushtetuese që garantonin lirinë fetare. Më me forcë u kundërshtuan normat mbi kontrollin e të mirave fetare nga ana e funksionarëve publikë dhe sidomos nevoja e miratimit qeveritar për drejtuesit e kultit, si kusht për ushtrimin e detyrës së tyre. Si katolikët, ashtu edhe ortodoksët kanë nevojë t'i kthejnë sytë nga vendet e tjera për sigurimin e drejtuesve të kultit, duke qenë se ka një prurje fare të vogël si të rishtarëve shqiptarë, ashtu edhe të seminareve për formimin e klerit.

Kritikat ndaj këtyre vendimeve, u bënë shkak për rrëzimin e Zogut nga pushteti në vitin 1924. Nuk qe e rastit që kryengritja e drejtuar aso kohe nga peshkopi ortodoks Fan Noli e gjeti pikën e vet të fortë tek Veriu katolik, pavarësisht se vetë Zogu qe verior, dhe në Jugun ortodoks, në zonat kufitare me Greqinë.

Gjithsesi ka disa arsye të tjera që i shtyjnë komunitet fetare të përshtaten me dekretin<sup>59</sup>. Si pasojë e ngjarjeve ndërkombëtare

---

*Shqipërisë*, nuk është pikasur veçantia lidhur me marrëveshjet e tjera të nënshkruara nga vendet e Lindjes ish komuniste dhe zhvillimet e mundshme që lindin nga nënshkrimi i marrëveshjeve me komunitete të ndryshme fetare, për më tepër të parashikuara në Kushtetutën e vitit 1999, pra, para botimit të artikullit: *La Commissione statale per i rapporti con i Culti*.

<sup>58</sup> Mbi evoluimin e konceptit juridik për besimet fetare, shih: G. CIMBALO, *Integración de los migrantes: un Islam plural para Eurvepa* (Reelaboración de los rascos ordinamentales de la noción de “culto” y de “confesión religiosa” desde la perspectiva de la UE), *Estudios sobre la integración de los inmigrantes*, (Enrique Álvarez Conde – Ana María Salazar dela Guerra Directores), Madrid Instituto de Derecho Público Universidad Rey Juan Carlos, 2010, 75-98.

<sup>59</sup> Lidhur me këtë qëndrim, dëshmojnë kongreset e komunitetit Bektashian dhe mysliman Sunit, ku miratohen statutet që flasin për përshtatjen e qartë dhe të



lidhur me vëllazëritë islame, komuniteti bektashian e ka të nevojshme të forcojë identitetin e vet dhe të qartësojë dallimin me organizatat e besimit islam, qoftë edhe brenda Shqipërisë. Për t'ia arritur kësaj, kërkon mbështetje në dekretin e vitit 1923 sa i përket natyrës juridike të komunitetit fetar dhe thërret me 9 korrik 1924, pranë teqes së Tomorrit, kongresin e tij të dytë që vlerëson dhe miraton statutin e ri të bektashinjve, ku në nenet 1-3 të tij sanksionohet qenësia e tyre e pavarur në brendësi të islamit, duke u dalluar kështu edhe nga komunitetet e tjera myslimane të vendit. Kongresi, pasi vendosi të ndërtonte teqenë e madhe që do të shërbente si seli e Kryegjyshitës dhe e Këshillit Atëror Bektashian të Shqipërisë, emëroi, në udhëheqjen e të gjithë bektashinjve brenda dhe jashtë vendit, Këshillin Atëror<sup>60</sup>.

Kongresi u mbajt thujse një muaj pas formimit të Qeverisë së Përkohshme Demokratike të drejtuar nga Fan Noli, e cila zgjati vetëm gjashtë muaj. Në dhjetor të vitit 1924 Zogu u rikthye në Shqipëri me ndihmën e Jugosllavisë<sup>61</sup>, rrëzoi Fan Nolin dhe qeverinë e tij dhe me 25 janar 1925 u shpall sërish Republika e

---

padiskutueshme të së drejtës së brendshme të komuniteteve me gjendjen e re juridike të krijuar. Shqyrtimi i statuteve na ofron të gjitha elementet për një ridimensionim, në mos një përgënjeshtim të idesë së përhapur gjerësisht mes studiuesve të historisë shqiptare lidhur me vlerën e vërtetë të reformave të mbretit Zog në marrëdhënie me komunitetet fetare, çka e dëshmon fakti që parimet e përmbajtura në to, u rimorën në mënyrë të pavarur nga komunitetet fetare kur këto fituan lirinë për t'u rikonceptuar. Për të gjitha këto shih: R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit., passim*.

<sup>60</sup> *Komuniteti Neni. 1. – Komuniteti Bektashian që përbëhet prej ashikave, muhibane, Varfe, Ater e Gjyshër ashtë Komuniteti independent në fenë Muhamedane ; dhe besimi mbetet trashgim sipas regullit të veçantë. Neni. 2. – Nga Komunitetet e tjerë kurrë kush si ndërhyjnë në të drejtat e përgjithëshme (morale dhe materiale) të këtij Komuniteti. Neni. 3. – Ky komunitet dashurohet me të gjithë vëllazërit Muhamedanë sinqerisht, kur se nuk i bëhet kundërshtim në të drejtat e përgjithëshme. Neni. 1. Komuniteti bektashian përbëhet nga ashikavë, muhibane, Varfe, Etër e Gjyshër dhe është një komunitet i pavarur në brendësi të muhamedanëve; besimi i tyre është një rregull i veçantë. Neni. 2. Komunitetet e tjera nuk ndërhyjnë në asnjë rast në të drejtat (morale dhe materiale) të këtij komuniteti. Neni. 3. Ky komunitet ushqen dashamirësi të sinqertë kundrejt të gjithë vëllazërve të komuniteteve të tjera myslimane, kur kjo nuk bie ndesh me të drejtat e përgjithëshme.*

<sup>61</sup> Qeveria rrëzohet nga bandat e armatosura të Ahmed Zogut, nën mbështetjen e qeverisë jugosllave. S. BENAR., *Fan Nolin, siç e kam njohur*, Dituria, Tiranë, 1997.

Shqipërisë, që do të zgjasë deri me 1 shtator 1928. Kryetar i qeverisë u emërua Ahmet Zogu i cili mbante njëkohësisht edhe detyrën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të Kryetarit të Këshillit të ministrave<sup>62</sup>.

Ndërkohë u miratua një statut i ri që nuk solli ndryshim domethënës në çështjen e marrëdhënieve me kultet. Në nenin pesë të tij ripohohet se shteti nuk identifikohet me ndonjë fe, të gjitha besimet dhe fetë respektohen, garantohet liria e ushtrimit të kultit dhe se përkatësia fetare nuk ndikon në gëzimin e të drejtave civile<sup>63</sup>. Lidhur me komunitetet fetare, neni 120 siguron njohjen nga ana e shtetit të të gjithë personave moralë që e kanë fituar këtë status në mënyrë të ligjshme<sup>64</sup>. Kjo bën që të shtohet interesi nga ana e komuniteteve fetare për hartimin e një statuti që mundëson lirinë dhe pavarësinë e ushtrimit të besimit. Problemet lidhur me ushtrimin e lirisë dhe përkatësisë së ndryshme fetare duket se janë fashitur, çka e dëshmon vëmendja e pakët që u kushtohet atyre, falë edhe efektshmërisë së dekretit mbi njohjen e personalitetit juridik civil. Prandaj, me t'u stabilizuar njëfarësoj gjendja politike, komuniteti Sunit e sheh të udhës të mbledhë më

---

<sup>62</sup> Statuti i ri i Republikës përbëhej nga 142 nene, të ndara në 4 krerë. Pushteti legjislativ i takonte parlamentit që për herë të parë përbëhej nga dy dhoma: Dhoma e deputetëve me 57 anëtarë dhe Senati me 18 syresh. Vihej në dukje pushteti i kreut të shtetit, Ahmed Zogut, që ishte President i Republikës dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave, i zgjedhur për 7 vjet. Po ashtu, u ngrit një këshill për kontrollin e financave dhe u shpall pavarësia e pushtetit gjyqësor. Në vlerësimin e përgjithshëm, i parë nga jashtë, ky model i ngjante atij të Shteteve të Bashkuara. Por, po ta shohësh me vëmendje, ai kishte më shumë tiparet e modelit francez të vitit 1875. Gjithsesi, duhet thënë që, ndryshe nga modeli francez, statuti shqiptar i vitit 1925 nuk arriti të vinte në jetë një sistem të qëndrueshëm parlamentar. Statuti nuk garantonte mbrojtje ndaj sjelljeve autoritare. Në fakt, që në dhjetor të vitit 1925, Zogu miratoi një ligj që parashikonte shtypjen e çdo ndërmarrjeje propaganduese kundër qeverisë dhe ngriti një gjykatë të veçantë në dorë të së cilës lëshoi armiqhtë e vet politikë. Rreth tekstit të statutit të Republikës së Shqipërisë të vitit 1925, shih: *Statuti themeltar i Republikës Shqiptare*. <http://licodu.cois.it/567/view>.

<sup>63</sup>“Art. 5. Republika Shqiptare s'ka fé zyrtare. Të gjitha fét e besimet janë të nderueme dhe lirija e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyne është e sigurueme. Feja nuk mund të formojë pengime juridike me as-nji mënyrë. Fét e besimet kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike.” *Ibidem*

<sup>64</sup>“Art. 120. Shteti njej persona morale të krijueme mbas ligjës.” *Ibidem*

26 korrik 1925 kongresin e dytë të tij, gjatë të cilit miratohet statuti i ri<sup>65</sup>.

Komuniteti drejtohet nga Këshilli Suprem i *Shari'a-s*, me seli në kryeqytet, ku zhvillohet edhe kongresi. Këtu këmbëngulet për ndarjen nga islami turk, ndikuar edhe nga shkarkimi prej detyrës i Cheikh-ul-islam-it nga Mustafa Qemali, quajtur ndryshe Ataturk. Prandaj, myftiu i përgjithshëm që do të përfaqësojë komunitetin duhet të ketë moral të spikatur, formimin e duhur fetar dhe të flasë gjuhën shqipe. Anëtarët e këshillit të *Shari'a-s* zgjidhen nga kongresi, qëndrojnë në detyrë për katër vjet (neni 10) dhe emërimi i tyre kërkon miratimin e Presidentit të Republikës. Drejtuesit e komunitetit, myftinjtë, funksionarët e komunitetit dhe ata që drejtojnë lutjen duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe të mësojnë anglishten për të siguruar komunikimin në nivel ndërkombëtar. Për këtë qëllim parashikohet hapja sa më shpejt e një medreseje në Tiranë ku do të studiohet si historia e vendit, ashtu dhe gjuhët e huaja (neni 44). Këshilli duhet të sigurojë botimin e librave dhe të revistave të komunitetit. Cilësitë që kërkohen për anëtarët e këshillit janë po ato që kërkohen për anëtarët e organeve të decentralizuara të komunitetit. Statuti parashikon detyrat e myftinjve (neni 17, 26) që veç të tjerash duhet të përkujdesen për medresetë nën juridiksionin e tyre, të shpërndara në komunitetet ndër rrethe, të cilët përbëhen prej jo më pak se njëqind familjesh. Komunitetet lokale grupohen në nivel krahinash e këto në nivel kombëtar. Struktura organizuese, bazuar mbi territorin, dëshmon rrënjosjen dhe përhapjen e gjerë të këtij komuniteti në vend. Statuti merret edhe me Vakëfet, drejtuesi kombëtar i të cilit është anëtar i së drejtës së Këshillit Epror të *Shari'a-s* dhe ka për detyrë të mbrojë moralin e anëtarëve të komunitetit (neni 28), t'u sigurojë mbështetje të varfërve dhe të gjitha veprimtarive shoqërore, edhe nëpërmjet kontrolleve që ushtron mbi bilancin e vakëfeve. Një ndër pikat kyçe të rregullores është mbarëvajtja e vakëfeve dhe veprimtaria e tyre, mbarështimi i tyre, kontrolli i bilancit dhe inventari ekonomik (27-44).

Sanksionohet, kështu, kalimi përfundimtar i mbarështimit të vakëfeve në dorë të komunitetit fetar, i cili e përdor atë për

---

<sup>65</sup> *Statuti i Trupit (Xhema-atit) Mysliman Shqipëtarë*, (Tiranë, më 26-VII-925.), <http://licodu.cois.it/625/view>

ruajtjen e kohezionit të brendshëm, duke ushqyer ndjenjën e përkatësisë dhe të devotshmërisë së besimtarëve, edhe falë shërbimeve të ofruara.

Edhe pse nuk shprehet qartazi gjëkund, jemi të mendimit se, në mungesë të një enti shtetëror për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga zakati, i mbetet komunitetit të përkujdeset si për veprimtaritë e kultit, ashtu dhe për administrimin e pasurive të vakëfeve në shërbim të besimtarëve<sup>66</sup>. Kështu, fillon të marrë trajtë veçanësia e islamit shqiptar, që vishet me tipare dalluese të një islami të shtrirë në territorin europian e veçanërisht në Ballkan, ku islami nuk është fe shtetërore<sup>67</sup>.

Së fundi, statuti dikton normat për zhvillimin e kongresit, duke përcaktuar numrin e delegatëve me raportin 1 për 15.000 vota. Nuk ndryshojnë kërkesat për përmbushjen e kritereve të tilla si: mosha (jo më pak se 25 vjeç), shtetësia, njohja e gjuhës, të qenët i padënuar dhe reputacioni i mirë. Kongresi parashikon kontrollin dhe verifikimin e bilancit, miraton dhe verifikon rregulloren, miraton ndryshimet në statut me shumicë kualifikuese 2/3 e kandidatëve, shqyrton dhe kontrollon vendimet e Këshillit të lartë dhe administrimin e vakëfeve; së fundi, atyre që punojnë për komunitetin, statuti u ndalon të zhvillojnë aktivitete që bien ndesh me veprimtarinë fetare. Kongresi, po ashtu, zgjedh Këshillin e kontrollit të përbërë nga 9 anëtarë, një për çdo prefekturë; ai ngarkohet me këtë detyrë nderi dhe në mbledhjen që zhvillohet një herë në vit, me 1 maj, kryen detyrat që i parashikon statuti. Ky

---

<sup>66</sup> Fakti që shteti refuzon të mbledhë taksën e zakatit, përbën një dëshmi tjetër lidhur me natyrën laike të shtetit shqiptar. Lëmosha rituale, që përbën një prej pesë shtyllave të islamit, merr natyrën e një vepre kryekëput fetare dhe si e tillë ka të bëjë vetëm me komunitetet e veçanta fetare, të cilët e vënë në shërbim të misionit të tyre në shoqëri. Lidhur me zakatin, shih : F. CASTRO, *Diritto musulmano*, in *Digesto nelle discipline privatistiche: sezione civile*, Torino, UTET, 1994, vol.6, 290 ss; ID., *Il modello islamico*, Torino Giappichelli, 2007.

<sup>67</sup> Në thelb, kemi të bëjmë me një rregull, i cili lejon mënyrën e të jetuarit sipas parimeve të islamit, ku egziston një hapësirë kulturore dhe shoqërore e mbrojtur juridikisht dhe e zotëruar nga myslimanët, të cilët kanë strukturën e tyre fetare të pavarur dhe gëzojnë mundësinë e të jetuarit në respekt të plotë me normat e kuranit, në kuadrin e lirisë fetare, lirisë së proselitizmit, pluralizmit fetar dhe tolerancës: hapësira ku ka vend për islamin pluralist. Për më shumë shih: A. AAMI A. ABU-SAHLIEH, *Il diritto islamico. Fondamenti, fonti, istituzioni*, (nën kujdesin e Marta Arena-s), Roma, Carocci, 2008, f. 517-546.

statut i jep fizionominë dhe trajtën përfundimtare komunitetit islam Sunit të Shqipërisë dhe sanksionon fundin e fazës së themelimit të komunitetit islam në vend.

Siç do të shohim në vijim, komunitetet më të vogla si ai i Alevitëve, etj., do të bëhen pjesë e njërit prej dy grupeve më të mëdhenj të myslimanëve<sup>68</sup>.

Ndërkohë, kriza politike e detyron Nolin, të dënuar tashmë me vdekje nga Zogu, të lërë Shqipërinë duke krijuar kështu një boshllëk të madh brenda Kishës ortodokse e cila po kërkonte autoqefalinë e vet, por në mungesë të ndjeshme të episkopëve që duhej të ndiqnin këtë çështje<sup>69</sup>. Pas kongresit të parë të ortodoksëve shqiptarë, Patriarku Ekumenik i Kostandinopojës

---

<sup>68</sup> Shqipëria, ashtu si i gjithë Ballkani deri në Anatoli, është një vend ku gjëlljnë disa vëllazëri islame. Shih: G. CIMBALO, *Le confraternite* "...cit., passim

<sup>69</sup> Autoqefalia iu dha, jo pa kundërshtime, të gjitha vendeve me shumicë ortodokse që dolën nga shpërbërja e Perandorisë Osmane, edhe për shkak të lidhjes mes juridiksionit kishtar dhe territorit të shtetit. Në disa raste, si më emblematiku, ai i Bullgarisë dhe kishës ortodokse bullgare, lëshimi i autoqefalisë, që u bë shumë kohë më parë rënies së perandorisë, kishte shkaktuar jo pak polemika. Gjatë Perandorisë Osmane (1453-1923), të gjithë Ortodoksët, banorë të Perandorisë, pa asnjë përjashtim, ishin nga pikëpamja civile, nën pushtetin civil dhe kishtar të Patriarkut së Kostandinopojës, të emëruar me dekret të Sulltanit dhe të quajtur *milet bashi*, pra *ethnarca* apo *kryetar i kombit*. Në fund të shekullit XIX, komuniteti bullgar, me mbështetjen e diplomacisë ruse, ia doli të merrte nga Sulltani një dekret, i cili i njihte bullgarët si komb i ndryshëm nga ai grek, për pasojë bullgarët nuk i nënshtroheshin më Patriarkanës së Kostandinopojës, por përbënin një millet më vete, të themeluar në vitin 1870. Kisha ortodokse bullgare, e kishte fituar autoqefalinë që në shekullin XI, por tashmë bullgarët nuk kontribuonin më për financat e administruara nga Fanari, por i paguanin taksën Sulltanit nëpërmjet mileteve të tyre. Pikërisht për këto arsye, ipeshkvinjtë grekë të Patriarkut të Kostandinopojës mblodhën në vitin 1872 një sinod ku u dënua pavarësia e bullgarëve, me pohimin që ata duan etninë e tyre (phylo – i dashur + ethnos – komb) më shumë se Krishtin. Pavarësisht kësaj, etnia, sipas normave të Kishës ortodokse, përbën një prej parimeve bazë të organizimit të kishës. Sinodi grek i vitit 1872 e shpalli dashurinë për kombin si herezi, por, deri më sot, asnjë autoritet tjetër i Kishës ortodokse nuk e ka njohur këtë vendim. Në fakt, kanoni 34 apostolik pohon se "ipeshkvinjtë e një kombi (ethnos) duhet të dinë se kush është i parë ndër ta, dhe duhet ta njohin atë si kryetar; të mos ndër marrin asgjë me rëndësi pa e njoftuar, dhe secili le të shohë vetëm punët e dioqezës dhe të fshatrave në varësi të tij, por pa ndërmarrë asnjë punë të rëndësishme pa lajmëruar të tjerët". Për më tepër shih: G. GRIGORITA, *Il concetto di ecclesia sui iuris. Un'indagine storica, giuridica e canonica*, Roma 2007, passim.

kishte pranuar t'u njihte atyre statusin e kishës autonome, duke i hapur rrugë kështu celebrimit të liturgjisë në gjuhën kombëtare dhe zgjedhjes së priftërinjve vendas, me kushtin e vetëm që të njihnin autoritetin e Patriarkut Ekumenik, i cili ushtronte të drejtën e emërimeve episkopale. Nga ana tjetër, Kisha ortodokse e Shqipërisë vepronte në një vend me shumicë myslimane, prandaj lindte nevoja e ushtrimit të kontrollit nga ana e Fanarit të hierarkisë, në mënyrë që emërimet episkopale të mos kushtëzoheshin nga pushteti politik<sup>70</sup>. Qeverisë shqiptare nuk i pëlqente kjo gjë, jo vetëm sepse në vend të emërimit të një peshkopi tjetër ortodoks si titullar dioqeze në Shqipëri, preferohej kthimi i Nolit nga mbështetësit e autoqefalisë së kishës shqiptare, por edhe sepse mbajtja e lidhjeve të ngushta me Fanarin i mundësonte Greqisë, që synonte territoret e Epirit të veriut, të ushtronte një ndikim të fortë mbi popullsinë e zonave me gjuhë dhe kulturë greke, nëpërmjet episkopëve grekë, me ndërmjetësinë e Patriarkanës. Autoqefalia e ortodoksëve shqiptarë nuk ishte thjesht një çështje kishtarë dhe shpirtërore, por kishte një dinamizëm të fortë politik, çka e dëshmon dhe fakti që në brendësi të komunitetit ortodoks formohen dy fraksione: i ashtuquajtimi "kombëtar" dhe ai prej pro Patriarkanës. Kjo është arsyeja që e shtyn qeverinë të ndërhyjë, duke nxitur hierarkinë e Kishës ortodokse serbe të sigurojë emërimin e një peshkopi në Shqipëri duke përfutur nga prania e një pakice serbe në veri të vendit. Pasoja do të ishte e dyfishtë: të shtrinte ndikimin e kësaj Kise në Shqipëri, në dëm të asaj të Kostandinopojës dhe të shkëpuste nga fanari Kishën ortodokse shqiptare, çka do të siguronte fitimin e autoqefalisë<sup>71</sup>. Një kërkesë e tillë u mirëprit dhe ipeshkvi i ri Viktor mbërrin në Shkodër për t'u kujdesur për pakicën serbe në këtë qytet dhe në rrethinat e tij<sup>72</sup>.

---

<sup>70</sup> Fanari (turq. Fener) është lagjia ku rrinte qëmoti Patriarkana Ekumenike e Kostandinopojës dhe përdoret si sinonim për të emërtuar këtë institucion kishtar.

<sup>71</sup> *Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, Simposium, Tiranë 19 shtator, 1992, Tiranë, Akademia Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1993; R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 44-62.

<sup>72</sup> Në Shkodër dhe rrethinat e saj kishte një pakicë serbe dhe malazeze prej rreth 6000 vetash. Një komunitet tjetër minoritar, me rreth 30000-50000 banorë e përbënin rumunët; grekët, nga ana tjetër, ishin një komunitet më i gjerë

Qeveria ndërhyri tek Fanari, i cili ndodhet nën presionin e diplomacisë italiane dhe të fuqive të tjera të interesuara të pengonin stabilizimin e Shqipërisë<sup>73</sup> dhe ta mbanin si gur shahu qeverinë shqiptare, por duke qenë se Patriarkana Ekumenike nuk ia mori parasysh kërkesat, qeveria vendosi të shfrytëzojë mjetet që i ofronte legjislacioni kombëtar mbi komunitetet fetare, në mënyrë që të arrijë një stabilizim më të qëndrueshëm. Kështu, u kërkohet komuniteteve fetare të hartojnë statutet e reja duke e vënë theksin tek karakteri i tyre kombëtar, tek roli i tyre si garant themelor i kompaktësisë kombëtare dhe tek nevoja për t'i qëndruar besnik traditës popullore dhe juridike shqiptare. Këtë e mundëson miratimi i një ligji të ri mbi komunitetet fetare që vë në zbatim dekretin e vitit 1923 i cili i njeh komunitetet si personalitete juridike civile.

Ndërkohë që ky propozim i qeverisë merr pëlqimin e sunitëve, bektashinjve dhe ortodoksëve, të cilët u përgjigjen pozitivisht kërkesave të tij, vështirë të gjejë pëlqimin e Kishës katolike, e cila kërkon të mbajë lidhjet me Romën dhe të ruajë karakterin e kishës universale<sup>74</sup>. Pozicioni i saj gjeografik si një vend mes Lindjes dhe Perëndimit e bën të pashmangshëm varësinë e saj ndaj Selisë së Shenjtë, e cila e sheh me interes strategjik veprimtarinë e konsolidimit dhe shtrirjes së katolicizmit në Shqipëri. E vetëdijshme për mangësitë e klerit të ritit latin, Selia e Shenjtë do t'ua besojë, edhe pse pa rezultat, murgjëve të Abacisë së Grottaferrata-s detyrën e proselitizmit dhe të ungjillëzimit në

---

minoritar i vendosur në Jug të Epirit, krahinë mjaft e lakmuar nga Greqia, e cila e kishte pushtuar ushtarakisht gjatë viteve 1919- 1921. R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit*, 54.

<sup>73</sup> Shih: R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit*, 63 e n. 129, i cili rindërton ngjarjet e brendshme të kishës ortodokse të pavarur të Shqipërisë dhe negociatat e qeverisë shqiptare me Fanarin, me qëllim heqjen e pengesave për miratimin e tomos-it për njohjen e autoqefalisë, duke shfrytëzuar marrëdhëniet diplomatike italiane dhe franceze.

<sup>74</sup> Duhet mbajtur parasysh gjendja e veçantë e Kishës katolike në Shqipëri, së cilës i ishte imponuar riti latin, pikërisht për ta mbajtur sa më larg të qe e mundur nga Ortodoksët dhe nga çdo ndikim i mundshëm i tyre. Kjo zgjedhje përjetohej si një vendim larg traditës vendase, sidomos në territoret e banuara nga myslimanët dhe ortodoksët që, në këndvështrimin dhe synimet e kishës së Romës, duheshin ungjillizuar, aq më tepër kur hierarkia kishtare emërohej direkt nga Roma dhe po nga Roma vinin anëtarët e urdhërave fetarë, sidomos françeskanët dhe jezuitët.

pjesën qendrore të jugut të vendit. Murgjit bazilianë të kësaj abacie, të themeluar pesëdhjetë vjet para shizmës që çoi në ndarjen mes katolikëve dhe ortodoksëve (1054), kanë qenë gjithnjë të bashkuar me Kishën e Romës, ndonëse kanë ruajtur ritin bizantin dhe traditën e manastireve të Lindjes, nga e kishin origjinën. Për këto veçori, murgjit e abacisë u çmuan nga Selia e Shenjtë si më të përshtatshmit për të predikuar katoliçizmin në tokën shqiptare, ku ruhej e fortë tradita liturgjike greko-bizantine. Pikë kryesore për depërtimin e tyre në territorin shqiptar qe famullia e administruar prej tyre në Vlorë<sup>75</sup>.

---

<sup>75</sup> Për më tepër shih: L. ANGELI MURZACU, *Returning home to Rome*. The Basilian monks of Rottaferrata in Albania, Grottaferrata, Αναλεκτα Κρυπτοφερρης, 2009., 111- 170.



## 1. 4. Monarkia e Zogut dhe institucionalizimi i komuniteteve fetare

Miratimi i kushtetutës së vitit 1928 dhe vendosja e Monarkisë së Zogut<sup>76</sup> shënuan fillimin e një transformimi të shpejtë të sistemit shqiptar, i cili u pajis me kodet e veta e veçanërisht me Kodin e parë Civil të saj<sup>77</sup>. Me 9 korrik 1929, me propozim të kryeministrit, u miratua një dekret i ri mbi formimin e komuniteteve fetare, i cili përmban dispozita që u mundësojnë atyre fitimin e personalitetit juridik dhe miratimin e statuteve si dhe rregullojnë veprimtarinë e tyre<sup>78</sup>, duke u mbështetur edhe në nenet 450-451 të Kodit Civil për çështje lidhur me personat moralë<sup>79</sup>.

---

<sup>76</sup> Edhe pse në nenin 141 të Statutit të vitit 1925 thuhet se *forma e Republikës nuk mund të ndryshohet*, në vitin 1927, Asamblea Kushtetuese, vuri dorë mbi të, duke e ndryshuar statutin, dhe më pas shpërndau parlamentin (12 qershor 1928) dhe vendosi Monarkinë, duke e shpallur Ahmed Zogun, Mbret të shqiptarëve, më 22 nëntor 1928. Statuti i ri i hartuar nga Monarkia shqiptare, edhe pse laik (meqë besimet fetare nuk mund të përdoren për qëllime politike apo për të ndërtuar parti fetare dhe as për të kandiduar drejtuesit fetarë në poste politike), megjithatë i detyroi deputetët të betohen para Zotit.

<sup>77</sup> Së pari, u ndryshua Kodi Penal i vitit 1928, redaktimi i të cilit u bë nga Terenc Toçi. Më pas edhe Kodi Civil (1929) dhe Kodi Tregtar (1932). Kodi Civil ishte mjaft më i moderuar se e drejta kushtetuese e së shkuarës, pasi rimerrte dhe përpunonte disa zëra të kanunit. Ai u ndërtua mbi Kodet klasike të kohës, një ndër të cilët ishte Kodi i Napoleonit, por edhe mbi Kodin Civil italian të vitit 1865 dhe atij zvicerian. “...një pjesë e mirë e këtij kodi, ishte thuajse riprodhim i plotë i teksteve juridike më të mira europiane, për unifikimin e së drejtës private. Kodi tregtar u hartua nga profesori i shquar, *Vivante*”. F. Jacomoni di San Savino, *La politica dell'Italia in Albania nelle testimonianze del Luogotenente del Re*, cit. 170. Edhe pse modeli ishte europian, rregullimi i disa çështjeve ishte krejt origjinal dhe respektonte tiparet e së drejtës shqiptare, sidomos lidhur me çështjet familjare, ku viheshin më shumë në dukje lidhjet me rregullat kanunore. Lidhur me këtë, shih: S. Villari, *Le consuetudini giuridiche dell' Albania*, Roma, Società ed. del Libro italiano, 1940, 75-110.

<sup>78</sup> *Dekret-Ligjë mbi Formimin e Komuniteteve Fetare*, 9 Korrik 1929, <http://licodu.cois.it/413/view>

<sup>79</sup> Neni 450. *Këshilli Ministrues, mbi propozimin e prefekturës dhe mbasi të marrë mendimin e këshillit të bashkisë dhe të ndëgjojë autoritetin e epërm të fondacionit, mundet me modifikue organizimin e fondacionit, kur kjo masë është absolutisht e nevojshme për konservimin e pasurisë ose për mbajtjen e qëllimit të themeluesit*. Neni 451. Gjith'ashtu Këshilli Ministrues tue mbajt formalitetet, munt të modifikojë qëllimin e fondacionit, kur karakteri ose randësia e qëllimit të parë ka ndryshue aq sa fondacioni qartazi nuk i përgjigjet më qëllimit të

Dekreti garanton lirinë e komuniteteve fetare duke filluar nga njohja e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë së individëve (neni 1), e cila gjen shprehje gjithashtu në nenet 5 e 203 të statutit të Monarkisë. Ndërkohë roli formues i komuniteteve fetare ka për qëllim ushtrimin e lirive dhe të të drejtave të garantuara në nenin 1 të dekretit. Veprimtaria e komuniteteve fetare zhvillohet në përputhje me këtë dekret. Në nenin 4 thuhet se miratimi i statuteve, të hartuara dhe miratuara nga komuniteti, i takon qeverisë. Statutet hyjnë në fuqi me pëlqimin e mbretit. Neni 3 e ndalon pjesëmarrjen e klerit në jetën politike të vendit dhe shkon deri aty sa në nenin 12 u ndalon klerikëve të marrin përsipër poste politike dhe gjyqësore. Me rëndësi të veçantë janë nenet 6, 7 dhe 8 që përcaktojnë të drejtat e shtetit mbi besimet fetare dhe mbi funksionarët e tyre, të cilët, në bazë të nenit 9, 10, 11 i nënshtrohen kontrollit të mbretit. Marrëdhëniet mes komunitetit dhe shtetit mbahen nga Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet organeve të posaçme siç është Komiteti për Çështjet Fetare. Ky organ, edhe pse i emërtuar ndryshe, mbijetoi deri më sot në të drejtën dhe strukturën institucionale shqiptare me rolin e ndërmjetësit mes shtetit dhe besimeve fetare.

Gjatë predikimeve të tyre, funksionarët klerikë duhej të transmetonin dhe të rrënjosnin tek besimtarët dashurinë për vendin<sup>80</sup>. Komunitetet kishin të drejtë të hapnin shkolla fetare dhe të ndërtonin godina kulturi; përjashtojë ekzistenca e gjyqtarëve

---

themeluesit. Mund të syprimohen ose të modifikohen po n'atë mënyrë dhe n'ato çirkostanca barrët dhe konditat që kompromentojnë qëllimin e themeluesit. Neni 452. Këshilli i ministrave, pas një prvepozimi konkret dhe këshillimit me këshillin e komunës dhe pasi të ketë marrë mendimin e drejtuesve të lartë të fondacionit, mund ta modifikojë strukturimin e tij, vetëm nëse lind nevoja e padiskutueshme për mbrojtjen e pasurive dhe qëllimit të themeluesit. Neni. 451. Këshilli i Ministrave, në përputhje me të gjitha formalitetet, mund ta modifikojë qëllimin e fondacionit kur karakteri apo rëndësia e këtij qëllimi ka ndryshuar qartazi dhe nuk përputhet më me atë të themeluesit. Po kështu dhe në të njëjtat rrethana mund të shfuqizohen apo modifikohen kushtet që cenojnë apo kompromentojnë qëllimin e themeluesit. Kodi civil i Shqipërisë 1929.

<sup>80</sup> Në dekret parashikohej gjithashtu që funksionarët fetarë duhet të kenë mbushur 25 vjeç, të mos jenë dënuar, të mos jenë fajtorë për krime antipatriotike. Në nenet 15-19 të dekretit parashikoheshin sanksionet civile dhe përgjegjësitë e funksionarëve fetarë, në rast dhunimi të tyre.

fetarë si për çështje civile, ashtu dhe fetare, pavarësisht mungesës së reformës së Kodit të procedurës civile dhe asaj penale.

Politika e qeverisë së vitit 1928 lidhur me marrëdhëniet e vendosura me komunitetet fetare, ndryshe nga ç'pohojnë disa<sup>81</sup>, nuk është vetëm një rimarrje përsëdyti e politikës së Zogut gjatë periudhës së Republikës në fillim të viteve '20, kur ky ishte ministër i Brendshëm, tashmë bëhet fjalë për një linjë politike më të rafinuar dhe komplekse të qeverisë, që lidhej me rolin që monarku kishte parashikuar për atdheun e tij në arenën ballkanike. Në përpjekjet e tij për modernizimin e vendit dhe në garën e tij me Qemal Pashanë për të fituar vendin e leadership-it të lëvizjes së botës myslimane, Zogu kishte nevojë për mbështetjen e komuniteteve fetare dhe për "shqiptarizmen" e tyre<sup>82</sup>.

Projekti i tij politik ishte të forconte identitetin kombëtar dhe të zgjeronte sa më shumë kufijtë e mbretërisë, duke e shtrirë ndikimin e vet mbi të gjithë përbërësit etnikë shqiptarë në trevat ballkanike, pavarësisht vështirësive jo të vogla në marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe Greqinë, ku shtriheshin territore dhe popullsi etnike shqiptare, përkatësisht Kosova, trevat shqiptare të Maqedonisë dhe Çamëria. Sipas këtij projekti, komunitetet fetare duhej të mbështesnin regjimin.

Miratimi i dekretit i kushtëzoi komunitetet fetare të hartonin statute të reja për t'iu përshtatur ligjit të ri në mënyrë që të përfitonin nga favorët që u siguronte ai, sidomos lidhur me aftësinë juridike dhe mbarështimin e pasurisë së tyre<sup>83</sup>. Komuniteti mysliman mblodhi kongresin e zakonshëm dhe miratoi statutin që, më pas, u ratifikua nga qeveria<sup>84</sup>. Statuti përbëhet nga dhjetë

---

<sup>81</sup> Lidhur me këto shih: R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 105 ss.; A. BIAGINI, *Storia dell'Albania* dall'origine ai nostri giorni, Bompiani, Milano, 1998, *passim*.

<sup>82</sup> Një prej kushteve që u kërkohej të përmbushnin drejtuesit e komuniteteve fetare ishte pasja e shtetësisë shqiptare dhe njohja e gjuhës shqipe, edhe për faktin se ritet fetare duheshin celebruar në gjuhën shqipe (neni 7 ss).

<sup>83</sup> Shih: *Statuti i Komuniteti Bektashian Shqiptar*, 26 Shtator 1929; *Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar*, 8 Gusht 1929; *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, 12 Shtator 1922, të gjitha mund të gjenden në: [http://Licodu.cois.it/Albania/comunita\\_religiose/generale/](http://Licodu.cois.it/Albania/comunita_religiose/generale/)

<sup>84</sup> Me 8 gusht 1929 mbreti Zog I dha mendimin e tij mbi statutin e komunitetit Mysliman duke mbështetur propozimin e Këshillit të Ministrave. Statuti u miratua gjatë Kongresit III të myslimanëve dhe u nënshkrua nga Vehbi Dibra,

kapituj dhe përmban disa dispozita kalimtare. Komuniteti mysliman përbëhet nga të gjithë myslimanët shqiptarë që i përkasin çdo lloj tradite besimi apo vëllazërie (neni 1-4). Organet e tij drejtuese janë Këshilli i Përgjithshëm, Drejtoria e komunitetit, Këshilli i Përhershëm, Drejtori i përgjithshëm i administratës financiare të vakëfeve, Kryemyftiu, myftinjtë, zëvendësmyftijtë dhe këshillët e qarqeve të funksionarëve (neni 2). Komuniteti mysliman është person juridik dhe gëzon të gjitha të drejtat e personave moralë, në bazë të Kodit Civil (neni 3); gjuha e tij zyrtare është shqipja.

Kapitulli i dytë i statutit, në vija të përgjithshme, nuk ndryshon shumë nga ai paraardhës. Këtu përcaktohen detyrat e Këshillit të Përgjithshëm, i cili përbëhet nga kryetari, 4 kryemyftinj dhe nga një i deleguar për çdo prefekturë<sup>85</sup>. Detyra e këshilltarit zgjat për pesë vjet dhe kompetencat e tij janë të përcaktuara qartë në rregullore. Këshilli i Përgjithshëm merr vendime për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë së komunitetit, kujdeset për edukimin fetar-patriotik dhe kulturimin e besimtarëve të vet dhe së fundi kontrollon përmbushjen e detyrave nga ana e organeve të tij, duke u mbledhur çdo 1 maj në një seksion të zakonshëm, i kryesuar nga drejtuesi i komunitetit. Në rast nevoje, mund të thërritet një seksion i jashtëzakonshëm me kërkesën e dy të tretave të anëtarëve të Këshillit.

Kapitulli i tretë përmban nenet 8-15 ku trajtohet drejtoria e komunitetit, e administruar dhe përfaqësuar nga një kryetar i zgjedhur me votë të fshehtë nga Këshilli i Përgjithshëm me dekret të Mbretit. Një ligj analog me këtë ishte i nevojshëm për shkarkimin e tij (neni 33 i statutit), që bëhej në ato raste kur ky kryente krime kundër lirisë personale, ose nëse ishte i dënuar me më shumë se një vit heqje lirie apo burg të sigurisë së lartë për

---

kryetar i këtij komuniteti. "Gazeta Zyrtare", nr. 53, 24 gusht, 1939, 6. Ref.: <http://licodu.cois.it/417/view>

<sup>85</sup> Neni 6 përcaktonte kompetencat: 1) shqyrtim dhe miratim i bilancit të të ardhurave, 2) kontroll i rregulloreve dhe punës së të gjitha organeve dhe çdo funksionari të komunitetit, 3) kontroll i punës së drejtorisë së përgjithshme të vakëfeve, të drejtorisë së medresesë së përgjithshme dhe të kryemyftinjve.

krime të tilla si: mashtrime, vjedhje si dhe për krime kundër zakoneve të mira<sup>86</sup>.

Kapitulli i katërt (neni 16,17) u kushtohet Këshillit të Përhershëm dhe atij të Përgjithshëm që e kishin selinë në kryeqytet, Tiranë<sup>87</sup>. Në kapitullin e pestë (neni 18 e 23) u kushtohet vëmendje Drejtorisë së përgjithshme, administrimit financiar, vakëfeve dhe drejtorit të saj, i cili zgjidhej nga Këshilli i Përgjithshëm e më pas miratohej nga Mbreti<sup>88</sup>. Administrimi i drejtpërdrejtë i vakëfeve nga ana e komunitetit përbën provën e vërtetë të ndarjes së shtetit nga feja, duke qenë se u lejon strukturave të saj të administrojnë

---

<sup>86</sup> Në rast së i zgjedhuri nuk kishte pëlqimin e mbretit, Këshillit të Përgjithshëm i lindte detyra të zgjidhte një kryetar të ri, duke ndjekur të njëjtën procedurë si për kandidaturën e parë. Kryetari duhej të ishte i diplomuar në teologji (të kishte marrë ixhazet) apo të kishte kryer shkollën *Nuv-vabit* dhe të mos ishte dënuar kurrë për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 33 të statutit. Para se të merrte detyrën e re, kryetari duhej të betohej para mbretit për besnikëri ndaj mbretit të Shqipërisë, atdheut, statutit themeltar të shtetit dhe të ishte garant për besnikërinë e të gjithë funksionarëve që vareshin prej tij. Po ashtu, betohej para këshillit të përgjithshëm, se do të zbatonte me besnikëri parimet fetare dhe do të respektonte statutin dhe rregulloren e komunitetit me ndërgjegje patriotike. Kryetari përfaqësonte komunitetin nga pikëpamja fetare, drejtonte zyrat, jepte urdhëra, merrte masat e nevojshme për mbarëvajtjen e përgjithshme të komunitetit. Në pamundësi të përmbushjes së detyrës së tij, zëvendësohej nga Kryemyftiu i qendrës; në rast se vendi i tij mbetej vakant, brenda 10 ditëve mblidhej Këshilli i Përgjithshëm dhe zgjidhte një kryetar të ri.

<sup>87</sup> Anëtarët e Këshillit të Përhershëm ishin: kryetari, drejtori i drejtorisë së përgjithshme të administratës financiare të vakëfeve, drejtori i medresesë së përgjithshme, Myftiu i madh i qendrës. Këshilli i përgjithshëm mblidhej së paku një herë në javë dhe vendoste mbi çështje të ndryshme të komunitetit si: emërime, zëvendësime, transferime të funksionarëve të ndryshëm, mbikëqyrte përmbajtjen e librave fetarë të nevojshëm për shkollat e besimtarëve, siguronte botimin e një reviste me karakter fetar-letrar, përkujdesej për lutjet në gjuhën shqipe dhe shpërndarjen e tyre, hartonte rregulloret e komunitetit, ndiqte mbarëvajtjen e kurseve për t'i ardhur në ndihmë formimit të imamëve. Vendimet merreshin me shumicë votash dhe u përcilleshin zyrove përkatëse. Në rast barazie votash, merrte përparësi qëndrimi i kryetarit.

<sup>88</sup> Drejtori bënte të njëjtin betim si kryetari dhe duhej të zotëronte po ato cilësi që kërkoheshin për kryetarin e komunitetit. Drejtori përfaqësonte administratën financiare të vakëfeve, mbante korrespondencën me qeverinë për çështjet financiare, hartonte bilancin, përcaktonte shpenzimet dhe të ardhurat e komunitetit, merrte kredi me miratimin e këshillit të përgjithshëm. Drejtori nuk mund të merrte përsipër detyra shtetërore. Shkarkimi i tij mund të bëhej me kërkesën e dy të tretëve të anëtarëve të këshillit të përgjithshëm.

burimet ekonomike që vihen në shërbim të besimtarëve si dhe u njeh komuniteteve fetare të drejtën të vendosin për shpërndarjen e lëmoshave rituale dhe të dhuratave.

Në kapitullin e gjashtë (neni 24-36) përcaktohen detyrat e kyemyftinjve dhe qarqeve administrative. Kryemyftinjtë, të zgjedhur nga Këshilli i Përgjithshëm dhe të miratuar nga Mbreti, bëjnë betimin para kryetarit të komunitetit<sup>89</sup>. Me dekret të kryetarit të komunitetit emëroheshin në xhami, imamë, hatibë, vaizë, myezinë, të zgjedhur nga drejtuesit e tyre, para të cilëve bënë betimin (neni 26). Detyra e këtyre funksionarëve përjashtonte çdo lloj detyre fetare, private apo tregtare, përveç profesionit të mësimdhënies, që mund të ushtrohej duke kërkuar së pari autorizimin e kryetarit të komunitetit.

Në kapitullin e tetë përfshiheshin nenet 40-52 ku trajtoheshin vendimet e menjëhershme lidhur me çështje të administrimit financiar të vakëfeve. Kjo pjesë e statutit ka një rëndësi të veçantë pasi rregullon aktivitetin ekonomik të komunitetit, jo vetëm në shërbim të tij, por edhe me shërbime të karakterit shoqëror, të ndihmës për të sëmurët, të edukimit, formimit si dhe mbështetjes së të varfërve, pikërisht me ndihmën e vakëfeve<sup>90</sup>.

---

<sup>89</sup> Po ashtu, përcaktoheshin detyrat e myftinjve, të zëvendës myftijve dhe të këshilltarëve të funksionarëve. Në qendrat e krahinave detyrën e myftiut e kryente kryemyftiu i zonës. Ata duhej të ndiqnin urdhërat dhe vendimet e marra nga kryetari i këshillit të përgjithshëm. Duhej të siguronin nëpërmjet predikimeve të tyre, vëllazërinë mes myslimanëve, të kontribuonin për unitetin kombëtar, të mbanin gjallë ndjenjën patriotike dhe t'i ftonin qytetarët të pajtoheshin me qytetërimin modern.

<sup>90</sup> Të mirat e vakëfeve përbënin një pjesë të pasurisë së komuniteteve që administrohej nga drejtorja e përgjithshme sipas një rregulloreje të posaçme. Bënin përjashtim nga ky rregull të gjitha vakëfet e xhamive që organizoheshin në mënyrë të pavarur. Të ardhurat e tyre përbënin një pjesë të konsiderueshme të komunitetit. Kryemyftinjtë dhe myftinjtë administronin, për llogari të drejtorisë së përgjithshme, vakëfet e seksioneve përkatëse dhe shërbenin si administrues të vakëfeve. Sipas nevojave, mund të emëroheshin nëpunës të veçantë, sekretarë dhe llogaritarë të vakëfeve. Drejtorja e përgjithshme, në bazë të marrëdhënieve që lindnin nga seksionet, përgatiste vit pas viti, me datë 1 maj buxhetin, duke ia nënshtruar më pas për verifikim këshillit të përgjithshëm. Në të njëjtën kohë paraqitej edhe buxheti i vitit paraardhës. Çdo hyrje dhe dalje duhej dokumentuar. Viti financiar fillonte me 1 qershor dhe mbyllej me 31 maj të çdo viti. Në rast vonese, i duhej kërkuar leje Ministrisë së Drejtësisë për t'i shtyrë afatin e mbylljes së bilancit. Pra, veprimtaria e vakëfeve i nënshtrohej kontrollit

Në kapitullin e nëntë ku përfshihen nenet 53, 54, trajtohen çështje lidhur me xhamitë dhe mesxhidet, që nuk duhej të mungonin në asnjë qytet dhe fshat, ndërsa kapitulli i dhjetë (55-60) merrej me medresenë e përgjithshme<sup>91</sup>.

Statuti mbyllej me disa dispozita në nenet 61 e 69 kushtuar pavarësisë së Këshillit të Përgjithshëm, organizimit të komunitetit

---

të rreptë shtetëror mbi përmbushjen e qëllimeve shoqërore, pasi nëpërmjet drejtimit të tyre vlerësoheshin kapacitetet e komunitetit Mysliman. Regjistrat dhe veprimet financiare mbaheshin qartë dhe me rregull. Të ardhurat e komunitetit përbëheshin nga fitimet e vakëfeve dhe nga ndihmat e subvencionet e ndryshme shtetërore. Çdo familje myslimane duhej të paguante një taksë fakultative që mund të ishte pesë, tre apo një frangë ari. Masa e taksës përcaktohej nga këshilli i pleqve të çdo zone. Familjet që nuk shlyenin taksën mund të përjashtoheshin nga pjesëmarrja në ceremonitë fetare. Ky vendim merrej nga kryemyftinjtë, myftinjtë dhe zëvendësmuftinjtë. Në rast se ndonjë prej funksionarëve fetarë ua rikthente mundësinë e jetës fetare, duke i bërë pjesëmarrës në shërbimet fetare, mund të ndërshkohej me masë disiplinore. Nuk mund të pranoheshin subvencione nga shtetet e huaja.

<sup>91</sup> Komuniteti mysliman sunit shqiptar duhej të kishte një institucion shkollor pranë qendrës së Tiranës, medresenë e përgjithshme, e cila duhej të ofronte arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Medreseja duhej të kishte një godinë konvikti të përhershme, të financuar nga të ardhurat e komunitetit. Në këtë mënyrë shkolla mund të ndiqej nga studentë të të gjitha zonave të Shqipërisë, pranimiti i të cilëve bëhej sipas një rregulloreje të brendshme. Medresetë e zonave periferike do të mbylleshin dhe vakëfet e tyre ktheheshin në të ardhura për komunitetin. Funksionarët e këtyre medreseve mund të vazhdonin t'u jepnin mësimet fetare personave të interesuar, pasi të kishin marrë pëlqimin e myftiut të madh të zonës. Drejtori i medresesë së përgjithshme zgjidhej nga Këshilli i përgjithshëm dhe e merrte shërbimin pas dekretimit mbretëror. Profesorët (*myderize, vaize*) e instituteve shkollore propozoheshin nga drejtori, emëroheshin nga këshilli i përhershëm dhe dekretoheshin nga kryetari i komunitetit. Stafi i mësuesve të shkollës kishte për detyrë të hartonte draftin e revistës së komunitetit mysliman. Personeli i shkollës, përveçse duhej të përmbushte të gjitha cilësitë e kërkuara për funksionarët e komunitetit mysliman Sunit, duhej të kishte kryer gjithashtu studimet në një fakultet të Universitetit të Tiranës ose jashtë vendit dhe të kishte përfunduar praktikën në shërbim të Sheriatit (të kishte studiuar librin e shenjtë të kuranit dhe të të gjitha shkrimeve fetare), si dëshmi e njohjeve të tij fetare. Organizimi i brendshëm, programet shkollore, administrimi i medresesë së përgjithshme dhe detyrimet e personelit përcaktoheshin nga rregullorja e brendshme e saj. Me këtë vendim, formimi i kadrove drejtues të komunitetit mbikqyrej dhe i nënshtrohej një kontrolli të rreptë.

musliman dhe detyrimeve të tij ndaj shtetit për të vijuar me dispozitat kalimtare përfshirë në nenet 70-72<sup>92</sup>.

Siç mund të vihet re, gjurma juridikionale është e fortë dhe kushtëzon vendosjen e marrëdhënieve mes shtetit dhe komunitetit fetar. Vëmendja e veçantë që i kushtohet rregullimit të veprimtarisë së vakëfeve dhe kërkesa për kontribute sipas parametrave të përcaktuar për mbledhjen e taksave (zakatit), përbëjnë një tipar domethënës në rregullimin e komunitetit musliman, çka nxjerr në pah karakterin e veçantë të islamit shqiptar.

Marrëdhënie të tilla mes shtetit dhe legjislacionit të tij, nuk i gjejmë vetëm tek muslimanët Sunitë, por edhe në statutin e miratuar në kongresin e Bektashinjve.

Kongresi u hap në Korçë (në teqen e shenjtë të Turanit) me 26 shtator 1929. Morën pjesë 55 delegatë fetarë dhe laikë, të cilët vendosën që bektashinjtë duhet të organizohen mbi bazën e një statuti më kompakt se ai i komunitetit musliman, por që në thelb rimerрте të njëjtën strukturë dhe dispozita. Dallimet mes dy komuniteteve qëndrojnë në autonominë dhe pavarësinë e secilit, veçoritë rituale dhe mënyra e organizimit të kultit<sup>93</sup>.

Të njëjtat shqyrtime mund të sjellim gjatë analizës së statutit të Kishës ortodokse të pavarur, ku në nenet 1-5 trajtohet Sinodi i shenjtë që e drejton dhe e administron atë. Sinodi është përgjegjës për gjithçka ka të bëjë me fenë: adhurimin e Krishtit dhe nderimin

---

<sup>92</sup> Statuti u nënshkrua nga Vehbi Dibra, kryetar i komunitetit musliman sunit, nga Zogu I, mbreti i Shqipërisë, Koço Kota kryeministër i vendit, Z. Delvina, Ministër i Drejtësisë, i miratuar me dekretin e datës 8 gusht 1929 dhe botuar në fletoren zyrtare, nr. 53, 24 shtator 1929, 1-6.

<sup>93</sup> Për të kuptuar klimën në të cilën i zhvilloi punimet kongresi, është e nevojshme të lexohet programi i punimeve. "Të enjten me 26 shtator 1929, në orën 10 të mëngjesit, në teqen e shenjtë të Turanit (Korçë), do të mbahet ceremonia e hapjes së Kongresit III të bektashinjve shqiptarë. Ceremonia fetare do të drejtohet nga shenjtëria e tij Gjyshi Kamber Prishta, që është edhe President i Këshillit Atëror. Ceremonia do të zhvillohet kështu: 1) Banda e Korçës do të luajë himnin për Lartmadhninë e tij, mbretin Zog. 2) Lutja për inaugurimin e Kongresit do të mbahet nga H. T, Gjyshi Kamberi 3) Banda do të luajë himnin bektashian 4) Shenjtëria e tij, baba Ali Tomorri, do të mbajë një fjalim mbi besimin bektashian dhe për punët e këtij kongresi 5) Banda do të luajë himnin e flamurit. 6) Në orën 11 do të fillojë kongresi dhe do të çelen diskutimet".



e shenjtërve, disiplinën fetare, organizimin dhe administrimin e brendshëm të Kishës të bazuar mbi dogmat e normave të shenjta, në përputhje me ligjet e shtetit si dhe kontrollin e veprimtarisë së episkopëve dhe të organeve të Kishës sipas rregullave të fesë<sup>94</sup>. Sinodi i shenjtë themelon dhe mirëmban shkolla fetare, harton programet e tyre shkollore dhe i mbikëqyr ato me ndihmën e ipeshvinjve. Përkujdeset për edukimin fetar-patriotik të meshtarëve dhe besimtarëve, mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve nga ana e klerikëve. Asnjë libër nuk mund të përdoret për liturgjinë pa autorizimin zyrtar të Sinodit të shenjtë dhe të Ministrisë së Arsimit<sup>95</sup>.

---

<sup>94</sup> Edhe komuniteti Ortodoks shqiptar e hartoi statutin me 29 qershor 1929. Ai u miratua gjatë Kongresit II të Kishës ortodokse të pavarur, të zhvilluar në Korçë. <http://licodu.cois.it/412/view>. Kisha e përcakton veten si të pavarur dhe kombëtare “që përbëhet nga të gjithë besimtarët me banim në mbretërinë e Shqipërisë, që besojnë në Krishtin dhe pranojnë simbolet e fesë së shenjtë ortodokse. Ajo është e bashkuar dogmatikisht dhe shpirtërisht me të gjithë Patriarkanat e Shenjta dhe kishat ortodokse të pavarura, duke ruajtur të paprekur, si të gjitha Kishat e tjera ortodokse të Krishtit, burimet e fesë, shkrimet e shenjta dhe normat e shenjta apostolike dhe te sinodeve”. Gjuha zyrtare është shqipja. Autoriteti më i lartë është Sinodi i shenjtë ipeshkvnor, i përbërë nga ipeshkvinjtë e çdo dioqeze, nga Ikonomi i madh mitrofor dhe i drejtuar nga metropolit qendror, Arqipeshkvi i të gjithë Shqipërisë. Ipeshkvinjtë drejtojnë dioqezat. Kisha ortodokse e pavarur e Shqipërisë është person juridik dhe trashëgon të gjithë titujt dhe të drejtat që u përkisnin komuniteteve ortodokse ekzistuese në vend deri në këtë moment.

<sup>95</sup> Këta libra përktheheshin nga greqishtja dhe më pas rishikoheshin nga sinodi i shenjtë, i cili kishte për detyrë t'i vinte sa më parë në shërbim librat që mungonin. Sinodi i shenjtë kishte për detyrë të mbikqyrte botimin e librave, shfaqjet teatrale, kinematografike dhe konferencat publike, në mënyrë që t'i vinte fre çdo ideje apo prononcimi që mund të hidhte baltë mbi dogmat dhe parimet e kishës ortodokse dhe të klerit në përgjithësi. Në rast se bëheshin shkelje të tilla, sinodi i shenjtë kërkonte ndërhyrjen e autoriteteve kompetente. Sinodi i shenjtë mbledhje një herë në vit çdo fillim tetori dhe i zhvillonte punimet në jo më pak se 15 ditë dhe për jo më shumë se një muaj. Arqipeshkvi, në rast nevojë mund ta ftonte sinodin e shenjtë në mbledhje të jashtëzakonshme, pas miratimit të shumicës së anëtarëve; Arqipeshkvi hap dhe mbyll mbledhjet e sinodit, për ligjshmërinë e të cilave është i nevojshëm një *quorum* ku numri i anëtarëve është së paku një më shumë se gjysma e tyre. Në rast të mungesës së Arqipeshkvit, vendin e tij e zinte anëtari më i moshuar dhe vendimet merreshin me shumicë vote e nëse kishte barazi votash, qëndrimi i arqipeshkvit vlerësohej dyfish. Gjatë mbledhjeve të sinodit të shenjtë, ishte i pranishëm edhe sekretari i përgjithshëm, emërimi i të cilit propozohej nga sinodi i shenjtë dhe miratohej

Me përcaktimin e strukturës territoriale të katër episkopatave në vend, statuti vendos që organet drejtuese të komunitetit të qëndrojnë në Korçë<sup>96</sup>. Emërimi i episkopit është i përhershëm, ndaj nëse zgjedhja e kryeespiskopit, peshkopëve apo e drejtuesve të ndryshëm të komunitetit nuk ka pëlqimin e Mbretit, Sinodi i shenjtë duhet të zgjedhë kandidatë të tjerë. Që të gjithë, para se të marrin detyrën e re, duhet të betohen për besnikëri ndaj Mbretit, vendit dhe statutit të Mbretërisë, duke përfshirë në këtë betim edhe personat që do të emërohen për kryerjen e detyrimeve kishtarë.

Para Sinodit të shenjtë duhet bërë, gjithaq, një betim tjetër për t'u qëndruar besnik dogmave, kanoneve dhe rregullores fetare që sanksionojnë njësinë dogmatike fetare dhe solidaritetin me patriarkana të tjera dhe Kisha ortodokse autonome nëpër botë. Statuti rregullon, gjithashtu, praktikat për shkarkimin, dorëheqjen, zëvendësimin e Kryeespiskopit, peshkopëve dhe funksionarëve të lartë, si dhe përcakton detyrimet përkatëse dhe zbatimin e tyre.

Në kapitullin e katërt (nenet 29-31) trajtohen çështje lidhur me masat disiplinore të ndërmarra nga Kryeespiskopi, ndërsa nenet 32-38 rregullojnë veprimtarinë e Komitetit disiplinor të përhershëm. Zbatimi i vendimit për shkishërimin e klerikëve bëhej në bazë të normave fetare dhe i dënuari ishte i detyruar të hiqte petkun fetar dhe shenjat e zyrës, në të kundërt duhej të përballlej me pasojat që parashikonte neni 214 i Kodit Penal të vitit 1928.

Administrimit të pasurisë i kushtohen nenet 39-43 të statutit. Aty rregullohen çështje të kishës, manastireve dhe të të gjitha të mirave të tjera të tundshme dhe të patundshme.

Burimet financiare sigurohen nga të ardhurat e Kishës dhe të manastireve; nga pasuritë e komunitetit ortodoks; nga

---

nga arqipeshkvi. Cilësitë që duhej të zotëronte sekretari i përgjithshëm përcaktoheshin në rregulloren e administratës së përgjithshme.

<sup>96</sup> Ipeshkvitë e kishës ortodokse ishin: ipeshkvia e Korçës ku përfshiheshin zona e Përmetit, Voskopojës, Leskovikut dhe e Kolonjës; Ipeshkvia e Durrësit ku bënin pjesë zona e Tiranës, Shkodrës, Kavajës, Elbasanit, Shpatit, Gorës, Mokrës, Pogradecit dhe Dibrës; Ipeshkvia e Beratit që përfshinte zonën e Vlorës, Myzeqesë, Kaninës; ipeshkvia e Gjirokastrës ku bënin pjesë: Delvina, Dropulli, Pogoni e Himara.

subvencionet e shtetit; nga ndihmat që mbërrijnë për Kishën; nga shlyerjet fakultative të pagave dhe çdo lloj dhurate apo ndihme të ofruar nga besimtarët shqiptarë.

Në nenet 44-53 trajtohet themelimi i Këshillit të përzier, i cili përbëhet nga anëtarët e Sinodit, nga 4 anëtarë laikë, një për çdo dioqezë, nën drejtimin e episkopit që mbante vit pas viti bilancin e të ardhurave të përgjithshme të komunitetit ortodoks. Një kopje e këtij bilanci i duhej paraqitur ministrit të Drejtësisë për miratim. Të mirat e luajtshme dhe të paluajtshme të administruara nga institucionet fetare dhe të destinuara për vepra bamirësie, ishin nën kontrollin e Kishës, e cila kujdesej për përmbushjen e vullnetit të donatorëve<sup>97</sup>.

Në Korçë e kishte selinë edhe Këshilli ekonomik i përhershëm, në përbërje të të cilit ishte Kryepiskopi dhe katër laikë. Anëtarët laikë zgjidheshin nga Këshilli i përzier dhe detyrimet e tyre përcaktoheshin nga një rregullore e posaçme.

Varësia e Kishës ndaj Mbretit shprehet qartë në këtë statut: neni 54 e detyron Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të thotë në çdo meshë, lutjet për Mbretin, për vendin dhe për ushtrinë. Neni 55 e detyron Kishën të mos pranojë, kurrsesi, subvencione nga një vend i huaj, në të kundërt duhej të përballlej me sanksionet e Kodit Penal për tradhti të lartë. Sipas neni 56, Sinodi i shenjtë angazhohet për përmirësimin e kushteve shoqërore të vendit. Si shkëmbim, shteti siguron juridiksionin e Kishës mbi territorin shqiptar.

Neni 57 pohon se asnjë klerik nuk mund të celebrtojë meshë në territorin shqiptar, nëse nuk është emëruar prift nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Asnjë laik apo murg nuk mund

---

<sup>97</sup>Arqipeshkvi dhe ipeshkvi i çdo dioqeze kishin të drejtë të mblidhnin ndihma për nevojat e kishës, ose individuale nga çdo familje ortodokse, siç e parashikon rregullorja. Asnjë e mirë e patundshme e institucioneve fetare të komunitetit ortodoks nuk mund të shitej pa pëlqimin e këshillit të përzier, përndryshe shitja ishte e pavlefshme. Administrimi apo shfrytëzimi i të mirave të tundshme dhe të patundshme dhe mënyrat e shitjes së të mirave të patundshme të institucioneve fetare dhe të komunitetit ortodoks vendoseshin nga rregullorja e përgjithshme e administratës. Autoritetet e kishës ortodokse të pavarur të Shqipërisë kishin detyrimin t'i paraqisnin inpektorit të Ministrisë së Drejtësisë regjistrat kontabël sa herë që u kërkoheshin. Në raste shkeljesh, përgjegjësit viheshin përballë gjyqimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe dënoheshin në bazë të kodit penal.

të jetë i tillë pa miratimin e Sinodit të shenjtë dhe pa marrë diplomën e seminarit ortodoks (neni 59). Të gjitha marrëdhëniet e Kishës me qeverinë mbahen nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë (neni 60). Së fundi, çdo episkopatë mund të ketë një vulë ku shënohet “Episkopatë” dhe emri i saj (neni 61).

Statuti përmbante edhe dispozitat përmbyllëse (neni 62-64) që kishin të bënin me herezinë e një pjese apo të të gjithë popullsisë së një fshati, çka bënte që të mirat e banorëve të saj t’i kalonin në pronësi Kishës Autoqefale të Shqipërisë<sup>98</sup>.

Nenet 1, 2, 3, 10, 24, 25, 40, 48, 49, 52, 60 të statutit konsideroheshin të pandryshueshëm, duke qenë se merreshin me identifikimin e komunitetit fetar, ndërkohë që nenet e tjera mund të ndryshoheshin me thirrjen e një kongresi. Statuti iu paraqit qeverisë me 29 qershor 1929 dhe mori miratimin e Mbretit<sup>99</sup>.

Analiza e statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë konfirmon qëndrimin thellësisht juridiksional të legjislacionit të Zogut. Ka, si të thuash, një shkëmbim nderesh mes komunitetit fetar dhe shtetit: vetë kërkesa për autoqefalinë e Kishës ortodokse shqiptare, përveçse t’u përgjigjet nevojave të besimit, vendos ndërprerjen e marrëdhënieve të varësisë ndaj Fanarit e në mënyrë të tërthortë edhe me Greqinë, që prej kohësh këmbëngul për Epirin e veriut. Për këto arsye, Kisha ka mbështetjen e shtetit, pavarësisht armiqësive politike me Theofan Stilian Nolin, kryeministër në vitin 1924 dhe peshkop i Kishës ortodokse.

Madje mbështetja e komunitetit ortodoks nga ana e shtetit shërben për të forcuar lidhjen me ata peshkopë që i kundërviheshin Nolit së brendshmi kishës<sup>100</sup>. Një linjë e tillë politike do t’i korrë frytet e veta vetëm drejt fundit të mbretërisë së Zogut, kur në vitin 1937 u bë shpallja e autoqefalisë së Kishës<sup>101</sup>.

---

<sup>98</sup> Kjo normë ligjore ka për synim të parandalojë dhe të sanksionojë çdo sjellje skizmatike të komunitetit dhe jo konvertime të mundshme personale në fe tjetër. Ndarja fetare sipas zonave, mund ta cënonte unitetin e shtetit, sidomos nëse ato u nënshtroheshin juridiksioneve të kishave të ndryshme ortodokse.

<sup>99</sup> Fletorja Zyrtare, nr. 45, 14 gusht 1929, 1-6.

<sup>100</sup> Për më tepër, shih: R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 49.

<sup>101</sup> Pas shumë përprjekjesh për ndërtimin e hierarkisë së kishës ortodokse të Shqipërisë, ia del të sigurojë Tomos-in që i jep asaj autoqefalinë në vitin 1937. Shih: *Tomos i patrikanor dhe Sinodik mbi bekimin e Autoqefalisë së Kishës*

Nga ana tjetër, Bektashinjtë dhe Sunitët janë të thirrur të japin kontributin e tyre për modernizimin e vendit, çka përpiqen ta realizojnë duke përdorur shqipen gjatë celebrimeve liturgjike, duke u treguar të hapur ndaj modernizimit të zakoneve<sup>102</sup>, duke kundërshtuar mbulimin me shami të grave, deri aty sa të ndalohej me ligj përdorimi i këtij petku<sup>103</sup>. Risi të tjera prekin fushën liturgjike, si bie fjala, kryerja e lutjes në këmbë e jo të rënë përmbys me ballin përtoke, duke u shkëputur kështu nga format liturgjike të islamit tradicional<sup>104</sup>.

Kjo analizë e detajuar e statuteve të tre besimeve fetare, që sollëm më lart, përbën provën më të qartë për të dëshmuar se si dhe sa e kushtëzonte dhe drejtonte strukturimin e komuniteteve fetare legjislativoni i Zogut. Debatet që shoqërojnë kongreset e mbajtura për reformimin e statuteve, prekën një prej çështjeve më të moderuara, pranimin e parimit të ndarjes mes fesë dhe shtetit, që është përmendur edhe më parë, por vetëm tani po bëhej pjesë konkrete e statuteve. Rëndësi pati edhe 'shqiptarëzimi' i kulteve nëpërmjet përdorimit të gjuhës shqipe dhe zbatimit të klauzolës për shtetësinë shqiptare të drejtuesve të besimeve fetare dhe të harmonizimit të normave me shoqërinë shqiptare.

---

*Orthodhokse në Shqipëri, Në vitin shpëtimtar 1937*, nr. 609 i prot., <http://licodu.cois.it/578/view>

<sup>102</sup> Me anë të ligjit *mbi fejesën*, në vitin 1934, vajzës i njihej e drejta të shprehte pëlqimin mbi zgjedhjen që kishte bërë i ati për martesën e saj dhe përcaktohej moshja jo më e vogël se gjashtëmbëdhjetë vjeç për fejesë. Vajzës i njihej e drejta ta zhbënte fejesën. Lidhur me këtë, u shtua një ligj i ri në kodin penal, i cili ndërshkonte ata prindër e kujdestarë fëmijësh që e shkelnin normat e këtij ligji.

<sup>103</sup> Në marsin e vitit 1937, u miratua një ligj mbi *heqjen e shamisë* për gratë, ku shembullin e parë e dhanë motrat e mbretit dhe oborri i tij, por nuk mungoi as fushata e komuniteteve fetare në mbrojtje të këtij vendimi. Fazat kryesore të kësaj rruge të gjatë qenë kushtetuta e shoqatës *Gruaja shqiptare*, e cila u angazhua nga të katër anët për mbrojtjen e pavarësisë dhe dinjitetit të gruas. Nën ndikimin e saj u mblodh kryesia e *komitetit të myslimanëve*, e cila pas debateve të gjata, doli me pohimin se kurani nuk e detyronte mbajtjen e shamisë, prandaj ky zakon mund të zhbëhej. Marrja e këtij vendimi shënoi një hap të rëndësishëm lidhur me vlerësimin dhe lirinë e gruas shqiptare dhe u parapri nga ndalimi i qarkullimit në rrugë i grave të zbatuara e të mbuluara nga koka tek këmbët me ferexhe (vel që mbulon fytyrën, duke lënë zbuluar vetëm sytë). Ref. N. SHEHU, *Donna e matrimonio in Albania. Profilo storico*, Bari 1988, 19 – 25; R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 119-127.

<sup>104</sup> *Ibidem*, 126 ss.

Është e vërtetë që Kisha katolike shqiptare nuk përshtatet me këtë gjendje të re, siç do të shohim në vijim, pasi ka marrëdhënie të vështira dhe të ndërlikuara me qeverinë. Pa nënvlerësuar rëndësinë e saj, por për vetë faktin që Kisha katolike nuk i tejkalonte 10% të popullsisë së vendit, ajo nuk mund të kishte aq peshë sa të vinte në diskutim marrëveshjen politike të qeverisë në marrëdhënie me besimet fetare. Forca dhe rëndësia e përbërësit katolik qëndron në marrëdhëniet e tij ndërkombëtare, në dominimin e pjesës veriore të vendit, kryesisht Shkodrës dhe rrethinave të saj, faktorë këto që, gjithsesi, nuk shkojnë tërësisht në të mirë të saj. Në fakt, përfaqësuesit e klerit, shpesh, nuk janë vendas, prandaj marrëdhëniet ndërkombëtare dhe varësia nga Roma, jo rrallë, ngrejne një mjegull dyshimi në një vend aq të lidhur pas pavarësisë së vet. Dyshimi rritet edhe më shumë kur fluksi i financimeve nga jashtë shpjegohet me faktin që nën përkatësinë fetare fshihet projekti i realizimit të interesave të vendeve të huaja e në mënyrë të veçantë i Italisë, meqë ndihmat mbërrijnë kryesisht nga ky gadishull.

Ndarja gjeografike pasqyrohet edhe në nivelin gjuhësor dhe kulturor, çka vihet re me përdorimin e dy dialekteve, geg në veri dhe toskë në jug. Nga ana tjetër, përhapja e komunitetit katolik të ritit latin në Veri dhe të ritit bizantin në Jug përbën një çështje që meriton shqyrtim të veçantë.

## 1. 5. Politika e Zogut kundrejt Kishës katolike

Thirrjes për hartimin e një statuti, nuk iu përgjigj Kisha katolike e Shqipërisë<sup>105</sup>, e cila, nën drejtimin e *Propaganda Fide-s*<sup>106</sup>, ishte

---

<sup>105</sup> Veprimtaria fetare në Shqipëri lidhet me praninë domethënëse të Benediktinëve, të Domenikanëve dhe të fretërve minorë. Lidhur me veprimatrinë e provincës françeskanë në Shqipëri, e cila mbledhi rreth saj një pjesë të konsiderueshme të popullsisë vendase dhe kreu një mision strategjik në të gjithë hapësirën e Ballkanit Perëndimor, për përhapjen e katolicizmit në këto zona, shih: V. VANNUPELLI, *L'Albania*, Roma, Tip. di M. Armanni, 1886, 177 ss.; (Sguardo all'Oriente) *Schizzo storico sull'Vepera dei francescani in Albania*, Scutari, Tipografia francescana, 1930; A. BALDACCI, *Il francescanesimo in Albania e il padre Giorgio Fishta*, in *Studi speciali albanesi*, III, Roma, Stabilimento tipografico F. Damasco, 1937, 42 ss.

<sup>106</sup> Kongregata e shenjtë Propaganda Fide, është një dikaster i Kuries romane, i themeluar në vitin 1622 nga Gregori XV për përhapjen e fesë ndër paganë dhe ruajtjen e saj në ato zona ku katolikët e rrit latin dhe atij grek, ishin në pakicë. Ajo, gjithashtu, duhej të përkujdesej për formimin fetar dhe kulturor të misionarëve dhe të klerit vendas. Komisioni iu nënshtrua rishtrukturimeve të koklavitura deri në vitin 1862, kur Piu IX vendosi t'i ndajë punët e lindorëve prej punëve të misionit mes të pafeve, duke ngritur një seksion më vete të Prvepaganda Fide-s, nën emërtimin *Pro negotiis ritus orientalis*. Benedikti XV, falë njohjes dhe ndjeshmërisë së tij të lartë për problemet e Lindjes, ia doli të themelonte, në vitin 1917, kongregatën e shenjtë *pro Ecclesia orientali*, së cilës iu besua drejtimi, thuajse ekskluziv, i çështjeve që kishin të bënin me ritet lindore, duke ia hequr këtë kompetencë kongregatës *Propaganda fide*. Mbi *Propaganda fide*, shih: P. CAIROLI, *La Congregazione de propaganda fide: sua figura e sue attribuzioni*, "Rivista di studi missionari", IV (1922), 4, 170-181; SACRA CONGREGAZIONE DI PROPAGANDA FIDE, *Guida delle missioni cattoliche*, Roma, Unione missionaria del clero in Italia, 1934; N. DEL RE, *La Curia romana. Lineamenti storico-giuridici*, Roma, Edizioni di storia e letteratura, 1970, 185 ss. (Sussidi eruditi, 23); SACRA CONGREGAZIONE DI PROPAGANDA FIDE, *Memoria rerum. 350 anni a servizio delle missioni, 1622-1972*, (a cura di J. Metzler), voll. 3, Rom-Freiburg-Wien, Herder, 1971-1976; J. METZLER, *Storia della Sacra Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli o de propaganda fide, Problemi attuali dell'evangelizzazione*, Roma, Pontificia Università urbaniana, 1975, 101-130; G. Piras, *La Congregazione e il Collegio di propaganda fide di J. B. Vives, G. Leopardi e M. De Funes*, Roma, Università Gregoriana, 1976 (Documenta missionalia, 10); *Guida delle missioni cattoliche 1989*, Roma, Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli, 1989, 11 ss.; A. REUTER, *Il Dicastero romano per le missioni e le sue riforme*, in *Ecclesiae memoria. Miscellanea in onore del R. P. Josef Metzler OMI, Prefetto dell'Archivio segreto vaticano*, (a cura di E. Henkel), Roma-Freiburg-Wien, Herder, 1991, 165-177; ID., *Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli*, PONTIFICIA UNIVERSITÀ URBANIANA, *Dizionario di missiologia*, I, Bologna, Dehoniane,

përqendruar në dioqezën e Shkodrës dhe kundërshtonte kërkesën e qeverisë për t'i dhënë Kishës karakter kombëtar. Ajo i kthente sytë nga tradita si model i marrëdhënieve mes Kishës dhe shtetit, pra arritja e një marrëveshjeje do të çonte në zgjidhjen e problemit të shtruar nga qeveria. Ngjarjet brenda vendit nuk ishin në favor të kësaj zgjidhjeje, por Zogu kishte nevojë të neutralizonte popullsinë katolike të Veriut<sup>107</sup>, ku kishte dhënë rezultate të mira i ashtuquajtur "Misioni shëtitës" (*Missione volante*)<sup>108</sup>, i cili kishte pasur si qëllim të "jetësonte" traditat, për të krijuar një lidhje mes tyre dhe krishtërit katolik të atyre anëve. Kjo veprimtari e ngjeshur proselitizmi kishte dhënë ndihmesën e vet për rrënjosjen e katoliçizmit në ato krahina, çka ishte në favor të Italisë, e cila ushtronte njëfarë ndikimi në Shqipëri.

Qeveria italiane ishte e vetëdijshme për rolin e Kishës katolike, aq sa nuk i kursente ndihmat financiare apo në fushë të arsimit<sup>109</sup>. Pas

---

1993, 137-140; "Annuario pontificio", 1994, 1729-1730; G. FEDALTO, *Dal Seicento ai nostri giorni*, in *Le Chiese d'Oriente*, III, Milano, Jaca Book, 1995, 100-107. Da ultimo, "Annuario pontificio", 2000, 1942-1943.

<sup>107</sup> Bërthama e veprimtarisë së katolikëve të veriut ishte Shkodra. Këtu ishin ngritur struktura të rëndësishme si "Kolegji papnor shqiptar i Shkodrës" dhe "Shën Francesco Saverio". Në tipografinë e jezuitëve në Shkodër, shtypeshin revista dhe botoheshin vepra fetare dhe letrare në latinisht dhe shqip. G. VALENTINI, *La Missione dei gesuiti e la cultura albanese*, in "*Spiritualità*", XXVI (1975), 2, 17 ss.

<sup>108</sup> "*Missione volante*" (Misioni shëtitës) u mundësoi klerikëve të njihnin banorët më të varfër dhe të izoluar, në gjirin e të cilëve mblodhën të dhëna mbi të drejtën zakonore dhe rindërtuan traditat shqiptare. Spikatën në këtë drejtim figura të tilla si Atë Domenico Pasi, Atë Fulvio Cordignano e Atë Giuseppe Valentini. Rreth "*Missione volante*" shih, F. CORDIGNANO, *L'Albania attraverso l'opera e gli scritti di un grande missionario italiano: il P. Domenico Pasi S.I. (1847-1914)*, Roma, Istituto per l'Europa orientale, XXV, voll. 3 1933-1934, (Pubblicazioni dell'Istituto per l'Europa orientale, s. II, Politica, storia, economia.); G. VALENTINI, *La famiglia nel diritto tradizionale albanese*, Città del Vaticano, Tip. poliglotta vaticana, 1945; ID., *La legge delle montagne albanesi nelle relazioni della Missione volante (1880-1932)*, (Studi albanesi, Studi e testi, 3), Firenze, L. S. Olschki, 1969.

<sup>109</sup> Italia kishte nënshkruar me Shqipërinë "Paktin e Miqësisë dhe të Sigurisë" me 27 nëntor 1926, i ratifikuar pa kundërshtim me 9 dhjetor të atij viti. Pakti i hapte rrugë ndikimit italian në vend dhe depërtimit ekonomik, tregtar dhe institucional. Rreth kësaj shih: F. JACOMONI DI SAN SAVINO, *vep. cit.*, 45 ss. Forcimi i marrëdhënieve mes të dy shteteve, solli, veç të tjerash, shtimin e subvencioneve italiane sidomos për shkollat katolike, çka e shtoi pakënaqësinë e qeverisë shqiptare.



përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Italia i kishte zënë vendin Perandorisë Austro-Hungareze në rrethin e Shkodrës, duke u mbështetur në prejardhjen lombardo-venedikase të shumë misionarëve, si dhe në mbështetjen financiare të shumë aktiviteteve të zhvilluara nga urdhërat fetarë dhe dioqezat e ndryshme<sup>110</sup>.

Në vitin 1926, Zogu deklaroi se ka një program qeveritar për europianizimin e Shqipërisë dhe në vitin 1927 vizitoi Shkodrën, ku premtoi subvencione për Kishën katolike<sup>111</sup>. Me këtë rast bëri një deklaratë publike, ku u shpreh se është i gatshëm të nënshkruajë një marrëveshje me Selinë e Shenjtë<sup>112</sup>. Nënshkrimi i marrëveshjes do të sillte avantazhe për Zogun, duke e forcuar pozicionin e tij si në nivel ndërkombëtar, ashtu dhe brenda vendit. Nënshkrimi i marrëveshjes do të kishte rëndësi të veçantë edhe për Kishën katolike, pasi të drejtat dhe detyrimet që rridhnin prej nënshkrimit, do t'i siguronin asaj stabilitet juridik, aq më tepër që Zogu po tregohej i hapur ndaj kërkesave të saj, çka e tregon shprehja e vullnetit të tij për t'u njohur statusin e personit juridik të gjitha kongregatave dhe institucioneve fetare katolike që vepronin në Shqipëri.

Me botimin e Kodit të ri Civil, u vu re se një sërë nenesh binin ndesh me parimet themelore të së drejtës kanonike, si, bie fjala, çështja e divorcit. Marrëdhëniet familjare dhe martesat rregulloheshin nga nenet 120-409 të Kodit, dhe fokusoheshin në njohjen e pushtetit të burrit dhe babait mbi bijtë e vet. Në këtë mënyrë, Kodi vazhdonte t'i përmbahej pabarazisë mes burrit dhe gruas brenda rrethit familjar, ashtu siç e parashikonte edhe kanuni. Çështjet e pasurisë që lidheshin me martesën trajtoheshin nën titullin “kontrata e martesës” në nenet 331-389 të Kodit Civil

---

<sup>110</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 127 ss.

<sup>111</sup> *Ibidem*, 116-117.

<sup>112</sup> B. J. FISCHER, *King Zog and the struggle for stability in Albania*, New York, Columbia University Press, 1984 113-114. Duke iu referuar raportit të botuar më 15 janar 1928 në “Corriere Vaticano”, R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 161 nr. 42, shqyrton mbarëvajtjen e negociatave dhe thekson se mund të bëhej fjalë për rreth njëzet artikuj ku: mbrohej feja katolike; mirrej shkas nga marrëveshjet e arritura me Poloninë, Bavarinë dhe Lituaninë, por duke u përshtatur me gjendjen e veçantë të Shqipërisë; mirëpritej parimi i ndarjes që karakterizonte shtetin shqiptar i cili shpallej laik dhe jofetar.

dhe u referoheshin dispozitave të përgjithshme për lidhjen e kontratave mbi marrëdhëniet pasurore që lindnin nga martesë, me përjashtim të rasteve që kërkonin trajtim të veçantë, të cilët trajtoheshin në katër kapituj të posaçëm.

1. Dispozita me karakter të përgjithshëm mbi veçoritë e marrëdhënieve familjare.

2. Paja që mund t'i jepej nuses nga i ati i saj apo nga një i tretë për përballimin e shpenzimeve të martesës, administrohej nga bashkëshorti i saj, deri në prishjen e kësaj martesë, nëse ndodhte një gjë e tillë.

3. Administrimi i të mirave paramartesore, të fituara nga pasuria e gruas, që nuk bënin pjesë në pajën e saj dhe që bashkëshorti nuk kishte të drejta mbi to.

4. Pasuria e ngritur nga të dy bashkëshortët gjatë martesës.

Kodi Civil, i hyrë në fuqi me 1 prill 1929 rregullonte çështjen e fejesës, duke e përcaktuar si premtim për martesë. Prishja e fejesës kishte pasojë juridike, mbi të gjitha shpërblimin e dëmit dhe kthimin e dhuratave (neni 114-119)<sup>113</sup>.

Gruaja e ve apo gruaja, martesë e së cilës ishte anuluar, nuk mund të martohej sërish pa kaluar 300 ditë nga vdekja e bashkëshortit apo nga zgjidhja e martesës. Kjo kohë mund të shkurohej me vendim gjykate nëse kishte prova të mjaftueshme që gruaja nuk ishte shtatzënë.

Kodi nuk i respektoi parimet e katolikëve, pasi parashikoi mundësinë e divorcit. Zgjidhja e martesës pranohej vetëm për

---

<sup>113</sup> Në kanun, mosha për martesë lidhej me kohën e pubertetit, 18 vjeç për burrat dhe 16 vjeç për gratë, duke bërë dallimin e mëtejshëm mes atyre që i kishin mbushur apo jo të njëzetat. Kush ishte nën moshën 20 vjeç, duhej të kishte miratimin e babait (neni 123 k.c), gjë që nuk kërkohej për ata që e kishin kapërcyer këtë moshë. Megjithatë, deri në moshën njëzet e pesë vjeç i duhej dorëzuar komunikimi me shkrim i noterizuar, prindit që nuk e jepte pëlqimin e vet (neni. 128 k.c). Dhjetë ditë para martesës bëhej leçitja pranë komunës ku çifti i ardhshëm do të banonte. Sipas kodit civil (neni 18), gruaja merrte mbiemrin e burrit dhe e ndiqte ngado; në rast se burri ishte i huaj, merrte automatikisht shtetësinë e tij. Burri duhej t'i siguronte jetesën gruas, por edhe prej saj kërkohej njëfarë kontributi, sidomos nëse burri kishte vështirësi ekonomike. Kodi civil i njihte gruas aftësinë e plotë për të vepruar, por kjo mbetej thjesht në letër, sepse gruaja nuk mund të bënte asgjë pa pëlqimin e burrit, sidomos nuk mund të ushtronte farë profesioni. S. VILLARI *Le Consuetudini giuridiche ...cit*, 93-110..

arsye të forta apo si vendim personal i bashkëshortëve. Arsyet e forta kishin të bënin me tradhtinë nga ana e gruas, me braktisjen e bashkëshortit, në rast sëmundjesh të pashërueshme apo mendore, për mungesë fëmijësh, për shterpësi natyrore. Rast më vete përbënte çakërdisja e marrëdhënieve familjare, parashikuar në nenet 203, 209 të Kodit Civil. Me shpalljen e këtij Kodi, familja nuk ishte më objekt i rregullave dhe i së drejtës fetare.

Hierarkia e lartë dhe Kleri katolik nuk binin dakord me qëndrimet e qeverisë, ndaj Zogu u akuzua për mosmbajtjen e premtimeve që bëri gjatë nënshkrimit të marrëveshjes. Fillimisht, Zogu u duk i kënaqur me ndërprerjen e negociatave, pasi e shqetësonte fakti se propozimi i katolikëve për nënshkrimin e marrëveshjes, parashikonte mbajtjen e klerit nga ana e shtetit dhe kjo do të rëndonte shumë mbi financat publike të shqiptarëve<sup>114</sup>. Pavarësisht kësaj, në fillim të vitit 1929, Zogu iu rikthye propozimit për nënshkrimin e marrëveshjes. Shpallja e Monarkisë, miratimi i statutit të ri dhe suksesi i politikave qeveritare në marrëdhëniet me besimet fetare, e shtynin drejt dëshirës t'u jepte zgjidhje juridike globale marrëdhënieve me komunitetet fetare.

Kështu, i ftoi katolikët të ngrinin një delegacion me të cilin u zhvilluan një sërë takimesh në nivel ministror dhe u vendos një skemë marrëveshjeje me disa dispozita, që, sidoqoftë, nuk fituan plotësisht pëlqimin e Vatikanit. Selia e Shenjtë nuk e miratoi, ndaj marrëveshja mbeti thjesht në letër<sup>115</sup>.

Pa dyshim, ligjet mbi modernizimin e shoqërisë shqiptare dhunonin edhe parimet fetare të myslimanëve, prandaj normat ligjore të sipërpërmendura shkaktuan një çarje jo të vogël mes shtetit dhe besimeve fetare. Mjafton të përmendim futjen e martesës civile, detyrimin për t'u regjistruar në shtetin civil, rregullimin e divorcit. Nga ana tjetër, mbështetja që i dha qeveria kërkesës së komuniteti Bektashian për të qenë krejtësisht i pavarur nga ai Sunit, shtoi pakënaqësinë e këtij të fundit që i shihte këto masa si përpjekje për të shpërbërë dhe dobësuar islamin, synime që shfaqeshin me hapjen ndaj vlerave perëndimore<sup>116</sup>. Për këto

---

<sup>114</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *op. cit.*, 125 ss.

<sup>115</sup> S. LUFİ, *Vatikani dhe Shqipëria*, AA.VV., *Simposium ndërkombëtar, Tiranë 16-19 Nëntor 1999*, Shkodër, 2000, 321-322.

<sup>116</sup> S. LUFİ *vep. cit.*, 321.

arsye, fillimisht u mendua se dekretligji mbi komunitetet fetare do të sillte një kundërshti në bllok nga këto komunitete<sup>117</sup>.

Konflikti me komunitetet fetare u përshkallëzua si pasojë e mosmarrëveshjeve lidhur me çështjen e shkollave private. Qeveria miratoi një ligj mbi arsimin publik dhe vendosi, qysh në vitin 1933, mbylljen e të gjitha shkollave private fetare. Kjo bëri që të shpërthente një kundërshti e fortë që erdh e u shua vetëm në vitin 1936 kur qeveria lejoi, edhe falë ndërhyrjes së politikës italiane, rihapjen graduale të shkollave private<sup>118</sup>.

Kundërshtimi i politikave qeveritare u zhvillua sidomos në brendësi të besimtarëve dhe të klerit katolik, deri aty sa normat e dekretit për komunitetet fetare nuk gjetën zbatim nga Kisha katolike. Ajo e mohoi haptazi ligjin. Shteti, nga ana tjetër, e konsideroi këtë komunitet fetar si organizatë të paligjshme dhe pa personalitet juridik, për pasojë nuk mund të kishte asnjë përfitim nga subvencionet që shteti parashikonte për komunitetet fetare<sup>119</sup>. Kjo nuk nënkuptonte që qeveria shqiptare të mos financonte nismat institucionale të Kishës katolike, por subvencionet ishin në masën e një “lëmoshe shtetërore” për disa nisma të veçanta, ente apo përfaqësues të Kishës, më shumë sesa kontribute për krijimin e pasurisë, apo donacione dhe oferta të ligjshme në ndihmë të këtij komuniteti, ndryshe nga ç’ndodhte me komunitetet e tjera që zotëronin personalitet juridik civil dhe që probleme të tilla i kapërcenin pa vështirësi.

Edhe autoritetet e Vatikanit mbajtën qëndrim kundër ndaj dispozitave ligjore të vitit 1929, pasi gjykonin se masa të tilla mund të shënonin fillimin e persekutimit të klerit katolik dhe shuarjen e autonomisë së Kishës, duke i sjellë pengesa organizimit të këtij komuniteti në vend.

Krejt i papranueshëm, edhe në pikëpamje dogmatike, ishte pretendimi për ndërtimin e një Kise katolike kombëtare pa lidhje

---

<sup>117</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 126-127.

<sup>118</sup> *Ibidem* 127-145.

<sup>119</sup> S. LUFJ *vep. cit.*, 322. Ligji për komunitetet fetare u bë objekt kritikash për shumë specialistë dhe analistë të çështjeve të katoliçizmit. Sipas kardinalit Ottaviani, gjendja juridike për kishën Katolike shqiptare ishte vështirësuar. A. OTTAVIANI., *Institutiones juris publici ecclesiasti*, II, Roma, Libreria Editrice Vaticana, 1936, 361.

me Selinë e Shenjtë, e mbyllur në guackën e saj dhe pa marrëdhënie me misionet e huaja të pranishme në vend që shërbeheshin nga klerikë dhe rregulltarë të huaj dhe që, sipas ligjit, duhej t'i nënshtroheshin kontrollit dhe pushtetit të qeverisë<sup>120</sup>.

Në fillim të vitit 1930, çështja e nënshkrimit të marrëveshjes u paraqit me nismën e Kishës katolike nëpërmjet imzot Lazër Mjedës<sup>121</sup>. I bindur për nevojën e “shqiptarizimit” të hierarkisë së Kishës katolike, për të thelluar rrënjosjen e saj në vend, ai kishte qenë gjithnjë një kundërshtar i fortë i Zogut, aq sa ky i fundit e kishte dëbuar nga vendi së bashku me eprorin e fretërve françeskanë. Mjeda njoftoi Selinë e Shenjtë për mundësinë e hapjes së negociatave. Papa e ngarkoi me detyrën e hapjes së bisedimeve dhe të përfaqësimit të Selisë së Shenjtë, derisa negociatat të ngriheshin në lartësinë e nivelit diplomatik. Zunë fill kështu, bisedime të thelluara që gradualisht përshkallëzuan konvergimin e qëndrimeve të të dy kaheve. Të dyja palët dukeshin gati për nënshkrimin e marrëveshjes, por, krejt papritur, qeveria shqiptare nxori pretendimin që nënshkrimit të marrëveshjes t'i paraprinte vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Selinë e Shenjtë, ndërkohë që kjo e fundit ngulte këmbë për të kundërtën, duke pasur si model të njëjtën procedurë të zbatuar në Itali, por edhe e shtyrë nga frika se mos shteti shqiptar i bishtnonte propozimit të bërë më parë<sup>122</sup>. Për këtë arsye Selia e Shenjtë vuri disa kushte paraprahe: përjashtimin e Kishës katolike nga zbatimi i dekretligjit për komunitetet fetare; mbrojtje të parimeve themelore të Kishës

---

<sup>120</sup> S. LUFU, *vep. cit.*, 323.

<sup>121</sup> Lazër Mjeda (1869–1935), aso kohe, ishte arqipeshkëv i dioqezës së Shkodrës dhe kishte të gjitha cilësitë për të përfaqësuar kishën katolike përballë shtetit. E shkuaara e tij, si mbështetës i shqiptarizimit për popullsinë e Prizrenit e më pas të Shkupit, e bënin bashkëbisedues të besueshëm dhe me autoritet në sytë e qeverisë, edhe për faktin se ai ishte përpjekur për ngritjen e hierarkisë shqiptare, duke shuguruar imzot Pjetër Gjurën, arqipeshkëv të Durrësit dhe ipeshkëv, imzot Frano Mirditën. Rreth kësaj figure të spikatur që drejtoi dioqezën e Shkodrës deri më 1935, viti i ndarjes së tij nga jeta, shih: I. L. MJEDA, *Mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar*, St. Gallen, Albanisches Institut, 2011. A. MJEDA, *Lazër Mjeda në argjipeshkvinë Shkup-Prizren mes 1909-1921*. (Sipas arkivit Austriak, emërimi i tij, laramanizmi, largimi nga Prizreni).

<sup>122</sup> *Ibidem*, 324.

katolike nga ana e shtetit; zhvendosjen e negociatave në Romë; modifikimin nga ana e shtetit shqiptar të fjalës “komb”, të përdorur në nenin 7 të Statutit themeltar të Monarkisë shqiptare, duke e zëvendësuar atë me termin “shtetas”<sup>123</sup>.

Në fillim të korrikut të vitit 1930, delegacioni qeveritar shqiptar u nis për në Romë dhe aty nga fundi i nëntorit u duk se negociatat do të kishin një fund të mbarë. Nuk ishte gjetur marrëveshje vetëm për dy çështje: për divorcin dhe lirinë e besimit të Uniatit<sup>124</sup>. Mbërritur në këtë pikë, Monarku shqiptar vendos të nxjerrë kundërshti të reja lidhur me tekstin e marrëveshjes, me qëllim që këto negociata t'i shtynte *sine die*. Ishte e qartë që Zogu i frikësohej idesë se nënshkrimi i marrëveshjes me komunitetin katolik mund ta forconte atë, deri aty sa të krijonte një shtet brenda shtetit, prandaj i preu përfundimisht bisedimet. Qysh prej asaj kohe, Selia e Shenjtë u përfaqësua në Shqipëri nga i deleguari apostolik, dhe jo nga kleri lokal<sup>125</sup> dhe bëri të pamundurën për të

---

<sup>123</sup> *Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare* (1928), (*Tiranë 1 Dhjetor 1928*), Art. 7. “Të gjitha pushtetet shtetërore burojnë nga Kombi, dhe ushtrohen sipas parimeve e rregullave që caktohen në këtë Statut” <http://licodu.cois.it/568/view>. Polemika zinte fill tek konceptimi i binomit shtet-komb, që shprehej pikërisht në këtë statut.

<sup>124</sup> Me termin “*uniati*” emërtohen të gjitha kishat e bashkuara me ipeshkvin e Romës, të cilit i njohin autoritetin juridiksional, bashkëndajnë me të fenë dhe vizionin teologjik, por ruajnë strukturat, rregullat, traditat dhe liturgjinë e origjinës greke-bizantine, sipas formulës së përcaktuar nga këshlli i Basilea-s, Ferrara, Firenze (1417-1431). Meqë një pjesë e besimtarëve në Shqipëri ishin të rritit grek dhe me traditë bizantine, por sidomos të shtyrë nga dëshira për të tërhequr drejt kishës katolike një pjesë apo të gjithë kishën ortodokse autoqefale të Shqipërisë, kisha katolike synonte futjen e disa klauzolave të veçanta në marrëveshjen që duhej të nënshkruante, në mënyrë që t'i zhdërvillonte këto marrëdhënie me to. Rreth historisë së ndërlikuar të uniatit, shih: V. PERI, *Chiesa romana e “rito greco”*, G. A. Santoro e *la congregazione dei greci*, Brescia, Paideia, 1975; ID., *La genesi storica dell’uniatismo*, in *Oriente cristiano*, 37, 1997, 3-39; C. KORELEVSKIJ, *L’Uniatisme. Définition - Causes Effets - Étendue Dangers - Rèmes*, in “*Irénikon*”, 5-6, 2027, 3-64; J. C. ROBERTI, *Les Uniates*, Paris, Le Cerf, 1992;

<sup>125</sup> Në fillim të viteve ’30 të shek.XIX, organizimi i Kishës katolike në Shqipëri ishte ky: Arqipeshkvia e Shkodrës, Arqipeshkvia e Durrësit, Ipeshkvia e Sapës, Ipeshkvia e Pultit, Ipeshkvia e Lezhës e së fundi abacia e Mirditës që varej drejtpërdrejt nga Vatikani. Shih: U.SHEME, *Veprimtaria e klerit katolik (1945-1967)*, Tiranë, 2001, 5.

vënë në dukje mbajtjen e distancës së hierarkisë katolike kundrejt Monarkut.

Për këtë dëshmon edhe fakti që, edhe pse të ftuar, krerët e Kishës katolike nuk denjuan të merrnin pjesë në festimet e shtruara me rastin e martesës së Monarkut<sup>126</sup>. Pavarësisht kësaj, nuk mund të mohohet që në tërësinë e vet, marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare të parashikuara në legjislacionin e mbretit Zog, përfaqësojnë arritjen e një legjislacioni kontraktual mes shtetit dhe komuniteteve fetare në Shqipëri, i cili do të shërbejë si pikë referimi për vitet e vështira të pushtimit italian dhe të atij nazist në vijim. Ky legjislacion do të rizbulohet pas përvojës së Republikës Popullore të Shqipërisë, kur, me rihyrjen në fuqi, do të bëhej ndihmë për rregullimin e fazës së parë kalimtare drejt njohjes së plotë të lirisë fetare dhe të lirisë së organizimit juridik të besimeve fetare.

E pasigurtë për të ardhmen, Kisha katolike, aso kohe, nuk dinte dhe nuk kishte vullnet t'i përgjigjej nevojës së hartimit të një marrëveshjeje me shtetin. Kjo përbënte një pengesë të madhe për misionin e unguillëzimit, që ishte dhe strategjia kryesore për organet klerikale të Romës, të cilët e lidhnin pozicionin e Kishës katolike në Shqipëri me një strategji më të gjerë, drejt ortodoksëve në mbarë Lindjen.

---

<sup>126</sup> F. JACOMONI DI SAN SAVINO,, *vep. cit*, 78 e ss.

## 1. 6. Marrëdhëniet mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve fetare nga koha e pushtimit italian deri në Luftën e Dytë Botërore.

Qysh prej Konferencës së Ambasadorëve (1913) që i dha jetë shtetit shqiptar, Italia kishte shfaqur interesin e saj për Shqipërinë, duke e parë atë si urë lidhëse me hapësirën ballkanike. Për këtë arsye ajo kishte shtuar gradualisht përpjekjet e saj për të ndërhyrë në ekonominë e vendit duke investuar kapitale publike dhe private dhe duke shprehur në instancat e ndryshme kombëtare, madje dhe në Organizatën e Kombeve të drejtën për t'u marrë parasysh mendimet e saj lidhur me fatin e ardhshëm të shtetit të ri<sup>127</sup>. Një gjendje e tillë njihej mirë në Shqipëri dhe interesat e Italisë mbështeteshin veçanërisht në qarqet shkodrane nga shumë arbëreshë, si Terenc Toçi, të cilët nuk e shkëpusnin vëmendjen nga atdheu i origjinës<sup>128</sup>. Aleat i natyrshëm i Italisë ishte Kisha katolike, qoftë për faktin se një pjesë e mirë e klerit vinte nga Italia, ose ishte formuar atje, qoftë për varësinë e Kishës katolike shqiptare nga komisioni i *Propaganda Fide-s*. Një marrëdhënie e tillë konkretizohej me faktin që Italia kishte marrë vendin e Austrisë për financimin e nismave të katolikëve lidhur me arsimin apo organizimin e këtij komuniteti fetar<sup>129</sup>.

Ndikimi i Italisë në politikën e brendshme shqiptare, ishte aq i ndjeshëm sa kur Zogu organizoi grushtin e shtetit, një prej veprimeve të para të tij që dërgimi i përhëndetjeve të përzemërta konsullit italian në Vlorë, për ta siguruar që interesat e Italisë ndaj Shqipërisë nuk do të cënoheshin, madje shkoi deri aty sa kërkoi ndihmën e Italisë për modernizimin e vendit dhe zhvillimin

---

<sup>127</sup> MINISTERO PER I BENI E LE ATTIVITÀ CULTURALI, DIREZIONE GENERALE PER GLI ARCHIVI, *L'unione fra l'Albania e l'Italia...cit., passim*.

<sup>128</sup> Juristi i shquar luajti një rol të rëndësishëm për hartimin e kodit penal dhe atij civil. Shih: T. TOÇI, *E drejta ndëshkimore (il diritto penale)*, Shkodër 1926. Emërohet ministër i Ekonomisë kombëtare gjatë Republikës dhe më pas kryetar i parlamentit gjatë bashkimit me Italinë. Dënohet si bashkëpunëtor i fashizmit dhe pushkatohet në vitin 1944. Për figurën e Terenc Toçit shih: F. FABBRICATORE, *Il contributo arbrësh alla questione albanico-balcanica*,Castrovillari, Grafica Pollino, 2009.

<sup>129</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.,167 ss.*



ekonomik të tij<sup>130</sup>. Në fakt, Zogu pati ndihmën e pakursyer të ekspertëve italianë në fushën juridike dhe sociale, por kjo nuk e pengoi të vijonte me politikën e tij vetjake dhe autonome, që jo rrallë herë, binte ndesh si me interesat e Italisë, ashtu dhe me Kishën katolike. Nga ana e vet, Italia emëroi një figurë të plotfuqishme në Shqipëri dhe u përpoq ta shtrijë praninë e saj falë marrëveshjeve bilaterale dhe një politike aleancash<sup>131</sup>. Gjatë fundit të viteve '30, kur Gjermania naziste synonte pushtimin e Europës qendrore, Italia e shihte “hapësirën e saj jetike” në Ballkan, me pikënisje Shqipërinë, duke hartuar një projekt asocimi mes dy shteteve, që sado që i përmbahej sovranitetit ndërkombëtar të Shqipërisë, gjithsesi e lidhte atë pazgjidhshmërisht me Italinë<sup>132</sup>.

Ky projekt kërkonte mbështetjen e ndërkombëtarëve dhe, ndër pasojat e para, do të ishte eliminimi i Zogut, në rast se ky nuk do të pranonte, çka, paraprakisht, duke sheshit.

Rrokullisjen e shpejtë të ngjarjeve e solli aneksimi i Austrisë nga Gjermania, sepse sipas vizionit të qeverisë italiane, ishte urgjente shtrirja e pushtetit italian mbi territorin shqiptar, për të shmangur mundësinë që Gjermania të forconte praninë e saj në Ballkan, duke qenë se nëpërmjet një *Anschluss-i*, tashmë trashëgonte rolin që kishte luajtur Austria në këtë zonë në një kohë jo shumë të largët. Kështu, brenda një kohe të shkurtër situata në Shqipëri u rrokullis dhe menjëherë pas arratisjes së mbretit Zog<sup>133</sup>, u shpall bashkimi i

---

<sup>130</sup> F. IACOMONI DI SANSAVINO, *vep. cit.*, 19 ss.

<sup>131</sup> Jacomoni di Sanansavino, i ardhur në Shqipëri që në vitin 1926, u bë, në vitin 1936, Ministër i Plotfuqishëm i Italisë në Shqipëri dhe me dekretin e datës 22 prill 1939 u emërua mëkëmbës i përgjithshëm i mbretit Vittorio Emanuele III në Shqipëri. *Ibidem* 157.

<sup>132</sup> Me 2 janar 1937 u nënshkrua një *gentlemen's agreement* mes Italisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, në të cilën të dy vendet shpallnin interesin e ndërsjellë për të drejtën e hyrje-daljes dhe tranzitit në ujërat e Mesdheut, duke marrë njëkohësisht angazhimin të mos e ndryshonin *status quo*-në e asnjërit prej vendeve bregdetare. Kjo marrëveshje u përforcua më tej me miratimin e të ashtuquajturit “Pakti i Pashkëve” (Patto di Pasqua) me 16 prill 1938. Me ndërhyrjen e saj në Shqipëri, Italia ishte e detyruar të ruante, së paku formalisht, pavarësinë e vendit, për të mos shkelur marrëveshjen e nënshkruar. Kjo, me gjasë, përbënte shqetësimin kryesor të Italisë gjatë fazës së bashkimit të Shqipërisë me Mbretërinë e Italisë. F. IACOMONI DI SANSAVINO, *vep. cit.*, 91 ss.

<sup>133</sup> Arratisja e mbretit shqiptar për shkak të pushtimit italian, nuk i nxiti trupat pushtuese ta ndalonin gjëkund. I ikur më parë në Greqi e më pas në Londër,

Shqipërisë me Italinë, për rrjedhojë mbreti i Italisë u bë mbret edhe i Shqipërisë dhe emëroi si përfaqësues mëkëmbësin e vet të përgjithshëm, Francesco Jacomoni nga San Severino. Kështu, më 3 qershor 1939, Shqipëria mori statutin e ri të mbretërisë<sup>134</sup>. Edhe pse në nenet e para të tij, statuti shpallte lirinë fetare, qëndrimi politik ndaj besimeve fetare ndryshoi ndjeshëm, duke qenë se marrëdhëniet me komunitetet fetare e veçanërisht me Kishën katolike ishin një ndër pikat kyçe për “asimilimin” e Shqipërisë nga Italia.

Kjo bëhet e qartë nëse vërejmë se ç’ndodh me Kishën katolike, e cila, pikërisht në vitin 1939, vendos të reformojë organizimin e Kishës në vend, duke e ndarë në dy zona: veriore dhe jugore. Zona e parë ruajti organizimin e mëparshëm dioqezan<sup>135</sup>, edhe pse

---

Zogu kishte lënë pas një vend, që siç pohojnë vetë pushtuesit, kishte një strukturë shtetërore relativisht të qëndrueshme; kishte forcuar përfaqësimin e vet identitar dhe për nga pikëpamja e legjislacionit të miratuar dhe zbatuar, ishte një shtet i laicizuar dhe shekullarizuar ndjeshëm. *Ibidem*, 124 ss. Po këtë mendim bashkëndan në analizën e fundit R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep.cit.*,174.

<sup>134</sup> Lidhur me tekstin e statutit themelor të mbretërisë së Shqipërisë, shih: *Raccolta di provvedimenti di carattere legislativo riguardanti l’Albania* (a cura di B. Bertuccioli) Roma, Ministero affari esteri, 1941, 9-16, i botuar në: Fletorja Zyrtare e Mbretërisë së Shqipërisë nr. 40, datë 10 qershor 1939, sot në: <http://licodu.cois.it/691/view>. Jacomoni, në kujtimet e tij, shprehet kështu: “Teksti i statutit u përpunua, përveç këshilltarit të mëkëmbësit, Corradino Berardi, edhe nga dy titullarë të shquar të katedrave universitare: Tommaso Pavasi e Claudio Baldoni. Në vija të përgjithshme, mund të thuhet se ai ishte një shkrimtar dhe statuti italian me statutin shqiptar që ishte në fuqi gjatë kohës së Zogut. Tek ky i fundit ishin mbështetur më së shumti për veshjen me pushtet të sovranit dhe jo aq tek statuti italian”. *Ibidem*. 159. Statuti shqiptar konsolidonte Monarkinë kushtetuese të trashëguar nga familja Savoia; parlamenti u zëvendësua nga këshilli i lartë fashist-korporativ që ushtronte pushtetin ligjvënës. Mbreti ushtronte pushtetin ekzekutiv, mund të kryesonte këshillin e ministrave, të refuzonte zbatimin e projekt-ligjeve të miratuar dhe mund të emëronte një mëkëmbës të vetin, rezident në Shqipëri, që të kryente funksione të caktuara në emër të tij.

<sup>135</sup> Lidhur me dioqezat shqiptare, shih: AGENZIA FIDES, *Le missioni cattoliche dipendenti dalla Sacra Congregazione de propaganda fide. Cenni geografici e storici. Dati statistici*, Roma, Consiglio superiore della Pontificia Vepera della prvepagazione della fede, 1946, 8-9, 103-104, 328, 350-352 e 355-356; L. TACCHELLA, *Le antiche sedi episcopali latine, greche e bulgare dell’Albania etnica e della Macedonia*, Milano, Seregini, 1990; R. TOLOMEO, *La Santa Sede e il mondo danubiano-balcanico. Problemi nazionali e religiosi* (1875-1921), Roma, La Fenice Edizioni, 1996, ss.

vazhdonte nën varësinë e kongregatës së shenjtë *Propaganda Fide*, e cila, sidoqoftë, ua besoi drejtimin e territorit urdhërit *Shoqëria e Jezusit*<sup>136</sup> dhe urdhërit të *Fretërve Minorë* (francëskanëve)<sup>137</sup>.

Në zonën e dytë, kongregata ngriti *Administratën Apostolike për Shqipërinë Jugore* (ku bënë pjesë rrethi i Gjirokastrës, Beratit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës), dhe ia kaloi drejtimin e saj delegatit apostolik në Shqipëri, arqipeshkvit Leone Giovanni Battista Nigris, nën juridiksionin e kongregatës së shenjtë *pro Ecclesia orientali*<sup>138</sup>. Në këtë zonë ishte i padiskutueshëm ndikimi i Kishës së Greqisë fqinje, e cila kishte vendosur jo vetëm epërsinë e ortodoksëve mbi katolikët, por ia kishte dalë të kthente një pjesë të këtyre të fundit në besimtarë të ritit bizantin.

Që nga viti 1938, kongregatës i qe dhënë juridiksion i plotë dhe ekskluziv mbi të gjithë besimtarët, hierarkinë, veprimtarinë dhe institutet e ritit latin e atyre lindorë, por me disa caqe për krahinat lindore dhe pjesën jugore të Shqipërisë<sup>139</sup>. Pas prillit të 1939-ës,

---

<sup>136</sup> Rreth veprimtarisë së jezuitëve në Shqipëri pas muajit prill 1939, ref: R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep.cit.*, 195 ss.; R. H. SIEBERT, *The Society of Jesus in Albania*, "Albanian catholic bulletin", (1993), XIV, 51 ss.; A. GUIDETTI, *Gesuiti in Albania. Apostolato, cultura, martirio nel 50° anniversario del martirio dei Padri Giovanni Fausti e Daniel Dajani (1946-1996)*, [Milano], San Fedele; 1996; L. MURZAKU, *The activity and the role of the Jesuits in the Albanian history and culture, 1841-1946*, doctoral dissertation, relator prof. C. Simon, Rome, Pontifical oriental institute, Department of ecclesiastic oriental history, 1995, (dattiloscritto), 114 ss.

<sup>137</sup> Lidhur me veprimtarinë e Provinçës françeskanë pas muajit prill 1939, shih: "Acta Ordinis minorum", (1939-1940), LVIII-LIX, (1941-1943), LX-LXII, (1944-1946), LXIII-LXV, *passim*; R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep.cit.*, 195 ss.

<sup>138</sup> Kongregata e shenjtë për Kishën lindore nxiti edhe punën e shumë instituteve fetare për femra të cilat iu përkushtuan sidomos hapjes dhe administrimit të kopshteve dhe shkollave si dhe shërbimit mjekësor në spitale. Një ndër to ishte kongregata e motrave baziliane, bijat e shën Macrina-s, Shërbëtoret e vogla të Zembrës së Shenjtë, Shërbëtoret e dashurisë të Provincës së Brescia-s, Bijat e varfra të stigmave të shenjtë të shën Françeskut të Asizit të Provincës së Firences, Motrat adhuresse të Gjakut të Shenjtë, Motrat e dashurisë të shën Vincenzo de' Paoli të provincës së Sienës, Motrat e shën Gjon Pagëzuesit dhe motrat e Maria Ausiliatrice të provincës së Torinos. Për më shumë lidhur me këto urdhëra rregulltarë, shih: *Dizionario degli istituti di perfezione*, Roma, Edizioni Paoline, 1973

<sup>139</sup> Edhe pse, në vitin 1917, u krijua kongregata për Kishën Lindore, si organ qendror për drejtimin e besimtarëve katolikë të Lindjes, u pa të nxirrte krye shumë shpejt, njëfarë dubliciteti juridiksional në Lindjen e krishterë, pasi

veprimtaria misionare iu besua urdhrave dhe kongregatave të pranishëm prej shekujsh në Shqipëri, si për shembull, murgjëve të urdhrorit bazilian me seli në Itali, në Grottaferrata, etërve vincensianë të së drejtës bizantine të ardhur nga provinca romane e Kongregatës së misionit<sup>140</sup> dhe kuvendit të fretërve minorë të ritit bizantin<sup>141</sup>. Po i dilej kështu në krye një rruge të nisur që në vitin 1927 nga bregu matanë Jonit, kur Kisha katolike kishte ngritur një eparki të dytë në Itali, në Piana degli Albanesi, me popullsi arbëreshe, nën drejtimin e manastirit të Grottaferrata-s, të ritit bizantin, e cila kishte për detyrë të ndiqte veprimtarinë e proselitizmit në Shqipëri<sup>142</sup>.

---

katolikët e ritit latin vazhdonin, si gjithnjë, të vareshin nga *Propaganda Fide*. Për t'i dhënë zgjidhje ngërçit të krijuar, Pio XI, me anë të *motu proprio. Sancta Dei Ecclesia* datë, 25 mars 1938, përcaktoi prerazi sferën e veprimit të Kongregatës së Shenjtë për Kishën Lindore, nga e cila do të vareshin të gjithë besimtarët, si ata të ritit lindor, ashtu dhe atij latin; hierarkia; veprimtaria e instituteve të pranishëm në Shqipërinë jugore, Bullgari, Qipro, Egjipt, Eritrea, Etiopinë e veriut, Greqi, Jordani, Iran, Irak, Liban, Palestinë, gadishulli i Sinait, Siri dhe Turqi.

[http://www.vatican.va/roman\\_curia/congregations/orientchurch/profilo/rc\\_on\\_orient\\_pro\\_20000724\\_profile\\_it.html](http://www.vatican.va/roman_curia/congregations/orientchurch/profilo/rc_on_orient_pro_20000724_profile_it.html)

<sup>140</sup> Prania e kongregatës në misionin, quajtur ndryshe misioni i Vinçensianëve, në Shqipëri, i kishte fillesat që në vitet '800, por vetëm në vitin 1931 Vinçensianëve të provincës së Napolit iu besua një mision nga Kongregata e Shenjtë për kishën lindore. Në vitin 1939, ata u zëvendësuan nga Vinçensianët e Romës. Siç shihet, duke filluar nga viti 1939, Kongregata e Shenjtë për Kishën Lindore, grumbulloi të gjitha burimet që zotëronte katolicizmi i ritit grek-bizantin për t'i investuar në Shqipëri. Ref. "Annali della Congregazione della missione e della Compagnia delle figlie della carità", (1940), XLII, pp. 93-99 e 178 ss.; A. TERZARIOL, *Gli albanesi. La Sacra Congregazione per le Chiese orientali nel cinquantesimo della fondazione, 1917-1967...cit.*, 224.

<sup>141</sup> A. TERZARIOL, *Gli albanesi...cit.*, 224; SACRA CONGREGAZIONE PER LE CHIESE ORIENTALI, *Oriente cattolico. Cenni storici e statistiche...cit.*, 581; G. ODOARDI, *Frați minori conventuali*, in *Dizionario degli istituti di perfezione* diretto da G. PELLICIA-G. ROCCA, III, Roma, Edizioni Paoline, 1976, 58-59; G. CARRARO, *Albania cristiana: cronistoria della missione latino orientale della Provincia patavina di S. Antonio dei frati minori conventuali*, Padova, Curia provinciale, 1985.

<sup>142</sup> Murgjit bazilianë të Grottaferrata-s, drejtonin famullinë e Vlorës dhe kishin për detyrë të përhapnin besimin katolik në Jug të Shqipërisë, duke u mbështetur tek zakonet e ritit bizantin të asaj popullsie. Përpjekja për të depërtuar në këto zona, nuk i arriti pritshmëritë e dëshiruara si për shkak të rrënjosjes së besimeve të tjera fetare në vend, ashtu dhe për ujditë e shpeshta të Kishës katolike shqiptare me pushtuesin italian. L. ANGELI MURZACU, *Returning home to Rome...cit.*, 111- 170.

Në të vërtetë, projekti ishte më i gjerë e më i ndërlikuar dhe kishte si fazë të parë hapjen e plotë të klerit latin në Shqipëri ndaj klerit dhe besimtarëve të besimeve të tjera fetare, duke u mbështetur në vizionin ekumenik të marrëdhënieve mes kulteve. Por qëllimi kryesor ishte forcimi i marrëdhënieve me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë e cila vetëm në vitin 1937 ia kishte dalë të merrte *Tomos-in* e autoqefalisë nga Patriarkana e Kostandinopojës dhe po kalonte një fazë rregullimi organizativ dhe doktrinal. Duke përfituar nga kjo situatë, u arrit marrëveshja me Kristoforos Kissin, metropolit i Tiranës për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, që të mundësohej kalimi i klerit dhe besimtarëve të kësaj feje në uniatizëm<sup>143</sup>. Gjatë zhvillimit të këtyre negociatave, Abacia e Grottaferrata-s po punonte për shtrirjen e pranisë së saj duke hapur kisha dhe inaguruar nisma të ndryshme në Gjirokastrë, Korçë, Berat, Fier dhe Lushnjë<sup>144</sup>.

Krijimi i një Kise katolike të rritit bizantin në Shqipëri do të kishte mundësuar përmbushjen e shumë synimeve me vetëm pak mundim. Kisha katolike do të kishte shtrirë ndikimin e saj jo vetëm brenda vendit, por edhe më gjerë, në territoret shqiptare, në Kosovë dhe në kufi me Jugosllavinë e Maqedoninë, duke marrë shkas nga nacionalizmi shqiptar i parë me sy të mirë nga Italia; do të ishte kapërcyer “anomalia” e krijuar nga një pakicë domethënëse e katolikëve të rritit bizantin në Itali, duke i vendosur ata në një strukturë më të madhe në nivel evropian, gjë që në planin fetar do t’u kishte lejuar “rigjenerimin” e praktikës së rritit bizantin, i cili padyshim është i mangët dhe i lëkundshëm edhe në territorin italian<sup>145</sup>; do të kishte marrë hov shtrirja e katoliçizmit drejt Lindjes, e ndihmuar nga shpërbërja e Perandorisë Osmane dhe nga fragmentarizimi i shteteve ballkanike si dhe nga shtrirja e politikës italiane mbi këto zona; do të kishte marrë një zgjidhje konkrete dhe të qëndrueshme çështja e uniatizmit me krijimin e

---

<sup>143</sup> Për zbatimin e këtij projekti, ka gjasa të ketë pasur marrëveshje mes tre ndër pesë ipeshkvinjve që përbënin Sinodin e shenjtë të kishës ortodokse autoqefale të Shqipërisë: përveç Kristoforos, ipeshkvi i Beratit Agathangjel Çamçe e Vasili Marku. Ndërkohë, ishin kundër uniatizmit ipeshkvi i Korçës dhe i Gjirokastrës. R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep.cit.*, 190.

<sup>144</sup> *Ibidem*, 193

<sup>145</sup> C., KOROLEVSKIJ, *L’eparchia di Lungro...cit., Passim*

një strukture të fortë klerikale të rritit bizantin, e cila do të kishte të gjithë aftësinë për t'u bërë ballë Kishave ortodokse të Rusisë, të vëna në krizë nga bolshevikët e ardhur në fuqi, por edhe atyre turke, që nën presionin e politikës laike të qeverisë, po shihnin ndrydhjen e forcës vepruese të Patriarkanës Ekumenike. Natyrisht, ky projekt kishte nevojë për mbështetje të mirë financiare, gjë që duhej ta merrte përsipër Italia.

Realizimi i këtij projekti do të kishte sjellë avantazhe të pamohueshme për qeverinë italiane duke filluar që me forcimin e lidhjeve me Shqipërinë në nivelin e një politike të mirë-organizuar që do t'i hapte rrugë depërtimit ekonomik dhe politik italian, falë një partneri të aftë për të mbështetur strategjitë e shtrirjes së regjimit, Kishës katolike. Me përmbushjen e këtij projekti, Kisha katolike në Shqipëri do të kishte diku rreth 30% të popullsisë.

Një provë tjetër që dëshmon se sa konkret ishte një plan i tillë, është ftesa që iu bë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për të marrë pjesë në Sinodin e eparkive arbëreshe, i mbajtur në Grottaferrata në tetor të vitit 1940, me qëllim që ta bënin bashkudhëtarë të tyre duke e njohur dhe vlerësuar si të barabartë. Ftesa u pranua, çka e dëshmon pjesëmarrja e një delegacioni shqiptar në këtë Sinod<sup>146</sup>.

Ndërkohë, me synimin për të ndërtuar një marrëdhënie “të ekuilibruar” me komunitetet e ndryshme fetare në Shqipëri, mëkëmbësi i Mbretit u takua me përfaqësuesit e besimeve të

---

<sup>146</sup> “Me të mbërritur në Romë me 14 tetor [1940], Ciano më priti në prani të një delegacioni të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, të kryesuar nga metropoliti i Beratit. Ky delegacion do të kalonte disa ditë në kuvendin e shën Nilo-s, seli e urdhërit të murgjëve bazilianë, katolikë të rritit lindor, që shërbenin në famullinë e Vlorës. Qëndrimi në Grottaferrata i përfaqësuesve të lartë të kishës ortodokse, bëhej në bazë të marrëveshjes së autoriteteve të hierarkisë fetare për një afrim të kishës ortodokse autoqefale të Shqipërisë me katedrën e shën Pjetrit. [...] Ishte koincidencë e çuditshme që afrimi mes besimeve të krishtera në Shqipëri, po ndodhte pikërisht atëherë kur Ciano po më shpallte qëllimin e parakohshëm të kësaj tentative. Ciano i pohoi metropolitit se numri i ortodoksëve në Shqipëri do të rritej shumë shpejt”. F. JACOMONI DI SANSAVINO, *vep. cit.*, 249-250. Delegacioni shqiptar shkoi më pas në Montecassino, e që andej në Predappio për të bërë homazhe në varrin e prindërve të Musolinit. shih: *Il primo Sinodo degli orientali di rito bizantino e Dopo cinque secoli un Sinodo e un incontro*, “Il Giornale d'Italia” 15 e 17 ottobre 1940 ora in R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.*, 239.

ndryshme dhe si akt të parë publik ndërmori “..me rastin e festës kombëtare të Shqipërisë, më 28 nëntor, dhe asaj të lindjes së Mbretit, me 11 nëntor, mëkëmbësi i Mbretit do të merrte pjesë në ceremoninë fetare të mbajtur në xhaminë e madhe të Tiranës; Kryetari i këshillit, besimtar mysliman, do të ishte i pranishëm në Kishën ortodokse ndërsa Kryetari i dhomës së deputetëve, Terenc Toçi, katolik i ritit lindor, do të merrte pjesë në ceremoninë fetare të një famullie katolike të ritit latin”<sup>147</sup>.

Kjo marrëveshje synonte t’i dëshmonte popullit ekzistencën e mirëkuptimit të thellë mes komuniteteve fetare në prag të regjimit të ri politik, duke ia rikthyer peshën hierarkisë së kulteve për t’i përmbushur dëshirën kryesisht Kishës katolike, e cila, edhe pse nuk përzihet shumë me pushtetin, gjithsesi e kishte siguruar epërsinë absolute të ritit latin, sadoqë disave, si për shembull Toçit, do t’i pëlqente që katolikët shqiptarë t’i ktheheshin ritit bizantin që arbëreshët e ruanin ende sot e kësaj dite.

Kur Italia i shpalli luftë Greqisë, kjo solli së pari zhgënjim e më pas humbjen e të gjitha shpresave që shqiptarët kishin vënë tek Italia për kthimin e trojeve etnike. Edhe pse për një kohë të shkurtër iu kthyen vendit Kosova dhe disa territore të Maqedonisë, kjo vetëm sa i përkeqësoi marrëdhëniet mes besimeve dhe pështjelloi lidhjet mes shtetit dhe komuniteteve fetare. Në fakt, popullsia myslimane në territoret e aneksuara karakterizohej nga prania e fortë e së drejtës dhe gjykatave fetare myslimane, tashmë të zhdukura prej dekadash në Shqipëri, dhe nga lidhjet me një traditë krejt të ndryshme nga ajo e bashkëvëllezërve në territorin e shtetit shqiptar<sup>148</sup>. Gjatë kohës së qëndrimit të trupave italiane në vend,

---

<sup>147</sup> F. JACOMONI DI SANSAVINO, *vep. cit.*, 187-188.

<sup>148</sup> Në Kosovë, Maqedoni dhe mes popullsive boshnjake të fesë myslimane, mbijetonte ende juridiksioni i gjykatave fetare dhe islami nuk ishte “modernizuar”, siç kishte ndodhur me islamin shqiptar, i cili kishte evoluar në përballjen dialektike mes shestimeve të ndryshme së brendshmi vetë islamit, por edhe në përjasje me besimet e tjera. Edhe pse, sipas disa studiuesve, islami ballkanik mbarte karakteristika të përbashkëta dhe ishte pasuruar nga bashkëjetesa e banorëve me fe dhe etni të ndryshme, edhe pse kishte, sidomos në këto zona, jo pak vëllazëri islame, e vërteta është se në Shqipëri identiteti i fortë kombëtar e kishte orientuar kërkimin e vlerave të përbashkëta tek çështja e shqiptarizmit, më shumë se sa tek sistemi i vlerave fetare islame, ortodokse, apo të çdo lloji tjetër. A. PVEPOVIC, *L’islam balkanique. Les musulmans du sud-est eurpeéen dans la période post-ottomane, ...cit, passim*; ID., *Le confraternite sufi*

Kisha katolike përfitoi mbështetje, përkrahje dhe financime, aq sa në sytë e shqiptarëve prania e saj lidhej me praninë italiane në vend. Rezultati i vërtetë pozitiv nën këndvështrimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, qe moszbatimi i ligjeve raciste në territorin shqiptar, gjë që u shpëtoi jetën jo vetëm hebrenjve shqiptarë, por u bë strehë edhe për ata që ia dolën të mbërrinin aty nga vende të ndryshme të Ballkanit, madje edhe nga Gjermania e Austria, të cilët u pajisën me dokumente e identitete të rreme deri në pushtimin gjerman kur gjendja u rëndua më keq<sup>149</sup>. Gjermanët, që u zunë vendin italianëve, u përpoqën gjithashtu të vendosnin marrëdhënie të mira me komunitetet fetare, kërkuan bashkëpunim dhe ngritën një organ drejtues shtetëror, “Regjenca” ku bënë pjesë përfaqësues fetarë të të gjitha besimeve. Kjo kishte për qëllim ngritjen e një organi të ngjashëm me atë të viteve '20, që do të shërbente si garant për unitetin e Shqipërisë<sup>150</sup>. Gjithsesi, interesi i pushtuesve gjermanë

---

*nella regione balcanica. in Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo. Il difficile equilibrio tra mistica e politica, (a cura di Marietta Stepanyants), Torino, 2008, 181-206; F. LUBOGNA., Feja ne Shqiperi. Tirane, Drita, 1995; G. CIMBALO. Le confraternite islamiche nei Balcani ...cit., passim.*

<sup>149</sup> Komuniteti hebre shqiptar përbëhej nga jo më shumë se disa qindra persona, por me fillimin e persekutimeve raciste, ia behën në këtë vend refugjatë nga Gjermania dhe Austria, por edhe nga vende të tjera ballkanike, të pushtuara nga nazistët. Është për t'u theksuar se në Shqipëri nuk u zbatuan kurrë ligjet raciste dhe se qeveria e Mustafa Krujës e refuzoi kërkesën e gjermanëve për t'u lëshuar në dorë 300 hebrenjtë e identifikuar nga gestapo, me pohimin që nuk i gjente dot kush ishin. Fshehurazi dhe në marrëveshje me mëkëmbësin e mbretit, qeveria i pajisi ata me pasaporta falso dhe i transferoi në jug të vendit, për t'u dhënë mundësinë të emigronin që andej. Qeveria bëri një zgjedhje të tillë, nisur nga qëndrimi i popullsisë kundrejt të ardhurve të huaj, të cilët i mirëpriste dhe i fshihte si mundej. Këto vendime dhe praktika shtuan fluksin e hebrenjve që kishin marrë arratinë nga mbarë Lindja drejt Shqipërisë. F. JACOMONI DI SANSAVINO, *vep. cit.* 288-289; MINISTERO DEGLI AFFARI ESTERI, *Relazione sull'opera svolta dal Ministero degli affari esteri per la tutela delle comunità ebraiche (1938-1943)*, [Roma], s.e., [1945], 16-17; F. FOLINO, *Ferramonti. Un lager di Mussolini. Gli internati durante la guerra*, Cosenza, Brenner, 1985, IX n; C. S. CAPOGRECO, *Ferramonti. La vita e gli uomini del più grande campo di internamento fascista (1940-1945)*, Firenze, La Giuntina, 1987. 85 e 88-89; H. SARNER-J. JAKOEL-F. JAKOEL, *The Jews of Albania*, Boston, Brunseick Press, 1992; R. DE FELICE, *Storia degli ebrei italiani sotto il fascismo*, Torino, Einaudi, 1993, 403 s.

<sup>150</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep.cit.*, 206 ss



përqendrohej tek komuniteti mysliman, edhe pse iu desh të kënaqej vetëm me disa marrëveshje sipërfaqësore e oportuniste<sup>151</sup>. Trajektorja që po merrte lufta i kishte bindur tashmë edhe qarqet nacionaliste shqiptare se, nëse kërkonin pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë, mbrojtjen duhej ta kërkonin tek Rusia Sovjetike, trashëgimtare e politikës cariste, që e kishte kthyer hapësirën ballkanike në një strumbullar të interesave të veta karshi Perëndimit. Propaganda e grupeve partizane nuk linte pa kujtuar vlerat e tolerancës fetare, “...duke iu referuar shembullit të Rusisë Sovjetike që u linte (...) liri të plotë myslimanëve, të krishterëve dhe besimtarëve të çdo feje në territorin e saj”<sup>152</sup>. Edhe kjo qe një ndër arsytet e forcimit gjithnjë e në rritje të rezistencës së drejtuar nga Partia Komuniste Shqiptare, e mbështetur nga jugosllavët, që gradualisht u shtri në të gjithë vendin, duke fituar mbështetjen e qarqeve më të hapura e më demokratike të shoqërisë shqiptare dhe duke u rrënjësuar sidomos në Shqipërinë qendrore dhe atë jugore. Komunitetet kryesore të këtyre zonave qenë myslimanët dhe bektashinjtë dhe pikërisht me këtë të fundit partia komuniste ndërtoi një dialog aktiv me qëllim vendosjen e epërsisë së vet<sup>153</sup>.

---

<sup>151</sup> Gjermanët zbarkuan në Shqipëri një divizion të SS-së të përbërë nga myslimanë, i cili në vitin 1943 ishte angazhuar në Francë dhe që me këtë rast u ripagëzua me emrin Skënderbeu. Kjo komandë zyrtarësh gjermanë rekrutoi rreth 6500 shqiptarë, kryesisht nga Kosova. Më shumë se gjysma e tyre dezertuan derisa me 1 tetor 1944 komanda u shpërbë. Preteksti se ajo kishte natyrë fetare dhe se anëtarët e saj do të përfaqësonin pikëtakimin mes antisemitizmit gjerman dhe kundërvënies myslimane ndaj sionizmit, shkaktoi protesta deri në nivelet e qeverisë kolaboracioniste, e cila doli në mbrojtje të laicizmit të shqiptarëve. R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep.cit.*, 221 ss.

<sup>152</sup> Edhe organit *Civiltà Cattolica* iu desh të pranonte se në zonat e çliuara nga rezistenca, gjatë luftës partizane, institutet dhe strukturat e kishës katolike mund të vazhdonin lirishit veprimtarinë e tyre. F. CAVALLI, *Persecuzione religiosa nell'Albania comunista*, “*La Civiltà Cattolica*”, 7. 6. 1947, 409-422.

<sup>153</sup> Dialogu i komunistëve shqiptarë me bektashinjtë zhvillohej kryesisht nëpërmjet Baba Fajës, nënkryetar i frontit të çlirimit kombëtar dhe Baba Fejzës, të vrarë të dy, pas një viti së bashku me Abas Hilmi Dede, për shkak të qëndrimeve të tyre.

Rreth këndvështrimit komunist për luftën partizane, shih: E. HOXHA, *Kur lindi Partia*, Tirana 8 nëntori, 1981. Për më tepër: B. FEVZIU, *Enver Hoxha - Biografi nga Blendi Fevziu*, Tirana, Uet/press, 2011; A. PUTO, *Lufta Italo-Greke Diktatore e Kuisling*, Tiranë, Toena, 2011, 366-367

## Kreu II

### REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË

Përmbledhje: 2.1. Lindja e Republikës Socialiste të Shqipërisë dhe marrëdhëniet me komunitetet fetare. Rishikimi i parë i statuteve. 2.2. Reforma agrare dhe shpronësimi i komuniteteve fetare. Mbyllja e shkollave fetare. 2.3. Ligji i ri për komunitetet fetare dhe statutet e tyre. Statuti i komunitetit mysliman. 2.4. Statuti i komunitetit bektashian. 2.5. Statuti i komunitetit ortodoks. 2.6. Statuti i komunitetit katolik.

#### **2. 1. Lindja e Republikës Socialiste të Shqipërisë dhe marrëdhëniet me komunitetet fetare. Rishikimi i parë i statuteve.**

Në datat 20-30 tetor 1944 u mbajt në Berat mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, që vendosi transformimin e saj në një Qeveri demokratike të përkohshme. U miratua *Një deklaratë e të drejtave të qytetarëve* në të cilën, garantohej mbrojtja e lirisë, të drejtat e përgjithshme, liria e besimit dhe e ndërgjegjes, dhe iu njohën të drejta të barabarta të gjitha besimeve fetare. Deklarata njohu pronën private dhe sigurinë vetjake të qytetarëve, lirinë e nismës private në jetën ekonomike.<sup>154</sup>

---

<sup>154</sup> A. A.Vv., *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, 1999, 210. Rreth tipareve të së drejtës në ish vendet socialiste dhe kushtetutat e tyre, shih G. Ajani, *Diritto dell'Europa Orientale*, Torino, UTET, 1996; G. Cimbalò, *Prime note sulla tutela penale dei culti nei Paesi dell'Est Europa*, në aktet e konferencës "La Carta e la Corte. La tutela penale del

Aso kohe nuk u bënë ndryshime të dukshme në jetën fetare, përkundrazi, politika e bashkimit kombëtar kërkonte që besimet fetare të trajtoheshin njëllor. Kundërvënia ndaj fesë do të shfaqej më vonë<sup>155</sup> Për të vënë bazat kushtetuese të pushtetit të ri të dalë nga lufta, në shtator të vitit 1945 u miratuan disa ligje për Asamblenë Kushtetuese, si dhe ligji elektoral që u njihte të drejtën e votës, pa dallim feje dhe bindjeje politike, grave dhe të gjithë qytetarëve mbi 18 vjeç, por duke respektuar rigorozisht listën e paraqitur nga Fronti Demokratik<sup>156</sup>.

Në zgjedhjet e 2 dhjetorit të vitit 1945, Fronti Demokratik, i udhëhequr nga komunistët, doli fitues me 90% të votave; me 24 mars 1946 zuri fill qeveria e kryesuar nga Enver Hoxha. Ndërkaq me 14 mars 1946 u shpall Kushtetuta, e cila theksonte laicizmin e shtetit dhe të sistemit arsimor; garantonte pronën dhe ndërmarrjen e lirë private, edhe pse u vendos që prona private mund të kufizohej dhe të tjetërsohej kur ta kërkonte interesi i përgjithshëm, gjithnjë në bazë të ligjit<sup>157</sup>.

Një kapitull i tërë i Kushtetutës, i trembëdhjeti, trajtonte të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, të cilëve u garantohej liria dhe barazia fetare dhe sanksiononte ndarjen e shtetit nga feja, megjithëse shteti mund t'i mbështeste ekonomikisht besimet fetare. Ligji për partitë politike (neni 7) ndalonte themelimin e atyre me sfond

---

fatto religioso fra normativa costituzionale e diritto vivente”, Ferrara, 27 tetor 2007, nën kujdesin e G. Leziroli-t, Cosenza, Pellegrini, 2009, 143-180.

<sup>155</sup> Lidhur me këtë argument ref. E. Jaques, *Shqiptarët*, Istanbul, Kartë e. Pendë, 1996, 101; D. Sadikaj, *Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist*, Tiranë, 1972, 504.

<sup>156</sup> AA.AV., *Historia e Shqipërisë Tiranë*, 1999, 284.

<sup>157</sup> Neni. 11 i Kushtetutës së vitit 1946 thotë: “Garantohen pronësia private dhe iniciativa private në ekonomi. Garantohet e drejta e trashëgimit të pasurisë private. Asnjëri nuk mund të përdorë të drejtën e pronësisë private në dëm të kolektivitetit. Pronësia private mund të kufizohet e të shpronësohet kur e lyp interesi i përgjithshëm dhe në bazë të një ligje. Me ligjë do të caktohet në ç’rast dhe sa do të shpërblehet pronari. Po me ato kushte mund të shtetëzohen disa degë t’ekonomisë ose sipërmarrje kur e do interesi i përgjithshëm. Ndalohen monopolet, trustet, kartelet, etj. të krijuara me qëllim që të diktojnë çmimet e të monopolizojnë tregjet në dëm të ekonomisë nacionale”.

*Kushtetuta e Republikës Popullore e Shqipërisë*, <http://licodu.cois.it/574/view>

fetar<sup>158</sup>, ndërkohë, komuniteteve fetare u kërkohet nga qeveria të rivendosnin hierarkinë klerikale, së cilës i garantohej liri e plotë për të kryer veprimtarinë e saj sipas ligjit dhe statuteve të miratuara në periudhën e Mbretit Zog<sup>159</sup>. Miratimi i ligjit shënon fundin e fazës së parë të marrëdhënieve të vendosura gjatë procesit të themelimit të unitetit kombëtar, pas së cilës hapet një fazë e re marrëveshjeje mes autoriteteve politike dhe komuniteteve fetare, që zgjati deri në vitin 1976. Gjatë kësaj kohe, qeveria vuri nën varësinë e plotë të shtetit socialist, komunitetet fetare, të cilat u ndoqën dhe u persekutuan deri në asgjësimin e plotë të tyre<sup>160</sup>. Në vitet e para të regjimit komunist zbatimi i dispozitave statutores ishte çështje e brendshme e komuniteteve fetare<sup>161</sup>. Në luftë për çlirimin e vendit ishin angazhuar edhe anëtarë të besimeve fetare apo të grupeve militante të këtyre besimeve, të cilët synonin t'i demokratizonin, por edhe të merrnin pjesë në këto komunitete, brenda të cilave, me vetëdije, nxisnin kundërshtitë të konsiderueshme. Një rast domethënës është ai që ndodhi brenda komunitetit mysliman ku Këshilli Drejtues i rinisë myslimane aktivizohet fuqishëm për rikthimin e statutit të vitit

---

<sup>158</sup> Shih. Dekret nr. 241, 6 dhjetor 1946 dhe ligjin "Mbi formimin e partive politike", në *Gazeta Zyrtare*, n.115, 23 dhjetor 1946, 2. Në nenin 7 të Kushtetutës thuhej se organet shtetërore kompetente ndalonin formimin e partive politike që kishin për qëllim ndërrimin apo përmbysjen e regjimit kushtetues të Republikës popullore të Shqipërisë; që kishin karakter antidemokratik; që organizoheshin mbi bazën e fesë duke mbjellë urrejtje mes kombësive të ndryshme, rracave dhe besimeve fetare. Ndalohej formimi i aktiviteteve të një partie politike kur themeluesit apo anëtarët e kryesisë së saj nxisnin ndjenjat dhe veprimet e sipërpërmendura.

<sup>159</sup> Nga një sondazh i vitit 1945, rezultoi se 68-70% e shqiptarëve ishin myslimanë, 17% ortodoksë dhe rreth 10% katolikë. Në komunitetin mysliman përfshiheshin, përpos Sunitëve që përbënin shumicën, edhe pesë vëllazëri: *haleveti, rufai, kadri, tixhan, sadi*. Bektashinjtë kishin një organizim më vete. S. Hysi, *Myslimanizmi në Shqipëri 1945-1950*, Tiranë, Mësonjtorja e parë, 2000,

<sup>160</sup> Rreth kësaj periudhe mjaft të vështirë marrëdhëniesh mes shtetit dhe komuniteteve fetare shih D. Beduli, *Kisha ortodokse autoqefale Shqipërisë gjer në vitin 1944*, Tiranë, 1992; D.N. Nogaj, *Kisha katolike Shqiptare 1944 nën torturë 1990*, at. Gjergj Fishta, Shkodër, 1999; S. Hysi, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare*, Tiranë, cit., *passim*.

<sup>161</sup> A. Shahu, *Shteti komunist dhe kisha katolike në Shqipëri (1945-1967)*, in Aa.Vv., *Simposio internazionale*, cit., 202.

1929 të këtij komuniteti<sup>162</sup>. Diskutimi me tone herë-herë të ashpra, çoi në rinovimin e hierarkisë myslimane. Kështu, me 22 dhjetor 1945 qeveria miratoi statutin e ri të komunitetit mysliman shqiptar, i cili edhe pse mbështetej në atë të 1929-s, kishte në përbërjen e tij një parathënie dhe 10 kapituj, si dhe, aty-këtu kishte disa ndërhyrje dhe modifikime në krahasim me atë të kohës së Zogut<sup>163</sup>.

Ndër risitë më domethënëse mund të përmenden: përjashtimi i kongresit si organ qendror organizativ dhe transferimi i kompetencave të tij Këshillit të Përgjithshëm dhe ndryshimi i formulës së betimit. Me anë të këtyre masave, orkestrohet një pikiatë e administrimit të komunitetit, në mënyrë që ajo të

---

<sup>162</sup> Për arritjen e këtij synimi duhej shfuqizuar dekretligji i datës 9 qershor 1942, në bazë të të cilit ishte themeluar këshilli i Ulema-s. Në ndihmë të këshillit drejtues të rinisë myslimane u gjend qeveria. Në shkurt të vitit 1945, Ministria e Drejtësisë, nxori një direktivë për formimin e një këshilli të përkohshëm, në përbërje të të cilit do të ishin edhe anëtarë të këshillit drejtues të rinisë. Lista do të hartohej nga Hafiz Musa Aliu, kryetar i komunitetit mysliman gjatë asaj kohe. Me 10 shkurt 1945, këshilli i përkohshëm nxori një qarkore nëpërmjet së cilës i bën me dije komunitetit urdhërin e ri të qeverisë si dhe përbërjen e organit të ri prej pesë anëtarësh. Këshilli i përkohshëm, si një organ drejtues, organizon zgjedhjet e reja për Këshillin e përgjithshëm të komunitetit. AQSH, Fondi, Nr. 882, dosja 6, 35, 1945, 6, 122, 8.

<sup>163</sup> Hyrja nuk u ndryshua. Për administrimin e komunitetit nuk pati ndryshime, duke filluar nga ai i Tiranës. Në nenin 23 të kapitullit VI të statutit të vitit 1945, Myftinjë ndaheshin në dy grupe. Deri në kapitullin IX nuk pati ndryshime të tjera, ndërsa në kapitullin X u shtua një nen me numër 54 sipas të cilit: “ Komuniteti Mysliman me qëllim për të sigurue funksionare fetare (si Imama, Muzina, neper xhamit e qyteteve dhe të katundeve) do të cele Medrese ne qendrat e Prefekturavet ku ka mundesi, si edhe ne disa N/Prefektura, te cilat do te mbahen me shpenzimet lokale”. Neni 56 u rishikua dhe mori trajtën e këtij teksti: “ Keshilli i Perhereshem ne konformitet me ligje e Shtetit esht independent ne veprimet e veta dhe ka te drejte te organizoje administrate fetare te Komunitetit ne menyre qe e shef t’arsyeshme”. Po ashtu, në kapitullin X u shtua neni 62 sipas të cilit: “ Ne cdo te Premte Hytbete, lutjet, per shtetin, per Kryetarin Shtetit, Kombine e Ushterine, bahen ne gjuhen shqipe” *Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar*, në *Gazeta Zyrtare*, Tiranë, e shtunë 22 dhjetor 1945, 1-6, <http://licodu.cois.it/428/view>. Statuti i ri u nënshkrua në Tiranë me datë 20 maj 1945 gjatë kongresit të tretë të komunitetit mysliman, u firmos nga kryemyftinjtë e katër zonave dhe nga delegatët dhe iu dorëzua Ministrisë së Drejtësisë me 4 shtator 1945. Këshilli i ministrave me vendim nr. 43 të datës 26 janar 1946, miratoi statutin e komunitetit mysliman. *Gazeta Zyrtare*, n. 18, 14 mars 1946, 1-2.

kontrollohet sa më lehtë nga politika. Mjafton të vërejmë formën e re të betimit, nëpërmjet së cilës qeveria e mban këtë komunitet lidhur pas direktivave të saj qartësisht politike<sup>164</sup>. Me rëndësi të veçantë ishin ndryshimet që u bënë lidhur me vakëfet. Në kapitullin e parë, neni 2, drejtoria e përgjithshme e administrimit të financave dhe e vakëfeve, një organ ky kolegjial, ia lë vendin një përgjegjësi të administratës së financave dhe të vakëfeve dhe në nenin 17 të kapitullit V, thuhet se drejtori i përgjithshëm zëvendësohet nga një përgjegjës i administratës dhe i vakëfeve; zgjidhet nga Këshilli i përgjithshëm dhe jo më nga shteti. Një dispozitë e tillë kishte rëndësi të veçantë pasi e vinte theksin tek mbarështimi privat i vakëfeve nga ana e komunitetit duke e bërë atë subjekt veprues mbi pasurinë dhe zotërimin e tokës. Riorganizimi i vakëfeve merr shtysë nga thirrja për regjistrim, sepse pasuritë dhe të mirat në zotërimin e tyre ishin dëmtuar rëndë nga lufta. Sidoqoftë, pasuria e komunitetit mysliman në 1945-n, pra në kohën e kongresit, ishte e konsiderueshme dhe siguronte mbarëvajtjen e veprimtarive të këtij komuniteti<sup>165</sup>.

Sa i përket liturgjisë, parashikoheshin pesë falje në ditë, një falje javore, ajo e së premtes (Xhuma), festat e mëdha vjetore; Bajram i Madh apo Fitër Bajrami (Festa e mbylljes së agjërimit), Bajrami i Vogël apo Kurban Bajrami. Agjërimi bëhej gjatë muajit të Ramazanit dhe kishte si qëllim mbrojtjen prej mëkatit dhe pastrimin prej së keqes. U përforcuan ritet e kultit me qëllimin për t'iu rikthyer normalitetit, por edhe për të respektuar kalendarin festiv të fesë myslimane. Drejtoria e komunitetit i kishte bërë kërkesë qeverisë të njihte zyrtarisht shtatë festat fetare të përkthyer në nëntë ditë pushimi festiv<sup>166</sup>. Pas miratimit të

---

<sup>164</sup> Betimi që bëhej para mbretit, tashmë duhej bërë para kryetarit të shtetit dhe Këshillit të përgjithshëm. Paragrafi që përmbante betimin për besnikëri ndaj mbretit, u anulua dhe u zëvendësua me “besnikëri ndaj atdheut”. Në nenin 11 u hoqën disa forma betimesh, duke lënë vetëm një që bëhej para kryetarit të shtetit. Pjesa që kishte të bënte me masën e shpërblimit të kryetarit të komunitetit u hoq dhe u mor vendimi se heqja e pagës mund të bëhej vetëm nga kryetari i shtetit, gjë që më parë bëhej vetëm me dekret mbretëror.

<sup>165</sup> AQSH, Fondi nr. 882, cit., 11, 109, 143, 162, 234-267, 268, 306.

<sup>166</sup> Këto festa ishin: 1) Nata e parë e mirë, 2) Nata e dytë e mirë, 3) Nata e tretë e mirë, 4) Nata e katërt e mirë, 5) Bajrami i madh (dy ditë), 6) Bajrami i vogël apo

kalendari nga ana e qeverisë, veprimtaria fetare zuri të zhvillohej legalisht, pasi praktikisht ajo kishte filluar që me 24 shkurt 1945, por gjithnjë me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë<sup>167</sup>. Duhet vënë në dukje se komuniteti fetar mysliman kishte në përbërjen e tij një personel fetar dhe ndihmësish që kapte shifrën prej 1500 vetash, 1269 prej të cilëve ishin klerikë të thjeshtë (hoxhallarë) ndërsa të tjerët ishin nëpunës<sup>168</sup>. Thuajse gjysma e personelit fetar kishte kualifikim teologjik të nivelit të shkollave 7-vjeçare e të mesme, por kishte edhe prej atyre që kishin studiuar teologji në universitete. Pjesa më e madhe e personelit fetar ishte përqendruar në zonat e Korçës, Tiranës, Peshkopisë, Elbasanit, ku numri i mësuesve të islamit ishte më i madh. Domethënëse ishin synimet e komunitetit në fushën e arsimit. Nga njëra anë kërkohesh përhapja e shkollave për formimin e personelit fetar, nga ana tjetër synohej futja e lëndës së mësimit fetar në shkollat publike, në përputhje me dispozitat e Statutit të vitit 1929, i cili nuk u shfuqizua ndonjëherë<sup>169</sup>. Pas kësaj faze të parë që karakterizohej nga njëfarë lirie relative, në fillim të vitit 1947 nisi përndjekja edhe kundrejt klerit mysliman<sup>170</sup>.

Që me ardhjen e regjimit të ri, kleri i lartë bektashian u përpoq të siguronte pavarësinë e vet në organizimin e komunitetit. Me 10 shkurt të vitit 1945 u mbledh këshilli i komunitetit Bektashian, i

---

Kurban Bajrami, 7) Ditëlindja e profetit të madh Muhamet. AQSH, Fondi nr. 882, dos. 78, 1945, 23.

<sup>167</sup> Komuniteti mysliman ndahej në katër zona të quajtura Kryemyftini. Zona e parë ishte ajo e Tiranës dhe përfshinte qytetet: Dibër, Durrës, Berat, Tiranë. Zona e dytë ishte ajo e Shkodrës dhe përfshinte Shkodrën dhe Kosovën. Zona e tretë ishte Korça dhe përfshinte qytetet Korçë e Elbasan dhe zona e katërt ishte ajo e Gjirokastrës ku përfshiheshin Gjirokastra dhe Vlora. AQSH, Fondi nr. 882, cit., 5, 34.

<sup>168</sup> AQSH, Fondi nr. 890, 1952, dos. nr. 1427, 23.

<sup>169</sup> T. Shilegu, *Lufta e klasave në Shqipëri 1948-1953*, Tiranë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë 1985, 174-175.

<sup>170</sup> U arrestua Hafiz Ismet Dibra ish drejtor i Medresesë së përgjithshme e njëkohësisht me të edhe profesorët e institutit të shkollës islame Hafiz Ibrahim Dalliu, Hasan Tahsimi e Jonuz Bulek, si dhe njohësit më të mirë e më të aftë të filozofisë dhe doktrinës islame, siç ishin Myfti Musa Stefhasani në Burrel, zëvendës myftiu i Hasit, Shejh Ali Bajdami dhe kryemyftiu i Korçës Hafiz Xhafer Aliu. Pretekstet e nxjerra ishin nga më të ndryshmet. Për më shumë shih: D. Sadikaj, *Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist*, Tiranë, 1972, 504.

cili vendosi të organizonte pas dy muajsh kongresin e katërt të bektashinjve. Delegatët pjesëmarrës do të ishin klerikë dhe laikë. Kongresi u mbajt në datat 2-5 maj 1945 në Tiranë<sup>171</sup>. Dyqind delegatëve iu bashkuan edhe shumë personalitete politike, ndër të cilët disa ministra si: Bedri Spahiu, Myslim Peza, zëvendës kryeministri. Kjo dëshmonte parapëlqimin e dukshëm të shtetit përkundrejt komunitetit bektashi, për shkak të meritave të fituara gjatë luftës kundër pushtimit italian e gjerman. Kleriku Mustafa Gjini, një prej organizatorëve të luftës nacional-çlirimtare, i drejtoi vetë punimet e kongresit, duke e justifikuar këtë mungesë të Kryegjyshit me moshën e tij të thyer. Diskutimet e delegatëve vunë në pah kontributin patriotik të bektashinjve gjatë luftës. Klerikët Mustafa Gjini e Fejzi Dervishi u dekoruan dhe kongresi u mbyll me një falenderim të veçantë për udhëheqësin Enver Hoxha, i cili u nderua si një “udhëheqës i shkëlqyer” i popullit shqiptar<sup>172</sup>.

U theksua dhe ripohua pavarësia organizative e bektashinjve të komunitetit mysliman, duke theksuar se bektashizmi është një fe myslimane e aftë për mbarështimin e kultit të vet dhe që i ka themelet tek profeti Muhamed dhe tek Kurani. Me 25 qershor 1945 u miratua një statut mjaft i zhdërvjellët, pa gjithë ato referime teologjike që mbingarkonin atë të 1929-s, përkundrazi, ky i fundit ishte mjaft liberal në organizimin e përgjithshëm të tij. Në statut thuhej se detyra kryesore e komunitetit bektashian ishte ajo e promovimit dhe e zhvillimit të ndjenjave fetare dhe merrte përsipër të rrënjoste tek besimtarët besnikërinë ndaj pushtetit popullor, Republikës dhe vendit. E gjithë veprimtaria e komunitetit i nënshtrohej legjislacionit në fuqi dhe marrëdhëniet me shtetin mbaheshin nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë<sup>173</sup>. Këshilli i

---

<sup>171</sup> AQSH, Fondi nr. 890, viti 1945, dos. 1, 8.; A.B. Tomori, *Historia e bektashizmit*, në *Revista Urtësia*, n. 3, Tiranë, 1994.

<sup>172</sup> *Gazeta Bashkimi*, 6 maj, 1945.

<sup>173</sup> Kongresi zgjodhi organet drejtuese të komunitetit bektashian dhe përcaktoi përbërjen dhe detyrat e tij. Po kështu u veprua edhe për këshillin e Gjyshërve, organ shpirtëror në të cilin bënin pjesë Kryegjyshi botëror dhe titullarët e gjyshatave të tjera. Këshilli të gjyshërve iu ngarkua detyra të mbronte unitetin dogmatik dhe kanonik të komunitetit, të jepte mësimë teorike dhe doktrinale, të kontrollonte respektimin e traditave fetare të klerit. Statuti hartonte skemën hierarkike të klerit bektashian dhe parashikonte masat disiplinore: kryetari i komunitetit ishte Kryegjyshi, për të cilin paracaktohej mënyra e të zgjedhurit dhe



Ministrave, me vendimin nr. 25 të datës 14 korrik 1945, miratoi statutin e komunitetit Bektashian të Shqipërisë<sup>174</sup>.

Kongresi mori edhe një vendim tej kufijve të statutit, për krijimin e një sekretariati si mëkëmbës të Kryegjyshit, duke hapur rrugë kështu një dualiteti pushtetesh mes këtij sekretariati dhe Kryegjyshit<sup>175</sup>. Ndërkohë shtohet debati për rinovimin e komunitetit fetar, i yshtur nga afria që kishin Bektashinjtë me organizatën e partisë komuniste. Kështu, me 14 mars 1947 u krijua organizata e “Bektashinje progresistë”, me kryetar Baba Fejzo Dervishin, i cili nisi përgatitjet për mbledhjen e kongresit V të Bektashinjeve. Progresistët hidhnin kritika ndaj “traditave prapanike”, me të cilat nënkuptonin ritet dhe ceremonitë dogmatike që s’kishin bërë tjetër veçse “e kishin dëmtuar popullin

---

detyrat e tij. Një vend të veçantë në statut zinte pasuria ekonomike e komunitetit, mënyra e administrimit të teqeve dhe ndërtesave të kultit, të pasurive të tundshme dhe të patundshme. Në ndryshim nga statuti paraardhës, tek ky i fundit parashikohet ngritja e një arke për çdo teqe, e cila do të shërbente për grumbullimin e donacioneve dhe të kontributeve financiare për të ndihmuar familjet në nevojë, jetimët dhe të moshuarit duke pëmbushur kështu detyrën e shenjtë të çdo myslimani për të dhënë lëmoshë. *Statuti i Komunitetit Bektashian të Shqipërisë*, në *Gazeta Zyrtare*, n. 60, 10 tetor 1945, 3-4.

<sup>174</sup> *Statuti i Komunitetit Bektashian të Shqipërisë* në <http://licodu.cois.it/424/view>.

<sup>175</sup> Partia komuniste i bëri propagandë të madhe kongresit bektashian. Në shtypin periodik u botuan një sërë artikujsh rreth kësaj ngjarjeje që mbanin tituj të tillë si: “Kongresi i madh Bektashi” apo “Kongresi IV historik”. Vendimet e kongresit IV i propozonin dy detyra themelore komunitetit: të përhapnin gjithnjë e më shumë bektashizmin anekënd vendit, 2) të bënin shumë kujdes me detyrën e orientimit dogmatik dhe të përkujdeseshin për bashkësinë e besimtarëve bektashian në të gjithë botën. Për të dhënë një ide rreth përbërjes së komunitetit, mund t’u referohemi të dhënave të ofruara nga Ali Baba Tomori, ekspert në fushën e dogmave të bektashizmit dhe autor i disa librave rreth këtij besimi, i cili pohon se për atë kohë anëtarët e vëllazërive në të gjithë botën ishin 7, 3 e 7, 5 milion besimtarë, ndërsa në Shqipëri numri varionte nga 100.000 deri në 200.000 besimtarë. A.B. Tomori, *Historia e bektashizmit*, në *Urtësia*, n. 3, Tiranë, 1994, 9. Nga studimet përkatëse rezultonte se Bektashinjtë ishin ngulitur në zonat e Filatit, Voshtinës, Janinës, Delvinës, Gjirokastrës, Tepelenës, Vlorës, Mallakastrës, Përmetit, Beratit, Skraparit, Ersekës, Korçës, Martaneshit, Tetovës, Kavajës, Elbasanit, Çermenikës, Peqinit, Krujës, Kukësit, Gjakovës, Prizrenit, Shkupit, Mitrovicës, Kërçovës, Shkodrës, Durrësit, Tiranës, Dibrës, Rrafshit të Dukagjinit. Shih Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, tani e tujte AMR, Fondi 2<sup>o</sup>, viti 1958, dos. 62, 7.

duke mbjellë padije, prandaj duheshin çrrënjësuar për t'ia lënë vendin një veprimtarie të re krijuese<sup>176</sup>.

Organizata e “Bektashinjve progresistë” shpërndau një dokument ku përmbledhej në mënyrë të qartë platforma politike e partisë komuniste shqiptare: një platformë ku parashikohej shkatërrimi i sistemit të vjetër ekonomik dhe shoqëror. Në këtë dokument theksohej cilësia e regjimit të ri politik, duke ftuar të gjithë besimtarët bektashian të përqafojnë rrugën e emancipimit të propozuar nga partia komuniste. “Feja, besimet prapanike dhe injoranca duhej të zhdukeshin nga bektashizmi” thuhej aty.<sup>177</sup>

Vijoi një periudhë e trazuar e karakterizuar nga vrasje me sfond politik dhe me viktime nga të dy fraksionet, por dinamikat e saj ende nuk janë qartësuar.<sup>178</sup>

Pas luftës, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë nuk e pa të arsyeshme ta riorganizonte statutin e vet, por u kufizua me disa ndërhyrje skajore mbi dispozitat e 1929-s, që u morën më shumë me mënyrën e veprimit sesa me anën organizative dhe me strukturën drejtuese të kultit. Nëse në dy vitet e para, pas luftës, Komuniteti dukej se po gëzonte njëfarë qetësie relative, pasi shumë ndër besimtarë kishin marrë pjesë në kryengritjet popullore dhe në luftën Nacional- çlirimtare kundër pushtuesve, më vonë, sidomos aty nga viti 1947 erdhën e u shtuan sulmet nga ana e qeverisë si për organizimet fetare, ashtu edhe kundër

---

<sup>176</sup> Në të vërtetë debati rreth këtyre tematikave kishte filluar që me 5 maj 1945, me rastin e hapjes së Kongresit IV të bektashinjve. Më pas kishte vijuar me 5 janar 1947 i yshtur nga një grup riformatorësh që kishte kërkuar thirrjen e një sesioni të jashtëzakonshëm të këshillit të përgjithshëm, duke parashtruar dy çështje: liberalizimin e veshjes fetare dhe martesën e klerikëve bektashianë. Grupi i tradicionalistëve u qëndroi besnik bindjeve të veta, e veçanarisht nguli këmbë kundër martesës së klerikëve bektashianë. Ndërsa grupi reformist i argumentoi propozimet e tij duke rikthyer në vëmendje sjelljet e pamoralshme të disa klerikëve, por duke i parë njëkohësiht si rrjedhojë e nevojave natyrore e biologjike. A.B. TOMORI, *Historia e bektashizmit*, cit., 13.

<sup>177</sup> AMR., Fondi i 2-te drejtues, viti 1958., dos. 60, 2.; AMR., Fondi i 2-te drejtues, viti 1958, 13, 15, 31.

<sup>178</sup> “Gazeta Bashkimi”, 20 mars, 1947, 27 mars 1947. AQSH, Fondi. Nr. 14/AP, 1947, dos. 59, 10-12; S. HYSI, *op. cit.*, 75. A B. TOMORI, *Historia e bektashizmi...cit.*, 9 ss.

priftërinjve apo hierarkisë që nuk pranonte t'i nënshtrohej rrjedhës së re të politikës shqiptare.<sup>179</sup>

Marrëdhëniet mes Shtetit shqiptar dhe Selisë së Shenjtë u përkeqësuan që të nesërmen e çlirimit të vendit. Me 4 janar 1945 u mbajt një takim mes Enver Hoxhës, si Kryeministër i Shqipërisë dhe të deleguarit Apostolik në Shqipëri, Shkëlqesisë së tij Leone G. B. Nigris<sup>180</sup>, të cilit, gjatë kthimit të tij nga Roma, në prill të të njëjtit vit iu refuzua viza hyrëse në Shqipëri, pasi konsiderohet person iu padëshirueshëm. Marrëdhëniet diplomatike me Romën u përkeqësuan akoma dhe u vendosen në një nivel inferior me nismën e qeverisë shqiptare në maj të vitit 1945, me Shkëlqesinë e tij Gasper Thaçi dhe Shkëlqesinë e tij Vinçens Prenushi. Qëllimi ishte të vihej bashkëpunim mes Shtetit dhe Kishës Katolike shqiptare me kusht që kjo të shkëputej nga Selia e Shenjtë për të ndërtuar Kishën Katolike Kombëtare Shqiptare, e cila duhej të pranonte pa kushte regjimin e ri komunist në këmbim të pajtimit dhe të ndihmave materiale për vazhdimësinë e ekzistencës e saj.<sup>181</sup> Shteti u përpoq të ndërpriste marrëdhëniet e Kishës Katolike me Selinë e Shenjtë por, herë pas here, i rikthehej prapë dialogut, pasi ndihej ende e dobët për të hapur konflikt në fronte të reja. Nga ana tjetër, kërkonte të përfitonte nga pushteti që ushtronin

---

<sup>179</sup> Le të sjellim ndër mend pushkatimin e at. Aleksandër Lipe-s, më 4 korrik 1946, akuzuar për bashkëpunim me armikun; prifti Aleksandër Koçiu nga Kaludhi, Përmet, i cili u qëllua më 4 korrik 1948 në Gjirokastrë, pas një vendimi të Gjykatës Ushtarake; Metropolit i Tiranës Kristofor Kisi, i cili luajti rol të rëndësishëm në afrimin mes Kishës ortodokse dhe asaj katolike, u izolua në Kishën e Shën Prodhonit, ku qëndroi deri në qershor të vitit 1958 dhe aty vdiq në rrethana të panjohura; Prelatë të tjere të shumtë vuajtën persekutime dhe kërcënime që erdhën duke u shtuar hap pas hapi ndërkohe që Qeveria i mëshonte qëndrimit të saj ateist. Për më shumë, shih:: A. DALIPAJ, *Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me kishën ortodokse...cit.*, 36 – 37.

<sup>180</sup> Ref: “Gazeta Bashkimi”, 4 janar 1945; R. BEQAJ, *Vepriartaria armiqësore e klerit katolik në Shqipëri 1945 – 1967*, Tiranë, 1973, 101 ss.

<sup>181</sup> Pas vdekjes së Shkëlqesisë së tij Gaspër Thaçit, Enver Hoxha, bëri një tentativë tjetër, rinovoi propozimin e Shkëlqesisë së tij, Frano Gjinit. Refuzimi i ipeshkvit që i qartë: “*Unë kurrë nuk do t'i ndaj besimtarët e mi nga Selia e Shenjtë,*” Z. Simoni, Persekutimi i Kishës Katolike ... cit., J. BORDINI, Dhjetë Vjet në Burg në Shqipëri 1945 - 1955, Tirane, 1992 30; L. ANGELS MURZACU, Gjithcka për të gjithë. Misioni i ri i Ungjillëzimit të Kishës, Kisha Katolike dhe shoqëria nëntokësore në kohët e komunizmit, Fondi Ricci dhe burimet e tij për një histori të besimeve fetare në Evropën Lindore, Clueb, Bologna, 2009, 35-51.

komunitetet fetare në shoqëri, prandaj vendosi ta fillonte persekutimin nga individët e veçantë duke i akuzuar ata si bashkëpunëtor të fashizmit dhe nazizmit.<sup>182</sup> Ndërkaq Shteti po përgatitej të përballej me bashkësitë fetare. Pranë Ministrisë së Drejtësisë u themelua sërish: “Komiteti për çështjet fetare”, organ që kishte funksionuar në kohën e mbretit Zog. Detyra e tij ishte të mbante raporte mes Shtetit dhe Bashkësive fetare. Komiteti:

-Kontrollonte projektet e statuteve të komuniteteve fetare dhe rregulloret e komuniteteve fetare që i paraqiteshin Këshillit të Ministrave për miratim.

-Kontrollonte mesazhet baritore, qarkoret e përgjithshme dhe çdo lloj dokumenti tjetër publik, të nxjerrë nga Komunitetet fetare; propozonte mos qarkullimin e atyre që ishin në kundërshtim me ligjet e Shtetit.

-Kontrollonte buxhetin e komuniteteve që i paraqiteshin për miratim Këshillit të Ministrave; shprehte vlerësimet e tij.

-Mbante një regjistër në të cilin shënohej përbërja e organeve qendrore të komuniteteve fetare, dhe mbaheshin shënimet e nevojshme për të gjitha organet ndihmëse vendore dhe të atyre drejtuese të enteve fetare.

Krijimi i këtij Komiteti dëshmonte vullnetin e Shtetit për të vënë nën kontroll aktivitetin e komuniteteve fetare e të vijonte politikat paraardhëse<sup>183</sup>

---

<sup>182</sup> Pas dëbimit të klerit fetar të huaj, goditja ra, veçanërisht, mbi Kishën Katolike. Sulmet drejtoheshin kundër institucioneve kishtare të Shkodrës dhe në veçanti kundër shoqatës “Bashkimi Shqiptar” e cila e kishte seline pranë Seminarit Papnor të atij qyteti. Qeveria i akuzoi drejtpërsëdrejti klerikët për komplot kundër shtetit, dhe shumë prej tyre u pushkatuan. Shih: Z. Simoni, Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri 1944 - 1990, Shkodër, 1998, 271-273; ID “, Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës”, S, 2000, 34, por edhe A. SHAHU, Shteti Komunist dhe Kisha katolike në Shqipëri (1945-196).. ... Cit, 202 ss.; S. PEPA, Martirizimi i kishës katolike, Shkodër, 1993; J. BORDINI, *Dhjetë Vjet në burg në Shqipëri ... cit.*, 30. ss..

<sup>183</sup> Krijimi i një organi *ad hoc* për të mbajtur marrëdhënie me bashkësitë fetare ishte një rregull konstant që mori formë me ligjin e 1928-s, i cili përdori “ Komitetin për çështje fetare “, i cili u propozua me të njëjtin emër nga legjislacioni pas vitit 1945. Synohej që me të të kryheshin negociatat me bashkësitë fetare për miratimin e legjislacionit të propozuar. Kjo zgjedhje tregon interesin e shtetit për shmangien e përplasjeve me komunitetet fetare, duke kërkuar një konsensus të negociuar, së paku gjatë fazës së parë, kur qeveria

Partia komuniste shqiptare, gjatë Kongresit I të saj që u mbajt më 8 - 22 nëntor 1948 doli si i vetmi subjekt i jetës së vendit dhe shpalli programin e saj socialist.<sup>184</sup> Komuniteteve fetare nuk u mbetej zgjidhje tjetër veçse të pranonin gjendjen e re politike në vend, e të bashkëpunonin me autoritetet shtetërore. Mjaft syresh kishin marrë pjesë në luftën nacional-çlirimtare, por shiheshin me dyshim e mosbesim. Të shumta qenë ujdite që autoritetet fetare patën bërë me qeveritë e periudhës së bashkimit me Italinë, si me autoritetet pushtuese italiane ashtu dhe gjermane, duke marrë ndihma dhe përfitime të tjera. Kjo rëndonte më shumë mbi kishën katolike si për lidhjen e kahershme me Italinë, ashtu edhe për raportet që ajo mbante me Selinë e Shenjtë, që në sytë e qeverisë shqiptare shihej e lidhur ngushtë me qeveritë perëndimore dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë klimë, qeveria shfrytëzoi rastin për të vënë në zbatim një riorganizim rrënjësor të të gjitha komuniteteve fetare e të përgatiste masat që do të merrte në të ardhmen me synimin për ta kthyer të gjithë shoqërinë shqiptare, në shoqëri laike. Për t'ia arritur këtij synimi, duhej vepruar mbi atë bazë ku shtriheshin komunitetet fetare në shoqëri.

---

komuniste ishte ende në fazën e konsolidimit të saj, por edhe nën ndikimin e këshilltarëve jugosllavë. Situata përmbysset kur qeveria vendos t'i rregullojë marrëdhëniet politike me kultet, duke u mbështetur në shembullin sovjetik, për të ndryshuar kryekëput, kur ajo i futet rrugës së vet origjinale, asaj të refuzimit total të fesë. Siç do të shohim, kjo traditë do të rishfaqet pas vitit 1991 dhe do të jetë Komiteti Shtetëror për kultet që do të menaxhojë rrugën për të arritur marrëveshjen e negociuar me Kishën katolike dhe të hyjë në marrëveshje bashkëpunimi me komunitetet e tjera fetare .

<sup>184</sup> Aa.Vv., *Historia e Partisë së punës të Shqipërisë*, Tiranë, 1968, 259

## 2. 2. Reforma agrare dhe shpronësimi i pasurisë së komuniteteve fetare. Ndalimi i shkollave fetare.

Me 22 shtator 1944, ende pa qenë qeveri e vendit, Këshilli Antifashist Nacional –Çlirimtar, e pa të udhës të ndërhynte për të dhënë një shenjë të dukshme të ndryshimit që do të sillte mbi marrëdhëniet shoqërore dhe prodhuese, me qëllimin për t’iu përgjigjur një prej nevojave më të ngutshme të fshatarëve të varfër dhe argatëve që përbënin pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare<sup>185</sup>. Për t’ia arritur kësaj, u konfiskoi tokat atyre që kishin bashkëpunuar me fuqitë pushtuese dhe pasurinë e tyre ua dha në përdorim fshatarëve. Mes të mirave të konfiskuara, përfshiheshin edhe ato fetare, që nuk ishin pak dhe, që për shërbime të ndryshme kishin marrë subvencione apo kishin bashkëpunuar me nazistët<sup>186</sup>.

Goditje e veçantë ra mbi Kishën katolike, zotëruese e pasurive të shumta si: toka, ara të kultivuara, vreshta, kullota, pyje, sisteme vaditëse, ndërtesa, mullinj, kafshë dhe të holla. Kjo pasuri, pjesa më e madhe e së cilës e përqendruar në Veri të vendit, ishte mbledhur me ndihmën e Selisë së Shenjtë, të Austrisë, Italisë dhe një pjesë e vogël nga ofertat e besimtarëve katolikë shqiptarë. Për më tepër, Kisha katolike vuajti krizën e strukturave të saj të

---

<sup>185</sup> Faktikisht, pas Kongresit të Përmetit, në maj të vitit 1944 Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar kishte marrë funksionet e qeverisë. Për mbështetjen e lëvizjes së reformës agrare u ngritën komitetet e fshatarëve të varfër në bazë të urdhëresës nr. 5, datë 20.05.1945, e miratuar nga Ministria e Ekonomisë, të cilët kryenin shpronësimin e pronarëve. Me këto masa paraprake, që me 29 gusht 1945 qeveria e përkohshme dëshmonte se kishte forcën e mjaftueshme për t’i çuar përpara këto reforma. *Reforma Agrare e 1946-ës, që i mori tokat pronarëve*, Shqip, 25.05.2007.<http://www.gazeta-shqip.com/ndryshe/7d7c2ee9bd4a0736037de3c0cf1c184e.html>.

<sup>186</sup> Veprimtaritë misionare të Kishës Katolike kërkonin gjithnjë ndihma prej atyre qeverive që synonin të shtonin ndikimin e tyre në Shqipëri. Besimet e tjera fetare nuk mbeteshin mbrapa në kërkimin e mbështetjes financiare, veçanërisht nga Italia, gjatë periudhës së bashkimit me Shqipërinë. R. MOROZZO DELLA ROCCA, *vep. cit.* 195 e ss. AA.AV., *Historia e Shqipërisë*, IV, Tiranë, 1984, 38 ss.

shkaktuar nga dëbimi i atyre që nuk kishin shtetësi shqiptare si dhe nga fajësimi i klerikëve dhe laikëve: dënimi i tyre në burgje çnjerëzore, në mos dënimi me pushkatim, u shoqërua me konfiskimin e të mirave të tyre si dhe të institucioneve kishtare ku bënë pjesë<sup>187</sup>.

Për shpronësimin, merrej vendim nga një komision shtetëror, i cili vepronte “*Në emër të popullit*”, përbëhej nga funksionarë të zonave ku duhej kryer shpronësimi dhe drejtohej nga kryetari i seksionit të sigurisë së komunave. Kjo fazë e parë u ndoq fillimisht nga riorganizimi e më pas nga konfiskimi i pasurive kishtare<sup>188</sup> si dhe nga pakësimi i të ardhurave të komunitetit fetar të parashikuara për rindërtimin e ndërtesave të kultit të shkatërruara gjatë luftës dhe për përmbushjen e nevojave të tjera. Mbi pasurinë e komuniteteve fetare pati ndikimin e vet edhe reforma tatimore. Ligji i datës 31 mars 1945 parashikonte vënien në fuqi të taksës mbi përfitimet nga lufta, taksë që do të godiste pronarët e ndërtesave, tokave, dyqaneve si dhe të çdo aktiviteti ekonomik, pavarësisht nëse pronarët ishin apo jo klerikë<sup>189</sup>.

Më vonë u shtua *vergjia*, një taksë mbi pasurinë, e barabartë me një të tretën e fitimit që rrjedh prej saj. Vergjia, edhe pse hyri në fuqi me ligjin e vitit 1947, kishte fuqi prapavepruese, pasi taksa duhej derdhur duke filluar që nga viti 1945<sup>190</sup>. Me 29 gusht 1945 u miratua ligji i reformës agrare<sup>191</sup>.

---

<sup>187</sup> S. PEPA, *Martirizimi i kishës katolike*, Shkodër, 1993.

<sup>188</sup> Me lënien në fuqi të legjislacionit të miratuar në kohën e Zogut, për besimet fetare zbatohesh neni 4 i *Dekret-Ligjit mbi Formimin e Komuniteteve Fetare* të datës 7 maj 1929 dhe neni 11 i dekretit *Mbi formimin e komuniteteve fetare*, datë 9 korrik 1929. Të dy ligjet duheshin parë nën dritën e neneve 450 e 451 të Kodit Civil mbi entet morale e për më tepër komunitetet fetare konsideroheshin si personalitet juridik civil që i nënshtrohej normave të përgjithshme të kodit për të mirat nën zotërimin e tyre.

<sup>189</sup> Ligji nr.37, datë 13.1.1945 “*Ligji i tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës*”. Taksat ishin shumë të larta dhe institucionet fetare patën kundërshtime. Në fund të vitit 1945 vakëfi i Vlorës, për shembull, ankohej se taksa që rëndonte mbi të ishte 64 000 franga, një shifër shumë më e lartë se vlera reale e vetë vakëfit, Vakëfi i Durrësit, pohonte se taksa mbi të ishte 30 000 franga, një shumë tepër e paarrtshme për kapacitetet e tij. AQSH., Fondo. nr. 882, 1945, dos. 47, 1.

<sup>190</sup> Bëhej fjalë për një taksë me origjinë turke që godiste veçanarisht pasuritë. Për të krijuar idenë e vlerës reale të saj, mjafton të kujtosh që në vitin 1950, të ardhurat që nxirrte Kryegjyshata e Tiranës nga tokat e kultivuara ishte 192 370

Neni 1 i saj parashikonte konfiskimin pa kompensim të tokave që shpronësoheshin dhe u shpërndaheshin fshatarëve, shtetas shqiptarë, që nuk ishin pronarë tokash, ose nuk kishin tokë mjaftueshëm. Po i njëjti nen, në pikën 3, i përcaktonte ato qartazi: “[...] toka bujqësore private, të enteve privatë dhe të komuniteteve fetare me përjashtime dhe saktësime të përshkruara në nenin 2 të këtij ligji”. Neni 2 listonte rastet e përjashtimit nga shpronësimi i detyrueshëm “[...]të tokave bujqësore të privatëve që e punonin vetë atë apo e administronin pa ndihmën e të tretëve” [...]; të tokave bujqësore të enteve fetare ku shtrirja maksimale e sipërfaqes së tyre (tokë e punueshme ose e papunueshme, pemë, vreshta, ullinj, kopshte, kullota etj.), nuk duhet të kapërcejë 20 hektarë, ku jo më shumë se 15 prej tyre mund të jenë toka të punueshme ose jo<sup>192</sup>.

---

lekë dhe taksa e vergjisë mbi këto të ardhura 70 305 lekë. AQSH., Fondi. nr. 882, viti 1950, dos. 1, 10.

<sup>191</sup> Shih: Ligji nr.108, 29.8.1945 “*Për Reformën Agrare*”. Qeveria e re ia doli mbanë aty ku Noli dhe Zogu kishin dështuar me përpjekjet e tyre për reforma të reja. Fan Noli e kishte futur këtë ligj në programin e qeverisë së tij, të prezantuar me 18 qershor 1924, por projekti i tij dështoi përballë qëndresës së pronarëve të tokave dhe rënies së qeverisë së tij. A. BIAGINI, *Storia dell’Albania dall’origine ai nostri giorni*, Milano, Bompiani, 1998, 115 ss. Zogu e miratoi reformën e tij agrare me 3 maj 1930, por edhe kjo ngeci përballë kundërshtimit të fortë të pronarëve të tokave, madje edhe të pjesëtarëve të klanit të vet. Dy të tretat e tokave mbetën në dorë të latifondistëve dhe vetëm një e treta u shpërnda. Gjithsesi, bëhej fjalë për toka që ishin kryesisht kënetat dhe të pakultivueshme, të cilat, gjatë viteve 1934-35, iu shpërndanë fshatarëve të varfër jo më shumë se nga pesë hektarë. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1982, 910-911.

<sup>192</sup> “Neni 1. Me shpalljen e kesaj ligje shpronësohen detyrimisht dhe u ndahen fshatareve nenshtetas shqiptare qe s’kane toke te tyre ose qe nuk u mjafton toka: 1) çifliqet e Shtetit 2) pronat bujqesore te konfiskuara pergjithsisht; 3) pronat bujqesore private dhe te enteve private dhe fetare me perjashtimet dhe percaktimet e pershkruara ne nenin 2 te kesaj ligje; “Neni 2. Perjashtohen nga çpronësimi i detyrueshem, ne masen e caktuar si me poshte: [...] 2. pronat bujqesore t’atyre privateve qe i punojne vete ose i administrojne direkt me menyra kulturele e mjete bujqesore ordinere te vendit t’one, ashtu dhe pronat bujqesore te enteve fetare: shtrirja maksimale e siperfaqes globale (tok’ e punuar ose e punuarshme, livadhe, kullota, korije, etj) te ketyre pronave nuk mund te kaperceje te njezet hektaret (20 ha.) nga te cilet jo me teper se pesembedhete hektare (15 ha) tok’ e punuar ose e punuarshme”. “*Për Reformën Agrare*”. *Gazeta Zyrtare*, n° 17, gusht 1945, 1-2.



Konfiskimi i pasurive të enteve fetare ishte i mundshëm sepse, duke qenë se komunitetet fetare ishin të veshura me personalitet juridik civil dhe duke qenë se myslimanët i mbarështonin pasuritë e tyre nën formën e Vakëfeve, nuk gëzonin ndonjë mbrojtje të veçantë, por u nënshtroheshin rregullave të përgjithshme që rridhnin nga legjislacioni i zakonshëm për të gjitha pasuritë private të tokës<sup>193</sup>.

Mënyra e formulimit të ligjit krijoi jo pak mëdyshje dhe pështjellim për zbatimin e normës nga ana e organeve të ngarkuara për zbatimin e reformës, sepse pasuritë fetare që kapërcenin 20 hektarë tokë ishin të pakta. Qeveria e përshpejtoi afatin dhe me 30 tetor 1945 u kërkoi enteve fetare informacione të detajuara rreth pasurive, si për shpërndarjen në zona të ndryshme, ashtu dhe për mënyrën e administrimit<sup>194</sup>. Komitetet e fshatarëve të varfër, të ngarkuar për zbatimin e reformës agrare, nuk pritën të mbërrinte informacioni nga komunitetet, por zunë të pushtonin pasuritë e vakëfeve, çka bëri që komunitetet fetare t'i drejtoheshin qeverisë për t'i kërkuar që ky ligj të mos i prekte vakëfet. Pas shumë kërkesave nga ana e komuniteteve fetare, me 10 tetor 1946, ministri i Bujqësisë u kërkoi organeve drejtuese të komuniteteve fetare të paraqisnin regjistrat me të dhënat e pasurive të patundshme të vakëfeve<sup>195</sup>. Duke qenë se gjatë luftës, një pjesë e dokumentacionit, ashtu si shumë regjistra ishin zhdukur apo shkatërruar, komunitetet fetare u detyruan të paraqisnin dokumente të mangëta<sup>196</sup>. Komuniteti mysliman që zotëronte dhe

---

<sup>193</sup> Ndryshe paraqitet gjendja juridike e pasurive të enteve fetare katolike, për shkak të mosmarrëveshjeve mes shtetit dhe kishës katolike lidhur me dhënien e personalitetit juridik civil për entet fetare. Për aq sa kemi mundur të rindërtojmë dhe me ç'del nga mosmarrëveshjet lidhur me konfiskimin e të mirave, dokumentimi i pasurisë bëhej në mënyra nga më të ndryshmet, si për shembull, duke e regjistruar atë në emër të dikuj tjetër, apo duke ia kaluar formalisht një enti apo fondacioni, sipas parashikimeve në Kodin Civil.

<sup>194</sup> Mungesa e administrimit shtetëror të vakëfeve në Shqipëri, u linte dorë të lirë komuniteteve fetare për mbajtjen e regjistrave të pasurive të tyre përkatëse. Kjo ka të vëjë me faktin se privatësia e komuniteteve fetare nuk lejonte që pasuritë e tyre t'i nënshtroheshin një mbrojtjeje të veçantë, pasi kjo do të cënonte parimin e ndarjes së shtetit nga besimet fetare.

<sup>195</sup> AQSH., Fondi. nr. 882, viti 1945, dos. 33, 6.

<sup>196</sup> Kjo është një ndër arsytet që, pas vitit 1992, kur u shtrua problemi i kthimit dhe kompensimit të pronave të konfiskuara, çështja e rinjohjes së pronave hasi në

administronte pjesën më të madhe të vakëfeve, hartoi një regjistër të ri, bazuar në ato të dhëna që diheshin. Përballë këtyre vështirësive të panumërta, Ministria e Bujqësisë u përpoq të jepte shpjegime të mëtejshme, duke u kapur pas formulimeve të përgjithshme dhe të paargumentuara juridikisht. Sipas juristëve të Ministrisë së Bujqësisë, ligjvënësi kërkonte që nëpërmjet kësaj dispozite të mbronte vetëm të drejtat e atyre enteve fetare që zotëronin aq tokë sa të punohej vetëm nga personeli i entit dhe të ardhurat e së cilës shërbenin vetëm për jetesën e atyre që e punonin atë. Ligji përjashtonte nga kjo kategori të gjitha ato institucione fetare që kishin nënshkruar kontrata qeraje toke; që kishin marrë punëtorë për ta punuar atë apo i kishin lënë tokat djerr për sigurimin e kullotave, në vend që t'i kultivonin ato<sup>197</sup>. Për më tepër, ishte e vështirë të dalloje pasuritë bujqësore individuale nga ato të enteve fetare në përgjithësi, pasi nuk ishte fiksuar prerazi dallimi mes këtyre pasurive. Jo gjithnjë, pranë një enti fetar ishte ngritur ndonjë vakëf apo ndonjë lloj tjetër enti në trajtë fondacioni, me natyrë tregtare apo sipërmarrëse siç parashikohej nga Kodi Civil, neni 450-451 dhe nga normat përkatëse mbi fondacionet në përgjithësi<sup>198</sup>.

---

vështirësi të mëdha, çka ngadalësoi punën përballë kërkesave të komuniteteve fetare.

<sup>197</sup> AQSH., Fondi. nr. 882, viti 1945, dos. 33, 5.

<sup>198</sup> Neni 445 i Kodit Civil shqiptar të vitit 1929 pohonte që: “Fondacioni ka si qëllim parësor përdorimin e pasurisë për qëllime të parapërcaktuara qartë”. Po ashtu, (neni 446) “Fondacioni themelohet me një akt autentik apo me anë të një testamenti sipas rregullave të përcaktuara në nenin 410”. Në nenin 447 thuhej: “Ligjërisht, fondacioni mund të themelohet nga një donacion trashëgimie ose nga kreditorët e themeluesit”. Po ashtu, sipas nenit 448 “Akti i themelimit e bën publike ngritjen e organeve të fondacionit dhe mënyrat e administrimit të tij. Në rast se informacionet janë të mangëta, këshilli administrativ i prefekturës merr masat e nevojshme. Po qe se fondacioni nuk mund të ndjekë qëllimin e parapërcaktuar, këshilli i administratës së prefekturës ia dorëzon pasuritë një fondacioni tjetër që ka qëllime të ngjashme apo të përafërta me të, gjithnjë me pëlqimin e themeluesit, apo në mungesë të ndonjë kushti që e ndalon rreptësisht këtë gjë. Sipas nenit 449, “Fondacionet i nënshtrohen mbikqyrjes së organeve publike (shtetit, komunës) dhe lidhen mes tyre falë qëllimit të përbashkët. Autoriteti administrativ merr masat e nevojshme me qëllim që pasuritë e fondacionit të përdoren sipas qëllimeve të përcaktuara paraprakisht. Së fundi, në nenin 452 thuhet: “Fondacioni zhbëhet “ipso jure”, me zhbërjen e qëllimit të tij. Shkrirja e fondacionit bëhet me vendim të gjykatës së shkallës së parë, kur

Ndërkohë që debati juridik dhe politik vazhdonte, reforma agrare përshpejtonte ritmin e vet. Kështu zëvendës myftiu i Lushnjës, me 1 nëntor 1945 i ankohej drejtorisë së komunitetit mysliman se kjo reformë po shtrihet edhe mbi tokat e vakëfit, duke dëmtuar në mënyrë të pariparueshme pasuritë<sup>199</sup>. Nisur nga parimi se *toka i përket atij që e punon*, u shpronësuan pa farë kompensimi tokat e bejlerëve, agallarëve dhe çifligjet iu dorëzuan shtetit<sup>200</sup>, ndërsa ç'u përkiste tjetër enteve fetare: godina të kultit, vegla pune, etj., iu dhanë falas atyre që i kishin marrë në përdorim. Fshatarëve pa tokë dhe atyre me pak tokë iu dhanë nga 5 hektarë për çdo kryefamiljar dhe nga 2 hektar për çdo bërthamë familjare. Pronarëve që e punonin tokën me metoda moderne iu lanë në përdorim deri në 40 hektarë tokë, enteve fetare deri në 20 hektarë, ndërsa pronarëve që nuk merreshin me bujqësi iu lejuan deri në 7 hektarë, me kusht që brenda 2 vjetësh ta administronin dhe punonin vetë atë. Ndalohej shitja e tokës, blerja dhe lënia në trashëgimi e saj<sup>201</sup>.

Në total, u shpronësuan 4717 pronarë latifondesh të mëdha feudale, 480 pasuri të mëdha institucionesh fetare dhe 4000 pronarë të mesëm. Reforma shpërndau 288.400 hektarë tokë, 90% e së cilës iu dha 21 544 familjeve pa tokë dhe 48.667 familjeve që kishin vetëm pak prej saj<sup>202</sup>. Pas këmbënguljes dhe presionit të vazhdueshëm të të gjitha komuniteteve fetare, me vendim nr. 175, datë 26 nëntor 1945 u miratua një ndryshim në ligjin agrar. Sipas

---

qëllimi i fondacionit vlerësohet si i paligjshëm, apo kur bie ndesh me zakonet e mira. Sipas nenit 453, "Shkrirja e fondacionit mund të kërkohet nga prokurori apo nga çdo person tjetër i interesuar"

<sup>199</sup> Bie fjala, xhamia e Këmishajt (Lushnjë), zotëronte 96 ara, pra më pak se dhjetë hektarë tokë, prandaj nuk mund t'i nënshtrohej reformës. Në fakt, komisioni i reformës, edhe pse në kundërshtim me ligjin, vendosi t'i linte xhamisë vetëm 70 ara, edhe këto larg godinës së kultit, për t'ia shpërndarë pjesën tjetër të tokave, fshatarëve.

<sup>200</sup> Bejleri ishte një pronar tokash, që vishej me cilësi të tilla, falë sistemit të organizimit të klasave shoqërore të tipit feudal. Agallarët ishin pronarë tokash, më pak të pasur se bejlerët. Tokat që zotëronin si bejlerët dhe agallarët, emëroheshin çiflig.

<sup>201</sup> AA. VV., *Historia e Shqipërisë*, IV, Tiranë, 1983, 39.

<sup>202</sup> Lidhur me këtë, shih: F. QYTYKU *Reforma agrare, revolucion i parë ekonomik*. Dokumenti gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë, i pabotuar, por i risjellë në AA. VV., *Historia e Shqipërisë...vep.cit.*, 67.

nenit 1, me termin ent fetar të përdorur në paragrafin 2, duheshin kuptuar teqetë, manastiret dhe komunitetet fetare të çdo prefekturë. Përrjashtoheshin nga shpronësimi i detyrueshëm sipërfaqe, deri në 5 hektarë në pronësi të çdo kishe, xhamie apo tyrbeje, të vlerësuara si jetike për këto vende lutjesh<sup>203</sup>. Sipas këtij ndryshimi, të gjitha vendet e lutjeve (kisha, xhamia, ndërtesa të shenjtja, shenjtore), gëzonin të drejtën e mos-shpronësimit deri në 5 hektarë, ndërsa institucionet fetare, si manastiret apo kuvendet që zotëronin pasuri dhe i administronin ato drejtpërsëdrejti apo me ndihmën e të tretëve, kishin të drejtë të mbanin deri në 20 hektarë tokë. E njëjta rregull vlente për administratat fetare në nivel nënprefekturash<sup>204</sup>. Sqarimet me karakter juridik, që u kërkoheshin vazhdimisht organeve qeveritare nga komunitetet fetare, nuk sollën asnjë ndryshim në politikat e zbatimit të reformës agrare. Dhënia e këtyre detajeve synonte të mbante nën kontroll konfliktet e mundshme shoqërore. Ndërkohë, Ministria e Bujqësisë, nëpërmjet qarkoreve njoftonte prefekturat që, në mungesë së tokave të shpronësuara, të vihej dorë edhe mbi pasuritë e institucioneve fetare. Për parandalimin e konflikteve dhe paqtimin e kundërshtive, entet fetare panë mundësinë e ngritjes së një komisioni dypalësh, të përbërë nga 5 anëtarë ku tre prej tyre të ishin nëpunës të shtetit dhe dy të tjerët përfaqësues të klerit<sup>205</sup>.

Në shumë raste, komisionet e fshatarëve të varfër e dhunuan haptazi ligjin duke shpronësuar edhe ato 5 hektarë, me pretekstin se toka nuk po punohej personalisht nga xhamia apo kisha që e kishte në pronësi. Kështu, institucionet fetare humbën edhe tokat e dhëna me qera fshatarëve pa tokë, të cilët, të nesërmen e

---

<sup>203</sup> *Vendim nr. 175 datë 26 nëntor 1945*, "Gazeta Zyrtare", nr. 81, 19 dhjetor 1945, 3.

<sup>204</sup> I. FISHTA – V, TOÇI, *Economia e Shqipërisë në vitet e para të ndërtimit socialist nëntor 1944 – nëntor 1948*, Tiranë, 1984, 218 – 219.

<sup>205</sup> Gjatë zbatimit të reformës në zonat e Shkodrës dhe të Gjirokastrës, pasuritë fetare u prekën pjesërisht, ndërsa në zonat e tjera ato u përgjysmuan. Vakëfit të Durrësit, nga 86 ara i mbetën vetëm 50 të tilla dhe nga 217 pemë ullinj, nuk i mbeti asgjë. Vakëfit të Korçës iu shpronësua gjysma e tokës. Në fshatrat e Bërzhitës dhe Mulletit çifligjet iu dhanë përgjysmë të tretëve, edhe pse toka ishte pasuri e ligjshme vakëfi AQSH., Fondi. nr. 224, viti 1946, dos. 33, 14.

reformës agrare, e panë veten pronarë tokash. Kjo reformë rrënjësore i shpronësoi pronarët e ligjshëm pa farë kompensimi<sup>206</sup>.

Me zbatimin e reformës agrare, pasuritë e patundshme të vakëfeve u pakësuan ndjeshëm. Jo vetëm tokat, vreshtat, ullinjët, por edhe numri i bagëtive u pakësua keqas dhe institucionet fetare mbetën me pak pasuri të paluajtshme. Në qytete të ndryshme, reforma agrare kishte shpronësuar gjithsej 150 xhami, që më parë zotëronin nga 4 – 220 ara<sup>207</sup>. Për të dhënë një ide mbi pakësimin e të ardhurave të komunitetit mysliman, mjafton të llogarisim që të ardhurat për trevjeçarin 1947-1949 nuk i tejkalonin 1.300.000 lekë. Në të njëjtën periudhë, komuniteti mori gjithsej 95.000 lekë nga aktivitetet e tjera, ndërsa subvencionin nga shteti për vitin 1947 qe 3 347 000 lekë dhe për vitin 1949 vetëm 1 920 000 lekë. Kjo dëshmon që komuniteti ishte gjithnjë e më i varur nga financimi shtetëror, që, për më tepër, po pakësohej në mënyrë të ndjeshme<sup>208</sup>; subvencionet shtetërore përbënin 60% të shumës. Këto të dhëna dëshmojnë se shteti kishte goditur bazën ekonomike të komunitetit mysliman, duke i vënë nën kontroll mjetet e tij financiare dhe duke i privuar pavarësinë ekonomike.

Mbijetesa e komuniteteve fetare kushtëzohej nga ndihma e shtetit. Me kalimin e kohës, humbja e pavarësisë ekonomike i rrokullisi komunitetet fetare drejt falimentimit ekonomik, çka rezultoi një prej mjeteve më të efektshme për rrënimin e tyre dhe për përmbushjen e strategjisë afatgjatë që synonte çrrënjësien e fesë në Shqipëri. Fondet shtetërore mbulonin pagat e administratës, ndihmën shoqërore dhe vetëm pak mbetej për subvencionimin e enteve fetare, të cilat nuk mund të kryenin më asnjë funksion shoqëror si, p.sh., t'u jepnin ndihma besimtarëve apo të

---

<sup>206</sup> Shpronësimi pa kompensim përbën një pikë të nxehtë edhe sot e kësaj dite për bazën juridike të kthimit dhe kompensimit të të mirave të konfiskuara dhe është temë e një legjislacioni të mbingarkuar për kesi çështjesh, krahas ngritjes së një organizmi të posaçëm për t'u dhënë zgjidhje këtyre mosmarrëveshjeve. Ligjet e ndryshme lidhur me këto çështje, janë publikuar në sitin [Licodu.cois.it/albania/beni\\_ecclesiastici](http://Licodu.cois.it/albania/beni_ecclesiastici). Sidoqoftë nga materiali propagandues i institutit të Partisë së Punës së Shqipërisë del se xhamitë, manastiret, vakëfet dhe teqet zotëronin 4.224 hektarë tokë, rreth 70.000 pemë ullinj, shumë tufa bagëtish, pyje, kullota dhe një sërë godinash F. QYTYKU, *Reforma agrare, cit.*, 58.

<sup>207</sup> AQSH, Fondi nr. 14/AP, viti 1949, dos. 520, 41.

<sup>208</sup> AQSH., Fondi. nr. 882, viti 1948, dos. 1/b, 31.

mbështesnin aktivitetet fetare, gjë që çoi në largimin gjithnjë e më shumë të besimtarëve nga organizatat e kultit.

Edhe më interesante paraqitet gjendja e të ardhurave të komunitetit bektashian gjatë viteve 1948-1949<sup>209</sup>. Bëhet fjalë për të njëjtën gjendje, që pamë tek komuniteti mysliman. Sidoqoftë, për të pasur një panoramë më të qartë, duhet të mbajmë parasysh që pasuria e komunitetit përbëhej, sipas parashikimit të statutit, nga pasuria e teqeve të veçanta dhe atyre të përgjithshme. Kështu gjendja e arkës në vitin 1948 arrinte shumën 533 710 lekë, shumë që në vitin 1949 zbriste në 506 589 lekë. Në vitin 1948 komuniteti kishte mbledhur 27 121 lekë nga aktivitete të ndryshme dhe gjatë vitit të ardhshëm shuma kishte kapur vlerën 39 000 lekë. Për t'i bërë ballë kësaj gjendjeje, subvencionet e shtetit ishin rritur nga 400 000 lekë në vitin 1948 në 951 000 lekë në vitin 1949. Kjo dëshmon se si komuniteti Bektashian varej tërësisht prej shtetit dhe shtimi i kontributit, edhe pse në një masë modeste, dëshmon për një farë krahëmbajtjeje ndaj këtij komuniteti, duke qenë se kontributi shtetëror i derdhur për komunitetet e tjera sa vinte e pakësohej. Pavarësisht kësaj, në fund të viteve '40 shteti goditi përfundimisht pavarësinë ekonomike të këtij komuniteti, ashtu si edhe të komuniteteve të tjera. Kështu, Kisha ortodokse, për shembull, ndodhej në një gjendje aq të pashpresë, sa t'i kërkonte shtetit të mbulonte shpenzimet për pritjen e një delegacioni të Kishës ortodokse të Bashkimit Sovjetik, në Shqipëri<sup>210</sup>. Pasuria e saj ishte strukturuar ndryshe nga ajo e komunitetit mysliman dhe përbëhej nga pasuritë e kishave dhe manastireve. Numri i vogël i anëtarëve të saj kushtëzonte pasurinë e pakët qysh më përpara, prandaj shteti nuk e pati të vështirë ta vinte, njëherësh, nën nevojën e plotë të kontributit që derdhte për të.

Krejt ndryshe paraqitej gjendja e Kishës katolike, e cila, duke qenë se nuk e kishte pranuar legjislacionin e Mbretit Zog, i kishte lënë entet e veta pa personalitet juridik civil, me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë. Ajo ua kishte besuar personave të tretë zotërimin e

---

<sup>209</sup> AQSH., Fondi. nr. 882, viti 1948, dos. 1, 10/1.

<sup>210</sup> Në letrën drejtuar Ministrisë së Financave, kisha ortodokse e Shqipërisë ankohej për pamjaftueshmërinë e të ardhurave të saj për të pritur delegacionin. Lidhur me këtë, shih: A. DALIPAJ, *Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me kishën ortodokse...cit., 42 ss.*

të mirave në emër dhe për llogari të kishës, ndërkohë që nevoja të shumta i përballonte me ndihmën e financimeve nga jashtë. Shteti e pati të lehtë të zbatonte mbi individët, pronarë të të mirave të enteve kishtarë, masat shtrënguese për çështjet e pronës dhe të konfiskonte pasuritë, si masë shoqëruese krahas arrestimeve, dënimeve dhe ekzekutimeve të klerikëve dhe rregulltarëve, të akuzuar për kërcënim të sigurisë së shtetit dhe për veprimtari kundërrevolucionare<sup>211</sup>.

Një fushë tjetër ku pati përplasje mes shtetit dhe komuniteteve fetare, qe ajo e arsimit. Në fillim të vitit 1945, qeveria miratoi një qarkore lidhur me mësimdhënien e fesë në shkollat fetare. U fut një orë mësimi feje në javë, jo e detyrueshme; programi duhej miratuar nga Ministria e Arsimit dhe nga komunitetet e ndryshme<sup>212</sup>; njëkohësisht u shtua numri i shkollave publike, pa cënuar ato private<sup>213</sup>. Me 17 mars 1945, qeveria shqiptare me anë të një qarkoreje njoftonte që mësimet e fesë do të zhvilloheshin në shkollat publike, duke lënë në dispozicion për këtë lëndë vetëm disa orë mësimi në muaj<sup>214</sup>.

Kjo gjendje vazhdoi, afërsisht, një vit, deri në muajt e parë të 1946-ës, kur qëndrimi ndaj komuniteteve fetare ndryshoi, çka u reflektua edhe në shkollë, pasi, me 13 mars 1946, Ministria e Arsimit urdhëroi nëpërmjet një qarkoreje të gjitha zyrat e saj të ndalonin mësimin e fesë në shkollat publike<sup>215</sup>.

---

<sup>211</sup> Çështja e persekutimeve në kurriz të kishës katolike, është mbresëlënëse. Për më gjerë, shih Z. SIMONI, *Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri 1944 - 1990* Shkodër, 1998, 168. A. SHAHU, *Shteti komunist dhe kisha katolike në Shqipëri (1945 - 1967)*, *Simposio internazionale ...cit.*, 202; S. PEPA, *Martirizimi i kishës katolike*, Shkodër, 1993; J. BORDINI, *Dhjetë vjet në burg në Shqipëri 1945 - 1955*, Tiranë, 1992, 30; R. BEQAJ, *Veprimtaria armiqësore e klerit katolik në Shqipëri 1945 - 1967*, Tiranë, 1973, 101.

<sup>212</sup> Si tekst përdoret libri *Edukimi fetar dhe moral i njeriut të vitit*, Tiranë 1942. Këtu sillen ide dhe mësimet të Ferid Vokopolës, studiues i shquar mysliman, i hapur ndaj pluralizmit fetar, autor i Himnit të kongresit të Lushnjës, një prej këngëve më të njohura të kulturës shqiptare.

<sup>213</sup> AQSH., Fondi. nr. 890, viti 1945, dos. 9, 7.

<sup>214</sup> AQSH., Fondi. nr. 890, viti 1945, dos. 9, 10.

<sup>215</sup> *Qarkorja e Ministrisë së Arsimit*, dos. 438, IX, maj 1945, AQSH., Fondi. nr. 882, fq. 63. Në disa zona, kjo nismë po zbatohet që para botimit të qarkores përkatëse. Për shembull, në Kukës, mësimi fetar ishte ndërprerë që dhjetë ditë para botimit të saj.

Me ligjin 281 të datës 17 gusht 1946 iu hap rrugë reformës mbi arsimin. Në nenin 1 thuhej: “Qysh me fillimin e vitit shkollor 1946-1947 shteti do të ofrojë arsimin fillor të detyrueshëm për meshkuj dhe femra nga moshë 7 vjeç. Në vjeshtë të këtij viti filloi shkolla fillore për të gjithë të miturit e moshës 8, 9, 10 vjeç që nuk kanë shkuar kurrë në shkollë. Arsimi fillor është i detyrueshëm deri në kryerjen e shkollës fillore. Arsimi fillor është falas për të gjithë dhe zhvillohet në shkollat fillore të ngritura nga shteti”<sup>216</sup>.

Laicizimi i procesit të mësimdhënies dhe ndarja e shkollës nga feja ishin dy elemente themelore të kësaj reforme, të vlerësuara si thelbësore për zhvillimin e vendit. Në ligj projektohej një sistem shkollor koherent me linjat kryesore të qeverisë. Në nëntor të vitit 1946, Ministria e Arsimit miratoi një dispozitë mbi mësimdhënien e fesë, ku ritheksohej se edukimi i gjeneratës së re i përkiste ekskluzivisht vetëm shtetit, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së miratuar me 11 mars 1946, ku në nenin 58 thuhej: “Shkolla është e ndarë prej fesë”<sup>217</sup>. Kjo dispozitë shënoi fillimin e rrënimit të seminareve dhe të shkollave të Kishës katolike dhe të besimeve të tjera, në favor të shkollës publike, e cila aspironte ‘për parimet demokratike të luftës çlirimtare dhe vepronte në harmoni të plotë me shkencën’<sup>218</sup>. Që këtu, filloi hapja e shkollave shtetërore për të gjitha nivelet, në të gjithë vendin, ndërkohë që shkollat fetare nuk mund të ekzistonin pa një leje të veçantë<sup>219</sup>. Ky ligj përcaktoi nivelet e ardhshme të shkollës: fillore dhe shtatëvjeçare, së bashku në një hark kohor prej 7 vjetësh, më pas niveli i mesëm për katër vjet. Më tej, shkollat u ndanë në të përgjithshme dhe profesionale, por nuk mungonte as arsimi parashkollor, me çerdhe e kopshte, në mënyrë që grave t’u krijohet mundësia të dilnin në punë<sup>220</sup>.

Këto masa synonin përjashtimin e plotë të shkollave fetare, por komunitetet fetare bënë përpjekje për hapjen e shkollave të tyre,

---

<sup>216</sup> *Reforma arsimore* Ligji 281, datë 17 gusht 1946, “Gazeta Zyrtare”, nr. 85, 10 shtator.1946, 11.

<sup>217</sup> *Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë*, mars 1946. Sot në: <http://licodu.cois.it/574/view>.

<sup>218</sup> H. HAKO, *Feja e parë në dritën e shkencës*, Tiranë, 1962, 5

<sup>219</sup> Të shihet edhe Gazeta Zyrtare, nr. 717, 10 shtator 1946, 1.

<sup>220</sup> Gazeta Zyrtare, nr. 85, 10 shtator 1946, 12 - 13.



ku jepeshin mësimë feje si dhe shkolla për formimin dhe mësimin fetar për klerikët<sup>221</sup>.

Për t'iu shmangur ndalimit të mësimin të fesë në shkollat publike, leksionet mbaheshin në ambiente private, por kjo nuk do të zgjaste për shumë kohë. Në dhjetor të vitit 1946 Ministria e Arsimit bëri me dije se nismat për hapjen e shkollave fetare binin ndesh me ligjet e shtetit<sup>222</sup>.

Për të kuptuar më mirë rëndësinë e këtyre masave, duhet të mbajmë parasysh që, për shembull, aktiviteti i Kishës katolike ishte i përqendruar në fushën e edukimit. Mes tyre kryesonin për cilësi dhe rëndësi seminari papnor i Shkodrës, grupi salezian me themelues Don Bosco-n, të cilët i përkushtoheshin edhe formimit të mësuesve katolikë. Në sektorin femëror, vepronte Instituti i Motrave Stigmatine, Motrat e Shërbëtorëve, Motrat Vinçenciane, të cilat kishin krijuar një rrjet të gjerë institutesh në të gjithë territorin e vendit. Në këto shkolla, përveç priftërinjve vendas, jepnin mësim edhe klerikë të huaj. Përjashtimi i këtyre të fundit dëmtoi rëndë mbarëvajtjen e këtyre shkollave. Shteti shtoi masat për tkurrjen në maksimum të mësimin katolik, deri në mbylljen e të gjitha institucioneve shkollore të çdo urdhëri dhe niveli të mbajtura dhe drejtuara nga klerikët katolikë. Në vazhden e zbatimit të këtij vendimi, u mbyllën edhe urdhri françeskan dhe ai

---

<sup>221</sup> Sapo u mor vesh që në Elbasan po vazhdonte punën një shkollë fetare, prokuroria e detyroi komunitetin e këtij qytetit të bënte autokritikë dhe të premtonte që do ta kryente aktivitetin e saj nën kontrollin e qeverisë. *Qarkorja e Ministrisë së Arsimit*, dos. 35, IX, maj 1945, 20-22. Medreseja kryesore ishte ajo e Tiranës, e cila u hap me 15 maj 1945. Aty nga fundi i këtij viti, e ardhmja e mësimin të fesë në shkollat publike shihej e errët. Myftinija e madhe e Shkodrës ankohej për mbylljen e medresesë. Komuniteti mysliman vendosi ta vazhdonte mësimin fetar pranë xhamive. Në pamje të parë, gjithçka dukej normale, por mësimdhënia e fesë u përball me shumë vështirësi, në shumë fshatra, pushteti vendor nuk jepte leje dhe, përveç kësaj, kishte mungesë mësuesish. Ministria e Arsimit, e shtyrë nga ankesat e shumta, ndërhyri për t'i dhënë zgjidhje problemit, duke i detyruar organet vendore të lejonin mësimin e fesë. Arsimiti i mesëm zhvillohej pranë medreseve. Në shkollat publike bëhej propagandë komuniste si nga mësuesit ashtu dhe drejtorët e shkollave. AQSH., Fondi nr. 882, viti 1946, dos. 31, 32.;

<sup>222</sup> Gazeta Zyrtare., nr. 62, viti 1947, 21.

jezuit dhe u konfiskuan pronat e tyre të luajshme dhe të paluajshme<sup>223</sup>.

Në vitin 1947, me një qarkore të Ministrisë së Arsimit, u ndalua mësimi i fesë në shkolla publike, për t'ua lënë vendin mësimëve ateiste dhe leksioneve mbi marksizëm-leninizmin<sup>224</sup>. Tashmë edukimi fetar ishte kthyer në oborret e kishave dhe xhamive. Pas mbylljes së medresesë së Tiranës<sup>225</sup>, drejtorja e komunitetit mysliman urdhëroi mbledhjen dhe sistemimin e literaturës fetare në bibliotekat fetare. U krijua po ashtu një komision për botimin e ardhshëm të librave fetarë<sup>226</sup>. Në të njëjtin vit, sulmi ndaj mësimëve fetare u rrit pa masë. Rregullat e reja të shtetit për

---

<sup>223</sup> AQSH., Fondi nr. 890, viti 1945, dos. 1, 19. Vendimi iu transmetua edhe urdhërit të motrave Stigmatine, në të cilin thuhej shprehimisht: “Ju bëjmë me dije, që në përputhje me dispozitat e dhëna nga Ministria e Arsimit ndalohet funksionimi i çerdheve dhe kopshteve private, sido qofshin ato. AQSH., Fondi. nr. 131, viti 1945, dos. 10, 4.

<sup>224</sup> H. H AKO, *Feja e parë në dritën e shkencës, vep.cit.* 5, ss.

<sup>225</sup> Goditjen e fundit dhe thelbësore, mësimdhënia e fesë e mori nga mbyllja e medresesë së përgjithshme. Në korrik të vitit 1946, Ministria e Arsimit i kërkoi drejtorisë së shkollës ta vinte godinën e medresesë në dispozicion të shkollave publike, ndërsa ajo vetë duhej të zhvendosej tek hotel Colombo. Ministria e Arsimit nuk e mori në konsideratë përgjigjen negative të drejtorisë së shkollës dhe një muaj më vonë nënshkroi një ultimatum me anë të të cilit deklaronte që shkolla do të dorëzohej brenda muajit shtator. Drejtorja mbajti qëndrim negativ, ndaj Ministria e Arsimit i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë të shqyrtonte dhe miratonte, para fillimit të vitit shkollor, programet dhe rregulloret e medresesë. Në fillim të fitit 1947, konflikti u zgjidh pas miratimit të programeve që u përgjysmuan. Orët e lëndëve fetare u zëvendësuan me lëndë të kulturës së përgjithshme. Kurani dhe feja u reduktuan në gjashtë orë, katër orë iu dhanë gjuhës shqipe, tri orë matematikës dhe po tri orë historisë dhe gjeografisë. Ndërtesa e medresesë u nda në dy pjesë, me kushtin që komuniteti t'i kishte filluar punët për ndërtimin e një godine të re për medresenë. Marrëveshja nuk zgjati shumë. Me pretekstin se komuniteti mysliman nuk po e lëshonte godinën, Ministria e Drejtësisë ndërhyri me forcë dhe urdhëroi evakuimin e saj brenda dy ditëve; ndërkohë që në Shkodër, Ministria urdhëroi të konfiskohen të gjitha materialet didaktike të medresesë së këtij qyteti. Me 17 dhjetor 1947, drejtorja e komunitetit mysliman vendosi mbylljen e kursit të parë, ndërsa medreseja u detyrua të hartonte një rregullore të re dhe ta zvogëlonte me dy herë numrin e studentëve. Në vitin 1949, drejtori i drejtorisë së komunitetit pati një takim me udhëheqësin Enver Hoxha, i cili i premtoi që medreseja do të mbetej pasuri e komunitetit mysliman, duke zhvilluar njëkohësisht funksionin e shkollës publike dhe asaj fetare.

<sup>226</sup> AQSH., Fondi. nr. 882, viti 1945, dos. 63, 60.

çështjet shkollore nuk përputheshin me mësimet fetare. Qeveria bënte thirrje për vigjilencë: në rast se merrej vesh që klerikët u kishin dhënë mësim fëmijëve, duheshin marrë masa disiplinore ndaj tyre. Qarkoret e qeverisë, drejtuar organeve vendore, tërhiqnin vëmendjen për përgjegjësinë e atyre që jepnin mësim feje, duke ushtruar presion të vazhdueshëm mbi klerin katolik dhe mbi të gjitha besimet, në mënyrë që të hiqnin dorë nga çdo lloj mësimdhënieje<sup>227</sup>. Kësisoj u ndalua mësimi dhe përgatitja e klerikëve të ardhshëm. Njëkohësisht me këto masa, u detyrua të mbyllej edhe shtypi fetar<sup>228</sup>. Madje po censuroheshin edhe letrat pastorale, të cilat, para se të botoheshin, duhej të merrnin miratimin e autoriteteve kompetente të qeverisë shqiptare. Si në të gjitha vendet ku partia komuniste kishte ardhur në pushtet, shumë ndërtesa kulturi ndryshuan destinacion duke u kthyer në muze, biblioteka, kinema, punishte, apo në ambiente për aktivitete ekonomike si dhe për interesa të ndryshme publike. Ndërkohë që transformimi i shtetit po kryhej shkallë-shkallë, hapësira për komunitetet fetare sa vinte e ngushtohej dhe kontrolli mbi to shtohej dita-ditës edhe nëpërmjet anëtarëve laikë të përfshirë në organizmat drejtuese të komuniteteve fetare, të cilët ushtronin presion të fortë lidhur me nevojën e mbështetjes së buxhetit të shtetit për shkak të angazhimeve të tij sociale. Falë këtij presioni të brendshëm dhe të jashtëm, shteti luajti taktikisht mirë që të krijonte kushtet për homologimin e statuteve të komuniteteve sipas një skeme të përgjithshme të projektuar prej tij.

---

<sup>227</sup> AQSH., Fondi. nr. 890, viti 1946, dos. 16, 3 - 4.

<sup>228</sup> Gazetat, revistat fetare dhe kulturore katolike, deri në vitin 1944 pushuan së ekzistuari. Béhet fjalë për gazeta dhe revista mjaft të njohura si: "Hylli i dritës", "Zani i Shna Ndout", "Bijat e Zojës. Kisha katolike nuk kishte të drejtë të të botonte asnjë organ të propagandës fetare, me përjashtim të botimeve që njoftonin mbi festat kalendarike. Për rrjedhojë, pushoi edhe veprimtaria e shtëpive botuese. Z. SIMONI, *vep. cit.*, 375.

## 2. 3. Ligji i ri për komunitetet fetare. Statuti i komunitetit Mysliman

Nisur nga ndryshimi i pozicionit ndërkombëtar të Shqipërisë dhe forcimit të marrëdhënieve të saj me Bashkimin Sovjetik, partia në pushtet gjykoj se mund t'ia dalë mbanë edhe pa 'veshjen' e Frontit Demokratik dhe t'i shpallë popullit dëshirën për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Në kuadër të kësaj politike, me 26 nëntor 1949, u miratua një ligj i ri mbi komunitetet fetare<sup>229</sup>. Në pamje të parë, duket sikur komunitetet fetare fitojnë më shumë të drejta lidhur me misionin e tyre për edukimin shpirtëror të popullit, por në të vërtetë, ligji i ri synon të krijojë kushtet për të ndërhyrë në organizimin e brendshëm të tyre, për modifikimin e rolit të tyre shoqëror<sup>230</sup>. Për t'ia arritur këtij qëllimi, duhej shfuqizuar medoemos legjislacioni i Zogut, që, edhe pse kishte disa detyrime juridiksionale, prapëseprapë, u krijonte mundësi organizimi të pavarur komuniteteve duke i lejuar ato të krijonin një rrjet lidhjesh të forta dhe të afta për të mbajtur kohezionin shoqëror. Tashmë, pas shkatërrimit të aktiviteteve në sistemin e tyre shkollor dhe edukativ, pas modifikimit të strukturës së tyre ekonomike si pasojë e konfiskimit të pasurive të tyre, komunitetet fetare vareshin thujtë tërësisht nga financimi shtetëror. Gjatë kësaj kohe, kur vendi kishte marrë rrugën e integritit drejt demokracisë socialiste, duhej dhe duhej e mundshme të përshtatej trajtimi i komuniteteve fetare në Shqipëri me mënyrën e trajtimit të tyre në vende të tjera aleate. Me gjendjen e re të krijuar, shteti nuk mund të lejonte që komunitet fetare të krijonin rrethet e tyre në gjirin e shoqërisë, aq më tepër në rastin e Kishës katolike, e cila shihej si një kundërshtarë e fortë e shoqërisë socialiste. Prandaj si masë paraprake, qeveria vendosi të ndërpriste marrëdhëniet politike të klerit katolik shqiptar me pjesën tjetër të botës<sup>231</sup>.

Kështu, shteti kërkonte të shtonte kontrollin mbi të gjitha komunitetet fetare. Pavarësia e tyre përbënte shqetësim serioz për

---

<sup>229</sup> *Mbi Komunitetet Fetare*, Dekret nr. 743, 26.11.1949, <http://licodu.cois.it/618/vieë>, aprovuar me ligjin nr. 773, "*Mbi komunitetet fetare*", 16.1.1950.

<sup>230</sup> E. HOXHA, *Vepra*, "Naim Frashëri" Tiranë, 1971, 159.

<sup>231</sup> AQSH, Fondi. nr. 890, 1946, dos. 459 *cit.*, 4.

kryesinë e partisë komuniste, prandaj, që me 26 dhjetor 1949, u miratua dekret-ligji për “Komunitetet fetare në Shqipëri”, i cili hapet me disa pohime në dukje pozitive: kërkohet të ketë garanci kushtetuese për lirinë fetare, parashikon sanksione kundrejt gjithë atyre që cenojnë ushtrimin e lirë të fesë apo nxisin urrejtjen fetare<sup>232</sup>. Por dispozita më e rëndësishme e këtij ligji parashikon që çdo komunitet fetar duhet të rishikojë statutin e vet për ta përshtatur me 37 nenet e dekretit e më pas t’ia paraqesë atë për miratim Këshillit të Ministrave. Në këtë mënyrë sheshohen veçoritë e kulteve të ndryshme dhe çështja e fesë trajtohet si një gjë me të cilën qeveria dhe vetë shoqëria duhet të përballen, pa e ulur vigjilencën ndaj saj (art. 6-7).

Dekreti parashikon ta thjeshtojë përbërjen e organizatave fetare, prandaj në nenin 8, pasi thekson organizimin e pavarur të komunitetit Bektashian, kërkon me detyrim bashkimin e vëllazërive të ndryshme myslimane në një prej dy komuniteteve islame. Sipas statutit të ri, zgjedhja e drejtuesve të komunitetit fetar, të rregullores së tij, buxhetit, botimeve, të vulave dhe shenjave të tjera simbolike duhet të kenë miratimin e Këshillit të Ministrave. Kështu forcohet kontrolli i shtetit mbi veprimtarinë dhe synimet e institucioneve fetare, të cilët ndërkohë duhet të rrisin besnikërinë ndaj popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të përpiqen të ruajnë unitetin kombëtar<sup>233</sup>. Duke e krahasuar këtë dekret me atë të kohës së Zogut, mund të thuhet se ai mbart ndryshime rrënjësore në *statusin* juridik të komuniteteve fetare, pasi u kufizon ndjeshëm lirinë e veprimit dhe ndërhyh në punët e tyre të brendshme.

Në nenin 1 të ligjit, përcaktohen prerazi standardet e lirisë fetare dhe të ndërgjegjes duke u mbështetur në ndarjen e plotë mes shtetit dhe komuniteteve fetare. Respekti për të drejtat civile të njeriut dhe për të gjitha detyrimet e parashikuara nga ligji, kërkohet njëlloj për të gjithë qytetarët, qofshin këta besimtarë apo

---

<sup>232</sup> Tre nenet e para të këtij ligji i referohen nenit 16 të kushtetutës dhe janë në funksion të zbatimit të tij. Në nenin 13 ndalohet çdo lloj konflikti dhe diskriminimi për arsye fetare dhe çdo lloj përplasjeje mes besimeve të ndryshme. Për më tepër, shih: D. SADIKAJ, *Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist*, Tiranë, 1972, 480 ss.

<sup>233</sup> *Ibidem*

jo (neni. 5). Kërkohej, gjithashtu, krijimi i një fashikulli biografik personal për personelin fetar të të gjitha rangjeve, i cili do të depozitohet pranë Ministrisë së Brendshme, për t'i vënë nën kontroll të rreptë të gjitha hallkat fetare<sup>234</sup>. Personeli fetar mund ta ushtrojë punën e vet vetëm me miratimin e qeverisë dhe (sipas nenit13), duhet të ketë reputacion të mirë, të dëshmojë besnikëri dhe ndershmëri kundrejt popullit, shtetit dhe të gëzojë të gjitha të drejtat civile. Për këtë arsye, komunitetet fetare duhet të hartojnë listat e plota të personelit fetar dhe administrativ, dhe t'ia dorëzojnë qeverisë për miratim. Nuk lejohet marrja e personelit me shtetësi të huaj për kryerjen e funksioneve fetare, masë kjo që godet veçanërisht Kishën katolike, e cila pas persekutimeve të vazhdueshme dhe dëbimeve të mëparshme, ka mungesë të ndjeshme të klerit vendas për përmbushjen e detyrimeve fetare kundrejt besimtarëve dhe për kryerjen e aktiviteteve të institucioneve të mbijetuara<sup>235</sup>. Neni 16 i dekretit i lejon qeverisë kontroll ekonomik mbi komunitetet fetare nëpërmjet miratimit të preventivit të bilancit të tyre. Me pak fjalë, komuniteteve u njihet e drejta të përfitojnë nga të mirat e tyre, por duke qenë se për çdo punë kërkohej autorizimi përkatës, mundësia e kryerjes së tyre nuk ka siguri e, për më tepër, komunitetet varen financiarisht nga bujaria e shtetit..

Njohja e efektit juridik për martesat, vlerësimi i saj si moment thelbësor i jetës së beqarëve, ua heq komuniteteve fetare mundësinë e celebrimit të martesave, të njohura dhe jetuara si dukuri të kohezionit dhe identitetit shoqëror, si një moment ku komuniteti mblidhet, gjinden me njëri-tjetrin duke pasuar kështu nga njëri brez në tjetrin. E gjithë veprimtaria e komuniteteve fetare duhet të synojë “zhvillimin e ndjenjës së besnikërisë ndaj pushtetit popullor dhe Republikës” (neni 12), ndërsa aktivitetet e tyre të bamirësisë, edukimit dhe arsimit i merr përsipër vetë shteti. Çelja e shkollave të reja fetare varet nga autorizimi i

---

<sup>234</sup> AQSH., Fondi. nr. 890, dos. 561, 1949, 3.

<sup>235</sup> Varësia e Kishës katolike nga kongregata *Propaganda Fide*, që përbën një tipar të veçantë të organizimit kishtar në Shqipëri, u kthye në disfavor të komunitetit, për shkak të dyshimeve që ushqente qeveria duke e parë klerin katolik dhe të gjithë organizatën kishtarë të varur nga interesat e fuqive të huaja, të cilat binin ndesh me ato të qeverisë legjitime, shtu këtu edhe pozicionin ndërkombëtar të Selisë së Shenjtë në lidhje me bllokun perëndimor.

qeverisë dhe paraprkasht kërkohet hartimi i rregullores për mënyrën e organizimit të saj dhe programet e institucioneve shkollore, në mënyrë që të fitojnë lejen për të vepruar<sup>236</sup>.

Neni 24 i ligjit, u ndalon komuniteteve fetare hapjen e spitaleve, jetimoreve apo institucioneve të tjera ndihmëse, ndërkohë që pas hyrjes në fuqi të dekretit ligjit, do të shtetëzohen pa kompensim institucione të tilla ekzistuese dhe pasuritë e tyre të tundshme dhe të patundshme do të kalojnë nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Korrespondenca, qarkoret dhe e gjithë literatura fetare vihen nën kontrollin e shtetit, i cili mund të pezullojë botimin dhe shpërndarjen e tyre në rast se bien ndesh me rendin publik dhe zakonet e mira. Urdhrrat fetare dhe misionet me seli jashtë vendit nuk mund të krijojnë degë apo filiale të tyre në Republikën Popullore të Shqipërisë. Ato ekzistuese duhet që brenda një muaji të mbyllën dhe riorganizohen, duke ndërprerë çdo marrëdhënie me degët apo qendrat e tyre jashtë. Edhe kjo normë godet më së shumti komunitetin Katolik, i cili e kishte të pamundur të vepronte pa drejtimin e Selisë së Shenjtë<sup>237</sup>. Kështu, ripërcaktohet roli i Komitetit për çështjet fetare që duhet t'i paraprijë zbatimit të ligjit dhe të sigurojë lidhjet mes shtetit dhe komunitetit fetar; të përkujdeset për përmbushjen e akteve ligjore të parashikuara nga dekreti si dhe për përpilimin e statuteve të reja, gjithnjë në përputhje me linjën e partisë komuniste<sup>238</sup> (neni 32).

Në fillim të vitit të ri, u hartua një qarkore që qartësonte përmbajtjen e dekretit dhe jepte udhëzime për zbatimin e saj, duke theksuar që në një hark kohor prej tre muajsh komunitetet duhet të mbyllin procedurat për miratimin e statuteve të tyre të reja<sup>239</sup>.

---

<sup>236</sup> AQSH., Fondi. nr. 882, dos. 1, 1949, 7.

<sup>237</sup> *Ibidem*, 2.

<sup>238</sup> *Ibidem*, 4.

Propaganda komuniste i bëri reklamë të zhurmshme ligjit për komunitetet fetare, duke e vlerësuar atë si një ndër sukseset e politikës së PKSH-së në fushën fetare, pasi "i siguronte hapësira të reja lirisë fetare". Ligji mbyllej me thirrjen për të goditur me forcë armikun e brendshëm dhe të jashtëm, që duhej kërkuar tek ata klerikë që mbeteshin armiq të partisë dhe të qeverisë. Gazeta "Zëri i Popullit". 14 janar 1949, 4 (gazetë zyrtare e Partisë Komuniste të Shqipërisë).

<sup>239</sup> AQSH, Fondi. nr. 882, dos. 1, 1949, 7.

Qarkorja u shoqërua me një projekt, si tip statuti, të parashikuar nga qeveria për t'u përdorur si model. Kjo qarkore theksonte (sipas nenit 7 të dekretligjit) se komunitetet fetare, deri në miratimin e statuteve të reja, janë në gjendje paligjshmërie. Komunitetet fetare mund ta rifitojnë të drejtën për të qenë persona juridikë, duke respektuar ligjet e shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira me miratimin e statutit të ri. Në rast të kundërt, me propozimin e qeverisë, parlamenti mund ta rrëzojë dhënien e personalitetit juridik. Në vijim, u përcaktohen procedurat, zbatimi i të cilave përbënte kushtet e nevojshme për rinjohjen e komunitetit dhe sanksionet në rasti të moszbatimit të tyre. Humbja e personalitetit juridik ka për pasojë zhdukjen e komunitetit e për rrjedhojë humbjen e të gjitha të mirave. Qarkorja bën me dije se institutet fetare, në bazë të statuteve të tyre duhet të përpilojnë bilancin, duke treguar me shumë transparencë dhe saktësi rreth të ardhurave dhe shpenzimeve përkatëse; me përmbushjen e këtyre kushteve mund të sigurojnë miratimin nga Këshilli i Ministrave. Drejtuesit e komuniteteve fetare, funksionarët fetarë si dhe i gjithë personeli në shërbim të tyre, duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe t'i qëndrojnë besnikë popullit shqiptar. Të zgjedhurit si drejtues të komunitetit fetar duhet të kenë miratimin e Këshillit të Ministrave, ndërsa drejtuesit vendorë duhet të regjistrohen pranë këshillave popullorë në rrethe<sup>240</sup>. Qarkorja mbyllet me pohimin se dispozitat e parashikuara prej saj duhet të gjejnë mbështetje tek pushteti popullor dhe, për më tepër, kërkohet zbatimi rigoroz nga ana e komunitetit fetar<sup>241</sup>. Duke qenë se puna për hartimin e statuteve po ecte me ritme të ngadalta, qeveria miratoi një qarkore tjetër drejtuar ipeshkvive, zëvendës metropolitëve dhe ipeshkvive vendore të Shqipërisë, ku përmbaheshin këto pika:

- 1) Sa herë të lindë nevoja për t'u mbledhur, i duhet kërkuar leje paraprakisht komitetit ekzekutiv të zonës, 48 orë më përpara.
- 2) Mbledhja nuk mund të fillojë pa mbërritur përgjigjja e komitetit ekzekutiv të zonës.
- 3) Në lejen që i drejtohet komitetit, duhet të jepet informacion i plotë lidhur me kohën, vendin dhe pjesëmarrësit e mbledhjes.

---

<sup>240</sup> AQSH, Fondi. nr. 490, 1949, dos. 562, 8.

<sup>241</sup> AQSH, Fondi. nr. 890, dos. 2133, 1950, 8 - 9.



4) Duhet bërë me dije rendi i ditës së mbledhjes<sup>242</sup>.

Siç shihet, qarkorja e vinte komunitetin fetar nën kontrollin e komitetit ekzekutiv të shtrirë në zona të ndryshme të territorit, duke ia kufizuar ndjeshëm lirinë e veprimit.

E shohim të nevojshme të sjellim këtu një analizë të detajuar të statuteve të ndryshme, duke qenë se ata u parapërgatiten në bazë të një skeme të vetme, të diktuar nga qeveria. Ky rregull, krejtësisht unik, u kthye në skemë të përgjithshme për marrëveshjet e vitit 2009, e në njëfarë mënyre rishfaqet në statutet e pasviteve 1990. Ky është rasti i vetëm që Kisha katolike pranon të hartojë një statut të vetin. Komunitetet që tregohen më të zellshëm për përmbushjen e kërkesave të qeverisë janë ai Mysliman, Bektashi dhe Ortodoks, të cilët, me 4 maj 1950 paraqitën statutet e tyre, që u miratuan nga shteti<sup>243</sup>.

Statuti i komunitetit Mysliman shqiptar përbëhet nga parathënia dhe nga njëmbëdhjetë kapituj<sup>244</sup>. Në parathënie bëhet me dije se statuti u miratua nga Këshilli i Përgjithshëm i komunitetit Mysliman, duke u bazuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë, sipas së cilës të gjithë qytetarëve u njihej dhe garantohej liria e ndërgjegjes dhe e fesë. Për garantimin e punëve të fesë dhe të vakëfeve të komunitetit, Këshilli i Përgjithshëm miratoi dhe shpalli statutin që hapej me pohimin që komuniteti Mysliman përbëhet nga të gjithë qytetarët shqiptarë myslimanë që i përkasin çdo lloj vëllazërie. Detyra e këtij komuniteti ishte të mbante gjallë dhe të zhvillonte tek besimtarët

---

<sup>242</sup> AQSH, Fondi. nr. 536, 1949, dos. 244,

<sup>243</sup> Gazeta Zyrtare nr. 40, 4 maj 1950. Pas reduktimit në masë të hapësirave për komunitetet fetare, shteti ngriti organizatat e veta: organizatën e gruas, të rinisë, të sindikatave të punëtorëve. E. HOXHA, *Kur lindi Partia*, 8 nëntori, Tiranë 1981 72. Organizatat e masës të ngritura nga partia komuniste, kanë një shpërndarje të gjerë sidomos në fshatra dhe për herë të parë në historinë e vendit, vlerësohet roli i shtresave fshatare dhe i klasës punëtore, e cila është e përqendruar në disa zona të vendit, por kryesisht në qytet.

<sup>244</sup> Teksti i statutit u hartua nga një komision ekspertësh në fushë të teologjisë, në mënyrë që të shfrytëzoheshin hapësirat e mundshme që linte modeli i statutit të diktuar nga qeveria dhe i ratifikuar nga këshilli i përgjithshëm i komunitetit, pas mbledhjes së tij në një konferencë të jashtëzakonshme. Lidhur me përmbajtjen e tekstit, shih: Gazeta Zyrtare, nr. 40, 29 qershor 1950, 2 sot gjendet në: <http://licodu.cois.it/576/view>.

ndjenjën e fesë, të patriotizmit dhe të besnikërisë ndaj atdheut, Republikës Popullore, pushtetit popullor dhe vëllazërisë kombëtare. Organet drejtuese të komunitetit ishin po ato që parashikonte statuti i vjetër. Në nenet 4-5 jepej përkufizimi i komunitetit Mysliman si një person moral që gëzonte të gjitha të drejtat e një personi juridik. Gjuha e komunitetit mysliman ishte shqipja. Në vijim jepej mënyra e organizimit të këtij komuniteti<sup>245</sup>.

Në nenet 19-24 jepeshin detyrat dhe të drejtat e Drejtorit të përgjithshëm të vakëfeve, i cili zgjidhej nga Këshilli i Përgjithshëm dhe emërohej me dekret të kryetarit të komunitetit Mysliman. Betohej para Këshillit të Përgjithshëm dhe duhej të zotëronte të gjitha cilësitë e duhura për të qenë kryetar i komunitetit<sup>246</sup>.

---

<sup>245</sup> Kapitulli i dytë përmbante 3 nene (6-8) kushtuar Këshillit të përgjithshëm. Në nenet 6 dhe 7 përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet e këshillit të përgjithshëm, i cili përbëhej nga kryetari i komunitetit, nga 4 kryemyftinjë dhe nga një delegat për çdo ish-prefekturë, për një afat 5 vjeçar. Këshilli i përgjithshëm shqyrtonte dhe miratonte bilancin, rregulloret, kontrollonte punën dhe veprimtarinë e çdo organi drejtues, të medresesë së përgjithshme, merrte vendime për përmirësimin e godinave të komunitetit, përkujdesej për edukimin dhe kulturën fetare. Mblidhej në një seksion të përvitshëm me 15 tetor, punimet e të cilit nuk mund të zgjasnin më shumë se njëzet ditë. Seksioni i jashtëzakonshëm mund të thirrej me kërkesë të jo më pak se dy anëtarëve (neni. 8). Kapitulli i tretë përbëhej nga 7 nene (9-15) dhe i kushtohej drejtorisë së komunitetit mysliman, ku rimerreshin dispozitat e statutit të vitit 1929. Kapitulli i katërt përbëhej nga 3 nene (16-18) dhe rregullonte përbërjen dhe funksionimin e këshillit të përhershëm. Ky funksiononte si organ mbështetës për drejtorinë e komunitetit dhe përbëhej nga kryetari, myftiu i madh, drejtori i përgjithshëm i vakëfeve dhe nga një anëtar civil për një periudhë tre vjeçare. Mblidhej një herë në javë, merrte vendime për çështje fetare dhe kujdesej për botimin e librave fetarë dhe të një reviste fetare dhe letrare. Merrej me hartimin e *Hytbet-ve* dhe të lutjeve të tjera në gjuhën shqipe, hartonte rregulloret dhe ia paraqiste këshillit të përgjithshëm për miratim. Anëtari civil duhej të kishte kulturë fetare dhe të gëzonte reputacion të mirë.

<sup>246</sup> Kapitulli i tetë përbëhej nga 9 nene (43-52) dhe u kushtohej çështjeve ekonomike të komunitetit, të ardhurave të tij, mirëmbajtjes së të mirave dhe mbajtjes së bilancit të fitimeve dhe shpenzimeve të komunitetit, të cilat duhej të pasqyroheshin medoemos në regjistrin kontabël. Buxheti i tij miratohej me 15 tetor të çdo viti. Viti financiar fillonte me 1 janar të përfundonte me 31 dhjetor. Të ardhurat e komunitetit përbëheshin nga subvencionet e shtetit, të ardhurat nga vakëfet dhe nga ofertat e ndryshme të besimtarëve. Nuk lejoheshin dhurata dhe subvencione nga të huajt, përveç atyre që siguronin lejen e qeverisë.

Ai përfaqësonte administratën, kontrollonte aktivitetin financiar dhe trajtonte çështjet ekonomike me autoritetet qeveritare. Në rast largimi nga detyra, ai zëvendësohej brenda një muaji, pasi të kishte përgatitur bilancin e përgjithshëm mbi fitimet dhe shpenzimet. Në statut trajtohej gjithashtu gjendja e personelit, veçanërisht fetar, mënyra e organizimit të komunitetit në territor dhe përcaktoheshin detyrat e zyrave qendrore<sup>247</sup>. Në nenet 53-54 trajtohen xhamitë dhe mesxhidet, të ndërtuara në çdo qytet dhe fshat mysliman, të cilat kërkonin mirëmbajtje nga komuniteti, ndërkohë që për personelin parashikohej një pagë e arsyeshme.

---

<sup>247</sup> Kapitulli i gjashtë përbëhej nga 14 nene (25-39) dhe u kushtohej myftinjve të mëdhenj, myftinjve dhe këshilleve të zonave. Për Tiranën, Shkodrën, Korçën dhe Vlorën parashikohej prania e një myftinie të madhe. Zona e Tiranës kishte nën juridiksionin e saj: Tiranën, Durrësin dhe Peshkopinë; zona e Shkodrës përfshinte Shkodrën dhe Kukësin; zona e Korçës, Korçën dhe Elbasanin; zona e Vlorës përfshinte Vlorën, Gjirokastrën dhe Beratin. Myftinjtë e mëdhenj zgjidheshin nga këshilli i përgjithshëm dhe miratoheshin nga Këshilli i Ministrave. Këta funksionarë betoheshin përpara kryetarit të komunitetit. Me përjashtim të qendrave kryesore, zonat e tjera, ish prefektura dhe nënprefektura drejtoheshin nga një myftini. Dalloheshin dy shkallë të ndryshme: në qendrat e zonave, detyrën e myftiut e kryente myftiu i madh i zonës. Kryemyftinjtë, myftinjtë dhe zëvendës myftinjtë duhej të përmbushnin të gjitha cilësitë e kërkuara, si: kryerja e shkollës së lartë, moral i shëndoshë dhe të jenë sprovuar për besnikëri. Ata duhej të kujdeseshin për zbatimin e urdhërave dhe vendimeve të marra nga organet drejtuese të komunitetit; të këshillonin besimtarët myslimanë për të pranuar progresin e shoqërisë; të merrreshin me përhapjen e revistave dhe të librave fetarë; të kujdeseshin për administrimin dhe ruajtjen e pasurive të komunitetit; të mbante në mënyrë sa më të rregullt regjistrat e vakëfeve dhe të siguronte prej tyre të ardhurat, sipas zonave ku shtriheshin kompetencat e tyre. Këto organe duhej të kishin mbështetjen e një këshilli të përbërë nga 4 deri në 6 anetarë, detyra e të cilëve zgjaste për pesë vjet. Kryemyftinjtë, myftinjtë dhe zëvendës myftinjtë mund të shkarkoheshin nga detyra e tyre në bazë të nenit 36 të këtij statuti, në rast se dënoheshin me heqje lirie për më shumë se një vit; në rast se kryenin veprime kundër lirisë së personit; bënë falsifikime, mashtrime; nëse bënë veprime që binin ndesh me zakonet e mira ose për shkak të pakujdesive në punë. Kapitulli i shtatë përbëhej nga 3 nene (40-42) që u kushtoheshin ngritjes së zyrave dhe nëpunësve të komunitetit. Në nenin 40 thuhej se në strukturat qendrore dhe në zona, të kishte pranë autoriteteve të komunitetit disa sekretarë dhe nëpunës të tjerë, paga e të cilëve mbulohej nga bilanci i komunitetit. Këta zgjidheshin dhe propozoheshin nga drejtuesit e tyre dhe ngarkoheshin në detyrë me dekret të kryetarit të komunitetit, pasi të ishte dhënë pëlqimi nga këshilli i përhershëm. Në xhami emëroheshin *muezin*, *imam*, dhe *vaizë*. Detyra e tyre përjashtonte çdo lloj angazhimi politik apo shtetëror.

Nenet në vijim, 55-59 trajtojnë çështjet e medresesë së përgjithshme, e cila konsiderohej një institucion qendror i komunitetit. Kishte një konvikt, një drejtor dhe profesorë të diplomuar, të pajisur me ixhazet apo që dëshmonin aftësi në fushën teologjike. Qëllimi i medresesë ishte t'u siguronte imamëve të rinj dhe hoxhallarëve, për të cilët ishin hapur kurse të reja, formimin e nevojshëm për ngritjen e klasës drejtuese të komunitetit<sup>248</sup>.

Me rëndësi të veçantë për përmbajtjen e re të tij, është kapitulli i njëmbëdhjetë i statutit i përbërë nga shtatë nene (67-73) ku trajtohet çështja e vëllazërive myslimane në përbërje të komunitetit<sup>249</sup>.

Secila prej tyre kishte një person fetar referimi, i zgjedhur nga këshilli i vëllazërive përkatëse që do të merrej me marrëdhëniet mes kësaj vëllazërie dhe komunitetit. Ai zgjidhet nga këshilli i vëllazërisë së vet, pasi kandidatura e tij të ketë marrë miratimin e kryetarit të komunitetit. Më pas, kërkohej miratimi i emërimit të tij nga Këshilli i Ministrave<sup>250</sup>. Në këtë mënyrë, vëllazëritë Kadri, Tixhani, Rifai, Sadi, përfshiheshin në komunitetin mysliman me

---

<sup>248</sup> Në nenet 43-46, jepeshin disa dispozita të përgjithshme lidhur me autonominë vendimarrëse të këshillit të përhershëm; me pandryshueshmërinë e pasurisë së komunitetit pa një vendim të këshillit të përgjithshëm; me rregulloret që hynin në fuqi pas miratimit të Këshillit të Ministrave. Ndryshimet në statut bëheshin me jo më pak se dy të tretat e votave. Po në këtë kapitull, trajtohej çështja e petkave fetare, të lutjeve të së premtës dhe të Bajramit. *Hytbete-t* dhe lutjet, gjatë këtyre ditëve bëheshin për shtetin, kombin, ushtrinë kombëtare dhe lexoheshin në shqip. Marrëdhëniet me qeverinë mbaheshin nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>249</sup> Vëllazëritë në fjalë dalloheshin dhe karakterizoheshin për mënyrën e ushtrimit të besimit, për disa mënyra rituale dhe për devocion të veçantë ndaj disa figuravë të dijetarëve dhe mësuesve që kishin dhënë dëshmi me jetën e tyre të përkorë dhe të drejtë, por pa u shkëputur, nga shkolla sunite. Ndryshe është rasti i bektashinjve, të cilët janë një vëllazëri sufi, por kredoja e tyre teologjike dhe praktikimi i besimit janë shprehje e një organizate fetare autonome, që, siç e kemi parë, është pikë referimi edhe për disa vëllazëri të tjera. Lidhur me këtë, shih: G. CIMBALO, *Le confraternite nell'Islam: associazioni di fedeli o "comunità religiose" ...cit., passim.*; A. POPOVIC, *Le confraternite sufi nella regione balcanica, Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo*. Il difficile equilibrio tra mistica e politica, (a cura di M. Stepanyants), Torino, 2008, 181-206.

<sup>250</sup> *Statuti i Komunitetit Mysliman shqiptar*, Dekret nr. 1064 datë 4.5.1950, Gazeta Zyrtare 29 qershor 1950 nr. 40, 2-14. Tashmë në: <http://licodu.cois.it/576/view>

anë të përfaqësuesve të tyre që merreshin me zgjidhjen e çështjeve të brendshme dhe të administrimit të pasurive të tyre, gjë që mundësonte një kontroll më të gjerë e të shumanshëm mbi aktivitetet fetare<sup>251</sup>. Edhe pse, si fillim, statuti u miratua, Komiteti për çështjet fetare, disa muaj më vonë, ndryshoi mendim dhe u shpreh i pakënaqur, vuri në dyshim punën e bërë duke pohuar se në statutin e komunitetit Mysliman, nuk ishin bërë ndryshime rrënjësore në krahasim me atë të vjetrin, siç kërkohej në dekretligj. Vërejtjet i drejtoreshin veçanërisht klasifikimit të Myftinjve. Drejtoria e komunitetit u detyrua që me 25 korrik 1950 të paraqiste ndryshimet e kërkuara.

Duke qenë se në versionin e parë numri i myftinjve ishte i papërcaktuar, udhëzohej që numri i tyre të kufizohej. Në fund të vitit 1950, Kryemyftiu i Tiranës mori nën juridiksionin e tij Myftininë e Elbasanit që i përkiste Kryemyftinisë së Korçës<sup>252</sup>. Nuk ka asnjë dyshim që statuti i ri e vë komunitetin Mysliman nën kontrollin e rreptë të qeverisë. Çdo veprimtari e saj vëzhgohet dhe monitorohet, të gjithë ata që drejtojnë lutjen, nëpunësit e komunitetit dhe të gjithë ata që punojnë për llogari të tij, kontrollohen me rreptësi. Nëse e krahasojmë gjendjen financiare të komunitetit me atë të paraluftës, vihet re se numri i klerikëve dhe i të mirave është ulur ndjeshëm dhe se komuniteti është riformuluar i tëri<sup>253</sup>. Së fundi, me ndryshimet e bëra në vitin 1950

---

<sup>251</sup> Bëhet fjalë për vëllazëri të tilla, ku secila e merr emrin nga një figurë mistike islame dhe bëhet ndjekëse e mësimave të tij. Përhapja e tyre në hapësirën ballkanike, lidhet, në njëfarë mënyre, me traditën e asketizmit bizantin, karakteristike e së shkuarës së këtyre zonave, por edhe me përpunimin e doktrinës në brendësi të islamit, me qëllim që ta bënte mesazhin fetar më të kapshëm, duke qenë i hapur ndaj larmishmërisë kulturore të popujve ku po shtrihej ky besim fetar. Lidhur me këtë, shih AA.VV., *La saggezza dei sufi. Rumi e gli altri mistici dell'islam*, (a cura di G. Mandel.). Rusconi, Milano 1999; AA.VV., *I mistici dell'Islam. Antologia del sufismo*, (a cura di E. de Vitray-Meyerovitch). Guanda, Parma 1991; A VENTURA, *L'esoterismo islamico*. Atanor, Roma 1981.

<sup>252</sup> AQSH, Fondi. nr. 882, 1950, dos. 1, 50.

<sup>253</sup> Lidhur me pasurinë e këtij komuniteti mund të thuhet se zotëronte 1058 xhami dhe teqe, ndërkohë që në vitin 1950, godinat e kultit kapnin shifrën 1815, duke përbërë kështu shumicën në shikallë vendi. AQSH, Fondi nr. 890, 1952, dos. 1437, 14, 18, 36. Në vitin 1952, komuniteti mysliman, vetëm nga pasuritë e tij të tundshme dhe të patundshme, përfitoi 3,3 milionë lekë të ardhura, megjithëse kishte pësuar humbje të mëdha nga reformat ekonomike. Në vitin 1950,

mbi numrin e Myftinjve, merret zotim për zvogëlimin gradual të personelit fetar, në mënyrë që të ndryshonte puna e komunitetit. Duke vepruar kështu, qeveria çon përpara politikat e saj për riformulimin gradual të komuniteteve fetare, sidomos të atyre që kanë treguar më pak gatishmëri dhe pëlqim për transformimin e shoqërisë shqiptare në shoqëri socialiste.

---

komuniteti kishte 664 ndërtesa të dhëna me qera, vakëfi i Elbasanit zotëronte 27 dyqane dhe 5 hotele, ndërsa ai i Korçës 28 dyqane të dhëna me qera. Vetëm pagat e funksionarëve të lartë arrinin shifrën 5,3 milionë lekë. AQSH, Fondi, nr. 890, 1952, dos. 2212, 2195, 23. Në vitin 1950, personeli i komunitetit mysliman i selisë qendrore përbëhej nga 40 veta, përfshirë ketu edhe personelin e medresesë së përgjithsme; personeli i myftinisë së Korçës përbëhej nga 50 veta, 40 prej të cilëve ishin imamë, 2 zëvendës myfti dhe pjesa tjetër myezinë. Myftinia e Gjirokastrës kishte 20 klerikë, ajo e Vlorës 57, myftinia e Peshkopisë kishte 158 klerikë, e Kukësit 56 dhe e Tiranës 1.008 klerikë. AQSH, Fondi. nr. 890, viti 1950, dos. 850, 3.

## 2. 4. Statuti i komunitetit Bektashian

Pas komunitetit Mysliman, edhe ai Bektashian ia dorëzoi qeverisë statutin e tij, i cili përmbante një hyrje të shkurtër me një sintezë të ngjeshur të aparatit doktrinal të komunitetit, thuajse si riformulim i funksionit fetar të organizatës. Në këto qëndrime, pasqyrohej pëlqimi i të gjithë atyre që propozonin një rilindje të thellë të komunitetit e mbi të gjitha një reflektim mbi parimet fetare nën dritën e vlerave shoqërore. Këta e shihnin komunitetin si një shoqatë, përcjellëse të vlerave tipike të popullit shqiptar, thuajse si një shoqatë me karakter kulturor dhe etik, e aftë të kontribuojë për zhvillimin e progresit civil të shoqërisë sipas kornizës së projektuar nga partia komuniste në pushtet.

Statuti i rishikuar me kërkesën e qeverisë ndahet në tetë kapituj<sup>254</sup>. Neni 1 pohon që komuniteti Bektashian është person juridik në përbërje të të cilit ka familje me një traditë të gjatë bektashiane, si ashikë, myhibë dhe kleri që ruan si të paprekshme parimet dogmatike dhe traditat e bektashizmit. Kleri bektashian, përveç angazhimit për të zhvilluar ndjenjat fetare, zotohet gjithaq të mbështesë dhe përhapë besnikërinë ndaj pushtetit popullor dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, ndjenjën e dashurisë për atdheun, prandaj klerikët dhe funksionarët e komunitetit Bektashian duhet të kenë shtetësi shqiptare, të jenë besnikë ndaj popullit dhe atdheut dhe të gëzojnë të drejtat civile.

Gjuha e komunitetit është shqipja, por gjatë predikimit dhe funksioneve fetare mund të përdoren edhe gjuhë të huaja. Ky përjashtim rrjedh nga fakti se selia botërore e këtij komuniteti është në Shqipëri. Shugurimi dhe dhënia e titujve të ndryshëm fetarë do të bëhet sipas rregullave dhe dogmave tradicionale fetare dhe në bazë të dispozitave të statutit. Personave të paautorizuar të komunitetit Bektashian u ndalohet predikimi i kësaj feje. Marrëdhëniet e komunitetit me shtetin shqiptar rregullohen nëpërmjet nenit 16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kryetari i komunitetit Bektashian shqiptar do të jetë njëkohësisht

---

<sup>254</sup> Statuti u miratua gjatë punimeve të kongresit V të bektashinjve, i mbledhur me 16 prill 1950 në selinë e shenjtë të Kryegjyshitës botërore në Tiranë. Rreth tekstit të statutit shih: *Statuti i Komunitetit Bektashian Shqiptar, Dekret Nr. 1066 datë 4.5.1950*, <http://licodu.cois.it/594/view>.

edhe Kryegjyshi Botëror dhe ka të drejtë të mbajë lidhje me selitë e tjera bektashiane, në të gjithë botën (neni 1-7). Kjo është e mundur, ndryshe nga ç'parashikohet për komunitetet e tjera lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare, duke qenë se selia qendrore e këtij besimi gjendet në Shqipëri, prandaj ky besim mund të konsiderohet "veçanti" shqiptare, në përputhje me karakterin kombëtar të këtij komuniteti.

Në vijim, statuti trajton mënyrën e organizimit të komunitetit Bektashian, i cili përbëhet nga 6 Gjyshata dhe përcakton organet drejtuese dhe të përfaqësues<sup>255</sup>. Po ashtu, cakton rolet dhe

---

<sup>255</sup> Çdo gjyshatë kishte një ose më shumë qendra fetare, të quajtura *Prindëri*, të cilat mund të kishin disa dervishije (qendra të vogla fetare në fshatra apo krahina). Kryegjyshata, gjyshatat, prindëritë dhe dervishijet, gëzonin të drejtën e personit juridik (nenet 8-11). Në kapitullin e tretë trajtohen organet e komunitetit që ndahen në organe qendrore si: këshilli i përgjithshëm, këshilli i lartë i gjyshërve, këshilli i gjyshatës (këshilli i halifijëve) dhe organe lokale si: këshilli i prindërve dhe këshilli i dervishëve. Këshilli i përgjithshëm përbëhet nga 14 anëtarë laikë (myhibe) dhe nga 6 titullarë të gjyshatave dhe kryesohet nga Kryegjyshi botëror, i cili ushtron autoritetin suprem mbi çështje fetare dhe administrative të bektashizmit. Këshilli i përgjithshëm shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet kryesore, organizon zgjedhjet e kryegjyshit, të gjyshërve, prindërve dhe dervishëve. Po ashtu, mbikqyr veprimtarinë e organeve ekzekutive; vendos masa disiplinore, madje deri edhe largimin e ndonjë kleriku të fajësuar për dhunimin e parimeve të bektashizmit apo për nëpërkëmbje të detyrimeve që i burojnë nga detyra e tij si klerik; miraton bilancin; thërret kongresin; emëron sekretarin e përgjithshëm. Këshilli i përgjithshëm mblidhet një herë në vit, me 7 dhjetor për seksionin e përvitshëm, ndërsa për mbledhje të jashtëzakonshme lypet kërkesa e dy të tretëve të anëtarëve të këshillit. Konferenca nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë ditë. Rendi i ditës përcaktohet nga kryetari i përgjithshëm dhe shpallet një muaj para. Anëtarët e këshillit e ushtrojnë këtë detyrë për 5 vjet. Siç shihet, kemi të bëjmë me një administrim piramidë dhe centrik të pushtetit. Këshilli i lartë i gjyshërve ishte një organ shpirtëror dhe sillej edhe si organ ankimimi. Përbëhej nga Kryegjyshi botëror dhe nga titullarët e gjyshatave të tjera. Këshilli i lartë i gjyshërve duhej të ruante unitetin dogmatik dhe fetar të komunitetit, të jepte mësimë teorike dhe doktrinale, të mbikqyrte respektimin e traditave fetare nga ana e klerit. Mblidhej sa herë që ishte e nevojshme, me propozimin e kryegjyshit ose të një të tretës së anëtarëve. Organet qendrore mund ta hapnin mbledhjen vetëm me praninë e dy të tretave të anëtarëve efektivë. Pranë çdo gjyshate, ngrihej këshilli i gjyshatës, i drejtuar nga gjyshi dhe i përbërë nga gjashtë anëtarë fetarë apo laikë të zgjedhur nga këshilli i prindërve dhe nga këshilli i dervishëve. Pranë çdo prindërie dhe dervishije, ngriheshin këshille që kishin për detyrë t'u jepnin zgjidhje çështjeve administrative dhe financiare dhe qëndronin në detyrë, përkatësisht 4, 3, 2 vjet (neni 12-27).



funkcionet e klerit bektashian, duke përfshirë Kryetarin e komunitetit, Kryegjyshin Botëror, Gjyshërit, Prindërit, Dervishët dhe funksionarët e tjerë të shërbimit fetar. Kryetari i komunitetit, në Shqipëri, është edhe lideri fetar i komunitetit në të gjithë botën, të cilit i njihet titulli “Shenjtëria e tij, Kryegjyshi Botëror”. Emërimi i tij propozohet nga Këshilli i *Halifejve* dhe zgjidhet nga Këshilli i Përgjithshëm me një përbërje sa dyfishi i anëtarëve. Kryegjyshi gëzon të gjitha të drejtat që i garantohen nga dogmat fetare, nga dispozitat e statutit, nga ligji mbi komunitetet fetare dhe nga rregullorja e përgjithshme e komunitetit. Ai ushtron të gjitha funksionet e Kryetarit të komunitetit Bektashian shqiptar. Kryegjyshi thërret, drejton dhe kontrollon organet qendrore të komunitetit dhe verifikon zbatimin e vendimeve të këtyre organeve. Merret me mbarëvajtjen e praktikave fetare dhe administrative, duke emëruar funksionarët në vendet vakant; kontrollon shpenzimet e organeve të ndryshme të komunitetit dhe ndihmohet nga dy Gjyshër, të cilët zbatojnë udhëzimet e Kryegjyshit, të cilin edhe mund ta zëvendësojnë.

Kur vendi i Kryegjyshit mbetet bosh, këtë vend e merr Gjyshi më i moshuar. Në dispozicion të tij ka një sekretari të përgjithshme dhe një sekretari private si dhe personelin e parashikuar nga dispozitat e veçanta<sup>256</sup>.

---

<sup>256</sup> *Kryegjyshi*, së bashku me dy gjyshërit formonin drejtorinë e komunitetit. Kryegjyshi betohej para këshillit, sipas formulës tradicionale të bektashinjve. Në hierarkinë organizative, gjyshi ishte drejtuesi i gjyshatës. Të drejtat e tij përcaktoheshin nga një rregullore e veçantë dhe ishte mbartës i titullit “Shenjtëria e tij”. Ndihmomej nga një sekretar dhe nga personeli laik. Ai administronte gjyshatën nga pikëpamja fetare, zbatonte vendimet e organeve qendrore dhe të këshillit të gjyshatës. Përfaqësonte gjyshatën pranë organeve shtetërore dhe qendrore; interpretonte dogmat fetare dhe ua transmetonte përsiatjet e veta, vartësve të tij klerikë; jepte ndihmën e vet për ruajtjen e pasurisë së komunitetit; mbikqyrte dhe kontrollonte punën e vartësve të tij, prindër dhe dervishë; duhej të jepte të gjitha udhëzimet e nevojshme për kryerjen e formaliteteve lidhur me praktikën fetare. Emërimi i tij propozohej nga këshilli i prindërve, me miratimin e këshillit të lartë të gjyshërve, për t’u emëruar më pas nga këshilli i përgjithshëm. Po ashtu, duhej të kishte miratimin e Këshillit të ministrave dhe të emërohej me dekret nga Kryegjyshi. Prindërit dhe dervishët ishin përkatësisht titullarë të prindërve dhe dervishive. Prindërit mbanin titullin “Shenjtëria e tij” dhe kishin si mëkëmbës një apo më shumë dervishë. Zgjedhja e prindërve bëhej ose me propozimin e muhibëve të teqesë, që i paraqitej me shkrim gjyshatës kompetente, ose nga këshilli i përgjithshëm dhe

Njëkohësisht me aktivitetin e shkollave për formimin e klerikëve dhe të botimeve, komuniteti kryen edhe punë të drejtpërdrejtë me një audiencë dhe publik më të gjerë se ai fetar, aq sa mund të botohen libra dhe revista jo vetëm për besimtarët bektashian, por për të gjithë popullin. Shkollat dhe revistat financoheshin me fondet e përcaktuara për to nga komuniteti Bektashian. (neni 47-50). Gjithsesi, sipas dekretit të vitit 1949 mbi komunitetet fetare, mbetej në fuqi kontrolli i shtetit mbi këto aktivitete.

Me sa parashikohet në kapitullin e gjashtë të statutit, kujdes i veçantë i kushtohet pasurisë së komunitetit, mënyrës së administrimit të teqeve dhe të godinave të kultit, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Pasuria ndahej në pasuri të shenjtë dhe pasuri të përdorshme: e para shërbente për ushtrimin e besimit bektashian dhe ishte e patjetërsueshme, ndërsa e dyta u nënshtrohej rregullave administruese dhe mbarështuese të pasurisë private. Pasuritë dhe çdo e mirë tjetër e disponueshme administroheshin nga organet kompetente për territorin. Të ardhurat mblihdeshin nga pasuritë e teqeve, nga ndihmat e besimtarëve e sidomos nga subvencionet e shtetit. Burimet e komunitetit bektashian shërbenin për të përballuar shpenzimet e besimit, ato për mbajtjen e klerit, për pagat e personelit laik administrativ të Kryegjyshitës e të Gjyshitës, për përballimin e shpenzimit të ceremonive fetare, për financimin e ndihmave që u shpërndaheshin teqeve me të ardhura të pakta si dhe për mbajtjen e ndërtesave e të pasurive të komunitetit.

---

emërohej nga kryegjyshi, pasi i nënshtrohej kontrollit fetar faqas këshillit të lartë të gjyshërve. Prindërit dhe dervishët duhej të drejtonin si nga ana fetare, ashtu dhe administrative prindëritë dhe dervishijet; duhej të zbatonin vendimet e organeve qendrore; të përfaqësonin prindëritë dhe dervishijet përballë autoriteteve lokale gjatë aktiviteteve civile dhe administrative; të administrojnë pasuritë e teqeve përkatëse; të mbikqyrnin traditën e mikpritjes dhe të bujarisë që karakterizonte bektashinjtë. Kujdestarët e funksioneve fetare propozoheshin nga prindërit e teqeve, emëroheshin nga gjyshërit kompetentë apo nga kryegjyshi. Ata kishin për detyrë: a) të këndonin lutjet fetare në raste martesash apo funeralesh; b) të kryenin këngët dhe lutjet e pesë vakteve dhe të zbatonin të gjitha detyrimet që kishin të bënin me fenë e Sheriatit (neni 28-46).

Kapitulli i shtatë i statutit përmbante dispozitat lidhur me nënshkrimet, shenjat dalluese të vulave, festat fetare dhe flamurin<sup>257</sup>.

Ashtu si komuniteti Mysliman, edhe ai Bektashian përmanente brenda tij disa vëllazëri me praktika besimi mjaft të ngjashme me to si: *Haleveti*<sup>258</sup>, *Rrufai*<sup>259</sup>, etj. Myhibëve që ushtronin detyra të larta, u akordoheshin grada të ndryshme nga Kryegjyshi si: *Dervish*, *Prind*, *Gjysh*, pas propozimit të titullarëve dhe me miratimin e Këshillit të Gjyshërve. Së fundi, në kapitullin e tetë caktoheshin dispozitat mbi veshjet fetare, masat disiplinore, rregulloren e përgjithshme dhe ndryshimet në statut<sup>260</sup>.

Jemi përballë një statuti më të zhdërvjellët, po ta krahasojmë me atë të myslimanëve Sunitë, por sigurisht jo aq të detajuar dhe të ndërlikuar sa ai i mëparshmi, çka pasqyron një vullnet më të madh të komunitetit për t'iu përgjigjur kërkesave të aparatit qeveritar

---

<sup>257</sup> Komuniteti Bektashian ka si shenja dalluese *Taxhen* dhe *Teslimin*. Festat fetare të komunitetit bektashian janë: dita e Hashures dhe dita e Nevruzit me 22 mars. Flamuri ka një fushë të kuqe, të zbukuruar me vargje të kuranit, thënie të dijetarëve, taxhen, teslimin dhe në të djathtë të tij me një yll. Për t'i shkuar për shtat partisë komuniste, ky besim fetar e kishte këmbyer ngjyrën e gjelbër, karakteristike të islamit, me ngjyrë të kuqe.

<sup>258</sup> Halevitët shqiptarë dallohen nga vëllazëritë e tjera për ceremonitë e tyre fetare (*âyîn-i cem*, ose thjeshte, *cem*), ku përfshihen muzikë dhe valle (semah). Predikojnë dashuri dhe respekt për të gjithë, deri aty sa pohojnë se nuk ka rëndësi feja e një personi, por sjellja e tij si qenie njerëzore. Mbështesin barazinë mes burrit dhe gruas, të cilët luten së bashku, praktikojnë monogaminë. Janë tolerantë kundrejt besimeve të tjera, deri në atë pikë sa dhunimi i këtij parimi zhvlerëson çdo lutje. Së fundi, respektojnë punën deri në atë pikë sa e quajnë, vepra më e madhe e fesë. Duke qenë se në disa pika, halevitët për afrohen me shitizmin, ata kanë pësuar ndikim të fortë nga humanizmi dhe universalizmi, aq sa dëshmojnë një besim të shekullarizuar ndjeshëm. Dallojnë nga bektashinjtë, pasi i qëndrojnë mendimit se detyra e dedesë kalon nga ati tek i biri.

<sup>259</sup> Vëllazëri e themeluar nga Sayyid Ahmad Rufai er Rufai, i quajtur ndryshe Taricat Rufai (i njohur më mirë si dervishë rrotullues) praktikat rituale të të cilit karakterizohen për rëndësinë që i kushtohet valles, muzikës, këngës, në kërkim të harmonisë, e cila mund të arrihet nëpërmjet meditimit nën stimulin e muzikës dhe të ekstazës, stimuluar nga rrotullimi i vazhdueshëm i trupit. A. F. AMBROSIO, *Dervisci: storia, antropologia, mistica*, Carocci Roma, 2011. Per un inquadramento generale: *Storia delle religioni. Islām*, (a cura di G. Filoramo), Laterza, Bari 2005.

<sup>260</sup> Statuti miratohet nga Kuvendi popullor me dekret nr, 1066, me 4 maj 1950, dhe firmoset nga presidenti Omer Nishani dhe nga sekretari Sami Baholli. Gazeta Zyrtare nr. 43, 14 korrik 1950, 3 - 14.

dhe të partisë. Garant i një qëndrimi të tillë për komunitetin ishte, që në vitin 1948, Ahmet Myftari, Baba i teqesë së Kuçit të Vlorës, i cili u bë Kryegjysh i komunitetit: një klerik, simpatizant i njohur i partisë<sup>261</sup>. Ky karshillëk ndaj qendrimeve të qeverisë nuk i shpëtoi bektashinjtë dhe klerikët e tyre as nga persekutimet, as nga rrënimi i ardhshëm i të gjitha organizatave të kultit. Përkundrazi, fakti që në brendësi të komunitetit gjendeshin lidhje të forta me partinë, e përshpejtoi procesin e asimilimit.

Territori i banuar nga bektashinjtë ndahej në dhjetë gjyshata, gjashtë prej të cilave brenda kufirit politik shqiptar dhe katër jashtë vendit<sup>262</sup>. Rrethana të tilla mund të kishin përbërë interes për qeverinë, pasi mund t'i kishte shfrytëzuar ato për të shtrirë ndikimin e vet mbi komunitetet me etni shqiptare, jashtë kufijve shtetërorë, por ka gjasa që kjo mundësi të mos jetë shfrytëzuar.

---

<sup>261</sup> Me 18 maj 1947, Kryegjyshi Abaz Ilmi Dede vrau në zyrat e tyre Mustafa Xhanin dhe Fejzi Dervishin, dy drejtues të grupit reformator të bektashinje progresistë, të cilët përpiqeshin për rinovimin e komunitetit, në mënyrë që ta afronin sa më shumë me qëndrimet e PKSH-së. Si pasojë e këtyre ngjarjeve, mbi të cilat nuk hidhet dritë sa duhet, Abaz Ilmi Dede u pushua. Gazeta Bashkimi, 20 mars, 1947; Gazeta Bashkimi, 27 mars, 1947, dhe SH. HYSI., *vep. cit.*, 75.

<sup>262</sup> *Gjyshatat* brenda territorit shqiptar ishin këto: 1) *Gjyshata* e Krujës me qendër teqenë e Fushëkrujës. Nën juridiksionin e saj ishin: Durrësi, Shkodra dhe Peshkopia ku vepronin 8 prindëri dhe dervishije, me tre teqe në qytetin e Krujës dhe ato të Sari Salltëkut, ajo e Martaneshit, e Blacës dhe e Bulqizës. 2) *Gjyshata* e Elbasanit me qendër teqenë e Xefan Babait. Nën juridiksionin e saj ishin zona e Elbasanit dhe e Gramshit ku vepronin 6 prindëri dhe dervishije, me tre teqe në krahinën e Elbasanit, teqja e madhe në qytet, ajo e Shëmpërdhenjit dhe ajo e Dushkut në Gramsh. 3) *Gjyshata* e Korçës me qendër teqenë e Turanit kishte nën juridiksionin e saj zonat e Korçës dhe të Ersekës. Kjo ishte gjyshata më e madhe ku vepronin 10 prindëri dhe dervishije, me teqe në Melcan, Qatrom, Vlemisht, Ersekë, Starje, Krushva, Vrëpckë, Mazrek dhe dy në zonën e Devollit. 4) *Gjyshata* e Gjirokastrës me qendër teqenë e Asim Babait, e quajtur dhe *Teqja e Zallit*. Nën juridiksionin e saj ishin zona e Gjirokastrës, Tepelenës, Sarandës dhe e Kuçit ku vepronin 12 *Prindëri* e *Dervishije*, me gjashtë teqe në krahinën e Tepelenës dhe dy nën zonën e Përmetit. 5) *Gjyshata* e Prishtës në Skrapar me qendër teqenë e Tahir Baba Tahirit në Prishtë. Nën juridiksionin e saj ishin zonat e Beratit, Përmetit dhe katër teqe në zonën e Tomoricës, teqet në Plashnik, Osmanzezë, Velabisht, Gaman (Berat), Therapel e Kulmak. 6) *Gjyshata* e Vlorës me qendër teqenë e Frashërit. Nën juridiksionin e saj ishin zona e Vlorës, Fierit me disa teqe si ajo e Kuz Babait në qytetin e Vlorës, ajo e Koshtanit, e Krahasit (Tepelenë), Corushit, e Kutës, Dizdarit, Greshinës, Fratarit dhe ajo e Kapajt (Mallakastër). AQSH, Fondo. nr. 883, anno 1950, dos. 10, 10 - 11.

Sidoqoftë, komuniteti Bektashian vendosi krijimin e katër gjyshatave jashtë kufijve të Shqipërisë. E para u krijua në Tetovë<sup>263</sup>, një tjetër në Gjakovë<sup>264</sup>, ku kishte dhe ka ende sot komunitete të qëndrueshme. Dy të tjerat në Detroit dhe Stamboll. Dy të fundit mbetën vetëm në letër, edhe për shkak të ndërprerjes së rreptë të marrëdhënieve shqiptare sidomos me vendet e bllokut perëndimor. Pavarësisht kësaj, duke nisur nga vitet '50 të shekullit XX, numri i besimtarëve bektashian u rrit ndjeshëm në vendet perëndimore, ku veprimtaria e komunitetit nuk ishte e ndaluar dhe as nën kontrollin e shtetit shqiptar. Një ndër veçoritë kryesore të besimit bektashian lidhet me praktikimin individual të fesë, çka përkthehet në sjellje etike dhe kulturore, veçori këto të një islami që përshtatej më mirë me ritmet dhe vlerat e një shoqërie perëndimore.

Selia e Shenjtë e Kryegjyshit Botërore, në Tiranë, për të qenë efektive botërore, duhet të kapërcente tre probleme të mëdha. I pari kishte të bënte me mungesën e një qendre të vërtetë teologjike, të aftë për përpunimin dhe thellimin e doktrinës. Dobësia e vazhdueshme e kësaj qendre, me kalimin e kohës, do t'i kushtojë shtrenjtë së ardhmes së bektashizmit, i cili do të përballet me shterjen e vazhdueshme të pasurisë së tij doktrinale dhe pakësimin e personelit fetar që drejtonte lutjen dhe ceremonitë fetare. Pasoja do të ndiheshin edhe mbi aparatit organizativ të vëllazërisë. Shenja e dytë e dobësisë kishte të bënte me gjendjen e rëndë ekonomike të vendit, ku e kishte selinë qendra botërore; pra kishte mungesë të theksuar fondesh në vendin ku komuniteti ishte më i madh në numër, por i izoluar brenda kufijve politikë. Kjo përbënte arsyen e tretë të krizës për shkak të së cilës jo vetëm pengohej hyrja e donacioneve nga jashtë, por edhe tkurreshin ndjeshëm lidhjet me komunitetet e tjera jashtë vendit. Për këtë arsye Kryegjyshi e kishte thuar se të pamundur të ushtronte

---

<sup>263</sup> Veçanërisht domethënëse është veprimtaria e komunitetit të Tetovës në Maqedoni, ku ishte dhe është e pranishme në shumicë popullsia shqiptare, me të cilët qeveria interesohej të mbante marrëdhënie në funksion të qëndrimit të saj anti-jugosllav.

<sup>264</sup> Bëhet fjalë për qytetin e tretë për nga rëndësia në një krahinë me popullsi deri në 80% shqiptare, institucionet kulturore-fetare të së cilës ishin dhe janë të lidhura me Shqipërinë.

detyrën e tij si ndërmjetës mes komunitetit Bektashian shqiptar dhe besimtarëve të tjerë të shpërndarë nëpër botë<sup>265</sup>.

Përkujdesja e veçantë e qeverisë kundrejt këtij komuniteti shprehej me përpjekjen e vazhdueshme për afrimin e militantëve të këtij komuniteti me partinë. E privuar nga lidhjet me vendet perëndimore, qeveria shqiptare u kujdes që nëpërmjet përfaqësuesve më të përgatitur të këtij komuniteti, të mbante lidhjet me pjesën tjetër të botës, falë faktit që në Shqipëri ishte qendra botërore e këtij besimi. Bektashizmi prezantohej si një tipar kombëtar shqiptar, thënë ndryshe si një tregues i shqiptarizmit, edhe brenda komuniteteve të emigruara dhe në komunitetet shqiptare jashtë territorit të shtetit, ku qeveria shqiptare nuk gëzonte kurrfarë vlerësimi.

Aftësia e këtij komuniteti për t'u shekullarizuar dhe për të lëvizur brenda mekanizmave të kulturës dhe mendimit perëndimor, qenë një ndihmë jo e vogël për partinë komuniste, për t'i siguruar asaj lidhjet me intelektualët e partisë komuniste të Perëndimit dhe për të qenë, herë-herë, shtysë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit si dhe për shprehjen e mendimeve të saj politike në arenën komuniste ndërkombëtare. Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë, pas vitit 1948, pati si pasojë largimin e këshilltarëve ekonomikë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare dhe zëvendësimin e tyre me personel të ardhur nga Bashkimi Sovjetik, i dhënë tërësisht pas zbatimit të politikës së planifikimit, natyrisht e papërshtatshme me ekonominë e brishtë të vendit, e cila kishte nevojë për investime në infrastrukturë dhe për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

---

<sup>265</sup> Aso kohe kishte komunitete kompakte në Angli, Francë, Australi dhe Shtetet e Bashkuara, vende këto tradicionalisht me emigrantë shqiptarë. Pas vitit 1992, në Itali, hasim një prani domethënëse, edhe pse të pashpallur. Ende sot mund të flasim për komunitete me numër të konsiderueshëm në Azinë e vogël dhe atë qendrore, si në Siri dhe në Iran, në ish Republikën Sovjetike të Azisë dhe në Indi. Qeveria iraniane, më kot i ka ofruar ndihma komunitetit bektashi, në Shqipëri, pasi kjo i ka refuzuar. V. L. GUIDETTI, *L'Islam vicino. I Bektashi*, Lionello Giordano ed, Cosenza, 2009. *passim*.

## 2. 5. Statuti i komunitetit Ortodoks

Edhe komuniteti ortodoks e paraqiti statutin e tij, të përbërë nga 92 nene<sup>266</sup>. Në të pohohej që Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, si pjesë e pandarë e Kishës ortodokse të përgjithshme apostolike, është një person juridik e përbërë nga të gjithë ortodoksët që jetojnë brenda vendit dhe atyre me qëndrim jashtë, por që ruajnë dogmat kanonike dhe traditën e shenjtë. Me këtë përkufizim, Kisha e deklaronte veten kombëtare, duke i paraprirë një plani afatgjatë për autoqefali si dhe dëshirave të qeverisë së asaj kohe. Marrëdhëniet e komunitetit Ortodoks me shtetin ngriheshin mbi dispozitat e ligjit për komunitetet fetare. Gjuha zyrtare ishte shqipja, por për kryerjen e shërbimeve fetare mund të përdroreshin edhe gjuhë të huaja, në mënyrë që të ruhej liturgjia greke e përdorur në ritin bizantin (neni 1-3).

Bashkë me ndjenjat fetare, Kisha angazhohej të zhvillonte te besimtarët e vet edhe ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit popullor dhe Republikës së Shqipërisë; patriotizmi dhe forcimi i bashkimit kombëtar përbënin një prej qëllimeve të veprimtarisë pastorale. Funkzionarët dhe personeli laik i komunitetit duhet të ishin shtetas shqiptarë, të ndershëm, besnikë ndaj popullit dhe atdheut dhe të gëzonin të gjitha të drejtat civile. Kisha ortodokse mund të bashkëpunonte me kishat e tjera ortodokse që respektonin parimet e larta ungjillore për paqe dhe vëllazërinë e vërtetë mes popujve (neni 4-5), duke ruajtur, sidoqoftë, tiparin kombëtar, çka e dëshmonte shtrirja e juridiksionit edhe mbi besimtarët e vet, jashtë vendit.

Lutjet që këndoheshin gjatë meshës dhe ceremonive fetare, hartoheshin nga Drejtoria e komunitetit ortodoks dhe miratoheshin nga autoritetet kompetente. Asnjë klerik nuk mund të ushtronte funksionet e fesë ortodokse pa qenë i veshur me një pushtet të tillë apo pa qenë anëtarë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Kisha ortodokse organizohej në formën e metropolisë, nën titullin: Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, sipas rregullave kanonike

---

<sup>266</sup> Statuti u miratua gjatë punimeve të kongresit III, të mbajtur në Tiranë në datat 5-10 shkurt 1950. Sot në: <http://licodu.cois.it/569/view>.

dhe administrative kishtare<sup>267</sup>. Autoriteti më i lartë i Kishës ishte Sinodi i Shenjtë Episkopal, i përbërë nga peshkopë të çdo dioqeze, nën drejtimin e metropolitë qendrore dhe të metropolitit të mbarë Shqipërisë<sup>268</sup>.

Kriteret për emërimin e peshkopit ishin të ngjashme më ato të komuniteteve të tjera fetare për emërimin e funksionarëve të lartë fetarë, në përputhje me skemën e parafabrikuar nga shteti, ku përfshihej edhe formula e betimit<sup>269</sup>. Më pas, vinin dispozitat

---

<sup>267</sup> Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfshinte: Metropolinë e Tiranës dhe Durrësit, me nënmetropolitë lokale në Tiranë, Durrës, Shkodër, Kavajë, Elbasan; Ipeshkvinë e Beratit me nënipeshkvitë lokale të Beratit, Vlorës, Fierit, Lushnjës; Ipeshkvinë e Gjirokastrës, me nënipeshkvitë lokale të Gjirokastrës, Pogonit, Delvinës, Sarandës, Himarës, Përmetit; Ipeshkvinë e Korçës me nënipeshkvitë e Korçës, Kolonjës, Leskovikut, Pogradecit. Me vendim të këshillit të përzier mund të krijoheshin ipeshkvi edhe për shqiptarët me qëndrim jashtë vendit, në varësi të kishës nënë (neni 8 – 9).

<sup>268</sup> Ky organ kryesonte dhe drejtonte Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Misioni i tij ishte të ruante njësinë dogmatike, kanonike të traditës së besimit, duke u mbështetur në bazën e doktrinës së kishës ortodokse. Nga ky organ zgjidhej arqipeshkvi dhe ipeshkvinjtë; zgjedhje që bazohej në dogmat e kanoneve të shenjta dhe në përputhje me ligjet e shtetit. Ky organizëm merrte vendime për lutjet, transferimin apo shkarkimin e anëtarëve të saj, gjykonte me kompetencë ekzekutive, gjithnjë në përputhje më kanonet e shenjta dhe me ligjet në fuqi. Gjykonte çështjet që kishin të bënin me shkishërimin e ndonjë kleriku, merrte vendime për çështje të natyrave të ndryshme, për aq sa u përkiste kompetencave të saj. Duhej të interpretohte, me kërkesë të organeve të tjera dispozitat e statutit dhe të rregullores së përgjithshme të administratës. Sinodi i shenjtë ushtronte kontroll mbi veprimtarinë e ipeshkvinjve dhe të organeve të kishës, sipas rregullave fetare. Merrej me edukimin fetar-patriotik të meshtarëve dhe besimtarëve dhe mbikqyrte përmbushjen e detyrimeve nga ana e klerikëve (neni 11). Në rast mungese të motivuar të arqipeshkvit, sinodi i shenjtë drejtohej nga ipeshkvi më i moshuar. Sinodi i shenjtë, mblidhej detyrimisht në seksion të zakonshëm një herë në vit dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që e shihnte të nevojshme. Thirrja dhe rendi i ditës vendoseshin një muaj para, nën përkujdesjen e arqipeshkvit, i cili hapte dhe mbyllte mbledhjet e sinodit. Në rast se arqipeshkvi refuzonte të thërriste në mbledhje sinodin, mjaftonte kërkesa e dy anëtarëve për t'u bërë mbledhja brenda 15 ditësh. Mbledhja ishte e vlefshme me praninë gjysmës plus një të anëtarëve. Vendimet merreshin me shumicë të thjeshtë votash (neni 12-15).

<sup>269</sup> Kandidatët për ipeshkvinj duhej të kishin kryer shkollën e lartë në një fakultet teologjic ortodokse. Nëse nuk kishte kandidatë që plotësonin këtë kusht, atëherë mund të emëroheshin ata që shquheshin për veprimtarinë e tyre fetare dhe patriotike. Arqipeshkvi dhe ipeshkvinjtë, me t'u bërë anëtarë efektivë të sinodit të shenjtë, betoheshin duke përdorur këtë formulë: “Betohem me ndërgjegjen



organizuese dhe ato lidhur me funksionet e peshkopëve, të metropolitëve dhe të meshtarëve<sup>270</sup>.

---

time para Hyjit se do të ruaj besnikërinë ndaj dogmave, kanoneve dhe traditave fetare ortodokse, ndaj popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë dhe ndaj parimeve demokratike të kushtetutës së shtetit (neni 17). Nuk mund të kishte më shumë se një ipeshkëv pa dioqezë.

<sup>270</sup> Në mbledhjet e Sinodit të shenjtë, merrte pjesë edhe një sekretar i përgjithshëm i emëruar nga Sinodi i shenjtë dhe i miratuar nga arqipeshkvia. Asnjë botim me përmbajtje fetare nuk mund të përdorej gjatë liturgjisë pa autorizimin zyrtar të Sinodit të shenjtë. Sinodi merrte përsipër edhe edukimin e klerit dhe të besimtarëve, “me qëllim që të luftoheshin bestytnitë e vjetra”. Në këtë mënyrë, drejtuesit e rinj të kultit, e siguronin qeverinë për besnikëri ndaj saj. Asnjë klerik apo laik nuk mund të shugurohej meshtar pa autorizimin e Sinodit të shenjtë. Po ashtu, nuk mund t’i jepej ndonjë kleriku, pavarësisht veprimtarisë së tij, asnjë titull apo funksion fetar, pa propozimin e titullarit përkatës dhe pa miratimin e Sinodit të shenjtë, gjithnjë në përputhje me dispozitat e rregullores së përgjithshme të administratës (neni 16-23). Nenet 24-28 i kushtoheshin figurës së arqipeshkvit dhe kompetencave të tij. Arqipeshkvi i të gjithë Shqipërisë për kishën ortodokse ishte i pari i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe i metropolitë së Tiranës dhe Durrësit. Ai gëzonte të gjitha të drejtat që rridhnin nga kanonet e shenjta, nga statuti, nga rregullorja e përgjithshme dhe nga ligjet për komunitetet fetare. Arqipeshkvi kishte këto kompetenca: thërrste dhe drejtonte organet qendrore të kishës; siguronte zbatimin e vendimeve të këtyre organeve; përfaqësonte personalisht kishën përpara autoriteteve shtetërore; mbante lidhjet me kishat e tjera ortodokse; u dërgonte letra baritore të gjitha kishave dhe këshilleve vartëse dhe shuante mosmarrëveshjet që lindnin mes tyre; merrej me procedurat përkatëse, në rast të krijimit të vendeve vakante, për zëvendësimin e tyre brenda 40 ditëve; vizitonte qendrat nën juridiksionin e tij, së paku një herë në vit; emëronte ipeshkvinjtë sipas Kanoneve të shenjta; nënshkruante qarkoret për emërimin e ipeshkvinjve; emëronte ipeshkvinjtë vikarë të përkohshëm, në rast të krijimit të vendeve vakant; shqyrtonte ankesat që ngriheshin kundër igumenëve të ndonjë dioqeze; kryente hetimet e nevojshme ndaj klerikëve dhe ia përcillte të dhënat Sinodit të shenjtë. Arqipeshkvi kishte për ndihmës një ipeshkëv, anëtar të sinodit, i cili ushtronte çdo detyrë që i besohej nga arqipeshkvi nën titullin e ipeshkvit të Apollonisë (neni 24-28). Ipeshkvi titullar ishte organ drejtues i një dioqeze dhe gëzonte të gjitha të drejtat e parashikuara nga kanonet e shenjta, nga statuti, nga rregullorja e administratës dhe nga ligjet në fuqi. Ai drejtonte dioqezën në të gjithë shtrirjen e saj; e përfaqësonte atë përpara autoriteteve shtetërore lokale, personalisht ose nëpërmjet një delegati; mund të emëronte meshtarë; me propozim të tij dhe me miratimin e sinodit të shenjtë mund t’u ngarkonte klerikëve funksione të ndryshme; merrte masa disiplinore ndaj klerikëve; vizitonte, së paku, një herë në vit dioqezën e tij; mbikqyrtonte mbarëvajtjen e punëve fetare; jepte udhëzimet e nevojshme duke ushtruar pushtetin që i rridhte nga kanonet e shenjta. Ipeshkvi kishte detyrimin të qëndronte vazhdimisht në

Sa i përket administrimit, Kisha kishte një strukturë gjithëpërfshirëse pjesë e së cilës ishin si kleri, ashtu dhe besimtarët si anëtarë në Këshillin e përzier<sup>271</sup>, në Këshillin ekonomik<sup>272</sup>, në

---

dioqezë, me përjashtim të rasteve kur duhej të merrte pjesë në sinodin e shenjtë dhe në mbledhjet zyrtare (nenet 29 – 32). Nënmetropolitë ishin qarqe kishtarë administrative fetare ku bënte pjesë një numër i caktuar famullish të një dioqeze. Arqipeshkvi, në cilësinë e metropolitit të qendrës dhe titullar i dioqezës Tiranë-Durrës, emëronte në qendër të çdo nënmetropolie vendore nën juridiksionin e dioqezës së tij, një vikar metropolit vendor, i cili drejtonte në emër të metropolitit, nën direktivat e saj dhe në përputhje me dispozitat e statutit, të rregullores administrative dhe të ligjeve në fuqi. Po kështu vepronin edhe titullarët e dioqezave, ku çdo ipeshkëv i një nënipeshkvie vendore emëronte një vikar si ipeshkëv vendor që drejtonte vikariatit në emër të dioqezës (neni 33 – 36). Famullia përbëhej nga të gjithë besimtarët, klerikë dhe laikë të fesë së krishterë ortodokse, të cilët jetonin në një territor të caktuar, fshat apo qytet qoftë ai. Çdo famulli gëzonte të drejtën të kishte një apo më shumë ndihmës, në varësi të numrit të banorëve të famullisë dhe të kishave të tjera të kësaj famullie si dhe në bazë të gjendjes së saj ekonomike. Ndhimësit e famullisë caktoheshin nga këshilli i famullisë që përbëhej nga disa banorë të atij vendi pasi kishin marrë miratimin e titullarit të kësaj famullie. Në fshatra, prifti ishte kryetari i këshillit baritor. Ai ishte përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij statuti, të rregullores së administratës dhe të dekret-ligjit mbi komunitetet fetare. Nëse, në një famulli, shërbente më shumë se një prift, numri i familjeve besimtare ndahej në mënyrë të barabartë mes tyre. Transferimi i tyre bëhej me vendim të këshillit famullitar (*Dhimogjerondi*) (nenet 37 - 44).

<sup>271</sup> Organi më i lartë i kishës për çështjet ekonomike dhe administrative ishte këshilli i përzier, i cili përbëhej nga titullarët e dioqezave dhe nga katër anëtarë laikë, një për çdo dioqezë dhe drejtohej nga arqipeshkvi për një afat kohor katër vjeçar. Mënyra e zgjedhjes së katër anëtarëve laikë të këtij këshilli, kompetencat dhe të drejtat e tyre përcaktoheshin në mënyrë të detajuar nga rregullorja e përgjithshme e administratës së kishës dhe ajo mbi sigurinë e klerit, në përputhje me dispozitat e statutit dhe ligjet në fuqi. Ky këshill ushtronte kontroll mbi bilancin e vitit paraardhës dhe hartonte preventivin për vitin e ardhshëm. Kisha përfaqësohej në gjykatë nga një anëtar laik i këshillit të përzier, i deleguar *ad hoc*. Këshilli i përzier, i thirrur nga i pari i komunitetit, mblidhej në seksion të zakonshëm një herë në vit dhe në seksion të jashtëzakonshëm, sa herë të shihej e nevojshme. Vendimet merrreshin me shumicë të thjeshtë votash dhe mbledhja quhej e vlefshme kur ishin të pranishëm primati, katër anëtarë, dy fetarë dhe dy laikë. Në rast barazie votash, pëlqimi i primatit vlente dyfish. Këshilli i përzier mund të modifikonte ato nene të statutit që nuk kishin të bënin me dogmat, kanonet e traditat e shenjta. Për këto ndryshime nevojitej një *quorum* prej shtatë anëtarësh, ku gjashtë prej tyre të votonin *pro*.

<sup>272</sup> Pranë drejtorisë së kishës, shërbente këshilli i ekonomisë, në përbërje të të cilit ishin arqipeshkvi, katër anëtarë, një klerik dhe tre laikë dhe nga një përfaqësues për çdo dioqezë që ishte nën drejtimin e arqipeshkvisë. Ky organ

Këshillet fetare të qyteteve dhe fshatrave<sup>273</sup> dhe në Këshillet e manastireve<sup>274</sup>. Të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkisnin Kryeepiskopatës, episkopatave, nënmetropolive, famullive dhe manastireve, përbënin pasurinë e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Sa i përket shpërndarjes, ajo ndahej në: pasuri e shenjtë dhe pasuri normale, siç pamë për komunitetet e tjera fetare<sup>275</sup>. Shpenzimet për mbajtjen e klerit, mbaheshin me kontributin e vullnetarëve dhe besimtarëve; nga të ardhurat e Kishës dhe të Manastireve, ndërsa pagat e klerikëve dhe të nëpunësve si dhe shpenzimet e tjera mbaheshin me të ardhurat e kishës dhe subvencionet e shtetit, njësoj si për komunitetet e tjera. Një normë të veçantë përbënte krijimi, pranë drejtorisë së Kishës, të “Fondit për sigurimin e klerit”, i cili kishte si qëllim t’u siguronte të gjithë klerikëve, në rast të pamundësisë së përmbushjes së misionit të tyre të shenjtë, pension për ta dhe familjet e tyre, në rast të humbjes së kryefamiljarit. Fondi drejtohej dhe

---

ishite pjesë e këshillit të përzier dhe kishte për detyrë të administronte ekonominë e komunitetit gjatë vitit financiar dhe të jepte llogari përpara tij. Anëtarët e këshillit ekonomik zgjidheshin nga këshilli i përzier për një periudhë katër vjeçare. Të drejtat dhe detyrimet e këshillit ekonomik përcaktoheshin nga rregullorja e përgjithshme e administratës. Sekretarinë e këtyre dy këshilleve e mbulonte sekretari i përgjithshëm i sinodit.

<sup>273</sup> Komiteti i Kishës ortodokse i çdo qyteti zgjidhte këshillin fetar lokal (*Dhimogjerondi*) i cili kryesohej nga nënmetropolitë dhe administronte famullinë dhe pasurinë e saj. Në këtë këshill bënte pjesë me të drejtë vote, edhe një anëtar famullie, i deleguar nga besimtarët e qytetit të tij. Këshilli fetar i çdo qyteti mund të zgjidhte mes anëtarëve të tij një ose dy kujdestarë për çdo kishë të qytetit, të cilët mbanin përgjegjësi përballë këtij këshilli, duke qenë se e administronin kishën në emër të tij.

<sup>274</sup> Çdo manastir drejtohej dhe administrohej nga këshilli i manastirit, i quajtur *Igumenale*, nën drejtimin e një igumeni apo administratori klerik, i emëruar nga titullari i dioqezës. Këshilli i manastirit mbante përgjegjësi përballë organeve ekonomike të qendrës dhe të titullarit të dioqezës. Në këshillin fetar mund të zgjidheshin të gjithë qytetarët ortodoksë të Republikës së Shqipërisë që kishin mbushur moshën e pjekurisë. Mënyra e zgjedhjes së këshillave fetarë të qyteteve përcaktohej nga dispozita të veçanta (neni 45-59).

<sup>275</sup> I pari përfshinte sendet që i përkisnin besimit të shenjtë, të cilat nuk mund të tregtoheshin, por mund të dhuroheshin me vendim të këshilleve përkatëse, ndërsa pasuria e zakonshme përbëhej nga mjete që siguronin mbarëvajtjen e kishës dhe të personelit të saj. Shitja, administrimi, shtimi dhe kontrolli mbi të bëhej në përputhje me dispozitat ligjore dhe të rregullores së përgjithshme administrative.

administrohej nga Këshilli i përzier në bazë të dispozitave të një rregulli të veçantë, në përputhje me ligjet në fuqi (nenet 60-66).

Kisha duhej të mbante hapur shkollat fetare për përgatitjen e klerit dhe të funksionarëve të saj, duke respektuar një rregullore të përgjithshme të hartuar posaçërisht për këtë, ndërsa formimi i lartë i klerit kryhej, hera-herës, në konferenca të ndryshme të drejtuara nga titullarë dioqezash apo zëvendës të tyre, por për zhvillimin e tyre lypsej leja e autoriteteve kompetente. Nën përkujdesjen e drejtorisë së komunitetit, botohej një revistë mujore, duke ndjekur dhe respektuar dispozitat e ligjit mbi komunitetet fetare (nenet 67-72).

Statuti parashikonte edhe një sërë masash disiplinore<sup>276</sup>. Në nenet 81-83 përshkruheshin shenjat simbolike, firmat dhe vulat e komunitetit Ortodoks, ndërsa dispozitat e përgjithshme dhe kalimtare (nenet 85-92) rregullonin mbylljen e përkohshme të selive vakante dhe trajtimin me pension të anëtarëve të Sinodit të Shenjtë, me vendimin që ata humbisnin çdo të drejtë, në rast se vepronin kundër Kishës dhe atdheut (neni 87). Në mungesë të ardhurash për pensionistët, parashikohej që ata të strehoheshin në ndonjë manastir<sup>277</sup>.

Ky statut i jepte Kishës ortodokse një drejtori të re, parime të reja dhe udhëzime që, edhe pse nuk ndërhyenin në aspektin doktrinal të besimit, ishin më të përshtatshme për karakterin dhe misionin popullor të ortodoksisë, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet

---

<sup>276</sup> Pranë selisë së dioqezës funksiononte një gjykatë fetare që përbëhej nga titullari dhe nga dy anëtarë klerikë. Ajo merrte vendime të formës së prerë brenda 30 ditëve pas kryerjes së veprës së dënueshme. Të gjithë ata klerikë të dioqezës që fajësoheshin për veprime të dënueshme, ndëshkoheshin deri në 15 ditë pushim nga detyra apo heqje page, ndërsa për sjellje që përbënin skandal në sy të tjerëve, pushoheshin nga detyra deri në një muaj. Për faje të tjera që kishin të bënin me dhunimin e dogmave apo shkelje disiplinore që kapërcenin kompetencat e titullarit, gjykimi i kalonte sinodit të shenjtë i cili merrte vendime të formës së prerë. Për çdo lloj ndëshkimi, vendimi merrej me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet e sinodit duhej të merreshin në përputhje me nenin 14 të dekret-ligjit mbi komunitetet fetare. Çdo klerik i shkishëruar ishte i detyruar të zhvishte petkun fetar dhe të mos celebronte gjatë shërbimeve fetare (neni 73-80)

<sup>277</sup> Statuti u miratua nga parlamenti me dekret nr. 1065, datë 4 maj 1950 dhe u firmos nga presidenti Omer Nishani dhe nga sekretari Sami Baholli. Gazeta Zyrtare nr. 38, 21qershor 1950, 2 – 19.

që përmbante dekret-ligji për komunitetet fetare. Ky organizim përputhej me territorin dhe ishte në përshtatje të plotë me ndërgjegjen e komunitetit fetar në zona të ndryshme të vendit. Struktura e re organizuese pasqyronte shpërndarjen në komunitete territoriale për besimtarët, sidomos në pjesën jugore të vendit, të konsideruar nga grekët Epiri i Veriut.

Komuniteti ortodoks e pranoi statutin pa i bërë shumë qëndresë, por kërkoi të ndryshohej paragrafi i dytë i nenit 48, i cili duhej të garantonte që Kisha të mund të përfaqësohej para drejtësisë nga titullarët e dioqezave me të gjitha të drejtat ligjore, ku secili të përfaqësonte juridiksionin e dioqezës së vet, personalisht ose nëpërmjet përfaqësisë ligjore të zgjedhur prej saj<sup>278</sup>. Propozimi kishte një arsye të fortë, sepse ishte e pamundur që një person i vetëm të përfaqësonte të gjithë Kishën ortodokse, e për më tepër në të gjithë territorin shqiptar, prandaj parlamenti vendosi ta merrte për bazë kërkesën e Kishës ortodokse, që u miratua dhe hyri menjëherë në fuqi.

Në fakt, ky ndryshim nuk ishte thelbësor e nuk e prekte strukturën e përgjithshme të statutit<sup>279</sup>, por ndërhynte në detyrën e përfaqësisë së Patriarkanës, duke e dobësuar qeverisjen e Kishës e duke u lënë hapësirë kundërshtive të brendshme, gjë që e kishte karakterizuar gjithnjë këtë komunitet. Përçarje të tilla nuk ishin të parëndësishme për qeverinë, që e shihte me interes fragmentimin e pushtetit të Kishës në brendësi të komunitetit e, për më tepër, përfaqësimi ligjor në shkallë hierarkie më të ulët, do t'u jepte më pak zë çështjeve të ngritura. Si rezultat, u shtua kontrolli politik i qeverisë mbi strukturat fetare, gjë që ishte aq e nevojshme në një kohë kur kjo përgatiste zhbërjen graduale të organizimit kishtar, duke filluar nga drejtuesit e saj<sup>280</sup>.

---

<sup>278</sup> AQSH, Fondi. Nr. 489, 1960, dos. 5, 11.

<sup>279</sup> *Mbi aprovimin e ndryshimit të paragrafit të dytë të statutit të Kishës Ortodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Dekreti Nr. 3030, 12.1.1960, <http://licodu.cois.it/585/view> modifikon nenin 49 të statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (1950) në bazë të nenit 7 të projektligjit 743, 26.1. 1949, lidhur me komunitetet fetare, duke theksuar që përfaqësimi ligjor i kishës përballë gjykatës, i takon, me ligj, titullarit të dioqezës, ose një përfaqësuesi të emëruar prej tij.

<sup>280</sup> Pas miratimit të statutit, hierarkia e Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, përbëhej nga arqipeshkvi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, Pais Vodice, nga

Rritja e izolimit të vendit u shoqërua me shtimin gradual të shtypjes së besimeve fetare, prandaj përballë rritjes së vështirësive në Shqipëri, Kisha ortodokse shqiptare rimori rrugën e Amerikës dhe u riorganizua për emigrim, sidomos në SHBA, ku u krijuan dy fraksione. E para kryesohej ende nga peshkopi Fan Noli, e menjëherë pas vdekjes së tij, në vitin 1965, nga peshkopi Stefan Laskos. Ky fraksion i mban lidhjet me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Fraksioni tjetër kryesohet nga peshkopi Lefkes Marko Lipa, i lidhur me Patriarkanën Ekumneike. Shpallja e Shqipërisë si shtet ateist në vitin 1967 i shtyu këto dy grupe të bënin përpjekje për t'u afruar, por kjo nuk dha rezultat. Duhej pritur rënia e regjimit që Kisha ortodokse e Shqipërisë të rindëronte praninë dhe strukturat e saj në vend.

---

ipeshkvi i Gjirokastrës, Damian Kokoneshi, nga ai i Korçës, Filothe Doni dhe ai i Portland-it (dioqezë në SHBA) Naslazi Cirillo. Si ndihmës shërbente Sofron Borova. Shpërtheu një persekutim i pashoq: ish arqipeshkvi, Visarion u burgos; ipeshkvi ndihmës i Apolonisë, Ireneo Banusi u largua nga vendi. Me 19 qershor 1958, u gjend i vdekur –nga një atak në zemër, thuhej-, imzot Christopher Kish, ish Arqipeshkëv i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, të cilin e kishin detyruar të jepte dorëheqjen dhjetë vjet më parë, për ta dënuar më vonë me arrest shtëpie. Në mars të vitit 1966 vdiq Pais Vodice dhe arqipeshkëv u emërua Damian Kokonesi, i cili, shumë shpejt, u internua së bashku me shumë klerikë të tjerë dhe ndërroi jetë në Pogradec, me 18 tetor 1973. U shkatërruan apo u dhanë për punë të tjera 11608 kisha dhe 25 manastire. Ref.: A. DALIPAJ, *Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me kishën ortodokse...cit., passim..*

## 2. 6. Statuti i komunitetit Katolik

Mes komuniteteve fetare, ajo që kishte më së shumti probleme me paraqitjen e një statuti që t'u përgjigjej kriterëve të caktuara nga dekreti i vitit 1949, ishte pa dyshim Kisha katolike, e cila faktikisht, që në vitin 1929 e kishte refuzuar një gjë të tillë. Duhet kujtuar se gjëja e parë që i kërkohet, ishte ndërprerja e marrëdhënieve me Selinë e Shenjtë, ose, së paku, nënshtrimi ndaj kontrollit të shtetit. Një ndërmarrje e tillë kishte pasoja të rënda për kryerjen e shërbimeve fetare, si për përpunimin, ashtu dhe zbatimin e doktrinës katolike<sup>281</sup>. Kjo që arsyeja që Kisha katolike e kundërshtoi dekret-ligjin e ri dhe gjatë një mbledhjeje të mbajtur në arqipeshkvinë e Shkodrës, në nëntor të vitit 1950, ku morën pjesë 56 përfaqësues të të gjitha besimeve, vendosën të ruanin varësinë ndaj Selisë së Shenjtë<sup>282</sup>.

U kundërshtua modeli i statutit i parapërgatitur nga qeveria, gjë që e vuri shtetin shqiptar para një sfide të papritur dhe ndezi një konflikt të pazgjithshëm. Shteti nuk mund t'i pranonte vendimet e Kishës katolike, megjithatë nuk e përdori, aty për aty, forcën dhe dhunën, pasi ishte i bindur që kleri përfaqësonte vullnetin e besimtarëve. Ta detyroje Kishën katolike të pranonte skemën e statutit, do të thoshte të nxisje rrëmujë, të shtyje drejt dhunës një pjesë të besimtarëve katolikë shqiptarë, për të cilët Selia e Shenjtë ishte simbol mijëravjeçar i fesë. Për këtë arsye, shteti e ftoi Kishën katolike të shtrohej në bisedime për arritjen e një marrëveshjeje që do t'i jepte zgjidhje konfliktit, por, në të njëjtën kohë, shihte si të bënte për vete, së paku, një pjesë të klerit.

Kisha katolike e pranoi ftesën e qeverisë për bashkëbisedime. Delegacioni qeveritar drejtohej nga zëvendës kryeministri Mehmet Shehu, ndërsa ai katolik nga meshtari Bernard Shllaku, i cili deklaroi menjëherë se skema e statutit, sipas këtij ligji, ishte e papranueshme për katolikët<sup>283</sup>. Bisedimet zgjatën thujse gjashtë muaj dhe u shoqëruan me debate të flakta, pasi secila palë këmbëngulte në arsyet e veta dhe nuk pranonte kompromise.

---

<sup>281</sup> A. SHAHU, *vep. cit.*, 358.

<sup>282</sup> AQSH, Fondi. nr. 890, 1950, dos. 2153., 34.

<sup>283</sup> AQSH, Fondi. nr. 890, 1950, dos. 2193., 9.; Z. SIMONI, *vep. cit.*, 375.

Delegacioni qeveritar mendonte se statuti sanksiononte pavarësinë e Kishës katolike shqiptare nga Selia e Shenjtë, ndërsa delegacioni katolik sillte argumentin që e gjithë bota katolike e njihte Papën si udhëheqës shpirtëror të krishterimit, prandaj propozimi ishte i papranueshëm. Nga ana tjetër, pala katolike jepte siguri që vazhdimi i lidhjes së Kishës katolike shqiptare me Selinë e Shenjtë nuk do ta cënonte pavarësinë e shtetit shqiptar, pasi ajo merrej vetëm me anën shpirtërore dhe veprimtarinë e kultit. Përplasja konkrete ndodhi me emërimin e ipeshkvinjve për dioqezat shqiptare. Delegacioni katolik këmbëngulte që emërimi i ipeshkvinjve duhet bërë nga Selia e Shenjtë. Mehmet Shehu hartoi këtë propozim në emër të qeverisë: delegacioni katolik mund të propozonte emrat e katër ipeshkvinjve dhe këto, pasi të shqyrtoheshin dhe miratoheshin nga qeveria, t'i dërgoheshin për dijeni Selisë së Shenjtë. Selia e Shenjtë nuk e pranoi këtë propozim, pasi duhej të ishte ajo vetë dhe jo kleri shqiptar për t'ia përcjellë emrat qeverisë, në formë të rezervuar, siç ndodhte me vendet e tjera<sup>284</sup>.

Kjo binte ndesh me parimet hierarkike që karakterizojnë organizimin kishtar dhe që i kanë themelet në vetë natyrën e pontifikatit të Romës. Këmbëngulja e Kishës katolike në qëndrimet e veta, i bllokoi negociatat dhe kjo e ashpërsoi kundërpërgjigjen e qeverisë shqiptare. Përplasja e qeverisë shqiptare me komunitetet fetare tashmë kishte marrë karakter të përgjithshëm dhe Enver Hoxha urdhëroi që “lufta” kundër tyre të zhvillohej në dy plane: së pari kundër klerikëve reaksionarë, e së dyti i duhej mëshuar edukimit ateist të popullsisë. Ai ishte i bindur që: *“Drejtuesit e klerit nuk do të bëheshin kurrë miq të qeverisë dhe të partisë, ndërsa besimtarët janë miqtë tanë, por partia duhet të punojë ngadalë dhe me durim për çrrënjosjen e besimit ndaj zotave, fesë dhe kishës”*<sup>285</sup>.

Me të marrë këto udhëzime, delegacioni qeveritar filloi të akuzonte hapur palën tjetër për veprime të kundraligjshme dhe kryetarin e delegacionit si bashkëpunëtor të fashizmit<sup>286</sup>. Kjo bëri që delegacioni katolik të zbriste në kompromis: t'i mbante të

---

<sup>284</sup> Z. SIMONI., vep.cit., 375 - 376.

<sup>285</sup> E. HOXHA, vep. cit., 159 - 160.

<sup>286</sup> AQSH., Fondi. nr. 890, 1950, dos. 830, 17.



fshehta lidhjet me Selinë e Shenjtë pa i bërë publike, por as kjo nuk ishte e mjaftueshme për delegacionin qeveritar, i cili i mbylli bisedimet me kërcënime ndaj Selisë së Shenjtë, duke e akuzuar edhe atë si bashkëpunëtore të fashizmit.

Delegacioni katolik u tërhoq nga negociatat për t'u konsultuar me bazën, mes anëtarëve të së cilës kishte mjaft pakënaqësi. Bernard Shllaku, edhe pse shumë i moshuar, pranoi të bënte hapin e parë për nënshkrimin e statutit, të hartuar sipas skemës së parapërgatitur nga qeveria, por u premtoi besimtarëve se do t'i mbante personalisht lidhjet me Selinë e Shenjtë<sup>287</sup>. Statuti kufizonte autonominë organizuese të Kishës katolike brenda vendit dhe ia kalonte kompetencat e Papës një organi të ri, Arqipeshkvisë së lartë katolike, me seli në Shkodër. Në të, bënin pjesë të gjithë prelatët e lartë të dioqezës shqiptare. Kryetar i komunitetit katolik bëhej Arqipeshkvi i Shkodrës, i cili mund të vendoste për mbajtjen e marrëdhënieve me institucionet analoge jashtë vendit. Statuti i ri e lejonte Kishën katolike të ruante të mirat e saj dhe të kryente funksionet e saj në vend.

Sipas nenit 1 të statutit “Kisha katolike e Shqipërisë ka karakter kombëtar, është një person juridik dhe përfshin të gjithë besimtarët katolikë të Shqipërisë. Ajo frymëzohet nga parimet fetare të Kishës botërore katolike, të themeluar prej Jezus Krishtit, nën drejtimin fetar të Papës, trashëgues i pushtetit të apostullit Pjetër. Ajo nuk mban me Papën asnjë lidhje të llojit organizues, ekonomik apo politik”. Ky nen përmbledh më së miri marrëveshjen e arritur dhe sanksionon parimin: Kisha katolike shqiptare ka karakter kombëtar, por sidoqoftë, besimtarëve katolikë shqiptarë u njihet e drejta të frymëzohen nga parimet e Kishës katolike botërore.

Duke ritheksuar se qëllimi i Kishës katolike synon dritën e Hyjit, shpëtimin e shpirtit dhe të mirën shpirtërore të popullit, statuti riprodhonte skemën e parafabrikuar nga ligji. Pra, ftesa drejtuar qytetarëve për besnikëri ndaj shtetit shqiptar; shtrirja e juridiksionit të kishës vetëm brenda territorit të shtetit; shtetësi shqiptare e detyrueshme për të gjithë funksionarët kishtarë dhe drejtuesit e kultit; përdorimi i gjuhës shqipe gjatë celebrimit të

---

<sup>287</sup> A. SHAHU, *vep. cit.*, 360.

riteve fetare, por edhe përdorimi i latinishtes për kishën e ritit latin në Shqipëri. Për kryerjen e veprimtarisë së saj, Kisha katolike i nënshtronte ligjit të Hyjit dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, Kodit kanonik të kishës katolike botërore, me kusht që dispozitat e këtij Kodi të mos bien ndesh me ligjet e shtetit shqiptar, me rendin publik dhe me zakonet e mira.

Me dorëzimin e drejtimit të Kishës katolike, Arqipeshkvisë së Shkodrës, që mbulonte funksionet më të larta të klerit, kësaj i lindte detyra të ruante të paprekur unitetin dogmatik, ligjet dhe traditat e Kishës katolike të Shqipërisë; të drejtonte dhe administronte dioqezat; të përkujdesej për përgatitjen e klerit katolik nëpërmjet hapjes së seminareve, të cilët mund të ngriheshin dhe administroheshin në bazë të rregullores së miratuar nga Këshilli i Ministrave; të plotësonte bilancin e kishës dhe të administronte pasuritë e saj; të pranonte subvencionet e shtetit; të përkujdesej për botimin e letrave pastorale, të revistave dhe librave fetarë dhe për përgatitjen e klerit katolik, në përputhje me dogmat dhe ligjet e shenjta dhe me legjislacionin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Arqipeshkvi emëronte ipeshkvinjtë dhe funksionarët e tjerë të lartë, të cilët miratoheshin nga Këshilli i Ministrave. Emërimi i ipeshkvinjve dhe arqipeshkvinjve të rinj bëhej në prani të arqipeshkvit apo ipeshkvit që autorizoheshin nga arqipeshkvi katolik shqiptar, në bazë të dogmave fetare si dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave.

Procedura e emërimit të klerikëve shkaktoi përplasjen më të fortë mes shtetit shqiptar dhe Kishës katolike, pasi qeveria këmbëngulte në fitimin e së drejtës për miratimin e emërimeve duke i lënë Selisë së Shenjtë vetëm 'bekimin' për të përzgjedhurit nga Kisha shqiptare, duke e konsideruar këtë të fundit një Kishë kombëtare që e caktonte hierarkinë e vet nëpërmjet zgjedhjeve. Nga ana tjetër, pala katolike nuk hiqte dorë nga lidhjet hierarkike dhe njihte vlefshmërinë e normave të së drejtës kanonike. Konflikti dukej pa zgjidhje, por qeveria ka të gjithë vullnetin për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, aq sa vendos t'u kërkojë ndihmë dhe këshillim "shokëve sovjetikë"<sup>288</sup>.

---

<sup>288</sup> Shih vendimin e sekretarisë së komitetit qendror të PPSH-së, datë 22 dhjetor 1950, firmosur nga Enver Hoxha: 1950: Vendim 245, Mbi komunitetet fetare,

Me caktimin e qarqeve administrative<sup>289</sup>, u vendos që Arqipeshkvia metropolitike e Shkodrës mund të mbante lidhje me komunitetet fetare dhe institucionet shtetërore me seli jashtë vendit. Këto nuk mund të ishin marrëdhënie varësie dhe as nënshtrimi, nga pikëpamja organizuese, ekonomike dhe politike, por bashkëpunuese lidhur me çështjet fetare dhe të ndiqnin kanalet zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 25 të dekretligjit për komunitetet fetare, nr. 743, datë 27/11/1949. Funksione të tilla zhvilloheshin edhe në bashkëpunim me

---

*http://vargmal.org/dan2293, "1- Projektstatuti i tretë i klerit katolik bije në kundërshtim me ligjin mbi komunitetet fetare në nenin e tij të 13-të, ku sipas propozimit të klerit katolik, gjerarkët e kishës katolike (vikar kapitullarët dhe mitropolitit) zgjidhen nga konferenca e klerit katolik, i parashtrohen Papës për konfirmim dhe pastaj i paraqiten qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për aprovim, kurse sipas ligjit të komuniteteve fetare, këta gjerarkët, mbasi të zgjidhen nga konferenca e klerit katolik, i paraqiten qeverisë për aprovim dhe pastaj mund të kërkojnë, në rrugën shtetërore, bekimin e Papës. Nenin e tjera të projektstatutit pothuajse të gjitha pajtohen plotësisht me ligjin mbi komunitetet fetare. Për të zgjidhur çështjen e përmbajtjes së nenit 13-të të projektstatutit të tretë të kishës katolike, është kërkuar mejtimi, në formë këshillimi, i shokëve sovjetike. Nga puna e bërë nga organet e partisë dhe Sigurimit të Shtetit në rrethet me popullsi katolike, është shkaktuar një përçarje në gjerarkët e klerit katolik, gjë e cila ndodh për herë të parë në konferencën e fundit të katolikëve, kur u mor në diskutim projektstatuti i tretë i tyre nga të 56 priftërinjtë, 21 shfaqen për propozimet e qeverisë".*

Përtej këtij rasti të veçantë, sado i rëndësishëm, rrjedha e ngjarjeve na flet për lidhjet dhe një bashkërendim të mundshëm të politikave fetare mes shqiptarëve dhe sovjetikëve. Marrëdhëniet ndërpritën me prishjen e lidhjeve me Moskën pas kongresit XX të PKSS të vitit 1956. Dokumenti flet, gjithashtu, për përçarjet që shkaktuan politika persekutuese e qeverisë së brendshme klerit, i cili nuk shqetësohej vetëm për fatin e tij vetjak, por për të ardhmen e besimit katolik në shoqërinë shqiptare, që po kërcënohej seriozisht nga politikat qeveritare.

<sup>289</sup> Aso kohe, Kisha katolike e Shqipërisë përbëhej nga këto dioqeza: Arqipeshkvia e Shkodrës me në krye një arqipeshkëv metropolit; Arqipeshkvia e Durrësit e drejtuar nga një arqipeshkëv me seli në Durrës; dioqeza e Lezhës, e drejtuar nga një ipeshkëv me seli të përkohshme në Kallmet; dioqeza e Sapës, e drejtuar nga një ipeshkëv me seli në Nënshat; dioqeza e Pultit (sot e bashkuar me atë të Shkodrës), e drejtuar nga një ipeshkëv me seli në kodrën e shën Gjergjit; abacia e Nullius, në Mirditë, e drejtuar nga një ipeshkëv me seli në Orosh. Në mungesë të arqipeshvinjve dhe ipeshkvinjve, vendin e tyre e zinin vikarët. Arqidioqezat dhe dioqezat drejtoheshin dhe administroheshin nga titullarët e tyre, nën juridiksionin e të cilëve ishin të gjithë klerikët katolikë që ushtronin funksionet e tyre brenda territorit të dioqezave.

pjesëmarrjen e vikarëve të përgjithshëm, të kancelarëve, të këshilltarëve dhe të zyrtarëve të tjerë të kancelarisë të zgjedhur prej ipeshkvit. Në vijim të statutit trajtoheshin famullitë dhe juridiksioni i tyre si dhe detyra e famullitarit i cili, ashtu si i gjithë kleri, duhej të mos martohej. Vëmendje e veçantë u kushtohej urdhrave rregulltarë për meshkuj dhe femra, e sidomos urdhrin françeskan që shihej si struktura më e qëndrueshme e Kishës katolike në Shqipëri.

Interes të veçantë paraqesin normat lidhur me financimin e kultit. Pasuria e kishës përbëhej nga të gjitha të mirat e arqipeshkvive dhe famullive dhe ndahej, ashtu si tek komunitetet e tjera, në pasuri të kultit, ku përfshiheshin të mirat në shërbim të qëllimeve fetare dhe në pasuri të zakonshme, e cila përbëhej nga të mirat materiale për mbajtjen e kishës, të personelit administrativ dhe shërbyes. Mbarështimi, shitja dhe administrimi i pasurisë fetare, kontrolli dhe verifikimi i tij, ashtu si për kultet e tjera, duhet të ishin në përputhje me dispozitat legislative në fuqi, me rregulloren e posaçme mbi administrimin e pasurisë së kishës katolike të Shqipërisë (që pritej të hartohej) dhe me dispozitat e Këshillit të Ministrave. Shpenzimet për mbajtjen e kultit dhe kryerjen e shërbesave fetare duhej të hiqeshin me kontributin vullnetar të besimtarëve, të ardhurat nga pasuria e kishës dhe me subvencionet e shtetit. Shteti mbështeste pushtetin disiplinor të ipeshkvinjve mbi klerin, përcaktonte ndarjen administrative, formën dhe strukturën e vulave.

Statuti u hartua dhe miratua në mbledhjen e përgjithshme të klerit katolik shqiptar, mbajtur me 26 qershor të vitit 1951, në Kurien e Arqipeshkvisë metropolitane të Shkodrës, sipas parimeve dhe dispozitave të përgjithshme të së drejtës kanonike në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të dekretligjit mbi komunitetet fetare. Aty u përcaktua mënyra sipas së cilës Kisha katolike e Shqipërisë rregullon, drejton dhe administron çështjet e saj fetare dhe se statuti hyn në fuqi pas miratimit të parlamentit të Republikës Popullore të Shqipërisë<sup>290</sup>.

---

<sup>290</sup> Statuti u miratua nga parlamenti me dekret nr. 1322, të datës 30 korrik 1951, u firmos nga presidenti i parlamentit Omer Nishani dhe nga sekretari Sami Baholli. Gazeta Zyrtare nr. 25, 14 shtator 1951, 795 – 800.

Ndryshimet që bënë komunitetet fetare mbi statutet e tyre gjatë vitit 1950, edhe pse e kufizonin ndjeshëm veprimtarinë, u lejonin atyre të ruanin njëfarësoj të mirat e tyre. Është pikërisht kërcënimi i zhveshjes prej të gjitha të mirave, që e shtyn Kishën katolike të Shqipërisë të hartojë statutin e vet dhe ky është një tregues i vërtetë i njohjes së qëndrueshmërisë së formave të reja të shtetit. Gjithsesi, jo më parë se me 3 gusht, qeveria botoi versionin e statudit të firmosur, tashmë në duart e saj dhe e paraqiti ngjarjen si një sukses të forcave progresiste të partisë komuniste dhe si mundje e forcave prapanike të klerit dhe të Kuries romake. Kjo e shtyu komunitetin katolik shqiptar të mbronte qëndrimet e veta. Një pjesë e tij pohonte se ishte mashtruar dhe se teksti i statudit ishte modifikuar pa dijeninë e tyre<sup>291</sup>. Të tjerë pohonin se një pjesë e klerit katolik kishte rënë në kompromis me qeverinë, nisur nga premtimi i Bernard Shllakut për t'i mbajtur personalisht lidhjet me Selinë e Shenjtë<sup>292</sup>.

Në gjendjen e sotme mund t'u referohemi vetëm burimeve arkivore shqiptare, duke mos i njohur ato të Vatikanit, por nëse shohim me vëmendje historinë e vendeve të tjera komuniste si në Europë, ashtu edhe në Azi, do të vëmë re politika të ngjashme të shteteve socialiste, që prodhuan po ato rezultate si në Shqipëri<sup>293</sup>.

---

<sup>291</sup> E. JAQUES., *vep.cit.*, 104, 504.

<sup>292</sup> A. SHAHU, *vep. cit.*, 503.

<sup>293</sup> Qeveritë komuniste janë përpjekur të themelojnë Kisha katolike kombëtare në disa vende ku ato qeverisnin, si në Hungari, ashtu edhe në disa Republika nën dominimin Rus, si në Lituani etj. Kjo përpjekje dha rezultat në Çekosllovakia, ku partia komuniste vendase promovoi dhe mbështeti lindjen e një "Aksioni katolik qeveritar" me qëllimin e shpallur që të krijonte një kishë kombëtare të shkëputur nga direktivat e Vatikanit. Rreth kësaj, shih: A. DE OTO, S. PRIBYL, *Analisi delle relazioni tra Stato e chiese nell'ex-Cecoslovacchia e nell'odierna Repubblica ceca. La nuova legge in materia di chiese e società religiose*, in "Il Dir. Eccl.", n.1/2004, 23; A. REBICHINI, *Chiesa, società e Stato in Cecoslovacchia, 1948-1968*, Padova, 1977, 36. Mbi formimin e një kishë klandestine që kërkonte të ruante lidhjet me Romës, shih: A. DE OTO, *Diritto e religione nella Repubblica ceca e in Slovacchia, Libertà di coscienza e diversità di appartenenza religiosa nell'Est Europa*, (a cura di Cimbalo G., Botti F), Bologna, 2008, 205 ss. Një politikë e tillë u braktis, si për shkak të shterpësisë së rezultateve, ashtu dhe për ndryshimet e politikës ruse, të nxitura nga Andrey Gromyko, Ministër i jashtëm i asaj kohe, i cili këmbëngulte në bindjen e tij se duhej kërkuar një marrëveshje me Selinë e Shenjtë. Ka gjasa që krijimi i kishës katolike kombëtare, të ketë pasur rezultat në Kinë, gjë që vazhdon të funksionojë edhe sot e kësaj dite. Edhe pse e mohuar nga Selia e Shenjtë dhe

Duke përfituar nga ndarja e pasurisë së komuniteteve fetare në të mira për kultin dhe të mira të përgjithshme, që u përkisnin këtyre komuniteteve, shteti filloi konfiskimin dhe shtetëzimin gradual të tyre<sup>294</sup>.

Mbërrijnë kohë, ku vihet re një rënie e ngadaltë por e vazhdueshme e rolit të komuniteteve fetare, deri në vitin 1963, kur nëpërmjet një dekreti, përcaktohen normat shtërnguese për veprimtarinë e komuniteteve fetare<sup>295</sup>, duke e modifikuar përmbajtjen e dekretit për komunitetet fetare të vitit 1949. Këto masa, kulmojnë me dekretin famëkeq të vitit 1967, i kthyer tashmë në ligj, sipas të cilit shfuqizohej menjëherë dekreti i vitit 1949 për komunitetet fetare dhe të gjithë statutet e komuniteteve fetare të pranishme në Shqipëri<sup>296</sup>.

---

nga Papa, ajo i mban lidhjet me hierarkinë klandestine katolike. Shih: B. K. F LEUNG. e W.T LIU, *The Chinese Catholic Church in Conflict: 1949-2001*, Boca Raton, FL, Universal Publishers, 2004.

<sup>294</sup> Bën përjashtim vendimi nr. 26, datë 10/01/1953 i këshillit të ministrave, i cili vendos t'i kthejë kishës katolike një pjesë të pasurive të konfiskuara në vitin 1946, pa farë dëmshpërblimi. Miratimi i statutit të Kishës katolike dëshmon se krerët e këtij besimi fetar kishin vendosur t'i shërbenin me besnikëri çështjes së komunitetit, pa dëmtuar interesat e shtetit. Prandaj shihej me leverdi të mbahej një qëndrim sa më i disponueshëm, për të thelluar të çarën brenda kishës katolike.

<sup>295</sup> Dekret nr.3660, datë 10.4.1963 *Mbi disa ndryshime në dekretin nr.743 26.11.1949 "Mbi komunitetet fetare"* Në dekretin nr.743, datë 26/11/1949, miratuar me ligjin nr.773, datë 16.1.1950 "Komunitetet fetare" bëheshin këto ndryshime: 1. Paragrafi i parë dhe i katërt, nenet 7 të të cilëve janë modifikuar si më poshtë: "Komunitetet fetare, mund të organizojnë aktivitete për të cilat shteti duhet të japë miratimin e vet. Kjo bëhet nëpërmjet miratimit të statuteve të tyre nga ana e Këshillit të Ministrave. Njohja e komunitetit fetar mund të shfuqizohet nga Këshilli i Ministrave, nëse veprimtaria e këtij komuniteti ka shkelur ligjet e sistemit juridik dhe zakonet e mira. 2. Neni 30 u modifikua si më poshtë: "Qendrat e komuniteteve fetare përcaktohen nga Këshilli i Ministrave". Shtrirja e madhe e kontrollit të qeverisë mbi komunitetet, i vë këto nën varësinë e plotë të vullnetit të ekzekutivit dhe i lë dorë të lirë qeverisë për turrjen gjithnjë në rritje të të drejtave të tyre, çka çon në shkërmoqjen e veprimtarisë së komuniteteve fetare.

Cfr.: <http://licodu.cois.it/586/view>

<sup>296</sup> Il *Dekret nr. 4337, 13.11.1967 "Mbi shfuqizimin e disa dekreteve"* emanato ai sensi dell'articolo 58, comma 6, della Costituzione del 1946 abroga, entrando immediatamente in vigore, i Dekreti nr. 743, 26.11.1949 "Mbi komunitetet fetare", siç është ndryshuar me dekretin Nr. 3660, 10.4.1943; dekreti nr. 1064,

Miratimi i këtij dekreti u bë nëpërmjet nenit 58, pika 6 të Kushtetutës së vitit 1946 duke i paraprirë ligjit të ri kushtetues nr. 5506, datë 28. 12. 1976. Neni 37 i kësaj Kushtetute shpall ateizmin e shtetit, si tipar dallues i Shqipërisë komuniste, ndërkohë që në nenin 55 ndalohet veprimtaria dhe vetë ekzistenca e të gjitha komuniteteve me karakter fetar<sup>297</sup>. E gjithë kjo i hap rrugë persekutimit fetar, gjatë të cilit shpërbëhen të gjitha strukturat e komuniteteve fetare, pasuritë e tyre konfiskohen dhe godinat e kultit modifikohen për shërbime të ndryshme. Madje, edhe liria vetjake për ushtrimin e fesë ndalohet, dhe shpërthen një propagandë ateiste pa fre dhe e paskrupullt që ngre një rrjet shtypës ndaj çdo forme praktikimi dhe shprehjeje të besimit<sup>298</sup>. Kjo linjë përforcohet në vitin 1977, me miratimin e Kodit të ri Penal, neni 55 i të cilit parashikon dënimin nga tre deri në dhjetë vjet për të gjithë ata që bëjnë propagandë fetare, prodhojnë, shpërndajnë apo ruajnë shkrime fetare<sup>299</sup>. Paralelisht me rrënjosjen e përshpejtuar të regjimit dhe izolimin ndërkombëtar gjithnjë në rritje të vendit, shtohet shtypja ndaj çdo aktiviteti fetar dhe vetëm një pjesë e klerit mbijeton në emigrim, por vështirësitë shtohen për ato komunitete fetare që nuk marrin ndihma dhe mbështetje nga jashtë dhe askush nuk i ndihmon për të ruajtur traditat apo për edukimin dhe formimin e drejtuesve të rinj të fesë.

---

4.5.1950 “*Mbi aprovimin e statutit të komunitetit mysliman shqiptarë*”; dekreti nr. 1065, 4.5.1950 “*Mbi aprovimin e statutit të kishës autoqefale të Shqipërisë*”; dekreti nr. 1066, 4.5.1950 “*Mbi aprovimin e statutit të komunitetit bektashian shqiptarë*”; dekreti nr.1322, 30.7.1951 “*Mbi aprovimin e statutit të kishës katolike të Shqipërisë*”, çfuqizohen..

<sup>297</sup> Neni 37. “*Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botkuptimin materialist shkencor*”. Neni 55 “*Ndalohet krijimi i çfardo organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist*”. *Ndalohet veprimtaria dhe propaganda fashiste, antidemokratike, luftënxitëse, si edhe nxitja e urrejtjes kombëtare e racore*.

<sup>298</sup> Vedi: H. HULUSI, *Ateizmi shkencor*, SHBLU, Tiranë, 1983; G. ILJAZ, *Veprimtaria reaksionare e klerit katolik në fushën e arsimit*, Tiranë, 1978.

<sup>299</sup> Teksti i nenit 55 rimerr fjalë për fjalë nenin 55 të kushtetutës së vitit 1967 duke futur masën e dënimit për shkelësit e ligjit. Neni 55 “*Krijimi i çdo lloj organizate me karakter fashist, anti-demokratik, fetare dhe anti-socialist është e ndaluar. Aktivitet fashiste, anti-demokratike, fetare, luftë-nxitëse dhe anti-socialiste si dhe nxitja e urrejtjes kombëtare dhe racore*”.

Nga ana tjetër, regjimi shqiptar nuk ngurron ta paraqesë veten si vendi më radikal dhe koherent mes vendeve socialiste, në zbatimin e linjës së marksizëm-leninizmit, gjë që e frymëzon të kërkojë pëlqimin e lëvizjeve të rinisë, që pas vitit 1968 po trondisnin ekuilibrat politikë të vendeve të Europës. Grupet e vogla filo-shqiptare që ishin krijuar në disa vende, prezantoheshin si organizata të masës dhe ushqenin në Shqipëri bindjen për ekzistencën e një bote që po rend drejt komunizmit dhe ateizmit të shtetit, kur në të vërtetë shfaqja e krizës së besimit fetar lidhej më shumë me proceset e shekullarizimit të shoqërive perëndimore, me konsumizmin, që as që njihej nga shoqëria shqiptare, dukuri këto mjaft më të rrezikshme për besimin sesa propaganda ateiste e regjimit lindor dhe politika rrënuese e zbatuar mbi organizatat dhe personelin fetar në këto vende. Madje, në shumë raste, persekutimi krijon efektin e kundërt, rrit pjesëmarrjen dhe shtyn një pjesë të madhe të njerëzve ta lidhin përkatësinë e tyre fetare me qëndrimet e tyre politike kundër regjimit.

Me pushtimin e Çekoslovakisë, u shfrytëzua tentativa e fundit e reformës së të majtës së shteteve të Europës Lindore<sup>300</sup>, për t'u ndjekur në krye të vitit nga politika e Gjermanisë Perëndimore, e cila gjeti mbështetjen e politikave analoge të Kishës katolike.

Iu hap rrugë një rrjeti të ndërlikuar marrëdhëniesh diplomatike të Selisë së Shenjtë me vendet e bllokut sovjetik, u nënshkruan marrëveshje dhe u bënë takime në frymën e lëshimeve të ndërsjella. Kështu, Kisha katolike ia doli të mbrojë besimtarët e vet në vendet e Europës Lindore. Në këto kushte, u inaugurua me 3 korrik 1973 Konferenca e sigurisë dhe e bashkëpunimit në Europë.

---

<sup>300</sup> Lufta e ashpër dhe e pandërprerë e këshilleve të punëtorëve në Poloni, kryengritja hungareze e vitit 1956 dhe së fundi reformat që karakterizojnë kërkesat e komunistëve polakë, pasqyrojnë një transformim “majtas” të sistemeve politike të këtyre vendeve. Sulmi i sovjetikëve dëshmon pamundësinë e reformimit të këtyre regjimeve politike. Qeveria shqiptare, e mbetur kryekëput staliniste, i sheh këto ngjarje si ndikim të kapitalizmit, por duke mos pasur kontakt me territorin e kontrolluar nga vendet e paktit të Varshavës, është e vetëdijshme se nuk ka pse t'u druhet rreziqeve të tilla. Lidhur me përpjekjet e reformimit të së majtës në regjimet e Europës Lindore, shih: A. BABEAU, *Les conseils ouvriers en Pologne*, A.Colin, Paris, 1960; B. NAGY & J.J MARIE *Pologne-Hongrie* EDI, Paris, 1956; M. ZANARINI, *La rivoluzione ungherese*, Arianna ed, Bologna, 2008; L. MAGRI, *Il sarto di Ulm*, Il Saggiatore, Milano 2009; A. FRIGERIO, *Budapest 1956. La macchina del fango*. Edd. Landau, Torino 2012.



Shqipëria është e vetmja ndër vendet europiane, bashkë me Andorën, që nuk marrin pjesë dhe me 1 gusht 1975, tridhjetë e pesë krerët e shteteve dhe të qeverive të pranishëm aty, firmosin në Helsink aktin final të CSCE-së. Mes firmëtarëve ishte edhe Selia e Shenjtë, ndërkohë që Shqipëria mbetet sërish jashtë<sup>301</sup>.

Izolimi i Shqipërisë është i plotë, ndaj lufta e saj kundër fesë dhe në favor të ateizmit të shtetit duhet të përballet me një hapje gjithnjë e më të madhe të vendeve të Europës Lindore drejt lirisë fetare dhe frymës së tolerancës. Gjithsesi duhej pritur vdekja e Enver Hoxhës në prill të vitit 1985, ardhja në pushtet e ndjekësit të tij, Ramiz Alisë, dhe një ndryshim i gjendjes politike ndërkombëtare, për të parë një frymë sado të vakët tolerance kundrejt fesë, që shikohej nga udhëheqësi i ri si “çështje private, familjare”<sup>302</sup>.

---

<sup>301</sup> Lidhur më këtë, shih analizën e detajuar dhe shtrruese të Giovanni Barberini-t, një prej protagonistëve të Konferencës së Helsinkit si dhe një prej studiuesve më të mëdhenj të çështjeve mbi lirinë fetare në vendet e Lindjes, gjatë periudhës komuniste: *La politica del dialogo. Le carte Casaroli sull'Ostpolitik vaticana* (a cura di Giovanni Barberini), Bologna, Il Mulino, 2008; G. BARBERINI, *Pagine di storia contemporanea. La Santa Sede alla Conferenza di Helsinki*, Cantagalli Editore Siena 2010; ID. *Pagine di storia contemporanea. La Santa Sede alla Conferenza di Helsinki*, Cantagalli Siena, 2010; ID, *L'Ostpolitik della Santa Sede. Un dialogo lungo e faticoso*, Bologna, Il Mulino, 2007; ID., *Al di là della cortina di ferro. Ricordi di un viaggiatore solitario*, Volumnia Perugia, 2005 ID., *La libertà di religione nel processo di democraticizzazione degli Stati dell'Europa centrale ed orientale*, in S. FERRARI – W. COLE DURHAM JR. – E. A. SEWELL, *Diritto e religione nell'Europa post-comunista*, Bologna, 2004, pp. 9-30; ID., *La libertà religiosa nell'Europa centro-orientale, Diritti umani e libertà religiosa*, (a cura di Vittorio Possenti) Rubettino, Soveria Mannelli 2010, 117 ss.; ID., *L'ibertà di religione nell'Europa centro-orientale*. Spunti di riflessione, . *Libertà religiosa e diritti umani nell'Est Europa*, (a cura di G. Cimbalo e F. Botti), Bononia University Press, Bologna, 2008. 141. Të shihen, gjithashtu, studimet e shumta dhe të vyera të Giovanni Barberini-t, lidhur me çështjet e legjislacionet në fushë të fesë për vendet e Europës Lindore, shkëputur nga: *Pubblicazioni di Giovanni Barberini, Scritti in onore di Giovanni Barberini* (a cura di A. Talamanca e M. Ventura), Giappichelli Editore, Torino 2010, XXXIII – XLIV

<sup>302</sup> Ramiz Alia, pas një përkushtimi të gjatë në hallkat e partisë së punës së Shqipërisë, në vitin 1991, bëhet kreu i shtetit. Pas vdekjes së Enver Hoxhës, në vitin 1985, bëhet sekretar i partisë. Edhe pse shpalli besnikëri ndaj rrugës së paraardhësit të tij, i lëshoi rrugë njëfarë reformizmi të ngadalshëm, të karakterizuar nga decentralizimi ekonomik dhe nga ndërmarrja e lirë e punëtorëve shqiptarë. Reformat e zbatuara gjatë viteve 1985-1989 ishin të pamjaftueshme për të shmangur shkërmoqjen e sistemit ekonomik. I rizgjedhur në krye të shtetit, pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 1987, tre vjet më vonë, me

Një ndër masat e para domethënëse merret në vitin 1988 dhe ka të bëjë me autorizimin e klerikëve, në emigrim, për t'u kthyer në Shqipëri për ushtrimin e funksioneve fetare, një shenjë dobësie kjo që shfaqet nga regjimi i lodhur tashmë. Ateizmi i shtetit kishte dështuar jo vetëm për shkak të paaftësisë së çdo politike shtypëse, sidomos kur kjo lidhet me lirinë e ndërgjegjes dhe të mendimit, por për shkak të rrënimit të gjendjes ekonomike dhe të çmimit tejet të lartë që struktura perandorake e URSS-së mbante mbi vete. Ekonomia perëndimore kishte marrë një hov të shpejtë transformimi që e bënte të pamundur mbajtjen e ritmit të ndryshimit dhe të rregullave të tregut. Po ashtu, zhvillimi i komunikimit publik, marrja e programeve televizive nga Lindja, shtrirja gjithnjë e më e madhe e komunikimit nëpërmjet rrjeteve telematike, sollën modele të reja të transmetimit të mesazhit kulturor dhe qasje ndaj një stili të ri jete, duke e sjellë gjithnjë e më afër idenë se një shoqëri ndryshe është e mundur.

Shqipëria, falë pozicionit të saj gjeografik, nuk mund t'i shpëtonte magjepsjes së Perëndimit, ndërkohë që ekonomia e saj e varfër dhe e degraduar kishte marrë rrokullisjen. Gjithsesi, politikat demografike të regjimit kishin ndikuar në rritjen e popullsisë, që tashmë përbëhej nga një masë e madhe të rinjsh, mijëra prej të cilëve morën rrugën e eksodit drejt Italisë dhe Europës, për shkak të krizës së sistemit politik shqiptar. Me heqjen e kufijve, u rikthyen në vend besimet fetare.

---

krizën e madhe që përfshiu vendet e Europës Lindore, i lëshoi rrugë pluralizmit. I rizgjedhur sërish president i Republikës në vitin 1991, dha dorëheqjen me 3 prill 1992 pas fitores elektorale të partisë demokratike të Shqipërisë të themeluar nga Sali Berisha, një ish komunist. I arrestuar nën akuzën për korrupsion dhe i liruar nga burgu në muajin korrik të vitit 1995, u dënua më pas me nëntë vjet burg. Jo pa interes janë kujtimet e tij. R. ALIA, *Jeta ime*, Toena, Tiranë, 2010.



## Kreu III

### Stina e marrëveshjeve: Shqipëria rikthehet në origjinë

Përmbledhje: 3. 1. Rilindja e lirisë së besimit, e ndërgjegjes dhe e pluralizmit fetar. -3. 2. Ligji mbi shoqatat jofitimprurëse dhe shfrytëzimi i tij për rregullimin e marrëdhënieve me kultet. -3. 3. Veçanëtia e modelit shqiptar. -3. 4. Rilindja e Kishës katolike në Shqipëri. -3. 5. Marrëveshjet e dakordësisë me Kishën katolike. Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë harton statutin e vet. -3. 6. Marrëveshjet e bashkëpunimit me myslimanët Sunitë, Bektashian dhe Kishën ortodokse autoqefale të Shqipërisë.

#### 3. 1. Rilindja e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe pluralizmit fetar

Rënia e sistemeve politike në Europën Lindore bëri që, në vitin 1990, edhe në Shqipëri, grupet fetare t'u rikthehen veprimtarive të tyre dhe të fillojnë të riorganizohen<sup>303</sup>.

---

<sup>303</sup> Kisha katolike, ajo Ortodokse dhe Myslimanët Sunitë marrin ndihma nga strukturat përkatëse të kultit, të cilat veprojnë në nivel ndërkombëtar. Por, ndërsa dy të parat mund t'i qasen një kleri të formësuar tashmë në vendet e tjera dhe që nuk paraqet dallime thelbësore në formimin kulturor dhe fetar lidhur me parimet e besimeve përkatëse, kjo nuk mund të thuhet për myslimanët Sunitë të cilët gjenden përballë një kleri të huaj për traditën islame shqiptare, që shfaqet e moderuar dhe dialoguese me perëndimin. Gjatë kësaj periudhe është shumë e ndjeshme mësymja e penetrimit islam, sidomos asaj *wahabita*, nëpërmjet klerikëve të formuar në Universitetin e Kajros dhe në universitete të tjera egjiptiane. Shih: X. BOUGAREL. – N. CLAYER, (sous la direction de), *Le Nouvel*

Me rënien e regjimit, u miratua me datë 29 prill 1991 ligji nr. 7.491, i cili do të funksiononte si Kushtetutë e përkohshme, e cila përmblante dispozitat themelore që, siç dëshmon neni 44 i po këtij ligji, do të mbetej në fuqi deri në hartimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, projekt i cili do të vihej në zbatim nga një komision i veçantë i emëruar nga Asambleja Kombëtare<sup>304</sup>. Në këtë kohë, i hapet rrugë veprimtarisë së partneritetit për pranimin e Shqipërisë në Këshillin e Europës dhe zë fill bashkëpunimi i shtetit shqiptar me Komisionin e Venecias për hartimin e Kushtetutës së re<sup>305</sup>. Negociatat hasin në jo pak vështirësi: zhvillohen mbledhje të njëpasnjëshme që synojnë plotësimin e ligjit kushtetues të vitit 1991, nëpërmjet ligjit në fuqi "*Për dispozitat kryesore kushtetuese*", i cili i shton të parit një kapitull të posaçëm lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive themelore dhe të të drejtave njerëzore, në mënyrë që parime të tilla të mund të përfshihen në kushtetutën e ardhshme<sup>306</sup>.

---

*Islam Balkanique. Les musulmans, acteurs du post-communisme. 1990-2000*, Paris, 2001; N. H. THIRLWALL, *Islam in the Balkans. Religion and society between Europe and the Arab World*, Hartus & C, London, 1993. Edhe Bektashinjtë i kthehen rindërtimit të kultit të tyre duke u mbështetur në ato pak burime që u kanë mbetur si dhe në traditën dhe në gjithçka ka mbetur nga persekutimi ateist. Për fazat dhe vështirësitë e kësaj ripërtëritjeje: A. POPOVIC., *Le confraternite sufi nella regione balcanica...cit.*, 198-199.

<sup>304</sup> *Për dispozitat kryesore kushtetuese*, Ligji nr. 7491, 29 .4. 1991. "Gazeta Zyrtare" n° 4, korrik 1991, 1, <http://licodu.cois.it/619/view>.

<sup>305</sup> Zgjedhjet e zhvilluara në mars 1991, do t'u siguronin, mes shumë kundërshtive, 169 nga 250 vende Partisë komuniste dhe aleatëve të saj. Pavarësisht kësaj, vendi hyn në Këshillin të Europës dhe pranon Kartën e Helsinkit duke i hapur rrugë një bashkëpunimi konkret me Këshillin, me qëllim modifikimin e rregullimit juridik dhe të hartimit të Kushtetutës së re. Për një vështrim të përgjithshëm rreth tipareve të rregullave juridike post komuniste shih G. AJANI, *Il modello post-socialista*, Torino, Giappichelli 2008, *passim*.

<sup>306</sup> *Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, 29. 4. 1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"*, Ligji nr.7692, 31 .3. 1993, <http://licodu.cois.it/615/view> . Ligji për "Të drejtat dhe liritë themelore", e sheh të nevojshme të kujtojë në parathënie "Duke marrë parasysh se, gjatë diktaturës së egër e tejet çnjerëzore 46-vjeçare të partisë-shtet në Shqipëri janë shkelur e mohuar, nëpërmjet terrorit shtetëror, të drejtat civile e politike, ekonomike, sociale e kulturore, si edhe liritë më themelore të njeriut; Duke marrë parasysh se respektimi dhe gëzimi i gjithanshëm i këtyre të drejtave e lirive përbën një nga aspiratat më të larta të popullit shqiptar dhe një nga parakushtet e domosdoshme për garantimin e lirisë, drejtësisë sociale dhe përparimit demokratik të shoqërisë sonë". Lidhur me

Në këtë mënyrë, Kushtetuta e re u përgjigjet kritereve të vendosura nga Këshilli i Europës për vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e këtij organizmi, por nuk mund të konsiderohet *octroyée*, siç ka ndodhur me disa vende ballkanike, veçanërisht sa i përket natyrës juridike dhe lirisë së komuniteteve fetare si dhe mbrojtjes së lirisë fetare, vetjake dhe kolektive, sepse kjo kushtetutë i përmbahet një linje vazhdimësie me përvojën juridike të shtetit shqiptar që nga koha e pavarësisë së tij.

Rikonfirmohet natyra laike e shtetit, e përcaktuar që në statutin e vitit 1914, si dhe forma i rinjohjes së personalitetit juridik, të cilit i nënshtrohen komunitetet fetare. Pra, Kushtetuta mbështetet në trungun e traditës juridike të vendit, e cila që në vitin 1923 ka shfaqur një tipar dallues të saj, pluralizmin e besimeve fetare, tipar ky që e bën Shqipërinë një rast unik mes vendeve me shumicë islame.

E gjithë kjo është në të mirë të idesë se islami shqiptar është një islam europian krejt i ndryshëm nga ai i praktikuar në vende të tjera të botës. Këto tipare të veçanta të qytetërimit juridik dhe institucional, kjo përkujdesje kundrejt pluralizmit fetar dhe laicizmit të shtetit, i sigurojnë Shqipërisë atë stabilizim shoqëror që e ka mbrojtur nga luftërat etniko-fetare, të cilat kanë karakterizuar hapësirën sllave të Ballkanit<sup>307</sup>. Pasojat e kësaj zgjedhjeje janë të dukshme në territorin e shtetit shqiptar, sidomos nëse hidhet shikimi në territoret fqinje të banuara nga komunitete të shumta me gjuhë dhe etni shqiptare, si në Kosovë dhe Maqedoni, ku, gjatë shekullit të kaluar, mbizotërimi i

---

këtë shih: A. HYSENI, *Të drejtat e njeriut në kushtetutën Shqiptare*, Dita, Tirana, 2000, si dhe: G. DAMMACCO, *Diritti e libertà dell'uomo nell'Albania democratica, Principio pattizio e realtà religiose minoritarie*, (a cura di V. Parlato – G. B. Varnier), Giappichelli, Torino, 1995, 385-299, edhe pse një pjesë e mirë e vërejtjeve janë bërë para mbylljes së debatit për reformën kushtetuese. Vetëm në vitin 1998, Shqipëria, e fundit mes vendeve të Europës lindore, ndërmoi nismën për miratimin e kushtetutës dhe ia doli mbanë vetëm kur konflikti mes palëve të ndryshme të shoqërisë u sheshua, të paktën në nivel social, por ende jo politikisht. A. BIAGINI, *Storia dell'Albania dalle origini ai nostri giorni*, Bompiani, Milano 1998.

<sup>307</sup> *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, <http://licodu.cois.it/304/view>. Për më tepër shih: ALB JURIS, *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me interpretime të gjykatës kushtetuese, Tiranë, 2008*.

popullsisë shqipfolëse nuk ka gjetur mbështetje në ndonjë strukturë juridike, e aftë të përcjellë edukatë pluraliste dhe tolerancë për të promovuar bashkëjetesën në këto treva.

Nga ana tjetër, mungesa e konflikteve ndërfaqetare së bashku me kohezionin kombëtar, ka luajtur një rol kyç në shmangien e luftërave fetare në territorin shqiptar, një vatër kjo mjaft e nxehtë për Ballkanin perëndimor.

Pavarësisht kësaj, me rënien e regjimit u vu re mungesa e mjeteve juridike për administrimin dhe rregullimin e veprimtarisë së komuniteteve fetare, të cilat u sforcuan të paraqiteshin nën forma të tjera apo duke përdorur institute të caktuara për aktivitete të tjera, në mënyrë që të mund të mbulonin boshllëkun normativ aktual dhe t'i hapnin rrugë misionit të tyre në territorin e shtetit shqiptar.

Rruga u çel me Kishën katolike e cila, që më 7 mars 1991, datë që përkon me shpërnguljen në masë të shqiptarëve drejt Italisë, u ofrua t'u vinte në ndihmë emigrantëve nëpërmjet strukturave të Karitasit italian. Puna e shumtë dhe pozitive për ndihmën dhe mikpritjen e emigrantëve në Itali, bëri që organizata e Karitasit të akreditohej edhe pranë autoriteteve shqiptare, duke i hapur rrugë kështu një nisme që do të sjellë në territorin shqiptar jo vetëm Karitasin italian, por edhe atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zvicrës, Gjermanisë, Francës, Anglisë dhe Spanjës. U hartuan programe të posaçme rehabilitimi edhe me ndihmën e Komunitetit European, dhe, nën këtë strehë, u zhvillua një sipërmarrje nismash që përfshinë shumë shpejt edhe qytetarët shqiptarë, deri aty sa, në vitin 1993, Ministria e Shëndetësisë lëshoi një urdhër të posaçëm për regjistrimin e Karitasit shqiptar në formën juridike të "Organizatës" që e zhvillon aktivitetin e saj kryesisht në fushën e shëndetësisë<sup>308</sup>.

Një mënyrë tjetër veprimi gjendet, fillimisht, në ligjin 7512, datë 10 gusht 1991 "*Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe*

---

<sup>308</sup> Duhej pritur viti 1995 që karitasi shqiptar, me zgjerimin e veprimtarisë së tij dhe deklarin në statutin e vet të qënit një strukturë e kishës katolike shqiptare, të shihte mundësinë e regjistrimit, duke u mbështetur në kodin civil pranë gjykatës së shkallës së parë të rrethit Tiranë.

*privatizimit*<sup>309</sup>, që ka si qëllim të formësojë një rend të ri ekonomik e t'i hapë rrugë kalimit nga një sistem me ekonomi të planifikuar dhe të kontrolluar nga shteti, drejt një sistemi ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë, sipas neneve 10,11,12,16 të ligjit nr. 7491 datë 29 prill 1991 "*Për dispozitat kryesore kushtetuese*".

Disa komunitete fetare, sidomos të ashtuquajturat "kultet e reja", kërkuar prej gjykatave të rretheve regjistrimin si organizata shoqërore jofitimprurëse, sipas ligjit nr. 2362, të datës 16 nëntor 1956 "*Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike*"<sup>310</sup>, ligj ky që nuk u shfuqizua asnjëherë, duke krijuar kështu një listë të gjatë shoqatash të krijuara në kohë trazirash për vendin. Në janar të vitit 1993 hyri në fuqi ligji "*Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare*"<sup>311</sup>. Duke shfrytëzuar edhe këtë ligj, disa gjykata vendore parashikuan regjistrimin e enteve fetare, por duke mos qenë një ligj tërësisht i përshtatur për natyrën e tyre, rezultoi e vështirë të bëhej dallimi mes enteve fitimprurëse dhe atyre jofitimprurëse, pavarësisht mundësisë për t'iu referuar ligjit nr. 7695, datë 7.4.1993, "*Për fondacionet*"<sup>312</sup>.

Një amulli e tillë në veprimet e administratës, gjykatave dhe të organeve politike, mund të kuptohet nëse mbajmë parasysh se në

---

<sup>309</sup> "*Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, ndërmarrjes së lirë, aktivitetit privat, të pavarur dhe të privatizuar*" Ky ligj, edhe pse nuk kishte të bënte qartazi me aktivitete të karakterit fetar, deri në vitin 1993 u bë një ndër rregullat juridike të përdorura nga disa ente fetare për njohjen e personalitetit juridik civil. Sa u përket enteve të kishës katolike, vetëm ndonjëri prej tyre ka përdorur këtë normë që u vishte enteve veçori të tilla që nuk përputheshin me ç'parashikohej në të drejtën kanonike.

<sup>310</sup> Ligji n. 2362, del 16.11.1956 "*Mbi organizatat shoqërore jofitimprurëse*" Shih: <http://licodu.cois.it/694/view>. Sidoqoftë, kjo normë do të shfuqizohet haptazi nga neni 1167 i kodit civil të vitit 1994

<sup>311</sup> Ligj nr. 7667, datë 28.1.1993 "*Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare*. Vendimet juridike dhe regjistrat janë mbajtur gjithnjë pranë gjykatave të rretheve deri në vitin 2001. Me miratimin e ligjit mbi organizatat jofitimprurëse, regjistrat mbahen pranë gjykatës së Tiranës, së bashku me regjistrat e organizatave joqeveritare apo organizatat jofitimprurëse dhe entet fetare të besimeve të ndryshme.

<sup>312</sup> Sa i përket kishës katolike, pranimi i një zgjidhjeje të tillë, binte ndesh me ç'parashikohej në të drejtën kanonike



ç'pështjellim të thellë, qoftë edhe në nivel institucional gjendej vendi gjatë kësaj kohe. Pa dyshim, kishte një boshllëk legjislativ që aty për aty mbushej me norma dhe rregulla të përkohshme me qëllim që t'u jepte zgjidhje kërkesave të komunitetit dhe të grupeve fetare për zhvillimin e veprimtarive të tyre. Sidoqoftë, në kuadrin e ri institucional, ekzistenca e komuniteteve fetare dhe mbrojtja e lirisë së besimit gjen sërish garanci në parimet kushtetuese, çka vërehet edhe në Kodin e ri Civil, të vitit 1994, ku në nenin 39 thuhet se shoqatat janë grupime shoqërore që ndjekin një qëllim politik, shkencor, kulturor, sportiv, fetar, bamirës apo çdo lloj qëllimi tjetër, përveç atij fitimprurës<sup>313</sup>. Kjo dëshmon se komunitetet fetare përfshihen në ato grupime shoqërore, veprimtaria e të cilave rregullohet nga legjislacioni i së drejtës së përbashkët<sup>314</sup>. Bashkë me garancitë që i ofron ligji së drejtës së tyre për t'u organizuar, shtohet edhe mundësia e rihapjes së veprimtarisë së komuniteteve fetare, duke filluar që me çeljen e procedurave për kthimin dhe kompensimin e pasurive të konfiskuara që në krye të vitit 1945 e që zgjati deri në zhbërjen e plotë të tyre në vitin 1967<sup>315</sup>. Në zanafillë bëhej fjalë për çështje të karakterit të përgjithshëm që kishin të bënin kryesisht me

---

<sup>313</sup> *Kodil Civil*, Ligji, nr. 7850, 29 korrik 1994, neni 39.

<sup>314</sup> Risitë e sjella nga ligji i ri, ka gjasa të mos kenë krijuar kushtet e nevojshme për të fituar njohjen juridike, së paku për Kishën katolike, pasi kërkohej zotërimi i disa cilësive dhe masa shtërnguese për regjistrimin e shumë enteve të saj. Normat e përmendura deri këtu kishin të bënin me natyrën juridike të shoqatave në varësi të aktiviteteve që ushtronin ato dhe jo aq lidhur me funksionin që ushtrojnë ata në strukturat fetare për kryerjen e shërbesave të kultit. Për këtë arsye, vetëm në disa raste është dhënë njohja zyrtare, kryesisht për drejtimin e shkollave, ndërsa për ente të tjera si: famullitë, dioqezat, institutet fetare etj., nuk kanë përfituar njohje zyrtare deri në vitin 2005, edhe për shkak të mospërputhjes mes normave civile dhe të Drejtës kanonike.

<sup>315</sup> Problemi i rikthimit të të mirave të konfiskuara është i përbashkët për të gjitha vendet e Europës Lindore, të cilat përjetuan përvojën e Republikave socialiste. Legjislacioni shqiptar që rregullon këto çështje është i tejmbushur dhe i ndërlikuar, por duhet pranuar që, edhe pse shumë probleme mbeten të hapura, një pjese të tyre u është dhënë zgjidhje, më shumë se në vendet e tjera ish socialiste, si përsa i përket rikthimit të të mirave të konfiskuara, ashtu edhe për dëmshpërblimin e të shpronësuarve. Lidhur me këtë, shih: *Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7699, 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore"*, Ligj Nr.7981, 27.7.1995, <http://licodu.cois.it/591/view>

pronësinë e tokës<sup>316</sup>, pasi në kohën e konfiskimit, ndër të mirat kryesore ishte toka, pas kësaj vinte radha e ndërtesave të konfiskuara për t'u kthyer në pronë e zyra publike<sup>317</sup>. Për t'u marrë me këtë çështje kaq delikate u ngrit “*Agjensia për kthimin dhe dëmshpërblimin e pasurisë*”, së cilës i drejtohen kërkesat përkatëse për rikthimin e të mirave të konfiskuara, kërkesë e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm si dëshmi e pronësisë së hershme<sup>318</sup>. Sidoqoftë, rikthimi i pronës komuniteteve fetare hasi në vështirësi jo të vogla, prandaj në vitin 1993, në bazë të nenit 16, të ligjit 7491 “*Për dispozitat kryesore kushtetuese, hyn në fuqi ligji “Për kthimin dhe kompensimin e tokave ish-pronarëve*”<sup>319</sup>. Neni 1 parashikon që ky ligj u njihet ish pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre legjitimë të drejtën e pronësisë mbi të mirat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas ligjit, masave administrative apo vendimeve gjyqësore të zbatuara pas datës 29 nëntor 1944, si dhe përcakton mënyrat për rikthimin dhe kompensimin e tyre. Sipas

---

<sup>316</sup> *Për tokën*, Ligj Nr.7695, 7.4.1993, <http://licodu.cois.it/599/view>, *Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit* <http://licodu.cois.it/600/view>

<sup>317</sup> *Për privatizimin e banesave shtetërore* <http://licodu.cois.it/601/view>

<sup>318</sup> Kjo agjensi e filloi veprimtarinë e saj në vitin 1991. Paraqitja e kërkesave mund të bëhet në një hark kohor prej njëzet vjetësh, pra brenda vitit 2011, për shkak të vështirësisë së sigurimit të dokumentacionit që dëshmon zotërimin e hershëm të të mirave të pretenduara. Problem më vete përbën sekuestrimi i relikeve dhe dokumentacionit historik, që aso kohe u bënë pjesë e pasurisë artistike dhe historike kombëtare. Për më gjerë, shih: *Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7699, 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”*, Ligj Nr.7981, 27.7.1995, <http://licodu.cois.it/591/view>; *Për tokën*, Ligj Nr.7695, 7.4.1993, <http://licodu.cois.it/599/view>, *Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit* <http://licodu.cois.it/600/view>; *Për privatizimin e banesave shtetërore* <http://licodu.cois.it/601/view>. Këto norma u riorganizuan dhe bashkërenduan me ligje që u miratuan në vijim, duke ardhur deri në ligjin e vitit 2004 që rregullon ushtrimin e funksioneve të agjensisë: “*Për disa ndryshime në vendimin nr.459, 23.9.1999 të këshillit të ministrave “për krijimin e komitetit shtetëror për kultet”*”, <http://licodu.cois.it/604/view>: Për ligjin përkatës lidhur me rolin dhe veprimtarinë e agjensisë, shih: *Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave*, Ligj, Nr. 9235, 29.7.2004, <http://www.akkp.gov.al/ligje.html>

<sup>319</sup> *Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve*, Ligj Nr. 7698, 15. 04. 1993, Gazeta Zyrtare n° 5, 1993, <http://licodu.cois.it/602/view>.

nenit 2, me pronë kuptohet prona e paluajtshme si ajo e tokës, ndërtesat dhe çdo gjë tjetër që lidhet pandashmërisht me të, si, për shembull, godinat për banim, fabrikat, dyqanet, magazinat etj. Ky ligj nuk përfshin pasurinë e paluajtshme siç parashikohet në ligjin e sipërpërmendur “Për tokën”.

Gjithsesi, drafti ka ende karakter shumë të përgjithshëm, ndaj në vitin 1995 u pa e arsyeshme të hyjnë në fuqi rregulla të veçanta që u mundësojnë komuniteteve fetare kthimin e pronave bujqësore të konfiskuara në vitin 1967<sup>320</sup>, ndërsa për pronat e tjera parashikohet kompensim ose transferim të tyre pa zhdëmtim, nëse çmohet se prona ka ruajtur të njëjtën vlerë të mëparshme<sup>321</sup>. Këto pasuri të rikthyera, shpeshherë në gjendje të denigruar, nuk mund të mos ngrënë problemin e mirëmbajtjes dhe ruajtjes së tyre<sup>322</sup>.

Lidhur me veprimtarinë shoqërore të komuniteteve fetare dhe me ushtrimin e të drejtave të tyre për proselitizëm, së pari vjen në ndihmë dekreti i Presidentit të Republikës nr. 506 i datës 3 prill 1993, nëpërmjet të cilit i shtohet një kapitull ligjit kushtetues nr. 7491 të vitit 1991 që, me 41 nenet e tij, garanton të drejta të tilla si: e drejta e jetës, e shprehjes së mendimit, e ankimit, e zgjedhjes, e organizimit, etj<sup>323</sup>. Në të njëjtin vit u lejohet komuniteteve fetare përdorimi i mjeteve të komunikimit në masë, duke u përjashtuar nga detyrimi i taksave për përdorimin e mjeteve radiotelevizive<sup>324</sup>. Gjithashtu lejohet, me anë të një ligji të posaçëm, mësimi i fesë në shkolla publike<sup>325</sup>.

---

<sup>320</sup> *Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7699, 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, Ligj, Nr.7981, 27. 7. 1995, <http://licodu.cois.it/598/view>.*

<sup>321</sup> *Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, Legj Nr.8053, 21.12.1995, <http://licodu.cois.it/603/view>*

<sup>322</sup> *Për pyjet dhe shërbimin pyjor, Ligj Nr. 9385, datë 4. 5. 2005 <http://licodu.cois.it/590/view>.*

<sup>323</sup> *Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, 29.4.1991 “për dispozitat kryesore kushtetuese”, Ligji Nr.7692, 31.3.1993, <http://licodu.cois.it/615/view>*

<sup>324</sup> *Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, Ligj Nr.7680, 3.3.1993, <http://licodu.cois.it/589/view>,*

<sup>325</sup> Lidhur me mësimin e fesë në shkolla, të shihet edhe neni 57, pika 6 e kushtetutës së vitit 1991, ku thuhet: “Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jo publike të çdo niveli, që ngrihen dhe funksionojnë në bazë të ligjit”. Kjo nënkupton sanksionimin e shkollave private dhe fetare. Në pikën 7

Në vitin 1995 parashikohet miratimi i Kodit të ri Penal, çka do të sjellë gradualisht stabilizimin e institucioneve, por ende jo në nivel politik, pasi vendi u është nënshtruar tërësisht shoqërive financiare që zhvasin burimet e tij dhe mashtrojnë një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë<sup>326</sup>. Gjithsesi, Kodi i ri u përafrohet atyre të Europës Perëndimore, duke iu shmangur ndjeshëm traditës juridike shqiptare, pa përjashtuar këtu edhe kodin e mbretit Zog, apo kanunet. Duke qenë se ky studim nuk ka të bëjë me analizën e kodeve, është e mjaftueshme të pohojmë vetëm se, përta i përket Kodit Civil, rikthimi i mënyrave për fitimin e personalitetit juridik civil dhe të pasurisë në përgjithësi, ndikojnë në mënyrë vendimtare në jetën dhe veprimtarinë e komuniteteve fetare<sup>327</sup>.

Ushtrimi të lirisë së fesë, të ndërgjegjes dhe mbrojtjes së tyre u kushtohet kreu X, (nenet 131-133) të Kodit Penal<sup>328</sup>. Që në krye të këtyre neneve dënohet pengimi i veprimtarisë së organizatave fetare dhe e ushtrimit të aktiviteteve të tyre. Dënimi i parashikuar varion nga marrja e gjobës, deri në tre vjet heqje lirie. Po ashtu, në

---

thuhet, gjithashtu: “Autonomia dhe liria akademike e institucioneve të larta garantohet me ligj”.

<sup>326</sup> A. PUTO, *Piramidi Albania: chi c'è sotto la piramide?*, Osservatorio Balcani e Caucaso, 5 aprile 2005; C. JAVIS, *The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes*, “Finance & Development”, Volume 37, Number 1, March 2000; J. E. PETTIFER, M. VICKERS, *The Albanian question: reshaping the Balkans*, I.B. Tauris, London, 2007.

<sup>327</sup> Edhe këtu, është me interes që lidhur me këto tematika, të rindërtojmë ndërthurjen mes traditës dhe modernizmit, por duke e parë Shqipërinë në kuadrin e përgjithshëm të krizës së të drejtës penale që i buron nga sovjetizmi e, njëkohësisht, në përballjen e saj të re me frymën perëndimore dhe veprimtarinë e Komisionit të Venecias gjatë përpjekjeve për riformim. Për më gjerë, shih: M. DEL TUFO, *Le riforme penali nei paesi dell'Est: uno sguardo di sintesi, Il diritto penale nella prospettiva europea*, Milano, Giuffrè, 2005, 5-14; G. AJANI, *Il modello post-socialista*, Giappichelli Torino, 2008. A. GAMBARO *Sistemi giuridici comparati, Trattato di Diritto Comparato*, diretto da R. Sacco, Torino, UTET, 2002, 421 ss.

<sup>328</sup> *Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr.7895, 27.1.1995*, <http://licodu.cois.it/>. Lidhur me variantin e përkthyer në italisht dhe një analizë në parathënien e tij, shih: *Il Codice Penale della Repubblica d'Albania*, (a cura di S. Vinciguerra) Cedam, Padova, 2008, me bashkëpunëtorë: E. R. Belfiore, M. Bertoli, D. Fondaroli, G. Fornasari, A. Manna, M. Pelissero, P. Pittaro, A. Rossi.

nenin vijues sanksionohet dëmtimi i vendeve të kultit, që shkakton humbjen e pjeshme apo të plotë të vlerave të besimit në fjalë.

Të gjitha këto masa mëtojnë të luftojnë çdo lloj tentative për zhdukjen dhe çrrënjosjen e pranishme kulturore dhe fetare të kulteve të pranishme historikisht në këtë vend dhe të vulosë identitetin e tyre. Për të njëjtat arsye, neni 133 ndëshkon këdo që pengon apo ndalon kryerjen e ceremonive fetare dhe pjesëmarrjen në to të popullit. Veç kësaj, mbrojtja shtrihet edhe mbi lirinë e shprehjes së bindjeve fetare. Kush bie ndesh me këtë, thyen normat penale dhe dënohet me gjobë ose me heqje lirie deri në një vit. Parashikimet e kreut X të Kodit të sipërpërmendur lidhen ngushtë me ç'parashikon neni 73 i Kodit Penal që ndalon krimin e genocidit duke parashikuar për të nga dhjetë vjet deri në burgim të përjetshëm, apo dhe dënim me vdekje<sup>329</sup>. I njëjti dënim parashikohet në nenin 74 për "*Krime kundër njerëzimit*"<sup>330</sup>. Në kategorinë e këtij krimi përfshihet edhe dhunimi i varreve apo varrezave (neni 118), qoftë kjo edhe vjedhje sendesh apo mungesë respekti kundrejt të vdekurit: dënimi për krime të tilla varion nga marrja e gjobës, deri në pesë vjet heqje lirie, në varësi të shkallës së dhunimit e cila arrin kulmin e saj kur dhunuesi e kryen veprën e tij penale i shtyrë nga përkatësia fetare apo etnike e të vdekurit.

Kjo sërë krimesh gjen pasqyrimin e vet në nenin 265, sipas të cilit dënohen të gjithë ata që nxisin konflikte kombëtare, racore apo urrejtje dhe konflikte fetare, qoftë edhe nëpërmjet përgatitjes, propagandës apo ruajtjes me qëllim propagande të shkrimeve me përmbajtje të tillë. Dënimi për këto raste varion nga marrja e

---

<sup>329</sup> Neni 73. Genocidi." Zbatimi i një plani të paramenduar që synon shkatërrimin tërësisht apo pjesërisht të një grupi nacional, etnik, racial apo fetar i drejtuar kundër anëtarëve të grupit dhe i shoqëruar me veprat që vijnë, si: vrasje me dashje të anëtarëve të grupit, dëmtime të rënda fizike dhe psikike, vendosja në kushte jetese të rënda që shkaktojnë shkatërrimin fizik, zbatimi i masave që synojnë pengimin e lindjeve, si dhe transferimi i detyrueshëm i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm. <http://licodu.cois.it/300/view>

<sup>330</sup> Neni 74. Krime kundër njerëzimit." Vrasjet, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, kundër një grupi të popullsisë civile për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm" *Ibidem*.

gjobës deri në dhjetë vjet heqje lirie. Masa të tilla i vijnë në mbrojtje pluralizmit etnik dhe fetar, bashkëjetesës, barazisë mes qytetarëve.

Këto vlera duhen mbrojtur duke luftuar çdo lloj diskriminimi si në nivel personal, ashtu edhe kolektiv që cytet nga përkatësia fetare dhe që mund të denigrojë në krijimin e avantazheve apo disavantazheve, ose në mohimin e të drejtave apo përfitimeve të parashikuara në ligj. Sipas nenit 253 të Kodit Penal, dënimi për këtë vepër varion nga gjobitja, deri në pesë vjet heqje lirie<sup>331</sup>.

Siç mund të vihet re nga analizimi i këtyre normave, është shfrytëzuar maksimalisht rregullimi i çështjeve të tilla nëpërmjet Kodit Penal, në mënyrë që t'i vihet fre, medoemos, çdo lloj nisme, brenda territorit shqiptar, që ka të bëjë me spastrimin etnik dhe fetar, siç ndodhi me territoret fqinje të Ballkanit. Kombi shqiptar mund të ekzistojë nëse mozaiku i përkatësive fetare bashkëjeton paqësisht në emër të interesit të përbashkët dhe të ndërgjegjes së plotë të të qenit pjesë e një kombi të vetëm, të një populli të vetëm. Përkatësia fetare është e papërfillshme, kur bëhet fjalë për gëzimin e të drejtës së lirisë. Këtë e konfirmon edhe neni 11 i Kodit Penal, që ndalon ekstradimin e personit, kur kërcënohet liria fetare e tij dhe neni 50, që përfshin si rrethana rënduese të veprës penale çdo dhunim ligji për shkak të abuzimit me detyrën që rrjedh nga *statusi* apo funksioni fetar i personit që ka kryer këtë krim<sup>332</sup>.

Nuk të habit fakti që Kodi Penal i vitit 1995 mori përsipër ndryshime kaq të thella për një popull që po kalonte nga një ateizëm i skajshëm drejt mbrojtjes së të drejtave dhe lirisë fetare, pikërisht për t'i paraprirë çdo lloj lufte fetare. Një tranzicion i tillë, sipas këndvështrimit të autorit të këtyre radhëve, u bë i mundur edhe falë rolit pedagogjik të së drejtës dhe parimeve të blatuara prej kohësh në statutet demokratike të katër komuniteteve më të mëdha fetare<sup>333</sup>.

Në këto rrethana, zuri fill debati për hartimin e Kushtetutës së re. U shqyrtuan, u votuan dhe u kthyen mbrapsht disa drafte të përpunuara në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, që herë

---

<sup>331</sup> *Ibidem*.

<sup>332</sup> *Ibidem*

<sup>333</sup> G. CIMBALO, *L'esperienza dell'Islam dell'Est Europa...cit., passim*.

pas here, jepte vlerësimin e vet rreth vendimeve të parlamentit dhe të komisioneve të ngritura prej saj<sup>334</sup>. Kjo përbën edhe një prej arsyeve se pse miratimi i kushtetutës nuk mund të realizohej para vitit 1998. Në nenin 3 të saj renditen parimet themelore mbi të cilat është ndërtuar shteti shqiptar, ndër të cilët mund të përmendim bashkëjetesën fetare si dhe detyrimin e shtetit për të respektuar dhe mbrojtur parime të tilla. Komunitetet fetare konsiderohen si pjesë e strukturës shoqërore mbi të cilën ndërtohet shteti shqiptar.

---

<sup>334</sup> Në vitin 1994, komisioni paraqiti përshtypjet e veta lidhur me projektin e kushtetutës të hedhur në referendum, por të pavotuar. Me rëndësi është neni 7 i projekt kushtetutës, i cili ndalonte përdorimin e fesë për qëllime politike e në mënyrë të veçantë mundësinë e krijimit të partive politike me sfond fetar, pasi kjo do të kishte ndikim të tepruar duke e lidhur elektoratin pas parimeve morale dhe etike, gjë që ishte ndaluar që me ligjin e vitit 1991. Një pikë tjetër me rëndësi, është neni 36 që mundëson kufizimin e lirisë fetare në dobi të sigurisë publike, për ruajtjen e rendit publik apo për mbrojtjen e shëndetit, moralit dhe të drejtës së tjetrit. Lidhur me këtë, komisioni bën thirrje për respektimin e konventës europiane të të drejtave të njeriut dhe, shteti shqiptar shkon më tej në qëndrimin e vet duke e parë zbatimin e këtyre normave si garanci për paqen fetare dhe kohezionin kombëtar. Së fundi, tërheq vëmendjen një dispozitë tjetër e nenit 7, ku thuhet që krerët e komuniteteve “të mëdha” fetare duhet të jenë shtetas shqiptarë, të lindur në Shqipëri dhe banues aty, prej së paku njëzet vjetësh. Kjo normë edhe pse është në përputhje me traditën e sistemit shqiptar, dhe mbështetet në dekretin e vitit 1923 për njohjen e personalitetit juridik të komuniteteve fetare, nuk pajtohet plotësisht, as me normat mbi lirinë e shoqatave, as me parimin e ndarjes së fesë nga shteti, çka pohohet, pikërisht, në nenin 7, por as me parimin e barazisë para ligjit. Kjo bie ndesh, gjithashtu me udhëzimet e përgjithshme të punës së komisionit dhe të Këshillit të Europës, që synojnë mbështetjen dhe zhvillimin e pluralizmit fetar, tek i cili shohin një ilaç të efektshëm kundër sjelljeve diktatoriale të qeverive, të cilat nuk duhet të pengojnë, përkundrazi duhet të mbështesin përhapjen e besimeve të reja fetare. Shih: COMMISSION DE VENICE, *Commentaires sur le projet de Constitution albanaise, soumis au vote populaire le 6 novembre 1994*, <http://www.venice.coe.int/docs/1995/CDL%281995%29005-f.asp>. Qeveria shqiptare i kundërvihet sërish kërkesave të komisionit, duke i rikujtuar rolin e veçantë të atyre besimeve fetare, prania e të cilëve u ka dhënë jetë në këtë vend, komuniteteve që, me vetorganizimin e tyre, kanë formuar ato shtresa shoqërore, mbi të cilat kanë lindur dhe janë themeluar shoqëria dhe shteti shqiptar. Ky qëndrim nuk e kufizon lirinë e organizimit të ndonjë besimi fetar, por i përshtatet traditës historike të së drejtës shqiptare, rrënjët e së cilës janë thellë në historinë e themelimit të shtetit. Koncepti i besimit tradicional, siç është për vendet e tjera të Lindjes me shumicë ortodokse, në Shqipëri duhet parë i lidhur me pluralizmin fetar, me laicitetin dhe parimin e ndarjes së fesë nga shteti, gjë që garanton lirinë dhe ruan unitetin në vend, forcon identitetin kombëtar dhe mbron paqen fetare.

Neni 9, pika 2, parashikon një përjashtim nga rregulli i parë: ndalohej me ligj krijimi i partive politike dhe i organizatave të tjera me programe, veprimtari e mënyra totalitariste, që nxisin apo ushqejnë urrejtjen fetare, etnike dhe territoriale; që përdorin dhunën për të qeverisur apo për të drejtuar politikën e vendit. Ky formulim riprodhon, në një trajtë më të zgjeruar, një prej rregullave që bën pjesë historikisht në kushtetutën e vendit<sup>335</sup>.

Neni 10, pika e parë, pohon se Republika e Shqipërisë nuk ka ndonjë fe zyrtare dhe në pikën e dytë thekson paanshmërinë e shtetit në punët e fesë e të besimit dhe mbi të gjitha siguron lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. Pika e tretë njih barazinë fetare. Sipas pikës së katërt, si shteti ashtu edhe komunitetet fetare angazhohen për të ruajtur pavarësinë e ndërsjellë dhe bashkëpunimin për të mirën e përbashkët, duke i paraprirë kështu, me pikën vijuese, nënshkrimin të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje duhet të miratohen nga parlamenti<sup>336</sup>. Pika e gjashtë i njih komunitetet fetare si persona juridikë dhe njih gjithashtu të drejtën e tyre për të administruar pasuritë e tyre sipas rregulloreve përkatëse, me kusht që të mos cënohen interesat e të tretëve. Në këtë mënyrë, rivendoset legjislacioni tradicional lidhur me komunitetet fetare që, siç kemi parë, ka origjinë të kahershme e të urtë në të drejtën shqiptare. Me këtë masë paraprake, mbyllet epoka e ateizmit që zuri fill me zhdukjen e komuniteteve fetare që me dekretin e vitit 1976, dhe i hapet rrugë traditës juridike për komunitetet fetare të veshura me personalitet juridik civil. Zhbërja e të drejtave dhe e statuteve të komuniteteve fetare, parashikuar nga Kushtetuta e viti 1976, do t'ia lërë vendin një regjistrimi

---

<sup>335</sup> Ky parim ishte sanksionuar në nenin 6, pika dy, të ligjit mbi partitë politike, sipas së cilës “nuk lejohet themelimi i ndonjë partie politike mbi bazë fetare, etnike apo krahinore”. *Për partitë politike*, Ligj nr. 7502, 25.7.1991, “Gazeta Zyrtare” nr. 4, gusht 1991. Arsyet e sanksionimit të kësaj norme lidhen, pikërisht, me ruajtjen e unitetit kombëtar.

<sup>336</sup> Mbrojtja juridike sigurohet nga neni 134 i kushtetutës, sipas të cilit “Gjykata kushtetuese ushtron kompetencat e saj me kërkesë të organeve të bashkësive fetare vetëm për çështje që u takojnë atyre. Në këtë mënyrë, komuniteteve fetare u krijohet mundësia të kenë mbrojtjen e drejtëpërdrejtë nga Gjykata Kushtetuese, duke u njohur këtyre organizatave shoqërore një rol kryesor në shoqërinë shqiptare dhe duke i siguruar mbrojtje të veçantë lirisë fetare.



përsedyti të tyre, me perspektivën e nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëpunim dhe marrëdhënie të ndërsjella<sup>337</sup>.

Neni 18 i Kushtetutës mbron një parim themelor, atë të barazisë. Të gjithë janë të barabartë para ligjit, pa dallim gjinie, race, feje, etnie, gjuhe, bindjesh politike, fetare dhe filozofike, gjendjes ekonomike, shoqërore, të drejtës për t'u arsimuar dhe përkatësisë prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për ndonjë nga arsyet e sipërpërmendura, përveç rasteve të parashikuara paraparakisht<sup>338</sup>.

Shteti garanton, nëpërmjet nenit 20, të drejtat e pakicave etnike, që duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe liri para ligjit, mund të shprehin lirisht përkatësinë e tyre etnike, kulturore, të arsimohen në gjuhën e tyre amtare dhe të mund të bashkohen në organizata dhe grupe të ndryshme për mbrojtjen e interesave dhe të dinjitetit të tyre.

---

<sup>337</sup> Duken krejt pa vend analizat e bëra mbi legjislacionin shqiptar, nga: G. DAMMACCO, *Costituzione, processo democratico e libertà religiosa nei Balcani, La libertà religiosa*, Tomo III, (a cura di Mario Tedeschi), Rubettino, Soveria Mannelli, 2002, 961-962, i cili ndalon në gjëra të papërfillshme si, bie fjala, mosnënshkrimi i marrëveshjes mes Selisë së Shenjtë dhe Shqipërisë, aty nga viti 1929. Përkundrazi, ai i mëshon traditës kanunore, duke anashkaluar punën e bërë për përpunimin juridik të statuteve lidhur me komunitetet fetare dhe rregullimin e brendshëm të tyre, që në vitin 1923, një punë kjo e bërë në përputhje me normat shtetërore që rregullojnë aktivitetin e komuniteteve fetare, të cilët gëzojnë statusin e personit juridik të së drejtës civile. Një shqyrtim i vëmendshëm i zhvillimit të statuteve të komuniteteve fetare dhe i bashkërendimit gradual mes tyre dhe ligjit civil, do të kishte nxjerrë në pah atë që, në gjykimin tonë, është tipari themelor i sistemit shqiptar lidhur me marrëdhëniet mes komuniteteve fetare, shtetit dhe lirisë së besimit: një legjislacion që mundëson lirinë e plotë të organizimit të besimeve fetare; respektin ndaj pluralizmit; lirinë e predikimit fetar dhe të proselitizmit; lirinë e përjasjes së opsioneve të ndryshme në çështjet fetare; respektin për lirinë fetare.

<sup>338</sup> Neni 18 i Kushtetutës (Liria e fesë dhe e besimit) thotë: Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit është e paprekshme. Kushdo është i lirë të ndryshojë besimin apo bindjet vetjake dhe t'i shpallë ato privatisht apo kolektivisht, në publik apo në jetën private, nëpërmjet besimit, edukimit, shërbesave apo celebrimeve fetare. Liria e shpalljes së fesë apo bindjeve vetjake nuk mund të kufizohet, përveç rasteve të parashikuara me ligj, si masë paraprake për sigurinë e demokracisë, interesit dhe sigurisë shoqërore, si dhe për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit, moralit, të drejtave dhe lirisë së të tjerëve.

<http://licodu.cois.it/662/view>.

Neni 24 i atribuon shtetit rolin e garantit të së drejtës për këto komunitete për të shpallur dhe praktikuar publikisht besimin përkatës<sup>339</sup>.

Është detyrë Kushtetuese ruajtja e parimit të paanshmërisë së shtetit për çështje të fesë, roli mbrojtës i tij për të drejtën e komuniteteve fetare për të marrë pjesë në jetën publike të vendit. Në planin individual, neni 24 garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit dhe të drejtën për të zgjedhur, ndërruar dhe shpallur besimin dhe bindjet vetjake, privatisht apo botërisht, nëpërmjet kultit, arsimimit dhe celebrimit të shërbesave fetare<sup>340</sup>.

Pohimi i pikës 24.3, sipas të cilit “askush nuk mund të detyrohet apo të privohet nga e drejta për të marrë pjesë në një komunitet fetar si dhe në veprimtaritë e tij”, dëshmon se Kushtetuta shqiptare rimerr të njëjtën dispozitë që gjendet në Kushtetutën e Çekisë apo Lituanisë, tipar i përbashkët ky për të gjitha vendet e Lindjes, të cilat synojnë të trajtojnë në mënyrë të barabartë si përkatësinë ashtu edhe mospërkatësinë fetare, me qëllim që të mbrojnë lirinë e ndërgjegjes, pra edhe prirjet ateiste<sup>341</sup>. Ky nen hedh bazat kushtetuese për zhvillimin e veprimtarive fetare dhe i siguron mbrojtje kushtetuese mësimit të fesë në shkollën publike në Shqipëri.

Së fundi, neni 167 siguron që, në sistemin juridik shqiptar, të zbatohen vendimet e dala nga CEDU dhe nga gjykata e Strasburgut. Pra, gjykatat shqiptare janë të detyruara të zbatojnë nenin 9 të CEDU-së dhe juridiksionin e gjykatës së Strasburgut lidhur me lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes<sup>342</sup>. Kjo dëshmon se jemi përballë

---

<sup>339</sup> *Ibidem*.

<sup>340</sup> Në nenin 25, sanksionohet, gjithashtu barazia përballë ligjit dhe në nenin 26, mbrojtja e pakicave etnike. *Ibidem*.

<sup>341</sup> Nuk biem dakord me mendimin e shprehur nga: G. DAMMACCO, *Costituzione, processo democratico... cit.*, 960, i cili e sheh këtë ligj të lidhur me strukturën klanore të shoqërisë shqiptare, duke anashkaluar frytet e zhvillimit të pasviteve '90 dhe normat që kanë të bëjnë si me komunitet fetare, ashtu dhe me lirinë vetjake të besimit. Po e njëjta tezë, madje duke iu referuar Dammacco-s, hidhet edhe nga: G. B. VARNIER., *Ordinamenti, religioni e tradizione nella nuova Albania, Scritti in onore di Giovanni Barberini*, (a cura di A. Talamanca e M. Ventura), Giappichelli Editore, Torino, 2010, 451-468.

<sup>342</sup> Shqipëria ka hyrë në Këshillin e Europës më 13 prill 1995 dhe ka ratifikuar Konventën Europiane të të drejtave të njeriut, në vitin 1996. Lidhur me këtë,

një hapjeje të qartë e të padiskutueshme të këtij vendi ndaj garancive të lirisë edhe për çështje të fesë dhe të lirisë së ndërgjegjes, konform traktateve të nënshkruara lirisht, pas mbylljes së epokës së izolimit të plotë të Shqipërisë nga pjesa tjetër e Europës.

Arsyet se pse Shqipëria është e fundit që miratoi Kushtetutën e vet nuk janë vetëm arsye politike dhe rrjedhojë e mungesës së stabilitetit në vend<sup>343</sup>, por kanë të bëjnë edhe me historinë e ndërlikuar kushtetuese të Shqipërisë që, edhe pse shtrihet në pjesën perëndimore të Ballkanit, ngërthen tipare mjaft të veçanta. Sipas mendimit të autorit të këtyre radhëve, kjo dukuri nuk lidhet me rishfaqjen e strukturave klanore të shoqërisë shqiptare<sup>344</sup>, por me shkallën e laicizimit të vendit, ku një ndër pikat e forta të tij nuk janë aq pasojat që ndihen ende sot, si rrjedhojë e propagandës ateiste të regjimit të shkuar, por pranimi, pa hezitim, i vlerave të një shoqërie konsumiste dhe shpërbërja e thellë shoqërore si pasojë e emigrimit në masë të vendit gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit që lamë pas<sup>345</sup>. Dukuritë e ndjeshme të urbanizimit që kanë shfityruar riorganizimin e brendshëm të popullatës në territorin e vendit, dyndja në masë e banorëve të fshatit drejt qytetit, kanë ndikuar në shpërbërjen e strukturave klanore që, për shekuj, kanë karakterizuar shoqërinë shqiptare. Nuk është e rastit

---

mund t'i referohemi dokumentacionit mbi marrëdhëniet mes Këshillit të Europës dhe Shqipërisë, në:

[http://assembly.coe.int/ASP/Doc/DocListingThesaurus\\_E.asp?descid=1125](http://assembly.coe.int/ASP/Doc/DocListingThesaurus_E.asp?descid=1125)

<sup>343</sup> M. CHOSSUDOVSKY, *La crisi albanese*, Edizioni Gruppo Abele, Torino, 1998; E. BIBERAJ, *Shqipëria në tranzicion: rruga e vështirë drejt demokracisë*, Tiranë, Ora, 2000.

<sup>344</sup> Qëndrim të kundërt mban: G. DAMMACCO, *Costituzione, processo democratico...cit.*, 953-93, 960-963, i cili këmbëngul në ndikimin e madh të traditës kanunore.

<sup>345</sup> Emigrimi në masë i shqiptarëve pas rënies së regjimit, sjell me vete transformimin e vlerave shoqërore dhe të marrëdhënieve njerëzore dhe ekonomike. Lidhur me fluksin e emigrantëve shqiptarë drejt Italisë dhe pasojat e tij, shih: A. CESARI, D., FANELLI, *La migrazione albanese in Italia fra passato e presente*, L'Harmattan Italia, Torino, 2004; R. DEVOLE, *L'immigrazione albanese in Italia*, Agrilavoro edizioni, Roma, 2006. Mbi rindërtimin e vlerave tradicionale të shoqërisë shqiptare, shih: N. CLAYER, *Le recours à l'"histoire" et à la "tradition" dans les recompositions identitaires et politiques albanaises*, SOLIIS-URMIS, Université de Nice-Sophia Antipolis, 2000.

që miratimi i Kushtetutës u bë në vitin 1998, atëherë kur konflikti mes palëve të ndryshme të shoqërisë erdhi drejt shuarjes, të paktën në nivel shoqëror, në mos politik dhe institucional<sup>346</sup>.

Tiparet e veçanta të qytetërimit juridik dhe institucional, përkujdesi ndaj pluralizmit fetar, e bëjnë sistemin shqiptar të aftë t'i garantojë shoqërisë stabilitetin e duhur, dhe të shmangë çdo lloj lufte e konflikti fetar që ka karakterizuar hapësirën Ballkanike. Kjo duhet t'i yshtë studiuesit të reflektojnë mbi rolin e së drejtës për administrimin e konflikteve ndërfaqetare në një shoqëri pluraliste, që sidoqoftë, ka një besim me epërsi numrash, aq më tepër që ky besim është ai islam<sup>347</sup>.

---

<sup>346</sup> A. BIAGINI, *Storia dell'Albania dalle origini ai nostri giorni*, Bompiani, Milano 1998; R. MOROZZO DELLA ROCCA, *Albania. Le radici della crisi*, Guerini e Associati, Milano, 1997; N. DELL'ERBA, *Storia dell'Albania*, Newton editore, 1997.

<sup>347</sup> *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, <http://licodu.cois.it/304/view>. Për më gjerë, shih: ALB JURIS, *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me interpretime të gjykatës kushtetuese*, Tiranë 2008.

### 3. 2. Ligji për organizatat jofitimprurëse dhe përdorimi i tij për rregullimin e marrëdhënieve me besimet fetare

Edhe pse besimet fetare, në një formë a në një tjetër, e kishin rifituar personalitetin juridik, kjo nuk i jepte zgjidhje problemit të njohjes së personalitetit juridik të Kishës katolike, as komuniteteve të tjera fetare, e aq më pak kulteve të reja që u shfaqën në Shqipërinë e viteve '90, prandaj, si Këshilli i Europës, ashtu dhe Komisioni i Venecias kërkonin rregullimin me ligj të tyre<sup>348</sup>, duke vepruar pak a shumë si vendet e tjera ish socialiste, me miratimin e një ligji të përgjithshëm mbi lirinë fetare<sup>349</sup>.

Jo vetëm kaq, por struktura dhe përbërja e shoqërisë shqiptare kishte pësuar ndryshime të shpejta me pjesëmarrje në organizata dhe grupime shoqërore të ngritura për qëllime solidare dhe bamirësie jo medoemos të karakterit fetar. Edhe këtyre nismave u duhej siguruar një veshje juridike, pasi ligji i miratuar në vitin 1993 për fondacionet, nuk ishte i mjaftueshëm, ndërkohë që ligji i vitit 1956 "*Mbi organizatat shoqërore jofitimprurëse*" ishte shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Civil. Ishte i nevojshëm miratimi i një ligji të detajuar dhe gjithëpërfshirës për rastin e organizatave jofitimprurëse<sup>350</sup>, hartimi i të cilit do t'u jepte zgjidhje këtyre problemeve me anë të normave të së drejtës së përbashkët, bazuar në traditën e ndarjes mes shtetit dhe fesë në sistemin shqiptar<sup>351</sup>.

---

<sup>348</sup> Në të shkuarën, ka pasur ndikim të pandërprerë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët, krahas politikave të tyre të vazhdueshme kundrejt vendeve ish komuniste, kanë parë me përparësi përhapjen e një numri sa më të madh besimesh fetare, ndër banorët e këtyre vendeve. Sot, komiteti shtetëror për kultet regjistron krahas grupeve fetare tradicionale, 245 organizata dhe fondacione, përfshirë këtu 34 organizata islame dhe 189 organizata protestante.

<sup>349</sup> Pas një analize përmbledhëse të marrëdhënieve mes shtetit dhe besimeve fetare në Shqipëri, merr në shqyrtim praninë e kulteve të reja. E. KARANDREA, *Chiesa e Stato in Albania, Diritto e religione nell'Europa post-comunista*, (a cura di S. Ferrari, E. Cole Durham Jr., E. A. Seëell), Bologna, Il Mulino, 2004, 31-46.

<sup>350</sup> *Për organizatat jofitimprurëse*, Ligji nr.8788, datë 7.5.2001, <http://licodu.cois.it/610/view>.

<sup>351</sup> Ligji shqiptar bazohet në ligjin e miratuar nga Mali i Zi, tekstin e të cilit e kemi konsultuar në gjuhën angleze "*The law on non-governmental organizations*", "Official Gazette of the Republic of Montenegro", no. 27 of July 29, 1999,

Neni 1 i ligjit, pasi përcakton kuadrin e zbatimit ligjor, dikton normat për krijimin, regjistrimin, administrimin, organizimin dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse që veprojnë për të mirën dhe interesin publik, me vetëdijen se në mesin e tyre mund të përfshihen edhe ato organizata që bëjnë propagandë fetare. Kjo vihet re, sidomos kur analizohet neni 2 i këtij drafti, ku kërkohet të përcaktohet lloji i disa veprimtarive<sup>352</sup>, veçanërisht me hartimin e pikës 3 të nenit 2, ku thuhet se ligji njih si organizata jofitimprurëse shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti”. Kuptohet mjaft mirë që në këtë përkufizim kaq të gjerë, gjen hapësirë edhe veprimtaria e ndonjë shoqate me karakter fetar, për më tepër nëse mbajmë parasysh që strukturat organizuese që rregullon ky ligj, nuk duhet të kenë qëllim fitimprurës<sup>353</sup>. Veprimtari të tilla mund të zhvillohen edhe nga shtetas të huaj<sup>354</sup>. Ky shënim i fundit, i shtuar me vetëdije, është tregues i fazës së ngulitjes së kulteve të reja në një vend që ka nevojë akute për personel me shtetësi të huaj.

Sigurisht, ligji thekson se veprimtaria shoqërore, duhet të synojë të mirën dhe interesin publik, në mënyrë që të përfitojë mbështetjen ligjore të parashikuar për të<sup>355</sup>. Me veprimtari shoqërore

---

<http://licodu.cois.it/695/view>. Neni 51 i ligjit shfuqizon ligjin e mëparshëm nr.7695, datë 7.4.1993 “Për fondacionet”. <http://licodu.cois.it/609/view>. Ligji “Mbi organizatat shoqërore jo fitimprurëse” ishte shfuqizuar me nenin 1167 të kodit civil 1994.

<sup>352</sup> Me “Grumbullim publik të fondeve”, nënkuptohet mbledhja e fondeve nëpërmjet fushatave sensibilizuese të opinionit publik në shkallë të gjerë; me “Organ shtetëror kompetent”, nënkuptohet një organizëm kombëtar, fusha e veprimit e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me fushën e veprimit të organizatave *non profit*, apo të një enti publik të përcaktuar me ligj.

<sup>353</sup> Me “Veprimtari jo fitimprurëse” nënkuptohet çdo aktivitet ekonomik apo antiekonomik, me kusht që të ardhurat apo pasuria e organizatave *non-profit*, të mund të përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimeve të shprehura në dokumentin themeltar të organizatës dhe në statusin e saj.

<sup>354</sup> Sipas nenit 5 të ligjit për “veprimtari të përkohshme”, me këtë të fundit nënkuptohet aktiviteti i ushtruar nga një shtetas i huaj në territorin shqiptar, pa qëllim fitimi, për përmbushjen e synimeve të parapërcaktuara brenda një harku kohor një vjeçar, por jo në më pak se 30 ditë radhazi dhe jo në shumë se gjashtë muaj.

<sup>355</sup> Me “Veprimtari në të mirë të interesit publik” nënkuptohet çdo aktivitet që mbështet dhe zhvillon tek individët dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe

nënkuptohet: përkujdesje shëndetësore, ofrimi i shërbimeve dhe asistencës sociale, zhvillimi i arsimit dhe ngritja e shkollave, qoftë edhe për formim shpirtëror, pra, veprimtari që përfshijnë edhe besimet fetare. Neni 3 i këtij ligji përjashton nga kuadri i zbatimit të këtyre normave sindikatat, partitë politike dhe organizatat e tjera jofitimprurëse<sup>356</sup>, ndërkohë që i njeh kujtdo të drejtën të bëjë pjesë në një organizatë kolektive, pa qenë nevoja që kjo të jetë medoemos e regjistruar si organizatë jofitimprurëse.

Në kreun e dytë të ligjit, sanksionohet e drejta e çdo personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, për themelimin e ndonjë organizate jofitimprurëse apo për të qenë anëtar ose pjesë e organeve drejtuese të saj, si dhe pjesë e personelit administrativ të kësaj organizate. Kjo u siguron mundësinë të gjithëve, edhe shtetasve të huaj, të zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë këtyre organizatave, çka e shmang pengesën që i privon ata nga detyra e drejtuesit të kultit, në mungesë të shtetësisë shqiptare. Kërkohet që gjatë gjithë veprimtarisë dhe administrimit të tyre të brendshëm, këto shoqata (neni 5) të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, por pa e humbur pavarësinë e tyre. Ndërkohë, shteti që i mbështet dhe i inkurajon ato, krijon kushtet për lehtësimin e praktikave dhe mjeteve për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre, pa anashkaluar kushtëzimet dhe caqet përkatëse të parashikuara me ligj. Autoriteti i shtetit synon të mos ndërhyjë në punët e organizatave jofitimprurëse dhe të mos bëhet pengesë për veprimtarinë e tyre, përveç rasteve të parashikuara me ligj (neni 7). Pra, rikthehemi sërish tek parimi i ndarjes që mbizotëron në Shqipëri sa u përket marrëdhënieve mes shtetit dhe organizatave që ndjekin punët e fesë. Detyrimi që u lind organizatave nga parimi i ndarjes, është respektimi i plotë i ligjeve të shtetit, siç parashikohet në Kodin Civil (neni 8-9). Kjo prek sidomos çështjet institucionale si ato të formimit, organizimit,

---

njerëzore; mbron jetën njerëzore, shëndetin; ofron dhe ushtron shërbime publike dhe shoqërore, ndihmë dhe mbështetje në rast fatkeqësisë; mbron ambientin dhe zhvillon kulturën dhe arsimin; mbështet dhe promovon vlerat dhe traditat kulturore dhe historike, shkencën, arsimin; kontribuon për zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike në të mirë të interesit publik.

<sup>356</sup> Këtu përcaktohet veprimtaria, organizimi dhe funksionimi i organizatave non-profit, që rregullohen nga ky ligj i veçantë.

funksionimit dhe çuarjes përpara të aktiviteteve të organizatave jofitimprurëse, pra gjithçka duhet të jetë në respekt me ligjin. Me qëllim që t'u sigurojë autonomi të plotë organizatave në fjalë, ligji njih lirinë e vullnetit për pjesëmarrje në to, fikson si numër dysheme, numrin pesë për themelimin e tyre, por lë të hapur mundësinë që organizata të mund të formohet edhe nga shoqata të tjera ekzistuese. Kjo i mundëson një grupi organizatash që më parë funksiononin të ndara formalisht nga njëra-tjetra, të riorganizohen për të arritur qëllimin e përbashkët të tyre. Pra, në këndvështrimin organizues, ka më shumë autonomi, pasi kushdo mund të marrë pjesë dhe mund të dëshmojë rolin e tij drejtues në një organizatë, qoftë kjo edhe fetare.

Për të siguruar sa më mirë lirinë e bashkëpunimit brenda organizatës, ligji garanton të drejtën e shkëputjes kurdo prej saj, duke respektuar lirinë e secilit e, në të njëjtën kohë, mundësinë e organizatës për të ndjekur synimet e saj dhe për të ngritur një strukturë që i vjen për shtat komunitetit fetar (neni 10). Vendimet merren nga bashkësia e ortakëve, çka përbën garanci për autonomi të plotë. Një shoqatë jofitimprurëse mund të themelohet edhe falë donacioneve apo trashëgimisë dhe për raste të tilla vendimet merren nga këshilli i saj administrues, gjë që i hap rrugë administrimit hierarkik të saj. Edhe këtu, ligji lë shteg për mundësitë e përshtatjes me nevojat e ndryshme të çdo komuniteti fetar.

Së fundi, për t'u siguruar liri të plotë organizative, parashikohet edhe mundësia e krijimit të organizatave që nuk kanë kurrfarë detyrimi të regjistrohesh në gjykatat civile dhe si të tilla nuk e përfitojnë statusin e personalitetit juridik civil, por mbeten thjesht shoqata. Me gjasë, veprohet kështu jo vetëm për të respektuar autonominë për t'u organizuar, por edhe për t'u ardhur në ndihmë grupimeve të ndryshme gjatë fazës së parë të themelimit të një shoqate, së cilës i nevojitet kohë për t'u strukturuar në nivelet e duhura.

Ligji përcakton, me anë të nenit 11, domethënien e termit *Qendër përkatësie* që nënkupton një person juridik që synon të ofrojë shërbime dhe të realizojë projekte në të mirë të interesit publik, por pa ushtruar aktivitet tregtar. Ajo mund të themelohet me një akt noterial me kërkesë të themeluesit të saj dhe, në të, mund të



bëjnë pjesë një a më shumë persona fizikë ose juridikë. Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e saj kërkohet mbështetje në dispozitat ligjore përkatëse të fondacionit, siç parashikohet në Kodin Civil, me përjashtim të rasteve të veçanta që parashikon dispozita në fjalë.

Organizatave jofitimprurëse mund të kenë selitë e tyre lokale ose filiale në territorin shqiptar edhe nëse nuk gëzojnë personalitet juridik të pavarur, po ashtu, u lejohej të ngrenë filiale jashtë vendit, për shkak të natyrës së tyre fetare. Edhe organizatat jofitimprurëse me seli jashtë vendit mund të veprojnë në Shqipëri (neni 12), me kusht që veprimtaria e tyre të mos bjerë ndesh me Kushtetutën e vendit dhe pasi të jenë regjistruar në gjykatë, siç parashikohet në ligj.

Veshja me personalitet juridik fillon që nga data e regjistrimit pranë një gjykate të shkallës së parë që mbulon territorin ku ka selinë kjo organizatë dhe në momentin e çregjistrimit të saj, zhvishet nga ky status. Kjo larmishmëri rregullash ofron mundësi të shumta për të zgjedhur trajtën juridike më të përshtatshme dhe më të leverdisshme për nevojat e një shoqate me karakter fetar, në mënyrë që kjo të ushtrojë veprimtarinë e saj nën mbrojtjen e të gjitha garancive juridike<sup>357</sup>. Sipas nenit 17, gjithçka që ka të bëjë me funksionimin e organizatave, i kalon statutit, përmbajtja e të cilit shtjellohet më në detaje nëpërmjet neneve të këtij ligji.

Statuti i çdo komuniteti fetar u kushton të njëjtën rëndësi: emrit, simboleve dalluese, vulës, por edhe mënyrës së administrimit të përgjithshëm, emërimit dhe veprimtarisë së organeve drejtuese, caktimit të personelit të punësuar pranë organizatës, përgjegjësive të këtij personeli në ushtrimin e funksioneve përkatëse, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të ndryshme etj.

Këto rregulla vlejnë edhe për organizatat jofitimprurëse me seli jashtë vendit, që duan të veprojnë në Shqipëri. Ato duhet të regjistrojnë filiale të tyre, sipas legjislacionit të këtij vendi; mund

---

<sup>357</sup> Vendimet mbi ndryshimin e aktit themeltar, që kanë të bëjnë me: emrin, simbolin, objektin, qëllimin, kuadrin e veprimtarisë së organizatës non profit, si dhe me vendimet për t'i dhënë trajtë tjetër kësaj organizate, duhet t'i paraqiten gjykatës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi nga organet drejtuese të organizatës në fjalë. Për ndryshimet në aktin themeltar, duhet ndjekur e njëjta procedurë si për regjistrimin e kësaj organizate (neni 16).

t'u kërkojnë autoriteteve përkatëse autorizim të përkohshëm për ushtrimin e aktiviteteve të tyre dhe, në mungesë të një përgjigjeje, brenda 30 ditësh, vlen pranimi në heshtje. Organizatat me seli jashtë vendit nuk mund t'u bëjnë konkurrencë organizatave të ngjashme, ekzistuese tashmë në Shqipëri dhe duhet të plotësojnë një dokument ku të dëshmojnë se gëzojnë njohjen e personalitetit juridik civil në vendin e tyre të origjinës. Po ashtu, duhet të deklarojnë se janë organizatë jofitimprurëse me seli jashtë vendit dhe se veprimtaria që do të zhvillojnë në Shqipëri, është në përputhje me qëllimin për të cilin është krijuar ky ent, qëllimet e të cilit duhet të jenë pranuar nga legjislacioni i vendit të origjinës<sup>358</sup>.

Në ato raste kur organizatës jofitimprurëse me seli jashtë vendit, i lëshohet licenca përkatëse, ndiqen po ato rregulla si për subjektet me shtetësi shqiptare. Në këtë mënyrë përmbushen kërkesat e organizatave ndërkombëtare që lypnin trajtim të njëjtë me ato vendase për veprimtarinë e tyre në Shqipëri<sup>359</sup>. Po ashtu, u jepet siguri e plotë organizmave ndërkombëtare që, më në fund, Shqipëria është e hapur kundrejt çdo lloj të drejte për t'u organizuar, si dhe çdo forme të shprehjes së besimit.

Organizatat jofitimprurëse mund të mbledhin fonde, donacione dhe mund të marrin pjesë, në të njëjtat kushte me ente të tjera juridike që gëzojnë të drejtën e sipërmarrjes, në garë dhe tendera për të përfituar mbështetje ekonomike dhe kontrata për të bërë blerjet e nevojshme; për të përfituar nga konkurset e shpallura nga organet shtetërore; për administrimin e shërbimeve publike për individët dhe për kalimin e shërbimeve publike dhe aktiviteteve lidhur me to, operatorëve privatë, duke u ofruar atyre shërbime në formën e subvencioneve.

---

<sup>358</sup> Dokumentacioni që kërkohet për njohjen e organizatës duhet të jetë original, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë: aktin e themelimit, statutin dhe vendimin e organit kompetent për hapjen e filialit të saj në Shqipëri (neni 32)

<sup>359</sup> Nenet 35-36 u ndalojnë organizatave non profit, të nxjerrin përfitime nga aktiviteti i tyre, me përjashtim të atyre rasteve kur të ardhurat shërbejnë për financimin e shërbimeve institucionale apo për pagat dhe shpërblimin e atyre që kryejnë këto shërbime.

Organizatave zhvishen nga detyrimi i taksës mbi të ardhurat e përfituara nga donacionet dhe nga ndihmat që mbërrijnë prej enteve të ndryshme, në shërbim të veprimtarisë së saj. Personat fizikë dhe juridikë që u ofrojnë ndihmën e tyre nëpërmjet donacioneve organizatave jofitimprurëse, fitojnë të drejtën për lehtësim të taksave mbi të ardhurat e tyre, sipas parashikimit me ligj<sup>360</sup>.

Shteti merr përsipër, për aq sa i cakton ligji, të vigjilojë mbi organizatat jofitimprurëse<sup>361</sup> dhe kur aktiviteti i organizatës përbën rrezik për publikun, gjykatësi i dërgon si masë paraprake organizatës, një ankesë me shkrim, duke i lënë 30 ditë në dispozicion për të korrigjuar mënyrën e saj të të bërit. Shkrirja e një organizate jofitimprurëse mund të bëhet me kërkesën e organit mbikëqyrës apo të ortakëve. Në çdo rast është e nevojshme, së pari, t'i kërkohet organizatës të riaktivizojë të gjithë veprimtarinë sipas programit të saj dhe Kushtetutës, ndërkohë që, gjatë kësaj faze ndërmjetëse, shkrirja e organizatës pezullohet.

Nëse paralajmërimet merren për bazë, gjykatësi mund ta mbyllë çështjen duke kufizuar, sa të jetë e mundur, rrezikun e shkrirjes së organizatës. Siç shihet, ligji shfrytëzohet gjerësisht me qëllim që shoqata të mos shkojë drejt zhbërjes së saj, në mënyrë që besimeve dhe shoqatave fetare t'u krijohen garancitë e nevojshme për ta shfrytëzuar sa më mirë atë. Këtë e konfirmojnë nenet 46-48 të ligjit që rregullon veprimtarinë e likuiduesve, të cilët nuk duhet të likuidojnë vetëm kreditorët dhe debitorët e mundshëm, por, pas

---

<sup>360</sup> "Autoritetet shtetërore kompetente kanë të drejtë të mbikqyrin organizatat jofitimprurëse lidhur me zbatueshmërinë e normave fiskale, doganore, të sigurisë shoqërore, në mënyrë që aktiviteti i tyre ekonomik të jetë i pajisur me kontratën përkatëse për ushtrimin e shërbimeve publike dhe shoqërore, si dhe për të siguruar fondet e nevojshme nga bilanci i shtetit (neni 41).

<sup>361</sup> Neni 44 pohon " Gjykatësi mund të vendosë për shkrirjen e organizatës jofitimprurëse, bazuar në kërkesën e anëtarëve të saj, të organeve të saj vendimmarrëse, ndërsa organizmi shtetëror është kompetent kur: a) Veprimtaria e organizatës jofitimprurëse bie ndesh me Kushtetutën; b) Organizata jofitimprurëse ka kryer vepër penale; c) Organizata jofitimprurëse nuk kryen detyrimet tatimore të parashikuara në ligj; d) Organizata jofitimprurëse ka falimentuar sipas ligjeve të falimentimit.

shlyerjes së detyrimeve, pjesën e mbetur duhet ta depozitojnë për qëllimet e shoqatës<sup>362</sup>.

Ligji për shoqatat jofitimprurëse përfundon me disa dispozita kalimtare që rregullojnë çështjen e mbylljes së aktivitetit të këtyre shoqatave të cilat, nëse kanë interes, mund ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre duke u mbështetur në kuadrin e ri legjislativ (neni 49), po të riorganizohen në harkun kohor prej një viti për t'u përshtatur me gjendjen e re juridike<sup>363</sup>. Nuk mund të mos vihet re se si ky ligj u përgjigjet plotësisht të gjitha nevojave të karakterit juridik me të cilat mund të përballen një komunitet fetar apo edhe grupet fetare informale që ende s'kanë hedhur mirë rrënjë në vend. Pra, garantimi i lirisë për pjesëmarrje në një grupim të caktuar fetar është e drejtë e të gjithëve, në sintoni të plotë me parimin e ndarjes dhe të laicizmit të shtetit.

Kështu, çështjet që kanë të bëjnë me fenë nuk njohin ndonjë trajtim të posaçëm, por rregullohen duke shfrytëzuar të gjithë lirinë që karakterizon këtë sistem, duke shmangur hartimin e tepruar të normave specifike për një fushë të tillë. Është fakt që – në pajtim me parashikimet kushtetuese të nenit 10 të saj- shteti nuk përjashton marrëveshje bashkëpunimi me besimet tradicionale, pa harruar se, prania e tyre në këtë vend, ka ndihmuar në formësimin e identitetit të popullit shqiptar dhe ka luajtur rol themelor në procesin e bashkimit kombëtar. Për këtë dëshmon koha dhe historia, pra veprat e burrave dhe grave që iu bashkuan komuniteteve të ndryshme fetare për pëgatitjen e

---

<sup>362</sup> Në ato raste kur organizata jofitimprurëse nuk ka paguar taksat apo ka mashtruar me donacionet apo financimet publike dhe shtetërore, pjesa e mbetur pas shlyerjes së detyrimit u shpërndahet organizatave të tjera pa qëllim fitimi që ndjekin të njëjtat qëllime për kryerjen e likuidimit. Kur një organizatë jofitimprurëse, shkrihet vullnetarisht, mbarështimi i përfitimit nga veprimtaria e saj përcaktohet në statut ose nga një vendim i organit të saj më të lartë vendimmarrës. Nëse nuk gjendet zgjidhje, çështja i kalon gjykatës (neni 47).

<sup>363</sup> Neni 49 pohon: “Pas një viti të hyrjes në fuqi të këtij ligji, organizatat jofitimprurëse ekzistuese, duhet të paraqesin kërkesën dhe të regjistrohen në gjykatë, përndryshe humbasin statusin e personit juridik dhe veprimtaria e tyre konsiderohet e paligjshme” Neni 50 pohon “Në ato raste kur aktiviteti ekzistues i organizatave jofitimprurëse nuk është në përputhje me dispozitat ligjore, brenda një viti të hyrjes së ligjit në fuqi, duhet të paraqesin ndryshimet e nevojshme pranë gjykatës [...] Modifikimet sipas pikës 1 të këtij neni, konsiderohen si ndryshim dhe jo si regjistrim i ri.

kushteve të favorshme në dobi të vendit, siç do të shihet, më tej, me rastin e Vëllazërisë Ungjillore. Menjëherë, pas heqjes së pengesave diplomatike dhe kapërcimit të çështjeve parimore nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi, ligji në fuqi i lejoi Kishës katolike të kërkojë dhe përfitojë njohjen e personalitetit juridik, synim ky, që kishte hasur për shumë kohë në përplasjen e fortë mes shtetit dhe Kishës katolike në Shqipëri.

### 3. 3. Veçantia e shtetit shqiptar

Sistemi shqiptar fillon t'u krijojë gjithnjë e më shumë hapësirë komuniteteve fetare duke i lehtësuar ato nga barra fiskale dhe duke mos ua mohuar privilegjet, për t'i dhënë dorë rindërtimit të tyre. Në të njëjtën kohë, bën kujdes të mos i pengojë marrëdhëniet e tyre me selitë përkatëse jashtë vendit<sup>364</sup> dhe i mbështet në përpjekjen për t'u rrënjosur sërish në shoqërinë civile, ndërkohë që këto i rikthehen përpunimit doktrinal dhe kulturor të tyre<sup>365</sup>. Nisma për riorganizimin e pranisë ortodokse në Shqipëri, ndërmerret nga Patriarkana Ekumenike në muajt e parë të vitit 1991 dhe, në datat 1-2 gusht të këtij viti, thirret Asambleja e përgjithshme e klerikëve dhe laikëve, në të cilën marrin pjesë 15 meshtarë dhe 30 laikë, të ardhur nga të gjitha dioqezat e Shqipërisë. Numri i pakët i pjesëmarrësve na bën të kuptojmë se ç'tkurrje kishte pësuar komuniteti Ortodoks shqiptar.

Sinodi i shenjtë i Patriarkanës zgjodhi Kryeepiskopin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë, Metropolitin e Andrusës, Anastasios; Metropolitin e Korçës, arqimandritin, Kristodhul Mustakas; atë të Gjirokastrës dhe Beratit, Alexander Kalpakidhis; të Vlorës-Kaninës-Triandis, arqimandritin Ignazio.

Qeveria shqiptare protestoi, sepse në këtë vendimmarrje dallon dorën e një shteti të huaj (Greqisë) që kërkon të ndërhyjë në punët e brendshme shqiptare. Kështu, zënë fill negociatat me Kishën, të cilat mbyllën me marrëveshjen për dorëheqjen e dy episkopëve, vendin e të cilëve e marrin peshkopë me origjinë shqiptare, ndërkohë që lejohet që dy të kenë lindur jashtë vendit. Ndërkaq,

---

<sup>364</sup> *Për një ndryshim në ligjin* nr. 8182, 22.12.1996 “*Për një ndryshim në ligjin*” nr.7609, 22.9.1992 “*Për tarifa doganore*”, Dekret nr.1807, datë 30.5.1997.

<sup>365</sup> Kryegjyshata botërore ia doli të lidhej me besimtarët bektashianë të shpërndarë nëpër botë. Në datat 23-24 shtator 2000, u mbajt Kongresi VII botëror bektashian. Lidhur me rezultatet e këtij kongresi, shih: *7° Congresso Mondiale dei Bektashi*, Tiranë, 2001. Të mbahet gjithaq, parasysht se me vendim nr. 43 të datës 26 janar 2001, këshilli i ministrave vendosi që 51% të pasurisë së aksioneve të shtëpisë botuese “Tirana Spa” në pronësi të shtetit, të kalonin në emër të Kryegjyshatës botërore, për t'i krijuar mundësinë e botimit të teksteve me karakter fetar dhe shoqëror. “Gazeta Zyrtare” nr. 1, 2001, 31.

shtrohet problemi i edukimit të meshtarëve të rinj, gjë që çon në ndërtimin e Akademisë Teologjike Ortodokse “Ngjallja e Krishtit”, në mënyrë që, duke filluar nga viti 1999, të ketë të paktën 110 priftërinj për të siguruar klerin autokton. Studentët e Akademisë përbënin bërthamën e parë të murgjëve të rinj, nga të cilët do të dalë hierarkia e lartë fetare<sup>366</sup>.

Në këtë periudhë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë (tani e tutje KOASH), bëhet pjesë e Konferencës Europiane të Kishës (KEK)<sup>367</sup> dhe të Këshillit Botëror të kishave<sup>368</sup>, ndërkohë që marrin hov nismat e saj të apostullimit dhe përhapjes së fesë në vend<sup>369</sup>.

---

<sup>366</sup> Duhet mbajtur parasysh që në Kishat ortodokse vetëm murgjit nuk mund të martohen, për t’iu përkushtuar funksioneve të karakterit hierarkik kishtar. Përveç 5 manastireve, bëhet fjalë edhe për 74 kisha të reja, 65 monumente të restauruara dhe më shumë se 230 godina të rikthyera në pronësi të tyre, ndërsa 20 janë ndërtuar të reja, ose janë blerë.

[http://sq.wikipedia.org/wiki/Kisha\\_Ortodokse\\_Autoqefale\\_e\\_Shqip%C3%ABris%C3%AB](http://sq.wikipedia.org/wiki/Kisha_Ortodokse_Autoqefale_e_Shqip%C3%ABris%C3%AB)

<sup>367</sup> Konferenca Europiane e Kishave lindi aty nga mesi i viteve pesëdhjetë të shekullit të shkuar dhe u mbledh për herë të parë në vitin 1959 në Nyborgin të Danimarkës. Sot ka në përbërje të saj 125 kisha protestante, ortodokse, anglikane dhe katolike të Europës. Nga viti 1971, ajo bashkëpunon, nëpërmjet Këshillit të ngritur prej tyre, me konferencën ipeshkvnore europiane (CCEE). Lidhur me veprimtarinë e kësaj organizate, shih: A. FABRI, *Presenza istituzionale e pastorale cattolica in Europa*, Soveria Mannelli, Rubettino, 2011. Këto dy organizma i kanë dhënë jetë Komitetit Paritetik CCEE-KEK që ushtron funksionet e tij pranë Komitetit Europian për promovimin e interesave të komuniteteve fetare. Ref: F. MARGIOTTA BROGLIO, *Il fenomeno religioso nel sistema giuridico dell’Unione Europea*, F. MARGIOTTA BROGLIO, C. MIRABELLI, F. ONIDA, *Religioni e sistemi giuridici*, Bologna, il Mulino, 1997, 122.

<sup>368</sup> Këshilli ekumenik i kishave (*World Council of Churches*) është një organ i përhershëm takimi ekumenik mes kishave të krishtera të të gjithë botës. Ai u themelua në vijim të asamblesë së parë botërore të kishave, mbajtur në Amsterdam në vitin 1948. Fillimisht pati pjesëmarrës nga 147 degë nga gjiri i protestantëve si dhe përfaqësues nga ortodoksia, më vonë pjesëmarrësit erdhën duke u shtuar, derisa kapën shifrën 340, mes të cilëve vlen të përmendet pjesëmarrja e të gjitha kishave ortodokse. *Ibidem*.

<sup>369</sup> Për më tepër, në vitin 1992 filluan të botoheshin periodikët mujorë “Ngjallja”; revista për fëmijë “Gëzohu”; ajo për rininë ortodokse “Kambanat”. Kisha ortodokse autoqefale e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë nismash me karakter shoqëror si p.sh. ngritja e qendrës së diagnostifikimit “Ungjillëzimi” në Tiranë. Nisma analoge me këtë janë marrë në Korçë, Jergrgucat, Kavajë, Lushnjë etj., ku janë ngritur çerdhe e kopshte, e veçanërisht struktura për fëmijët me aftësi të

Myslimanët e rifillojnë zyrtarisht veprimtarinë e tyre në vitin 1991 në Shkodër, pranë Xhamisë së Plumbit, pesë ditë pasi katolikët kishin celebruar meshën e parë në një klimë solidariteti mes besimeve të ndryshme. Edhe ata duhet të rindërtojnë dhe riorganizojnë komunitetin e tyre, çka bën që të mbërrijnë ndihmat e para, të ofruara jo pa interes, nga vende të ndryshme myslimane, në këmbim të orientimit drejt islamit *salafit*, i huaj dhe i pazakontë për traditën shqiptare. Ndihma mbërrijnë edhe nga Turqia, e cila i ndjek me vëmendje komunitetet myslimane në mbarë Ballkanin Perëndimor<sup>370</sup>. Edhe pse nuk mungon njëfarë interesi me karakter politik, që shkon tej atij fetar, si ende drejt panturqizmit, nuk mund të mohohet që islami shqiptar ndihet më afër atij turk.

Ndërtimi i xhamive dhe strukturave fetare, mori një zhvillim të hovshëm dhe, fatkeqësisht, të paorganizuar duke filluar nga viti 1991, ndaj komuniteti Mysliman duhet të bëjë përpjekje të shumta për të rifituar dhe ruajtur traditën e islamit shqiptar<sup>371</sup>. Në

---

kufizuar në: Tiranë, Durrës, Kavajë, Elbasan etj. *Kalendari Ortodoks*, Tiranë, 2004, 5.

<sup>370</sup> Komunitetit mysliman, fillimisht iu kthyen 4 xhami nga 38 që zotëronte para zbatimit të reformës agrare, përveç tokave që iu dhanë në formë dëmshpërblimi, për shkak se shumë të mira të konfiskuara, ishte vështirë të ktheheshin. Sa u përket besimeve të tjera, u kthyen, gradualisht 220 kisha, që ishin modifikuar për punë të tjera.

Ajo çfarë ndodh me islamin është diçka spekuluese, po ta krahasosh me gjendjen e besimeve të tjera. Pas rënies së regjimit, Shqipëria shfaqet si një terren i virgjër, mjaft i lakmueshëm për të gjitha lëvizjet fetare, e sidomos për ato të krishtera që vinin nga SHBA-të. Për t'i ardhur në ndihmë veprimtarisë së tyre, ata sinllin me vete ndihma materiale, mallra tipike perëndimore që joshnin pa masë, sidomos, në një gjendje varfërie të skajshme, ndoshta edhe shumë më tepër se gjysëm milioni Kuranë e Ungjij të botuar nën përkujdesjen e besimeve tradicionale, por të mbetura në magazinat e kishave dhe xhamive. Por, me kalimin e kohës, shumica e popullsisë nuk i çmon për gjë këto besime të reja dhe të pazakonta ndër shqiptarë, sidomos kur në Shqipëri, gjendja ekonomike filloi të përmirësohet.

<sup>371</sup> Bullgaria kishte mbetur një vend për formimin fetar edhe gjatë periudhës komuniste. Fakulteti i teologjisë në Sofie, ishte shtetëzuar dhe bërë pjesë e Universitetit shtetëror të Sofies, por pa e ndërprerë funksionin e tij. Pas vitit 1991, ai u privatizua sërish dhe në vitin 1998 u themelua në Sofie Instituti i lartë islamik (Висшият ислямски институт), në kurset e të cilit iu kushtua vëmendje e veçantë studimit të islamit ballkanik dhe ku u mirëpritën jo pak anëtarë të komunitetit bektashian, që po përgatiteshin për të drejtuar lutjen dhe për të ringritur strukturat e besimit edhe në Shqipëri.



territoret e ish Jugosllavisë kishte mundësi të formohej prej kohësh personeli fetar, shpesh i etnisë shqiptare, por gjithë kjo prurje ndihmash dhe ndikimesh të ndryshme islame, solli me vete jo pak kundërshti në brendësi të komunitetit Mysliman. Domethënëse mbetet përpjekja e një grupi jo të vogël të rinjsh që kishin studiuar në Egjipt, për ta modifikuar ritin e komunitetit shqiptar duke filtruar brenda tij praktikat më tradicionale të islamit *Salafit*, përpjekje kjo që dështoi dhe u kundërshtua në unanimitet nga organet drejtuese të komunitetit Mysliman<sup>372</sup>.

Bektashinjtë, po ashtu, përpiqen të riorganizojnë komunitetin e tyre, sidoqë me kohë dhe burime më të pakta. Me 22 mars 1990, me rastin e ditës kushtuar Sulltan Novruzit, pas një ndërprerjeje, prej rreth 50 vjetësh, u hap zyrtarisht aktiviteti i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane<sup>373</sup>. Për të mbështetur veprimtarinë e tyre, mbërriti ndihma e komuniteteve bektashiane nga vende të ndryshme të botës si: Azi e Vogël, Turqi, Iran, Irak, Egjipt, Rumani, Hungari, Bullgari, Jugosllavi (Kosovë e Maqedoni), Greqi<sup>374</sup>.

---

<sup>372</sup> Propozohet që të zëvendësohet *medh'hebi* i shkollës tradicionale *hanefita* me atë të një shkollë më radikale, *salafita*. Kjo do të çonte në braktisjen e traditës shqiptare që karakterizohet nga një islam tolerant dhe reformist si në fushën juridike, rituale dhe të stilit të jetës tradicionale, për t'u hedhur drejt një islami nën ndikimin e shkollës salafite. M. VICKERS, *Feja në Shqipërinë paskmuniste* "Bota Shqiptare", 21 tetor - 3 nëntor 2006 (përkthimi në italisht nga Marjola Rukaj), *La fede degli albanesi*, "Osservatorio sui Balcani", sot në:

<http://www.balcanicaucaso.org/aree/Albania/La-fede-degli-albanesi>

<sup>373</sup> Bektashizmi ishte mbajtur gjallë nga komunitetet e emigrantëve shqiptarë. Lidhur me këtë, shih: BABA REXHEBI, *Misticizma islame dhe bektashizma*, Neë York, Ëaldon Press, 1970, ku veç të tjerash, risjell themelimin e këtij besimi fetar.

<sup>374</sup> U rindërtuan shumë teqe në qytetet e Krujës, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, dhe u ndërtua krejt e re nga Dede Sali Njaziu, teqeja e Dergjakut në Tiranë, e hapur për publikun në vitin 1993. Komuniteti bektashian është i organizuar në: 1) Gjyshatën e Krujës me qendër teqenë e Sheshemit në Fushë-Krujë që përfshin nën juridiksionin e saj zonën e Krujës, Durrësit, Shkodrës, Kurbinit, Matit, Dibërës, Bulqizës. 2) Gjyshatën e Elbasanit me qendër teqenë e Xhefai Babai që përfshin nën juridiksionin e saj zonën e Elbasanit, Gramshit, Librazhdit, Peqinit, Prrenjasit, Lushnjës, Kavajës. 3) Gjyshatën e Beratit me qendër teqenë e Tahir Babai në Prishtë të Skraparit që përfshin nën juridiksionin e saj zonën e Beratit, Skraparit, Përmetit. 4) Gjyshatën e Korçës me qendër teqenë e Turani që përfshin nën juridiksionin e saj zonën e Devollit, Korçës, Kolonjës, Pogradecit, Ersekës. 5) Gjyshatën e Gjirokastrës me qendër teqenë e Asim Babai Shtufit që përfshin nën juridiksionin e saj zonën e Gjirokastrës, Sarandës, Tepelenës.

Pasi u mbushën thujt dhjetë vjet nga rihapja e komuniteteve fetare, qeveria shqiptare ndjeu nevojën e rregullimit të marrëdhënieve të ndërsjella me to, kështu që në vitin 1999 u themelua Komiteti Shtetëror për Kultet<sup>375</sup>, para të cilit shtroheshin të gjitha çështjet e hapura me komunitetet fetare e, veçanërisht, zhvillimi i negociatave për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, sipas nenit 10 të Kushtetutës.

Kështu, marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare morën një drejtim të ri dhe krejt origjinal, pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1998, por pa cënuar traditën e sistemit shqiptar, thellësisht pluraliste në çështjet e marrëdhënieve me grupet fetare dhe në dakordësi të plotë me organizmat e zgjedhur apo emëruar lirisht prej tyre. Norma kushtetuese sanksionon lirinë për proselitizëm, rolin “kombëtar” të grupimeve fetare që shihet dhe vlerësohet si dukuri e përbashkët kolektive për të gjitha shtresat shoqërore që konvergjojnë në interesin e përbashkët të kohezionit dhe bashkimit kombëtar. Kjo normë është shumë më afër gjegjëses së saj italiane dhe spanjolle sesa asaj belge, për të cilën Komisioni i Venecias ushqen një simpati të veçantë, ndaj dhe “sponsorizohet” bujarisht për vendet Ballkanike<sup>376</sup>.

---

6) Gjyshatën e Vlorës me qendër teqenë e Kuzum Babai Sulltanit që përfshin nën juridiksionin e saj zonën e Vlorës, Fierit, Patosit, Roskovecit, Mallakastrës. Sa i përket çështjes së kompensimit të pasurive të shpronësuara nga reforma agrare, komunitetit bektashian iu rikthyen të gjitha teqet dhe tyrbet që i kishin mbijetuar konfiskimit dhe mësymjes për shkatërrimin e godinave të kultit. A. D. GULÇIÇEK, *Bektashimi në Shqipëri*, “Haçi”, 2000, 21-22.

<sup>375</sup> Rreth strukturës organizuese të komitetit dhe rregullores, shih: *Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet*. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 23 shtator 1999, <http://licodu.cois.it/305/view>., por edhe Vendim i këshillit të ministrave nr 128, datë 11 mars 2004, ku i janë bërë disa ndryshime ligjit paraardhës. “Gazeta Zyrtare”, viti 2004, 914–915.

<sup>376</sup> Gjatë punës së tij si udhëzues dhe mbështetës i politikave të vendeve të Europës Lindore në procesin e tranzicionit dhe si garant i ushtrimit të lirisë fetare dhe pluralizmit, Komisioni i Venecias i është referuar shpesh shembullit të sistemit belg lidhur me marrëdhëniet mes shtetit dhe besimeve fetare, dhe ka bërë thirrje për zbatimin e ligjeve të përgjithshme dhe të njëanshme për çështje të lirisë fetare, duke shpërfillur kështu mundësinë e përdorimit të ligjeve të negociuara me kultet, çka dëshmon padije, në mos mungesë interesi për traditat juridike të sistemit shqiptar për çështjet në fjalë, sistem që ka dhënë prova të kënaqshme për shmangien e konflikteve ndërfetare. Sidoqoftë, kjo këshillë u refuzua nga qeveria shqiptare, e cila iu rikthye përvojës dhe traditës juridike të

Pasojë e pashmangshme e kësaj zgjedhjeje është përdorimi i gjuhës shqipe gjatë rriteve fetare; shtetësia shqiptare për drejtuesit e kultit dhe të të gjithë të ngarkuarve me poste drejtuese në hierarkinë e komunitetit fetar; përpjekja e përbashkët për ruajtjen e të mirave kulturore me karakter fetar, falë vlerave të tyre kulturore; përpjekja e përbashkët për pavarësinë kombëtare<sup>377</sup>. Për këto arsye, shteti shqiptar vendos të bashkëpunojë me këto përbërës shoqërorë, në respekt të lirisë fetare dhe të ndërgjegjes, të laicizmit të shtetit dhe të ndarjes së tij nga komunitetet fetare<sup>378</sup>. Sistemi i Republikës së Shqipërisë favorizon përdorimin e legjislacionit për rregullimin e çështjeve të lirisë fetare vetjake dhe kolektive<sup>379</sup> dhe shfrytëzon mjete juridike të posaçme për t'i

---

vendit, duke u mbështetur në marrëveshjet bashkëpunuese, shumë më të përhapura si me sistemin italian 'mbi marrëveshjet' neni 8 i kushtetutës, ashtu dhe me atë spanjoll 'mbi pakicat', çka bëri të mundur nënshkrimin e një marrëveshjeje dakordësie me kishën katolike. Lidhur me këto qëndrime strategjike, për më gjerë shih: G. CIMBALO, *Tutela individuale e collettiva della libertà di coscienza e modelli di relazione tra Stato e Confessioni religiose nei paesi dell'Est Europa*. in *Libertà di coscienza e diversità di appartenenza religiosa nell'Est Europa*. Workshop multidisciplinare Est Europa "Libertà religiosa e diritti umani nell'Est Europa". Bologna. 21 - 22 settembre 2007, Bononia University Press Bologna, 2008, 15 - 29. Rreth marrëdhënieve mes shtetit dhe besimeve fetare, huazuar nga sistemi spanjoll, shih: D. LLAMAZARES FERNÁNDEZ, *Derecho de la libertad de conciencia* Madrid. Civitas Ediciones S.L., 2007; A. CASTRO JOVER, *Las minorías religiosas en el derecho español*. Cursos de Derechos Humanos de Donostia-San Sebastián Bilbao, De. Soroeta Licerias, Juan 1999, 211-244; A. FERNÁNDEZ-CORONADO GONZÁLEZ, *Estado y confesiones religiosas, un nuevo modelo de relación : (los pactos con las confesiones: leyes 24, 25 y 26 de 1992)*, Madrid, Civitas Ediciones S.L., 1995; P. C. PARDO PRIETO, *Laicidad y acuerdos del Estado*, Valencia. Lib. Tiran lo Blanch S. L., 2007; A. TORRES GUTIÉRREZ, *El desarrollo postconstitucional del derecho fundamental de libertad religiosa en España*, "Revista de Estudios Políticos" n.120, 2003, 243-268.

<sup>377</sup> Këto elemente i gjejmë edhe në përmbajtjen e statuteve të dy besimeve kryesore të fesë islame të vitit 1921 dhe 1925 si dhe në dekretin e cituar të vitit 1923.

<sup>378</sup> Për më tepër, siç e kemi theksuar tashmë, shteti shqiptar vendos që gjatë shtypjes së monedhës prej 50 cent frangësh, në anën retro të saj të vihet, në të njëjtin plan, imazhi i një xhamie, një teqeje dhe një kisha, si shenjë dalluese e unitetit kombëtar.

<sup>379</sup> Lidhur me këtë, le të shihet legjislacioni i zakonshëm që rregullon çështje të ndryshme të besimeve fetare lidhur me transmetimin e tyre në radio dhe televizion. *Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë*, Ligj nr.7680, datë 3.3.1993, <http://licodu.cois.it/589/view>. Siç do të shohin në vijim, kjo normë

konkretizuar këto të drejta, gjë që e dëshmon nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, konfigurimi juridik i të cilave është i ngjashëm me atë të ligjeve të negociuara. Kështu, nënshkruhet një marrëveshje dakordësie me Kishën katolike, sipas modelit të vendeve të tjera të Europës Lindore, por me përmbajtje dhe formë të kufizuar, sipas një marrëveshjeje-kuadër. Pika e parë vendimmarrëse e Komitetit Shtetëror të Kulteve, përcakton krijimin e këtij organizmi, veprimtaria e të cilit ka si qëllim vendosjen e marrëdhënies mes shtetit dhe komuniteteve fetare apo organizatave të ndryshme fetare. Sipas pikës tre të ligjit, Komiteti Shtetëror i Kulteve ka në përbërjen e tij një drejtor dhe katër anëtarë. Struktura organizuese dhe rregullorja e funksionimit të tij miratohen nga Kryeministri. Paga e drejtorit përcaktohet sipas pikës katër të ligjit, dhe fiksohet sipas nivelit A12 të grupit një<sup>380</sup>. Në pikën dy thuhet: Komiteti është një organ shtetëror, që varet nga Këshilli i Ministrave dhe:

- Rregullon marrëdhëniet e komuniteteve fetare, të shoqatave, të fondacioneve dhe të shoqatave humanitare me shtetin, pa bërë asnjë dallim në varësi të shtrirjes apo strukturimit organizativ të tyre.

- Negocion hartimin e marrëveshjeve mes përfaqësuesve të komuniteteve fetare dhe Këshillit të Ministrave, pa e cënuar paanshmërinë e tij në çështje të fesë. Një organ shtetëror ka për detyrë t'i përmbahet parimit të ndarjes, të laicizmit dhe të pluralizmit, tipare këto që karakterizojnë sistemin shqiptar si i paanshëm në çështje të administrimit publik.

- Duhet të ndjekë parimin e barazisë për trajtimin e komuniteteve fetare dhe të respektojë pavarësinë e tyre, sepse sipas parimeve të sipërpërmendura, komiteti duhet të ruajë barazinë dhe të njohë autonominë e përbërësve shoqërorë fetarë.

- Kujdeset të ruajë lirinë e fesë, mbarëvajtjen, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën mes komuniteteve fetare në

---

rimerret dhe përpunohet në përputhje me marrëveshjet bashkëpunuese të nënshkruara.

E njëjta rrugë ndiqet për njohjen e personalitetit juridik civil për besimet fetare, duke u mbështetur në ligjin për organizatat jofitimprurëse. Shih: *Për organizatat jofitimprurëse*, Ligj nr.8788, datë 7.5.2001, <http://licodu.cois.it/610/view>

<sup>380</sup> *Ibidem*.

Shqipëri. Këto synime janë parësore për shtetin, si siguri dhe garanci jo vetëm për të drejtat e individëve, por edhe për paqen fetare dhe ruajtjen e unitetit kombëtar.

- Mbështet veprimtarinë fetare duke u bazuar në Kushtetutën e vendit, në ligjet që rregullojnë këto çështje, duke vënë mbi gjithçka epërsinë e sistemit dhe përparësinë e vlerave kushtetuese.

- Bashkëpunon me komunitetet fetare për hartimin e projektligjeve dhe për punët që i takojnë. Bazuar në nenin 10 të Kushtetutës, komiteti i hap rrugë legjislacionit të negociueshëm, çka do të thotë se kërkon marrëveshje për çështje që kanë të bëjnë me lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes, aq të nevojshme për kohezionin shoqëror.

- Kërkon pëlqimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës në fushën didaktike, për programet e lëndëve të ndryshme dhe tekstet mësimore të fesë në shkolla, pasi ushtrimi i të drejtave dhe lirive fetare bëhet në respekt të rregullave të përgjithshme dhe me garancitë e nevojshme për respektin e lirisë së formimit vetjak të secilit.

- Merr pëlqimin e qeverisë për mundësinë e hapjes së shkollave private dhe të instituteve shkollore, ku jepen mësimet për fenë, duke mbajtur parasysh ndarjen administrative të territorit. Të drejtat e përmendura më lart për çështje të lirisë së formimit, kërkojnë aq vigjilencë dhe garanci, sa vetëm qeveria, si shprehje e zërit të ligjëvënës, mund t'i japë.

- Përcakton numrin e instituteve shkollore fetare, duke peshuar ekuilibrin e zgjedhjeve të ndërmarra.

- Në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe me Komunitetet fetare, angazhohet për ruajtjen e godinave të kultit, pasi këto janë pjesë e trashëgimisë historike kombëtare, pra të ruajtjes së identitetit të popullit shqiptar.

- I shpreh gjykimin e vet Ministrisë së Financave, rreth hyrjeve në vend të të mirave të karakterit fetar për komunitetet, si dhe për trajtimin e tyre nga sistemi tatimor, nëse duhen përjashtuar apo jo nga taksa doganore, sipas ligjeve në fuqi<sup>381</sup>.

---

<sup>381</sup> Bëhet fjalë për përjashtimin nga taksa doganore të sendeve të kultit për komunitetet fetare. *Për një ndryshim në ligjin*, nr. 8182 22.12.1996 "Për një

Pika pesë e këtij vendimi pohon se krijimi dhe funksionimi i Komitetit Shtetëror për Kultet duhet financuar nga fondet e shtetit që shkojnë për llogari të sekretarisë shtetërore për besimet fetare, për vitin 1999. Në pikën gjashtë thuhet se Komiteti shtetëror për kultet ngarkohet të zbatojë këtë vendim<sup>382</sup>.

Më tej rishikohet ky ligj në pikën 1 të tij, duke saktësuar që krijimi i Komitetit shtetëror për kultet ka si qëllim të lehtësojë krijimin, modifikimin, mbylljen e marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare që kanë për qëllim punët e fesë, në respekt të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Komiteti shtetëror për kultet është një institucion kombëtar i veshur me personalitet juridik dhe varet nga Këshilli i Ministrave. Drejtori dhe katër anëtarët që përbëjnë këtë komunitet, emërohen nga Këshilli i Ministrave. Për zgjedhjen e këtyre funksionarëve, Këshilli i Ministrave duhet të mbajë parasysh parimet e paanshmërisë së shtetit dhe barazinë mes komuniteteve fetare, si dhe faktin që vendimet e marra duhet të pasqyrojnë identitetin dhe vlerat e komuniteteve fetare. Struktura dhe rregullorja për veprimtarinë e Komitetit miratohen nga Kryeministri sipas propozimit të Sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. Sa i takon pagës së funksionarëve të Komitetit shtetëror për kultet, ajo përcaktohet në bazë të nivelit të të ardhurave të funksionarëve të shtetit<sup>383</sup>. Në vazhden e përkujdesjes që tregon qeveria kundrejt këtyre çështjeve, mund të përmendet edhe fakti që ajo i pajis drejtuesit e katër komuniteteve fetare me pasaportë diplomatike për t'ua lehtësuar barrën e mbajtjes së marrëdhënieve ndërkombëtare me kultet përkatëse, çka shpreh vlerësimin e saj për rolin e tyre në shoqërinë shqiptare<sup>384</sup>.

---

*ndryshim në ligjin*” nr. 7609, 22.9.1992; “*Për tarifat doganore*”, Dekret nr.1807, 30.5.1997, “Gazeta Zyrtare”, nr. 27, viti 1999, 1044 – 1045.

<sup>382</sup> *Për krijimin e komitetit shtetëror për kultet*, <http://licodu.cois.it/305/view>

<sup>383</sup> Me vendim të këshillit të ministrave nr. 128, datë 11 mars 2004, u bënë ndryshime mbi vendimin nr. 459, datë 23 shtator 1999 që ka të bëjë me krijimin e komitetit shtetëror për kultet. “Gazeta Zyrtare”, viti 2004, 914– 915.

<sup>384</sup> *Për një ndryshim në vendimin*, nr.335, 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, “*Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit*”, të ndryshuar (nr. 226, 5.5.2000) <http://licodu.cois.it/579/view>

Qëndrimi vlerësues i qeverisë karshi marrëdhënieve me përfaqësuesit e komuniteteve fetare ndjek përvojën e kahershme, ku gjejmë taktika dhe sjellje aq të sprovuara, sa t'u mbijetojnë edhe 40 viteve regjimi komunist. Madje mund të thuhet që vlerësimi dhe shfrytëzimi i mençur i traditës, ka orientuar më shumë se çdo gjë tjetër legjislacionin, prandaj Kushtetuta parashikon negociimin e marrëdhënieve me komunitetet, që vendosja e normave lidhur me to, të bëhet mbi bazën marrëveshjeve të ndërsjella. Në themel të kësaj qëndron vetëdija për rëndësinë e madhe që ka paqja ndërfaqetare në ruajtjen e unitetit të vendit dhe sigurinë e kalimit drejt një rendi demokratik të tipit liberal, i aftë për mbrojtjen e lirisë fetare dhe të ndërgjegjes. Sidoqoftë, shteti nuk e anashkalon përdorimin e legjislacionit të së drejtës së përbashkët, përkundrazi i referohet atij vazhdimisht edhe për rregullimin e çështjeve më delikate si, për shembull, ndërtimi i godinave të kultit, të cilat duhet t'u nënshtrohen planeve dhe ligjeve të urbanistikës. Edhe në këtë rast sistemi shqiptar shfaq veçoritë e tij dalluese, si ajo e ndarjes mes shtetit dhe komuniteteve fetare, çka është shprehje e një juridiksioni mjaft të mprehtë. Gjatë fazës së parë, negociatat mes Komitetit dhe komuniteteve fetare kanë për qëllim t'u japin zgjidhje çështjeve lidhur me Kishën katolike në Shqipëri, trajtimi dhe zgjidhja e të cilave monopolizon punën e këtij Komiteti, nga viti 2002 deri në 2006. Shteti shqiptar është i vetëdijshëm që, edhe pse komuniteti Katolik nuk përbën shumicën në vend, gjithsesi, Kisha katolike gëzon prestigj ndërkombëtar dhe, për më tepër, Kisha katolike e Shqipërisë luan një rol jo të vogël për akreditimin e qeverisë së vendit në komunitetin ndërkombëtar, duke i atribuar kredibilitetin e nevojshëm, falë qëllimeve të saj të shpallura, qartazi, për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe të lirisë fetare. Nga ana tjetër, emërimi i Nuncit, një diplomat i rafinuar, si Imzot Giovanni Bulaits, dëshmon interesin e Selisë së Shenjtë për të futur në një rrugë të re marrëdhëniet me këtë vend, i cili vazhdon të mbetet një shteg i hapur për të depërtuar në gjendjen e trazuar të Ballkanit. Dëshmi e kësaj është fakti që territori shqiptar u shndërrua në një prapavijë në kohën e konflikteve në Kosovë, Bosnjë, Maqedoni, Mal të zi, drejt të cilit vërshuan në masë refugjatët që u pritën dhe u rehatuan në kampet e ngritura enkas nga Karitasi shqiptar dhe ai ndërkombëtar. Vetëm nëpërmjet Shqipërisë, Kisha katolike mund të forcojë praninë e saj

në vendet ballkanike, duke u avitur për të krijuar marrëdhënie më të mira me Kishën ortodokse në një zonë kaq strategjike për ekuilibrat gjeopolitikë të Europës Lindore. Po ashtu, qeveria shqiptare është e interesuar të fitojë vlerësimin e Komunitetit Europian si një sistem demokratik që i përmbush të gjitha cilësitë e nevojshme për të hyrë në Europë, prandaj normalizimi i marrëdhënieve me Romën është thelbësor. Kështu pra, kushtet janë pjekur për të shkuar drejt marrëveshjes.



### 3. 4. Rilindja e Kishës katolike në Shqipëri

Një prej punëve që u krye menjëherë pas rënies së regjimit komunist, ishte rivendosja e marrëdhënieve diplomatike mes Nunciaturës Apostolike për Selinë e Shenjtë dhe Ambasadës për shtetin shqiptar, më 7 shtator 1991<sup>385</sup>. Pak ditë më vonë u emërua Nunci i parë Apostolik, Imzot Ivan Diaz, që vinte nga një përvojë e mëparshme si Nunc në vendet e Afrikës dhe Koresë së Jugut dhe çmohej aq shumë nga Sekretaria e shtetit të Vatikanit, sa që në vitin 2006 u emërua Prefekt i Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve<sup>386</sup>. Ky emërim nuk mund të mos shihet i lidhur me përvojën e tij të mëparshme për sigurimin e marrëdhënieve mes Sekretarisë së shtetit dhe vendeve të Europës Lindore. Si njohës i mirë i problematikave të kishave të kësaj zone, Imzot Diaz e di mirë se hapi i parë që duhet hedhur është sigurimi i vendeve të kultit, që të mos mungojë mbështetja e nevojshme infrastrukturore për kryerjen e punës baritore. Për t'ia arritur kësaj, i mbështetur edhe nga krerët e tjerë fetarë, me të cilët ndërton marrëdhënie të përzemërta, ai shtron kërkesën për

---

<sup>385</sup> Për rivendosjen e marrëdhënieve me Shqipërinë, Selia e Shenjtë i ktheu sytë edhe një herë nga komuniteti arbëresh në Itali dhe në maj të vitit 1991 dërgoi një komision të përbërë nga imzot. Lupinacci, Ipeshkëv i Lungrës (Lungro), imzot Paglia (i komunitetit të shën Egidio-s, më pas ipeshkëv i Ternit) dhe P. Pietro Maione, jezuit italian, por me pasaportë braziliane. Këta kishin për qëllim të mblidheshin me meshtarët dhe rregulltarët e mbijetuar nga regjimi dhe të pasqyronin përmbledhtazi praninë e tyre në vend. Në mbyllje të vizitës së tyre, bënë me dije se thuajse të gjithë meshtarët ishin vrarë apo kishin dhënë shpirt nën vuajtje të mëdha e ndonjë, në moshë të shkuar, prandaj, në një gjendje të tillë, tejet të vështirë, duhej nisur nga e para.

<sup>386</sup> Në vitet 1973-1982, imzot. Ivan Diaz ka qenë kryetar i seksionit pranë sekretarisë së shtetit në Bashkimin Sovjetik, Shtetet Balltike, Bjellorusi, Ukrainë, Poloni, Bullgari, Kinë, Vietnam, Laos, Kamboxhia, Afrikën e Jugut, Namibi, Lesoto, Suazilend, Zimbabvejë, Etiopi, Ruandë, Burund, Ugandë, Zambijan, Kenia, Tanzani. Gjatë gjashtë viteve të qëndrimit të tij në Shqipëri, imzot Diaz ka punuar veçanërisht për ringritjen e kongregacioneve femërore dhe shtrirjen e tyre sa më të gjerë në vend, duke i mëshuar rolit të rëndësishëm të rregulltareve nga të gjitha trojet etnike shqiptare, e në mënyrë të veçantë, shembullit të Nënë Terezës.

[http://www.vatican.va/news\\_services/press/documentazione/documents/cardinale\\_nali\\_biografie/cardinali\\_bio\\_dias\\_i\\_it.html](http://www.vatican.va/news_services/press/documentazione/documents/cardinale_nali_biografie/cardinali_bio_dias_i_it.html)

rikthimin e të mirave të konfiskuara dhe ia del mbanë duke shfrytëzuar legjislacionin e zakonshëm për t'i trajtuar këto probleme me ligjet e përgjithshme të shtetit lidhur me rikthimin e të mirave të shpronësuara<sup>387</sup>.

Sidoqoftë, normalizimi i marrëdhënieve shënon vetëm fazën e parë të këtij procesi, i cili duhet të ndjekë ritmet e duhura. Mungesës së klerikëve vendas i vjen në ndihmë dërgimi i meshtarëve nga Italia dhe mbërritja e prelatëve me etni shqiptare nga vendet fqinje. Emërimi i ipeshkvinjve të parë, lidhet me emra prelatësh të shkuar në moshë, të cilët i mbijetuan persekutimit; detyra e ipeshkvit të Tiranës dhe Durrësit i ngarkohet një malazezi me etni shqiptare, Imzot Rrok Mirditës, i cili ka shërbyer për njëzet vjet si kapelan i shqiptarëve në New York. Për të ruajtur traditën e ndarjes administrative mes kishës katolike në Veri dhe asaj në Jug, si Administrator apostolik për këtë të fundit, emërohet, fillimisht, vetë imzot Ivan Diaz, e më pas imzot Hil Kabashi, shqiptar i Kosovës, françeskan i ritit bizantin, kapelan i shqiptarëve në Gjermani. Faza e parë e normalizimit të marrëdhënieve mbyllet me 22 prill 1993, kur ambasadori i parë shqiptar, Wili Kamsi, prezantoi letrat kredenciale në Vatikan, pak ditë para vizitës të papës Gjon Pali II në Shqipëri me 25 prill 1993. Vizita e Atit të Shenjtë në Shkodër dhe Tiranë, shënoi rilindjen zyrtare të Kishës shqiptare, pasi u rindërtua hierarkia e Kishës katolike në vend me emërimin e katër ipeshkvinjve: imzot Rrok Mirdita konfirmohet Ipeshkëv i Tiranës dhe Durrësit; për Shkodrën emërohet imzot Frano Ilia, me ndihmës imzot Zef Simonin. Kësaj liste i shtohen edhe dy ipeshkvinj françeskanë: imzot Robert Ashta për Veriun e skajshëm të vendit dhe Imzot Hil Kabashi si Administrator apostolik për Jugun<sup>388</sup>. Jo më vonë se një vit, më 29 nëntor 1994, Papa emëroi kardinalin e parë shqiptar, Shkëlqesinë e tij, Mikel Koliqin. Kështu, struktura organizuese e Kishës katolike në Shqipëri rivishet me petkun e saj historik. Tashmë mund të ngrihet Konferenca

---

<sup>387</sup> *Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, ligj nr. 7698, datë 15.4.1993*, <http://licodu.cois.it/602/view>; *Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, ligj nr.8053, datë 21.12.1995*, <http://licodu.cois.it/603/view>.

<sup>388</sup> Dioqeza e Rrëshenit u themelua në vitin 1996.

Ipeshkvnore Shqiptare<sup>389</sup> që, sipas pikës dy të normës 449 të Kodit të së drejtës kanonike, ka një rëndësi të veçantë për rregullimin e sistemit kanonik.

Së pari, duheshin sqaruar mirë mënyrat e përfitimit të personalitetit juridik civil, por duhej mbështetur, gjithaq, kërkesa e Kishës shqiptare për t'u veshur juridikisht sipas rregullores së brendshme, para se të sqaroheshin marrëdhëniet e saj me Selinë e Shenjtë dhe lidhjet me kishën universale. Ishte ende i gjallë kujtimi i rropatjeve të qeverive të ndryshme shqiptare, nga ajo e Zogut e deri tek e Hoxhës, për ndërtimin e një Kise katolike kombëtare.

Gjithsesi, nuk shtrohej vetëm nevoja e rindërtimit të hierarkisë, por edhe e vetë klerit (rregulltarët dhe rregulltaret mezi bëheshin 35-40 vetë gjithsej dhe, për më tepër, ishin shumë të moshuar), për këtë, iu kushtua vëmendje e madhe sigurimit të tyre duke sjellë klerikë të huaj. Jo më parë se më 29 qershor të vitit 2000, pas kryerjes së studimeve filozofike-teologjike në seminarin ndërdioqezan të Shkodrës (i rindërtuar posaçërisht në vitin 1992, si një prej veprave të para të rinovimit të katoliçizmit), u bë shugurimi i meshtarëve të parë dioqezanë dhe françeskanë pas periudhës komuniste. Nga ana tjetër, duke shfrytëzuar prestigjin e madh që gëzonte Nënë Tereza në nivel ndërkombëtar, u bë përpjekje për përhapjen e urdhrave të rregulltareve, pa lënë pas

---

<sup>389</sup> Sipas §2, neni 449 i kodit të së drejtës kanonike të vitit 1984: “Konferenca ipeshkvnore, me t’u themeluar në mënyrë të ligjshme, gëzon personalitet juridik që i buron nga e drejta”. G. FELICIANI, *Episcopal Conferences from Vatican II to the 1983 Code* “*The Jurist*”, 1988, 48,11-25; ID., *Gli episcopati nuovi protagonisti delle relazioni tra la Chiesa e gli Stati*, “*Rivista periodica de re canonica*” Pontificia Università Gregoriana, 2000, 89, 661-680; ID. *Il potere normativo delle Conferenze Episcopali nella comunione ecclesiale*, “*Monitor Ecclesiasticus*”, 1991, 116, 87-93 ID., *Le Conferenze Episcopali dal Vaticano II al nuovo Codice di Diritto Canonico*, “*La Scuola Cattolica*”, 1988, 116, 124-136; ID., *Le Conferenze episcopali nel magistero di Giovanni Paolo II*, “*Aggiornamenti Sociali*”, 1987, 38, 141-154. Da ultimo vedi: A FABBRI, *Presenza istituzionale e pastorale cattolica in Europa*, Soveria Mannelli, Rubettino, 2011.

Aktualisht, Konferenca ipeshkvnore shqiptare përbëhet nga shtatë ipeshkvinj: Arqipeshkvi metropolit Rrok Mirdita (Tiranë-Durrës), Imzot George Frenndo, ipeshkëv ndihmës në Tiranë-Durrës, arqipeshkvi metropolit Angelo Massafra (Shkodër), imzot Luçjan Agustini (Sapë), imzot Cristoforo Palmieri (Rrëshen), imzot. Ottavio Vitale (Lezhë) e imzot. Hil Kabashi (Administrator apostolik për Shqipërinë jugore).

dore përkujdesjen ndaj thirrjes hyjnore ndër shqiptarët e Ballkanit. Gjatë gjithë periudhës komuniste, Kisha katolike, falë asaj lirie të brishtë që gëzonte në ish Jugosllavi, ia kishte dalë të formonte rregulltore shqiptare nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i zi, prania e të cilave tashmë ishte shumë e çmuar për rimarrjen e punëve baritore dhe të apostullimit në Shqipëri. Kishte nevojë urgjente për klerikë, si për formimin katekistik, ashtu dhe për veprimtarinë shkollore dhe arsimin profesional, pa përjashtuar edhe punët e bamirësisë, veprimtari këto, që do të rigjeneronin përtëritjen shoqërore dhe do të ndihmonin misionin e ungjillëzimit të Kishës katolike, të përqendruar kryesisht në Shkodër dhe rrethinat e saj.

Në vitin 2005 numëroheshin vetëm pesë shkolla, numër që me kalimin e kohës shkoi në pesëdhjetë e një. Këto ritme pune i siguronin Kishës katolike në Shqipëri autonomi më të madhe vepruese, gjë që ishte tejet e nevojshme në një vend ku ishin mbledhur predikatorë dhe misionarë të mbërritur nga anë e anës, për të rikthyer fenë në shtetin e vetëm në botë, të vetëshpallur ateist. Në këto kushte, Kisha katolike duhej të dinte të dëshmonte rrënjët e saj historike në vend dhe të ishte e gatshme të ngrihej në nivelin e interesave të përgjithshme të popullit shqiptar, ndaj Konferenca Ipeshkvnore vendosi t'i drejtohej me një mesazh publik dhe solemn të gjithë kombit, kur ky ishte i përfshirë në skandalin e piramidave dhe po merrte rrugët e eksodit në masë, kryesisht drejt brigjeve Italiane<sup>390</sup>. Mesazhi përcillte vullnetin e Kishës katolike për të bërë gjithçka ishte e mundur në të mirë të gjendjes ekonomike dhe shoqërore në vend<sup>391</sup>.

Në thirrjen që Konferenca Ipeshkvnore i drejtoi drejtpërsëdrejti popullit shqiptar, nëpërmjet mediave që nuk ia kursenin minutazhin, deklaroi se, edhe pse gjendja ekonomike dhe shoqërore është e rëndë, rreziku i luftës civile mund të

---

<sup>390</sup> Lidhur me këtë, shih: E. GIAP PARINI, *Richiedenti asilo e strutture di accoglienza in provincia di Lecce Asylumisland: accoglienza ed inserimento socio-economico di rifugiati e richiedenti asilo nelle regioni del Sud Italia*, (a cura di Ada Cavazzani), Rubettino editore, Soveria Mannelli, 2005, 128 ss.

<sup>391</sup> Konferenca ipeshkvnore e Shqipërisë, *Deklaratë e konferencës ipeshkvnore të Shqipërisë mbi gjendjen aktuale në vend*, Lezhë, 18 prill 1997.

[http://press.catholica.va/news\\_services/bulletin/news/544.php?index=544&po\\_date=18.04.1997&lang=en](http://press.catholica.va/news_services/bulletin/news/544.php?index=544&po_date=18.04.1997&lang=en)

konsiderohet i shmangur, edhe falë bashkëpunimit mes komuniteteve fetare. Sidoqoftë, lind nevoja që, pasi të merret miratimi nga Ati i Shenjtë<sup>392</sup>, t'u bëhet apel të gjithë atdhedashësve, pa dallim, për pajtim dhe dialog mes të gjitha palëve përgjegjëse të shoqërisë shqiptare. Për Konferencën Ipeshkvnore, përparësi të plotë ka rivënia e rendit publik dhe e ligjshmërisë në vend; është gjithaq e nevojshme të punohet për të mirën e përbashkët, jo vetëm për të siguruar bazën materiale për jetesë, por edhe atë shpirtërore, nëpërmjet një angazhimi jo të dhunshëm, sistematik dhe të vazhdueshëm, i aftë për të siguruar përmirësim të pandërprerë. Kjo kërkon bashkëpunimin e palëve, në respekt të njeriut dhe të drejtave të tij, për të rikthyer besimin e qytetarëve tek pushtetarët e tyre. Asgjë nuk është e mundshme, pa kthyer më së pari rendin publik. Kështu mbyllet deklarata e ipeshkvinjve, duke cituar papa Gjon Palin II.

Ata çmojnë ndihmën e ofruar nga Komuniteti European, por ritheksojnë se Shqipëria duhet dhe mund të ndërtohet nga shqiptarët, nga duart e tyre. Që t'ia arrihet këtij qëllimi, lind nevoja e edukimit të ndërgjegjes vetjake lidhur me të drejtat dhe detyrimet që i takojnë secilit. Çdo njeri duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe t'i përkushtohet punës së vet, të zbatojë drejtësinë me transparencë e vendosmëri dhe të luftojë sjelljet korruptuese.

Me këtë rast, Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, u shpreh falenderimin e saj më të thellë misionareve dhe misionarëve që, duke vënë jetën e tyre në rrezik, qëndruan në Shqipëri, pranë besimtarëve. Falenderimi u shkon edhe atyre që mbrojtën dhe vazhdojnë të mbrojnë veprat e Kishës dhe qendrat e saj, duke përfshirë këtu edhe besimtarët e Kishës ortodokse dhe myslimanët që dhanë mbështetjen e tyre, duke dëshmuar, kësisoj, unitet kombëtar ndër shqiptarë, sidomos, në kohë krizash.

Ipeshvinjtë iu drejtuan, së fundi, Europës duke ritheksuar se Shqipëria i përket familjes së madhe europiane dhe se nuk i mungon dëshira për t'iu bashkuar asaj për arsye historike dhe kulturore, duke punuar dhe shfrytëzuar çdo mundësi për t'ia arritur këtij qëllimi, edhe me ndihmën e vendeve miq. Sidoqoftë,

---

<sup>392</sup> K. Wojtyła, *Appello alle nazioni "non dimenticate l' Albania"* 6 dicembre 1997,

Europa duhet t'i përvishet çështjes shqiptare me një impenjim më të madh dhe më të efektshëm nga ç'ka treguar deri tani. Kështu, investimet e saj të shumta, duhet të përkthehen në më shumë zhvillim ekonomik për vendin, por përveç ndihmave humanitare që shkojnë për ata që janë vërtetë në nevojë, duhet të përkujdeset edhe për vlerat shpirtërore, nëpërmjet edukimit të demokracisë së vërtetë.

Së fundi, Konferenca Ipeshkvnore kujton se një ndër mënyrat për të kapërcyer krizën, është edhe emigracioni i kontrolluar, sidomos ai sezonal, i cili mund të zvogëlojë ndjeshëm papunësinë në vend<sup>393</sup>.

Angazhimi i Kishës katolike në fushë ekonomike dhe shoqërore është një zë i rëndësishëm në Shqipëri që nga vitet e para të rindërtimit të demokracisë. Në vitin 1993 në vijim të vizitës së Atit të Shenjtë, kongregata kishtarë "Bijtë e Zojës së Papërlyer", themeloi një fondacion, mbështetur në të drejtën shqiptare, i cili e mori emrin nga shenjtorja e njohur e Shkodrës, *Zoja e Këshillit të Mirë*. Vepra e parë që hapja e poliambulancës, pranë qendrës së kryeqytetit.

Më pas, qeveria e Tiranës i kërkoi Nënë Terezës të ndihmojë në ngritjen e një spitali. Ky projekt u mor përsipër nga fondacioni i sipërpërmendur, falë angazhimit të kongregatës në fushën e shëndetësisë. Në vitin 1995 filloi puna për ndërtimin e spitalit, por u ndërpre herë pas herë për arsye nga më të ndryshmet, nga mungesa e rendit në vitin 1997 për shkak të shembjes së piramidave financiare, deri tek lufta e Kosovës, e cila solli në Shqipëri qindra e mijëra refugjatë. Për një vit, ky fondacion iu përkushtua punës për drejtimin e një kampi strehimi të ngritur prej tij për refugjatët kosovarë, diku, në periferi të Tiranës<sup>394</sup>. Nga

---

<sup>393</sup> Thirrja mbyllet me fjalët e shën Palit: "Shkoni mirë me njëri-tjetrin, jetoni në paqe. Dhe Hyji që dhuron dashuri dhe paqe do të jetë me ju" (2 Korintasve 13, 11) dhe mban firmën e Shkëlqesisë së tij, imzot Rrok Mirditës, Ipeshkëv i Tiranës dhe Durrësit, aso kohe, edhe president i konferencës ipeshkvnore; firmën e imzot Frano Illisë, Ipeshkëv metropolit i Shkodrës; imzot Robert Ashtës, ipeshkëv i Pultit, imzot Angelo Masafres, ipeshkëv i Rrëshenit dhe administrator apostolik për Lezhën; imzot Hil Kabashit, administrator apostolik për Shqipërinë jugore; imzot Zef Simonit, ipeshkëv ndihmës i Shkodrës.

<sup>394</sup> Le të shihet marrëveshja për administrimin e një spitali, e firmosur nga qeveria shqiptare, konkretisht nga ministri i shëndetësisë, aso kohe, Tritan

ana tjetër, iu krijuan kushtet e nevojshme punës së Karitasit, drejtimi i të cilit iu besua ipeshkvit të Tiranës<sup>395</sup>.

Ndërkohë që marrin jetë këto marrëveshje “më të vogla”, që mund të quhen të dorës së dytë, vazhdojnë negociatat mes shtetit dhe Selisë së Shenjtë, të drejtuara nga Nunci, imzot Giovanni Bulaits, ekspert për çështjet juridike lidhur me shtetin dhe pjesëmarrës aktiv në Konferencën Ipeshkvnore shqiptare.

Me 23 mars të vitit 2002 u firmos marrëveshja e parë mes Selisë së Shenjtë dhe Republikës së Shqipërisë<sup>396</sup>. Kjo shënoi mbylljen e një fazë të gjatë përballjesh në marrëdhëniet mes shtetit dhe Kishës katolike dhe vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjella, të cilat, sa ç’i japin liri të plotë veprimi Kishës katolike, po aq e çlirojnë Shqipërinë nga dyshimet e forta që ngrinte komuniteti ndërkombëtar për sjelljen e gjatë armiqësore të shtetit shqiptar kundrejt komuniteteve fetare.

Sidoqoftë, do të duhet ende kohë derisa komuniteti ndërkombëtar të kuptojë se ç’kah u ka dhënë sistemi shqiptar marrëdhënieve me komunitetet fetare, dhe ç’lloj çelësi leximi duhet për të kuptuar nocionin e laicizmit të shtetit, që sistemi shqiptar ka përpunuar dhe shkruar me sistemin e vet juridik. Vetëm atëherë, Europa dhe Komisioni i Venecias, pra i gjithë Këshilli i Europës do të jenë në gjendje të pranojnë efektin e kësaj zgjidhjeje origjinale që ia doli ta

---

Shehu dhe nga përfaqësuesi i kishës katolike, imzot Rrok Mirdita. “Gazeta Zyrtare”, nr. 13, 2000, 573-577. Po ashtu, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 23 maj 2001, lidhur me kalimin në pronësi të kishës katolike të tokës për ndërtimin e një kompleksi universitar, konkretisht, Universitetit katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe të “Qendrës së rehabilitimit dhe të mjeksisë sportive” me një sipërfaqe prej 49 453 m<sup>2</sup>. Bashkia e Tiranës ngarkohej për nënshkrimin e kontratës për shitblerjen e tokës. “Gazeta Zyrtare”, n° 25, 2001, 784-785.

<sup>395</sup> Shih ligjin nr. 8768, datë 19 prill 2001, me anë të të cilit parlamenti shqiptar ratifikon marrëveshjen mes Këshillit të Ministrave, Dioqezës së Rrëshenit dhe karitasit shqiptar, për ndërtimin e qendrës së formimit profesional “San Giuseppe Lavoratore”. Dioqeza e Rrëshenit merr përsipër realizimin e projektit marrjen e masave të nevojshme për mbarëvajtjen e shkollës. Nga ana tjetër, karitansi shqiptar, angazhohet për respektimin e legjislacionit shqiptar. Marrëveshja e miratua me dekretin nr.2001 të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Mejdani “Gazeta Zyrtare”, nr. 3, 2001, 669-671

<sup>396</sup> *Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës katolike*, Ligji nr. 9365, 31.3.2005, <http://licodu.cois.it/571/view>.

mbajë Shqipërinë larg konflikteve dhe luftërave fetare, që përfshinë dhe ende nuk janë shuar në Ballkanin Perëndimor<sup>397</sup>.

Synimet kryeneçe të komunitetit ndërkombëtar, të Komisionit të Venecias, të Këshillit të Europës dhe të “ekspertëve” të tyre rrezikojnë të bëjnë dëm më të madh sesa fundamentalistët islamikë, me këmbënguljen e tyre për të “normalizuar” Shqipërinë, të bindur se zgjidhja për problemet e Ballkanit vjen nga “një kolonizim i urtë” kulturor dhe juridik i shteteve të Europës Perëndimore.

Kjo epërsi e pandehur nga shkenca juridike dhe nga manovrat e qeverisë së Europës Perëndimore, me t’u eksportuar në kontekste të tjera, ka rezultuar krejt e papërshtatshme. Prandaj, nëse shtetet e Europës Lindore shihen me sy asimilues, duke ua lëvizur rrënjët e tyre historike dhe kulturore, për t’i ngjeshur në kallëpe të parapërgatitura enkas për integrimin e tyre, kjo s’do të shërbente gjë tjetër, veçse për të gatuar konflikte, madje në një zonë që historikisht nuk i është kursyer luftës kur i janë mohuar respekti dhe dinjiteti.

---

<sup>397</sup> Padyshim që qeveria e Shteteve të Bashkuara, tashmë ka vlerësim pozitiv si për shkallën e mbrojtjes së lirisë fetare, ashtu edhe për mundësinë që u krijohet grupeve fetare për të zhvilluar veprimtarinë e proselitizmit në Shqipëri. Lidhur me këtë, shih raportin e Departamentit të Shtetit të vitit 2007: <http://www.state.gov/j/drl/rls/irf/2007/90147.htm>



### 3. 5. Marrëveshjet e dakordësisë me Kishën katolike. Konferenca Ipushkvnore e Shqipërisë harton statutin e vet.

Edhe pse marrëveshja për *Rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella*<sup>398</sup> duket se bën pjesë në tipologjinë e atyre të nënshkruara nga Selia e Shenjtë me shtetet e ish vendeve socialiste<sup>399</sup>, Republika e Shqipërisë përbën një rast më vete për shkaqe krejt historike. Para së gjithash, kemi të bëjmë me një shtet që nuk ka shumicë katolike dhe ku krishterimi në tërësi, edhe pse ka luajtur një rol historik të rëndësishëm, mbetet pikë referimi vetëm për një pakicë të vogël shtetasish shqiptarë. Një gjendje e tillë kuptohet, sidomos, në parathënien e marrëveshjes, qëllimi i shpallur i së cilës është të rregullojë statusin juridik të Kishës katolike në Shqipëri, për t'i ofruar asaj garancitë ndërkombëtare, mungesa e të cilave, në të shkuarën, përbënte një problem serioz për këtë komunitet fetar<sup>400</sup>. Nuk ka gjurmë parathënieje apo hyrjeje, siç e gjejmë në marrëveshjet e tjera, që të kujtojnë rolin historik që ka luajtur besimi katolik, si përsa i takon formimit të identitetit kombëtar, ashtu dhe për bashkimin e vendit. “*Marrëveshja për zgjidhjen e çështjeve juridike*” përbën, ashtu si

---

<sup>398</sup> Shih: *Accordo fra la Santa Sede e la Repubblica di Albania sul regolamento delle relazioni reciproche*, <http://licodu.cois.it/308/view>, e nënshkruar nga palët me 23 mars 2002 dhe e miratuar në parlament me 21 shtator 2002.

<sup>399</sup> Marrëveshjet për marrëdhëniet e ndërsjella i nënshkroi Jugosllavia në vitin 1966, Polonia në vitin 1993, Kroacia në vitin 1996, Estonia në vitin 1999, Letonia, Lituania dhe Sllovakia në vitin 2000, Sllovenia gjatë viteve 2001-2004. Të gjitha këto mund të konsultohen në adresën: <http://licodu.cois.it>. Për një analizë krahasuese të marrëveshjeve të nënshkruara nga Gjon Pali II, të shihet numri monografik i revistës “*Quaderni di Diritto e Politica Ecclesiastica*” Vëllimi 2, 1 prill 1999, ku kanë sjellë kontributin e tyre: A. Krassikov, F. Margiotta Broglio, G. Rumi, R. Astorri, I. C. Ibàn, G. Barberini, A. Hollerbach, R. Palomino, R. Minnerath, A. Talamanca, R. Puza, J. Gaudemet, C. Cardia, S. Raponi, F. Vasini, S. Ferrari, nonché G. BARBERINI, *Stato e religione nel processo di democratizzazione dei Paesi europei post-comunisti*, Stato, Chiese e pluralismo confessionale, Rivista telematica, prill 2009,

[http://www.statoechiese.it/images/stories/2009.4/barberini\\_statom.pdf](http://www.statoechiese.it/images/stories/2009.4/barberini_statom.pdf)

<sup>400</sup> “Selia e Shenjtë dhe Republika e Shqipërisë, në frymën e miqësisë dhe me dëshirën e përbashkët për të përforcuar dhe promovuar marrëdhëniet ekzistuese mes tyre si dhe me synimin për të rregulluar me marrëveshje statutin juridik të Kishës Katolike në Shqipëri, vendosën...”

për vendet e tjera të Europës Lindore, një ligj kuadër për çështje të rëndësishme të veçantë që rregullojnë marrëdhëniet ndërkombëtare. Shteti merr përsipër të miratojë disa norma shoqëruese për marrëveshjen, ku, falë autonomisë ligjvënëse të tij dhe në përputhje me Kushtetutën, ai mund të shfuqizojë çdo normë të së drejtës së përbashkët, të karakterit të përgjithshëm. Kjo marrëveshje mund të emërtohet si protokoll i ndarjes mes shtetit dhe fesë. Sidoqoftë, tipari më i veçantë i kësaj marrëveshjeje shprehet në nenin 9 të saj, aty ku i referohet nenit 122 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës shqiptare për të konkretizuar lidhjen e saj me burimet e së drejtës. Prej këndej rrjedhin norma të përpunuara nga një komision *ad hoc*, i cili nëpërmjet strukturës së ligjeve të negociuara, e shndërron marrëveshjen në një laborator burimesh të pazakonta dhe normash që, me t'u miratuar, hyjnë menjëherë në fuqi dhe mund të rishikohen vetëm me dakordësinë e palëve. Duke shqyrtuar testin e marrëveshjes, mund të vihet re se i mëshohet lirisë së shpalljes dhe ushtrimit në publik të fesë katolike dhe, siç garantohet me Kushtetutë për të gjitha besimet, marrëveshja pohon të drejtën e Kishës katolike për t'u organizuar dhe për të kryer misionin e saj.

Kishës i njihet personaliteti juridik publik i institucioneve të saj, duke u garantuar: arqidioqezave, dioqezave, administratave apostolike, famullive, komuniteteve fetare, misioneve, shoqatave, seminareve, shkollave, institucioneve arsimore të të gjitha niveleve dhe qendrave shëndetësore të njëjtin status që u njeh atyre e drejta kanonike, me kusht që ata të regjistrohen si persona juridikë pranë gjykatës së Tiranës, ose sipas rastit, pranë gjykatave kompetente mbi territorin ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre. Kështu, trajtimi që i bëhet Kishës katolike nga e drejta shqiptare është i njëjtë si për të gjitha besimet e tjera dhe mbështetet në marrëveshjet e nënshkruara me komunitetet e tjera fetare, si dhe në *Ligjin për njohjen e personalitetit juridik të personave juridikë të Kishës katolike*, i miratuar në 2005-n. Sipas këtij ligji, Kishës Katolike i lejohet të ngrejë strukturat e veta, të krijojë dhe modifikojë trajtën e personave juridikë kishtarë, sipas së drejtës kanonike dhe në respekt me legjislacionin shqiptar<sup>401</sup>.

---

<sup>401</sup> *Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës katolike*, Ligji Nr. 9365, 31.3.2005. Ky ligj analizohet nga: G. DAMMACCO,

Marrëveshja i garanton Selisë së Shenjtë dhe Kishës katolike, në Shqipëri, lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës, ndërkohë që marrëdhëniet diplomatike i trajton në nivelin e Nunciaturës apostolike dhe të Ambasadës. Nën garancinë e tyre, vendosen procedurat përkatëse për caktimin e detyrave kishtarë: Selia e Shenjtë ka dorë të lirë për zgjedhjen e një rregulltari për zyrën e ipeshkvit apo të administratorit apostolik, por, para se ta shpallë emërimin e tij, vë në dijeni, në shenjë kortezie dhe në mënyrë të rezervuar, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet ministrit të Jashtëm<sup>402</sup>.

Marrëveshja trajton edhe një prej problemeve që kishte shkaktuar përplasje të forta mes palëve në të shkuarën: praninë e rregulltarëve dhe klerikëve me shtetësi të huaj në Shqipëri. Kjo çështje është e një rëndësie të veçantë, qoftë për mungesën e klerikëve shqiptarë, qoftë për faktin që Selia e Shenjtë e konsideron vendin tokë misioni, çka do të thotë që duhet punuar për fuqizimin e strukturave në vend, jo vetëm në nivel dioqezash dhe famullish, por edhe për ngritjen e rregullave fetare me ndihmën e rregulltarëve dhe kishtarëve të huaj. Me ndihmën e mjeteve që ofron drejta e përbashkët, ipeshkvijnjtë dhe administratori apostolik konsiderohen si sipërmarrës që përdorin krah pune nga vende të huaja dhe, si të tillë, ashtu si çdo punëtor me shtetësi të huaj, duhet të kërkojnë vendqëndrim, të nënshkruajnë lejen e punës, që nënkupton kryerjen e shërbimit baritor, dhe të paguajnë taksat siç e parashikon ligji. Sidoqoftë,

---

*Note alla vigente legge Albanese sugli Enti Ecclesiastici, "Iura Orientalia" II, 2005, 52-60 [www.iuraorientalia.net](http://www.iuraorientalia.net), i cili nuk e kupton si duhet vlerën e kësaj marrëveshjeje e aq më pak mbrojtjen që i ofron asaj neni 122 i kushtetutës dhe i sheh të shkëputura nga konteksti normat e kësaj marrëveshjeje, pasi nuk i referohet ligjit *Për organizatat jofitimprurëse* të vitit 2001 dhe procedurave që parashikon ky ligj. Në fakt, siç e kemi theksuar, ky ligj përbën bazën kryesore ku janë mbështetur komunitetet fetare, përfshirë edhe atë katolik, për t'u organizuar brenda sistemit juridik shqiptar për kryerjen e veprimtarisë së tyre.*

<sup>402</sup> Më në fund i hapet rrugë kësaj procedure që kishte ngjallur aq debat dhe aq polemika në të shkuarën, madje deri në atë pikë sa të ndërpriteshin negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes me Kishën katolike gjatë mbretërimit të Zogut.

dhënia e lejes së qëndrimit nuk do të hasë në asnjë pengesë, ndërsa pagimi i taksës është një procedurë e rëndomtë<sup>403</sup>.

Pra, shteti nuk heq dorë nga qëndrimet e tij parimore që i sigurojnë sovranitet të plotë në vendimmarrje, duke u dhënë zgjidhje çështjeve të tilla nëpërmjet së drejtës së përbashkët, por pa ua mohuar kushtet e favorshme komuniteteve fetare.

Një pjesë e marrëveshjes merret me praninë e Kishës katolike në shoqëri. Asaj i garantohet, qoftë e drejta për të mbajtur mjetet e veta të komunikimit, qoftë mundësia e shfrytëzimit të mjeteve të komunikimit publik, sipas dispozitave përkatëse në fuqi, të vlefshme për të gjitha kultet. Kisha katolike mund të ngrejë dhe drejtojë shkolla, spitale, klinika dhe qendra shoqërore në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Siç është vepruar edhe me komunitetet e tjera fetare, Republika e Shqipërisë do të rikthejë pasuritë e këtij besimi fetar, sipas ligjeve shqiptare dhe do të mbështesë regjistrimin përsëdyti të tyre në emër të Kishës katolike, pranë zyrave kompetente të Republikës (neni 8). Për çështje të veçanta, mund t'i referohet legjislacionit të përbashkët dhe organit të *Agjencisë për kthimin dhe kompensimin e pronës*. Në rast çështjesh të diskutueshme, të pazgjidhshme apo pretendimesh të ngritura nga Kisha katolike, nga komunitete të veçanta apo institucione katolike në Shqipëri, ngrihet një komision *ad hoc* me detyrën e gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja palët; për interpretimin dhe zbatimin e marrëveshjes, palët angazhohen të gjejnë zgjidhje miqësore<sup>404</sup>.

---

<sup>403</sup> Për përmbushjen e detyrimeve baritore, ipeshkvi dhe administratori apostolik kanë të drejtë të sjellin në Shqipëri, meshtarë, anëtarë të kongregatës fetare apo laike me shtetësi të huaj si dhe të nënshkruajnë kërkesën për lejen e qëndrimit dhe të punës së këtyre shtetasve, kërkesë që u drejtohet autoriteteve shqiptare, siç e parashikojnë ligjet e Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast ndiqet procedura e parashikuar në ligjin për shoqatat non profit. Shih § 3. 1. Pas një kërkesë formale nga ana e ipeshkvit apo administratorit dhe pas shlyerjes së taksës përkatëse, lëshohet leja e qëndrimit dhe ajo e punës me motivimin për kryerjen e shërbimit baritor, ashtu siç e parashikon ligji. Leja duhet të jetë e vlefshme për pesë vjet, por, për shkak të zgjatjes së procedurave, ajo, shpeshherë, kufizohet në vetëm një vit, duke lënë shteg për polemika, sidomos kur kërkohet rinovimi i saj. *Ibidem*.

<sup>404</sup> Kjo marrëveshje hyn në fuqi sapo të njoftohet kryerja e proceduarve përkatëse nga të dyja palët.

Kjo dispozitë e kthen normat e dala nga puna e Komisionit, në pjesë integruese të marrëveshjes dhe u siguron atyre papreksshmërinë, për aq kohë sa palët bien në ujdi për funksionimin e tyre<sup>405</sup>.

Për shkak të natyrës dhe karakterit të saj ndërkombëtar, me t'u ratifikuar marrëveshja e nënshkruar, pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Shqipërisë, bëhet pjesë e pandashme e sistemit juridik të brendshëm dhe fiton përparësi kundrejt ligjeve kombëtare që bien ndesh me të<sup>406</sup>.

Pas firmosjes së marrëveshjes, krijohen kushtet e duhura politike që Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, në mbështetje të Kodit civil dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji për shoqatat jofitimprurëse, të kërkojë njohjen e personalitetit juridik civil sipas së drejtës shqiptare. Ndërkaq, ajo pranon t'u nënshtrohet normave të vendosura me ligj nga shteti, si për të

---

“Marrëveshja zhbëhet nëse njëra palë ia njofton këtë vendim palës tjetër me shkrim dhe shfuqizohet pasi të kenë kaluar 90 ditë nga njoftimi i zhbërjes së saj.”Gazeta Zyrtare”, n° 9, 2002, 228. Për Selinë e Shenjtë firmosi Shenjtëria e tij, Nunci Apostolik në Shqipëri, ndërsa për Republikën e Shqipërisë, firmosi Kryeministri i përkohshëm Pandeli Majko, i shoqëruar nga Ministri i Punëve të Jashtme. Nunci Apostolik shoqërohej nga imzot Rrok Mirdita, arqipeshkëv i Durrësit dhe i Tiranës dhe zëvendës president i Konferencës ipeshkvnore të Shqipërisë, si dhe nga Ambroz Madtha, ipeshkëv, këshilltar i Nunciaturës apostolike në Shqipëri, shenjë e dukshme e njohjes së Konferencës Ipeshkvnore, ndonëse ajo nuk është ende e veshur me personalitet juridik civil. Me 23 maj 2002, parlamenti shqiptar, pas një debati të ndezur, miratoi me 91 vota pro, dy abstenim dhe asnjë kundër, marrëveshjen që u ratifikua me ligj nga Presidenti i Republikës me 14. 06. 2002. Shih:Vendim, nr. 96, 21.3.2002, “*Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella*” <http://licodu.cois.it/309/view>

<sup>405</sup> Lidhur me mbrojtjen kushtetuese të këtyre normave, mekanizmi i përdorur është i ngjashëm me atë që u përdor për rishikimin e marrëveshjes italiane të vitit 1984, sipas së cilës ligji 222/85 gëzon të njëjtën mbrojtje kushtetuese që parashikohet për ligjet kryesore.

<sup>406</sup> Neni 122 i kushtetutës: “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”. <http://licodu.cois.it/662/view> .

gjitha komunitetet e tjera fetare, për çështje të tilla. Me këtë merr zgjidhje një prej mosmarrëveshjeve historike që kishte nxjerrë krye që me legjislacionin e mbretit Zog dhe ishte mbartur ndër vite, pavarësisht ndryshimit të regjimeve në pushtet<sup>407</sup>.

Statuti i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë<sup>408</sup> u hartua sipas neneve 447-459 të Kodit të së drejtës kanonike, të vitit 1993, ligj nr. 8788, datë 07.05.2001 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (neni 2). Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, në nenin 1, e emërton veten si organizatë jofitimprurëse dhe pohon se me këtë emër do të dalë në të gjitha dokumentet ligjore. Më tej, thuhet se fitimi i personalitetit juridik arrihet kur vendimi i Gjykatës civile të shkallës së parë të Tiranës, do të marrë formën e vendimit të prerë, ndërkohë që statusi i personalitetit juridik humbet me vendim gjykatë<sup>409</sup>. Juridiksioni shtrihet në të gjithë territorin shqiptar, por organizata do ta ushtrojë detyrën e vet edhe jashtë vendit, duke iu përmbajtur veprimtarisë së saj pa limit kohe (neni 4-5).

---

<sup>407</sup> Që nga themelimi i saj e deri në momentin e regjistrimit të statutit, Konferenca ipeshkvnore, ka funksionuar në Shqipëri si një shoqatë fakti, e rregulluar ekskluzivisht nga e drejta kanonike, një gjendje juridike kjo, që njihej mirë nga MRTKS. Zëvendës-presidenti i Konferencës ipeshkvnore mori pjesë në negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes si anëtar i delegacionit të Selisë së Shenjtë të drejtuar nga Nunci apostolik.

<sup>408</sup> Për t'u informuar rreth tekstit të statutit të shoqatës Konferenca ipeshkvnore e Shqipërisë, shih: <http://licodu.cois.it/693/view>. Sa u përket posteve kishtare në Shqipëri, aktualisht imzot Dodë Gjergji, administrator i dioqezës së Sapës, nuk është më anëtar i Konferencës ipeshkvnore shqiptare, pasi në vitin 2006 u transferua në Kosovë si Administrator apostolik në vend të imzot Mark Sopit, i cili kishte ndërruar jetë. Ipeshkvi i Sapës dhe anëtar i konferencës është imzot Luçjan Agustini, i shuguruar ipeshkëv, më 05.01.2007; At Ottavio Vitale, i cili u shugurua ipeshkëv i dioqezës së Lezhës më 06.01.2006, vazhdon të jetë anëtar i konferencës. At Cristoforo Palmieri, i shuguruar ipeshkëv i dioqezës së Rrëshenit më 28.12.2005, është, po ashtu, anëtar i konferencës. Imzot Zef Simoni ipeshkëv nderi i dioqezës Shkodër-Pult ka ndërruar jetë. At Prel Gjurashaj nuk është më anëtar i konferencës, pasi e përfundoi mandatin e tij si administrator i dioqezës së Pultit. Imzot George Frendo u shugurua ipeshkëv ndihmës për Tiranën dhe Durrësin, më 23.09.2006 dhe është anëtar i konferencës.

<sup>409</sup> Ligji për miratimin e statutit nga ana e gjykatës së Tiranës, mban numrin 530 dhe i përket datës 10 shkurt 2003. Konferenca ipeshkvnore e Shqipërisë e ka selinë qendrore në rrugën Don Bosko n° 1/4 Tiranë. Kjo seli mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së përgjithshme të Konferencës ipeshkvnore të Shqipërisë.

Qëllimi i shoqatës është fetar, social-kulturor, formues-edukativ, pa qëllim fitimi, i përkushtuar ndaj së mirës dhe shpëtimit të njerëzve nëpërmjet veprave ungjillore, predikimit të vlerave të shoqërisë shqiptare, sidomos atyre të familjes. Gjithashtu, ajo ushtron aktivitet edukues dhe kulturor, duke ngritur shkolla të niveleve të ndryshme, përfshirë dhe nivelin universitar, me një staf mësimdhënësish që i përshtaten këtij qëllimi dhe janë të azhornuar nga pikëpamja profesionale. Për promovimin e misionit të saj baritor, Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë organizon aktivitete të ndryshme në shërbim të vlerave të familjes dhe të shoqërisë, përpiqet të krijojë kushte të përshtatshme për kërkimin shkencor në fusha të ndryshme, me qëllim promovimin e botimeve të studimeve dhe të kërkimit shkencor; organizon konferenca dhe takime me besimtarët, bashkërendon aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me komunitetet e tjera fetare.

Shoqata nuk ka qëllime fitimi, prandaj nuk parashikon asnjë lloj shpërblimi për ata që janë subjekte të statutit, të aktit themeltar, të rregullores apo të çdo lloj pune të kryer, me përjashtim të rrogave apo bonuseve për rimbursimin e shpenzimeve të bëra gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive, në emër të shoqatës, si nëpunës të saj (kur janë të tillë), të cilët, jo doemos, janë anëtarë të shoqatës (neni. 8)<sup>410</sup>. Neni 9 pohon, në pikën 9.1. që shoqata mund të jetë pronare e të mirave të luajtshme dhe të paluajtshme; e të ardhurave të parashikuara nga ndarja juridiksionale e Kishës (dioqeza, famulli, etj.), nga donacionet si dhe nga të ardhura dhe burime të tjera ligjore. Në pikën 9.2. thuhet se fondi fillestar i shoqatës ka një vlerë prej 2000 dollarë.

Shpenzimet e shoqatës kanë për qëllim arritjen e objektivave të saj, duke përdorur të mirat e pasurisë së vet; burimet që rrjedhin nga donacionet në përputhje me masën e vënë në dispozicion nga donatorët, sipas kritereve të përcaktuara në të drejtën kanonike, nga statuti dhe nga akti i tij i themelimit. Me shkrirjen e organizatës, të mirat u shpërndahen dioqezave dhe Kishës katolike në Shqipëri. Në nenin 11 të statutit renditen organet e shoqatës:

---

<sup>410</sup> Kjo normë duhet parë e lidhur me ligjin për shoqatat non profit, lidhur me taksimin e atyre që punojnë për këto lloj shoqatash dhe, sidomos, për çështje të sigurimeve shoqërore, kur ata janë shtetas të huaj.

Asambleja e Përgjithshme, Presidenca, Sekretaria e përgjithshme dhe përcaktohen detyrat e secilit.

Asambleja e Përgjithshme është organi suprem i shoqatës dhe vendos për rastet e modifikimit të statutit dhe të aktit themeltar, përcakton linjat dhe programin e aktiviteteve të shoqatës duke u kërkuar organeve ekzekutuese informacion mbi punën e tyre për shkak të rolit kontrollues që ushtron mbi to; shqyrton gjendjen ekonomike, financiare dhe administrative; miraton bilancin preventiv dhe përfundimtar; zgjedh presidentin, sekretarinë e përgjithshme dhe arkëtarin; miraton dispozitat e nevojshme për rregullimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe organizimin e strukturave të shoqatës, mbylljen e aktivitetit dhe fatin e pasurisë së mbetur si dhe çdo çështje të parashikuar qartazi në ligj; krijon dhe modifikon strukturat e administratës. Asambleja e përgjithshme përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë, por nuk ka kufi numri i anëtarëve që qëndrojnë në detyrë pa limit kohe dhe emërohen siç parashikohet në të drejtën kanonike<sup>411</sup>.

Presidenti i shoqatës organizon, administron dhe thërret mbledhjet e Asamblesë e të Presidencës, dhe në mungesë apo pamundësi të tij, kjo detyrë i kalon zëvendës presidentit. Anëtarët e Asamblesë nuk marrin ndonjë shpërblim për punën e tyre dhe mandati u përfundon kur dorëhiqen ose për shkak të humbjes së jetës, por edhe në ato raste që e parashikon e drejta kanonike. Asambleja e Përgjithshme mbledhet, së paku, dy herë në vit, por mund të mbledhet edhe më shpesh kur e kërkojnë, të paktën, pesë anëtarë të saj, ose në rast emergjence. Mbledhjet janë të vlefshme me praninë e me më shumë se gjysmës së anëtarëve, ndërsa vendimet merren nga dy të tretat e anëtarëve të pranishëm. Çdo anëtar ka të drejtën e një vote, ndërsa delegimi i saj nuk lejohet<sup>412</sup>.

---

<sup>411</sup> Lidhur me këtë, shih marrëveshjen e nënshkruar mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë dhe të ratifikuar me ligjin nr. 8902, datë 23/05/2002, neni 5, i cili sanksionon pavarësinë e organizatave fetare.

<sup>412</sup> Njoftimet që u drejtohen anëtarëve të asamblesë, lidhur me vendimmarrjet në mbledhje, bëhen me shkrim brenda 10 ditësh nga data e mbledhjes dhe u dërgohen atyre me postë në adresën që i kanë deklaruar shoqatës. Mbledhjet duhen protokolluar dhe proces verbalet përkatëse, ashtu si edhe vendimet e marra nga Presidenti i asamblesë dhe mbajtësi i protokollit, duhen nënshkruar nga të gjithë.



Presidenca është organ ekzekutiv dhe përbëhet nga Presidenti, zëvendës Presidenti dhe nga Sekretaria e përgjithshme.

Presidenti e ushtron detyrën e tij për tre vjet dhe gëzon të drejtën e rizgjedhjes. Zgjedhja e tij sigurohet nga shumica e anëtarëve të Asamblesë; në mungesë të tij, zëvendësohet nga zëvendës Presidenti. Kryen të gjitha veprimet bankare, përgatit dhe nënshkruan kontratat në emër të shoqatës dhe, në dakordësi me Asamblenë e Përgjithshme, mban lidhjet me subjektet private dhe të huaja. Mund të marrë vendime të menjëhershme, por gjithnjë në përputhje me statutin dhe aktin themeltar; propozon modifikimin e statutit, të aktit themelues dhe të rregullores së brendshme. Të gjithë anëtarët e Presidencës, e ushtrojnë aktivitetin e tyre pa shpërblim.

Sekretaria e përgjithshme zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme; mban një raport përfundimtar vjetor mbi aktivitetin dhe praninë e kësaj Asambleje; harton raportin mbi punën dhe vendimet e saj; përgatit akte të ndryshme me kërkesë të Presidentit dhe ua shpërndan të gjithë anëtarëve të Asamblesë.

Çdo anëtar i shoqatës gëzon të drejtën e pjesëmarrjes në aktivitetet e saj, në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të drejtën e shprehjes së mendimit vetjak dhe të votës; mund të japë dorëheqjen, gjithnjë në përputhje me statutin, aktin e themelimit dhe rregullat procedurale. Kuota e pranimi për secilin anëtar është 200 lekë në vit. Kompetencat për modifikimin e statutit dhe të aktit themeltar i përkasin Asamblesë së Përgjithshme. Modifikimet dhe propozimet mund të paraqiten nga çdo anëtar i Asamblesë. Çdo propozim duhet të paraqitet në formë të shkruar e të mbështetet nga argumente të forta, të afta për të arsyetuar kërkesën për ndryshim e propozuar<sup>413</sup>.

Mosmarrëveshjet mes palëve, Asamblesë, Presidentit dhe Sekretarit të përgjithshëm apo mes këtyre dhe nëpunësve të zgjedhur, në përputhje me statutin e së drejtës kanonike, zgjidhen me dy të tretat e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e thirrur nga Asambleja.

---

<sup>413</sup> Propozimet duhen dërguar 20 ditë para mbledhjes së Asamblesë. Vendimi për ndryshimin e statutit dhe të aktit themeltar miratohen me dy të tretat e anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje; me të njëjtat rregulla miratohen normat procedurale.

Presidenti është përfaqësuesi ligjor ndaj të tretëve dhe mund ta delegojë pushtetin e tij, kur kjo gjykohet e nevojshme. Administrata përbëhet nga arkëtari dhe nga sekretari. Arkëtari ka për detyrë të mbajë kontabilitetin. Viti financiar i shoqatës fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti, përveç vitit të parë. Shoqata mund të shkrihet vetë, me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme kur e sheh të pamundur realizimin e qëllimit të saj apo për çdo lloj arsyeje që e gjykon vetë Asambleja. Likuiduesit duhet të jenë anëtarë të shoqatës dhe që, në krye të herës, anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme janë themeluesit e shoqatës.

Statuti mbyllet me një formulim ritual, duke pohuar se për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë statut, zbatohen dispozitat në fuqi të së Drejtës kanonike, ato të Kodit Civil dhe të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit 87888, datë 07.05.2001, për shoqatat *non profit*. Shkruhet, në shqip, në katër kopje, miratohet dhe firmoset nga personi që përfaqëson shoqatën.

Marrëveshja mbi çështjet juridike të nënshkuara nga palët, përbën një pikë referimi nga ku rrjedhin aktet e mëtejshme normative dhe marrëveshje që kthehen në ligje të zakonshme apo në norma rregulluese, ndërsa negociatat për përcaktimin e marrëveshjeve rreth çështjeve të tjera vijnë ende.

Kështu, nuk është e pazakontë që, në vitin 2002, u miratua një ligj që i përjashton komunitetet fetare nga barra e taksës lokale mbi pasuritë e paluajtshme dhe transferimin e pasurisë<sup>414</sup>. Kjo masë që rregullon edhe shoqatat jofitimprurëse, ka për qëllim garantimin e aktiviteteve të ushtruara nga kultet e tjera, të cilët ndihmohen nga persona moralë për përmbushjen e funksionit të tyre shoqëror, nëpërmjet aktiviteteve që kryhen pa qëllim fitimi<sup>415</sup>. Ajo lidhet edhe me aktivitetin e *Agjencisë për kthimin dhe kompensimin e pronave*, që ka si qëllim t'u japë zgjidhje çështjeve të shumta në ngërç që presin kthimin e të mirave të shpronësuara, pas vitit 1945 ose mundësinë e dëmshpërblimit për të mirat e pakthyeshme<sup>416</sup>. Në vendimmarrjen e Komisionit për kultet, ushtron ndikimin e vet

---

<sup>414</sup> *Për sistemin e taksave vendore*, Ligj Nr. 8982, 12.12.2002, <http://licodu.cois.it/593/view>

<sup>415</sup> *Ibidem*.

<sup>416</sup> Fryt i kompensimit të të mirave të konfiskuara, është edhe vendi ku u ngrit katedralja ortodokse, tempulli qendror i besimit.

edhe ligji *Mbi trashëgiminë kulturore*, që shënon një risi të padiskutueshme edhe për çështjen e mbrojtjes së të mirave kulturore me interes fetar, që, jo rastësisht, u miratua në frymën e marrëveshjeve me komunitetet e tjera fetare<sup>417</sup>. Në këtë ligji, paraqet interes të veçantë neni 25, i cili parashikon se, si godinat fetare të ndërtuara para vitit 1990, ashtu edhe ato të ndërtuara para vitit 1944, që janë ende në përdorim, duhen mbrojtur nga Instituti i të Mirave Kulturore.

Marrëveshja e nënshkruar me Kishën katolike duket se nuk ka ndikuar në fushën e së drejtës familjare, siç mund të vihet re nga një shqyrtim i Kodit të Familjes, i miratuar në vitin 2003<sup>418</sup>, por sigurisht ka ndikimin e vet mbi ligjin për ushtarakët, të cilëve u sigurohet e drejta për të marrë pjesë në aktivitetet fetare, me kusht që kjo të kryhet jashtë ngulimeve ushtarake dhe jashtë orarit të shërbimit<sup>419</sup>. Po ashtu, ligji që rregullon administrimin e varrezave publike, parashikon ndarjen në sektorë të veçantë sipas besimeve të ndryshme fetare, duke rikthyer në fuqi rregullat e shfuqizuara gjatë periudhës komuniste<sup>420</sup>.

Në çështjet që lidhen me veprimtarinë e *Agjencisë për kthimin dhe kompensimin e pronave*, bën pjesë edhe ligji për mbrojtjen e pyjeve, që janë pasuri e komuniteteve fetare. Duhet mbajtur parasysh që pasuritë e konfiskuara komuniteteve fetare ishin

---

<sup>417</sup> Shih ligjin *Për trashëgiminë kulturore*, Ligj nr. 90 48, 07.04.2003, <http://licodu.cois.it/573/view>, i zëvendësuar nga ligji *Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme*, Ligj Nr. 7867, datë 12.10.1994, të cilit i referohet R. Santoro për ta krahasuar me legjislacionin italian, edhe pse ky ligj ishte shfuqizuar tashmë. R. SANTORO, *Tutela dei beni culturali d'interesse religioso in Italia e in Albania*, "Il Dir. Eccl.", I, 2003, 841-849.

<sup>418</sup> *Kodi i familjes i Republikës së Shqipërisë*, Ligj nr.9062, 8.5.2003, <http://licodu.cois.it/570/view>

<sup>419</sup> *Për statusin e ushtarakut të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë* (Ligji Nr.9210, 23.3.2004) <http://licodu.cois.it/581/view>

<sup>420</sup> *Për shërbimin publik të varrimit*, Ligj nr. 9220, 15. 4. 2004, <http://licodu.cois.it/584/view>. Kohët e fundit ka pasur jo pak polemika nga ana e myslimanëve lidhur me propozimin e bashkisë së Tiranës për të ndëruar pëllumbarë në varrezat publike, pasi kjo praktikë bie ndesh me rregullat e fesë islame që dikton varrimin direkt në tokë. Ndërkohë që ortodoksët kanë shfaqur njëfarë gatishmërie ndaj kërkesës së bashkisë, Kisha katolike është distancuar nga ky propozim në respekt të ndjeshmërisë së myslimanëve. Ka gjasa që, për shkak të mosmarrëveshjeve, ky propozim të jetë lënë përkohësisht mënjanë.

kryesisht toka dhe terrene. Të mirave që po u ktheheshin pronarëve të vjetër, tashmë u kishte rënë vlera, ndaj kërkohej mbështetje ekonomike me qëllim që të kapnin vlerën e tregut<sup>421</sup>. Megjithë nënshkrimin e marrëveshjes, dolën mjaft probleme gjatë zbatimit të saj, ndaj Nunciatura Apostolike, në Tiranë, kërkonte me ngulm ngritjen e një komisioni *ad hoc* të parashikuar në marrëveshje dhe, pas shumë përpjekjesh, Nunci, imzot Bulaitis, ia doli të çelë rrugën për ngritjen e këtij komisioni dhe për hartimin e ligjit mbi *Njohjen e personalitetit juridik të personave juridikë të kishës katolike*, miratimi i të cilit u bë pa shumë fjalë, si nga komisioni parlamentar, ashtu dhe nga parlamenti.

Deri aso kohe, kishte vetëm disa norma të përgjithshme të Kodit Civil rreth njohjes së personalitetit juridik për personat fizikë dhe për entet pa qëllim fitimi si dhe normat e ligjit të shumëpërmendur mbi organizatat jofitimprurëse.

Normat e veçanta të së drejtës së brendshme që kishin të bënin me entet e komuniteteve fetare, ishin shfuqizuar me dekretin e vitit 1967, në vazhden e përndjekjeve të komuniteteve fetare<sup>422</sup> dhe të masave të marra ndaj tyre. Është e vërtetë që miratimi i ligjit nr. 7491, datë 29 prill 1991 kishte rivënë në fuqi normat e sistemit parakomunist, por, me ligjin në fjalë, kërkohej rindërtimi i bazës

---

<sup>421</sup> *Për pyjet dhe shërbimin pyjor*, ligj nr. 9385, 4. 5. 2005 <http://licodu.cois.it/590/view>

<sup>422</sup> Nuk ndajmë të njëjtin mendim me Dammacco-n, i cili pohon që ligji nuk i referohet në asnjë prej dymbëdhjetë neneve të tij, marrëveshjes së nënshkruar me Kishën katolike në muajin prill 2003. G. DAMMACCO, *Note alla vigente legge Albanese sugli Enti Ecclesiastici*, "Iura Orientalia", II, 2005, 52-60 [www.iuraorientalia.net](http://www.iuraorientalia.net), Në fakt, neni 1 pika 2 e ligjit pohon se Kisha katolike në Shqipëri ka të drejtë të organizohet dhe të ndjekë misionin e saj; neni 2 e marrëveshjes pohon se Republika e Shqipërisë njeh personalitetin juridik publik të institucioneve të Kishës katolike, të cilat gëzojnë të njëjtin status sipas së drejtës kanonike. Në këto institucione bëjnë pjesë: arqidioqezat, dioqezat apo administratat apostolike, famullitë, komunitetet fetare, misionet, shoqatat, seminarët, shkollat dhe institucionet edukative të të gjitha niveleve dhe institucionet shëndetësore pas regjistrimit të tyre pranë organeve gjyqësore. Neni 5 pika 1 pohon se autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat e veta kishtarë, e në mënyrë të veçantë të emërojë dhe të ndryshojë personat juridikë kishtarë sipas së drejtës kanonike dhe në respekt me legjislacionin e Shqipërisë. Nuk mund të mos vihet re ngjashmëria e disa dispozitave dhe përputhja e normave mes marrëveshjes dhe ligjit në fjalë.

normative të sistemit shqiptar, duke shëruar kështu *vulnus-in* e shkaktuar nga legjislacioni ateist. Nga ana tjetër, nuk mund të lihet në harresë fakti që një prej përplasjeve më të forta të së shkuarës mes shtetit dhe Kishës katolike ishin, pikërisht, normat lidhur me marrjen e personalitetit juridik për institucionet kishtare.

Edhe pse ligji në fjalë nuk njihet si fryt marrëveshjeje dhe nuk duket as formalisht i lidhur me ndonjë të tillë mes shtetit shqiptar dhe Selisë së Shenjtë për çështjet juridike, në të vërtetë, ai është negociuar nga vetë Komiteti, i cili ka diktuar procedurat normative për njohjen e aftësisë juridike kishtare për personat juridikë (ente apo institucione fetare) të Kishës katolike në Republikën e Shqipërisë, të ngritura nga autoritetet kompetente kishtare konform së drejtës kanonike.

Me përforcimin e parimit të pavarësisë dhe të ndarjes së shtetit nga feja, thuhet se entet në fjalë ushtrojnë aktivitetin e tyre pavarësisht nga punët e shtetit dhe se të qënët e tyre kishtarë vihet në dukje nga e drejta kanonike, në respekt të plotë me autonominë fetare.

Personat juridikë kishtarë gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përbushin të gjitha detyrimet e parashikuara nga dispozitat e Kodit Civil dhe të normave të tjera juridike në fuqi për të gjithë personat juridikë, ndërsa, në përputhje me të Drejtën kanonike, ata mund t'i modifikojnë dhe t'i shfuqizojnë këto norma.

Njohja e tyre bëhet pasi përfaqësuesi ligjor të ketë dorëzuar, në gjykatën e Tiranës, kërkesën të shoqëruar me aktin juridik të themelimit të entit kishtar të miratuar nga autoriteti kompetent i Kishës. Në këtë akt përcaktohet organi i Kishës që emëron përfaqësuesin ligjor, funksionet dhe kompetencat e entit, selia kryesore të tij, natyra e këtij enti, lloji i veprimtarisë së tij, burimet financiare dhe juridiksioni që pushon ekzistencën e entit në fjalë.

Gjithçka kërkohet, duhet pasqyruar në statutin e entit. Gjykata e shkallës së parë të Tiranës, brenda 30 ditëve nga data e kërkesës dhe dorëzimit të dokumentacionit të sipërpërmendur, bën njohjen e personalitetit juridik dhe regjistrimin e Kishës me anë të miratimit të këtij vendimi (neni 6). Kjo procedurë nuk është aspak e ndryshme nga ajo e parashikuar në ligjin për shoqatat jofitimprurëse, sipas së cilës, enti ka detyrimin të regjistrohët

pranë zyrave të tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve të parashikuara me ligj, në varësi të aktivitetit që ushtron.

Sipas nenit 9 të ligjit, personat juridikë kishtarë që nuk kanë qëllim fitimi gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përparësitë në çështjet tatimore [...] si të gjithë personat juridikë që nuk kanë qëllim fitimi, me kusht që kjo të jetë e parashikuar në ligj. Ata mund ta ushtrojnë aktivitetin e tyre, pa limit kohe, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 8). Kanë detyrimin të pajisen me licensë apo autorizimin përkatës, siç e parashikon ligji për kryerjen e veprimtarive që kanë të bëjnë me arsimin, çështjet sociale dhe shëndetësinë (neni 10)<sup>423</sup>.

Së fundi, dispozitat kalimtare për normalizimin e kushteve juridike të personave juridikë katolikë që nuk gëzojnë aftësi juridike dhe të atyre që janë regjistruar si organizata jofitimprurëse para miratimit të këtij ligji, duhet t'i paraqesin gjykatës dokumentet e nevojshme për njohjen e tyre, brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji<sup>424</sup>. Pra, ligji riprodhon të njëjtat norma që janë në fuqi, pa i krijuar asnjë privilegj të veçantë Kishës katolike. Lidhur me marrëveshjen e vitit 2001, ligji i vitit 2005 merr vlerën e një ligji zbatues, të cilit i sigurohet mbrojtja e nevojshme nga neni 122, pika 1 dhe 2. Ky ligj parashikohet nga komisioni *ad hoc*, dhe ka për qëllim t'u mundësojë enteve të Kishës katolike përmbushjen e çdo nismë juridike si: punësimin e nëpunësve; marrjen e donacioneve apo subvencioneve të ndryshme; kryerjen e transfertave bankare; ndërtimin e godinave të kultit apo ngritjen e institucioneve ndihmëse për njerëz në nevojë. Kjo u dha zgjidhje problemeve të shumta praktike, çka e dëshmon fakti që, pas vitit 2005, figurojnë të regjistruar një sërë entesh të cilëve iu njoh natyra juridike prej "enti kishtar". Miratimi i këtij ligji mbyll një fazë të punës së Komitetit shtetëror për kultet, i cili, me ndryshimet e pjesshme në përbërjen e tij dhe me shtimin e të ardhurave ekonomike<sup>425</sup>, më në

---

<sup>423</sup> G. DAMMACCO, *Note alla vigente legge Albanese sugli Enti Ecclesiastici ...cit.*, 58-60, sheh mangësi në këtë ligj, pasi gjykon që gjykata e Tiranës është e veshur më shumë me fuqi administrative sesa me fuqi të vërtetë gjyqësore.

<sup>424</sup> Ligji hyn në fuqi me dekretin nr. 4539, datë 13.4.2005

<sup>425</sup> *Për disa ndryshime në vendimin nr.459, del 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komitetit shtetëror për kultet"*, të ndryshuar Vendim, nr. 666, del 26. 10.2005 <http://licodu.cois.it/306/view>

fund mund t'i bëjë ballë çështjes së nënshkrimit të marrëveshjeve me komunitetet fetare të pranishme historikisht në vend. Mosmarrëveshja ekzistuese mes Kishës katolike dhe shtetit thuajse ishte zgjidhur.

Ndërkohë që negocimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit nis shqyrtimin e një sërë problemesh të hapura me komunitetet e tjera, mbeten ende të pasqaruara mirë çështjet ekonomike dhe tatimet me Kishën Katolike, prandaj, më 3 dhjetor 2007, palët nënshkruajnë marrëveshjen e fundit lidhur me disa çështje ekonomike dhe tatimore<sup>426</sup>.

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë i mëshojnë vullnetit të forcimit të marrëdhënieve reciproke lidhur me veprimtarinë e Kishës katolike në Shqipëri<sup>427</sup>.

E drejta që i njihet me ligj Kishës katolike, për të mbajtur dhe administruar në mënyrë të pavarur të mirat dhe burimet ekonomike të saj, fiton garanci ndërkombëtare, falë marrëveshjes së nënshkruar (neni 1). Ajo mund të pranojë ndihma materiale apo financiare të ofruara nga besimtarë apo donatorë, qofshin këta edhe me banim jashtë shtetit; mund të organizojë mbledhjen e ofertave publike; të pranojë dhurata që kushtohen për kryerjen e misionit të saj dhe, të gjitha këto, përjashtohen nga taksat dhe tatimet (neni 2). Përjashtohen nga barra tatimore edhe pasuritë e paluajtshme të Kishës dhe të enteve katolike, si dhe ato institucione që Kodi i së drejtës kanonike i njuh si persona juridikë kishtarë apo si organizata jofitimprurëse të Kishës katolike. Këto të fundit duhet të regjistrohen si të tilla pranë organeve kompetente të shtetit shqiptar, për aq kohë sa të përdoren për qëllimet e kultit, si: për drejtimin dhe administrimin kishtar; për kryerjen e veprimtarive baritore, humanitare apo bamirëse; për formimin e

---

<sup>426</sup> *Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë mbi disa çështje ekonomike dhe tatimore*, Për ratifikimin, ligj nr.9865, Tiranë, më 31.1.2008

<sup>427</sup> Duke u mbështetur në parimet e njohura ndërkombëtarisht mbi lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë, duke marrë parasysh kontributin e rëndësishëm shoqëror, moral dhe historik të Kishës katolike në jetën e vendit dhe me qëllimin për të përcaktuar një kuadër ligjor të përhershëm për garantimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së Kishës katolike në Shqipëri, u pa e arsyeshme të arrihet në një marrëveshje për rregullimin sa më të mirë të çështjeve të natyrës ekonomike dhe tatimore.

meshtarëve dhe rregulltarëve; për mësimin e teologjisë apo të shkencave të tjera fetare si dhe për banesa të drejtuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës. E njëjta rregull parashikohet për pasuritë që nuk janë në pronësi të Kishës katolike, por që vihen në shërbim të veprimtarive të sipërpërmendura (neni 3). Kjo normë nuk zbatohet për godinat që u përshtaten punëve për qëllime fitimi, prandaj ato i nënshtrohen taksimit të zakonshëm (neni 4).

Për godinat dhe mjediset e ngritura për aktivitete edukuese, shkollore, universitare e pasuniversitare, sociale dhe shëndetësore, që janë në pronësi apo në përdorim të enteve apo institucione të parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje, zbatohet tarifa e përcaktuar nga organet administrative vendore. Ajo nuk mund ta kapërcejë masën e taksës së vendosur për organizatat e tjera jofitimprurëse që kryejnë të njëjtin aktivitet, masë që vendoset vetëm në varësi të sipërfaqes së ambienteve ku zhvillohen veprimtaritë e sipërpërmendura (neni 5). Këto ente çlirohen edhe nga barra e taksës së trashëgimisë apo ajo e kalimit të pasurisë, në rastet e donacioneve mes Kishës katolike dhe enteve të saj, apo mes vetë këtyre të fundit, siç parashikohet në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje. Destinacioni i të mirave vërtetohet nga nënshkrimi i akteve noteriale përkatëse.

Sipas nenit 7, personeli fetar dhe laik në shërbim të Kishës, si dhe drejtuesit e kultit me shtetësi të huaj, por me banim të vazhdueshëm në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për aktivitetin e ushtruar prej tyre në shërbim të Kishës, përjashtohen nga detyrimi i taksave për shërbimet shoqërore dhe shëndetësore. Kjo vlen edhe për themeluesit, drejtuesit dhe përfaqësuesit ligjorë të enteve dhe institucioneve të përcaktuara në nenin 3 të marrëveshjes, të cilët derdhin kontributet e tyre në vendet nga vijnë. Të gjithë ata që pretendojnë një trajtim të tillë, duhet të paraqesin vetë dokumentacionin e nevojshëm pranë organeve shtetërore kompetente.

Nuk kanë detyrim të mbajnë farë regjistri kontabël apo t'u nënshtrohen masave administrative, personat juridikë kishtarë të Kishës katolike, të parashikuar në Kodin e së drejtës kanonike apo të njohura nga autoritetet kompetente kishtarë dhe të regjistruar



pranë organeve kompetente shtetërore. Këtu bëjnë pjesë: organi drejtues dhe administrues kishtar; veprimtaria baritore, humanitare dhe bamirëse; formimi i meshtarëve dhe rregulltarëve; mësimdhënia e teologjisë dhe e shkencave të tjera kishtarë. Pra, për veprimtari të tilla, organet kishtarë, nuk kanë farë detyrimi t'u paraqesin bilancin vjetor organeve kompetente të shtetit dhe as ta dorëzojnë atë pranë organizmave shtetërorë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi (neni 8).

Mbështetur në nenin 9, u ngrit një komision bilateral, i ngarkuar për t'u dhënë zgjidhje të pranueshme të dyja palëve për çdo lloj konflikti që mund të lindë mes tyre, shtetit dhe Kishës katolike në Shqipëri si dhe enteve dhe institucioneve si persona juridikë kishtarë apo të njohur si organizata jofitimprurëse, të regjistruara pranë organeve kompetente të shtetit shqiptar. Çështje të tjera të karakterit financiar apo tatimor, që nuk gjejnë pasqyrim në këtë marrëveshje, do të rregullohen nga marrëveshje shtesë.<sup>428</sup>

Një tipar i veçantë për të gjitha këto marrëveshje dhe ligje është padyshim norma që parashikon shfuqizimin e secilës prej tyre, pasi të jenë kapërcyer të gjitha hallkat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në nivel dypalësh, si dhe mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve të reja, në përputhje me nenin 10 të Kushtetutës.

Nuk mund të mohohet që marrëdhëniet mes shtetit dhe Kishës katolike në Shqipëri, më në fund, kanë marrë një drejtim të ri. Në fakt, krijimi i klimës së bashkëpunimit mundësoi firmosjen e një sërë marrëveshjeve, duke filluar nga ato më të thjeshtat si, për shembull, nismat në fushën e shëndetësisë<sup>429</sup>, e deri tek realizimi i

---

<sup>428</sup> Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e njoftimit të të dyja palëve, pasi secila prej tyre të ketë përmbushur procedurat e nevojshme dhe shfuqizohet nëse njëra palë ia njofton tjetrës me shkrim vendimin e marrë për prishjen e marrëveshjes. Ky vendim hyn në fuqi 90 ditë pasi të jetë dhënë njoftimi. Për palën shqiptare, marrëveshja u firmos nga Ministri i Financave, ndërsa për Selinë e Shenjtë firmosi imzot Giovanni Bulaitis, Nunci Apostolik i Shqipërisë.

<sup>429</sup> Të shihet marrëveshja mes Ministrisë së Shëndetësisë së Shqipërisë dhe Qendrës së kërkimit spitalor "Bambino Gesù", ent i Selisë së Shenjtë (2007); marrëveshja mes Ministrisë së Shëndetësisë së Shqipërisë dhe spitalit *Casa del Sollievo del Dolore* në San Giovanni Rotondo, ent i Selisë së Shenjtë (2008); marrëveshja e Ministrisë së Shëndetësisë së Shqipërisë dhe *Università Cattolica del Sacro Cuore*, Policlinico Universitario "Agostino Gemelli" e Romës (2010).

bashkëpunimeve të tilla, si ai mes Ministrisë së Jashtme për arkivat në Shqipëri dhe Arkivit sekret të Vatikanit. Duhet thënë se kjo nismë nuk ka të bëjë vetëm me Kishën katolike, por edhe me komunitetet e tjera fetare. Bëhet fjalë për bashkëpunime që lindin në nivelin e nismave individuale, kryesisht fetare dhe dukshëm më të pakta në Shqipëri, po të krahasohet me vendet e tjera ish socialiste<sup>430</sup>.

Marrëveshja e vitit 2008 u ka dhënë zgjidhje shumë problemeve tatimore dhe ekonomike, duke futur nën juridiksionin kishtar, si ente të kishës Katolike ato pak ente që ishin regjistruar si OJQ (organizata joqeveritare) o OJF (organizata joftimprurëse), nën formulimin “ente të njohura nga autoritetet kompetente kishtarë”. Në përfundim të shqyrtimit të marrëveshjeve të nënshkruara nga Kisha katolike, vihet re se një ndër treguesit e parë me interes është *modus operandi* i Komitetit. Edhe pse katolicizmi nuk është fe e shumicës në vend, i është dhënë përparësi këtij komuniteti për nënshkrimin e marrëveshjeve, për shkak të peshës ndërkombëtare që fitojnë vendimet e nënshkruara falë natyrës juridike të entit me të cilin nënshkruhet kontrata. Nuk mund të mohohet që Selia e Shenjtë është një ent me peshë ndërkombëtare.

Paralelisht është vepruar me komunitetet e tjera fetare, për të cilët, nënshkrimi i marrëveshjeve ka fituar vlerë juridike nën fuqinë ekskluzive të ligjit të shtetit. Problemet që lypnin zgjidhje, ishin të njëjta si për Kishën katolike, ashtu edhe për komunitet e tjera, aq sa Komiteti të krijonte përshtypjen se i përmbahej mënyrës së procedimit të vitit 1949, lidhur me rinovimin e statuteve të komuniteteve fetare, madje qysh më përpara, që me legjislacionin e mbretit Zog, mendohej për një skemë të vetme për hartimin e marrëveshjeve, pa anashkaluar veçoritë specifike për secilin komunitet. Është e vërtetë që në vitin 1949, shteti ndërhynte në punët për hartimin e statuteve, e për rrjedhojë edhe në jetën e brendshme të komuniteteve, duke shkelur pavarësinë

---

<sup>430</sup> F. BOTTI, *Le confessioni religiose e il principio di sussidiarietà nell'Unione europea: un nuovo giurisdizionalismo attraverso il mercato*, Stato, Chiese e pluralismo confessionale, Rivista telematica, janar 2011, 1-38.

Së fundi është mbajtur protokollin i bashkëpunimit i firmosur nga ministri i Rinisë, Kulturës, Turizmit dhe Sportit dhe *l'Opera Romana Pellegrinaggi* në vitin 2011.

normative dhe rregulluese të tyre, por tani kjo nuk ndodh më, sepse bëhet fjalë vetëm për zbatimin e një skeme të përbashkët për marrëveshjet që do të nënshkruhen me shtetin. Ndryshimi me të shkuarën nuk qëndron vetëm në kontekstin e ri politik dhe kushtetues në të cilin nënshkruhen këto marrëveshje, por edhe në natyrën kontraktuale të bashkëpunimit mes palëve<sup>431</sup>. Konvergimi drejt një metodologjie të përbashkët pune, prodhon marrëveshje me dispozita të përbashkëta, pa anashkaluar ato ndryshime të veçanta që lindin për shkak të traditës apo nevojave të secilit komunitet, e për rrjedhojë, natyrshëm, gjejnë pasqyrim në statutet përkatëse. .

---

<sup>431</sup> Për më tepër, shih: G. CIMBALO, *Religione e diritti umani nelle società in transizione dell'Est Europa. Diritti umani e libertà religiosa* ,(a cura di V. Possenti), Soveria Mannelli, Rubettino,2010, 160-164.

### 3. 6. Marrëveshjet e bashkëpunimit me Myslimanët Sunitë, Bektashianë dhe Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Me zgjidhjen, thuajse të plotë, të mosmarrëveshjes me Kishën katolike, u hapet rrugë negociatave me komunitetet e tjera tradicionale në vend - Sunitë, Bektashianë, Ortodoksë- me të cilët, nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit, u arrit në vitin 2009<sup>432</sup>. Kjo marrëveshje u mbështet, u parapri dhe u shoqërua nga legjislati i zakonshëm<sup>433</sup> dhe nga zgjidhja e menjëhershme e problemeve që, ende sot e kësaj dite, nuk gjejnë zgjidhje në vendet e tjera me demokraci socialiste si, për shembull, çështja e kthimit dhe kompensimit të të mirave të konfiskuara komuniteteve fetare<sup>434</sup>. Bazuar në nenin 10 të Kushtetutës, palët nisën nënshkrimin e marrëveshjeve të ndërsjella, që u ratifikuan nga Këshilli i Ministrave, i cili ia paraqet për miratim parlamentit, duke vijuar më pas me publikimin e ligjit përkatës.

Delegacionet negociuese ngrihen nga komiteti shtetëror për kultet dhe nga përfaqësues të nivelit të lartë të komuniteteve, të cilët

---

<sup>432</sup> *Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Islam Shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta"* Ligji nr. 10 056, datë 22.01.2009, <http://licodu.cois.it/622/view>; Për ratifikimin e "*Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë in dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta*" Ligji nr. 10 057, datë 22. 01.2009, <http://licodu.cois.it/623/view>; Për ratifikimin e "*Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane për rregullimin e Marrëdhënieve të ndërsjella*" Ligji nr. 10 058, datë 22.01.2009, <http://licodu.cois.it/624/view>

<sup>433</sup> Shih tek shembulli: *Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me këshillin e ministrave*, Ligji nr.10 140, datë 15.5.2009.

<sup>434</sup> Përsa i përket rikthimit të të mirave të konfiskuara shih: për Shqipërinë, aktiviteti i Agjencisë për rikthimin dhe shpërblimin e pronës dhe ligjet e ndryshme të sjella në <http://licodu.cois.it/7/6/4/>. Për Bullgarinë: Aplikimi i ligjit të rikthimit të të mirave fetare, <http://licodu.cois.it/4/6>. Për Lituaninë, shih: <http://licodu.cois.it/4/6>. Në Rumani, në Republikën çeke dhe në shumë vende të tjera të Europës Lindore, çështja e rikthimit të të mirave të konfiskuara ende mbetet një problem i hapur dhe shkak përplasjesh në gjykatë. Shih: G. BARBERINI, *Stato e religione nel processo di democratizzazione dei Paesi europei post-comunisti,...*, 12 ss.

kanë hartuar statutet përkatëse, duke i qëndruar besnikë traditës për ruajtjen e vazhdimësisë historike qindrvjeçare dhe punës së tyre me statutet.<sup>435</sup> Edhe pse skema e marrëveshjes dhe një pjesë e mirë e neneve janë identikë, palët duhet të mbajnë parasysh natyrën e ndryshme juridike për secilin komunitet. Komuniteti mysliman që përbën shumicën në vend, ka karakter kombëtar dhe mbart brenda vetes disa vëllazëri që janë pjesë e përvojës së pasur fetare të islamit ballkanik<sup>436</sup>. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë e ka fituar autonominë e saj falë *tomos*-it, që në vitin 1937, por gjithsesi ka ruajtur lidhje historike me Patriarkanën e Kostandinopojës, çka gjen pasqyrim edhe në statut<sup>437</sup>.

Komuniteti bektashian, jo vetëm që mbart brenda vetes disa vëllazëri më të vogla, por e ka selinë ndërkombëtare në Shqipëri, gjë që e ngarkon me detyrën e përkujdesjes për marrëdhëniet me bashkëvëllezërit e shpërndarë nëpër botë. Të gjitha komunitetet fetare e kanë për zemër ruajtjen e lidhjeve me shqiptarët e diasporës, të shtuar në numër sidomos pas eksodit që pasoi rënien e regjimit komunist. Sa u takon Bektashinjve, është për t'u përmendur vëmendja që u kushtohet bashkëvëllezërve në Kosovë dhe Maqedoni, si pasojë e fragmentarizimit të gjerë të shpërndarjes së tyre në Shqipërinë etnike. Nuk ndodh kështu me Myslimanët sunitë dhe Ortodoksët, pasi në të dy vendet e sipërpërmendura, janë formuar tashmë strukturat me karakter kombëtar të këtyre kulteve, e për më tepër, janë të prirur ta braktisin islamin tradicional ballkanik në favor të një islami të llojit arab.

---

<sup>435</sup> Statutet e komuniteteve fetare që janë në fuqi, u miratuan nga organet përkatëse dhe, për sa nuk parashikohet në to, i duhet referuar Kodit Civil. Shih: *Statuti Komunitetit Musliman të Shqipërisë*, Tiranë 14. 05. 2005, <http://licodu.cois.it/632/view>; *Statuti i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane*, Tiranë, më 06 . 07 . 2009, <http://licodu.cois.it/617/view>; *Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, 04 . 11 . 2006 Tiranë <http://licodu.cois.it/641/view> .

<sup>436</sup> Për trajtimin juridik të pakicave myslimane në Ballkan: *The legal treatment of Islamic minorities in Europe*, (a cura di R. Aluffi B.-P. e G. Zincone), Peeters, 2004.

<sup>437</sup> Rreth bashkëpunimit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, në brendësi të ortodoksisë, shih: MGR. T. PETRESCU, *La Chiesa ortodossa e la sua attuale organizzazione amministrativa, Libertà di Coscienza ...cit.*, 103-110.

Kjo na bën të kuptojmë se çështja e marrëveshjes ka dakordësinë e të gjitha komuniteteve lidhur me tekstin e përbashkët ku përcaktohen qëllimet, mbështetja në dispozitat kushtetuese dhe ligjet në fuqi, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për interpretimin që i bëhet zbatimit të marrëveshjes.

Në nenin 2 të marrëveshjes, thuhet se komuniteti Mysliman i Shqipërisë është komunitet fetar, i cili përfshin edhe *tariketet* që ishin pjesë e komunitetit deri në vitin 1967, kur dekretet për komunitetet fetare u shfuqizuan më 13. 11. 1967; ajo është një organizatë e besimtarëve myslimanë që shfaqin, dëshmojnë dhe ushtrojnë besimin e tyre, parimet dhe ritet fetare të parashikuara në burimet islame, në shkollën juridike fetare "*Hanafita*"<sup>438</sup> dhe në statutin e komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Ky pohim shpreh në mënyrë të saktë marrëdhëniet me shkollat e ndryshme islamike, duke i vënë pritë islamit fundamentalist për të ruajtur të njëjtën linjë me traditën e islamit ballkanik.

Kisha ortodokse e përkufizon veten, në nenin 1 të statudit të saj: ajo njih si themelues të saj Jezus Krishtin; është një institucion i shenjtë; shpallet Kishë e shenjtë, e krishterë apostolike e lidhur në mënyrë të pandashme me Patriarkanën Ekumenike dhe me të gjitha kishat motra; themelohet mbi shkrimet e shenjta, traditën dhe kanonet e shenjta apostolike.

Bektashinjtë pohojnë se bëjnë pjesë në Kryegjyshatën Botërore të bektashinjve, e cila është një organizatë individësh që shpallin dhe dëshmojnë të njëjtin besim fetar dhe janë regjistruar në regjistrat përkatës të besimtarëve të zakonshëm si pjesëtar të këtij komuniteti<sup>439</sup>.

Marrëveshjet janë mjete për garantimin e të drejtave të sanksionuara në Kushtetutë për komunitetet nënshkruese, sipas një shkalle prioritetesh të ndryshme të përcaktuara prej tyre, por

---

<sup>438</sup> Sulla scuola *hanafita* vedi per tutti: S. A. ALDEEB ABU-SAHLIEH, *Il diritto islamico. Fondamenti, fonti, istituzioni*, (ed. it. a cura di Marta Arena), Carocci, Roma, 2008; F. CASTRO, *Diritto musulmano, Digesto nelle discipline privatistiche...cit.*, 290 ss

<sup>439</sup> Komunitat fetare janë struktura territoriale të besimit që bashkojnë një numër të caktuar familjesh, të cilave u jepet mundësia të bashkohen në një godinë kulti dhe të ndërtojnë komunitetin e tyre mbi këtë territor. Bëhet fjalë për një strukturë organizuese shumë të përhapur, sidomos në Ballkan. Për më shumë, shih: G. CIMBALO, *L'esperienza dell'Islam dell'Est Europa...cit., passim*

që konvergojnë në njohjen e rëndësisë për rolin e strukturës fetare<sup>440</sup>. Komunitetet fetare theksojnë nevojën e mbrojtjes së lirisë fetare individuale, jo vetëm për pjesëmarrjen në ritet fetare, por edhe për të ndërruar besimin fetar, duke njohur plotësisht lirinë e proselitizmit dhe të drejtën e secilit për të mos marrë pjesë në asnjë rit fetar, ashtu si të drejtën për të mos i përkatur asnjë kulturi.

Është gjë e veçantë që liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë të garantohet në marrëveshje me komunitetet fetare, madje në këtë pikë marrëveshjet dallojnë mes tyre. Ndërkohë që Ortodoksët dhe Bektashinjtë e shohin çështje parimore mbrojtjen e vlerave të tilla<sup>441</sup>, teksti i marrëveshjes me komunitetin Mysliman shkon përtej kësaj kur në pikën e fundit pohon se komuniteti Mysliman angazhohet të bëjë me dije dhe të garantojë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e komunitetit Mysliman të Shqipërisë, përballë deformimeve dhe prirjeve ekstremiste apo përballë çdo lloj sjelljeje kërcënuese në mjediset e besimtarëve. Në rast se vihen re sjellje të tilla, komuniteti Mysliman i Shqipërisë, njofton organet kompetente. Së fundi, palët angazhohen të sigurojnë lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo liri nuk mund të bëhet pengesë për lirinë e tjetrit. Me këtë pohim komuniteti Sunit angazhohet të vigjilojë mbi vetveten për rrezikun e shfaqjes së qëndrimeve ekstremiste, që janë karakteristikë e vizionit islam, si fe dominuese e, siç dëshmojnë tensionet e ngritura skajeve të komunitetit Sunit të islamit shqiptar<sup>442</sup>, pasojë e luftës ndaj

---

<sup>440</sup> Myslimanët preferojnë të theksojnë traditat e besimit dhe përmbajtjen e statutit të tyre. Ata u mëshojnë tipareve të islamit Sunit shqiptar, që gjatë shekujve ka përpunuar parimet e tolerancës dhe të pluralizmit fetar, duke u dalluar nga shkollat e tjera islamike, për tu identifikuar me atë Hanafita. Kisha Ortodokse, përkundrazi, u referohet normave dhe traditave për të vënë në pah veçoritë e saj.

<sup>441</sup> Neni 3, pika e fundit e marrëveshjes me ortodoksët dhe bektashinjtë thotë: “Kjo liri nuk njeh kushtëzime të tjera, veç atyre të parashikuara me ligj, me kusht që të ruhet demokracia, siguria shoqërore, mbrojtja e rendit shtetëror, e shëndetit, e moralit publik, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tretëve”.

<sup>442</sup> Konflikti në Bosnjë, Kosovë dhe Maqedoni, ka ndikuar në rritjen e një islami me frymëzim Salafit, në Ballkan, i cili është përpjekur të shtrihet edhe në komunitetin sunit shqiptar, duke ofruar forma të reja ritesh dhe praktikash fetare, që në vitin 2008. Kësaj nisme iu pre rruga edhe nga qeveria shqiptare, e sigurisht, marrëveshja me komunitetin fetar i shtoi forcat e moderuara në

integralizmit islamik, në favor të një islami pluralist. Për t'ia arritur kësaj, komuniteti Mysliman i Shqipërisë nënshkroi një marrëveshje me shtetin, ku pranon parimet demokratike dhe ndihmat ekonomike si dhe ofron bashkëpunimin e vet për mbrojtjen e parimeve të lirisë fetare brenda dhe jashtë komunitetit, duke i kërkuar shtetit të bëhet garant i këtyre vlerave. Ky pohim, i shprehur në nenin 3 të marrëveshjes, ka lidhje të drejtpërdrejtë me përkufizimin që bën komuniteti për veten në nenin 1. Me mbylljen e çështjes së zbatimit të marrëveshjes me të gjithë pjesëtarët e komunitetit që e kanë nënshkruar atë, theksohet që shteti respekton dhe njeh si përfaqësues të tij vetëm personat e autorizuar nga komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe garanton mbrojtjen e tij prej çdo personi apo grupi që pretendon të marrë emrin, sendet e kultit, pasurinë, simbolet dhe vulën e tij.

E njëjta formulë përdoret edhe për Kishën ortodokse. Kjo ndodh sepse për të dy rastet ka grupe që aspirojnë të marrin kontrollin e organizatës së kultit për ta transformuar komunitetin. Ndër Myslimanë, vihet re prirja për ta afruar atë me islamin ndërkombëtar dhe për të ushqyer konfliktin mes fundamentalistëve dhe islamit tradicional, ndërsa për Ortodoksët mund të përmenden konfliktet brenda këtij komuniteti për shkak të shkëputjes së disa kishave që pretendojnë autoqefalinë e tyre. Por, dihet se komunitetet fetare, në Shqipëri, qoftë ortodoksët, qoftë myslihanët (sunitë apo sufite)<sup>443</sup>, janë të lidhur ngushtë me historinë, me “shqiptarizmen” dhe me prejardhjen ballkanike të tyre. Shteti shqiptar e njeh prejardhjen e tyre që shprehet edhe në

---

traditën e islamit shqiptar, edhe për shkak se u vihej fre financimeve të huaja, jo pa kushte. Për më tepër, shih intervistën e lënë nga Xavier Bougarel, ballkanolog dhe kërkues shkencor pranë CNRS-së në Paris. Islam, i Balcani, l'Europa (a cura di Rosaria Zilli),

<http://www.balcanicaucaso.org/ita/aree/Serbia/L-Islam-i-Balcani-l-Europa> (ult. visita 6/04/2010)

<sup>443</sup> F. LUBONJA., *Feja në Shqipëri*. Tirane, Drita, 1995; A. POPOVIC, *Le confraternite sufi nella regione balcanica*. in *Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo. Il difficile equilibrio tra mistica e politica*, nën kujdesin e Marietta Stepanyants-is, Torino, Centro di studi religiosi comparati Edoardo Agnelli, 2008, 181-206; *Le nouvel Islam balkanique. Les musulmans, acteurs du postcommunisme (1990-2000)*, (sous la direction X. Bougarel - N. Clayer), Paris, Maisonneuve & Larose, 2001; *Muslim Identity and the Balkan State*, (a cura di H. Poulton e S. Taji-Farouki), Washington Square 1997.



marrëveshjen e nënshkruar dhe ofron mbrojtje të identitetit fetar dhe kulturor për komunitetet 'e veta' fetare. Për t'ia arritur këtij qëllimi nevojitet bashkëpunim i ngushtë me organet e shtetit nga persona juridikë që përfaqësojnë komunitetet fetare, në mënyrë që shteti, të njohë autonominë statutores të komunitetit mysliman dhe atij ortodoks<sup>444</sup>. Sidoqoftë, ky është një prej rasteve ku teksti i marrëveshjes kërkon përshtatje në varësi të veçorive që shfaq një komunitet.

Komunitetit Bektashian, për shkak të natyrës kombëtare dhe ndërkombëtare, i nevojitet mbrojtje e veçantë për Kryegjyshatën Botërore të Bektashinjve që e ka selinë në Tiranë dhe statuti i së cilës miratohet nga gjykata e shkallës së parë të Tiranës. Duke qenë se filialet e saj ndodhen si brenda, ashtu dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, ata varen nga Kryegjyshata brenda kufijve të shtetit shqiptar dhe pranojnë t'i nënshtrohen së drejtës shqiptare përsa i takon njohjes së strukturës së tyre, por në respekt të plotë me traditat e vendeve përkatëse. Prandaj shteti shqiptar u njeh komuniteteve të drejtën për t'u dhënë jetë strukturave të tyre (fetare ose jo), të cilat mund të fitojnë aty për aty njohjen e personalitetit juridik civil, duke fituar të drejtën e vetorganizimit të strukturave përkatëse fetare, menjëherë pas dorëzimit të draftit të marrëveshjes për themelimin e tyre pranë Komitetit shtetëror për kultet. Si komunitetet, ashtu edhe çdo degëzim i tyre janë persona juridikë jofitimprurës, prandaj mbi to zbatohet legjislacioni për çështjet financiare dhe juridike, i parashikuar për këto shoqata<sup>445</sup>.

---

<sup>444</sup> Neni 7, pika e dytë e marrëveshjes për myslimanët dhe ortodoksët Themelimi, struktura, organizimi, qëllimi i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe pezullimi si person juridik i komunitetit mysliman të Shqipërisë, bëhet në bazë të rregullave dhe traditave të këtij komuniteti, të kësaj marrëveshjeje dhe të ligjit në fuqi ”.

<sup>445</sup> Shpeshherë ka rikthim tek ligji *Për organizatat jofitimprurëse*, nr.8788, datë 7.5.2001, <http://licodu.cois.it/610/view>, i cili përbën një mjet kryesor për entet e komunitetit fetar që e përdorin për t'u strukturuar si organizata në shërbim shoqëror dhe për kryerjen e veprimtarisë së tyre. Ligji lidhur me marrjen e personalitetit juridik për personat juridikë të Kishës Katolike të vitit 2005 nga njëra anë dhe marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2009 me komunitetet fetare nga ana tjetër, shërbejnë si mjete të veçanta që mundësojnë ngritjen e enteve fetare, falë një procedure në thelb të njëjtë me atë të parashikuar në ligji.

Që komunitetet fetare, nënshkrues të marrëveshjes, të mund të fitojnë personalitetin juridik civil, duhet të paraqesin kërkesën pranë gjykatës së Tiranës, por edhe këtu udhëzimet ndahen: Myslimanët dhe Bektashinjtë duhet ta paraqesin kërkesën nëpërmjet përfaqësuesit të tyre ligjor, e cila duhet shoqëruar me aktin themeltar ku tregohet vendi i selisë; natyra dhe veprimtaria e komunitetit; statuti që hedh dritë mbi organet dhe detyrat e funksionarëve të tyre; të dhëna për të ardhurat financiare në zotërim si dhe mirëkuptimin për mënyrat e humbjes së personalitetit juridik. Krahas kësaj, kërkohet edhe pëlqimi i Komitetit shtetëror për kultet, i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të atij që shtron kërkesën.

Në rastin e Kishës ortodokse, huazohet një formulë 'historike', prandaj gjykata e Tiranës bazohet në veprimtarinë e mëparshme, por kjo nuk e përjashton nga detyrimi i formulimit të kërkesës për dhënien e personalitetit juridik dhe të hartimit të statutit<sup>446</sup>. Brenda tridhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës, gjykata e Tiranës u bën të ditur vendimin e saj, të gjithë të interesuarve.

Arsyet për procedura të ndryshme, në varësi të komunitetit, kanë të bëjnë me strukturën hierarkike dhe statute të Kishës ortodokse, si strukturë më e hapur dhe e ndryshueshme nga ajo e dy komuniteteve myslimane të cilët, edhe pse të ngarkuar me detyrën për të drejtuar lutjet dhe organizuar kultin, nuk kanë hierarkinë e një kleri të strukturuar si ai ortodoks<sup>447</sup>. Juridiksioni i besimeve fetare shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përjashtuar atë Bektashian, që ka shtrirje ndërkombëtare. Megjithatë, këta të fundit i mëshojnë idesë që, për veprimtaritë fetare të zhvilluara në territorin shqiptar, duhet

---

<sup>446</sup> Edhe pse komunitete fetare, përjashtuar Kishën katolike, për ato motive që tashmë i kemi shpjeguar, kanë fituar personalitetin juridik civil së paku që në vitin 1923 në të drejtën shqiptare nuk fitohet, personaliteti juridik civil, për efekt kohor, siç ndodh në të drejtën italiane, por vetëm nëpërmjet regjistrimit të statutit të komunitetit pranë gjykatës, në këtë rast asaj të Tiranës. Për këtë arsye, me humbjen e personalitetit juridik të komuniteteve fetare në vitin 1967, lindi nevoja e regjistrimit përsëdyti si dhe lind detyrimi për ta vënë në dijeni Gjykatën e Tiranës, sa herë që komuniteti bën ndryshime në statutin e tij.

<sup>447</sup> Baba Selim R KALIÇANI, *Historia e Bektashizmit si sekt mistik Islam*, Tiranë, 1999, *passim*; A. POPOVIC, *Le confraternite sufi...cit, passim*; F. J PEIRONE., G. RIZZARDI, *La spiritualità islamica*, Roma, Studium, 1986.

përdorur gjuha shqipe. Në nenin 10 të marrëveshjes, komunitetet fetare marrin përsipër të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e shtetit, ndërkohë që ky u njeh të drejtën për t'u organizuar dhe për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pavarësi të plotë, duke i qëndruar besnik parimit të ndarjes mes komuniteteve fetare dhe shtetit. Kjo bëhet në të mirë të interesit kombëtar, të ndarjes, të laicitetit, të pluralizmit, pra, të bashkëjetesës dhe tolerancës së plotë mes komuniteteve të ndryshme fetare, parime këto në të cilët duhen mbështetur statutet e tyre. Marrëveshja siguron edhe autonominë organizuese të komuniteteve fetare për sa e sheh të mundshme kryerjen e roleve statutore. Emrat e atyre që ngarkohen me poste drejtuese për komunitetin, i duhen bërë me dije Komitetit shtetëror për kultet, në mënyrë që t'u garantohet liri e plotë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre fetare, administrative dhe organizuese, gjithnjë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Marrëveshja garanton, gjithashtu, të drejtën e komunitetit fetar për të pasur lidhje me komunitetet fetare të huaja dhe të pranojnë prej tyre apo individëve të huaj ndihma, qoftë edhe në të holla, por me kushtin që aktivitetet e kryera të mos cenojnë rendin e brendshëm, atë ndërkombëtar, legjislacionin në fuqi dhe vetë marrëveshjen. Kjo dispozitë kërkon të ruajë kontrollin mbi lidhjet e ndryshme ndërkombëtare, që, duke vepruar brenda komunitetit mysliman, mund ta orientojnë islamin shqiptar drejt një islami integralist, i cili do të çenonte parimet kushtetuese të laicitetit, ndarjes, pluralizmit dhe tolerancës brenda rendit shqiptar.

Shteti shqiptar, duke qenë se u njeh komuniteteve fetare një rol pozitiv në jetën shoqërore, parashtron në nenin 13 të marrëveshjes, disa norma për çështje të financimit nga shteti dhe dhënies së ndihmave materiale si për organet qendrore, ashtu dhe për entet e ngritura nga komunitetet fetare. Masa të tilla parashikohen në një ligj të veçantë, të miratuar në maj të vitit 2009<sup>448</sup>, i cili u rezervon komuniteteve fetare, nënshkrues të marrëveshjes disa lehtësira. Në nenin 2 thuhet: "*Shteti mund të financojë pjesërisht komunitetet fetare për ndërtimin apo mirëmbajtjen e godinave të kultit, si dhe për rinovimin dhe*

---

<sup>448</sup> *Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me këshillin e ministrave*, Ligj nr.10 140, 15.5.2009, <http://licodu.cois.it/612/view>

*restaurimin e qendrave të pelegrinazhit dhe strukturave ndihmëse të tyre, objektet që lidhen me turizmin fetar, sipas projekteve të paraqitura nga komunitetet fetare, nga shteti apo Komiteti shtetëror për kultet dhe të miratuara nga ministria kompetente*". Këshilli i Ministrave përcakton masën e këtyre financimeve, duke iu përmbajtur minimumit të shumës që është sa "...gjysma e buxhetit minimal për nëpunësit e personelit, bazuar në dëshminë e pagave që i paraqitet institutit kompetent për Sigurimet shoqërore". I njëjti trajtim parashikohet për pagat e mësuesve të shkollave të administruara nga komunitetet fetare. Këto shkolla mund të ngrihen edhe nga institute apo ente jofitimprurëse që kanë lidhje me komunitetet fetare, por financimi i tyre bëhet në bazë të shpenzimeve të paraqitura nga Komiteti shtetëror për kultet dhe miratohet nga Ministria e Rinisë, Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Për kryerjen e këtyre aktiviteteve, shteti mund të vërë në dispozicion edhe ndërtesa apo objekte që i shërbejnë këtij qëllimi. Në nenin 5 të marrëveshjes, parashikohet një shumë vjetore, e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, falë një projekti për mbrojtjen e rendit botëror *Headquarters Bektashi*, duke qenë se në Shqipëri gjendet selia botërore e bektashizmit. Projekti kërkon miratimin e një komisioni që, nëpërmjet ministrit përgjegjës për kultet, harton propozimin për Këshillin e Ministrave, i cili shqyrton dhe miraton të gjitha projektet e paraqitura nga komunitetet fetare. Projektet plotësohen sipas moduleve të paracaktuara, paraqiten para datës së skadencës së fiksuar nga ligji mbi bilancin e shtetit dhe miratohen me dekret të ministrit kompetent për kultet. Përdorimi i burimeve bëhet nën vëzhgimin e organeve kompetente shtetërore për sektorin e shpenzimeve. Këto organe ndërhyjnë në raste abuzimesh me fondet e dhëna, duke proceduar sipas ligjit. Mënyrat e zbatimit të ligjit, i nënshtrohen monitorimit të Komitetit shtetëror për kultet dhe Ministrisë përkatëse.

Për financimin e aktiviteteve të ndryshme fetare, nuk duhet të angazhohet vetëm shteti. Në fakt, ligji parashikon edhe mundësinë e privatëve, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, të cilët mund të përfitojnë lehtësira nga barra fiskale, siç parashikohet me ligj, në rast se marrin përsipër të sponsorizojnë aktivitete të tilla<sup>449</sup>. Së

---

<sup>449</sup> Ligji i referohet nenit 5 ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 për sponsorizimin, i cili trajton rrugët që duhen ndjekur për mbështetjen financiare dhe ndihmën

fundi, në dispozitat kalimtare dhe përmbyllëse (neni 12) ligji parashikon që për ndërtimin e godinave të kultit, për të gjitha institutet arsimore, përfshirë dhe kopshtet, dhe për godinat e ngritura për shërbimet shoqërore dhe shëndetësore, komunitetet fetare përjashtohen nga barra e taksave siç e parashikon ligji nr. 9482, datë 03.04. 2006 “*Mbi legalizimin, urbanizimin dhe njohjen e ndërtimeve pa lejë*”.

Nga shqyrtimi i dispozitave financiare del se duhet bërë e njohur ana financiare e komuniteteve fetare si subjekte mbi të cilat mund të zbatohen normat për këtë sektor. Nga ana tjetër, veprimtaria e tyre duhet të jetë e kontrollueshme, për aq kohë sa sponsorizimi për to sigurohet nga kontribuesit, rrjedhimisht neni 14 i marrëveshjeve të ndryshme që ka të bëjë me regjistrimin e komuniteteve fetare, pranë organeve tatimore, i trajton ato si të gjitha organizatat e tjera jofitimprurëse. Me mbylljen e çështjes financiare, marrëveshja fiton statusin juridik tatimor të komunitetit fetar, duke përdorur formulime të ndryshme për të dhënë garanci për respektimin e ligjit lidhur me administrimin e bilancit të tyre dhe pranimin e donacioneve si nga subjekte që veprojnë brenda vendit, ashtu dhe nga të huajt.

Pjesa e përbashkët për të gjitha komunitetet, që ka të bëjë me aktivitetet dhe subvencionet që përjashtohen nga taksat e veçanërisht subvencionet e ndryshme të fituara në mënyrë ligjore dhe donacionet që shkojnë për kryerjen e misionit të komunitetit, ndërtimin e godinave të reja të kultit dhe pasuritë e patundshme që i përkasin si komunitetit ashtu dhe enteve të krijuara prej saj e që kanë si qëllim vetëm ushtrimin e aktiviteteve fetare. E njëjta gjë

---

materiale, i përkufizuar me termin “sponsorizimet” e veprimtarive shoqërore dhe publike të kryera nga subjekte private dhe nga ente, institucione, shoqata dhe organizata që njihen nga ligji dhe që janë regjistruar si persona juridikë. Në nenin 5, lidhur me sponsorët, masën e sponsorizimit dhe të taksës mbi shërbimet thuhet: “a) subjektet, persona fizikë apo juridikë që paguajnë taksën e përfitimit sipas ligjit nr. 7677, datë 3.3.1993 zbresin nga taksa mbi të ardhurat shumë e sponsorizuar, që konsiderohet si shumë e zbritur në masën 4% të të ardhurave para kaktimit të taksës. b) subjektet, persona fizikë apo juridikë mund të paguajnë taksën e parashikuar në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993 lidhur me taksat për ndërmarrjet e vogla, duke u mbajtur nga shuma e pagesës 1% të të ardhurave të tatuara. Në rastin e dhënies së financimit nënshkruhet një kontratë nga e cila zyra e tatimeve mund të zbrësë pjesën e financimit të dhënë. *Për sponsorizimet*, Ligji nr.7892, datë 21.12.1994. <http://licodu.cois.it/611/view>

mund të thuhet për kalimin e pasurisë enteve jashtë apo brenda të njëjtit komunitet. Personat juridikë që e kanë fituar këtë status para marrëveshjes mund të regjistrohen brenda dy vitesh si të tillë pranë Gjykatës së Tiranës, siç parashikohet në nenin 8 të marrëveshjes. Po ashtu, përjashtohen nga detyrimi për t'u regjistruar pranë zyrës së sigurimeve shoqërore pjesëtarët e personelit fetar me shtetësi të huaj, të cilët mendohet se i kanë derdhur kontributet në vendlindjen e tyre, ndërkohë që gëzon të drejtën të regjistrohet pranë sigurimeve shoqërore, i gjithë personeli tjetër, që duhet të derdhë kontributet në përputhje me të ardhurat. Lidhur me veprimtari të karakterit institucional, si: ushtrimi i kultit; administrimi i klerit; aktiviteti baritor, humanitar dhe bamirës; formimi i klerit dhe mësimdhënia e teologjisë dhe e shkencave fetare, komuniteti dhe personat juridikë të krijuar prej saj nuk kanë asnjë detyrim të mbajnë regjistrat përkatës apo të kryejnë detyrat administrative, të parashikuara nga ligjet në fuqi. Për veprimtari të tilla, ata nuk kanë farë detyrimi të mbajnë kontabilitet vjetor për organet kompetente të shtetit dhe aq më pak ta dorëzojnë atë pranë organeve shtetërore të caktuara nga legjislacioni në fuqi. Më pas, në marrëveshje trajtohen festat fetare, duke njohur, zyrtarisht, vetëm një pjesë të tyre. Komunitetet fetare janë të lira të caktojnë edhe festa të tjera, por shteti nuk është i detyruar t'i njohë ato<sup>450</sup>. Komunitetet kanë të drejtë të ngrenë dhe të administrojnë institute të edukimit dhe të arsimit të të gjitha niveleve. Shteti dhe komuniteti duhet të respektojnë të drejtën e prindërve për t'u siguruar fëmijëve të tyre edukimin bazë rreth besimit të tyre fetar dhe të njohin diplomat e lëshuara nga institutet e arsimit fetar<sup>451</sup>. Ndërkohë që Bektashinjtë huazojnë për shkollat e tyre programin e shkollës publike, komuniteti Mysliman dhe Kisha ortodokse hartojnë kurrikulat përkatëse për shkollat fetare jo publike, testojnë dhe vlerësojnë stafin pedagogjik. Për miratimin e tyre, merr vendim Ministria e Arsimit dhe e Shkencës". Si për të zbutur karakterin fetar të shkollave, palët bien dakord që gjatë procesit mësimor, shteti dhe

---

<sup>450</sup> Për një studim kritik lidhur me festat fetare tradicionale shih: G. KONOMI, *Mbi festat fetare*, Tiranë, M. Duri, 1967.

<sup>451</sup> Shih: *Për sistemin arsimor parauniversitar*, Ligj nr.7952, 21.6.1995, <http://licodu.cois.it/310/view>

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë angazhohen që arsimimi i fëmijëve të bazohet në të drejtat njerëzore dhe në parimet e demokracisë dhe që përgatitja e tyre të orientohet drejt një jete të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në harmoni, paqe, tolerancë, barazi gjinore dhe vëllazëri mes njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare, personave me prejardhje të ndryshme si dhe të luftohen prirjet raciste dhe fanatizmi. Njëkohësisht u jepet garanci komuniteteve për ushtrimin e veprimtarive shoqërore me karakter ekonomik, edukativ dhe shëndetësor dhe për ngritjen e organizatave humanitare, qoftë edhe në formën e shoqatave jofitimprurëse. Marrëveshja u garanton komuniteteve fetare masat që janë në përdorim si dhe ato që do të ndërmerren në të ardhmen, si element themelor i lirisë së shprehjes dhe të ndërgjegjes<sup>452</sup>; po ashtu, u jep të drejtën të ngrenë strukturat e veta që u mundësojnë përdorimin e mjeteve të komunikimit, por në asnjë rast, mesazhi nuk duhet të përhapë ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare apo që diskriminojnë komunitetet e tjera fetare dhe nxisin konfliktin mes besimeve të ndryshme.

Shteti u lejon komuniteteve fetare t'i konsiderojnë të shenjta ndërtesat dhe objektet e kultit, prandaj ndalohet çdo lloj ndërhyrjeje nga forcat e rendit, përveç rasteve flagrante, kur kjo kërkohet me prokurë nga një vendim gjykate, nga një organ ekzekutiv apo në rast kanosjeje serioze. Me përjashtim të këtyre rasteve, shteti mbron hapësirat publike të komunitetit fetar. Lidhur me ndërtimin e godinave të reja të kultit, edhe pse marrëveshjet përmbajnë dispozita krejt të ndryshme, efektet janë tërësisht të njëjta për lëshimin e lejeve të ndërtimit, por në respekt të plotë me rregullat e planit urbanistik (neni 21)<sup>453</sup>. Marrëveshja trajton edhe çështjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të komuniteteve fetare dhe e detyron shtetin të kthejë gjithë ç'ka

---

<sup>452</sup> Ligji për shfrytëzimin e televizioneve ishte ndër të parët që u miratua pas vitit 1991 dhe që në vitin 1993, emisionet televizive të realizuara nga komunitetet fetare përjashtoheshin nga çdo lloj takse. *Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë*, Ligj Nr.7680, 3.3.1993, <http://licodu.cois.it/589/view>.

<sup>453</sup> Sa i përket komunitetit mysliman hasim një dispozitë tjetër ku thuhet: “Këshilli i ministrave merr përsipër të legalizojë godinat e kultit të paregjistruara, duke u mbështetur në kërkesën e dokumentacionit teknik të paraqitur nga komuniteti mysliman i Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi”.

konfiskuar në të shkuarën<sup>454</sup>, duke u dhënë përparësi kërkesave të mëparshme të Myslimanëve, me mbështetjen e *Agjencisë për kthimin dhe kompensimin e pronave*, e cila shqyrton rastet e palëve në konflikt, bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë arkivit të shtetit (neni 22). Ky detyrim vlen edhe për ndërtesat historike dhe monumentet me vlera kulturore kombëtare dhe shpirtërore, prandaj shteti bashkëpunon për restaurimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në zbatim të ligjit *për trashëgiminë kulturore*<sup>455</sup>. Shteti mjaftohet me lejen për përdorimin e ndërtesave me vlerë të veçantë historiko-artistike, në pronësi të komuniteteve fetare, leje që lëshohet prej këtyre të fundit. Tek përmbytja e marrëveshjeve, vihet re ndonjë dallim që ka të bëjë me rregullat e zhbërjes së saj, sepse nëse është e vërtetë që pranohet prej të gjithëve që zgjidhja e mosmarrëveshjeve të bëhet duke rënë në ujdi mes palëve, duket se Bektashinjtë ia besojnë këtë rol të veçantë ndërmjetësimi Komitetit shtetëror për kultet. Në mbyllje të marrëveshjeve, palët ritheksojnë angazhimin e tyre për t'u marrë vesh lidhur me zbatimin e tyre, duke marrë parasysh që qëllimet e arritura përbëjnë bazën për marrëveshjet e ardhshme. Komunitetet marrin parasysh edhe shkëputjen nga kjo marrëveshje, duke e kundërshtuar atë në parlament, sipas procedurave që presin ende të miratohen. Sipas nenit 116 të Kushtetutës<sup>456</sup>, natyra juridike e këtyre marrëdhënieve duhet parë

---

<sup>454</sup> Bektashinjtë dhe ortodoksit e shohin me vend të theksojnë që: “Shteti duhet të kthejë dhe kompensojë të gjitha pasuritë e Kryegjyshitës botërore të bektashinjve, duke filluar me godinat e kultit të njohura tashmë prej të gjithëve, të cilat për shumë kohë kanë qenë qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit Bektashi dhe që mbartin historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, vendet e shenjta, sendet e arkivat e konfiskuara gjatë regjimit komunist”.

<sup>455</sup> Në zbatim të ligjit nr. 9048, 07.04.2003 *Për trashëgiminë kulturore*, <http://licodu.cois.it/573/view> Komuniteti mysliman i Shqipërisë i paraqet MTKRS-së (dega e turizmit) listën e objekteve të kultit që janë monumente kulturore, në mënyrë që përfshihen në planin e turizmit kulturor. Për restaurimin dhe ruajtjen e tyre kanë përparësi objektet që shfaqin interes më të madh për rritjen e turizmit.

<sup>456</sup> Neni 116: 1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. 2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. 3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve



e lidhur me burimet e jashtme të ligjit, të ratifikuara nga parlamenti dhe të përfshira në sistemin e shtetit me miratim ligjor. Lidhur me modifikimet e mundshme të marrëveshjeve, shteti nuk mund të veprojë në mënyrë të njëanshme, por duhen rihapur negociatat mes palëve, ku ai luan rolin e mbikëqyrësit sipas natyrës që i lejon legjislacioni i negociuar. Nëse nuk respektohen këto norma, do të çenohej rëndë parimi i laicitetit dhe i ndarjes, e sidomos do të shkelej marrëveshja për trajtimin e njëjtë të komuniteteve të ndryshme fetare, tipik për sistemin shqiptar.<sup>457</sup>. Sidoqoftë, njohja e vlerës juridike të marrëveshjeve duket e volitshme në këndvështrimin politik, dhe është e detyrueshme nga pikëpamja juridike, me kusht që të respektohen klauzolat përmbyllëse të marrëveshjes konform procedurave të paralajmëruara nga palët dhe natyrës negociuese të normave ligjore. Kështu, Shqipëria përmbyll kuadrin normativ lidhur me marrëdhëniet me kultet kryesore në vend dhe u rinovon drejtuesve të komuniteteve dhe presidentit të Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë pasaportën diplomatike, gjë që thekson rolin e tyre institucional dhe publik<sup>458</sup>. Komunitetet fetare, të veshura me personalitet juridik të së drejtës civile, fitojnë dinjitet të plotë juridik dhe gëzojnë trajtim të njëjtë nga ana e shtetit, ndërkohë që marrëveshjet e nënshkruara prej tyre, garantojnë zbatimin e plotë të detyrimeve kushtetuese.

---

drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

<sup>457</sup> Probleme të veçanta dolën nga marrëveshja mes shtetit dhe komunitetit Bektashi të cilit shteti i njeh dimensionin e një strukture ndërkombëtare.

<sup>458</sup> *Për një shtesë në vendimin* nr.335, 2.9.1997 të këshillit të ministrave “*Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit*”, të ndryshuar, Vendim nr.49, 14.1.2009, <http://licodu.cois.it/580/view>.

## Kreu IV

### Hapja ndaj “kulteve të reja”: Shqipëria rilexon historinë e vet

Përmbledhje: 4.1. Ungjillorët shqiptarë në mbështetje të gjuhës, kulturës, identitetit dhe të pavarësisë shqiptare. 4. 2. Marrëveshja e bashkëpunimit me Vëllazërinë Ungjillore (VUSH). Përmbajtja dhe efektet lidhur me legjislacionin e zakonshëm dhe mbrojtjen e lirisë së besimit. 4. 3. Drejt marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit: Hebrejtë, Bahaitë, Dëshmitarët e Jehovait.. 4. 4. Magjia e Perëndimit: një ligj shqiptar për lirinë e besimit. 4. 5. Shtrirja e efektshmërisë së marrëveshjeve mbi trevat e Shqipërisë etnike. 4. 6. Marrëveshjet e bashkëpunimit: model i eksportueshëm?

#### **4.1. Ungjillorët shqiptarë në mbështetje të gjuhës, kulturës, identitetit dhe të pavarësisë shqiptare**

Shqipëria, e vendosur në kufi mes krishterimit perëndimor dhe atij lindor, dalëngadalë u islamizua, duke filluar që nga shekulli XV<sup>459</sup>. Për shkak të vështirësisë për t'iu afruar këtij vendi, si nga deti, ashtu dhe nga toka, protestantëve europianë u dukej gati e pamundur të depërtonin aty. Për daljen faqas të besimeve të ndryshme si ai ortodoks e katolik, duhej pritur fillimi i viteve tetëqind, kur Perandoria Osmane, në kohën e Tanzimatit, shfuqizoi

---

<sup>459</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA *Nazione e religione in Albania...*, cit., *passim*; AA. VV. *Historia e popullit...cit.*; Sh. HYSI, *Histori e komuniteteve fetare...cit.*; N. JOTGA, *Histori e shkurtër... cit., passim*.

ligjin për ndalimin e proselitizmit, çka bëri që protestanizmi të fillonte të përhapej nëpërmjet veprimtarisë së “Rizgjimit”, e cila përfshiu kishat protestante europiane dhe ato të Shteteve të Bashkuara<sup>460</sup>. Bëhej fjalë për një formë proselitizmi të bazuar në përhapjen e shkrimeve të shenjta në çdo gjuhë kombëtare, për t’i afruar besimtarët sa më shumë me leximin e mesazhit të krishterë<sup>461</sup>.

---

<sup>460</sup> Edhe protestantët përfituan nga politika e reformave të shpallura nga Perandoria Osmane duke e përshpejtuar shtrirjen e tyre sidomos nëpërmjet konvertimit të besimtarëve ortodoksë, madje deri në atë masë sa shfuqizimi i dënimit me vdekje për veprën penale të proselitizmit u kundërshtua jo vetëm në rrethet islame, por sidomos nga Patriarkana Ekumenike. R. BOTTONI, *vep. cit.*, 33, ss. Po ashtu, mes shek. XVIII-XIX protestanizmi u përfshi nga lëvizja e përtëritjes dhe e rilindjes shpirtërore që mori emrin “Rizgjimi ungjillor”. Synimi ishte rikthimi tek predikimi edhe nëpërmjet shpërndarjes së literaturës së shenjtë, frytet e së cilës ishin shumë më të mëdha nëse ofrohej në gjuhën vendase, mjaft më e thjeshtë për masën e gjerë. Nga kjo e mori shtysën përkthimi i biblës e, veçanërisht, besëlidhja e re në sa më shumë gjuhë të ishte e mundur. Për më tepër, rreth “Rizgjimit” shih: E. G. LÉONARD, *Storia del protestantesimo*, Il declino e la rinascita, vol. III. - I, Milano, il Saggiatore, 1971; D. MASELLI, *Tra Risveglio e millennio*, Torino, Claudiana, 1974; G. CIMBALO; *I rapporti finanziari tra Stato e Confessioni religiose nei Paesi Bassi*, Milano Giuffrè, 1989, 124 ss.

<sup>461</sup> Nisma për përkthimin e Biblës në gjuhën shqipe zë fill diku mes viteve 1816-1819. Për këtë dha ndihmën dhe mbështetjen e vet *British and Foreign Bible Society* (BFBS), e cila vuri 300 stërlina në dispozicion. Puna filloi me veprën Vangjel Meksit (1770-1821), tashmë mësues dhe autor i një libri të gramatikës shqipe. U ra dakord që përkthimi të sillej në dialektin e Janinës. Meksi ndërroi jetë pa e pasë kryer veprën e tij, e cila u rishikua dhe u përmyll nga Gregor Gjirokastriti, aso kohe, arqimandrit i Eubea-s dhe mbështetës i pavarësisë së Greqisë nga Turqia. Ai botoi, gjithashtu, përkthimin e ungjillit të Mateut në vitin 1824 dhe Besëlidhjen e re në vitin 1827. Lidhur me këtë, shih: XH. LLOSHI, “*Të dhëna dokumentare të reja mbi V. Meksin, G. Gjirokastritin dhe K. Kristoforidhin*”, *Studime Filologjike*, 1973/4, 1974/1, 2; G. GURGA, “*Dorëshkrimi i pabotuar i “Anonimit Epirot”*”, *Studi in onore di Antonino Guzzetta*, (a cura di F. Di Miceli e M. Mandalà), Palermo, Helix Editore, 2002, 205-207. Përkthime të tjera të një niveli të admirueshëm gjuhësor si për Besëlidhjen e re, ashtu edhe për tekstet e tjera të shenjta, vijnë nga Kostandin Kristoforidhi, edhe falë mbështetjes së *British and Foreign Bible Society* (BFBS). Nuk ka dyshim që botime të tilla rrinë përkrah veprave që hodhën bazat e gjuhës moderne shqipe dhe dhanë kontributin e tyre në lëvizjen patriotike për pavarësinë e vendit. Ref. AA. Vv. *Bibla shqip dhe tradita*, Tiranë, Toena, 2004; XH. LLOSHI, *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Tiranë, Bota shqiptare, 2005.

Tiparet e predikimit ungjillor, praktikat e kultit që u përqendruan në leximin vetjak të shkrimeve të shenjta, i shtynë organizatat protestante ndërkombëtare të merrnin përsipër përkthimin në shqip të Biblës dhe të veprave të tjera liturgjike, duke ndikuar kështu në zhvillimin dhe vlerësimin e gjuhës, e cila u kthye në një mjet të rëndësishëm gjatë luftës për pavarësi. Vëmendja për interesin kombëtar shtrihej tek një sërë lëvizjesh dhe përpjekjesh të tyre për forcimin e bashkimit kombëtar<sup>462</sup>. Përhapja e protestanizmit në Shqipëri u arrit falë edukimit dhe zhvillimit të kulturës në nivel kombëtar. Leximi i teksteve të shenjta dhe komentimi i tyre në bashkësinë e besimtarëve është praktika fetare kryesore e komunitetit protestant, prandaj shkollimi dhe njohja e gjuhës u bënë parakusht për procesin e ungjillizimit. Këto komunitete fetare, në ndryshim nga besimet tradicionale, nuk përdorin ndonjë gjuhë liturgjike, por gjuhën e vendit ku ndodhen. Kjo solli me vete angazhimin serioz të besimeve të reja në fushë të arsimit, me qëllimin për të njohur dhe përdorur gjuhën shqipe. Gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XIX, protestantët shqiptarë dhanë kontributin e tyre në këtë sektor, çka u siguroi atyre mirënjohjen e shoqërisë e për pasojë mundësinë për të shërbyer për zgjimin e shpirtit kombëtar dhe në luftën e pavarësisë që kulmoi në njëzetvjetëshin e parë të shekullit të ri.

Pikërisht, në këtë kohë, protestanizmi bëhet pjesë e traditës së vendit dhe një pjesë e përfaqësuesve të këtij besimi fetar janë patriotë aq të shquar dhe aktivë, sa të meritojnë vlerësimin e shqiptarëve me bindje të ndryshme politike dhe fetare<sup>463</sup>.

Një shtysë tjetër e rëndësishme, gjatë kësaj periudhe, për përhapjen e mesazhit të kishave ungjillore në mbarë Europën dhe në Shqipëri, ka të bëjë me shtimin gjithnjë e më shumë të fluksit të

---

<sup>462</sup> Dalëngadalë, mesazhi ungjillor mbërriti në ambientet fetare shqiptare nëpërmjet komunitetit ortodoks. Falë veprës së tre misionarëve amerikanë, besimtari ortodoks Gjerashim Qiriazhi, u konvertua në protestant në vitin 1877. Qiriazhi, së bashku me të motrën, Sevastia, edhe ajo e kthyer në ungjillore, hapin një sërë shkollash, sidomos për edukimin e vajzave.

<sup>463</sup> Mjaft domethënës është vlerësimi që i bën qeveria e Republikës popullore të Shqipërisë, e cila, pavarësisht se i kishte shpallur besimet fetare të jashtëligjshme, nuk e sheh këtë si pengesë që t'i akordojë Gjerashim Qiriazhit titullin e nderit "Mjeshtër i popullit", në vitin 1987.

emigrantëve nga Ballkani perëndimor, dhe Europa drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës<sup>464</sup>.

Tashmë, thyerja e kufijve fisnorë dhe e traditave të moçme që ndajnë popullsinë shqiptare, mund të ndodhë në një kontekst të ri, pikërisht në emigracion, falë ballafaqimit me komunitete të ndryshme dhe nevojës për të krijuar hapësirën vetjake dhe mbrojtjen prej të tjerëve. Në këto rrethana, origjina e përbashkët shqiptare është boshti që mban lidhur komunitetet e ndryshme në emigrim, të cilat përpiqen të kultivojnë identitetin e tyre për t'i shpëtuar asimilimit të mundshëm dhe për të rifituar sadopak siguri në një kontekst të ri shoqëror, kryekëput të ndryshëm nga ai i origjinës. Bëhet fjalë për një dukuri komplekse që përfshin edhe besimet tradicionale, duke i mbështjellë ato edhe me petkun kombëtar. Në këtë botë të re për ta, shqiptarët forcojnë lidhjen e tyre me Kishën ortodokse dhe aspirojnë për të fituar autoqefalinë e saj duke projektuar ndarjen nga Kisha e Patriarkanës së Kostandinopojës, në kërkim të “shqiptarisë” së tyre<sup>465</sup>. Pikërisht në Shtetet e Bashkuara, ortodoksët shqiptarë i dhanë jetë strukturës së parë të kishës së organizuar, e cila dha kontribut të padiskutueshëm për lindjen e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, qoftë edhe në kuadrin e Patriarkanës Ekumenike.

Gjithsesi, nuk është e mundur të shkëputesh plotësisht nga konteksti ku jeton, prandaj kontakti dhe ndikimi i botës fetare në Shtetet e Bashkuara e sidomos degëzimi i larmishëm i fesë, bëri që shqiptarët emigrantë të zbulonin magjinë e besimeve të reja dhe t'i

---

<sup>464</sup> Protestantizmi me prejardhje nga Shtetet e Bashkuara shfaqte tipare të ndryshme nga ai me prejardhje europiane. Një ndër qëllimet e tij strategjike ishte shpallja e ungjillit në vendet e Europës jugore, aty ku, ndër shekuj, mesazhi ungjillor nuk kishte depërtuar edhe për shkak të pranisë së katoliçizmit. Strategjia e besimit protestant me prejardhje nga Shtetet e Bashkuara ka në shënjestër së paku dy probleme: kriza politike e kishës së Romës, e cila ishte përfshirë në ngjarjet e rilindjes dhe nga mosmarrëveshjet mbi fuqinë e përkohshme të papëve dhe, së dyti, në krijimin e ngadaltë por të vazhdueshëm të procesit të riatdhesimit drejt vendeve të Europës Jugore. Këtu mbërrinin emigrantët që ktheheshin nga Shtetet e Bashkuara, të cilët përbënin grupin kryesor të protagonistëve për përmbushjen e këtij misioni.

<sup>465</sup> Nuk është e rastit që *cursus honorum* e Fan Nolit zhvillohet në komunitetin ortodoks të emigruar në Shtetet e Bashkuara dhe është pikërisht Noli një prej kontribuesve më të shquar në majë të përpjekjeve për autoqefalinë e Kishës ortodokse shqiptare.

përkushtohen krijimit të strukturave të kulteve të reja. Efekt të veçantë mbi emigrantët shqiptarë pati predikimi ungjillor, i cili afroi pranë vetes sidomos anëtarë të kulturës dhe besimit ortodoks që përbënin jo vetëm shumicën e asaj bashkësie emigrantësh, por edhe grupin më të vëmendshëm ndaj mesazheve emancipuese edhe në nivel kulturor dhe politik<sup>466</sup>. Prirje të tilla shkojnë paralel me frymën nacionaliste në rritje, e cila po përhapej vullshëm ndër emigrantë duke sjellë me vete zbulimin e vlerës të gjuhës mëmë gjatë celebrimeve liturgjike, si nevojë e pashmangshme për përfshirjen e të gjithëve në procesin e konvertimit në kultin e ri.

Në këtë mënyrë konsolidohen ato dy përbërës që sjellin me vete protestanizmin në Shqipëri dhe grupi i misionarëve të parë të mbërritur nga Anglia përforcohet me vullnetarë shqiptarë që kthehen nga emigrimi në Shtetet e Bashkuara. Në brendësi të këtij grupi dalloheshin edhe lëvizje të ndryshme në shërbim të pavarësisë së vendit, të cilat, nga njëra anë shfrytëzonin njohjet, lidhjet ndërkombëtare dhe mbështetjen e tyre politike dhe nga ana tjetër i hapnin rrugë ligjshmërisë së kultit të ri që po shtrihej dalëngadalë mbi shoqërinë shqiptare. Roli i Ungjillorëve, ashtu si ai i besimeve tradicionale: myslimanëve Sunitë, Bektashinjve, Ortodoksëve dhe Katolikëve, është qendror në përpjekjet për pavarësinë e vendit, ndaj nën hijen e prestigjit të fituar nga komunitetet fetare dhe për meritat e pamohueshme në luftën për pavarësi, u bë e mundur që në vitin 1922 të hapej në Korçë misioni ungjillor shqiptar i drejtuar nga misionarë amerikanë<sup>467</sup>. Në të

---

<sup>466</sup> Trevat nga ku kishte fluks të madh emigrator, i përkisnin pikërisht zonës lindore të Shqipërisë, ku përqëndrohet edhe pjesa më e madhe e besimtarëve ortodoksë.

<sup>467</sup> Në vitin 1908, për drejtimin e shkollave, u thirr Violet James Bond Kennedy, e bija e një misionari të kongregatës së Manastirit dhe reverendi presbiteran Phineas B. Kennedy, i diplomuar në Princeton University ku kishte pasur profesor Woodrow Wilson. Kjo i krijoi shanset që të ndikonte në vendimet e presidentit të SHBA-ve, i cili, në konferencën e Versajës (1919) doli në mbrojtje të lirisë së Shqipërisë, po ashtu kërkoi dhe fitoi njohjen e së drejtës së shqiptarëve për vetëqeverisje. Të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare e vlerësuan dhe nderuan për këtë mision të tij. Veprimtaria e Phineas B. Kennedy-së, u përforcua më shumë kur me të u bashkuan anëtarët e një delegacioni shqiptar në kongresin e Versajës si dhe patriotët të tillë si Anselmo Lorecchi, intelektual dhe patriot arbëresh, themelues dhe drejtor i gazetës “La Nazione albanese”, i cili mbledhi dokumente diplomatike dhe hartoi një memorandum mbi pavarësinë e

vërtetë, bëhet fjalë për zyrtarizimin e pranisë së tyre, tashmë prej dekadash në Shqipëri. Shkolla e Korçës u themelua në vitin 1887 dhe, që atëherë, rruga e saj qe plot vështirësi pasi ishte e vetmja shkollë në vend që jepte mësim në shqip, ndryshe nga shkollat e tjera, të cilat, duke qenë nën kontrollin e grekëve, turqve, italianëve, austriakëve, bullgarëve, përdornin gjuhët përkatëse të këtyre vendeve.

Gjatë përpjekjeve të vazhdueshme për marrjen e personalitetit juridik civil të komunitetit ungjillor, u duk sikur u hap një dritare sado e vogël me nënshkrimin e dekretit të vitit 1923<sup>468</sup>, por, sidoqoftë, ky komunitet ishte ende i ri dhe i dobët për t'u përballur me rrethana të tilla në të mirë të të drejtave e tij.

Kështu, si në vitet e para të Republikës, ashtu dhe gjatë Monarkisë, Ungjillorët kalojnë një periudhë të vështirë, por megjithatë nuk e ndërpresin hovin e zhvillimit të tyre, edhe falë ndihmave që marrin nga jashtë, të cilat shkojnë kryesisht për mëkëmbjen e shkollave dhe për shërbime të ndryshme sociale.

Sa më shumë i shton shteti shqiptar qëndrimet e veta autoritare dhe përpjekjet për institucionalizimin e plotë të marrëdhënieve me besimet fetare, siç e dëshmon legjislacioni zogist i 1929-ës, nga i cili protestantët nuk janë në gjendje të përfitojnë asgjë<sup>469</sup>, aq më

---

Shqipërisë dhe rolin që mund të luante ajo për ruajtjen e ekuilibrave në Ballkan, për ndërtimin e paqes së vazhdueshme të bazuar në njohjen e autonomisë dhe të pavarësisë së kombeve të ndryshme. Këto qëndrime që i bashkëndante edhe delegacioni amerikan u konkretizuan nga Woodrow Wilson, i cili këmbënguli që të merreshin në konsideratë nga të gjithë. Për më shumë, shih: A. LORECCHIO, *Albania, memorandum per l'indipendenza albanese*, Roma, 1929, e *Popoli e culture in dialogo tra il Danubio e l'Adriatico* (Contributi italiani al X Congresso internazionale dell'Association Internationale d'Études du Sud-Est Européen, Parigi, 24-26 settembre 2009), (a cura di A. D'Alessandri – M. Genesin), *România Orientale*, 22, 2009, Roma, Bagatto Libri, 2009. Pra, fati i shqiptarëve të Shqipërisë u kryqëzua sërish me atë të shqipatrëve të emigruar në Itali.

468 Duhet mbajtur parasysh që miratimi i statuteve të komuniteteve fetare tradicionale, i diktuar nga dispozitat kushtetuese dhe nga ngjarjet ndërkombëtare, bëri që në vitin 1923 të miratohej ligji për statutet ligjore të komuniteteve fetare, me anë të të cilit u akordohej statusi i personalitetit juridik civil kulteve të ndryshme. V.: *Statuti legal i komuniteteve fetare*, <http://licodu.cois.it/415/view>

469 Rreth kësaj, shih: MINISTERO PER I BENI E LE ATTIVITÀ CULTURALI, DIREZIONE GENERALE PER GLI ARCHIVI, *L'Unione fra l'Albania e l'Italia*, Censimento delle fonti (1939-1945) conservate negli archivi pubblici e privati di Roma (a cura di Silvia Trani), Roma,

shumë përpiqet t'i fuqizojë shkollat publike duke ashpërsuar paralelisht luftën kundër shkollave private. Kështu, në vitin 1933 mbyllet shkolla e Korçës bashkë me shkollat e tjera private fetare në vend, për t'u hapur vetëm atëherë kur, më në fund, Zogu vendos ta zbusë qëndrimin e tij politik ndaj sistemit shkollor.

Pavarësisht kësaj, Lëvizja Ungjillore ia del të marrë ende ndihma gjatë viteve në vijim, nga misionarët anglosaksonë, duke mos u shkëputur nga rruga e ndjekur edhe nga vendet e tjera europiane, përfshirë edhe Italinë<sup>470</sup>. Gjatë njëzetvjetëshit mes dy luftërave, lëvizjet ungjillore në Europën Jugore dhe Lindore ishin nën persekutimin e vazhdueshëm të qeverive totalitare, të cilave nuk u mungonte mbështetja edhe nga besimet fetare tradicionale, të trandura nga frika e konkurrencës së kulteve të reja, por sidomos të shtyra nga dyshimi i fortë i qeverive se mos këto lëvizje fetare fshehin në vetvete qëndrime kundërshtuese dhe armiqësore ndaj regjimeve totalitare që ishin ulur këmbëkryq në mbarë kontinentin.

Në Shqipëri, u hasën vështirësi sidomos gjatë pushtimit italian<sup>471</sup> e më pas atij gjerman. Në sytë e italianëve, ata shiheshin si benjaminë të botës anglosaksone, pra të atyre fuqive që kërkojnë medoemos ta shkëpusin Ballkanin nga thonjtë e politikës fashiste, ndërkohë që për gjermanët janë, thjesht, agjentë të armiqve të tyre. Është kjo një arsye më shumë që ungjillorët shqiptarë të hidhen, pa hezitim, kundër pushtuesve dhe të shtojnë përpjekjet në luftën për pavarësi, gjë që ua rriti vlerën në sytë e popullit dhe në marrëdhëniet me partitë që ishin në frontin e luftës. Sidoqoftë më përparësi fitojnë marrëdhëniet ndërkombëtare, sidomos me

---

Pubblicazioni degli Archivi di Stato, Strumenti CLXXIII, 2007. R. MOROZZO DELLA ROCCA, *op. cit.*, 249 ss.

<sup>470</sup> Edhe në Itali, ku kishte tashmë një prani historike të kishës Valdeze, lëvizjet e reja ungjillore ia dalin të depërtojnë nëpërmjet emigrantëve, të cilët gjatë qëndrimit të tyre në Amerikën veriore kishin njohur këto përvoja të reja fetare. Shih: S. LARICCIA., *Battaglie di libertà. Democrazia e diritti civili in Italia (1943-2011)*, Roma, Carocci ed., 2011, *passim*.

<sup>471</sup> Gjatë periudhës së bashkimit me Mbretërinë e Italisë e më pas gjatë pushtimit prej saj, komunitetet ungjillore në Shqipëri patën mjaft vështirësi pasi mbi ta ra persekutimi i regjimit që kishte përfshirë ndërkohë Jugun e gadishullit. Për më tepër, shih: G. ROCHART, *Regime fascista e Chiese evangeliche*, Torino, Claudiana, 1990.



vendet perëndimore dhe s'ka dyshim që ungjillorët shqiptarë e shihnin me sy të mirë mundësinë e ndërhyrjes angleze, për t'i bërë ballë komunizmit që po lëshonte rrënjë në vend.

Në përfundim të luftës, Ungjillorët nuk kanë më shumë se 400 besimtarë. Kisha ungjillore është e ndërgjegjshme se nuk është vetëm vendi i shkatërruar që kërkon rimëkëmbje, por janë edhe një sërë nismash dhe veprimtarish shoqërore që duhen risjellë në jetë. Pas Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që në Perëndim, kushtetutat e reja demokratike i hapin portat lirisë fetare, madje, në disa raste, duke i dhënë konkretisht mbështetje veprimtarisë dhe predikimit të kulteve të reja<sup>472</sup>, në vendet e Europës Lindore, ku erdhën në krye udhëheqës të demokracisë socialiste, përfshirë dhe Shqipërinë, liria dhe besimi fetar iu nënshtuan një persekutimi të pashoq gjithnjë e në rritje. Fillimisht, kjo u vu re me mënjanimin gradual të çdo besimi fetar, më pas masat u ashpërsuan me shpronësimin e të mirave materiale të tyre, për të kulmuar në vitin 1967 me zhdukjen e plotë të çdo kulti dhe shpalljen e ateizmit shtetëror<sup>473</sup>.

Edhe pse në dekretet e asaj kohe nuk pasqyrohet zhbërja e komunitetit të ungjillorëve, ky, ashtu si komunitetet e tjera fetare është i detyruar të heqë dorë nga predikimi i fesë, ndërkohë që të gjitha veprimtaritë dhe pasuritë e tij i kalojnë shtetit. Një gjendje e tillë vazhdon deri në vitin 1990, vit në të cilin bie regjimi komunist. Vullneti i shtetit për vendosjen e bashkëpunimit me besimet fetare, bën që në vitin 1992 të dalë në pah edhe rilindja e Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë (VUSH), organizatë që përfaqëson kishat dhe besimet protestante me drejtim ungjillor. Ajo i sheh të lidhura rrënjët e saj me Kishën ungjillore në Shqipëri këtu e 118 vjet më parë, kur me 14 nëntor 1882 mori jetë kjo lëvizje, falë kontributit të themeluesve të saj si Gjerasim Qiriazhi e

---

<sup>472</sup> Në vende të tilla si Italia, Shtetet e Bashkuara synonin vendosjen e pluralizmit fetar si ilaç kundër qëndrimeve autoritare brenda shoqërisë italiane, aq sa në një traktat të posaçëm parashikonte lirinë fetare për lëvizjet ungjillore. Shih: "Ratifica ed esecuzione del Trattato di amicizia, commercio e navigazione, del Protocollo di firma, del Protocollo addizionale e dello scambio di Note conclusi a Roma, fra l'Italia e gli Stati Uniti d'America", il 2 febbraio 1948, Legge 18 giugno 1949, n. 385, in Suppl. a Gazz. Uff., 12 luglio, n. 157.

<sup>473</sup> R. MOROZZO DELLA ROCCA, *Albania. Le radici della crisi*, Milano, Guerini e Associati, 1997.

Petro Nini Luarasi, njëkohësisht edhe përfaqësues të shquar të Rilindjes kombëtare<sup>474</sup>. Në rrethanat e reja që ishin krijuar, si nevojë parësore dilte organizimi i disa nismave për rizbulimin e mesazhit fetar, sipas protestanizmit. Po ashtu, aktivizimi i protagonistëve të kishave të ndryshme, që shoqërohej me një pësjtjellim të përgjithshëm, për shkak të misionëve të ndryshme që ishin shfaqur në vend, kërkonte të kthehej vëmendja tek përvoja e mëparshme e këtij populli e të konvergohej në një pikë të përbashkët. Po ashtu, lindte nevoja e mjeteve juridike për rishikimin dhe shfuqizimin e normave të sistemit shqiptar, i cili trashëgonte normat për rregullimin e ateizmit shtetëror, në mënyrë që të sigurohej disi mbrojtje për grupet fetare që po rimëkëmbnin veprimtaritë e tyre të mëparshme në shoqërinë shqiptare.

E kemi parë tashmë se si komunitetet fetare gjurmuan dhe gjetën disa norma në brendësi të sistemit, të cilat u mundësuan atyre dhe enteve përkatëse hartimin e kërkesës për të fituar personalitetin juridik civil, duke u bazuar në veprimtarinë e zhvilluar prej tyre. VUSH-i, ashtu si komunitetet e tjera fetare protestante më të vona në Shqipëri, gjetën strehë tek ligji nr. 2362, datë 16.11.1956 “*Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike*”<sup>475</sup>, ligj që mundësonte hapjen e shoqatave të njohura në nivel lokal dhe që nuk u shfuqizua kurrë. Kjo ishte një ndihmë jo e vogël për komunitetet dhe grupet e vogla, të cilat merrnin jetë si kulte të reja, falë mundësisë për t’iu drejtuar gjykatës së rrethit përkatës, në mënyrë që të regjistroheshin si organizata shoqërore pa qëllim përfitimi, duke i hapur rrugë kështu një liste të gjatë organizatash, të lindura gjatë një periudhe të turbullt në vend dhe të strehuara nën “çadrën”<sup>476</sup> mbrojtëse të VUSH-it.

---

<sup>474</sup> Po atë ditë ishte krijuar kisha ungjillore e Korçës dhe shoqata “Vëllazëria ungjillore e Shqipërisë” edhe kjo me seli në Korçë. Në të njëjtin muaj fillon botimi i gazetës së shoqatës me titull “*Letra e Vëllazërisë*”.

<sup>475</sup> Ligji nr. 2362, datë, 16/11/1956/ “*Mbi organizatat shoqërore jofitimprurëse*” ...,cit.

<sup>476</sup> Interes të veçantë paraqiste neni 13 i projektligjit lidhur me strukturën e VUSH-it, ku thuhej: “Neni 13. *Një organizatë shoqërore mund të ketë degë të saj në vende të ndryshme, në një fshat, lokalitet, qytet, rreth ose qark, kur në atë vend ka anëtarë në një numër jo më të vogël nga ai i parashikuar në statut të organizatës. Degët regjistrohen në një regjistër të veçantë, që mbahet nga*

Edhe pse me miratimin e Kodit të ri Civil të vitit 1994, norma e sipërpërmendur u shfuqizua me anë të nenit 1167, përsëri u krijuan kushtet me anë të normave në fuqi, që të sigurohej mbrojtja e duhur për përfitimin e personalitetit juridik civil (neni 28-63 k.c), pasi regjistrimi mund të kryhej pranë gjykatave edhe falë miratimit të ligjit të sipërpërmendur, mbi organizatat *non profit*. Të gjitha këto rrethana ligjore krijojnë kushtet që VUSH-i të dalë në skenën politike dhe shoqërore të vendit, për të paraqitur kërkesën e saj, e cila për shumë arsye gjen mbështetje si në rangjet politike, ashtu edhe në shoqërinë shqiptare. Kërkesa e saj për t'u njohur dhe për të përfituar trajtim dhe respekt të njëjtë me besimet e tjera shërben si provë për matjen e nivelit të demokratizimit të sistemit shqiptar dhe masën e mbrojtjes së lirisë fetare në vend. Dëshmi për këtë janë ndërhyrjet e vazhdueshme të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve nëpërmjet ambasadës së tyre në Tiranë, qëndrimet e mbajtura nga Këshilli i Europës dhe nga Komisioni i Venecias të përmendura edhe më lart.

Demokracia e rilindur shqiptare, duhet të dëshmojë se i ka kthyer krahët ateizmit të shtetit dhe se, madje, i ka lënë pas vendet e Europës Lindore në çështje të lirisë fetare, në mënyrë që të pranohet në Këshillin e Europës dhe në NATO, me perspektivën e shumëpritur për t'u bërë pjesë e Bashkimit europian. Qeveria shqiptare ka përparësinë të punojë në një vend ku pluralizmi fetar është traditë e rrënjosur, së pari mes vetë komuniteteve fetare, prandaj është e vetëdijshme se mund t'i bëjë ballë sfidës së ndërtimit të marrëdhënieve me një besim jo tradicional, aq më tepër tani që bëhet fjalë për një "besim të ri", që sidoqoftë ka ndërtuar një histori të vetën në vendin e shqiptonjave dhe ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin kulturor të këtij vendi.

---

*komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit, të rrethit ose qarkut përkatës ku është krijuar dega."*

#### 4. 2. Marrëveshja e bashkëpunimit me Vëllazërinë Ungjillore Shqiptare (VUSH). Përmbajtja dhe efektet lidhur me legjislacionin e zakonshëm dhe mbrojtjen e lirisë së besimit

Që në fitin 1992, u paraqit pranë sekretarisë për besimet fetare, kërkesa për njohjen zyrtare të *Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë* (VUSH) shoqëruar me programin dhe statutin, i cili bazohej tërësisht në statutin e parë të Vëllazërisë Ungjillore shqiptare, atë të vitit 1892. Si atëherë, edhe sot vëllazëria ka për qëllim “përhapjen e ungjillit dhe të shkrimit shqip anekënd Shqipërisë”.<sup>477</sup>

Me t’u kryer marrëveshjet me Kishën katolike, aty mes viteve 2005-2006, nisin negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes shtetit shqiptar dhe VUSH-it, çka përbënte, për së pari, njohjen e barazisë së plotë juridike të një kulti, i cili nuk i përkiste asaj kategorie të ngushtë besimesh tradicionale për vendet e Europës Lindore<sup>478</sup>. Tashmë që kishte marrë rrugë një legjislacion i negociuar me ekuilibër të admirueshëm, në respekt të plotë me parimet e barazisë mes besimeve, po piqeshin kushtet për thellimin e bashkëpunimit me kultet më të vogla.

---

<sup>477</sup> Kërkesa lindi nga shqetësimi se po kryhej heshturazi, njëfarë diskriminimi ndaj komunitetit fetar, gjë që u përcillej në formën e një letre të hapur nëntë gazetave kryesore në vend për ta botuar (Alternativa, Pasqyra, Sindakalisti, Koha Jonë, Republika, Zëri i Popullit, Kombi, Rilindja Demokratike, Zëri i Rinisë). Shih: VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË, *Letër e hapur*, drejtuar presidentit të Republikës, Sali Berisha, kryeministrit, Aleksandër Meksi, Kryetarit të parlamentit Pjetër Arbnori dhe mbante datën 13 shkurt 1993. Kjo kërkesë shoqërohej me një lutje për njohjen e personalitetit juridik civil, gjë që ishte kërkuar që në vitin 1991 bazuar në ligjin nr. 2362, datë 16.11.1956 “*Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike*”...cit.

<sup>478</sup> Në raportin e Departamentit të shtetit (2006) mbi gjendjen politike në Shqipëri, theksohet roli aktiv i ambasadës dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara si në subvencionimin e minoriteteve fetare jo tradicionale në Shqipëri, ashtu edhe në ndërhyrjen pranë qeverisë shqiptare dhe zhvillimin e takimeve me komitetin shtetëror për kultet, me qëllim që të siguronte njohjen e plotë të të drejtave dhe lirisë fetare, edhe për këto besime fetare si dhe arritjen e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit. U. S. DEPARTMENT OF STATE, *Albania, International Religious Freedom Report 2006*, <http://www.state.gov/g/drl/rls/irf/2006/71364.htm>, (ult. ac. 26.09, 2011).

Pas marrëveshjeve bashkëpunuese me komunitetet fetare tradicionale, po i hapet rrugë zhvillimit të negociatave mes Komitetit shtetëror për marrëdhëniet me komunitetet fetare dhe VUSH-it.

Mbetet një çështje e diskutueshme nëse ky komunitet fetar përfaqëson një 'besim të ri' në Shqipëri, apo radhitet ndër besimet tradicionale. E kemi parë tashmë se historia e tij kryqëzohet thellësisht me përpjekjet për emancipimin e popullit shqiptar; me gjallërimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe; me alfabetizimin e vendit dhe luftën për pavarësi. Prania e gjerë e grupeve ungjillore, në veprimtaritë e ndryshme kulturore; angazhimi i përfaqësuesve të këtyre grupeve për studimin dhe futjen e shqipes në përdorim dhe përpjekja për konsolidimin e kulturës shqipe, të gjitha këto kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për formimin e asaj elite që la gjurmë në historinë e Shqipërisë. Kjo na shtyn të pohojmë se, nëse u referohemi dy shekujve të fundit, VUSH-i, apo me saktë organizatat fetare që përfshihen aty, janë pjesë e traditës shqiptare, çka do të thotë se e përmbushin atë kriter që mat shkallën e rrënjosjes së një besimi fetar në vend, i cili shërben si parakusht që shteti të ndër marrë nënshkrimin e marrëveshjes bashkëpunuese, siç sanksionohet në Kushtetutë.

Shkalla e përhapjes në vend, prania e godinave të kultit dhe e qendrave të ndryshme shoqërore, kryesisht atyre arsimore, përbëjnë kriteret themelore për nënshkrimin e marrëveshjes. Sigurisht, edhe kjo marrëveshje, sado që e hartuar mbi modelin e paraardhëseve, përmban disa veçori domethënëse.

Gjatë zhvillimit të negociatave, Komiteti shtetëror për marrëdhëniet me komunitetet fetare ka zbatuar kriteret e sistemit spanjoll për përcaktimin e VUSH-it si komunitet i vetëm fetar, duke e vlerësuar veprimtarinë e kishave ungjillore në Shqipëri si atë të një 'familjeje fetare' e cila bashkëndan të njëjtat karakteristika, ashtu si edhe vizionin për botën, të vërtetën mbi fenë, strukturat kishtare, misionin bamirës në Shqipëri dhe veprimtarinë në shërbim të edukimit dhe arsimit<sup>479</sup>.

---

<sup>479</sup> Sistemi spanjoll parashikonte nënshkrimin e marrëveshjeve të minoriteteve me ente që përfaqësonin një bashkësi organizatash kishtare në mënyrë që të kishte një orientim fetar sa më të gjerë. Për këtë dëshmon fakti që marrëveshjet e nënshkruara me protestantët, edhe në këtë vend, mbulojnë një sërë kishash,

VUSH-i ia doli të dërgonte një delegacion, i cili përfaqësonte gjithë bashkësinë e larmishme që karakterizohej nga puna për predikimin e ungjillit, bashkësi që u riorganizua dhe u mblo dh rreth një statuti të përbashkët, të hartuar që në vitin 1992, duke iu përmbajtur të njëjtave qëllime të Vëllazërisë Ungjillore të vitit 1892.

Selia qendrore e organizatës është në Tiranë dhe ngarkohet me detyrë të përhershme, gjithnjë në respekt me ligjet e Shqipërisë. Ajo frymëzohet nga Bibla, nga Besëlidhja e Re dhe e Vjetër dhe beson në Jezus Krishtin. Neni 5 i statutit pohon se VUSH-i ka si qëllim të organizojë dhe të përfaqësojë bashkimin kombëtar të kishave, të komuniteteve, bashkimin e kishave dhe të organizatave ungjillore në Shqipëri, të cilat synojnë përhapjen e ungjillit në vend”. VUSH-i nuk ka qëllime fitimi, nuk është shoqatë qeveritare apo me karakter politik; të ardhurat nga veprimtaritë e saj i shpërndan mes anëtarëve të vet dhe për përmbushjen e qëllimeve të veta; mban marrëdhënie me individë, organe, organizata, shoqata dhe institucione brenda dhe jashtë vendit dhe ka të drejtë të bëhet anëtare e organizatave homologe ndërkombëtare. Është anëtare e Aleancës Ungjillore Europiane dhe Botërore dhe përfaqësohet nga presidenti i saj. Objektivat e VUSH-it janë: të vendosë, të zhvillojë dhe të mbajë marrëdhënie mes besimtarëve, kishave, komuniteteve, bashkimit të kishave dhe organizatave ungjillore me prejardhje të ndryshme që i janë bashkuar VUSH-it; të promovojë arsimin laik dhe fetar nëpërmjet seminareve, kurseve, kolegjeve, shkollave të të gjitha niveleve, mbështetur në mjetet e veta; të bashkërendojë punën për ndihmat humanitare, materiale dhe ekonomike për të gjithë shqiptarët pa dallim si në degën e arsimit, ashtu edhe në shëndetësi, kulturë, sport dhe në ndihmën sociale; të shpallë ungjillin nëpërmjet botimeve, shpërndarjes së librave, revistave, broshurave, botimeve të periodikëve dhe materialeve audiovizive mbi fenë, të cilat shërbejnë për përmbushjen e qëllimeve që do të përcaktohen; të

---

ashtu siç ndodh me besimin islam, i cili përfshin benda vetes disa degëzime të këtij besimi dhe po ashtu vepron edhe me komunitetet hebre. A. CASTRO JOVER, *Las minorías religiosas en el derecho español cit.*, 211-244; A. TORRES GUTIÉRREZ, *El desarrollo postconstitucional del derecho fundamental de libertad religiosa en España...cit.*, 243-268.

organizojë veprimtari artistike, kulturore shkencore dhe sportive si dhe të përfaqësojë komunitetin ungjillor përballë të tjerëve. Anëtarësimi në këtë organizatë është i lirë dhe kërkon zbatimin e statutit pa cënuar pavarësinë dhe vetëqeverisjen e ortakëve; drejtimi i saj është i ngjashëm me atë të një asambleje<sup>480</sup>. Struktura organizuese e VUSH-it përbëhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Komiteti Ekzekutiv. Presidenti i VUSH-it drejton edhe Asamblenë e Përgjithshme, e cila përbëhet nga dy përfaqësues të çdo kisha, komuniteti apo organizate anëtare. Vendimet merren me shumicë absolute duke zbatuar parimin një votues një votë. Në rast barazie votash, presidenti gëzon të drejtën e votës së dyfishtë<sup>481</sup>.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme hartohen me shumicë absolute të votave, ku vota e secilit ka të njëjtën vlerë. Në rast barazie votash, vota e kryetarit vlen sa për dy. Me t'u vendosur hallkat organizuese, statuti përcakton trajtën e organeve drejtuese, rregullat e funksionimit të brendshëm, strukturën administrative dhe drejtimin e financave, mënyrat e shkrirjes së organizatës dhe shpërndarjen e pasurisë besimeve të tjera që bashkëndajnë të njëjtat parime dhe qëllime me VUSH-in. Po ashtu, rikonfirmohet roli drejtues i Asamblesë së Përgjithshme, i cili mund të përjashtojë një anëtar në rastet e parashikuara nga statuti dhe nga rregullorja e brendshme, pasi të ketë marrë propozimin nga pjesëtarët e tjerë

---

<sup>480</sup> Çdo kishë, komunitet, bashkësi kishash apo organizatë ungjillore (që ka më shumë se njëzet anëtarë dhe pranon konventën e Lozanës të vitit 1974) ka të drejtë t'i bashkohet VUSH-it, pasi t'i ketë paraqitur kërkesën Komitetit ekzekutiv të VUSH-it, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës. Deri në marrjen e një vendimi të prerë nga ana e Asamblesë së përgjithshme, struktura e interesuar është 'anëtar vëzhgues'. Vetëm pas shprehjes së pëlqimit nga ana e asamblesë, anëtari vëzhgues mund të bëhet pjesëtar i VUSH-it dhe të gëzojë të gjitha të drejtat si anëtar i përhershëm. Pranimi bëhet me shumicë të thjeshtë votash.

<sup>481</sup> Një bashkësi kishash nuk mund të ketë më shumë se gjashtë përfaqësues në Asambenë e përgjithshme e në rast mosmarrëveshjes, komiteti ekzekutiv vendos se si t'u jepet zgjidhje. Asambleja e përgjithshme mblidhet vetëm një herë në vit, por edhe në raste të jashtëzakonshme kur thirret nga komiteti ekzekutiv i VUSH-it, ose kur mbledhja kërkohet nga 1/5 e anëtarëve të tij. Thirrja duhet bërë brenda 30 ditësh nga data kur merret vendimi dhe është e vlefshme nëse janë të pranishëm së paku 2/3 e anëtarëve. Nëse gjatë mbledhjes së parë nuk arrihet *quorum*-i i nevojshëm, mbledhja e dytë zhvillohet brenda 10 ditësh me praninë e së paku 1/3 e anëtarëve.

apo të shqyrtojë dhe pranojë dorëheqjet nga shoqata. Më pas, listohen rregullat për llogaritjen dhe shpërndarjen e kuotave për shoqatat, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Asambleja e Përgjithshme ka për detyrë të fuqizojë, bashkërendojë dhe zhvillojë misionin fetar të të gjithë pjesëmarrësve në të, duke u shfaqur para shoqërisë shqiptare si një komunitet që gëzon njohjen e komuniteteve të tjera fetare, e veçanërisht të qytetarëve e për rrjedhojë edhe të institucioneve<sup>482</sup>. Komiteti ekzekutiv kryeson dhe drejton, nën kontrollin e Asamblesë së Përgjithshme, gjatë periudhës mes zgjedhjeve. Ai mblidhet jo më rrallë se një herë në tre muaj<sup>483</sup>.

Negociatat janë përballur me vështirësi të ndryshme dhe njëkohësisht kanë kërkuar mbështetje në përfundimet e marrëveshjeve paraardhëse të nënshkruara me komunitetet historike dhe tradicionale të pranishme në vend, siç del nga analiza e detajuar e këtyre marrëveshjeve. Gjithsesi, u është kushtuar vëmendje e veçantë tipareve dalluese të VUSH-it, ose duke mënjанuar ndonjë problematikë që trajtohet në marrëveshjet me komunitetet e tjera, por që s'ka lidhje me VUSH-in, ose duke modifikuar normat e përbashkëta të marrëveshjeve bashkëpunuese me besimet e tjera. Me sa duket, marrëveshja e nënshkruar me Kishën katolike nuk ka shërbyer si pikë referimi, paçka se bëhet fjalë për një besim të krishterë, i cili mund të bashkëndajë elemente të përbashkëta me atë katolik, më shumë se me besimet e tjera tradicionale<sup>484</sup>. Arsyet e këtij qëndrimi, ndoshta,

---

<sup>482</sup> Këtu, duket sikur parlamenti shqiptar të ketë huazuar konceptin *notorio arraigo*, tipik për sistemin spanjoll, sipas të cilit kriteri thelbësor për njohjen juridike të një besimi fetar është se vetë ky i fundit duhet të ketë siguruar njëfarë reputacioni në publik dhe të shihet nga individë të ndryshëm si organizatë e veçantë fetare, e përshtatshme për t'u veshur me personalitet juridik dhe e aftë për të luajtur rolin e saj në shoqëri. LLAMAZARES FERNÁNDEZ, *Derecho de la libertad de conciencia ...cit*; AA. VV, *Constitución, leyes de libertad religiosa, acuerdos, derecho común, actas del I Congreso Internacional Hispano-Portugués, sobre Libertad Religiosa*, León, 22-23 octubre, 2009, León, Universidad de León, 2010.

<sup>483</sup> Statutit të vitit 1992, aktualisht në fuqi, i është shtuar një pjesë e rregullores së brendshme të vitit 1999 që ka të bëjë me punën e komitetit ekzekutiv për kryerjen e regjistrimit pranë gjykatës së Tiranës.

<sup>484</sup> Ndodh edhe në sistemet e tjera, si për shembull në atë italian, ku, për përcaktimin e përmbajtjes së marrëveshjeve për besimin protestant, por jo vetëm për të, të përdoret si model marrëveshja e nënshkruar me kishën katolike.



duhen kërkuar në shqiptarësinë e theksuar të strukturës organizuese të *modus operandi* dhe të veprimtarisë së VUSH-it, deri aty sa kjo organizatë të shihet si një organizate fetare kombëtare, edhe pse e lidhur nëpërmjet marrëdhënieve ekumenike të qëndrueshme, të dukshme dhe të shpallura me organizatat e Kishës protestante ndërkombëtare<sup>485</sup>. Ndërtimi i marrëdhënieve të tilla shpjegon edhe praninë e një sërë ambasadorëve në ceremoninë e mbajtur për nënshkrimin e marrëveshjes<sup>486</sup>, me 22 nëntor 2010, në sallën e hotel “Sheraton”.

Marrëveshja u nënshkrua mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komunitetit fetar Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella. Marrëveshja bazohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 902, datë 10 nëntor 2010. Ajo u firmos nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në ceremoninë e zhvilluar morën pjesë përfaqësues të institucioneve më të larta (rreth 200 persona), të shoqërisë civile dhe të botës akademike. VUSH-i përfaqësohej nga

---

Këtu bën përjashtim Shqipëria, për shkak të rolit të rëndësishëm që kanë luajtur besimet tradicionale, sidomos ato shqiptare të cilët shërbejnë si pikë referimi e qëndrueshme dhe e sigurt për të gjitha besimet e tjera që aspirojnë të jenë pjesë e traditës së vendit, duke u integruar në historinë dhe në të përditshmen e popullit shqiptar.

<sup>485</sup> Marrëveshja e nënshkruar shqyrton dhe mbron marrëdhëniet ndërkombëtare të besimit fetar, njësoj siç veprohet me besimet e tjera, të cilët, me qëllimin për të ruajtur dhe zhvilluar këto marrëdhënie, kanë përfituar, sipas ligjit, lëshimin e pasaportës diplomatike për drejtuesit e tyre, në mënyrë që të kenë liri sa më të plotë për të lëvizur jashtë. Shih: *Për një ndryshim në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, të këshillit të ministrave, “Për lë- lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”*, të ndryshuar, Vendim, nr. 226, datë 5.5.2000, <http://licodu.cois.it/579/view>; *Për një shtesë në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të këshillit të ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”*, të ndryshuar, Vendim nr. 49, datë 14.1.2009, <http://licodu.cois.it/580/view>

<sup>486</sup> Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësuesit e ambasadave të: Shteteve të Bashkuara, Deborah Jones; Mretërisë së Bashkuar, ambasadorja Fiona Mcilwham; Republikës frëncese, ambasadorja Maryse Daviet; Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, ambasadori Henk van den Dool; Republikës federale të Gjermanisë, i ngarkuari me punë Jan Rudolf; Zvicrës, ambasadorja Yvana Enzler. Për l'OSCE-në, mori pjesë ambasadori dhe zëvendës drejtori i Departamentit ligjor të shtetit, Frank Dalton.

pastorë dhe personeli laik. Edhe krerët e katër komuniteteve fetare tradicionale e mirëpritën ftesën për të marrë pjesë<sup>487</sup>.

Marrëveshja u bë pjesë e sistemit shqiptar nëpërmjet ligjit nr. 10 394, datë 10 mars 2011, me të njëjtën procedurë të ndjekur për komunitetet e tjera fetare, pas një diskutimi të gjatë, ku u vunë në dukje lidhjet e forta kulturore dhe patriotike të Vëllazërisë Ungjillore. Veprimtaria e saj ka kontribuar në përpunimin e gjuhës shqipe; shkollat e saj kanë qenë burim kulture dhe dije në vend, gjithnjë në respekt të traditave kulturore dhe njëkohësisht, duke ushqyer dëshirën për progresin dhe emancipimin e vendit<sup>488</sup>. Po ashtu, u vu në pah fakti se VUSH-i nuk është një përvojë e huaj për popullin dhe shoqërinë shqiptare, por është pjesë e rëndësishme e jetës historike dhe shoqërore të saj.

Në parathënie, marrëveshja u referohet normave të përdorura edhe për besimet e tjera fetare e në veçanti, nenit 10 të Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë. Në dispozitat e përgjithshme lidhur me objektin e marrëveshjeve, përdoret po ai formulim që gjejmë për çdo marrëveshje të nënshkruar, ndërkohë që vihet re një dallim në nenin 2, aty ku pohohet se “VUSH-i është bashkësia e kishave dhe OJF-ve Ungjillore (protestante) të regjistruara ose jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, në të cilën janë organizuar individë që shfaqin e shprehin të njëjtat bindje e besime fetare”<sup>489</sup>. Po në nenin 2, flitet për komunitetet e tjera si organizatë: individësh, për Bektashinjtë; besimtarësh, për Sunitët; ndërsa për Ortodoksët i referohet nenit 2 të statutit të këtij komuniteti<sup>490</sup>. Qëllimet e organizatës (neni 3), nuk ndryshojnë nga ato të komuniteteve të

---

<sup>487</sup> Lidhur me praninë e VUSH-it në Shqipëri, i referohemi një studimi të bërë nga ky komunitet fetar, sipas të cilit, në vitin 2003, në Shqipëri, ishin rreth 22.000 besimtarë, në zotërimin e të cilëve ishin 180 kisha, 40 prej të cilave ndodheshin në Tiranë.

<sup>488</sup> Shih: Ligji nr.10 394, datë 10.3.2011 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, botuar në “Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë”, nr. 34, datë 7 prill 2011.

<sup>489</sup> Shih: Neni 2 i marrëveshjes me VUSH-in. *Ibidem*.

<sup>490</sup> Neni 2. “Kuptimi. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë e kupton dhe e shpreh vetveten ashtu siç përcaktohet në nenin 1 të statutit të saj”. *Ibidem*.

tjera. Kjo mund të pohohet si për nenin 4 që rregullon zbatimin e marrëveshjes, për nenin 5 që i detyron palët të respektojnë parimin e ndarjes, të laicitetit dhe të ligjshmërisë, ashtu edhe për nenin 6 që bashkërendon punët mes organeve shtetërore dhe atyre të komunitetit. Të njëjtat norma i gjejmë edhe në kapitullin e dytë, kushtuar organizatës dhe personelit juridik, ku neni 7, në mënyrë të veçantë, trajton statusin e personave fetarë dhe juridikë. E njëjta gjë mund të thuhet për nenin 8, lidhur me njohjen e personalitetit juridik, me dallimin e vetëm që përcaktimi i kohës prej tridhjetë ditësh brenda të cilave gjykata e Tiranës duhet të dekretojë njohjen, kalon si pikë e dytë e nenit 9 të marrëveshjes së VUSH-it. Për më tepër, ky nen është i njëjtë me gjejmësin e tij tek marrëveshja e komunitetit Bektashian nëpërmjet të cilit (ndryshe nga Sunitët dhe Ortodoksët) kërkohet të shtrihet mbrojtja edhe mbi shqiptarët e këtij besimi me qëndrim jashtë vendit<sup>491</sup>. Nenet 10, 11 dhe 12 kanë të njëjtin formulim si tek marrëveshjet e komuniteteve të tjera. Struktura dhe përmbajtja e marrëveshjes ndryshojnë përsa u përket marrëdhënieve financiare të trajtuara në kapitullin III.

Neni 13 i marrëveshjes së VUSH-it detyron si vëllazërinë, ashtu edhe personat juridikë të saj, të regjistrohen pranë organeve tatimore si persona juridikë *non profit*, në përputhje me ligjin në fuqi. Një urdhër të tillë e gjejmë të shprehur edhe tek marrëveshjet e tjera, në nenin 14 të tyre. Ndërsa në nenin 13 të të gjitha marrëveshjeve, përveç asaj të VUSH-it, parashikohet mundësia që komunitetet fetare të financohen nga shteti, sipas një ligji të posaçëm që parashikon shfrytëzimin e një fondi shtetëror për financimin e kulteve, fond ky i krijuar posaçërisht në bilancin e shtetit. Vëllazëria Ungjillore nuk kërkon dhe as pranon kurrfarë financimi nga shteti, në respekt të marrëveshjes për respektimin e plotë të parimit të ndarjes. Neni 14 i marrëveshjes së VUSH-it, ku trajtohen normat lidhur me statusin juridik dhe tatimor, është

---

<sup>491</sup> Në vendet kufitare me Shqipërinë, e veçanërisht në Maqedoni, Kosovë dhe Mal të Zi, Vëllazëria ungjillore dhe grupet fetare të ngjashme me të, pavarësisht vënies në fuqi të një ligji për lirinë fetare, nuk gëzojnë atë njohje dhe mbrojtje që u njeh legjislacioni shqiptar, sidomos përsa i përket numrit të pjesëmarrësve të këtij kulti. Bëhet njëfarësoj përpjekjeje për ta shtrirë mbrojtjen mbi to nëpërmjet personave me origjinë shqiptare, banues në këto treva, të ashtuquajtura pjesë të “Shqipërisë së madhe”.

krejtësisht i njëjtë si në formë, ashtu dhe në përmbajtje me nenin 15 të marrëveshjes së komuniteteve të tjera fetare.

Kapitulli i katërt i marrëveshjes i kushtohet bashkëpunimit në të mirë të qytetarëve, duke riafirmuar kështu qëllimin dhe funksionin shoqëror që u njeh sistemi të gjitha komuniteteve fetare. Të njëjta janë edhe kriteret për përcaktimin e ditëve festive, ku, për të gjitha komunitetet parashikohet mundësia e festimeve, edhe në ato raste kur nuk njihen dhe nuk zyrtarizohen nga shteti.

Lidhur me angazhimin në fushë të edukimit, marrëveshja e VUSH-it bën dallim nga të tjerat në dy pika. E para ka të bëjë me edukimin e fëmijëve, ku ndryshe nga komunitetet e tjera që zotohen të respektojnë zgjedhjen fetare të prindërve, në marrëveshjen e VUSH-it pohohet se është e nevojshme të garantohet e drejta e individit për t'u edukuar pa farë diskriminimi, përfshirë këtu edhe edukimin fetar në respekt të së drejtës së prindërve, etj. Kjo lloj garancie që kërkohet, ka karakter të përgjithshëm dhe përfshin të gjithë procesin e edukimit në tërësi, si një e drejtë e personit, që duhet mbrojtur jo vetëm në fushën e edukimit fetar, por sidomos duhet shtrirë në të gjitha hallkat dhe aspektet e procesit edukativ. Pika e dytë, ku vihet re ndryshimi, ka të bëjë me lëndën e edukimit seksual në shkollë, çështje për të cilën VUSH-i mban të njëjtin qëndrim me Sunitët dhe Ortodoksët, duke mos qenë në të njëjtën linjë mendimi me Bektashinjtë, siç kemi parë të ndodhë rëndom. Këta të fundit, janë të mendimit se edhe lënda e edukimit seksual duhet të jetë pjesë e programit të shkollave fetare. Nuk kanë ndryshim nga marrëveshjet e tjera, normat e marrëveshjes së VUSH-it, që rregullojnë veprimtaritë shoqërore (neni 17) dhe ato të bamirësisë (neni 18). Sa i përket lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së informimit, kjo marrëveshje dallon nga të tjerat në pikën 3 të nenit 19, ku thuhet se mesazhi i përcjellë nga VUSH-i, nëpërmjet mediave apo masmediave nuk duhet, në asnjë rast, të mbartë ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare apo që diskriminojnë komunitetet fetare dhe nxisin luftën ndërfetare. Së fundi, mund të thuhet se edhe normat në mbrojtje të ndërtesave të kultit dhe të vendeve kushtuar celebrimit të riteve fetare janë formuluar njësoj.

Kapitulli i pestë i marrëveshjes trajton pasuritë e komunitetit dhe, për vetë tiparet delikate të kësaj çështjeje po ndalemi në disa pika

që përbëjnë ndryshim nga marrëveshjet e tjera. Neni 21 garanton të drejtën e pasurisë duke pohuar se shteti i njeh VUSH-it të drejtën mbi të mirat e luajtshme dhe të paluajtshme. Nenet gjegjëse me marrëveshjet e besimeve të tjera fetare, pas këtij pohimi trajtojnë problemin e rikthimit të të mirave fetare të konfiskuara nga shteti, përfshirë sendet e kultit, vendet e shenjta, sendet dhe arkivat e konfiskuara gjatë regjimit komunist. Në këtë mënyrë, marrëveshjet e bashkëpunimit tërheqin vëmendjen e Agjencisë për rikthimin dhe dëmshpërblimin e pasurisë, qoftë edhe duke u mbështetur në dokumentacionin e arkivit të shtetit në raste konfliktesh.

Lidhur me mbrojtjen e pasurisë fetare, neni 22 i marrëveshjes së VUSH-it dhe ai gjegjës i marrëveshjeve të kultet e tjera (nr. 23), kanë jo pak ndryshime mes tyre, për shkak të strukturës dhe paraqitjes së pasurisë së mëparshme fetare. Vëmë re se në marrëveshjen e nënshkruar nga VUSH-i, detyrimi për kthimin e të mirave të konfiskuara nga regjimi komunist, zhvendoset në këtë nen<sup>492</sup>. Në të vërtetë, marrëveshjet e komuniteteve të tjera fetare kanë të tjera garanci, si për shembull angazhimi i shtetit për

---

<sup>492</sup> Neni 22. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore fetare 1. Republika e Shqipërisë njeh trashëgiminë morale dhe pasurore të besimit që përfaqëson VUSH. 2. Shteti do t'i kthejë dhe kompensojë bashkësisë VUSH të gjitha pronat e konfiskuara nga regjimi komunist. 3. Në rastet kur objektet e kultit të bashkësisë VUSH nuk gjenden të regjistruara në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronësinë do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit. 4. Objektet e kultit që kanë statusin e monumentit të kulturës, i kthehen në pronësi dhe përdorim bashkësisë VUSH dhe për çdo ndërhyrje të mundshme që do të bëjë Instituti i Monumenteve të Kulturës, duhet të bashkëpunojë me të. 5. Shteti mund marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interesa madhore dhe vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e bashkësisë VUSH. 6. Këshilli i Ministrave, duke u bazuar edhe në mendimin e bashkësisë fetare ungjillore VUSH bashkërendon përpjekjet në të ardhmen, për të evidentuar, vlerësuar e mbrojtur pasuritë kulturore, si dhe godinat e kultit të bashkësisë VUSH që bartin vlera të kulturës kombëtare materiale e shpirtërore. 7. Shteti lejon ushtrimin e veprimtarisë fetare në një objekt të kultit që është trashëgimi kulturore kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 6. Il Consiglio dei ministri, con il parere della comunità religiosa evangelica VUSH coordinerà gli sforzi futuri per identificare, valutare e proteggere i beni culturali e gli edifici di culto della comunità VUSH secondo il loro valore carico di cultura materiale e spirituale.

shpenzimet që kërkon restaurimi i të mirave të paluajtshme, siç parashikohet në ligjin që mbron identitetin kulturor, një ligj ky i së drejtës së përbashkët <sup>493</sup>.

Ajo çfarë bie në sy këtu, është kujdesi i vazhdueshëm i komunitetit fetar për të mos pranuar asnjë lloj ndihme nga ana e shtetit.

Kapitulli i gjashtë i marrëveshjes së bashkëpunimit, i cili përmban dispozita të përkohshme dhe të përhershme, trajton normat që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (neni 23). Pas normave të përbashkëta për të gjitha marrëveshjet, të cilat kërkojnë zgjidhje pajtuese, normat gjegjëse të VUSH-it, ashtu si ato të komunitetit Bektashian, parashikojnë që Komiteti shtetëror për kultet të luajë rolin e ndërmjetësit në rast mosmarrëveshjesh. Ndërkohë, dispozitat e fundit (neni 24) të marrëveshjes së VUSH-it kërkojnë që Asamblea e vëllazërisë ungjillore, e cila ka pushtet ta shkrijë organizatën, të ushtrojë kontroll mbi nënshkrimin e marrëveshjes, si dhe në ndryshimet që mund t'i bëhen asaj. Siç e kemi vënë re gjatë shqyrtimit të detajuar të normave të marrëveshjes së nënshkruar nga VUSH-i, kjo nuk del nga skema e përdorur edhe për besimet fetare tradicionale shqiptare, madje disa zgjidhje teknike të sprovuara më parë, huazohen pa ndryshimin më të vogël.

Megjithatë, nuk mund të bëhet fjalë për një ligj “të fotokopjuar”, pasi, aty-këtu, ngrenë krye disa tipare domethënëse, që, përgjithësisht, pasqyrojnë qëndrimet e ndryshme të VUSH-it për çështje të veçanta. Tërheq vëmendjen fakti që ky komunitet i referohet rëndom ligjit të zakonshëm, çka shpreh bindjen e tij që jo medoemos çështja e fesë kërkon norma të veçanta për t’u ndier e mbrojtur. Kjo vihet re edhe tek marrëveshja e komunitetit Bektashian, në të cilën, jo rrallë herë, hasen të njëjtat formulime si tek ajo e VUSH-it.

Ajo çfarë e dallon dukshëm marrëveshjen e Vëllazërisë Ungjillore nga marrëveshjet e të gjitha komuniteteve të tjera është fakti që VUSH-i nuk kërkon farë financimi nga shteti për kryerjen e veprimtarive të kultit, gjë që parashikohet me ligj për të gjitha komunitetet fetare. Ky qëndrim përjashton çdo lloj lehtësimi apo

---

<sup>493</sup> *Për trashëgiminë kulturore*, Ligji nr. 9048, 07.04.2003, <http://licodu.cois.it/573/view>

financimi, përveç rasteve kur kjo e drejtë buron nga legjislacioni i përbashkët, duke e vënë komunitetin fetar dhe veprimtarinë e tij në të njëjtat pozita me veprimtarinë e zhvilluar nga subjekte jofetarë, si, për shembull, me organizatat *non profit*<sup>494</sup>.

Ky është një tregues që e bën marrëveshjen e VUSH-it me koherente ndaj parimit të ndarjes, të laicitetit, të pluralizmit dhe të autonomisë së komunitetit fetar, çka përbën edhe tiparet dalluese të sistemit ligjor shqiptar. Teksti i marrëveshjes së VUSH-it, do të na lejonte të pohojmë që ky është ndër komunitetet më të çlirëta në vend, nëse, mes shumë gjërash të tjera, do të merrte në konsideratë edhe edukimin seksual, çka në të vërtetë e gjejmë vetëm tek komuniteti Bektashian, ndaj, në panoramën e komuniteteve fetare shqiptare, ky i fundit rezulton të jetë më afër vlerave shoqërore, kulturore dhe laike të vendeve perëndimore. Arritja në këtë përfundim nuk mund të mos hapë sërish debatin mbi pluralizmin në fushë të islamit, çka e vë gishtin edhe një herë mbi plagën e miopisë tek të gjithë ata që, si në nivel shoqëror, ashtu dhe politik, kërkojnë ta shohin botën islame si një realitet të vetëm, të përshkruar anekënd nga të njëjtat tipare<sup>495</sup>.

Në të vërtetë, shqyrtimi i veprimtarisë dhe i qëndrimeve të komuniteteve të ndryshme fetare në Shqipëri, u ofron një leksion të mirë studiuesve dhe vëzhguesve perëndimorë, të cilët, shpeshherë, të shpërqendruar keqas dhe në padije, përpiqen të interpretojnë përvojat e sistemit ligjor shqiptar.

---

<sup>494</sup> Për hir të së vërtetës, ky qëndrim është në përputhje me orientimin e kishave dhe komuniteteve ungjillore në të gjithë botën, të cilat mbështesin ndarjen e plotë mes shtetit dhe kishës dhe e çmojnë dhe vlersojnë vullnetin e besimtarëve që angazhohen të mbështesin, edhe financiarisht, besimin e tyre, organizatat fetare dhe veprimtarinë e kishës, duke filluar nga ato me karakter shoqëror. Në thelb, sipas ungjillorëve, shteti për nga natyra është laik, ndaj të gjitha veprimatritë fetare duhet të zhvillohen me kontributin vullnetar të anëtarëve dhe simpatizantëve të fesë. Për më tepër, shih: *Chiese e società: compiti e vocazione*, (a cura di H. Milkau e F. Negri) Torino Claudiana, 2007.

<sup>495</sup> G. CIMBALO, *L'esperienza dell'Islam dell'Est Europa come contributo a una regolamentazione condivisa della libertà religiosa in Italia*. in *Identità religiosa e integrazione dei Musulmani in Italia e in Europa - omaggio alla memoria di Francesco Castro*, Roma 22 maggio 2008, (a cura di R. Aluffi Beck-Peccoz), Giappichelli, Torino 2011, 71-104.

#### 4. 3. Drejt marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit: Hebrenjtë, Bahaitë, Dëshmitarët e Jehovahit...

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me një kult të ndryshëm nga ato tradicionale, është dëshmi e interpretimit të gjerë që i bën sistemi juridik dhe bota politike shqiptare, nenit 10 të Kushtetutës. Lista e kulteve që mund të çelin procedurat për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit duket se është e hapur, por s'ka dyshim që për të mbërritur në fazën e negociatave e më pas në nënshkrimin e saj, është e nevojshme, qoftë edhe në rrugë jozyrtare, të përmbushen disa kritere, ku ndër më kryesorët është rrënjosja e këtij kulturi në vend si dhe roli shoqëror që mbart ky komunitet fetar.

Për ta verifikuar në mënyrë sa më objektive përmbushjen e kriterit të parë, s'ka dyshim që një ndër treguesit kryesorë është qëndrueshmëria në kohë, tipar ky i përbashkët për të gjitha besimet fetare tradicionale në vendet e Ballkanit. Kjo do të thotë që një besim i ri fetar rrënjohet në një shoqëri nëpërmjet celebrimit të festimeve, riteve publike; sjelljeve të veçanta gjatë fazave të ndryshme të jetës: lindjes, martesës, vdekjes; qëndrimet e ndryshme ndaj kulturës, vlerave në tërësi, etj. Prania e Vëllazërisë Ungjillore në Shqipëri, këtu e dy shekuj më parë, e vë atë në një pozicion epror përkundrejt kulteve të reja të behura në vend.

Kushti i dytë, që ka të bëjë me rolin shoqëror që ka luajtur historikisht në shoqëri komuniteti fetar, ose disa nga përfaqësuesit e tij, përmbushet më së miri në rastin e Vëllazërisë Ungjillore, e cila ka dhënë kontribut të padiskutueshëm në përcaktimin e identitetit të vendit dhe të gjuhës.

Për njohjen ligjore të një kulturi të ri, është gjithaq e nevojshme të përmbushen edhe disa kushte të tjera, si për shembull, përbërja numerike e grupit fetar; shtrirja e gjerë apo e kufizuar në territorin e shtetit; tiparet e strukturës së saj organizuese që përbëjnë një parakusht për hapjen e negociatave mes shtetit dhe komunitetit fetar. Sidoqoftë, hapja e negociatave është kulmimi i një sërë nismave që lidhen me veprimtarinë e grupit fetar në shoqëri, të cilat shoqërohen me pasoja juridike.

Së pari, kërkesa për të fituar personalitet juridik civil i referohet ligjit për shoqatat *non profit*, çka do të thotë se veprimtaria e palës



së interesuar nuk duhet të ketë aspak karakter ekonomik, pra të mos ketë qëllim fitimprurës. Në këndvështrimin tonë, po të vëmë re historinë e marrëdhënieve mes shtetit dhe besimeve fetare në Shqipëri, si dhe tiparet e sistemit ligjor në këtë vend, nuk mund të mos dallosh pragmatizmin e skajshëm, por pa çenuar koherencën dhe paanshmërinë në marrëdhëniet mes palëve, gjë që ka siguruar ruajtjen e paqes fetare në vend. Pra, i vetmi kriter bindës, pas ngritjes së bazës ligjore përkatëse, është përvijimi i zhvillimit të shtetit shoqëror, marrja parasysh e orientimeve të ndryshme të banorëve në një territor të caktuar dhe vlerësimi i nevojave të tyre, nëse janë konsoliduar apo jo deri në atë shkallë sa të shihet e arsyeshme të ngrihen në sistem. I rikthehemi, pra, sërish, “faktorit kohë” dhe pranisë historike të çdo komuniteti fetar.

Fleksibiliteti gjatë zhvillimit të negociatave përbën një rrethanë tjetër lehtësuese, ndaj marrëdhëniet dypalëshe nuk do të hasin vështirësi dhe do të çelen natyrshëm edhe falë pjekjes së kushteve në shoqëri për të mirëpritur një grup të ri fetar. Nisur nga kjo analizë, është me interes të veçantë të marrim në shqyrtim hapat e komunitetit Hebre në Shqipëri, jo vetëm për origjinalitetin e ngjarjeve, por edhe për faktin se, sot për sot, ai mund të konsiderohet i paqenë, nëse bazohemi tek shifrat<sup>496</sup>.

Zanafilla e dokumentuar e pranisë së hebrenjve në territorin shqiptar i përket shekullit XII pas Krishtit, kur mund të flitet për ngulime të tyre në pjesën më të madhe të qyteteve shqiptare. Numri i tyre u shtua nga familje me origjinë sefardite, me prejardhje spanjolle dhe portugeze, të cilat u dëbuan nga Gadishulli Iberik që në vitin 1492. Historianët që studiojnë hebraizmin, bien dakord me idenë se nuk mund të bëhet fjalë për një komunitet Hebre në Shqipëri, gjatë kohës kur kjo ishte nën sundimin osman<sup>497</sup>, edhe pse, aso kohe, kishte një numër relativisht të qëndrueshëm të tyre në Vlorë që merreshin me

---

<sup>496</sup> Ka të ngjarë që ngulimet e para hebraike në vend, t'i përkasin shekullit V ose VI pas Krishtit. Kohët e fundit është zbuluar një sinagogë jo e parëndësishme në Sarandë, e cila mund të ketë shërbyer për një kohë të gjatë, por fjala e fundit u mbetet gërmimeve, të cilët vazhdojnë ende në terren.

<sup>497</sup> B. LEWIS, *Gli ebrei nel mondo islamico*, Firenze, Sansoni, 1991, 125 ss.; E. BENBASSA, A. RODRIGUEZ; *Les Juifs des Balkans, Espace Judeo-iberiques XIV-XX siècles* Paris, La Découverte 1993, 71 ss.

tregti, falë punës që ofronte porti i këtij qyteti<sup>498</sup>. Megjithatë, siç dëshmon L. Brazzo, historia e hebrenjve në Shqipëri, dallon nga ajo e vendeve të tjera në Perandorinë Osmane, së paku, për tri arsye: për shkak të ndërprerjes së vazhdueshme të qëndrimit të tyre në këtë vend; për origjinën romake të atyre që u vendosën këtu mes gjysmës së dytë të viteve tetëqind dhe fillimit të viteve nëntëqind; së fundi, ka gjasa që, të paktën gjatë viteve të pavarësisë shqiptare, hebrenjtë nuk ndërtuan një komunitet, por vetëm disa 'koloni' të vogla, për çka dëshmon edhe fakti që ata nuk u njohën si pakicë fetare<sup>499</sup>. Nga regjistrimi i bërë në vitin 1920, numri i bashkësive hebreje në vend luhetet nga 90 deri në 120, ndërsa me regjistrimin e vitit 1930, rezulton se numri i tyre ka kapur shifrën 204, por më vonë, ky numër është gjithnjë në rënie<sup>500</sup>.

Për shkak të marrëdhënieve të mira që mbante mbreti Zog me komunitetin Hebre ndërkombëtar, prania e tyre në Shqipëri njihet zyrtarisht në prill të vitit 1937, ashtu siç e parashikonte ligji i miratuar me 1929 për komunitetet fetare<sup>501</sup>. Puna shkon deri aty sa të parashikohet ngulimi i hebrenjve në Shqipëri dhe jo në Palestinë<sup>502</sup>, madje, pas vitit 1938, me përshkallëzimin e persekutimit kundër hebrenjve në Gjermani dhe mbarë Europën, Shqipëria bëhet pikë kyçe për strehimin e të gjithë atyre që kërkojnë shpëtim nga persekutimi që u bëhet në vendet e

---

<sup>498</sup> A. PUTO, *La Communauté juive en Albanie avant e durant la Seconde guerre mondiale, The Jervis Communities of Southern Europe*, Thessalonica, I. K. Hassiotis ed, 1997; *Gli ebrei in Albania. Catalogo dei documenti dell'Archivio Centrale dello Stato della Repubblica d'Albania*, (a cura di N. Nika L. Vorpsi), Bari, Progesit, 2006.

<sup>499</sup> L. BRAZZO, *Dall'Impero agli Stati. Gli ebrei nei Balcani e in Albania fra la seconda metà dell'Ottocento e la vigilia della Seconda guerra mondiale. Gli ebrei in Albania sotto il fascismo. Una storia da ricostruire*, (a cura di L. Brazzo e M. Sarfatti), Firenze, Giuntina, 2010, 36 – 37.

<sup>500</sup> M. SARFATTI, *La condizione degli ebrei in Albania fra il 1938 e il 1943. Il quadro generale. Gli ebrei in Albania sotto il fascismo...cit.* 127.

<sup>501</sup> Shih: B. J. FISCHER, *Albania at War 1939-1945*, Indiana, Purdue University Press: Ëest Lafayette, 1999. Pavarësisht përprjekjeve e kemi pasur të pamundur të biem në gjurmë të këtij projektligji.

<sup>502</sup> Kjo veçori tipike e shqiptarëve për të mos u kushtëzuar nga përkatësia fetare, por dhe kushtet e vështira ekonomike në vend, të bëjnë të mendosh se emigracionit të drejtuar, fillimisht, për në Palestinë, iu ndryshua kursi për në Shqipëri. L. BRAZZO, *Dall'Impero agli Stati cit.*, 42 ss

originës<sup>503</sup>. Bashkimi i Shqipërisë me Italinë nuk ndikoi në ndryshimin e gjendjes së mëparshme: legjislacioni racist italian, edhe pse u ofrua në variantin shqip, nuk u zbatua kurrë në Shqipëri, sidomos falë formimit kulturor të popullsisë vendase që tregonte zemërgjerësi kundrejt gjithkujt në nevojë.

Respektimi i besës (fjalës së dhënë) dilte si detyrim për qeverinë shqiptare, e aq më tepër për autoritetet italiane në këtë vend të huaj, ndaj u shpëtuan rreth 2.200 hebrenj gjatë luftës<sup>504</sup> dhe i krijuan kushtet për t'i shpëtuar arrestimit në trevat ballkanike<sup>505</sup>. Refugjatët hebrenj u mbrojtën edhe nga forcat e rezistencës shqiptare dhe, pas pushtimit të Italisë Jugore nga aleatët, u transferuan në Pulja, nën mbrojtjen amerikane<sup>506</sup>. Pas mbarimit të luftës, thuajse të gjithë hebrenjtë shqiptarë, e panë të arsyeshme të emigronin në Izrael, kështu që kjo koloni e vogël erdhi e u zhduk.

Sot, në Shqipëri, kryesisht në Tiranë, jetojnë rreth 160-200 hebrenj. Sinagogës së vjetër të Vlorës, me pak vizitorë, iu shtua në dhjetor të 2010-ës një tjetër, në Tiranë, që mori emrin e Rabinit të madh të Izraelit Hechal Shlomo. Në Tiranë është ndërtuar, gjithashtu, qendra kulturore e komunitetit Hebre *Moshe Rabenu*<sup>507</sup>.

---

<sup>503</sup> M. SARFATTI, *La condizione degli ebrei in Albania...cit.*, 125 ss.

<sup>504</sup> G. VILLARI, *Il sistema di occupazione fascista in Albania. Gli ebrei in Albania sotto il fascismo...cit.* 93 ss.

<sup>505</sup> C. S. CAPOGRECO, *I profughi ebrei rastrellati in Montenegro nel luglio del 1941 e il loro internamento in Albania e in Italia, Gli ebrei in Albania sotto il fascismo...cit.*153 ss.

<sup>506</sup> Cfr.:*La Puglia dell'accoglienza: profughi, rifugiati e rimpatriati nel Novecento.* (cura di V. A. Leuzzi e G. Esposito) Bari, Progedit, 2006.

<sup>507</sup> REC-i emëroi si Kryerabin për Shqipërinë, Joel Kaplan-in, i cili, me ç'lë të kuptohet deklarata e tij për shtyp, kishte si qëllim parësor të hapte një restorant për t'u ofruar ushqim, jo vetëm anëtarëve të pakët të komunitetit, por edhe turistëve dhe sipërmarrësve hebrenj që mund të ndodheshin përkohësisht në Shqipëri. Ky emërim ngjalli protesta tek rreth tre të katërtat e hebrenjve shqiptarë, që, në cilësinë e anëtarëve të këtij komuniteti, kërkujnë me forcë t'u jepet e drejta për të marrë pjesë në zgjedhjen e Rabinit. Rreth polemikave lidhur me këtë çështje, shih:

M. RIMLER, *Albania Jewish Community Installs Chief Rabbi "Chabad Lubavitch"*, 14 /12 /2010 <http://lubavitch.com/news/article/2030153/Albania-Jewish-Community-Installs-Chief-Rabbi.html> ; G. SHEFLER, *Albanian Jews reject appointment of new chief rabbi*, "The Jerusalem Post", 1/06/2011, <http://www.jpost.com/JewishWorld/JewishNews/Article.aspx?id=202415>

Masat e marra deri më sot, janë të pamjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, po të mbajmë parasysh se sa e hershme është prania e hebrenjve në vend; sa është numri i anëtarëve të tyre dhe a përputhet ai me mundësinë juridike për ngritjen e një komuniteti, paçka se legjislacioni në fuqi nuk përcakton një numër dysHEME anëtarësh, por, megjithatë, duket pa vend hartimi i një statuti që s'ka ç'të rregullojë.

Për t'u siguruar mbrojtje, qoftë edhe kolektive, anëtarëve të besimit hebre në Shqipëri, mjafton të zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji për organizatat *non profit*, pa qenë nevoja për hartimin e normave të veçanta apo të marrëveshjeve me shtetin, nënshkrimi i të cilave varet nga qëndrimi i qeverisë, por sidomos nga ujdia paraprake dhe e padiskutueshme mes hebrenjve të Shqipërisë. Por, sot për sot, duket se ata nuk bashkëndajnë të njëjtin mendim lidhur me administrimin e komunitetit dhe me zgjedhjet që u diktohen nga organizma fetarë jashtë vendit, siç dëshmojnë edhe polemikat që shkaktoi së fundi emërimi i rabinit<sup>508</sup>. Sidoqoftë, ende nuk ka gjurmë të ndonjë ligji, që na dëshmon për mundësinë e shpejtë të nënshkrimit të marrëveshjes mes shtetit dhe këtij komuniteti fetar, çka do ta bënte atë besimin e gjashtë fetar në vend. Numri i anëtarëve të komunitetit nuk e kushtëzon paraqitjen e kërkesës për njohjen zyrtare të grupeve fetare, por, sidoqoftë, është e nevojshme të sigurohet organizimi dhe administrimi i kultit nëpërmjet organizmave drejtuese të ngritura prej tyre.

Nëse problemet që shtron prania hebreje në vend, janë të kapërcyeshme, pavarësisht numrit të pakët të tyre, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për kultet e tjera, të cilët, sadoqë janë shfaqur relativisht vonë në vend, kanë njëfarë shtrirjeje të konsiderueshme, po të kihet parasysh numri i popullsisë shqiptare. Një ndër kriteret kryesore për t'u bërë pjesë e marrëveshjes së

---

<sup>508</sup> Këto struktura lindin me nismën e Qendrës rabine të Europës (CRE) e cila promovon zhvillimin e komuniteteve të vogla hebraike, por nuk është institucion shqiptar. Përveç njohjes së komunitetit CRE-ja synon të sigurojë donacione financiare, t'i jepet terren për institucionet komunitare dhe të hapë diskutimet për rikthimin e atyre pak pasurive të shpronësuara. Të gjitha këto synime gjejnë hapësirë në interpretimin e kuadrit ligjor aktual.

bashkëpunimit, është padyshim roli shoqëror që ka luajtur komuniteti fetar në vend dhe kjo nuk vlerësohet vetëm me kohëzgjatjen në këtë territor, por edhe me aftësinë për t'u organizuar, me nismat e ndërmarra si nga anëtarët e tij, ashtu edhe nga strukturat e tij vendore, çka shtojnë peshë në hapat që ndërmerren për njohjen e personalitetit juridik civil, gjithnjë në mbështetje të ligjit për organizatat *non profit*, siç është vepruar me të gjitha grupet fetare, aq më tepër, kur prania e këtij grupi rezulton të jetë e kahershme. Duhet mbajtur parasysh se aty nga vitet '20 të shekullit që lamë pas, Shqipëria, falë ndryshimit të kuadrit kushtetues, u hap ndaj lirisë dhe pluralizmit fetar, çka bëri që gjatë asaj kohe të vërshonin drejt këtij vendi, edhe dy besime të tjera fetare, që sot duket se i kanë bërë rrugë vetes: Bahaitë dhe Dëshmitarët e Jehovahit.

Një ndër anëtarët e para të kultit Bahai në Shqipëri, ishte Martha Luise Root, mësuese dhe gazetare, e cila mbërriti këtu në shtator të vitit 1929, pas një përvoje të mirë mikpritjeje në oborret aristokrate të shumë vendeve të tjera. Pas mbërritjes me traget në Durrës, ajo u nis për në Tiranë për të takuar mbretin Zog, e veçanërisht nënën dhe pesë motrat e tij, e vetëdijshme për ndikimin e madh që kishin ato si mbi Mbretin ashtu dhe oborrin e tij, por edhe për rolin shoqëror të tyre në hapjen e vendit ndaj risive të vendeve më të zhvilluara. Kjo ishte vetëm qasja e parë, pasi përhapja sistematike e mesazhit Bahai, zuri fill në vitin 1931, me rikthimin në Shqipëri të Refo Çaparit, i konvertuar në këtë besim të ri, në vitin 1928, gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara<sup>509</sup>. Që nga ky moment, ai fillon të botojë në masë literaturë fetare, kryesisht tekstet themelore të kultit Bahai, që ia shpërndan bujarisht publikut shqiptar<sup>510</sup>. Me kalimin e kohës, mjaft

---

<sup>509</sup> Në një letër të datës 8 qershor 1931, ai informon Shoghi Effendi-në (Rojtar i fesë që nga viti 1921) për mbërritjen në Tiranë me datë 28 prill 1931, duke i bërë me dije se në shqip nuk ka literaturë Baha'i. Duke gjetur mbështetje edhe në detyrën e tij pranë Ministrisë së arsimit publik, ai merrte përsipër të përkthente libra Baha'i, për të cilët, sipas tij, do të shfaqnin interes një pjesë e myslimanëve e sidomos, bektashinjte për shkak të lidhjeve me traditat mistike të dy besimeve. R. Elsie, *A dictionary of Albanian religion, mythology and folk culture*, New York University Press, 2001

<sup>510</sup> J. E. ESSLEMONT, *Bahá' u' lláh and the New Era*, Wilmette, Illinois, USA, Bahá'í Publishing Trust, 1980, botimi i pestë.

intelektualë bëhen anëtarë të këtij kulti, çka e shton peshën e tij në nivel kombëtar e për rrjedhojë edhe në shtrirjen e këtij besimi në vend. Pushtimi italian dhe ngjarjet që rrodhën më pas, i tkurrën kufijtë veprues të të gjitha besimeve, prandaj në vitin 1944, Refo Çapari transferohet në Korçë dhe me 7 shtator të po këtij viti, ndërrohet jetë. Në këto rrethana, Asambleja Shpirtërore Kombëtare e Gjermanisë, u ofrua të çonte më tej punën e nisur nga Çapari me besimin Bahai në Shqipëri, angazhim që zgjati deri në vitin 1989, për t'i kaluar më pas Asamblesë Shpirtërore Italiane, e cila ndërmoi udhëtimet e para në Shqipëri për t'u njohur me gjendjen ekzistuese dhe për të ruajtur lidhjet e mëparshme<sup>511</sup>. Kjo bëri të mundur që në prill të vitit 1991 të nisej për në Shqipëri, grupi i parë i “mësuesve shtegtues”<sup>512</sup> dhe me 16 qershor të po këtij viti, të mbahej Asambleja e parë Shpirtërore lokale e Tiranës, në të cilën morën pjesë 40 “miq bahai”. Në datat 17-24 korrik 1991, u mbajtën Asambltetë Shpirtërore lokale të Durrësit, Fierit dhe Vlorës, ndërsa në gusht ajo e Elbasanit. Secila prej tyre, përzgjedhi organet drejtuese përkatëse.

Konferenca e parë kombëtare u mbajt në Durrës në datat 3-6 tetor 1991, në prani të 40 miqve italianë dhe rreth 250 besimtarëve shqiptarë. Me 1 dhjetor 1991, numri i përgjithshëm i besimtarëve Bahai, ishte rreth 800 veta, dhe brenda kësaj date numërohen 6 Asamble Shpirtërore lokale. Duke u mbështetur në ligjin nr. 2362, datë 16.11.1956 “*Mbi organizatat shoqërore që nuk kanë qëllim fitimi*” e në veçanti në nenin 13 të saj, secila nga asambltetë e ndryshme shpirtërore lokale u regjistrua pranë gjykatës së rrethit përkatës më 16 maj 1992, ndërsa Ministria e Rinisë, Kulturës,

---

<sup>511</sup> Regjistroheshin si anëtarë: Skënder Aliacka, Dritan Mezini, Anila Ismaili, e Naum e Gazjeta Çaushti, intelektualë shqiptarë.

<sup>512</sup> Meqë besimtarët Bahá'í besojnë që Abrahami, Krishna, Zoroastri, Moisiu, Buda, Jezusi dhe Muhameti ishin lajmëtarë të një Hyji të vetëm, apo mësues të shenjtë, dërgimi i të cilëve në tokë, është pjesë e një plani të vetëm dhe historik “Planit të Hyjit”, për t'i bërë të njohur njerëzimit krijuesin e tij dhe për të kultivuar aftësitë morale, intelektuale dhe shpirtërore të rracës njerëzore, qëllimi kryesor është ai i përgatitjes së rrugës për ardhjen e një civilizimi global, unik dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Njohja e vullnetit të Hyjit për njerëzimin e epokës moderne, u zbulua pak më shumë se njëqind vjet më parë nga Bahá'u'lláh, i cili është lajmësi i fundit hyjnor. “Mësimet hyjnore” vazhdojnë misionin e predikimit të fesë. Natyra sinkretike e kësaj feje, i lejon asaj të gjurmojë idhtarë ndër besime të tjera.

Turizmit dhe Sportit i dha miratimin komunitetit Bahai të Shqipërisë, duke u bazuar në ushtrimin e kultit.

Pas kësaj, u ngritën një sërë brigadash shtegtare mësimdhënëse me mësues të ardhur nga vende të ndryshme, të cilët ia behin edhe në fshatrat më të thella, duke mbërritur atje, shpesh, në këmbë për t'u shpallur fenë si njerëzve të kulturës, ashtu edhe popullit të thjeshtë. Në fund të vitit 1993, numri i regjistruar i anëtarëve, kapi shifrën 9.700<sup>513</sup>. Sot, komuniteti Bahai ka 11 qarqe dhe të paktën 12 Asamble Shpirtërore lokale dhe, falë këtyre rezultateve, mund të hartojë statutin e vet, ndaj i ka paraqitur kërkesën Komitetit Shtetëror për Kultet të fillojë negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, mbështetur në nenin 10 të Kushtetutës, por edhe në faktin se ky komunitet është tashmë i hershëm në shoqërinë shqiptare. Nuk kemi të bëjmë me një besim të ri fetar, por jemi brenda kulturës historike të vendit. Rasti në fjalë duket se i plotëson kriteret dhe se nuk ka pengesa për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.

Përafërsisht në të njëjtën kohë me besimin Bahai, mbërritën edhe Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri. Në vitin 1920, kongregata vendosi të dërgojë misionarë në mbarë vendet e Europës, duke u mbështetur kryesisht tek emigrantët që e kishin përqafuar këtë besim gjatë qëndrimit të tyre në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Protagonistët e *Watchtower Society* qenë mjaft aktivë në kohën e mbretit Zog, por iu desh të përballeshin me kundërvënien e rreptë të qeverisë gjatë kohës së bashkimit të Shqipërisë me Italinë, e sidomos, gjatë pushtimit gjerman. Në vitin 1942, pas vdekjes së Joseph Franklin Rutherford-it dhe zgjedhjes së Nathan Knorrit në krye të kongregatës, *Watchtower Society* u përhap me ritme të shpejta, edhe falë hapjes së shkollës Galaad, funksioni i së cilës ishte përgatitja e misionarëve për t'i shpërndarë ata në mbarë botën. Kongregata përfitoi nga politika e Departamentit të Shtetit të ShBA-ve, e cila ishte favorite për rritjen e lirisë fetare në botë, pra për përhapjen e të gjitha besimeve fetare, çka do t'i mundësonte ndërhyrjen në vendet europiane, sigurisht edhe në Shqipëri, por, këtu, politika antifetare e partisë komuniste në pushtet ishte pengesë serioze për depërtimin e kësaj organizate në vend. Kjo gjendje vështirësohet edhe më shumë pas persekutimit

---

<sup>513</sup> I. D. HOXHA, *Refo Çapari: Çaparenjtë*, Tirana Toena, 2006, 361-382.

dhe shkrirjes së plotë të komuniteteve dhe shërbimeve fetare, në vitin 1967.

Që nga ajo kohë, edhe propaganda e dëshmitarëve të Jehovahit u zhvillua në fshehtësi të plotë, e ndihmuar edhe nga veçoritë e këtij kulti që e zhvillon veprimtarinë e vet të apostullimit dhe proselitizmit nëpërmjet kontakteve individuale “derë më derë” për përhapjen e mesazhit të vet fetar. Duke vepruar me shumë kujdes, ata ia dolën ta çojnë përpara punën e proselitizmit. Pas krizës që pësuan regjimet e Europës Lindore, *Bureau for Democracy, Human Rights and Labor* (Bdhr), agjencia e Departamentit të Shtetit, shtoi mbështetjen e saj për ‘lëvizjet e reja fetare’ të cilët iu përveshën me vrull propagandës dhe proselitizmit në vendet ish komuniste<sup>514</sup>.

Që në vitin 1990 kongregata iu rikthye veprimtarisë së vet në Shqipëri, falë misionarëve të ardhur sidomos nga Italia dhe, në vitin 1992, dëshmitarët e Jehovahit duke u mbështetur në ligjin nr. 2362, paraqitën kërkesën për regjistrimin e organizatave të tyre pranë gjykatave të rretheve përkatëse. Në këtë kohë tranzicioni dhe të pështjelluar, edhe dëshmitarët e Jehovahit ia dolën të fitonin miratimin e Ministrisë së Rinisë, Kulturës, Turizmit dhe Sportit.

Pas miratimit të ligjit për shoqatat *non profit*, organizata u regjistrua pranë gjykatës së Tiranës si shoqatë *non profit*. Ndryshimet në statut, të diktuar nga zgjerimi i organizatës, u paraqitën herë pas here dhe u pasqyruan në regjistrin e personave juridikë *non profit* pranë gjykatës së shkallës së parë në Tiranë. Sot, anëtarët e *Watchtower Society* në Shqipëri janë më shumë se 3.200. Dyert e tyre janë të hapura për të gjithë ata që janë pagëzuar si dëshmitarë të Jehovahit dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë. Ca kohë më parë, ky besim fetar u vu përballë akuzave të shtypit, ku gjykohej se dëshmitarët e Jehovahit po u bënin proselitizëm të miturve, duke u shkaktuar atyre probleme të natyrës ekzistenciale,

---

<sup>514</sup> Në vitin 1998, struktura u fuqizua me ndërtimin e një departamenti të ri pranë Bdhr-së: *Bureau for Democracy, Human Rights and*. Ligji që dekretoi lindjen e këtij departamenti vendosi që ky të drejtohej nga një ambasador fuqiplotë, i cili ngarkohej me pesë funksione (*officers*) të sekretarisë së shtetit. Departamenti mund të kishte nga një agjent të vetin në të gjitha ambasadat amerikane. Si kryetar i parë i tij u emërua Robert A. Seiple. Nën kujdesin e *Office* vazhdon të hartohet ende sot një raport vjetor mbi lirinë fetare për secilin vend. Shih:

<http://ëëë.state.gov/j/drl/rls/fs/2011/170635.htm>



deri aty sa në disa raste i kanë shtyrë drejt vetëvrasjes<sup>515</sup>. Kjo vuri në lëvizje Ministrinë e Arsimit, e cila ndaloi çdo kontakt të përfaqësuesve të këtij besimi me nxënësit brenda mjediseve shkollore.

Përplasja e radhës ishte kundërvënia e këtij besimi fetar ndaj detyrimit të shërbimit ushtarak për anëtarët e vet, problem që u shua me shfuqizimin e këtij detyrimi si pasojë e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ndërkohë që mbeten hapur të gjitha problematikat lidhur me transfuzionin e gjakut. Tani për tani nuk ka të dhëna që kjo kongregatë të jetë në pritje të nënshkrimit të marrëveshjes me shtetin. Përbërja numerike e këtij grupi fetar dhe kohëzgjatja e tij në vend, ia bëjnë të vështirë Komitetit shtetëror për kultet, qëndrimin kundër për hapjen e negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes, përjashtojë këtu ngërçin me çështje të tilla si refuzimi i mjekimit në disa raste terapeutike që kanë të bëjnë me transfuzionin e gjakut etj..

Gëlimi i grupeve të tjera fetare në vend, nuk e përjashton faktin që në të ardhmen të paraqiten kërkesa të tjera për nënshkrimin e marrëveshjeve bashkëpunuese, por është e sigurt që mundësia e grupeve fetare për të fituar personalitetin juridik civil dhe mbrojtjen e ofruar nga ligji për organizatat *non profit*, e mbron sistemin shqiptar nga çdo lloj cënimi të lirisë fetare dhe dëshmon se sa të padobishme janë kufijtë e vendosur nga sistemi i garancive kushtetuese të hartuara në të shkuarën nga Komisioni i Venecias dhe nga Këshilli i Europës në mbrojtje të lirisë fetare vetjake dhe kolektive.

---

<sup>515</sup> A. KADILLARI, *I Testimoni di Geova alla conquista dell'Albania*, "Panorama", 18 shkurt 2005 (Përkthimi në italisht nga Mandi Gueguen e Carlo Dall'Asta) në "Osservatorio dei Balcani", 5 mars 2005

#### 4. 4. Magjia e Perëndimit: një ligj shqiptar për lirinë e besimit

Siç u përmend më lart, në janar të vitit 1992, drejtuesit e Vëllazërisë Ungjillore shfaqën shqetësimin e tyre lidhur me përmbajtjen e projektligjit “Për komunitetet dhe besimet fetare” që po diskutohej aso kohe<sup>516</sup>.

Miratimi i këtij ligji dukej një strehë e mirë për shtyrjen e vendimeve të domosdoshme në kuadrin e ri kushtetues. Në tetor të vitit 1992, u paraqit para Këshillit të Ministrave një projektligj “Për komunitetet fetare”<sup>517</sup>. Pas një diskutimi të gjatë, ky propozim, fillimisht u modifikua dhe u reduktua në vetëm shtatë nene nga gjithë ajo përmbajtje e hallakatur dhe, më vonë, u hoq dorë fare prej tij<sup>518</sup>.

Që prej asaj kohe, sistemi shqiptar, pavarësisht këmbënguljes kryeneçe të Këshillit të Europës, mori një kthesë tjetër. Rekomandimet e Komisionit të Venecias, siç e kemi thënë, synonin përfshirjen e këtij ligji gjatë hartimit të Kushtetutës së re dhe për këtë u vendos të hartohej një ligj i zakonshëm që do të garantonte lirinë fetare në nivel kushtetues. Pas shpalljes së Kushtetutës së

---

<sup>516</sup> VUSH-i shtronte shqetësimin se dokumentacioni i paraqitur në ministrinë përkatëse për të fituar njohjen juridike të kësaj organizate, kishte humbur dhe ishin detyruar ta paraqisnin sërish, por pas shqyrtimit të bërë, ishte hedhur poshtë me pretendimin se Ministria e kulturës nuk kishte asnjë të drejtë firme për çështjet fetare. Por, në të vërtetë, kërkesa e shtruar nga “Bahá’í” dhe nga “Dëshmitarët e Jehovahit” ishte pranuar nga kjo ministri. Përballë këtij qëndrimi, përfaqësuesit e VUSH-it kërkuan t’u jepej shpjegim dhe përgjigjia që morën ishte “...të prisnin derisa të miratohej ligji për komunitetet fetare”, në mënyrë që kërkesa e tyre të merrej në shqyrtim. *Letër e hapur...cit*

<sup>517</sup> Ky projektligj nuk u dërgua asnjëherë për miratim në parlament për shkak të mangësive që viheshin re në disa dispozita të tij, pasi binin ndesh me të drejtat njerëzore. Për këtë arsye, u hartua një tjetër projektligj me ndihmën e këshilltarëve të huaj, i cili përmbante 28 nene. Ky u paraqit në parlament dhe u miratua me 4-5 janar 1993, pasi iu bë ndonjë ndryshim i vogël nga disa komisione parlamentare.

<sup>518</sup> Në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur mbizotëronte pasiguria më e madhe lidhur me orientimet e shtetit shqiptar për rregullimin e çështjeve fetare, përfaqësuesit e VUSH-it mbështesnin me forcë nevojën e përkrahjes dhe të miratimit nga ana e shtetit. Por, aso kohe, miratimi i Kushtetutës dhe i nenit 10 të saj që merrej me marrëveshjet e bashkëpunimit, ishte ende i largët: VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË, *Letër e hapur...cit*.

vitit 1998 dhe hyrjes së saj në fuqi në vitin 1999, ligji “Për marrëdhëniet me komunitetet fetare” u vlerësua si i plotë, pasi i kishte të gjitha mjetet e nevojshme për të vënë në zbatim gjithë ç’parashikohej në Kushtetutë: një legjislacion i negociuar me komunitetet fetare, i cili do të gjente zbatim nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta.

Pavarësisht këtij vendimi, vendet perëndimore këmbëngulnin që sistemi shqiptar të uniformohej me sistemet e vendeve të tjera të Lindjes, që kishin kaluar përvojën e demokracive socialiste. Këshilli i Europës, nëpërmjet Komisionit të Venecias, kërkonte në mënyrë të vazhdueshme të hartohej një projektligj mbi lirinë fetare dhe marrëdhëniet e ndërsjella me shtetin<sup>519</sup>, i cili e pa dritën vetëm në muajin shtator 2009, kur iu dërgua për një shqyrtim paraprak komuniteteve fetare nga Komiteti shtetëror për kultet<sup>520</sup>. Komiteti është i shtyrë ta marrë një nismë të tillë, si përgjigje ndaj parashikimeve kushtetuese për vendosjen e marrëdhënieve me komunitetet e mëdha fetare, si dhe i ndikuar nga vendimi i Kosovës dhe Maqedonisë për hartimin e ligjeve, brenda viteve 2006-2008, në mbrojtje të lirisë fetare, duke iu dorëzuar kështu shtytjes së fortë të Komisionit të Venecias<sup>521</sup>.

Meqë edhe ky projektligj nuk u prezantua hapur, por u ndoq rruga e marrëveshjeve bashkëpunuese, një prej të cilave u nënshkrua me VUSH-in, e shohim të arsyeshme të analizojmë faktet për të kuptuar nëse përmbajtja e saj përputhet me arritjet e derikëtushme dhe në ishte e nevojshme kjo për sistemin juridik shqiptar, apo kemi të bëjmë me një eksperiment të radhës të

---

<sup>519</sup> Në vitin 2005, pas marrëveshjes së nënshkruar me kishën katolike, kryetari i përkohshëm i Komisionit shtetëror për marrëdhëniet me komunitetet fetare, deklaronte në një intervistë se ishte i nevojshëm dhe i pashmangshëm miratimi i një ligji për lirinë fetare. Shih: Kryetari i komisionit shtetëror për kultet: “*Gati ligji për besimet fetare*”, “*Panorama*”, 10 shkurt 2005.

<sup>520</sup> Projekti, *Draft Law on Freedom of Religion and Mutual Relations with the State*, i përket vitit 2008. Që nga ajo kohë, ka gjasa të mos jetë marrë më në diskutim. Teksti i plotë mund të konsultohet *on line*: <http://legislationline.org/documents/id/16297>

<sup>521</sup> Për Kosovën shih: *On Freedom of religion in Kosovo*, Law nr. 02/L-31, 13 July 2006 <http://licodu.cois.it/6/view> ; për Maqedoninë, shih: *Ligj për gjendjen juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit fetar*. Datë, 20.10. 2007, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 113, <http://licodu.cois.it/434/view>

legjislacionit apo një shembull tjetër kolonizimi juridiko-politik, çka Këshilli i Europës e ka fort për zemër.

Në nenin 1 të projektligjit, thuhet se ky ligj u drejtohet katër komuniteteve tradicionale fetare në vend, por, siç do të shohim, ai shtyhet të rrokë të gjitha problematikat lidhur me ushtrimin e besimit fetar. Është e qartë se këtij ligji, tashmë, i ka kaluar koha jo vetëm për shkak të firmosjes së marrëveshjeve bashkëpunuese (për më tepër, tani nuk bëhet fjalë më për katër, por për pesë komunitete fetare), por edhe për faktin se koncepti i besimeve tradicionale në vend është rishqyrtuar, pasi ndër to radhitet edhe VUSH-i, i pranishëm në Shqipëri që në vitet e para të tetëqindës. Kjo na shtyn të shtrojmë pyetjen se ç'parametra duhen marrë parasysh për t'i hapur rrugë marrëveshjeve bashkëpunuese me një komunitetet fetar? Ku ndryshon përmbajtja e normave të marrëveshjes së nënshkruar nga ç'parashikon projektligji? Dhe së fundi, në ç'raport janë normat e dakordësisë që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me normat ligjore? Pyetje të tilla nuk gjejnë përgjigje, e megjithatë të tërheq vëmendjen përkufizimi për termat *komunitet fetar*, *grup* dhe *grumbullim* me karakter fetar për të cilin në nenin 2 të ligjit thuhet se *një komunitet fetar përbëhet nga tërësia e besimtarëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre fetare sipas një rregulli fetar, në respekt të normave, parimeve dhe kanoneve të komunitetit dhe që marrin pjesë në jetën dhe misionin e tij. Një komunitet dallohet për karakterin e tij historik dhe territorial. Komuniteti fetar ka të drejtë t'i kërkojë Institutit të shtetit për çështjet fetare, të nënshkruajë marrëveshjet, që miratohen nga Këshilli i Ministrave. Komunitetet regjistrohen në regjistrin e komuniteteve apo grupeve fetare.*

*Një grup fetar është bashkësia e individëve fetarë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre fetare sipas një rregulli fetar dhe që marrin pjesë në jetën dhe misionin e këtij grupi. Një grup fetar ka të drejtë të regjistrohet në Regjistrin për komunitetet apo grupet fetare.*

*Grupimet fetare janë forma bashkëpunimi apo organizimi mes komuniteteve apo grupeve fetare, ruajnë personalitetin e tyre juridik të fituar më parë. Grupimet regjistrohen si të tillë në regjistrin e komunitetit fetar. Një organizatë fetare, sipas ligjit në*

*fuqi, është një term i përgjithshëm që u referohet komuniteteve fetare, grupeve fetare dhe fondacioneve fetare*<sup>522</sup>.

E pamë të udhës t'i sillnim të plota këto përkufizime, sepse, sado që të stërholluara e herë-herë të mjegullta, sidoqoftë të lënë të kuptosh se komunitetet, grupet apo organizatat fetare gëzojnë të drejta të barabarta për nënshkrimin e marrëveshjeve, gjë që e bën të tepërt ligjin për rregullimin e marrëdhënieve negociuese, që vazhdon të jetë në fuqi.

Pavarësisht kësaj, ligji sjell dy risi të rëndësishme: 'Regjistrin e komuniteteve fetare' dhe 'Institutin shtetëror për çështjet fetare', falë të cilave, siç do të shohim në vijim, legjislacioni shqiptar do të pësojë një ndryshim thelbësor lidhur me çështjen e marrëdhënieve me komunitetet fetare dhe ushtrimin e besimit, duke u paraprirë kështu, ngërçeve rreth kushtetueshmërisë. Po ashtu, neni 2 shpalos një vizion të gjerë dhe pjekuri në trajtimin e çështjes së fesë. Një përpunim i tillë konceptual, i thelluar deri në mënyrën e strukturimit dhe të ushtrimit të besimit fetar, është i panjohur për ligjet analoge të miratuara në Kosovë dhe Maqedoni, çka tregon shkallën e lartë të pjekurisë së sistemit shqiptar lidhur me rregullimin juridik të çështjeve fetare<sup>523</sup>.

Projektligji synon të mbrojë lirinë vetjake dhe kolektive për çështjet fetare në përputhje me normat kushtetuese ndërkombëtare dhe me ligjet e shtetit, duke i garantuar secilit lirinë e zgjedhjes së besimit, të ushtrimit të tij, të celebrimit të rriteve fetare veçmas apo bashkë me të tjerët pa farë pengese që i buron nga normat penale, përveç rasteve kur bie ndesh me rendin dhe sigurinë publike, me mbrojtjen e mjedisit, të shëndetit, të moralit dhe të drejtave të të tretëve. E njëjta mbrojtje i rezervohet ushtrimit kolektiv të besimit, personave juridikë fetarë si dhe të gjithë atyre që zhvillojnë veprimtari fetare, edukative dhe bamirësie, duke zbatuar kështu parimet e barazisë dhe jo ato diskriminuese, respektin e ndërsjellë, pavarësinë e secilit dhe parimin e bashkëpunimit në interes të të gjithëve (neni 3)<sup>524</sup>. Bëhet

---

<sup>522</sup> *Draft Law on Freedom of Religion...cit.*

<sup>523</sup> Për Kosovën, shih: *On Freedom of religion in Kosovo, cit.* ; për Maqedoninë, shih: *Ligj për gjendjen juridike të kishës...cit.*

<sup>524</sup> Të njëjtat parime mbrohen në formë të detajuar nga ligji, si në Kosovë ashtu dhe Maqedoni. *Ibidem.*

fjalë për një listë pioniere në llojin e saj, për një tekst, thuajse të pashoq në çështje të lirive dhe të të drejtave që i gjejmë të shpërndara gjithandej në normat e këtij sistemi, por që, në të vërtetë, nuk ofron asgjë të re lidhur me mbrojtjen e lirisë fetare dhe të ndërgjegjes. Përkundrazi, listimi i gjatë dhe i pështjelluar e vështirëson më shumë zbatimin e tij.

Pikat 1-3 të nenit 4, që merren me zbatueshmërinë e ligjit, synojnë ta shtrijnë fuqinë vepruese të këtij ligji edhe mbi qytetarët shqiptarë jashtë vendit dhe institucionet e tyre fetare atje, me qëllim që të arrijnë të njëjtat rezultate si me nënshkrimin e marrëveshjeve bashkëpunuese me komunitetin Bektashian dhe VUSH-in, të vetëdijshëm që disa komunitete fetare në Shqipëri, e shtrijnë veprimtarinë e tyre, sidomos përgjatë Ballkanit Perëndimor. Në pjesën e dytë të nenit 4, pikat 4 dhe 5, japin garanci për respektimin e normave kushtetuese lidhur me marrëveshjet mes shtetit dhe komuniteteve fetare<sup>525</sup> si dhe të dinjitetit të personit pa dallim feje dhe bindjeje vetjake, për mbrojtjen e pluralizmit fetar dhe të laicitetit në një klimë harmonie mes institucioneve publike dhe fetare, në mbrojtje të të drejtave njerëzore dhe të lirisë (neni 5)<sup>526</sup>.

Në nenin 7 të tij, projektligji garanton të drejtën e ushtrimit të lirisë fetare nëpërmjet pjesëmarrjes në një organizatë fetare, në ushtrimin e veprimtarive të kultit, në mundësinë e predikimit të fesë, në edukimin e fëmijëve në frymën e fesë dhe në mundësinë për të marrë pjesë në aktivitetet që organizon kulti edhe në nivel ndërkombëtar, gjithnjë në përputhje me ligjet në fuqi. Në bazë të nenit 8 të projektligjit, u garantohet liria e fesë dhe e ndërgjegjes të gjithë qytetarëve shqiptarë dhe të huaj si dhe atyre pa shtetësi që ndodhen në territorin shqiptar. Krahas kësaj, neni 9 trajton lirinë negative të fesë, duke siguruar se askush nuk mund të detyrohet të veprojë kundër bindjeve të veta fetare apo të ndërgjegjes si dhe

---

<sup>525</sup> Neni 4. 5. "Agreements signed between representatives of religious communities and the Council of Ministers, ratified by the Assembly according to Article 10/5 of the Constitution, may not contain provisions which violate the freedom of religion, and/or which contain discriminations as provided for in Article 2/2, 3 of this law."

<sup>526</sup> Sipas nenit 6 të projekt ligjit, palët do të përfaqësohen, nga njëra anë, nivelet më të larta të organeve shtetërore dhe nga ana tjetër, subjektet e zgjedhuar në liri të plotë nga komunitetet fetare.

nuk mund të pengohet të shpallë përkatësinë e vet fetare, qoftë individualisht, kolektivisht, privatisht apo publikisht, duke e detyruar të sillet dhe të kryejë veprime që diskriminojnë individin apo grupe personash për shkak të besimit fetar.

Askush nuk mund të diskriminohet, të privilegjohej, të detyrohet të heqë dorë nga shërbimet fetare apo të shtrëngohet të marrë pjesë, pa vullnetin e vet, në ceremonitë fetare, në rite apo të betohet mbi fenë e vet dhe aq më tepër të detyrohet të zbulojë bindjet e tija fetare<sup>527</sup>. Lidhur me këtë, vlen, po ashtu, shqyrtimi i dhënë më lart.

Gjithsesi, liria fetare njeh disa kufij në bazë të ligjit për mbrojtjen e sigurisë dhe të rendit publik, të të drejtave themelore morale dhe shoqërore dhe lirisë së të tretëve. Garantohej mundësia e refuzimit të shërbimit ushtarak, duke e zëvendësuar atë me shërbime të tjera alternative, pasi të jetë paraqitur një certifikatë që vërteton përkatësinë fetare (neni 10). Është disi i paqartë fati i kësaj norme, përderisa detyrimi për kryerjen e shërbimit ushtarak është shfuqizuar. Subjekteve që jetojnë në institucione të mbyllura apo të ndara si: spitale, burgje, ushtri etj., u duhet garantuar mundësia e praktikimit të kultit (neni 11)<sup>528</sup> dhe secili ka të drejtë të mbështesë financiarisht organizatën fetare së cilës i përket si dhe institucionet bamirëse apo të marrë ndihmë financiare prej tyre.

Kapitulli i tretë i ligjit u kushtohet marrëdhënieve mes shtetit dhe organizatave fetare dhe garanton ndarjen e tyre prej shtetit. Shteti është i paanshëm, njeh barazinë dhe pavarësinë e tyre, pasi nuk ka asnjë fe shtetërore, ndaj nuk mund të ketë privilegje të veçanta për

---

<sup>527</sup> Mbrojtja e lirisë negative të fesë është një tipar i përbashkët për të gjitha legjislacionet e vendeve të Europës lindore që duhet t'u sigurojnë mbrojtjen e nevojshme një numri të vogël qytetarësh jo besimtarë, por mbi të gjitha t'u paraprijnë dukurive që shfaqin mungesë tolerance fetare, qoftë edhe nën presionin e ushtruar nga ato besime fetare që duan medoemos ta shtojnë numrin e ndjekësve të tyre. Për rastin e Republikës çeke, shih: *O svobodě náboženského vyznání a postavení církví a náboženských společností a o změně některých zákonů*, 3/2002 Sb. ZÁKON ze dne 27. listopadu 2001 -Změna: 4/2003 Sb. <http://licodu.cois.it/41/view>; Per la Lituania *Religijų bendruomenių ir bendrijų*, I-1057- Data: 2006 12 12-Kalba: Lietuvių; <http://licodu.cois.it/75/view>;

<sup>528</sup> Lidhur me mbështetjen fetare për anëtarët e ushtrisë, shih: *Për statusin e ushtarakut të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë*. Ligji nr.9210, datë 23.3.2004, <http://licodu.cois.it/581/view>;

asnjërën prej tyre nga ana e shtetit. Shteti nuk duhet të ndërhyjë në punët e brendshme të komunitetit apo të grupeve fetare dhe as të ndikojë në zgjedhjet e tyre, emërimet apo shkarkimet e funksionarëve fetarë e aq më pak në krijimin e strukturave të brendshme të organizatave fetare. Këto të fundit duhet t'i edukojnë fëmijët në përputhje me dispozitat shtetërore, sa i takon formimit shkollor<sup>529</sup>. Këtu, gjen garanci edhe liria e mbledhjes dhe e organizimit fetar, kufijtë e së cilës përcaktohen vetëm në rastet e parashikuara me ligj, sipas standardeve ndërkombëtare, në mbrojtje të sigurisë publike, të shëndetit, të të drejtave themelore morale publike si dhe në respekt të lirisë së të tretëve. Në rast mosmarrëveshjes lidhur me këto çështje, komunitetet fetare duhet t'i drejtohen entit "Instituti shtetëror për çështjet fetare" apo t'i japin zgjidhje problemit duke iu referuar marrëveshjeve të nënshkruara mes shtetit dhe komuniteteve fetare (neni 13).

"Instituti shtetëror për çështjet fetare"<sup>530</sup> që përbën një prej risive të këtij ligji, është themeluar nga Këshilli i Ministrave dhe ka për detyrë të bashkërendojë marrëdhëniet mes shtetit dhe organizatave fetare, si dhe t'u japë zgjidhje problemeve që mund të burojnë nga këto marrëdhënie. Ky duhet të jetë një institut i pavarur që, me anë të këtij ligji, fiton personalitetin juridik.

---

<sup>529</sup> Neni 13. 4. "The state may provide material assistance for healthcare activities, education, charity and social services offered by religious organizations, provided that such services are provided without discrimination on the part of the religious organization with regards to not only the freedom of religion but all the aspects of fundamental freedoms and rights". 13. 5. "Religious organizations may perform functions related to the family, children and their upbringing or education in compliance with this law. Such functions shall in no case be performed avoiding respective legislation and services provided by the authorized state bodies".

<sup>530</sup> Neni 14. *State Institution on Religious Affairs* 1. "A state institution on religious affairs shall be established for coordinating the relations between the state and the religious organizations as well as for following up on issues that may arise from such relations" 2. "The state institution on religious affairs is an independent institution which shall acquire legal personality through this law and be established at the Council of Ministers". 3. "Duties, composition, organizational structure and the regulation on the functioning of the State Institution on Religious Affairs shall be approved with a decision of the Council of Ministers." Po ashtu, Komiteti i shtetit për kultet ka të drejtë t'u kërkojë komuniteteve fetare, për qëllime statistikore, të dhëna të ndryshme për anëtarët e tyre, (neni 23).



Detyrat, përbërja, struktura organizuese dhe rregullorja e funksionimit të institutit duhet të miratohen nga Këshilli i Ministrave në bazë të nenit 14 të këtij projektligji.

Pra, të krijohet përshtypja që Instituti është një strukturë e ndryshme nga Komiteti për marrëdhëniet me kultet, edhe pse dallimi mes detyrave që duhet të ushtrojë secili, nuk del shumë qartë, duke qenë se ka mbivendosje të shpeshtë kompetencash, ndërkohë që ç'mbetet, i takon Komitetit, nëse nuk po shkohet drejt shkrirjes së plotë të tij. Duket sikur ky projektligj synon ta shndërrojë Institutin në një strukturë “si palë e tretë” mes qeverisë dhe komuniteteve fetare, një lloj *authority*, që ka rolin e mbikëqyrësit dhe të ndërmjetësit mes palëve. Një ide e tillë të përforcohet më shumë gjatë shqyrtimit të neneve në vijim.

Kështu, sipas nenit 15, mund të nënshkruhen marrëveshje mes Këshillit të Ministrave dhe komuniteteve fetare, nëse një grup fetar kërkon që t'i njihet statusi i komunitetit fetar, sipas kërkesave që parashikohen në nenin 31. Marrëveshja rregullon marrëdhëniet e organizatave fetare me shtetin, duke promovuar bashkëpunimin në të mirë të të gjithëve, në interes të vendit dhe në mbrojtje të lirive dhe të të drejtave themelore të qytetarëve, duke parandaluar cenimin e interesave të të tretëve, por, gjithsesi, mbetet e paqartë nëse është Instituti i ri që negocion këtë marrëveshje apo kjo detyrë i takon Komitetit për kultet si dhe nuk kuptohet fati i marrëveshjeve të nënshkruara tashmë.

Sidoqoftë, si komuniteti fetar që ka fituar personalitetin juridik në bazë të projektligjit, ashtu edhe shteti mund të kërkojnë hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi. Lejohet nënshkrimi, qoftë edhe i përkohshëm, i marrëveshjeve lidhur me një çështje të caktuar që prek më shumë se një besim fetar, çka mund të jetë edhe kufizimi i veprimtarisë së tyre. Refuzimi i palës publike për nënshkrimin e marrëveshjes kërkon arsyetim duke iu referuar kushtetueshmërisë, ligjshmërisë apo detyrimeve financiare, në mbrojtje të interesave të shtetit. Ky refuzim mund të hidhet poshtë nga komuniteti fetar brenda tridhjetë ditësh nga shpallja e vendimit (neni 15). Nënshkrimi i marrëveshjeve me komunitetet fetare bazohet në nenin 16 të projektligjit, i cili parashikon dorëzimin e një kërkesë të argumentuar dhe paraqitjen e një propozimi pranë Institutit shtetëror për çështjet fetare nga

përfaqësuesi i komunitetit të interesuar. Pas një shqyrtimi paraprak, vijohet me miratimin e projektit të marrëveshjes, i cili duhet kryer brenda tridhjetë ditësh, nga paraqitja e kërkesës. Nënshkrimi i marrëveshjes, mund të kthehet mbrapsht nga instituti për përpunueshmëri me Kushtetutën dhe me ligjin përkatës. Pasi të ketë kryer shqyrtimet e rastit, Instituti shtetëror për çështjet fetare ia dërgon kërkesën dhe propozimin e projektit, Këshillit të Ministrave, i cili pasi ta ketë shqyrtuar, në dritën e nenit 15, e miraton ose e hedh poshtë me anë të një vendimi të argumentuar, jo më vonë se 90 ditë nga paraqitja e kërkesës. Neni 15 lë të kuptosh që Instituti ndërhyt në kompetencat e Komitetit, megjithatë mbetet e paqartë se në cilën seli kryhen këto procedura dhe nëse ka kontradikta mes palëve.

Kur marrëveshja miratohet, Këshilli i Ministrave ia dërgon fashikullin Institutit për ta futur në zbatim. Ratifikimi i marrëveshjes me komunitetet fetare bëhet në bazë të nenit 17 të projektligjit, i cili parashikon miratimin e një ligji nga shumica e anëtarëve të pranishëm në seancë parlamentare, në përputhje me procedurat e parashikuara nga rregullorja e parlamentit.

Bashkëpunimi me komunitetet fetare, lidhet me ditët e festave të kultit, të cilat përcaktohen në bazë të nenit 18 të ligjit; me celebrimin dhe zgjidhjen e martesave (neni 19); me edukimin, edhe fetar, të të miturve, i cili duhet të bëhet në respekt të të drejtave njerëzore dhe të vlerave demokratike; me mësimin e fesë në shkollat publike (neni 20).

Neni 21 i projektligjit rregullon veprimtarinë shoqërore në fushën ekonomike, edukative dhe shëndetësore, përfshirë krijimin e shërbimeve shoqërore dhe të shoqatave bamirëse, sipas normave në fuqi (neni 22). Po ashtu, lejohet liria e shprehjes dhe e drejta për informim, qoftë nga mjetet e informimit publik, qoftë nga ato të ofruara nga komunitetet fetare, gjithnjë në përputhje me ligjet përkatëse. Përmbajtja e mesazheve që përcillen me anë të mjeteve të komunikimit publik, nuk duhet të ketë sinjale që dhunojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare apo të diskriminojnë personat ose organizatat e tjera fetare, duke nxitur përplasje ndërfaqetare. Këtu, shtrohet edhe çështja e regjistrimit të popullsisë në bazë të

përkatësisë fetare, që kohët e fundit ka ngjallur jo pak polemika në vend<sup>531</sup>.

Neni 14 parashikon mbrojtje të veçantë për godinat e kultit që konsiderohen të shenjta. Autoritetet shtetërore nuk mund të ndërhyjnë në to, përveç rasteve të parashikuara me ligj, si për shembull në rastin e zbatimit të një vendimi gjykate, në përmbushje të një vendimi ekzekutiv apo nën rrezikun e një kërcënimi akut. Shteti garanton, gjithashtu, përdorimin e hapësirave publike për vendosjen e sendeve të kultit, kur procedurat ndjekin rrugën ligjore, duke kërkuar miratimin e Këshillit vendor të komunave apo bashkive si dhe të Këshillit të territorit të Republikës së Shqipërisë, pasi të jetë dhënë së pari pëlqimi nga Instituti shtetëror për çështjet fetare<sup>532</sup>. Pika e fundit e nenit 24 pohon se projektet për ndërtimin e godinave të kultit dhe për restaurimin e tyre duhet t'u përmbahen traditave dhe arkitekturës së godinave të kultit të ngritura mbi territorin shqiptar, duke shmangur kështu rrezikun e përhapjes së 'kolonizimit arkitekturor' në vend, që mund të shfaqet bashkë me traditën e godinave të kultit të vendeve financuese të këtyre

---

<sup>531</sup> Vendimi për të përfshirë në formularin e regjistrimit të vitit 2011 disa pyetje troç lidhur me përkatësinë fetare dhe etnike të personave të intervistuar, ka ndezur debat si në shtyp, ashtu dhe në mbarë vendin. Ndërkohë që disa mbështesnin idenë po veprohej kështu, për të regjistruar minoritetet, pjesa tjetër i mëshonin idesë se po shkeleshin të drejtat kushtetuese mbi privatësinë, lirinë fetare dhe të ndërgjegjes, pa folur këtu për pamundësinë e verifikimit të të dhënave të mbledhura. Shih: N. BAZE, *Leka i Parë, firmëtari i 20 000 kundër regjistrimit të popullsisë*, Tema on line, 16 prill

2011, <http://www.gazetatema.net/web/2011/04/16/leka-i-pare-firmetari-i-20-000-kunder-regjistrimit-te-popullsisë/>; (ultimo accesso 28.05.2012) *Regjistrimi mbi baza etnike do të rrisë artificialisht numrin e minoritetit*, Gazeta ShqipMedia, 21 prill 2011, <http://www.shqipmedia.info/portal/2011/07/regjistrimi-mbi-baza-etnike-do-te-rrise-artificialisht-numrin-e-minoritetit/> (klikimi i fundit 28.05.2012); G. CIMBALO, *Paqja fetare, dhuratë e shqiptarëve Europës*, "Shekulli", 23/02/2010, sot në: Shqipëri.com, <http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/7128/Paqja-fetare-dhurate-e-shqiptareve-Europes> (klikimi i fundit 28.05.2012).

<sup>532</sup> Kjo normë ligjore i referohet haptazi ligjit nr. 9048, datë 2003/07/04 "Mbi trashëgiminë kulturore".

projekteve<sup>533</sup>. Neni 25 prek thelbin e çështjes, pasi aty përcaktohen kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen nga komuniteti fetar për marrjen e personalitetit juridik civil. Kërkesa kryesore ka të bëjë me regjistrimin pranë gjykatës së rrethit Tiranë. Parashikohet, gjithashtu, hartimi i një regjistri për komunitetet dhe grupet fetare, pranë Institutit shtetëror për çështjet fetare, i cili verifikon aktin e regjistrimit dhe përditëson regjistrin me vendimet e reja të gjykatës<sup>534</sup>. Çdo ndryshim i selisë qendrore të organizatës fetare, qoftë adresa apo ndryshime të ndonjë lloji tjetër, i duhen bërë me dije si gjykatës, ashtu edhe Institutit për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse.

Komunitetet fetare janë të lira të përmbushin misionin e tyre si ta shohin ata më mirë dhe të kryejnë veprimtarinë e tyre të frymëzuar nga toleranca dhe bashkëjetesa fetare, nga ana tjetër, shteti, duke marrë parasysh regjistrimin e tyre si persona juridikë, duhet të respektojë zgjedhjet dhe aftësitë e tyre vetërregulluese dhe organizuese, por me kusht që këto të mos bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Instituti shtetëror për çështjet fetare, brenda tridhjetë ditësh duhet të njohë ndryshimet që u janë bërë normave të brendshme të statutit; komuniteteve fetare duhet t'u jepet mundësia të zhvillojnë çdo lloj aktiviteti fetar, shoqëror, edukativ, shëndetësor dhe ekonomik duke ngritur struktura, të cilave u njihet personaliteti juridik civil si dhe duke u pajisur me licencat dhe lejet e nevojshme siç parashikohet në legjislacionin e zakonshëm. Pavarësia organizuese e komuniteteve fetare është aq e gjerë sa ato, kurdo ta shohin të arsyeshme, mund t'i bashkëngjisin apo t'i

---

<sup>533</sup> Kjo çështje prek sidomos ndërtesat e kultit islam, të ndërtuara sipas traditës së Lindjes së Mesme që u përhapën në Shqipëri pas vitit 1991 duke ndjekur pëlqimin e donatorëve sadoqë ky shpeshherë nuk përputhej me nevojat reale të popullsisë.

<sup>534</sup> Hartimi i një regjistri për komunitetet fetare është kërkesë e vazhdueshme e Komisionit të Venecias. Këtë e gjejmë në shumë sisteme perëndimore, si p.sh., në sistemin spanjoll, i cili pasqyrohet edhe mbi ligjin maqedonas (kreu 2, nenet 9-17). Synimi i tij është t'u krijojë siguri komuniteteve fetare për të fituar njohje ligjore dhe për të pasur garancinë e nevojshme shtetërore mbi identitetin e komunitetit dhe të grupeve fetare. Kërkesat për njohjen janë po ato që parashikohen në ligjin e Kosovës (nenet 6-7). Kjo *modus operandi* nënkupton vështirësinë e grupeve të panjohura ligjërisht, të cilëve mund t'u krijohet mundësia të mbështeten tek ligji për shoqatat *non profit*.

shkëpusin vetes struktura të ndryshme të ngritura prej tyre, me kushtin e vetëm që t'ia përcjellin këtë vendim për dijeni Institutit shtetëror për çështjet fetare.

Neni 26, pika e fundit pohon se komunitetet dhe grupet fetare duhet të jenë persona juridikë jofitimprurës në të gjitha format e tyre juridike. Normat e reja bashkërenditen me ato të mëparshmet të parashikuara në ligjin e vitit 2001 për shoqatat jofitimprurëse dhe nuk vihet re dallimi me normat e mëparshme të marrëveshjeve me komunitetet fetare apo me legjislacionin mbi organizatat *non profit*. Në përputhje me nenin 10 të Kushtetutës, neni 27 i këtij projektligji pohon: “*Registration of religious communities shall be based on the agreement concluded between representatives of respective communities and the Council of Ministers, ratified by the Albanian Assembly.*”

Regjistrimi në regjistrin për komunitetet fetare kryhet pas paraqitjes së kërkesës për regjistrim të personit juridik, kërkesë që bëhet nga përfaqësuesi ligjor i komunitetit fetar. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet akti themeltar i personit juridik, i firmosur nga përfaqësuesi ligjor i komunitetit në përputhje me rregulloren e brendshme ku përcaktohen selia e komunitetit; natyra dhe qëllimi i veprimtarisë; statuti ose rregullorja e personit juridik ose çdo lloj akti i përdorur nga komuniteti fetar në përputhje me rregullat e tij; emërtimi i komunitetit fetar, i cili duhet të jetë i qartë dhe i dallueshëm nga ai i komuniteteve të tjera; përshkrimi i doktrinës apo ideologjisë së mbështetur nga komuniteti, po ashtu i dallueshëm nga të tjerët; mënyrat e zhvillimit të ceremonive fetare dhe qëllimi i aktiviteteve; struktura organizuese e komunitetit: selitë dhe funksionarët përkatës, mënyra e emërimit apo e zgjedhjes së përfaqësuesve ligjorë si dhe funksionet dhe detyrat që u ngarkohen atyre<sup>535</sup>. Pas kësaj liste të gjatë dhe të detajuar, lind natyrshëm pyetja se ç'pavarësi organizuese dhe statutore u mbetet komuniteteve fetare, sadoqë kjo është një e drejtë kushtetuese e garantuar!

---

<sup>535</sup> Në pamje të parë, kjo tërësi tiparësh të përbashkëta duket se ka si qëllim të shmangë konfliktet, por faktikisht ato gjejnë zgjidhje nga kontrolli mbi punët e brendshme të komunitetit fetar, duke e shtërnguar entin vigjilent t'i japë zgjidhje konfliktit ndërfaqetar.

Duhet bërë, po ashtu, të ditura burimet financiare të komunitetit, shkaqet dhe mënyrat e humbjes së personit juridik, territori mbi të cilin ky person juridik ushtron funksionin e tij, çka i hap rrugë kontrollit mbi baza territoriale, por kjo është e diskutueshme nga pikëpamja kushtetuese. Brenda tridhjetë ditësh nga paraqitja e kërkesës dhe e dokumenteve shoqëruese të përmendura më lart, gjykata e rrethit Tiranë, duhet të lëshojë urdhrin për regjistrimin e komunitetit fetar si person juridik në regjistrin e komuniteteve dhe të shoqatave fetare<sup>536</sup>.

Neni 28 i këtij projektligji, dikton norma analoge për regjistrimin e grupeve fetare. Kërkesat për regjistrim janë po ato: të bëhen të ditur emrat e përfaqësuesve, burimet financiare, doktrina dhe territori ku do ta ushtrojë veprimtarinë e tij ky grup fetar. Kërkohet, po ashtu, pëlqimi i Institutit shtetëror për çështjet fetare, ndërkohë që kërkesa për regjistrim mund të hidhet poshtë për të njëjtat arsye të parashikuara për komunitetet. Projektligji merret edhe me përcaktimin e veprimtarisë së grupit fetar (neni 29) duke ndjekur, gjithnjë, të njëjtën linjë si për komunitetet fetare. Një ndër shkaqet e zhbërjes së grupit fetar (neni 30) mund të jetë tejkalimi i afatit që u jepet për kryerjen e veprimtarisë së tyre si dhe për regjistrimin si komunitet fetar, sipas parashikimeve ligjore. Është krejt e qartë se veprimtaria e ushtruar, fillimisht, si grup fetar, është vetëm një veshje juridike e përkohshme që i hap rrugë, për atë sa është e nevojshme, ngulitjes së këtij besimi në një territor të caktuar, për t'u shndërruar, më pas, në komunitet fetar. Është e nënkuptueshme se, nëse veprimtaria e komunitetit bie ndesh me normat dhe ligjet kushtetuese, prokuroria e rrethit përkatës mund të ngrejë padi dhe të kërkojë shkrirjen e këtij grupi

---

<sup>536</sup> Mundësia e regjistrimit të komunitetit fetar mund të hidhet poshtë nëse: dokumentacioni i kërkuar nuk është i plotë; qëllimi dhe organizimi i statutit dhe i rregullores bien ndesh me kushtetutën e Republikës së Shqipërisë apo me ligjet në fuqi; veprimtaria e komunitetit çënon rendin publik, të drejtat dhe lirinë themelore të të tretëve apo nëse përhap urrejtje ndaj komuniteteve fetare ekzistuese. Vendimi për refuzimin e regjistrimit duhet të motivohet dhe t'i shpallet komunitetit të interesuar brenda dhjetë ditësh nga data e marrjes së këtij vendimi. Komuniteti fetar mund ta paraqesë sërish dokumentacionin e plotë për regjistrim, nëse janë shfuqizuar arsyet për të cilat është hedhur poshtë më parë. Së fundi, vendimi për refuzimin e regjistrimit mund të apelohe brenda 15 ditësh nga data e marrjes së tij, gjithnjë në përputhje me normat e përgjithshme të parashikuara në kodin e procedurës civile.

fetar. Vendimi për këtë i mbetet gjykatësit, i cili vendos në bazë të nenit 36 të projektligjit mbi shkeljet ligjore.

Tendenca për t'i trajtuar njëlloj si komunitetet fetare, ashtu edhe grupet fetare, gjen pasqyrim në procedurat e njëjta që parashikon neni 31 për paraqitjen e kërkesës për regjistrim, edhe pse nuk mungon njëfarë animi nga përmasat e shtrirjes territoriale të kultit dhe numrit të ndjekësve të tij. Sidoqoftë, kjo s'bën gjë tjetër, veçse shton maturinë lidhur me procesin dhe procedurat e njohjes. Projektligji parashikon edhe marrëveshjet e mundshme me grupet fetare dhe miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave. Në rast refuzimi të nënshkrimit të marrëveshjes, çështja mund të çohet në gjykatën e rrethit Tiranë, e cila parashikon regjistrimin e këtij grupi fetar në përputhje me nenin 27 të projektligjit. Kohëzgjatja e veprimtarisë së grupit fetar nuk është e kufizuar ashtu si nuk ka kufi pavarësia organizuese e tyre (neni 32-33), por emrat e funksionarëve që ushtrojnë detyrën e përfaqësuesve të këtij grupi, i duhen përcjellë Këshillit të Ministrave. Për grupet fetare, mbeten në fuqi të njëjtat pengesa ligjore si për komunitetet fetare.

Neni 34 kërkon t'i japë zgjidhje një prej çështjeve më të nxehta që është bërë pengesë në marrëdhëniet mes shtetit dhe organizatave me karakter fetar, sidomos atyre të huaja që e kanë selinë qendrore jashtë vendit. Prandaj ky nen pohon: "Organizata fetare ka të drejtë të marrë financime materiale nga ente apo individë të huaj, me kusht që këto përfitime të pasqyrohen në deklarinimin e të ardhurave të organizatës fetare, në mënyrë që të garantohet transparencë e plotë lidhur me veprimtarinë dhe qëllimet e saj"<sup>537</sup>

Për t'iu përshtatur kërkesave të këtij projektligji, organizatat fetare mund të shkrihen dhe të riorganizohen sipas procedurave të përcaktuara në statutin apo rregulloren e tyre. Lidhur me vendime të tilla, duhet vënë në dijeni Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Institutit shtetëror për çështjet fetare, jo më vonë se dhjetë ditë nga shkrirja apo riorganizimi i komunitetit fetar. Në rast të një regjistrimi të dytë, shoqata fetare duhet t'u përmbahet po atyre kërkesave që parashikon ligji (neni 35). Të njëjtën rrugë duhet të

---

<sup>537</sup> Transparenca e financimit nuk e mbron shtetin nga ndërhyrjet nga jashtë mbi shoqërinë shqiptare dhe nuk u vë fre synimeve të 'kolonizimit' fetar, që u shfaqën me mbërritjen e protagonistëve fetarë nga e gjithë bota, pas viteve nëntëdhjetë.

ndjekë edhe ai grup fetar që vendos të çregjistrohet (neni 36). Çdo organizimi fetar i është e qartë rëndësia e respektimit të kriterëve juridike lidhur me qenësinë dhe veprimtarinë e tyre, pavarësisht mënyrës se si kanë vendosur ta ushtrojnë ata veprimtarinë e tyre në territorin shqiptar.

Së fundi, kreu VI i projektligjit, në nenin 37 të tij, dikton dispozitat lidhur me çështjet fetare, sipas të cilave shteti respekton pavarësinë e organizatave fetare për administrimin e pasurisë së tyre, në përmbajtje të parimeve, rregullave, traditave dhe zakoneve. Për nga pikëpamja e tatimeve dhe e doganave, ato trajtohen njëjloj si organizatat *non profit* (neni 38)<sup>538</sup>. Përveç veprimtarisë fetare, ata mund të pajisen me lejen dhe licensën e nevojshme për të kryer shërbime të ndryshme në fushën sociale, si, për shembull, në arsim dhe shëndetësi, ashtu siç mund të kryejnë aktivitete të ndryshme ekonomike, duke iu nënshtruar të njëjtit trajtim juridik të parashikuar për çdo lloj enti që kryen aktivitete të tilla (neni 39). Për këto raste, siç parashikon norma vijuese, përveç regjistrimit në regjistrin e komuniteteve fetare, pranë gjykatës, ato duhet të regjistrohen edhe pranë sigurimeve shoqërore të shtetit, për detyrimet tatimore. Projektligji mbyllet me nenet 41-42, që rregullojnë mbështetjen financiare për organizatat me karakter fetar, duke e lënë të hapur mundësinë e financimit të tyre, kryesisht për komunitetet fetare tradicionale në vend, për shpërblim të dëmeve të pësuar nga regjimi i shkuar<sup>539</sup>. Po ashtu, për raste të veçanta, parashikohet financimi i ndërtimit të godinave të kultit, apo rikthimi dhe restaurimi i qendrave të pelegrinazhit, përfshirë edhe infrastrukturën mbështetëse të tyre. Për të siguruar funksionimin e rregullt të organizatave fetare, parashikohet që shteti të marrë përsipër vënien në dispozicion të një shume prej 30% të pagave të klerit; deri në 50% të pagave të personelit të administratës civile të punësuar pranë selive të komuniteteve fetare dhe deri në 60% të pagave të personelit

---

<sup>538</sup> Përfshirimi nga detyrimi i taksave doganore për të mirat fetare, u arrit nëpërmjet një ligji të vitit 1997: “*Për tarifât doganore*”, Dekret nr.1807, datë 30.5.1997.

<sup>539</sup> Është e pashpjegueshme ekzistenca e kësaj norme, përballë garancive të shumta që burojnë nga ligji përkatës, i cituar, madje, shpeshherë gjatë veprimtarisë së *Agjensisë për kthimin dhe dëmshpërblimin e pronave*.



mësimdhënës në shkollat e arsimit të lartë. Si kriter për llogaritjen e pagave duhen të shërbejë tabela e hartuar nga Instituti i sigurimeve shoqërore për secilin shërbim të kryer. Në këtë mënyrë u paraprihet mospërputhjeve të mundshme lidhur me shumën në ngarkim të shtetit, e cila i bie të përcaktohet nga besimet dhe grupet fetare<sup>540</sup>.

Pjesa e 'zakonshme' e projektligjit, mbyllet me nenin 43 ku parashikohet ngritja e komisioneve *ad hoc* për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, vendimet e të cilëve kërkojnë miratimin e Këshillit të Ministrave, pas një konsultimi paraprak me organizatat fetare. Në mungesë të një marrëveshjeje, çështja i kalon për gjykim gjykatës së rrethit Tiranë. Lidhur me kohën e tranzicionit, neni 44 merr në shqyrtim rikthimin e pronave komuniteteve fetare, duke e lënë të hapur mundësinë e dëmshpërblimit për ato raste kur nuk mund të ketë rikthim të pronës. Në këtë rast, prona e re regjistrohet në listën e pronave të komunitetit fetar. Neni 45 parashikon që i njëjti ligj të zbatohet edhe për organizatat fetare që, aktualisht, veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që vërteton zotërimin e pronës nga ana e tyre, para procesit të shpronësimit<sup>541</sup>. Gjykata e rrethit përkatës i shqyrton me prioritet çështje të tilla juridike dhe kërkesat përkatëse, dhe nëse pajtohet me to, hap procedurat për regjistrimin e pasurisë në emër të të interesuarve.

Në ato raste kur komuniteti fetar e zotëron tashmë njohjen e personalitetit juridik civil, ky njihet automatikisht nga gjykatësi, menjëherë pas paraqitjes së dokumentacionit përkatës. Përgjithësisht, projektligji është një përmbledhje organike e normave që ekzistojnë tashmë në sistemin shqiptar, por, megjithatë, ai krijon pështjellim në marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare, për të cilat u shpenzua aq mundim për të

---

<sup>540</sup> Sipas kësaj norme, të gjitha besimet fetare duhet t'i referohen ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009, *Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me këshillin e ministrave*, <http://licodu.cois.it/612/view>

<sup>541</sup> Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me ripropozimin e një norme të parashikuar tashmë nga legjislacioni në fuqi dhe gjerësisht të përdorur.

ardhur deri aty, sa këto marrëdhënie të bëheshin garant i paqes dhe bashkëjetesës mes komuniteteve të ndryshme fetare.

Nëse kërkesat e ngritura nga Komisioni i Venecias e kanë marrë shtysën nga shqetësimi për mbrojtjen e lirisë fetare, në gjykimin tonë, ky shqetësim rezulton krejt i pathemeltë. Nënshkrimi i marrëdhënieve të veçanta bashkëpunuese, të parashikuara në Kushtetutë, garantohet në mënyrën më të mirë, sipas kërkesave të besimeve të ndryshme. Kërkesat e Kishës katolike për hartimin e marrëveshjeve të dakordësisë kanë marrë përgjigje pozitive, po ashtu, kohët e fundit, është nënshkruar marrëveshja me VUSH-in ndërkohë që, për grupet fetare të reja në vend, janë krijuar kushte dhe lehtësira të një niveli thuajse të panjohur për vendet e tjera të Europës Lindore.

Po ashtu, fakti që sistemi shqiptar përdor një ligj të së drejtës së përbashkët, atë të shoqatave *non-profit* për rregullimin e marrëdhënieve me besimet e ndryshme fetare, duke i zbatuar norma të tilla edhe për kultet me më shumë traditë në vend, është shprehje e respektimit të parimit të ndarjes dhe të laicitetit, gjë që në shumë sisteme me traditë demokratiko-liberale kjo mbështetet nga norma të tipit neojuridiksional, çka nënkupton përdorimin e normave të përgjithshme për rregullimin e disa çështjeve fetare.

Në gjykimin tonë, miratimi i një ligji të përgjithshëm, si ai i mësipërmi, në mbrojtje të lirisë fetare, nuk ndikon aspak në garantimin e lirisë dhe barazisë fetare për asnjë prej besimeve apo personave që ndodhen në territorin shqiptar, madje në disa raste na rezulton regresiv dhe paraprijës i mosmarrëveshjeve të mundshme, nëse u referohemi proceduarve të ndryshme dhe ndonjë pengese paraprake në çështje të lirisë fetare, si, për shembull, shtimi i kontrollit mbi aftësitë vetërregulluese të komuniteteve dhe grupeve fetare. Sipas mendimit të autorit të këtyre radhëve, vetëm nevoja për njëfarë njëtrajtësimi abstrakt të legjislacionit për çështje të lirisë fetare e të të drejtave njerëzore, ashtu si njëfarë kolonizimi kulturor-juridik, mund të bëjë që ekspertët e Këshillit të Europës –të dhënë kaq fort pas modeleve të tyre mbi administrimin e marrëdhënieve juridike mes besimeve fetare dhe shtetit- të ofrojnë zgjidhje të njëjta për problemet e bashkëjetesës dhe pluralizmit fetar, por e vërteta është se, në këtë rast, zgjidhjet e ofruara nga përpunimi i sistemit juridik shqiptar,

kanë rezultuar të efektshme, ndërkohë që nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ato të Komisionit të Venecias.

#### 4. 5. *Shtrirja e efektshmërisë së marrëveshjeve mbi trevat e Shqipërisë etnike*

Në mbyllje të kësaj analize, të lind natyrshëm pyetja se sa është e mundshme që modeli shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve me komunitetet e ndryshme fetare të kthehet në një përvojë të eksportueshme, sidomos sa i takon hapësirës së ashtuquajtur “Shqipëri etnike”<sup>542</sup>, por, pse jo, edhe vendeve të Ballkanit me prani domethënëse dhe të qëndrueshme të pakicave etnike fetare, aq sa do të ishte më e saktë të përcaktoheshin si komunitete fetare<sup>543</sup> sesa si besime fetare<sup>544</sup>.

---

<sup>542</sup> Me termin *Shqipëri etnike* kuptohet hapësira e banuar nga popullsia me shumicë shqiptare dhe që sot përfshin një pjesë të territorit malazez në kufi me Shqipërinë, Kosovën dhe një pjesë të mirë të shtrirë në drejtim të Serbisë, një pjesë të Maqedonisë dhe krahinën e Çamërisë apo jugun e Epirit, aktualisht pjesë e Greqisë. Komunitetet fetare projektojnë mbi këto territore juridiksionin e tyre, çka e dëshmon fakti se ato u ofrojnë mbrojtje personave që jetojnë jashtë vendit. Kjo vlen për komunitetin bektashian dhe për vëllazërinë ungjillore. Kësaj dispozite i jep kuptim fakti që qendra botërore e bektashinjve e ka selinë në Tiranë, për rrjedhojë komuniteti shqiptar përfaqëson një pikë referimi për rreth tetë milion besimtarë bektashinj që jetojnë në vende të ndryshme, të cilët mund të gjejnë mikëpritjen e duhur në Shqipëri. Po ashtu, duhet mbajtur parasysh ndikimi që ushtron qeveria shqiptare në nivel diplomatik për mbrojtjen e të drejtave të pakicave fetare, në vendet kufitare. E njëjta logjikë vlen për Vëllazërinë ungjillore e cila ka kërkuar dhe i është lejuar e njëjta klauzolë për shkak të shtrirjes së saj ndërkombëtare dhe për lidhjet që ka ajo me organizmat ndërkombëtarë të besimit protestant. Kapërcimi i mbrojtjes që ofron sistemi shqiptar përtej kufijve, vjen si përgjigje e aspiratës së këtij vendi për t’u identifikuar me trojet etnike, çka mund të sjellë garanci për stabilitetin e këtyre trevave nëse ia del të ngrihet në nivelin e veprimeve moderuese, përkundrajt lëvizjeve nacionaliste, filo shqiptare të vendeve fqinje. Ndryshe nga këto, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë respekton territorin kanonik të kishave të tjera ortodokse, të cilat ushtrojnë juridiksionin e tyre mbi territoret përkatëse. Po ashtu, myslimanët Sunitë u lënë hapësirë të lirë organizatave fetare përkatëse të shteteve ku ata janë të pranishme. Kjo është arsyeja se përse mungon një dispozitë e tillë në tekstin e marrëveshjeve të tyre.

<sup>543</sup> Lidhur me ndryshimin e kuptimit që ka pësuar termi ‘besim fetar’ në sistemet e ndryshme europiane, përgjatë rrjedhës së kohës, shih: G. CIMBALO, *Integración de los migrantes: un Islam plural para Europa...cit.* 75-98,

<sup>544</sup> Për vetë natyrën, edhe etnike, të besimeve fetare në Shqipëri, mund të pohohet se përdorimi i termit ‘komunitet fetar’, që nuk është aq i largët nga termi ‘besim’, term ky që u përdor historikisht në legjislacionin vendas duke

Është me vend të marrim në shqyrtim rastin e Kosovës<sup>545</sup>, e cila, pas një rrugëtimi të mundimshëm ia doli të hartojë Kushtetutën e vet dhe një legjislacion të veçantë për lirinë fetare<sup>546</sup>, i cili përbën kuadrin normativ që, për hir të së vërtetës, i është diktuar Kosovës, lidhur me çështjen e lirisë së besimit<sup>547</sup>. Ligji mbi lirinë fetare, i vitit 2006 sanksionon mungesën e fesë shtetërore dhe ndarjen e besimit fetar nga shteti (neni 5, c. 1 e 2). Më pas, jepet një listë e komuniteteve fetare të pranishme në Kosovë: komuniteti Islam i Kosovës, Kisha ortodokse serbe, Kisha katolike romake, komuniteti fetar Hebre, Kisha ungjillore (neni 5, c. 4), të cilëve u ofrohet mbrojtje dhe mbështetje për ushtrimin e kultit. Format organizuese të një besimi fetar, duhen parë të lidhura ngushtë me organizimin e një komuniteti individësh apo edhe me tërësinë e komuniteteve fetare për të cilat ligji, së paku teorikisht, krijon hapësirat e nevojshme për organizim, gjë që u mundëson besimeve më të vogla dhe atyre më të vona përzgjedhjen e rrugëve më të përshtatshme për ngulitjen e tyre në këtë territor<sup>548</sup>.

---

nisur që me dekretin e vitit 1923 për njohjen e personalitetit juridik të komunitetit fetar dhe u rimor në statutet e mëtejshme të sistemit shqiptar.

<sup>545</sup> Për të kuptuar strukturën e ndërlikuar institucionale të Kosovës, lind nevoja e shqyrtimit të marrëveshjeve të Dayton-it. Shih: <http://licodu.cois.it/1/view>. Për tekstin e kushtetutës së vitit 2008, shih: *Constitution of the Republic of Kosovo*, <http://licodu.cois.it/4/view>. Për një analizë më të hollësishme, shih: Q. BRAZZO, *La libertà religiosa in Kosovo, ovvero un ossimoro "in fieri", Libertà di coscienza e diversità...cit., passim*.

<sup>546</sup> Rreth ligjit për lirinë fetare në Kosovë, shih: *Law on freedom of religion in Kosovo*, <http://licodu.cois.it/6/view>; për variantin në shqip të të njëjtit ligj, shih: *Për lirinë fetare në Kosovë*, Ligji nr. 02/L-31, Lidhur me botimin e ligjit në vitin 2006, shih: *Regulation no. 2006/48, on the promulgation of the law on freedom of religion in Kosovo*.

<sup>547</sup> Cfr.: Q. LOBELLO, *La libertà religiosa in Kosovo, ovvero un ossimoro...cit.*, 331.

<sup>548</sup> Ligji i mëparshëm, në fuqi, n. 22/1953 i Republikës federale të Jugosllavisë, mbron të drejtat dhe liritë fetare, përcaktonte kufirin e marrëdhënieve shtet-kishë dhe njihte si besime të regjistruara: Kishën e krishterë batiste, Kishën e krishterë aventiste, Kishën ungjillore metodiste, Kishën e rrëshajave, Kishën e krishterë ungjillore dhe disa organizata të tjera fetare. *Legge fondamentale sullo statuto giuridico delle comunità religiose, n. 22/1953*, <http://licodu.cois.it/241/view>.

Me shpërbërjen e shtetit federal, u shpërbë edhe gjendja e mëparshme dhe njohja tashmë garantohej nga dispozita nr.22 e UMNK-ut, (1999) mbi dhënien e personalitetit juridik civil për OJQ-të, të cilat vepronin në territorin e Kosovës.

Ndërkohë, ligji nuk i njeh vendimet e mëparshme dhe kërkon të kryhet një regjistrim i ri për marrjen e personit juridik, por duke lënë jashtë këtij procesi besimet e vogla. Kjo, si në të shkuarën, ashtu edhe sot, vjen si rezultat i paqartësisë së përcaktimit të kriterëve që duhet të përmbushë një komunitet fetar, në mënyrë që të pranohet kërkesa e tij për regjistrim. Dëshmi e kësaj është edhe fakti që, ende sot e kësaj dite, qeveria e Kosovës refuzon ta njohë Kishën ungjillore si personalitet juridik<sup>549</sup>.

Në vazhden e kësaj analize, del e qartë nevoja për ndryshimin e ligjit, edhe pse nuk ka farë garancie për orientimin e ligjvënësist dhe për ndikimin që do të ketë mbi të qëndrimi i Shteteve të

---

UNMIK/RREG/, Rregullore nr. 22, 15 nëntor 1999, *Për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare ne Kosovë*,

[http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A1999regs/RA1999\\_22.htm](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A1999regs/RA1999_22.htm) Vendosja e protektoratit të Shteteve të Bashkuara mbi Kosovën, bëri që në vitin 2006 të miratohej një ligj për komunitetet fetare, sipas të cilit parashikohej një procedurë e veçantë për komunitetet fetare që kërkonin njohjen e personalitetit juridik civil. Për rrjedhojë, ligji i mëparshëm i Kosovës për OJQ-të përjashtonte nga procedura e njohjes, pikërisht komunitetet fetare, duke qenë se një çështje e tillë rregullohej tashmë nga ligji i sipërmendur. Ref: *Ligji për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare*, nr. 2009/03-L-134, neni 1, pika 2..

<sup>549</sup> Ligji i vitit 2007 nuk përcakton një numër dysHEME anëtarësh për përfitimin e njohjes; nuk jep sqarime mbi emërimin që duhet të marrin besimet fetare (më saktë, në duhet ta përfshijë fjalën 'Kosovë' emërtimi i tyre); nuk përcakton ç'marrëdhënie duhet të kenë ato me organizatat fetare ndërkombëtare dhe as nëse mund të jenë filiale të organizatave të huaja, të cilat dërgojnë qytetarë të huaj për të shërbyer në Kosovë. Mungesa e njohjes ka pasoja lidhur me ligjin mbi varrezat (neni 16). Sipas ligjit në fuqi, në Kosovë, administrimi i varrezave bëhet në bazë të fesë dhe secili komunitet fetar merr përsipër kryerjen e shërbimeve për besimtarët e vet. Kjo do të thotë se besimet që nuk gëzojnë njohje ligjore, nuk mund të kenë varrezat e tyre. Po ashtu, mosnjohja ligjore, ndikon mbi mbështetjen fetare të sëmurëve në spitale (neni 23) si dhe në ushtrimin e lirisë fetare nga ana e ushtarakëve dhe forcave të policisë, nëse besimi i tyre nuk njihet (neni 24). Mungesa e njohjes rëndon edhe në administrimin e komunitetit fetar dhe në mundësinë e përfitimit të financimeve si dhe të kontrollit për përdorimin e tyre (neni 25). Pasoja të rënda bien edhe mbi kryerjen e veprimtarive të tyre. Së fundi, ligji nuk vendos asnjë kufi dhe lejon asnjë kontroll të grupit të personave që kërkojnë njohjen e tyre si organizatë fetare, edhe sepse, në fakt, ata duan ta përdorin një veshje të tillë si mbulojë për aktivitetet e tyre. Ligji i ofron, gjithashtu, mbrojtje të veçantë sekretit për ata komunitete fetare që e kërkojnë një gjë të tillë.

Bashkuara, kur të ndërhyhet për ta ndryshuar këtë ligj<sup>550</sup>. Parë nga kjo anë, është e kuptueshme se pse marrëveshja e nënshkruar në Shqipëri me Vëllazërinë ungjillore, kërkon ta shtrijë strehën e saj mbrojtëse edhe mbi bashkë-besimtarët në Kosovë, me shpresën që edhe ata të mund të krijojnë një strukturë fetare të njohur nga ligji. Kjo formë mbrojtjeje, e shprehur në marrëveshjen e bashkëpunimit në Shqipëri, shtrihet edhe mbi Maqedoni, kushtetuta e së cilës (1992) sanksionon ndarjen mes shtetit dhe besimeve fetare<sup>551</sup>. Në vitin 1997 u miratua ligji i parë për kishat, komunitetet dhe grupet fetare, sipas të cilit njihej Kisha ortodokse maqedonase, komuniteti Islam, Kisha katolike, komuniteti Hebre dhe Kisha metodiste. Ky ligj lejonte, po ashtu, njohjen e komuniteteve dhe grupeve të tjera, të cilët me plotësimin e kushteve të parashikuara në ligj dhe me pëlqimin e organit ekzekutiv, mund të regjistroheshin dhe të njiheshin si të tilla. Ligji ndalonte çdo aktivitet apo rit fetar nga komunitetet dhe grupet që nuk ishin të regjistruara, për të cilët kërkohej firma e së paku pesëdhjetë qytetarëve maqedonas për regjistrimin e tyre si grup fetar<sup>552</sup>. Për t'u prerë rrugën pretendimeve të Kishës ortodokse serbe, që binin ndesh me Kishën ortodokse maqedonase, e cila sapo

---

<sup>550</sup> Është diskutuar dhe diskutohet ende shumë mbi rolin e OKB-së dhe mbi rolin e saj administrues në Kosovë. Lidhur me këtë, shih: G. H. FOX, *Humanitarian Occupation*, Cambridge, Cambridge University Press, 2008; I. INGRAVALLO, *Il Consiglio di Sicurezza e l'amministrazione diretta di territori*, Editoriale Scientifica, Napoli 2008; C. STAHN, *The Law and Practice of International Territorial Administration, Versailles to Iraq and Beyond*, Cambridge, Cambridge University Press, 2008; E. ARINELLI, G. SCOTTO, *La guerra del Kosovo. Anatomia di un'escalation*, Roma, Editori Riuniti 1999; CENTRE FOR EUROPEAN POLICY STUDIES, *The CEPS plan for the Balkans*, (a cura di M. Emerson e D. Gross), Bruxelles, CEPES, 1999..

<sup>551</sup> Neni i ligjit të vitit 2006 që rregullon këtë çështje, mban numrin 19: "The freedom of religious confession is guaranteed. The right to express one's faith freely and publicly, individually or with others is guaranteed. The Macedonian Orthodox Church and other religious communities and groups are separated from the state and are equal before the law. The Macedonian Orthodox Church and other religious communities and groups are free to establish schools and other social and charitable institutions, by ways of a procedure regulated by law". Për konsultimin e kushtetutës maqedonase në maqedonisht, shih:

<http://licodu.cois.it/23/view>

<sup>552</sup> Për tekstin e ligjit maqedonas mbi lirinë fetare, shih: *On freedom of religion in Kosovo*, <http://licodu.cois.it/512/view>

kishte shpallur autoqefalinë e vet, ligji ndalonte krijimin e organizatave të ndryshme në brendësi të të njëjtit kult, duke diskriminuar, kështu, jo vetëm një pjesë të ortodoksisë në vend, por edhe besimtarët Bektashinj.

Ky komunitet fetar, i pranishëm historikisht në Maqedoni, i mirëkuptonte pretendimet e myslimanëve Sunitë, të cilët, në përputhje me ligjin e shtetit për komunitetet fetare, i mbulonin zyrtarisht, duke përfshirë edhe të mirat e të gjithë myslimanëve të shkollave të ndryshme, nën emrin e një komuniteti të vetëm. Kjo është bërë e mundur sadoqë, në Maqedoni, edhe në pikëpamje të besimit, ekzistojnë çarje të thella mes bektashinjve, të cilët, tradicionalisht kanë mbajtur qëndrime të moderuara, laike, dhe përfaqësuesve Sunitë maqedonas, të cilët, përkundrazi, kanë qëndrime shumë të afërta me islamin tradicional panarab, fundamentalist, të llojit *wahabit*, por që faktikisht kanë luajtur rol qendror në luftën për pavarësi, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, çka u siguron pushtet jo të pakët në rrafsh politik<sup>553</sup>.

Këto dispozita ligjore kanë ndikuar negativisht edhe në njohjen e besimeve të ndryshme protestante, të cilët nuk kanë mundur t'i regjistrojnë kishat e tyre, çka sjell mungesën e garancive të nevojshme për mbrojtjen ligjore të ndjekësve dhe nëpunësve të tyre. Kështu, është shkelur edhe paragrafi 16.3 i Aktit final të Vjenës, i cili e detyron Maqedoninë, si nënshkruese e këtij akti, të njohë kërkesat e komuniteteve fetare që praktikojnë apo po përgatiten të praktikojnë fenë e tyre, në përputhje me kushtetueshmërinë e shteteve dhe t'u garantojë njohjen e atij statuti që gëzojnë në vendet e tyre të origjinës<sup>554</sup>. Po ashtu, ligji

---

<sup>553</sup> Lidhur me këtë, shih: K. IVANOVA PETROVA, *La Corte Costituzionale della Repubblica macedone dichiarata illegittimo l'insegnamento della religione nella scuola pubblica, Stato Chiese e pluralismo confessionale, giugno 2009, 2-3.*

<sup>554</sup> Ref.: *Documento della riunione di Copenhagen della conferenza sulla dimensione umana della CSCE*, veçanërisht, pikën 9.4 <http://www.osce.org/it/odhr/elections/14304>. Për më tepër: G. BARBERINI, *L'Ostpolitik della Santa Sede. Un dialogo lungo e faticoso*, il Mulino, Bologna, 2007; ID., *La Politica del dialogo. Le carte Casaroli sull'Ostpolitik vaticana*, (nën kujdesin e G. Barberini-it), il Mulino Bologna, 2008; ID., *La libertà di religione nel processo di democratizzazione degli Stati dell'Europa centrale ed orientale*, S. FERRARI – W. COLE DURHAM JR. – E. A. SEWELL, *Diritto e religione nell'Europa postcomunista*, Bologna, il Mulino 2004, 9-30.



nuk u lejonte drejtuesve të kultit të celebronin, qoftë edhe privatisht, ritet dhe shërbimet fetare, të vishnin petkun fetar (neni 18)<sup>555</sup>, e çka është më e rëndë, ndalonte dhe vazhdon ende të ndalojë ngritjen e godinave të kultit për ato besime që nuk kanë fituar ende njohje ligjore<sup>556</sup>.

Puna ka shkuar deri aty, sa në vitin 2002, qeveria maqedonase i konfiskoi dy teqe komunitetit Bektashian dhe ia kaloi ato në pronësi komunitetit fetar Islam të Maqedonisë (IRCM)<sup>557</sup>. Ka qenë e kotë përpjekja e besimtarëve Bektashian për të rifituar të mirat e tyre, pasi IRCM-ja, e mbështetur edhe nga qeveria, pretendon ligjshmëri të plotë mbi pronën e konfiskuar, nisur edhe nga fakti se, sipas ligjit maqedonas, komuniteti Mysliman është një i vetëm dhe përfaqëson të gjithë myslimanët e Maqedonisë. Ky qëndrim ka ndezur polemika të shumta në nivel ndërkombëtar, aq sa në vitin 2007, parlamenti maqedonas miratoi një ligj mbi statusin juridik të kishave, komuniteteve fetare dhe grupeve fetare<sup>558</sup>. Ky ligj është fryt i një ekuilibri të kujdesshëm mes presioneve ndërkombëtare<sup>559</sup>

---

<sup>555</sup> Në paragrafin 3, art.18 i ligjit të vitit 1997, thuhet se ritet fetare, lutjet dhe format e tjera të besimit, mund të drejtohen dhe të organizohen vetëm nga një klerik që është anëtar i një Kisha, një komuniteti fetar apo një grupi fetar të njohur në Republikën e Maqedonisë dhe që ka lejen e tyre. Shih: <http://licodu.cois.it/435/view>

<sup>556</sup> Mungesa e njohjes si kishë, komunitet apo grup fetar, bëhet pengesë për zotërimin e të mirave, pra për përfitimin e terreneve të nevojshme për ndërtimin e godinave të kultit; për pasjen e pronës së paluajtshme në shërbim të veprimtarive të kultit, për t'i ristrukturuar apo zgjeruar ato; për të paraqitur kërkesën për t'i përfshirë ato në planin rregullues apo për të ndërtuar godina të reja për kultin. Tjetër gjë është pastaj shembja e ndërtesave të kultit për kishat që nuk gëzojnë njohje ligjore, siç ndodhi me kishën ortodokse serbe. Për më shumë shih: <http://licodu.cois.it/435/view>.

<sup>557</sup> Në parathënien e aktit kushtetues të saj, datë 24 korrik 2008, *Bashkësisë Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë* pohon se është orgnizata e vetme për të gjithë islamit, në mënyrë që t'i përmbushë sa më mirë qëllimet e saj, si dhe të zotërojë të gjitha të mirat e organizatave të mëparshme islame në Maqedoni. <http://www.bim.org.mk/kushtetuta.pdf>

<sup>558</sup> Ligji u hartua në shtator të vitit 2007 dhe hyri në fuqi me 1 maj të vitit pasardhës. Ref.: *Ligj për pozitën juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, Ligj 20.10. 2007, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" n.. 113, <http://licodu.cois.it/434/view>

<sup>559</sup> Për këtë çështje kanë ndërhyrë si Bashkimi europian, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara, duke kërkuar që ligji të njihte lirinë e plotë fetare, e në mënyrë të

dhe negociatave me komunitetet fetare vendase. Ai rregullon statusin juridik të kishave, komuniteteve dhe grupeve fetare, lejimin e shërbimeve fetare, praktikimin e lutjeve dhe ceremonive liturgjike, mësimin fetar dhe aktivitetet edukative, financat e kishave, të komuniteteve fetare dhe grupeve fetare.

Ligji i ri propozon ndarjen e besimeve fetare në: *kisha, komunitete fetare dhe grupe fetare*, por pa e shpjeguar domethënien e këtyre termave. Ai e ndalon krijimin e grupeve apo të besimeve fetare në brendësi të një kulti, dhe regjistrimin e tyre në regjistrin shtetëror për kultet si dhe vendos, me anë të nenit 21, parimin e bashkëpunimit mes shtetit dhe besimeve të ndryshme, pa hequr dorë nga detyrimi që u ngarkon besimeve fetare për marrjen e një lejeje të posaçme nga autoritetet, para celebrimit të riteve fetare, jashtë godinave të kultit që njihen zyrtarisht si të tilla.

Ky diskriminim i vazhdueshëm i ka shtyrë bektashinjtë shqiptarë të kërkojnë dhe të sigurojnë në përmbajtjen e marrëveshjes bashkëpunuese me shtetin shqiptar (neni 9), mbrojtjen e besimtarëve të tyre jashtë kufijve shtetëror, duke e arsyetuar kërkesën e tyre me faktin se selia qendrore e kultit gjendet në Shqipëri<sup>560</sup>. Konflikti ndërfeetar mes ortodoksëve të Kishës serbe dhe asaj maqedonase; mes myslimanëve të IRCM-së dhe bektashinjve, nuk gjen prehje, çka e dëshmon edhe vënia nën flakë e një teqeje në Tetovë<sup>561</sup>.

---

veçantë t'u lejonte regjistrimin, pa më të voglin diskriminim, besimeve të ndryshme fetare në vend. Është mbajtur qëndrim sidomos nga Këshilli i bashkimit europian me ndërmjetësinë e Komisionit të Venecias. Venice Commission [22/03/2007] CDL-AD(2007)005, *Opinion on the Draft Law on the Legal Status of a Church, a Religious Community and a Religious Group of "the former Yugoslav Republic of Macedonia"* adopted by the Venice Commission at its 70th Plenary Session (Venecia, 16-17 Mars 2007)

<sup>560</sup> Është e vërtetë që si Bektashinjtë, ashtu dhe Ungjillorët, janë organizata me karakter fetar që kanë degëzimet e tyre në nivel ndërkombëtar, por është e sigurt se mbrojtja e besimtarëve të tyre jashtë vendit, me ndërmjetësinë e shtetit shqiptar dhe nëpërmjet klauzolës së marrëveshjes së bashkëpunimit, është një shtysë për projektin e atyre që luftojnë edhe për bashkimin politik të Shqipërisë etnike. Si rezultat, norma që duhej të ishte mjet i afirmimit të 'shqiptarisë' territoriale, kthehet në mjet që dobëson identitetin kombëtar.

<sup>561</sup> T. BLUSHI, *Kreu i Bektashinjve: Po më kërcënojnë me jetë*, "Gazeta Shqiptare on line", 29 shtator 2011. <http://www.balkanweb.com/gazetav5/artikull.php?id=104861>.

E pasigurtë duket edhe mbrojtja e lirisë fetare për ungjillorët në Mal të Zi, por prania e tyre nuk shtrihet në hapësirat shqipfolëse të vendit<sup>562</sup>. Komuniteti më i qëndrueshëm ndodhet në Juglindje, veçanërisht në Ulqin, por këtu nuk është regjistruar asnjë komunitet ungjillor dhe as bektashian, e për më tepër nuk ka përputhje mes përkatësisë fetare dhe asaj etnike. I njëjti gjykim vlen për Çamërinë, krahinë që ndodhet në Jug të Shqipërisë, nën territorin grek.

Fakti që këto territore nuk janë pjesë e sovranitetit shqiptar, ka bërë që, me kalimin e kohës, të kushtëzohet sjellja dhe perceptimi i vlerave dhe lirive fetare në mesin e këtyre popullsive, të cilave u ka munguar roli pedagogjik i së drejtës, i kulturës dhe marrëdhënieve shoqërore që mbizotëron në territorin e shtetit shqiptar, dhe për rrjedhojë, sot shohim të gatuhet në kazanin ballkanik kësi përplasjesh të pareshtura ndër-etnike dhe ndër-fetare. Nuk ka si të shpjegohet ndryshe dhe më bindshëm kjo sjellje kaq e ndryshme kolektive, në një kontekst në të cilin përqindja e përkatësive fetare është e njëjtë me atë në territorin e shtetit shqiptar, e megjithatë ekzistojnë lidhje kaq të thella kulturore dhe fetare mes këtyre trevave.

Pas krizës dhe shpërbërjes së Federatës Jugosllave, komuniteti ndërkombëtar, e veçanërisht, Këshilli i Europës, NATO dhe OKB-ja kanë marrë mbi vete përgjegjësinë politike për mirë-administrimin e këtyre territoreve. E pra, pas një bilanci kaq dëshpërues, nuk ta rrok mendja se si mund të marrë përsipër Komisioni i Venecias dhe Këshilli i Europës të ngrihen si gjykatës dhe si ente që diktojnë rrugën dhe shpërndajnë këshilla për hartimin e legjislacioneve që

---

<sup>562</sup> Në ditët e sotme, marrëdhëniet me besimet fetare në Mal të Zi karakterizohen nga tensione të forta dhe përshkallëzim të konfliktit, pasi priftërinjtë ortodoksë të Kishës serbe iu kundërvunë dëshmitarëve të Jehovahit të cilët, pasi kishin siguruar lejen e autorizimit, organizuan në Danilovgrad një ceremoni publike në përkujtim të një bashkëbesimtari të tyre. Tubimi u ndërpre menjëherë nga priftërinjtë ortodoksë, të shumtë në numër, të cilët kërkonin me zë të lartë ndërprerjen e menjëhershme të mbledhjes, duke i kërcënuar të pranishmit, se nëse do të mblidheshin sërish, ata do t'i vinin flakën godinës dhe pjesëtarëve që ishin aty në mbledhje. Ref.: *Montenegro: Commemorazione dei Testimoni di Geova interrotta dal clero della Chiesa Ortodossa Serba*, 22 aprile 2011, <http://www.cristianitestimonidigeova.net/articolo.aspx?Articolo=1882>

do të jenë busulla për fashitjen e konflikteve ndërfaqetare dhe garant i të drejtave, lirisë fetare dhe paqes.

Padyshim, është e gabuar bindja se mund të ndërtohen në mënyrë abstrakte disa modele, qofshin këto edhe fryt i përvojave të sistemeve politikisht më të besueshme, meqë i përkasin Europës Perëndimore dhe akoma më e gabuar ideja e transplantimit të këtyre modeleve, me bindjen se njëtrajtësimi i rregullave përbën garanci si për afirmimin e të drejtave njerëzore, ashtu edhe për parimet e së drejtës dhe të lirisë fetare. Të ndjekësh shtigje të tilla, do të thotë se ka një koncept të gabuar lidhur me ekzistencën e pluralizmit fetar në një kontekst pluri-kulturor, që ndërlikohet edhe më shumë nga ndërthurja e etnive të ndryshme, të cilat i ruajnë me shumë fanatizëm traditat, gjuhën dhe zakonet e veta. Çdo grup shoqëror dhe fetar mbart me vete përvojën, traditën, zakonet rituale, sjelljet etike e të gjitha këto gjejnë shprehjen e vet në art, kulturë, në festime, tradita, madje përthyhen edhe në kapërcimin e fazave të jetës: lindjes, martesës, vdekjes, pra, kanë të bëjnë jo vetëm me të drejtat e individit për çështje pasurie e trashëgimie, por edhe me shpërndarjen e të mirave të fituara nga martesa e madje edhe me ceremonitë mortore. Është kjo arsyeja që, jo aq besimet fetare, por traditat, zakonet kulturore-fetare, ritet, festimet, janë ato që duhet të zënë vend në hartimin e legjislacioneve. Këto nuk duhet të ngjeshin, dosido, rregullore 'uniformë', por t'u përmbahen normave të grupit përkatës, në mënyrë që gjithë sa u takon individëve, të përpunohet në normë për grupet shoqërore. Ligji duhet t'u sigurojë atyre ndarjen mes shtetit dhe besimit; laicitetin e institucioneve publike; ekzistencën e një entiteti shtetëror mbi palët, laik dhe të pavarur; interesin e përbashkët që justifikon ekzistencën e kësaj strukture shtetërore; ngritjen e atij sistemi që garanton lirinë e individëve dhe të grupeve, në respekt të plotë e të ndërsjellë mes tyre.

Kur bëhet fjalë për rregullim dhe strukturim marrëdhëniesh, vështirë të gesh hapësirë për transplant formantësh të jashtëm apo modelesh të gatshme, por do të ishte e udhës të kryhej një gjurmim historiko-juridik i evoluimit të sistemit, i cili, në rrjedhë të kohës, përpunon juridiksionin e vet mbi atë territor. Vetëm kështu mund të zbulohen tiparet dhe përvoja dalluese e sistemeve të ndryshme juridike, që, duke u ndërthurur me frytin e negociatave të sotme, mund të shkrihen e të sjellin ndryshimin e

nevojshëm për t'iu përgjigjur ritmit të marrëdhënieve të sotme shoqërore, kulturore dhe ndërvepruese që janë termometri matës i marrëdhënieve dialektike mes institucioneve, territorit dhe qytetarëve.

Pra, duhet kapërcyer prova e pjekurisë institucionale për të dalë tej logjikës së modeleve të gatshme, duhen lënë pas burokracitë e organizmave ndërkombëtare, qëndrimet shabllone kulturore dhe juridike, në mënyrë që t'u gjendet zgjidhje mosmarrëveshjeve mes palëve në konflikt.

Komuniteti ndërkombëtar mund t'i ngrejë në nivelin e duhur rolin dhe kërkesat e tij, nëse dikton një katalog të drejtash të negociuara dhe të negociueshme, aq të nevojshme për ndërvarësinë e sistemeve ekonomive, marrëdhënieve kulturore dhe nevojës për bashkëjetesë të paqme. Por, s'mund të ketë pikënisje tjetër, veç njohjes së identitetit dhe të së shkuarës që nënkuptojnë trashëgiminë e patjetërsueshme të individëve dhe mbarë kolektivit.

Ashtu si individët që nuk mund të integrohen dhe t'i afrohen tjetrit pa fituar më parë sigurinë e brendshme, po ashtu sistemet, që janë shprehje e lidhjes shoqërore në një territor të caktuar me traditat dhe historinë e vet, nuk mund ta shkrehin identitetin, t'i shembin shtyllat e ekzistencës së tyre dhe as të trazojnë harmoninë e brendshme, pa humbur më parë aftësinë e perceptimit dhe të përpunimit të institucioneve dhe zotësinë për t'u bërë ballë problemeve të ndryshme që dalin në shteg. Ashtu si njeriu që pa të shkuar nuk mund të ketë personalitet, bash ashtu sistemi që i bie mohit historisë së vet nuk mund të qëndrojë dhe as ta përmbushë funksionin e tij kryesor që është garantimi i bashkëjetesës së lirë mes grupeve të ndryshme.

#### 4. 6. Marrëveshjet bashkëpunuese: model i eksportueshëm?

Duke marrë parasysh ngërçet e sipërpërmendura, që sjell procesi i fabrikimit të modeleve institucionale dhe juridike dhe rrezikun e transplantimeve të kota dhe të dëmshme të përvojave të disave mbi ca të tjerë, është me vend të shtrojmë pyetjen nëse modeli shqiptar për marrëdhëniet mes shtetit dhe komuniteteve fetare, mund të jetë një rast i mirë reflektimi dhe përsiatjeje për ata që duan t'u japin zgjidhje paqësisht konflikteve ndërfitare mes grupeve të ndryshme e sidomos kur përplasjet fetare shoqërohen edhe me konflikte etnike. Edhe më e ndërlikuar paraqitet gjendja kur, me kalimin e kohës, grupe të ndryshme, ngrenë, sipas pëlqimit të vet strukturën e komunitetit, duke i gërshetuar tiparet fetare me ato etnike dhe gjuhësore, deri në krijimin e një identiteti vetjak. Nëse hedhim sytë mbi Ballkanin Perëndimor e, konkretisht, mbi rregullimin ligjor të çështjes fetare, vërejmë se Këshilli i Europës, me ndërmjetësinë e Komisionit të Venecias u ka “sugjeruar” Maqedonisë dhe Kosovës t'i njohin besimet e ndryshme fetare duke ndjekur rrugën e ligjit. Kjo nënkupton t'i lihet dorë e lirë shtetit për zgjidhje të njëanshme, si për mënyrën, ashtu dhe për kohën e përfshirjes së komuniteteve fetare në qerthullin demokratik dhe kjo bëhet në padije të plotë, jo aq për natyrën e besimit, sa për organizmin e ndërlikuar të komunitetit, madje kjo punë u besohet disave, duke shpërfillur pavarësinë e grupeve shoqërore dhe aftësinë e tyre për formësimin e identitetit vetjak.

Ka gjasa që frymëzimi për kësi zgjidhjesh, të ketë ardhur nga modeli i huazuar nga Belgjika, vend tipik për ndarjet në bazë të gjuhës dhe etnisë, çka u ka rezultuar më i përdorshmi për trevat ballkanike<sup>563</sup>, pikërisht për përafrinë e veçorive që mbartin.

---

<sup>563</sup> Pirja e organizmave ndërkombëtarë në përcaktimin e mënyrave dhe mjeteve për të sheshuar mosmarrëveshjet mes palëve, shpeshherë përqendrohet tek përdorimi i modeleve të huaja, përkundrejt traditës së vendit me të cilin po punojnë, duke i diktuar atij pranimin e formantëve të huaj për sistemin juridik në tërësi. Pjesa më e ndryshme dhe me pasoja më të rënda ndaj futjes së këtyre formantëve të huaj, është padyshim, ajo e besimeve fetare, sidomos kur ekzistenca e tyre lidhet ngushtësisht me karakteristikat e vendit. Një shembull i tillë është ai i Kosovës, ku organizmatat ndërkombëtarë, gjatë mandatit të tyre

Sigurisht që nuk ka munguar përqsja edhe me modele të tjera, për shembull, me atë bullgar në rastin e Republikës së Maqedonisë, model që, në kërkim të një zgjidhjeje për krijimin e kompaktësisë dhe njëtrajtësisë së brendshme të komuniteteve myslimane, u ka veshur atyre 'uniformën' e strukturës së mbarë komunitetit, duke shtypur dhe asgjësuar dallimet kulturore, që njëherë e një kohë ishin aq të larmishme mes tyre.

Këto zgjidhje u kushtëzuan nga prania e një feje dominuese në vend, asaj ortodokse dhe një shtrese domethënëse myslimane, pa folur për komunitetet etniko-fetare më të vogla në numër<sup>564</sup>. Për shkak të rolit të rëndësishëm që luan besimi ortodoks në Bullgari, dukuri kjo që haset në shumë treva ballkanike, është parë me vend rikthimi i modelit të qëmotshëm të mileteve, të cilin Perandoria Osmane e zbatonte për qeverisjen e komunitetit ortodoks, duke e përfshirë atë në punët e shtetit dhe të së drejtës.

Por, me garancinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, në Bullgari u krijua një strukturë e vetme dhe e detyrueshme komunitare për myslimanët, ku duhej të përfshiheshin të gjithë ata që i referoheshin besimit islam dhe etnisë turke<sup>565</sup>. Ky qëndrim

---

atje, kanë vepruar nën shembullin e modelit belg, duke anashkaluar traditën autoktone. Nuk përjashtohet fakti që në marrjen e këtij vendimi të ketë ndikuar fakti që shumica e juristëve të ngarkuar me këtë detyrë, ishin belg... . Për më tepër, lidhur me këtë çështje, shih: R. SACCO, *Sistemi giuridici comparati*, 2<sup>a</sup> ed., Torino, Utet, 2002; P. BISCARETTI DI RUFFIA, *Introduzione al diritto costituzionale comparato*, 6<sup>a</sup> ed., Milano, Giuffrè, 1988; G. G. BOGNETTI, *Introduzione al diritto costituzionale comparato*, Torino, Giappichelli, 1994; B. MARKESINIS, *Comparative Law in the Courtroom and Classroom. The story of the Last Thirty-Five Years*, Oxford-Portland Oregon, Hart Publ., 2003, trad. it., *Il metodo della comparazione. Il retaggio del passato e le sfide del futuro*, Giuffrè, Milano, 2004; L. PEGORARO, A. RINELLA, *Introducción al Derecho Publico Comparado*, UNAM, Ciudad de Mexico, 2006, e Palestra, Lima, 2006.

<sup>564</sup> Sipas regjistrimit të vitit 2002: 64% e popullsisë është e besimit ortodoks, prej së cilës, një pjesë i përket Kishës ortodokse autoqefale të Maqedonisë, të lindur në vitin 1967, ndërsa Kisha ortodokse serbe ka ndërtuar një grupim të vetin, që e ka marrë emrin nga arqidioqeza e Ohrit, me seli në këtë qytet. Myslimanët, të detyruar të jenë një komunitet i vetëm, përbëjnë 33,3% të popullsisë. Për më gjerë, shih: K. IVANOVA PETROVA, *La Corte Costituzionale della Repubblica macedone dichiara...cit.*, 3.

<sup>565</sup> Kemi parasysh këtu, traktatin e shën Stefanit, të firmosur mes Rusisë cariste dhe Perandorisë Osmane me 3 mars 1878, i cili i dha fund luftës dhe sanksionoi njohjen e pavarësisë së Serbisë, Malit të zi dhe Rumanisë nga ana e perandorisë

institucional u bazua në prirjen e besimit dominues ortodoks për t'u çliruar, një herë e mirë, nga barra e degëzimeve të ndryshme të islamit dhe pesha e ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit të tyre, duke ia prerë kështu hovin dinamizmit dhe përtëritjes së tyre kulturore, me qëllimin (ndoshta, politikisht të goditur) që ta shpinte komunitetin islam drejt asimilimit gradual, pikërisht falë humbjes së avashtë të identitetit të tij.

Si përfundim, pjesa më e madhe e komunitetit turko-islam të Bullgarisë nuk pa rrugë tjetër, veçse t'i kthente sytë nga Turqia për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, por kjo shkaktoi jo pak tensione politike, revansh dhe një gjendje krize të mbërthyer nga ksenofobia anti-islame, sa herë që komuniteti mysliman rritej dhe shkonte deri aty sa të vinte në dyshim kufirin e nënshtrimit të tij absolut ndaj shumicës ortodokse<sup>566</sup>.

---

osmane. Me nenin 11 të traktatit të shën Stefanit, Bullgaria garanton se pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të myslimanëve që banojnë në këtë vend, mbeten pasuri e myslimanëve dhe se në kushtetutën që do të miratohet, do të garantohen të drejtat e tyre. Klauzolat e traktatit në favor të Ruisë u kundërshtuan nga Anglia dhe Austro-Hungaria, të cilat propozuan modifikimet e mundshme gjatë mbajtjes së Kongresit të Berlinit gjatë muajve qershor-korrik të vitit 1878. Ky kongres u mbyll me traktatin e Berlinit që u nënshkrua më 13 korrik 1878 nga Mbretëria e Bashkuar, Perandoria Austro-Hungareze, Franca, Gjermania, Rusia dhe Perandoria Osmane.

<sup>566</sup> Në kohën e pavarësisë, besimtarët islamë përbënin 34% të popullsisë bullgare, por shumë turq vendosën të emigronin në Turqi, ndërsa të tjerët u mbyllën në komunitetet e tyre etniko-fetare. Neni 42 i Kushtetutës së Tirnovos të vitit 1879, pohon se veprimtaria fetare e të krishterëve që nuk predikojnë krishtërimin ortodoks dhe ajo e heterodoksëve (të pafeve) rregullohet nga autoritetet kishtare përkatëse, por nën mbikqyrjen e Ministrisë që i është ngarkuar kjo detyrë, si dhe në bazë të ligjeve që pritet të miratohen për çështjen në falë. Конституция на българското княжество, Приета на 16.04.1879 г. <http://licodu.cois.it/127/view>.

Me këtë rast, miratohet një *Rregullore e përkohshme për veprimtarinë fetare të krishterëve, myslimanëve dhe hebrejve* 1880. Привременни правила за духовното управление на христијаните, мюсюлманите и евреите 1880, Дв. 56 от 9.VII.1880. Me kalimin e kohës, bëhet e qartë se nuk mjafton vetëm një normë e përgjithshme për të rregulluar jetën e komunitetit mysliman, por duhej të kalonin 15 vite, për të mbërritur në nënshkrimin e një *Rregulloreje të përkohshme për veprimtarinë fetare të myslimanëve* e cila do të merrej me aktivitetet e këtij besimi dhe do të përcaktonte strukturën etij. Shih: *Временни правила за духовното управление на мюсюлманите* 1895, Дв. 210 от 26.IX.1895.

Për statutet, si fryt i veprimtarisë normative të pavarur të komunitetit mysliman të Bullgarisë, shih: <http://licodu.cois.it/4/9/3>. Për një krahasim mes modelit të



Një “zgjidhje” e tillë krijon vazhdimisht një gjendje të paqëndrueshme, e cila prodhon kriza të njëpasnjëshme përballë ndryshimit të ekuilibrave mes shtresave të ndryshme shoqërore, prandaj sa më gjatë të funksionojë sistemi i garancive dhe sa më shumë të rritet komuniteti mysliman, aq më shumë piqen kushtet për një krizë të re dhe shtohet nevoja për shfryrjen e numrit të popullsisë së tij nëpërmjet dëbimit të disave.

Për më tepër, kush e ka mbështetur dhe vazhdon ende ta mbështesë këtë tezë, harron se kjo mund të japë rezultat aty për aty, sidomos në ato vende ku islami është në pakicë, si, për shembull, në Bullgari, ku u jepet përkohësisht zgjidhje krizave, sadoqë duke sakrifikuar interesat e një shtrese të popullsisë, por kjo tezë është krejt e pavend aty ku popullsia islame përbën shumicën, si në Kosovë, por as aty ku grupet etniko-fetare që përbëjnë shumicën relative janë të përcarë së brendshmi dhe aq më pak në Maqedoni ku islami është në shumicë, por grupet minoritare janë në rritje të vazhdueshme demografike, dukuri kjo që lidhet me nevojën për të mbrojtur identitetin etniko-fetar<sup>567</sup>.

---

Bullgarisë dhe Shqipërisë për marrëdhëniet mes shtetit dhe komunitetit fetar, shih: G. CIMBALO, *L'esperienza dell'Islam dell'Est Europa come contributo a una regolamentazione condivisa...cit.*, 71-104.

<sup>567</sup> Përdorimi i krahasimit e, sidomos, shartimi i modeleve dhe i formantëve të sistemeve të ndryshme është një punë delikate që kërkon studim të thelluar të traditave juridike, të kontekstit historik, politik, të përbërjes etniko-fetar të popullsisë, elemente këto të një rëndësie të parë për garantimin e efektshmërisë së modelit të ri institucional. Mënjanimi apo vlerësimi i gabuar, qoftë edhe i disa elementeve, mund të prodhojë pakënaqësi të mëdha që mund të degjenerojnë në luftëra civile apo të prodhojnë kriza institucionale. Lidhur me këto probleme, shih: R. DAVID, C. JAUFFRET-SPINOSI, *Les grands systèmes de droit contemporains*, Paris, Dalloz, 2002; G. LOMBARDI, *Premesse al corso di diritto pubblico comparato. Problemi di metodo*, Milano, Giuffrè 1986; A. PIZZORUSSO, *Sistemi giuridici comparati*, Milano, Giuffrè, 1995; G. DE VERGOTTINI, *Diritto costituzionale comparato*, Padova, 2007.

Për një krahasim të marrëdhënive të shtetit me kishën dhe besimeve/komuniteteve fetare, shih: F. ONIDA, *L'interesse della comparazione negli studi di Diritto Ecclesiastico, La legislazione ecclesiastica*, in *Atti del Congresso celebrativo del centenario delle leggi amministrative si unificazione*, Vicenza, ISAP, 1967, 603 ss.; MARGIOTTA BROGLIO F., MIRABELLI C., ONIDA F., *Religioni e sistemi giuridici. Introduzione al Diritto Ecclesiastico Comparato*, il Mulino, Bologna, 2004, *passim*.

Pra, kjo rrugë mund të shpjerë drejt detyrimeve që diktojnë konvergjenca dhe bashkëjetesë të detyrueshme, si mes myslimanëve, ashtu edhe mes ortodoksëve aq më tepër kur bëhet fjalë për dallime të kahershme brenda një komuniteti, prandaj të gjitha këto shndërrohen në burim konfliktesh ndërfitare dhe ndërretnike e për pasojë në piketimin e caqeve ku janë të shtrënguar të qëndrojnë grupet etniko fetare, ndërkohë që përreth tyre vazhdon pastrimi etnik nga njëra palë besimtarësh kundrejt palës tjetër që i konkuron ata.

Krijimi i këtyre enklavave me strukturë homogjene, bie ndesh me nënsistemet fetare që nuk gëzojnë farë mbështetjeje juridike, për sa kohë komunitetet etniko-fetare përdoren si kafaze për të kyçur aty grupe të ndryshme popullsish, gjë që, me kalimin e kohës, degjeneron në luftë civile.

Përvojat që mbërrijnë nga vende të ndryshme do të na këshillonin një model pluralizmi fetar, ku çdo komuniteti t'i jepej mundësia për t'u organizuar rreth parimeve të veta, duke e pranuar pluralizmin fetar si një prej modeleve të sistemit juridik, i cili, duhet ngritur në përputhje me historinë dhe traditat fetare të shumë prej këtyre popujve.

Kjo ka gjetur shprehjen e vet në Shqipëri, ku modeli i marrëdhënieve, i bazuar në negociatat mes shtetit dhe secilit grup fetar, ka për rezultat bashkëjetesën në diversitet, çka ushqehet nga parimet e laicitetit, të ndarjes dhe të pluralizmit. Një prej arsyeve që e ka bërë të mundur këtë, është struktura e islamit shqiptar, natyra e tij pluraliste dhe respekti ndaj degëzimeve fetare në brendësi, por edhe jashtë tij.

Pra, duket shpresëdhënëse dhe e dobishme analiza që kemi bërë, nëse ka interes për kapjen e aspekteve të veçanta të sistemit të marrëdhënieve, i cili tërheq vëmendjen mbi një tregues aq të rëndësishëm që është përkujdesja maksimale ndaj diversitetit. Vetëm kjo e shmang formimin e kotë dhe të dëmshëm të grupeve kundërshtarë, siç po ndodh me sistemin italian që pretendon t'i japë zgjidhje shfaqjes së islamit në Itali, duke i konsideruar besimtarët islamë si një gjë e vetme dhe duke i shtrënguar ata të gjejnë vend brenda një strukture unike fetare, nëse pretendojnë që një ditë të fitojnë nënshkrimin e marrëveshjes. Ka gjasa që interesi i përbashkët për zgjerimin e të drejtave dhe lirive fetare, t'i shtyjë

përbërësit e ndryshëm islamë të gjejnë një gjuhë të përbashkët, por padyshim, kjo do të sjellë me vete dy pasoja: forcimin e grupeve më të organizuara e më të pasura ekonomikisht dhe dërrmimin e atyre identiteteve që do të kërkojnë mëvetësinë e tyre e kjo do të çojë drejt konflikteve ndërfaqetare; por, ndoshta, ky mund të jetë synim politik për ndonjë që është i dhënë pas teknikave të sprovuara si prodhuese konfliktesh!

Nëse hidhet shikimi mbi ndryshimin e përbërjes etnike dhe fetare të popujve të Europës dhe ndryshimeve që sjell me vete lëvizja e pandalshme e emigrantëve, nëse mbahet parasysh larmishmëria e përvojave, përhapja dhe ndikimet në gjuhë dhe mendim, zhvillimi dhe transformimi i ndjeshmërisë, atëherë do të kuptohet që e ardhmja i përket pluralizmit dhe tolerancës, përpjekjes për ta bërë të mundshme bashkëjetesën që duhet qeverisur nga një laicizëm i plotë<sup>568</sup>.

Përpjekja për të ruajtur, me çdo kusht, homogjenitetin territorial, sidomos kur shoqërohet me spastrime etnike, s'do të sjellë gjë tjetër veç ndarjeve dhe urrejtjes, në mos një të ardhme plot konflikte.

Mosmarrëveshje të tilla janë plagë të pashërueshme që, edhe nëse fashiten gjatë një breznie, rilindin, me t'u krijuar kushtet e nevojshme, qoftë edhe falë mbajtjes gjallë të një miti apo gojëdhënave që kapërcejnë brezni të tëra. Kujtimi i tmerreve mund të zbehet, por nuk mund të zhbëhet dhimbja e nëpërkëmbjes dhe dëshira për t'iu rikthyer epërsisë së mohuar.

Në ditët e sotme, kur panorama fetare është kaq e ndërlikuar jo vetëm nga trashëgimia e rënduar historike, por edhe nga përhapja e sotme e kulteve të reja që kërkojnë të drejtën e shtetësisë nga Lindja në Perëndim, bankëprova e vërtetë e sistemeve të marrëdhënies mes shtetit dhe komuniteteve fetare gjendet në

---

<sup>568</sup> Për më tepër, shih: G. CIMBALO, *Laicità come strumento di educazione alla convivenza. Laicità e diritto*, (a cura di S. Canestrari) Bologna, Bononia University Press, 2007, 269-313.; ID., *L'incidenza del diritto dell'Unione europea sul diritto ecclesiastico*-Verso un "Diritto Ecclesiastico" della Comunità europea in, *L'incidenza del diritto dell'Unione europea sullo studio delle discipline giuridiche nel cinquantesimo della firma del Trattato di Roma*. Aktet e kongresit të mbajtur në nder të pesëdhjetë vjetorit të Bashkimit Europian dhe të Traktateve të Romës. (Bologna. 16 mars 2007), Napoli, Editoriale Scientifica, 2008, 213-239.

trevat kufitare të Ballkanit, i cili gjithmonë ka qenë kryqëzim i paqes dhe i luftës në Europë.

Këtu, si kudo, përvoja shqiptare mund të na vlejë shumë.



## Bibliografia

“Annali della Congregazione della missione e della Compagnia delle figlie della carità”, Siena, 1940, XLII.

“Annuario pontificio”, 1994, 1729-1730.

“Annuario pontificio”, 2000, 1942-1943.

Aa.Vv., Bibla shqip dhe tradita, Tiranë, Toena, 2004.

Aa.Vv., Historia e Partisë së punës të Shqipërisë, Tiranë, 1968.

Aa.Vv., Historia e popullit shqiptar, Tiranë, 1994.

Aa.Vv., Historia e Shqipërisë, Tiranë, 1999.

Aa.Vv., Historia e Shqipërisë, IV, Tiranë, 1983.

Aa.Vv., Simposio internazionale, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër, 2000.

Agenzia Fides, Le missioni cattoliche dipendenti dalla Sacra Congregazione de propaganda fide. Cenni geografici e storici. Dati statistici, Roma, Consiglio superiore della Pontificia Opera della propagazione della fede, 1946.

Ajani G., Diritto dell'Europa Orientale, Torino, UTET, 1996.

Ajani G., Il modello post-socialista, Torino, Giappichelli, 2008.

Albanisches Institut. Imzot Lazër Mjeda, mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar, St. Gallen, 2011.

Alb Juris, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me interpretime të gjykatës kushtetuese, Tiranë, 2008.

Aldeeb Abu-Sahlieh S.A., Il diritto islamico. Fondamenti, fonti, istituzioni, (ed. it. a cura di Marta Arena), Roma, Carocci, 2008.

Alfeyev H., La nozione di territorio canonico nella tradizione ortodossa, in *O Odigos*, 3, 2006.

Alia R., Jeta ime, Tiranë, Toena, 2010.

Allam K.F., L'islam globale, Milano, Rizzoli, 2002.

- Aluffi Beck-Peccoz R., Zincone G. (eds.), *The legal treatment of Islamic minorities in Europe*, Leuven, Peeters, 2004.
- Ambrosio A.F., *Dervisci: storia, antropologia, mistica*, Roma, Carocci, 2011.
- Andre P., *Contribution à l'étude de Confréries religieuses musulmanes*, Alger, Les Maison des Livres, 1956.
- Angeli Murzacu I., *Tutto a tutti. La nuova missione di evangelizzazione della Chiesa Cattolica e società sotterranea ai tempi del comunismo, Il fondo Ricci e le sue fonti per una storia delle religioni in Europa Orientale*, Bologna, Clueb, 2009.
- Angeli Murzacu I., *Returning home to Rome. The Basilian monks of Rottaferrata in Albania*, Grottaferrata, Αναλεκτα Κρυπτοφερρησ, 2009.
- Arinelli E., Scotto G., *La guerra del Kosovo. Anatomia di un'escalation*, Roma, Editori Riuniti, 1999.
- Asthor E., *Storia economica e sociale del vicino oriente nel Medioevo*, Torino, Einaudi, 1982.
- Babeau A. *Les conseils ouvriers en Pologne*, Paris, A. Colin, 1960.
- Baer G., *The Waqf as a Prop for the Social System (Sixteenth-Twentieth Centuries)*, in *Islamic Law and Society*, vol. 4, n. 3, 1997, Leiden, Brill.
- Baldacci A., *Il francescanesimo in Albania e il padre Giorgio Fishta*, in *Studi speciali albanesi, III*, Roma, Stabilimento tipografico F. Damasco, 1937.
- Barberini G., *La libertà di religione nel processo di democratizzazione degli Stati dell'Europa centrale ed orientale*, in Ferrari S., Cole Durham Jr. W., Sewell E.A., *Diritto e religione nell'Europa postcomunista*, Bologna, il Mulino, 2004.
- Barberini G., *Al di là della cortina di ferro. Ricordi di un viaggiatore solitario*, Perugia, Volumnia, 2005.
- Barberini G., *L'Ostpolitik della Santa Sede. Un dialogo lungo e faticoso*, Bologna, il Mulino, 2007.
- Barberini G., *Libertà di religione nell'Europa centro-orientale. Spunti di riflessione*, in Cimbalò G., Botti F. (a cura di), *Libertà religiosa e diritti umani nell'Est Europa*, Bologna, Bononia University Press, 2008.
- Barberini G., *Stato e religione nel processo di democratizzazione dei Paesi europei postcomunisti*, in "Stato, Chiese e pluralismo confessionale", *Rivista telematica*, prill 2009.

- Barberini G., La libertà religiosa nell'Europa centro-orientale, in Possenti V. (a cura di), *Diritti umani e libertà religiosa*, Soveria Mannelli, Rubbettino, 2010.
- Barberini G., *Pagine di storia contemporanea. La Santa Sede alla Conferenza di Helsinki*, Siena, Cantagalli, 2010.
- Barberini G. (a cura di), *La Politica del dialogo. Le carte Casaroli sull'Ostpolitik vaticana*, Bologna, il Mulino, 2008.
- Baze N., Leka i Parë, firmëtarë i 20 000-të kundër reg jistrimit të popullsisë, Tema on line, 16 prill.
- Beduli D.H., *Kisha ortodokse autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, Tiranë, 1992.
- Benar S., *Fan Nolin, siç e kam njohur*, Tiranë, Dituria, 1997.
- Benbassa E., Rodriguez A., *Les Juifs des Balkans, Espace Judeo-iberiques XIV-XX siècles* Paris, La Découverte, 1993.
- Beqaj R., *Veprimtaria armiqësore e klerit katolik në Shqipëri 1945-1967*, Tiranë, 1973.
- Bertola A., *Il regime dei culti in Turchia. I. Il sistema giuridico dei culti nell'Impero ottomano*, Torino, SEI, 1927.
- Bertuccioli B., *Raccolta di provvedimenti di carattere legislativo riguardanti l'Albania*, Roma, Ministero affari esteri, 1941.
- Biagini A., *Storia dell'Albania dall'origine ai nostri giorni*, Milano, Bompiani, 1998.
- Biberaj E., *Shqipëria në tranzicion: rruga e vështirë drejt demokracisë*, Tiranë, Ora, 2000.
- Biscaretti Di Ruffia P., *Introduzione al diritto costituzionale comparato*, Milano Giuffrè, 1988, 6a ed.
- Bognetti G.G., *Introduzione al diritto costituzionale comparato*, Torino, Giappichelli, 1994.
- Bordini J., *Dhjetë vjet në burg në Shqipëri 1945-1955*, Tiranë, 1992.
- Botti F., *Le confessioni religiose e il principio di sussidiarietà nell'Unione europea: un nuovo giurisdizionalismo attraverso il mercato*, in "Stato, Chiese e pluralismo confessionale", *Rivista telematica*, gennaio 2011.
- Bottoni R., *Il principio di laicità in Turchia. Profili storico-giuridici*, Milano, Vita e Pensiero, 2012.



- Bougarel X., Clayer N. (sous la direction de), *Le nouvel Islam balkanique. Les musulmans, acteurs du postcommunisme (1990-2000)*, Paris, Maisonneuve & Larousse, 2001.
- Bousquet G.H., Notes sur les reforme de l'Islam albanais, in *Révue du monde musulman*, 4, 1935.
- Brazzo L., Dall'Impero agli Stati. Gli ebrei nei Balcani e in Albania fra la seconda metà dell'Ottocento e la vigilia della Seconda guerra mondiale, in Brazzo L., Sarfatti M. (a cura di), *Gli ebrei in Albania sotto il fascismo. Una storia da ricostruire*, Firenze, Giuntina, 2010.
- Brown J., *The Darvishes on Oriental Spiritualism*, Oxford University Press, Oxford 1927.
- Bucciol E., *Albania fronte dimenticato della guerra*, Portogruaro, Ediciclo, 2001.
- Cahen C., Reflexion sur le waqf ancien, in *Studia Islamica*, XIV, 1961.
- Cairolì P., La Congregazione de propaganda fide: sua figura e sue attribuzioni, in *Rivista di studi missionari*, IV, 1922, 4.
- 70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, simpozium, Tiranë, 19 shtator, 1992.
- Capogreco C.S., Ferramonti. La vita e gli uomini del più grande campo di internamento fascista (1940-1945), Firenze, La Giuntina, 1987.
- Capogreco C.S., I profughi ebrei rastrellati in Montenegro nel luglio del 1941 e il loro internamento in Albania e in Italia, in Brazzo L., Sarfatti M. (a cura di), *Gli ebrei in Albania sotto il fascismo. Una storia da ricostruire*, Firenze, Giuntina, 2010.
- Carulli Fumagalli O., Lo Stato albanese e le Comunità religiose, in *Jus*, LI, janar-prill 2004.
- Castro F., *Il modello islamico*, Torino, Giappichelli, 2007.
- Castro F., *Diritto musulmano*, in *Digesto nelle discipline privatistiche: sezione civile*, vol. 6, Torino, UTET, 1994.
- Castro Jover A., *Las minorías religiosas en el derecho español. Cursos de Derechos Humanos de Donostia-San Sebastián*, Bilbao, Juan De Soroeta Licerias, 1999.
- Cavalli F., *Persecuzione religiosa nell'Albania comunista*, in *La Civiltà Cattolica*, 7.6.1947.
- Centre for European Policy Studies, *The CEPS plan for the Balkans*, (eds. M. Emerson, D. Gross), Bruxelles, CEPES, 1999.

Chossudovsky M., *La crisi albanese*, Torino, Edizioni Gruppo Abele, 1998.

Cimbalo G., *Albania cristiana: cronistoria della missione latino orientale della Provincia patavina di S. Antonio dei frati minori conventuali*, Padova, Curia provinciale, 1985.

Cimbalo G., *I rapporti finanziari tra Stato e Confessioni religiose nei Paesi Bassi*, Milano, Giuffrè, 1989.

Cimbalo G., *Laicità come strumento di educazione alla convivenza*, in Canestrari S. (a cura di), *Laicità e diritto*, Bologna, Bononia University Press, 2007.

Cimbalo G., *L'incidenza del diritto dell'Unione europea sul diritto ecclesiastico. Verso un "Diritto Ecclesiastico" della Comunità europea*, in *L'incidenza del diritto dell'Unione europea sullo studio delle discipline giuridiche nel cinquantesimo della firma del Trattato di Roma*, Atti del Congresso organizzato per celebrare il cinquantenario dell'Unione Europea e dei Trattati di Roma (Bologna, 16 marzo 2007), Napoli, Editoriale Scientifica, 2008.

Cimbalo G., *Tutela individuale e collettiva della libertà di coscienza e modelli di relazione tra Stato e Confessioni religiose nei paesi dell'Est Europa*, in Cimbalo G., Bot- ti F. (a cura di), *Libertà religiosa e diritti umani nell'Est Europa*, Bologna, Bononia University Press, 2008.

Cimbalo G., *Le confraternite islamiche nei Balcani: un modello di Islam europeo plurale*, in *Daimon. Annuario di diritto comparato delle religioni*, Bologna, il Mulino 2009.

Cimbalo G., *Prime note sulla tutela penale dei culti nei Paesi dell'Est Europa*, in Leziroli G. (a cura di), *La Carta e la Corte. La tutela penale del fatto religioso fra normativa costituzionale e diritto vivente*, Atti del convegno, Ferrara, 27 tetor 2007, Cosenza, Pellegrini, 2009, 143-180.

Cimbalo G., *Integración de los migrantes: un Islam plural para Europa (Reelaboración de los rasgos ordinamentales de la noción de "culto" y de "confesión religiosa" desde la perspectiva de la UE)*, *Estudios sobre la integración de los inmigrantes*, (Enrique Álvarez Conde-Ana María Salazar dela Guerra Directores), Madrid, Instituto de Derecho Público, Universidad Rey Juan Carlos, 2010.

Cimbalo G., *Religione e diritti umani nelle società in transizione dell'Est Europa*, in Possenti V. (a cura di), *Diritti umani e libertà religiosa*, Soveria Mannelli, Rubbettino, 2010.

- Cimbalo G., Paqja fetare, dhuratë e shqiptarëve Europës, gazeta Shekulli, 23.02.2010, në: Shqipëri.com.
- Cimbalo G., Contributo allo studio dell'Islam in Europa. Aequitas sive Deus, in Studi in onore di Rinaldo Bertolino, Torino, Giappichelli, 2011.
- Cimbalo G., Il diritto ecclesiastico oggi: la territorializzazione dei diritti di libertà religiosa, in Il riformismo legislativo in diritto ecclesiastico e canonico, Cosenza, Pellegrini, 2011.
- Cimbalo G., L'Albania apre agli accordi di collaborazione con i "nuovi culti", in "Rivista Telematica, Stato, Chiese e pluralismo confessionale", tetor 2011.
- Cimbalo G., L'esperienza dell'Islam dell'Est Europa come contributo a una regolamentazione condivisa della libertà religiosa in Italia, in Aluffi Beck-Peccoz R. (a cura di), Identità religiosa e integrazione dei Musulmani in Italia e in Europa, omaggio alla memoria di Francesco Castro, Roma 22 maj 2008, Torino, Giappichelli, 2011.
- Clayer N., Le recours à l'"histoire" et à la "tradition" dans les recompositions identitaires et politiques albanaises, SOLIIS-URMIS, Université de Nice-Sophia Antipolis, 2000.
- Clement O., Un vicariat extraordinaire du Trone œcuménique en Europe occidentale, in Istina, t. 17, 1, 1972.
- Conferenza Episcopale d'Albania, Deklaratë e Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë mbi gjendjen aktuale në vend, Lezhë, 18 prill 1997.
- Constitución, leyes de libertad religiosa, acuerdos, derecho común, actas del I Congreso Internacional Hispano-Portugués, sobre Libertad Religiosa, León, 22-23 tetor, 2009, Universidad de León, León, 2010.
- Cordignano F., L'Albania attraverso l'opera e gli scritti di un grande missionario ita- liano: il P. Domenico Pasi SI (1847-1914), XXV, voll. 3, Roma, Istituto per l'Europa orientale, 1933-1934 (Pubblicazioni dell'Istituto per l'Europa orientale, s. II, Politica, storia, economia).
- D'Emilia A., Il waqf ahli secondo la dottrina di Abu Yusuf, Roma, Pubblicazioni dell'istituto di diritto romano, del diritto dell'oriente mediterraneo, 1938.
- Dalipaj A., Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Kishën ortodokse 1945-1967, Tiranë, 1992.
- Dallas N., Le statut de la diaspora orthodoxe, in Istina, 1995.

- Dammacco G., Diritti e libertà dell'uomo nell'Albania democratica, in Parlato V., Varnier G.B. (a cura di), *Principio pattizio e realtà religiose minoritarie*, Torino, Giappichelli, 1995.
- Dammacco G., Costituzione, processo democratico e libertà religiosa nei Balcani, in Tedeschi M. (a cura di), *La libertà religiosa*, tomo III, Soveria Mannelli, Rubbettino, 2002.
- Dammacco G., Note alla vigente legge Albanese sugli Enti Ecclesiastici, in *Iura Orientalia*, II, 2005.
- David R., Jauffret-Spinosi C., *Les grands systèmes de droit contemporains*, Paris, Dalloz, 2002.
- De Felice R., *Storia degli ebrei italiani sotto il fascismo*, Torino, Einaudi, 1993.
- De Oto A., Diritto e religione nella Repubblica ceca e in Slovacchia, in *Libertà di coscienza e diversità di appartenenza religiosa nell'Est Europa*, in Cimbalo G., Botti F. (a cura di), *Libertà religiosa e diritti umani nell'Est Europa*, Bologna, Bononia University Press, 2008.
- e Oto A., *Diritto e religione nell'Europa di Mezzo: la Repubblica Ceca*, Bologna, Bononia University Press, 2012.
- De Oto A., Pribyl S., Analisi delle relazioni tra Stato e chiese nell'ex-Cecoslovacchia e nell'odierna Repubblica ceca. La nuova legge in materia di chiese e società religiose, in *Il Dir. Eccl.*, n. 1/2004, 23.
- De Rada G., *Antichità della Nazione Albanese e sua affinità con gli Ellene i Latini*, Napoli, Stamp. dell'Industria, 1864.
- De Rapper G., Vakëf: lieux partagés du religieux en Albanie, in Albera D., Couroucli M. (ed.), *Religions traversées. Lieux saints partagés entre chrétiens, musulmans et juifs en Méditerranée*, Arles, Actes Sud, "Études méditerranéennes", 2009.
- De Vergottini G., *Diritto costituzionale comparato*, Padova, Cedam, 2007.
- Del Re N., *La Curia romana. Lineamenti storico-giuridici*, Roma, Edizioni di storia e letteratura, 1970.
- Del Tufo M., *Le riforme penali nei paesi dell'Est: uno sguardo di sintesi. Il diritto penale nella prospettiva europea*, Milano, Giuffrè, 2005.
- Dell'Erba N., *Storia dell'Albania*, Roma, Newton & Compton, 1997.
- Duizings G., *Religion and Identity in the Balkan*, London, 1999.

- Dumont P., Mustafa Kemal invente la Turquie moderne, Paris, Complexe, 1983.
- El-Bokhâri, Les traditions islamiques, traduites de l'arabe avec notes et index par O. Houdas et W. Marçais, vol. II, Paris, stampa anastatica, 1977.
- Elsie R., A dictionary of Albanian religion, mythology and folk culture, New York, New York University Press, 2001.
- Engelhardt E., La Turquie et le Tansimat ou histoire des réformes dans l'empire ottoman depuis, 1826 jusqu'à nos jours, vol. I, Paris, Cotillon et C.ie, 1882.
- Esslemont J.E., Bahá u' lláh and the New Era, Wilmette, Illinois, USA, Bahá'í Publishing Trust, 1980, 5a ed.
- Fabianić D., Schizzo storico sull'opera dei francescani in Albania, Shkodër, Tipografia francescana, 1930.
- Fabrizi A., Presenza istituzionale e pastorale cattolica in Europa, Soveria Mannelli, Rubbettino, 2011.
- Fabbricatore F., Il contributo arbërësh alla questione albanobalcantica, Castrovillari, Grafica Pollino, 2009.
- Faroqi S., L'Impero Ottomano, Bologna, il Mulino, 2008.
- Fattal A., Le statut légal des non-musulmans en pays d'Islam, Bayrou, Imprimerie catholique, 1958.
- Fedalto G., Dal Seicento ai nostri giorni, in Le Chiese d'Oriente, III, Milano, Jaca Book, 1995.
- Feliciani G., Le Conferenze episcopali nel magistero di Giovanni Paolo II, in Aggiornamenti Sociali, 38, 1987.
- Feliciani G., Episcopal Conferences from Vatican II to the 1983 Code, in The Jurist, 48, 1988.
- Feliciani G., Le Conferenze Episcopali dal Vaticano II al nuovo Codice di Diritto Canonico, in La Scuola Cattolica, 116, 1988.
- Feliciani G., Il potere normativo delle Conferenze Episcopali nella comunione ecclesiale, in Monitor Ecclesiasticus, 116, 1991.
- Feliciani G., Gli episcopati nuovi protagonisti delle relazioni tra la Chiesa e gli Stati, in Rivista periodica de re canonica, Pontificia Università Gregoriana, 89, 2000.
- Fernández-Coronado González A., Estado y confesiones religiosas, un nuevo modelo de relación: (los pactos con las confesiones: leyes 24, 25 y 26 de 1992), Madrid, Civitas Ediciones S.L., 1995.

- Fevziu B., Enver Hoxha-Biografi nga Blendi Fevziu, Tiranë, Uet/press, 2011.
- Filoramo G., Storia delle religioni. Islām, Bari, Laterza, 2005.
- Fiorita N., Il costituzionalismo islamico tra modello liberale e integralismo religioso, I diritti cultural-religiosi dall’Africa all’Europa, Torino Giappichelli, 2012, 85-104.
- Fischer B.J., King Zog and the struggle for stability in Albania, New York, Columbia University Press, 1984.
- Fischer B.J., Albania at War 1939-1945, West Lafayette, Indiana, Purdue University Press, 1999.
- Fishta I., Toçi V., Economia e Shqipërisë në vitet e para të ndërtimit socialist, nëntor 1944-1948, Tiranë, 1984.
- Folino F., Ferramonti. Un lager di Mussolini. Gli internati durante la guerra, Cosenza, Brenner, 1985.
- Fox G.H., Humanitarian Occupation, Cambridge, Cambridge University Press, 2008.
- Frigerio A., Budapest 1956. La macchina del fango, Torino, Landau, 2012.
- Gambaro A., Sistemi giuridici comparati, Trattato di Diritto Comparato, diretto da R. Sacco, Torino, UTET, 2002.
- Gibb H.A.R, Bowen H., Islamic Society and the west, I, II parte, London, Oxford University Press, 1950.
- N. Nika, L. Vorpsi (a cura di), Gli ebrei in Albania. Catalogo dei documenti dell’Archivio Centrale dello Stato della Repubblica d’Albania, Bari, Progesit, 2006.
- Grassi F.L., L’Italia e la questione turca 1919-1923. Opinione pubblica e politica estera, Torino, Zamorani, 1996.
- Grassi F.L., Atatürk. Il fondatore della Turchia moderna, Roma, Salerno, 2008.
- Grignaschi M., L’Impero ottomano e le minoranze religiose, in R. Traini (a cura di), Studi in onore di Francesco Gabrieli nel suo ottantesimo compleanno, Roma, Dipartimento di studi orientali dell’Università di Roma La Sapienza, 1984.
- Grigorita G., Il concetto di ecclesia sui iuris. Un’indagine storica, giuridica e canonica, Roma, 2007.

- Guidetti A., *Gesuiti in Albania. Apostolato, cultura, martirio nel 50° anniversario del martirio dei Padri Giovanni Fausti e Daniel Dajani (1946-1996)*, [Milano], San Fedele, 1996.
- Guidetti V.L., *L'Islam vicino. I Bektashi*, Cosenza, Lionello Giordano, 2009.
- Gulçiçek D., *Bektashizmi në Shqipëri*, Haçi, 2000.
- Gurga G., *Dorëshkrimi i pabotuar i "Anonimit Epirot"*, in F. Di Miceli, M. Mandalà (a cura di), *Studi in onore di Antonino Guzzetta*, Palermo, Helix, 2002.
- Hako H., *Feja e parë në dritën e shkencës*, Tiranë, 1962.
- Hoxha E., *Opera*, Naim Frashëri, Tiranë, 1971.
- Hoxha E., *Kur lindi Partia*, Tiranë, 8 nëntori, 1981.
- Hoxha I.D., *Refo Çapari: Çaparenjtë*, Tiranë, Toena, 2006.
- Hulsi H., *Ateizmi shkecor*, Tiranë, SHBLU, 1983.
- Hyseni A., *Të drejtat e njeriut në kushtetutën Shqiptare*, Tiranë, Dita, 2000.
- Hysi S., *Myslimanizmi në Shqipëri 1945-1950*, Tiranë, Mësonjtorja e parë, 2000.
- Hysi S., *Histori e komuniteteve fetare shqiptare*, Tiranë, Mësonjtorja e parë, 2006.
- Ianari V., *L'eclissi del califfato e i nazionalismi islamici*, in *Ricerche di storia sociale e religiosa*, 35 1989.
- Iljaz G., *Veprimtaria reaksionare e klerit katolik në fushën e arsimit*, Tiranë, 1978.
- Ingravallo I., *Il Consiglio di Sicurezza e l'amministrazione diretta di territori*, Napoli, Editoriale Scientifica, 2008.
- Ivanova Petrova K., *La Corte Costituzionale della Repubblica macedone dichiara illegittimo l'insegnamento della religione nella scuola pubblica*, in *Stato Chiese e pluralismo confessionale*, qershor, 2009.
- Jacomoni di San Savino F., *La politica dell'Italia in Albania*, Nelle testimonianze del Luogotenente del Re, Rocca San Casciano, Cappelli Editore, 1965.
- Jaques E., *Shqiptarët*, Istanbul, Karté e Pendë, 1996.
- Javis C., *The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes*, in *Finance & Development*, vol. 37, n. 1, March 2000.

- Jotga N., *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar*, Saraçi, 2004, 138-139.
- Kadarë I., *Aprile spezzato*, Milano, Longanesi, 2008.
- Kadillari, A., *I Testimoni di Geova alla conquista dell'Albania*, in *Panorama*, 18 febbraio 2005 (trad. di Mandi Gueguen e Carlo Dall'Asta), Osservatorio dei Balcani, 5 marzo 2005.
- Kalendari Ortodoks, Tiranë, 2004, 5.
- Kaliçani R., *Historia e Bektashizmit si sekt mistik Islam*, Tiranë, Koha, 1999.
- Karal E.Z., *La transformation de la Turquie d'un empire oriental en un état moderne et national*, in *Cahiers d'histoire mondiale*, 4, 1958.
- Karandrea E., *Chiesa e Stato in Albania*, in Ferrari S., Cole Durham Jr. W., Sewell E.A. (a cura di), *Diritto e religione nell'Europa post-comunista*, Bologna, il Mulino, 2004.
- Kitromilides P., *Eleftherios Venizelos: The Trials of Statesmanship*, Edinburgh, University Press, 2008.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Civil, Ljgi, nr. 7850, 29 luglio 1994.
- Konomi G., *Mbi festat fetare*, Tiranë, M. Duri, 1967.
- Korelevskij C., *L'Uniatisme. Définition – Causes Effets – Étendue Dangers – Re- mèdes*, in *Irénikon*, 5-6, 1927.
- Korelevskij C., *L'Eparchia di Lungro nel 1921: relazione e note di viaggio*, a cura di S. Parenti, Rende (CS), Unical, 2011.
- Kujtim vepre dhe intige, Tiranë, Shtypshkronja, 1926.
- La Provincia francescana d'Albania dopo l'aprile 1939, in "Acta Ordinis minorum", (1939-1940), LVIII-LIX, (1941-1943), LX-LXII, (1944-1946), LXIII-LXV. Lariccia S., *Battaglie di libertà. Democrazia e diritti civili in Italia (1943-2011)*, Roma, Carocci, 2011
- Léonard E.G., *Storia del protestantesimo, Il declino e la rinascita*, vol. III.-I, Milano, il Saggiatore, 1971.
- Leung K.F., Liu W.T., *The Chinese Catholic Church in Conflict: 1949-2001*, Boca Raton, FL, Universal Publishers, 2004.
- Leuzzi V.A., Esposito G. (a cura di), *La Puglia dell'accoglienza: profughi, rifugiati e rimpatriati nel Novecento*, Bari, Progedit, 2006.
- Lewis B., *Gli ebrei nel mondo islamico*, Firenze, Sansoni, 1991.



- Llamazares Fernández D., *Derecho de la libertad de conciencia*, Madrid, Civitas Editiones S.L., 2007.
- Lloshi Xh., Të dhëna dokumentare të reja mbi V. Maksin, G. Gjirokastritin dhe K. Kristoforidhin, në *Studime Filologjike*, 1973/4, 1974/1-2.
- Lloshi Xh., *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Tiranë, Bota shqiptare, 2005.
- Lobello Q., *La libertà religiosa in Kosovo, ovvero un ossimoro "in fieri"*, in Cimbalo G., Botti F. (a cura di), *Libertà religiosa e diritti umani nell'Est Europa*, Bologna, Bononia University Press, 2008.
- Lombardi G., *Premesse al corso di diritto pubblico comparato. Problemi di metodo*, Milano, Giuffrè 1986.
- Lorecchio A., *Albania, memorandum per l'indipendenza albanese*, Roma, 1929.
- Lorecchio A., *Popoli e culture in dialogo tra il Danubio e l'Adriatico in D'Alessandri A., Genesin M. (a cura di), Contributi italiani al X Congresso internazionale dell'Association Internationale d'Études du Sud-Est Européen, Parigi, 24-26 shtatot 2009*, in *România Orientale*, 22, 2009, Roma, Bagatto Libri, 2009.
- Losano M.G., *L'ammodernamento giuridico della Turchia 1839-1926*, Milano, Unicopli, 1985.
- Luarasi A., *Akte Juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, Tiranë, SHBLU, 1999, 59-64.
- Lubogna F., *Feja në Shqipëri*, Tiranë, Drita, 1995.
- Lufi S., *Vatikan dhe Shqipëria*, in *Aa.Vv., Simposio internazionale, Tiranë 16-19 Novembre 1999*, Shkodër, 2000.
- Magri L., *Il sarto di Ulm*, Milano, il Saggiatore, 2009.
- Margiotta Broglio F., *Il fenomeno religioso nel sistema giuridico dell'Unione Europea*, in Margiotta Broglio F., Mirabelli C., Onida F. (a cura di), *Religioni e sistemi giuridici. Introduzione al Diritto Ecclesiastico Comparato*, Bologna, il Mulino, 2004.
- Margiotta Broglio F., Mirabelli C., Onida F. (a cura di), *Religioni e sistemi giuridici. Introduzione al Diritto Ecclesiastico Comparato*, Bologna, il Mulino, 2004.
- Markesinis B., *Comparative Law in the Courtroom and Classroom. The story of the Last Thirty-Five Years*, Oxford-Portland Oregon, Hart Publ., 2003, trad. it. *Il metodo della comparazione. Il retaggio del passato e le sfide del futuro*, Milano, Giuffrè, 2004.
- Maselli D., *Tra Risveglio e millennio*, Torino, Claudiana, 1974.

- Matran R. (sous la dir. de), *Histoire de l'Empire ottoman*, Paris, Fayard, 1989.
- Martucci D., (a cura di), *Il Kanun di Lek Dukagjin*, Nardò (Lecce), Besa, 2009.
- Mervin S., *L'Islam. Fondamenti e dottrine*, Milano, Bruno Mondadori, 2004.
- Metzler J., *Storia della Sacra Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli o de propaganda fide, Problemi attuali dell'evangelizzazione*, Roma, Pontificia Università urbaniana, 1975.
- Milkau H., Negri F., (a cura di), *Chiese e società: compiti e vocazione*, Torino, Claudiana, 2007.
- Ministero degli Affari Esteri, *Relazione sull'opera svolta dal Ministero degli affari esteri per la tutela delle comunità ebraiche (1938-1943)*, [Roma], s.e., [1945].
- Ministero per i beni e le attività culturali, Direzione generale per gli archivi, *L'unione fra l'Albania e l'Italia*, a cura di S. Trani, Roma, Pubblicazioni degli Archivi di Stato, Strumenti CLXXIII, 2007.
- Montanelli I., *Çështja fetare, Shqipëria një dhe njëmijë*, [Albania una e mille, trad. in albanese dell'edizione italiana ormai introvabile], Tiranë, 2005, ed. 55.
- Morozzo della Rocca R., *Albania. Le radici della crisi*, Milano, Guerini e Associati, 1997.
- Morozzo della Rocca R., *Nazione e religione in Albania*, Bologna, il Mulino, 1999.
- Mosca R., *Il regime internazionale del Danubio, la guerra e altri studi*, Società carpatodanubilana, Budapest, 1943.
- Nagy B., Marie J.J., *Pologne-Hongrie*, Paris, EDI, 1956.
- Nogaj D.N., *Kisha katolike Shqiptare 1944 nëntor 1990*, at. Gjergj Fishta, Shkodër, 1999.
- Odoardi G., *Frati minori conventuali*, in *Dizionario degli istituti di perfezione*, diretto da G. Pelliccia e G. Rocca, III, Roma, Edizioni Paoline, 1976.
- Onida F., *L'interesse della comparazione negli studi di Diritto Ecclesiastico, La legislazione ecclesiastica*, in *Atti del Congresso celebrativo del centenario delle leggi amministrative di unificazione*, Vicenza, ISAP, 1967.
- Ottaviani A., *Institutiones juris publici ecclesiastici*, II, Roma, Libreria Editrice Vaticana, 1936.
- Papadopoulos Th., *Geographical jurisdiction and hierarchy Ecumenical Patriarchate*, *Studies and Documents Relating to the*

History of the Greek Church and people under Turkish domination, "Bibliotheca Graeca Aevi Posterioris", Brussels, 1952.

Papastathis C.K., The Ecumenical Patriarchate and the International Administration of the Rum Millet in the Tanzimat Reform era (1839-1876) Orthodoxy and Ecumenical Gratitude Volume in Honour of Ecumenical Patriarch Bartolomaios I, Athens, Harmos Publications, 2001.

Papathomas G., Les différents modalités canoniques d'exercice de la juridiction du patriarcat œcuménique de Constantinople, in *Istina*, 4, 1995.

Papathomas G., Essai de bibliographie pour l'étude des questions de l'autocéphalie, de l'autonomie et de la diaspora, Katerini, Ed. Epektasis, 2000.

Papathomas G., Le Patriarcat œcuménique de Constantinople et le statut canonique de la "diaspora" orthodoxe de langue hellénique: le cas de la France, Atene, Editions Epektasis, 2001.

Pardo Prieto P.C., Laicidad y acuerdos del Estado, Valencia, Lib. Tirano Blanch S. L., 2007.

Parini Giap E., Richiedenti asilo e strutture di accoglienza in provincia di Lecce, in Cavazzani A. (a cura di), *Asylumisland: accoglienza ed inserimento socio-economico di rifugiati e richiedenti asilo nelle regioni del Sud Italia*, Soveria Mannelli, Rubbettino, 2005.

Pegoraro L., Rinella A., *Introducción al Derecho Publico Comparado*, Ciudad de Mexico, UNAM, 2006.

Peirone F.J., Rizzardi G., *La spiritualità islamica*, Roma, Studium, 1986.

Pepa S.P., *Martirizimi i Kishës katolike*, Shkodër, 1993.

Peri V., Chiesa romana e "rito greco", G.A. Santoro e la congregazione dei greci, Brescia, Paideia, 1975.

Peri V., La genesi storica dell'uniatismo, in *Oriente cristiano*, 37, 1997.

Pettifer J.E., Vickers M., *The Albanian question: reshaping the Balkans*, London, I.B. Tauris 2007.

Piras G., *Guida delle missioni cattoliche 1989*, Roma, Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli, 1989.

Piras G., *La Congregazione e il Collegio di propaganda fide di J.B. Vives, G. Leonardi e M. De Funes*, Roma, Università Gregoriana, 1976 ("Documenta missionaria", 10).

Pizzorusso A., *Sistemi giuridici comparati*, Milano, Giuffrè, 1995.

Pontificia Università Urbaniana, *Dizionario di missiologia*, I, Bologna, Dehoniane, 1993.

- Popovic A., *L'islam balkanique. Les musulmans du sud-est européen dans la période post-ottomane*, Berlin-Wiesbaden, Otto Harrassowitz, 1986.
- Popovic A., *Le confraternite sufi nella regione balcanica. Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo*, in Stepanyants M. (a cura di), *Il difficile equilibrio tra mistica e politica*, Torino, Centro di studi religiosi comparati Edoardo Agnelli, 2008.
- Poulton H., Taji-Farouki S. (eds.), *Muslim Identity and the Balkan State*, Washington Square 1997.
- Puto A., *La Communauté juive en Albanie avant e durant la Seconde guerre mondiale*, *The Jervis Communities of Southern Europe*, Thessalonica, I. K. Hassiotis, 1997.
- Puto A., *Piramidi Albania: chi c'è sotto la piramide?*, Osservatorio Balcani e Caucaso, 5 prill 2005.
- Puto A., *Lufta Italo-Greke Diktatorë e Kuisling, Tiranë, Toena*, 2011.
- Qytyku F., *Reforma agrare, revolucioni i parë ekonomik. Dokumenti gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë, nuk është botuar, por i konsultueshëm në: Aa.Vv., Historia e Shqipërisë, Tiranë, 1983.*
- Ramaj A., *Lazër Mjeda në arqipeshkvinë Shkup-Prizren mes 1909-1921 (Sipas arkivit Austriak, emërimi i tij, laramanizmi, largimi nga Prizreni)*.
- Rebichini A., *Chiesa, società e Stato in Cecoslovacchia, 1948-1968*, Padova, Ceseo Liviana, 1977.
- Reuter A., *Il Dicastero romano per le missioni e le sue riforme*, in Henkel W., *Ecclesiae memoria. Miscellanea in onore del R. P. Josef Metzler OMI, Prefetto dell'Archivio segreto vaticano*, Roma-Freiburg-Wien, Herder, 1991.
- Reuter A., *Congregazione per l'evangelizzazione dei popoli*, in Pontificia Università Urbaniana, *Dizionario di missiologia*, I, Bologna, Dehoniane, 1993.
- Rexhebi B., *Misticizma islame dhe bektashizma*, New York, Waldon Press, 1970.
- Roberti J.C., *Les Uniates*, Paris, Le Cerf, 1992.
- Rodoupolos P., *Territorial Jurisdiction according to Orthodox Canon Law, Territorialità e personalità nel diritto canonico ed ecclesiastico*, Budapest, 2002.
- Sacco R., *Sistemi giuridici comparati*, Torino, UTET, 2002, 2a ed.
- Sacra Congregazione di propaganda Fide, Guida delle missioni cattoliche*, Roma, Unione missionaria del clero in Italia, 1934.

Sacra Congregazione per le Chiese Orientali, Oriente cattolico. Cenni storici e statistiche, Città del Vaticano, Sacra Congregazione per le Chiese orientali, Città del Vaticano, 1974.

Sacrae Congregationis de Propaganda Fide, Memoria rerum. 350 anni a servizio delle missioni, 1622-1972, a cura di J. Metzler, voll. 3., Rom-Freiburg-Wien, Herder, 1971-1976.

Sadikaj D., Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist, Tiranë, 1972.

Sami A. Abu-Sahlieh, Il diritto islamico. Fondamenti, fonti, istituzioni, (ed. it. a cura di Marta Arena), Roma, Carocci, 2008.

Santillana D., Istituzioni di diritto musulmano malichita con riguardo anche al sistema shafita, Roma, Istituto per l'oriente, 1938.

Sarfatti M., La condizione degli ebrei in Albania fra il 1938 e il 1943. Il quadro generale, in Brazzo L., Sarfatti M. (a cura di), Gli ebrei in Albania sotto il fascismo. Una storia da ricostruire, Firenze, Giuntina, 2010.

Sarner H., Jakoel J., Jakoel F., The Jews of Albania, Boston, Brunswick Press, 1992.

Shahu A., Shteti komunist dhe Kisha katolike në Shqipëri (1945-1967), Simpozium ndërkombëtar, Tiranë 16-19 nëntor 1999.

Shefler G., Albanian Jews reject appointment of new chief rabbi, in The Jerusalem Post, 01.06.2011.

Shehu N., Donna e matrimonio in Albania. Profilo storico, Bari, Puglia grafica Sud, 1988.

SHEME U., Vepërtaria e klerit katolik (1945-1967), Tiranë, 2001.

Shilegu T., Lufta e klasave në Shqipëri 1948-1953, Tiranë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1985.

Siebert R.H., The Society of Jesus in Albania, in Albanian catholic bulletin, XIV, 1993.

Simoni Z., Persekutimi i Kishës katolike në Shqipëri 1944-1990, Shkodër, 1998.

Simoni Z., Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës, Shkodër, 2000.

Stahn C., The Law and Practice of International Territorial Administration, Versailles to Iraq and Beyond, Cambridge, Cambridge University Press, 2008.

Sufismo e confraternite nell'Islam contemporaneo Il difficile equilibrio tra mistica e politica, Torino, Fondazione Giovanni Agnelli, 2003.

- Tacchella L., *Le antiche sedi episcopali latine, greche e bulgare dell'Albania etnica e della Macedonia*, Milano, Seregni, 1990.
- Terzariol A., *Gli albanesi. La Sacra Congregazione per le Chiese orientali nel cinquantesimo della fondazione, 1917-1967*, Roma, Tipografia Italo-Orientale "San Nilo", 1969.
- Thirlwall N.H., *Islam in the Balkans. Religion and society between Europe and the Arab*, London, World, Hartus & C., 1993.
- Toçi T., *E drejta ndëshkimore (Il diritto penale)*, Shkodër, 1926.
- Tolomeo R., *La Santa Sede e il mondo danubiano-balcanico. Problemi nazionali e religiosi (1875-1921)*, Roma, La Fenice Edizioni, 1996.
- Tomori A.B., *Historia e bektashizmit*, in *Urtësia*, n. 3, Tiranë, 1994.
- Torres Gutiérrez A., *El desarrollo postconstitucional del derecho fundamental de libertad religiosa en España*, in *Revista de Estudios Políticos*, n. 120, 2003.
- Torres Gutiérrez A., *El derecho a la libertad de conciencia en Austria*, Dykynson, Madrid, 2006.
- Valentini G., *La famiglia nel diritto tradizionale albanese*, Città del Vaticano, Tip. poliglotta vaticana, 1945.
- Valentini G., *La legge delle montagne albanesi nelle relazioni della Missione volante (1880-1932)*, Firenze, Olschki, 1969 (*Studi albanesi, Studi e testi*, 3).
- Valentini G., *La Missione dei gesuiti e la cultura albanese*, in *Spiritualità*, XXVI, 2, 1975.
- Valentini G., *Istituzioni del mondo musulmano*, Einaudi, Torino, 1996.
- Vannutelli V., *L'Albania*, Roma, Tip. di M. Armanni, 1886.
- Varnier G.B., *Ordinamenti, religioni e tradizione nella nuova Albania*, in *Talamanca A., Ventura M. (a cura di), Scritti in onore di Giovanni Barberini*, Torino, Giappichelli, 2010.
- Ventura A., *L'Esoterismo islamico*, Roma, Atanor, 1981.
- Ventura A., *L'Islam sunnita nel periodo classico (VII-XVI secolo)*, in *Filoramo G. (a cura di), Storia delle religioni*, vol. 3, Bari, Laterza, 1995.
- Vinciguerra S. (a cura di), *Il Codice Penale della Repubblica d'Albania*, Padova, Cedam, 2008, con contributi di E.R. Belfiore, M. Bertoli, D. Fondaroli, G. Fornasari, A. Manna, M. Pelissero, P. Pittaro, A. Rossi.
- Villari S., *Le Consuetudini giuridiche dell'Albania*, nel *Kanun di Lek Dukagjini*, Roma, Società ed. del Libro Italiano, 1940.
- Villari G., *Il sistema di occupazione fascista in Albania*, in *Brazzo L., Sarfatti M. (a cura di), Gli ebrei in Albania sotto il fascismo. Una storia da ricostruire*, Firenze, Giuntina, 2010.

Vokopola F., Edukimi fetar dhe moral i njeriut të vitit, Tiranë, 1942.  
Zanarini M., La rivoluzione ungherese, Bologna, Arianna, 2008.  
Zekiyani B.L., Potere e minoranze, il sistema dei millet, 2007.  
Zurcher E.J., Storia della Turchia, dalla fine dell'Impero ottomano ai  
giorni nostri, Roma, Donzelli, 2007.